

ENVER HOXHA

VEPRA

64

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

64

MARS 1978

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1989

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 64-T

Vëllimi i 64-t përmban materiale të muajit mars 1978. Këto janë fjalime e biseda që udhëheqësi i dashur e i paharruar i Partisë dhe i popullit tonë, shoku Enver Hoxha, bëri me popullin në rrethet Gjirokastrë e Sarandë. Gjatë rrugës për në këto dy rrethe, ai u ndal edhe në Fier e në Tepelenë, ku bisedoi me kuadro drejtues. Me këto biseda hapet edhe vëllimi.

Vizitat në rrethe të ndryshme të vendit, bisedat gju më gju me popullin, ishin metodë e përhershme pune e shokut Enver Hoxha gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Por Gjirokastra, qyteti i vet i lindjes, i ngjallte atij emocione të veçanta sa herë që e vizitonte. Kalaja e lashtë e shtëpitë e gurta, rrugët e sokaqet e kalldrëmta, çdo gjë e këtij qyteti-muze ishin sa të njohura aq edhe të dashura për birin e shtrenjtë të saj e të të gjithë Shqipërisë. Sa herë shkonte në vendlindje, ai dëshironte të shëtiste sa më shumë nëpër lagjet e qytetit, të takohej e të bisedonte me të gjithë, me anetë e moshatarët e vet tashmë të thijnur, me bijtë e me bijat e tyre, që derdhin djersën në qendra pune e prodhimi, me kalamanët e shëndetshëm e të qeshur, që ai nuk i ndante kurrë nga vetja. I thellë e i papërmbajtur ishte edhe gëzimi i gjirokastritëve për ta parë e për ta takuar udhëheqësin e shtrenjtë, për t'i shtrënguar dorën e për

t'u përshëndoshur me të. Ndonëse nga vitet e fëmijërisë kishin kaluar dekada të tëra, ai i thërriste me emër bashkëqytetarët e vet, të cilëve u tregonte ngjarje dhe episode të viteve të shkuara, që i mbante mend aq mirë, dhe gjallëronte e ngazëllente njerëzit e thjeshtë, aq të dashur e të respektuar për të.

Midis popullit, në mbledhje e biseda me kuadro, në mitingje e takime spontane, ku grumbulloheshin qindra e mijëra njerëz, ai këmbente mendime e këshillohej me masat, interesohej për hallet e problemet e tyre, jepte porosi të çmuara që kishin vlerë të madhe jo vetëm për ata që e takonin dhe e dëgjonin, por për gjithë popullin e Partinë. Ky kujdes e interesim i vazhdueshëm për problemet e bazës e për njerëzit e thjeshtë, si dhe pritja shumë e ngrohtë dhe entuziaste e popullit në takime e në biseda, ishin shprehje konkrete e atij uniteti të pathyeshëm Parti-popull, sepse, siç theksoi shoku Enver Hoxha në takimin me kuadro të rrethit të Gjirokastrës, «populli dhe Partia janë thesaret më të mëdha».

Në materialet që përfshin ky vëllim bie në sy kujdesi që tregonte shoku Enver Hoxha për njohjen dhe për zhvillimin e traditave luftarake të popullit tonë, që, siç nënvizon ai, është një popull plot vitalitet, i kalitur gjatë historisë së tij shekullore, në luftëra të lavdishme, me shpatë e me penë, që e bëri atë t'u rezistojë invadimeve të panumërta, të mbronte e të zhvillonte zakonet, gjuhën e kulturën e tij të lashtë, që rrezatonte edhe në kulturat e vendeve të tjera. Këto tradita të mrekullueshme të popullit tonë, porosit ai, t'i njohim në mënyrë të gjithanshme, t'i ruajmë e t'i zhvillojmë

më tej, se ato janë me vlera të jashtëzakonshme për edukimin patriotik e revolucionar të masave dhe veçanërisht të brezit të ri. Këtë ai e quante një detyrë të rëndësishme për të sotmen e për të ardhmen e vendit tonë dhe theksonte që Partia dhe organizatat e masave, baballarët e nënat, t'i mësojnë vajzat e djemtë të jenë trima, të guximshëm, me pikëpamje të reja për Shqipërinë socialiste, të gatshëm për të shkuar kudo ku ka nevojë atdheu, për vazhdimin me sukses të revolucionit në vendin tonë.

Në takimet me kuadro e me punonjës të rretheve Fier, Tepelenë, Gjirokastër e Sarandë, kujdes të veçantë tregoi shoku Enver për zhvillimin e bujqësisë, të blegtorisë, të pemëtarisë, të ullinjve e të agrumeve. Në bisedat dhe fjalimet e tij për këta sektorë gjen këshilla të vlefshme për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për vlerësimin e drejtë të pemëtarisë, për përvetësimin e shkencës e të teknikës etj. «Detyrat që shtron Partia, për sot e për të ardhmen, thuhet në vëllim, nuk mund të realizohen pa thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, pa zotërimin e shkencës e të teknikës nga masat punonjëse».

Vëmendje të posaçme i kushton shoku Enver Hoxha në këto biseda e fjalime forcimit të rolit udhëheqës të Partisë, duke e vënë theksin në forcimin e rolit pararojë të çdo komunisti. Anëtarët e Partisë vë në dukje ai, kudo që rrojnë e punojnë, duhet ta zgjerojnë këndin e shikimit të tyre. Puna e tyre nuk mbaron vetëm me plotësimin e detyrave që u janë caktuar. Komunisti ka për detyrë të udhëheqë popullin, klasën, në rrugë të pashkelura, të gjejë zgjidhjen e problemeve të sotme

e të së ardhmes. Dhe faktor vendimtar për arritjen e të gjithë objektivave, theksohet në vëllim, është njeriu ynë. Për këtë Partisë dhe levave të saj, u kërkohet të bëjnë një punë të diferencuar me njerëzit, të mos i konsiderojnë të gjithë në një nivel, të mos mendojnë se ndjenjat, aspiratat, dëshirat e tyre janë të prera si me thikë dhe se edukimi është për të gjithë njëlloj, pra njerëzit të merren ashtu siç janë e të punohet që të bëhen siç duhet të jenë.

Edhe pse ky vëllim përfshin materiale të dy javëve, ka një tematikë të gjerë. Fjalimet dhe bisedat dallohen për problematikën e ndryshme që trajtojnë. Në çdo takim me kuadro e punonjës, udhëheqësi i Partisë ka shtruar probleme të rëndësishme, ka evidencuar detyra që u përgjigjen auditorit, aktualitetit dhe perspektivës.

Problemet dhe detyrat që shtrohen në materialet e këtij vëllimi për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, kulturor, politik e shoqëror, janë të pandara nga gjendja ndërkombëtare. Duke trajtuar çështje të politikës së brendshme, shoku Enver ndalet edhe në politikën e jashtme të Partisë sonë, që është një politikë e mbrojtjes së lirisë e të të drejtave të vendit tonë, politikë e parimeve proletare e internacionaliste. Siç thekson në fjalimin që mbajti në mitingun e Grapshit, me popullin e minoritetit grek të Dropullit, ajo është politikë e miqësisë dhe e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera, sipas parimeve të barazisë e të respektit reciprok, të respektimit të integritetit tokësor, të sovranitetit e të pavarësisë kombëtare, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit e të leverdisë së dyanshme. Në

fjalime e biseda të këtij vëllimi trajtohen edhe probleme të tjera të gjendjes ndërkombëtare, të luftës së popujve e të proletariatit kundër shtypjes e shfrytëzimit nga ana e dy superfuqive, kundër revizionizmit modern e reaksionit.

Në përmbajtjen e materialeve, gjithashtu, duken qartë kultura e gjerë e shokut Enver Hoxha, aftësia e tij e veçantë për të komunikuar me njerëz të moshave e të profesioneve të ndryshme, që nga bujq e blegtorë e deri tek arkeologë, që nga nxënës të shkollës e deri te veteranë.

Mësimet, këshillat e porositë shumë të çmuara të këtyre fjalimeve e bisedave të shokut Enver Hoxha kanë edhe sot e në të ardhmen një vlerë të madhe e përbëjnë një program të gjerë pune për gjithë popullin e Partinë. Ato janë një ndihmë e çmuar për komunistët, kuadrot e gjithë punonjësit për të përballuar me sukses detyrat në të gjitha fushat e ndërtimit socialist e të forcimit të fuqisë mbrojtëse të atdheut.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

PER REALIZIMIN E PLANEVE KERKOHEN ORGANIZIM DHE KONTROLL I VAZHDUESHEM

*Nga biseda me kuadro kryesorë të organeve
të Partisë, të pushtetit e të organizatave
të masave të rrethit të Fierit*

14 mars 1978

Mendova që gjatë udhëtimit për në Gjirokastrë, të ndalesha vetëm për pak orë, edhe këtu, në qytetin tuaj, për të shkëmbyer ndonjë mendim së toku. Në fillim do të jetë interesante për mua të dëgjoj shokët drejtues të Partisë të rrethit tuaj. Do të doja, shkurtimisht, të më jepej një pasqyrë e gjendjes së këtushme, sido që jam në korent të punës në rreth dhe të problemeve që ju preokupojnë.

Udhëheqjen e Partisë sonë, vazhdimisht, si për çdo rreth të vendit, edhe për rrethin e Fierit e kanë preokupuar dhe e preokupojnë të gjitha çështjet e Partisë dhe të pushtetit. Për to në mbledhje të ndryshme, ne kemi diskutuar e kemi rrahur mendime por, kur piqemi e shihemi sy më sy me njëri-tjetrin, më duket sikur flasim më shtruar e më hapur, dhe, siç thonë në Mallakastër, «nga një fjalë, nga një halë». Në punë,

natyrisht, kemi suksese, por kemi edhe të meta dhe këto duhet t'i vëmë në dukje. Prandaj, ç'mendime e vërejtje kemi për njëri-tjetrin do t'i themi, pse nga kjo, as neve nuk na vjen keq, as juve nuk ju vjen keq, përkundrazi na vjen mirë se të tëra janë për të mirën e punës.

Shoqen sekretare të parë të komitetit të Partisë të rrethit¹ e kemi dëgjuar shumë herë në mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror, kurse shokun Ligor², natyrisht, e kemi dëgjuar më pak. Ligori është dëgjuar për mirë, por atë ju do ta njihni tani edhe më mirë në punë. Partia do ta ndihmojë Ligorin, por edhe vetë ai duhet të punojë pa u lodhur për t'ju dhënë juve sidomos përvojën e kooperativave të Korçës, se shkëmbimi i përvojës ka rëndësi të madhe për punën.

Tani le të dëgjojmë shoqen Naunka, e cila do të na informojë shkurtimisht për gjendjen në Fier. Unë mendoj të rrimë siç jemi, ulur e të bisedojmë, pse kështu, sikur flasim më çpenguar.

Pasi shoqja Naunka Bozo informoi për rezultatet e arritura në sektorë të ndryshëm të ekonomisë të rrethit të Fierit, në bisedë morën pjesë edhe shokë të tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po kooperativa e Strumës si i ka punët? A i realizon detyrat e planit?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Kjo kooperativë ka

1. Naunka Bozo.

2. Ligor Çifligu, në atë kohë, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Fierit.

dy-tre vjet që ka bërë kthesë; veçanërisht në drithërat e bukës ka rezultate të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këto anë ka qenë dhe babai im. Më kujtohet një këngë që ai, megjithëse vetë ishte mysliman, i këndonte myzeqarçe shën Mërisë së Strumës.

SHOQJA NAUNKA BOZO: Organizata e Partisë në sektorin e naftës po punon më mirë për kryerjen e detyrave dhe çrrënjosjen e mbeturinave të veprimtarisë armiqësore.

SHOKU ENVER HOXHA: A u vunë në punë të katër sondat? Ku është sekretari i parë i komitetit të Partisë për rajonin e Patosit?

SHOKU MIHAL STEFANI: Këtu jam, shoku Enver. Të katër sondat do të vihen në punë në fund të muajit gusht.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë në fund të gushtit thua ti. Po mirë, se ju e kishit parashikuar këtë punë për një kohë shumë më të gjatë, deri në fund të vitit, «lungo-lungo», siç thotë italiani.

SHOKU MIHAL STEFANI: I tillë erdhi plani nga ministria.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ju ku ishit? Ministrisë i duhej thënë mendimi juaj: «Kjo duhet bërë me doemos!». Klasa punëtore, siç i thonë një fjale, duhet t'ia vërë këmbët në një këpucë edhe ministrisë, po qe nevoja. Kur ju mund ta bënit këtë punë në gusht, pse nuk i kundërshtuat ministrisë? Kjo do të thotë se edhe juve ju erdhi mirë dhe ishit dakord me afatin që caktoan drejtuesit e dikasterit, ndryshe s'ka si shpjegohet.

Po në pusin B si paraqitet gjendja?

SHOKU KOLI XHAXHO¹: Është në përvetësim, shoku Enver. Kemi arritur në thellësinë 3 200 metra.

SHOKU ENVER HOXHA: Deri në sa metra thellësi do të shkoni?

SHOKU KOLI XHAXHO: Kanë mbetur akoma edhe nja 200 metra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në zonën C është arritur kjo thellësi?

SHOKU KOLI XHAXHO: Kjo zonë ka tjetër strukturë, shoku Enver. Presupozohet të jetë një strukturë më vete.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, te pusi B, për të cilin po flasim, ne kemi filluar shfrytëzimin e shtresës së parë të gëlqerorëve.

Tani desha të di se çfarë jep shtresa e parë e gëlqerorëve në zonën C?

SHOKU HYSNI FRAKULLA²: Kjo shtresë na jep po ato shenja si pusi B. Ne po punojmë të kalojmë në shtresat më të vjetra të gëlqerorëve. Deri tani, në vendin tonë, vetëm dy puse janë shpuar në këtë shtresë.

SHOQJA NAUNKA BOZO: Në këtë pus, shoku Enver, kemi pasur shumë avari.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëni kujdes të madh e ruhuni nga avaritë!

SHOQJA NAUNKA BOZO: Është pozitive që Instituti i Naftës po paraprin me studime dhe tashti, ky institut, punon për llogari të vitit 1979.

1. Në atë kohë, sekretar i parë i komitetit të Partisë të rajonit të Ballshit.

2. Në atë kohë sekretar i komitetit të Partisë të rajonit të Patosit.

SHOKU ENVER HOXHA: A vërtetohen të dhënat e Institutit të Naftës, kur shpohet, apo jo? Të mos flasim në vija të përgjithshme, por konkretisht.

SHOKU HYSNI FRAKULLA: Këtë vit nga vendburimet e studimet del se kemi një përputhje të plotë me projektin.

SHOKU ENVER HOXHA: Shoqja Naunka, si u pa në aktiv çështja e planit të këtij viti? A pati optimizëm dhe besim nga shokët kryesorë të Partisë, që ishin të deleguar në këtë aktiv, se do të realizohet ky plan dhe do të mbulohen një pjesë e deficiteve që keni pasur? A u rrahën mendime për këto gjëra? Pra, si u diskutua, me bindje të plotë e me zjarr, apo sa për të kaluar radhën?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Ne, para se të mblihdeshim në aktiv, e diskutuam planin në bazë. Shokët folën me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, u thelluan në shkaqet e dobësive e të metave që penguan realizimin e planit dhe bënë autokritikë për deficitet që iu krijuan ekonomisë.

Shumë diskutantë sollën në aktiv përvojën pozitive për të krijuar bindjen që ne i kemi mundësitë në rrethin tonë për ta realizuar këtë plan. Vitin e kaluar në disa zona, ne morëm mbi 40 kuintalë grurë për hektar. Pra, ekzistojnë mundësi të mëdha që ta realizojmë planin edhe këtë vit.

SHOKU ENVER HOXHA: Moti vitin e kaluar nuk ka qenë aq i favorshëm për bujqësinë, megjithatë, fakti që janë marrë nga 40 kuintalë grurë për hektar, në disa zona, tregon se rendimenti i tij varet shumë nga puna e njerëzve. Nuk mund të themi që kushtet

atmosferike nuk kanë asnjë efekt në prodhimet bujqësore. Jo, edhe ato ndikojnë për mirë ose për keq. Por, problemi shtrohet që kushtet atmosferike jo aq të favorshme t'i përballojmë në një shkallë sa më të madhe. Kjo arrihet me një punë të kujdesshme e të organizuar mirë, e cila bën të mundur që, edhe në të tilla kushte, të merren mbi 40 quintalë grurë për hektar në një sipërfaqe prej 2 000 hektarësh.

Po pse të kenë disa kooperativa rendimente më të larta se disa të tjera? Ç'i bën ato të dallohen?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Në radhë të parë se organizimi i punës në ato kooperativa ka qenë më i mirë. Përveç kësaj, investimet që duheshin bërë për bimët, u bënë në kohën e duhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë e kuptoj këtë gjë, po dua të di një mendim, si të thuash, më konkret, pra, pse ndodh që direktivat, orientimet kuptohen e zbatohen më mirë në ato ekonomi? Cilat janë arsytet e përgjithshme që i çojnë ato më përpara se të tjerat? Është çështja se njerëzit në kooperativa të tilla janë më luftarakë apo se niveli i kulturës është më i lartë?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Nga bisedat që kemi pasur me njerëzit e bazës del se duhet të rritet roli drejtues i kuadrove.

SHOKU ENVER HOXHA: Tashti të dëgjojmë pak Ligorin.

Ti, Ligor, a mund të na bësh një konfrontim të përvojës së punës në Fier me atë të Korçës? Por shiko se unë e njoh Korçën, prandaj as mos na e mburr, as mos na e ul. Ti ke punuar në Korçë dhe e njeh mentalitetin, kapacitetin dhe ngritjen politike të fshatarit të

Korçës. Këtu, në Fier, ke shumë pak kohë. Por, dhe për kaq pak kohë sa ke, mund të na bësh një krahasim, pra, të vësh në dukje shkurtimisht se cilat janë anët pozitive dhe negative të punës atje, në Korçë, dhe cilat janë këtu, në Myzeqe.

SHOKU LIGOR ÇIFLIGU: Për sa u përket kushteve tokësore për bujqësinë, rrethi i Fierit i ka më të mira sesa rrethi i Korçës, flas në përgjithësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, më të mira janë kushtet këtu se në Gorë, në Opar e Panarit. Edhe Fieri ka malësi, si, për shembull, atë të Mallakastrës, por klima aty është më e ëmbël se në fshatrat malore të Korçës.

SHOKU LIGOR ÇIFLIGU: Kam mendimin se punë më me cilësi bëhet nga kooperativistët e rrethit të Korçës, sesa nga këta të kooperativave të fushës së Fierit. Ta nisësh që nga veglat e punës: ndryshe është shati i devolliut dhe i fusharakut të Korçës, si nga gjatësia e bishtit dhe nga gjerësia e tij; por edhe nga goditja përdorimi i tij është më i mirë atje. Pra, në drejtim të cilësisë së punës me krah atje bëhet një punë e mirë, domethënë, siç i themi ne në Korçë, puna bëhet më e tapinjatur.

SHOKU ENVER HOXHA: I është futur në gjak një punë e tillë devolliut apo fusharakut të Korçës; ai nuk bën dot ndryshe.

SHOKU LIGOR ÇIFLIGU: Në përgjithësi atje ndiqet më me kujdes gjithë procesi i punës në bujqësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk e ekzagjeron! Kështu është në përgjithësi, por sidomos dallohet fusha e Korçës dhe e Devollit.

SHOKU LIGOR ÇIFLIGU: Ka edhe një gjë tjetër. Në qoftë se planifikohen t'i bëhen dy apo tri prashitje bimës atje, në realitet i bëhen katër. Kurse këtu vëmë re një fenomen tjetër. Puna nuk ecën mirë sidomos në bimët prashitëse, të cilave shërbimet nuk u bëhen mirë dhe me kohë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo gjë, pra kryerja e shërbimeve dhe e punimeve në bujqësi në kohë në rrethin e Korçës, në afatin që caktohet, i pati rënë në sy edhe një komunisti të vjetër francez, i cili para disa vjetësh kishte ardhur për një vizitë në vendin tonë. Unë e ftova dhe për darkë ku biseduam një copë herë së toku. Quhej Monmuso¹ dhe ishte një komunist i vërtetë. Ka shkruar dhe një libër të bukur për Shqipërinë. Tani ka disa kohë që ka vdekur.

Gjatë qëndrimit të tij në vendin tonë, Monmuso, pati rastin të vizitonte Korçën në kohën e vjeljes së rrushit. Kur u kthye e pyeta: E, si t'u duk Korça? Ai ma mburri, tha plot fjalë të mira për vendin dhe për njerëzit atje. Ky vetë ishte nga Shampanja, që besoj se e keni dëgjuar si një krahinë që nxjerr atë verën e mirë që në Francë ka marrë emrin e krahinës, «Shampanjë». Natyrisht, Shampanja prodhon rrush shumë të mirë, me famë; kështu që ai i njihte mirë llojet e rrushit dhe cilësitë e tyre. Nga Korça, siç thashë, ai u kthye shumë i kënaqur. «Nga të katër anët ku kishte vreshta njerëzit ishin mobilizuar për ta vjelur rrushin dhe për ta transportuar shpejt e pa e dëmtuar. Të dukej sikur

1. Gaston Monmuso, autor i librit «Baba Tomori», me përshtypje nga Shqipëria.

të gjithë ishin në festë gjatë kësaj fushate», më tha ai.

Po më gëzon që të pëlqeu mobilizimi i njerëzve, i thashë. Po vera e Korçës a të pëlqeu, e pyeta unë. «Jo, m'u përgjigj, vera e atjeshme ishte si uthull, se klima e Korçës nuk është e përshtatshme për pjekjen dhe për ëmbëlsimin e rrushit. Se cilësia e verës varet shumë nga lloji dhe shkalla e pjekjes së rrushit, pra edhe nga klima e vendit të vreshtit. Pastaj, rëndësi ka dhe përzierja. Nuk mund të futen të gjitha llojet e rrushit në një vend. Një lloj rrushi piqet më shpejt, një lloj tjetër piqet më vonë. Kjo duhet pasur mirë parasysh për verën», përfundoi ai.

Ju fola për këtë rast për të theksuar ato që tha Ligori, se korrja, shirja, grumbullimi, kjo apo ajo fushatë ose edhe çfarëdo pune tjetër në bujqësi duhet të bëhen të studiuar, me kujdes dhe në kohën e duhur.

SHOQJA NAUNKA BOZO: Këtë vit, shoku Enver, shohim se ka kudo një mobilizim të madh në punë, gjë që u vu re dhe në përfundimin e mbjelljes së lulëdellit brenda muajit shkurt. Po këtë vit do të vëmë nën ujë edhe 600 hektarë të tjerë tokë nga rezervuari i Lumarës.

SHOKU ENVER HOXHA: Më kujtohet, shoqja Naunka, koha kur ti ke qenë kryetare kooperative, domethënë atëherë kur unë nuk kisha akoma leshra të bardha në kokë. Kaluam nga Mallakastra dhe vendosëm ta ujitnim gjithë atë zonë. Bile, për këtë thirrëm edhe një inxhinier, i cili na solli hartat e na përcaktoi se ku do bëheshin rezervuarët. Ne diskutuam e vendosëm edhe se ç'fidanë do të mbilleshin në Mallakastër. U caktua se cilat toka ishin të përshtatshme për ulli-

rin, për fiqtë etj. Mirëpo, puna nuk eci. Ju edhe sot e kësaj dite jeni prapa me këtë punë. Ne parashikonim që Mallakastra të bëhej me të vërtetë një zonë jashtë-zakonisht pjellore, sidomos për sa i përket pemëtarisë e veçanërisht ullirit, fiqve etj. Po tani, po punohet atje?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Po punohet, por këtë vit jemi prapa me planin. Për zonën e Mallakastrës na preokupon shumë edhe sistemimi i tokave.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe për sistemimin e tokave kërkohet kujdes i madh, por, njëkohësisht, edhe për kullimin e tyre. Të kihet parasysh që toka në këtë zonë, në Mallakastër, nuk është si ajo e Semanit, prandaj duhet gjetur mënyra e sistemimit më të përshtatshëm të saj që ujët apo shiu të mos e gërryejë e të mos e prishë. Për këtë arsye, këtij problemi i duhet kushtuar një vëmendje e madhe nga inxhinierët e ujërave dhe nga agronomët e kësaj zone. Po puna me fidanishtet si shkon?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Kemi një ndërmarrje bujqësore të specializuar vetëm për rritjen e fidanëve të drurëve frutorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po a u bëhen shërbimet fidanëve apo «i merr lumi» si ullinjtë e Tiranës që kanë 20 vjet që janë mbjellë e s'po japin prodhim akoma?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Në përgjithësi u shërbehet mirë. Ca janë në prodhim e ca në rritje.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë për informimin, shoqja Naunka. Desha të pyes për kulturën, si punohet këtu?

SHOQJA NAUNKA BOZO: Edhe për kulturën

punohet. Përveç grupeve profesioniste të teatrit e të estradës është punuar për të gjallëruar edhe grupet amatore artistike në ndërmarrje, kooperativa bujqësore etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Sikur e dija se këtë përgjigje do të merrja. Për sa u përket aktiviteteve kulturore-artistike, nga grupet profesioniste apo amatore, nuk kam asnjë dyshim që ato bëhen mirë, se i kam parë e i kam dëgjuar edhe vetë në televizor dhe më kanë pëlqyer shumë. Por, kur flasim për kulturën nuk flasim vetëm për artin e të mos shkojmë më tutje sesa organizimi i aktiviteteve artistike. Jo. Kultura është një fushë me një diapazon shumë të gjerë, prandaj edhe kuadrot drejtues të Partisë duhet ta konceptojnë më thellë këtë punë. Kulturës i shërben, për shembull, edhe puna që duhet bërë me njerëzit që ata të njohin mirë historikun e fshatit apo të krahinës së tyre. Këtu nuk është fjala për një njohje të thjeshtë të historikut të këtij populli që ka luftuar e ka vuajtur, por për një njohje me rrënjë, si i thonë fjalës, të historisë e të traditave përparimtare të popullit, të psikologjisë së tij, të luftës e të vuajtjeve të tij. Po vallë, meqë mora si shembull këtë çështje, a punohet si duhet në këtë drejtim? A e njihni ju gjendjen? Të mos harrojmë, shokë, që në qoftë se nuk i njohim mirë të gjitha këto që thashë, është e zorshme të dimë e të zbatojmë si duhet vijën e Partisë në rrethe e në krahina të ndryshme.

Ne themi se ekzistojnë mbeturina të së kaluarës, të huaja për shoqërinë tonë. Por këto mbeturina nuk ekzistojnë kudo njëlloj; në disa qytete apo fshatra ato

janë më të theksuara, në disa të tjera më pak të theksuara. Po pse ndodh kështu? Sepse edhe në të kaluarën kanë ekzistuar ndryshime midis krahinave, ndryshime në zhvillimin e luftës së klasave e në drejtime të tjera: një krahinë, fjala vjen, ka luftuar më tepër në një moment; një krahinë tjetër ka qëndruar pak më prapa. Dhe, kur themi pak më prapa, me këtë kuptojmë që në atë krahinë shtypja ka qenë më e madhe.

Pastaj të ndalemi te çështja se kush e ka shtypur popullin e kësaj apo të asaj krahine? Pse, nuk ka në këtë krahinë njerëz të mësuar, njerëz që kanë mbaruar universitetin për ta studiuar këtë problem? Ka, dhe bile ka shumë. Këta njerëz duhet të bëjnë studime, jo të shkruajnë vetëm për ndonjë ngjarje që atyre u ka lënë mbresa, por të studiojnë se si është zhvilluar, për shembull, feudalizmi në rrethin tuaj, se këtu ka qenë qendra e feudalizmit. A ka bërë ndonjëri nga njerëzit e arsimuar këtu, një analizë konkrete apo studim për ata feudalë të njohur që kanë shtypur e kanë lënë në mjerim këtë popull? A është studiuar për të ditur se si ky popull i shtypur ka ngritur krye kundër tyre, për të njohur se ç'metoda ka përdorur populli në luftë e çfarë metodash ka përdorur armiku kundër tij; për të njohur se cilët janë heronjtë, figurat e shquara të lëvizjes së fshatarësisë sonë që ka luftuar kundër këtyre feudalëve e satrapëve?

Me kalimin e kohës, nga fundi i shekullit të 19-të dhe nga fillimi i shekullit të 20-të ndodhën ndryshime në fushën ekonomike e shoqërore që ndikuan dhe në strukturën klasore të vendit. Me dobësimin e pronës së tyre, feudalët filluan ta humbasin bazën e mëparshme

ekonomike. Mirëpo, dobësimi i fuqisë ekonomike të feudalëve shkaktoi edhe dobësimin e fuqisë politike të tyre, kuptohet, deri në njëfarë shkalle. Po kush filloi të fuqizohej, populli? Jo. Filluan të fuqizohen bejlerët, çifligarët, zotëruesit e fondit kryesor të tokës. Studiuesi këtu duhet të ndalet e të shikojë: cilët ishin çifligarët që trashëguan metodat e feudalëve Vriomas me shokë dhe iu adaptuan disa momenteve që ndryshonin nga periudha kur fuqinë e kishin në dorë Aziz Vrioni, Kahreman Vrioni dhe të tjerë si këta? Po këta çifligarë nga ishin dhe çfarë origjine kishin? Këta ishin tregtarë, që ua blenë çifligjet bejlerëve.

Kështu erdhi periudha e lindjes dhe e fuqizimit të një borgjezie tregtare e uzurare¹, e cila ua kufizoi pasurinë këtyre feudalëve. Mjaft nga këta çifligarë ishin gjirokastritë, por kishte dhe nga krahina të tjera të vendit. Populli përsëri shtypej e shfrytëzohej, por tani rezistenca e tij kundër tyre ishte më e madhe. Këta çifligarë kishin nga dy, nga tre e nga katër çifligje të tyre. Për shembull, Hashoja² Libofshën e kishte çiflig të tij, të cilin ia jepte në pronësi një djali që kishte mbaruar universitetin, por që do të merrte për grua çupën e tij.

Pse fola për këto gjëra? Fola sepse më duket që kjo është një çështje me rëndësi. Studiuesit, kur shkruajnë historikun e fshatrave, nuk duhet të kufizohen vetëm në periudhën e lavdishme të Luftës Nacionalçli-

1. Nga fjala e vjetër uzurë: kamatë që merrej mbi paratë e dhëna borxh, interes.

2. Ali Hasho.

rimtare. Këta njerëz me kulturë duhet t'i futen thellë së kaluarës. Ky është problemi kryesor i zhvillimit dialektik materialist të historisë, i luftës së klasave që ngriti masat e popullit tonë në këmbë, derisa shpërtheu revolucionin.

Nëpër rrethe, ku aktualisht kemi një bazë të shëndoshë kuadrosh, një armatë të tërë mësuesish, ne nuk i orientojmë si duhet këta që t'i futen punës e të bëjnë studime për zhvillimin e përgjithshëm të historisë dhe të kulturës, por i lëmë të merren vetëm me punët e profilit të ngushtë të tyre dhe nuk u hapim perspektiva që të shohin më tej. Por një gjë e tillë ka rëndësi të madhe, se shikimi më tej i problemeve të kulturës të jep një situatë më të qartë, të jep «brumë», me të cilin do të zësh «bukën», të shikosh se çfarë «mielli» është, dhe këtë «miell» ta kalosh në një «sitë», në dy apo në tri «sita». Këtu e kam fjalën për atë edukatë politike dhe atë përgatitje ideologjike të shëndoshë, që u jep mundësi këtyre njerëzve për ta parë e për ta trajtuar këtë problem në prizmin e materializmit dialektik e historik.

Njohja e historisë së popullit, e traditave dhe e psikologjisë së tij ka rëndësi të veçantë për punën tonë. Tokën ku do të mbjellësh, duhet ta njohësh më parë, që të dish se ç'lloj është, që të dish se ç'shërbime duhet t'i bësh për të pasur prodhime të mira. Ti mund ta hedhësh farën dhe fara nuk do të rrijë pa mbirë. Por, në rast se nuk do t'ia bësh të gjitha shërbimet agroteknike bima nuk do të rritet siç e kërkon ti; në çoftë se tokës, ku do të hedhësh farën nuk ia njeh strukturën, atëherë, megjithëse do t'ia bësh të gjitha shër-

bimet agroteknike, rezultati nuk do të jetë ai që dëshiron. Mund ta bëjmë një krahasim të tillë? Si thoni, është kështu apo jo?

Ose, të shikojmë përgatitjen e hartave pedologjike. Pse i bëjmë këto harta? Këto i bëjmë që të njohim strukturën e tokës. Shoqja sekretare e parë, që është edhe agronome e lartë, i di këto gjëra shumë mirë. Ajo e të tërë ju keni qeder për këto probleme. Ja, sapo na tha këtu që do të bëjmë këtë e atë për sistemin e tokës. Mirëpo, që ta bëjmë sistemin duhet ta njohim më parë vetë tokën, se ndryshe do të gabojmë.

I bëra këto krahasime për të treguar se sa e rëndësishme është njohja e historisë, e zakoneve, e shpirtit, e traditave të popullit, si ka qenë në të kaluarën, ç'përparim ka bërë sot etj., etj. Një gjë e tillë do t'u shërbejë Partisë e kuadrove tanë për një drejtim më të mirë të sektorëve që drejtojnë dhe për të bërë një punë më të diferencuar me njerëzit. Kjo, gjithashtu, do të bëjë që puna jonë politike me konferenca, me leksione, me mbledhje, me aktive, me sesione shkencore, me këngë e valle etj., të zërë vend më mirë, t'i qartësojë njerëzit për detyrat që kanë e të ngrejë më lart nivelin e tyre kulturor.

Ballafaqimi i së kaluarës me të sotmen në këtë mënyrë do të japë fryte më shumë. Duhet t'i themi shokut që s'del në punë, ose që nuk realizon normën: «Puno, se na duhet akoma shumë punë për të ecur gjithmonë përpara, mos u vetëkënaq me këto që ke arritur. Ti kënaqesh, sepse me të vërtetë ke bërë përparime në sektorin tënd, por pse nuk shikon atë shokun tjetër

që merr më shumë, 70 edhe bile 80 kuintalë misër për hektar? Pse merr ai një rendiment më të lartë se ti? Sepse i kupton këto çështje më mirë, prandaj puno që t'i kuptosh edhe ti këto çështje!». Një gjë e tillë duhet medocmos të arrihet, prandaj ta marrim njeriun ashtu siç është dhe ta edukojmë, duke e njohur mirë me të kaluarën e me të gjitha përpjekjet që ka bërë dhe bën mbarë populli për të gëzuar këto ditë të lumtura.

Lidhur me këtë problem dua të theksoj edhe diçka tjetër, që studimet për këto çështje të mos pritet t'i bëjnë vetëm studiuesit, historianët, sociologët apo punonjësit e shkencave të tjera, ose ata të artit dhe të kulturës të institucioneve qendrore. Ata le ta bëjnë punën e tyre, por mua më duket se një njeri i arsimuar, që jeton në atë apo këtë fshat dhe që apasionohet me njerëzit, me të kaluarën e tyre, me tokën e me çdo gjë, mund të nxjerrë nga duart e tij një studim shumë të mirë, mund të bëjë edhe monografi mjaft interesante.

Pse i them këto gjëra? Në leximet që bëj vërej se si kanë punuar historianët në vende të tjera të botës. Ka libra të tërë për historikun jo vetëm të një krahine, por edhe të një fshati, sepse studiuesit e apasionuar punojnë, studiojnë me vullnet e shkruajnë. Ashtu siç është studiuar e kaluara historike, kulturore e letrare e fshatarëve të Francës, të Anglisë e të Italisë, fare mirë mund të studiohen edhe traditat e pasura patriotike, historike e kulturore të fshatarësisë sonë. Është e domosdoshme që një punë të tillë ta bëjnë edhe njerëzit tanë dhe të jenë të bindur se kjo nuk është një

punë pa bukë. Ka shumë rëndësi të kuptohet vlera e kësaj pune.

Vallet, këngët, teatri, estrada juaj (dhe në parantezë dua t'ju them se ju keni këtu artistë të talentuar të komedisë, që më kanë pëlqyer shumë dhe është mirë që elementë të tillë të inkurajohen), të gjitha këto ndikojnë në edukimin politik, kulturor e artistik të njerëzve. Kur shikon një numër të madh njerëzish të talentuar në skenë, gjithë ato të reja e të rinj që këndojnë e hedhin valle, kur shikon gjithë ato orkestrena në fshatra, njeriu ndien kënaqësi dhe çlodhje. Këto aktivitete, të marra në tërësi, ndikojnë në prodhim, në zhvillimin shoqëror e mendor dhe përbëjnë atë që i thonë kulturë.

Te ne sot aktivitetet kulturore kanë marrë një hov të madh në të gjitha drejtimet dhe një veprimtari e tillë, siç thashë, është me shumë «bukë», me shumë vlerë. Nevoja për studime, për njohjen e thellë të traditave kulturore dhe shfrytëzimin e tyre duhet kultivuar te njerëzit në mënyrë sistematike. Natyrisht, Partia duhet t'i nxitë, t'u hapë horizonte njerëzve në fushën e artit, të muzikës, të kulturës së përgjithshme, të studimit e të zhvillimit historik të popullit etj., etj., ashtu siç u hap horizonte edhe për çështjen e bujqësisë, të industrisë etj.

Për sa u përket problemeve ekonomike dhe të planit, nuk do t'ju flas shumë se në plenum dhe në aktivin e organizuar për këto probleme ju diskutuat, analizuat gjendjen, rrahët mendime dhe realizuat që këto probleme, që u shtruan nga Plenumi i 4-t i Komitetit Qe-

ndror¹, kanë një rëndësi shumë të madhe. Detyrat janë të mëdha, të vështira, por këto janë reale dhe duhet t'i realizojmë. Vetë jeta ka treguar se këto detyra janë të realizueshme, bile edhe mund të tejkalohen dhe duhet të tejkalohen. Kjo nuk është thjesht një dëshirë, por një realitet, sepse në çdo rreth, në çdo sektor, në çdo kooperativë kemi shembuj të shkëlqyer që tregojnë se detyrat jo vetëm janë kryer, por ato janë tejkaluar dhe janë tejkaluar në një mënyrë të tillë që as në një bujqësi moderne intensive nuk i arrijnë ato rendimente të larta që marrim ne.

Është fakt se, kur thamë që prodhuam bukën në vend, me sa më kanë thënë, në disa universitete dhe në qendrat agroteknike të Italisë, filluan të pyesin e të diskutojnë. Si është e mundur, thanë, të bëhet një hop i tillë në Shqipëri? Përgjigjen ua dhanë njerëzit që kishin vizituar Shqipërinë: «Kjo është reale, nuk flasim kot shqiptarët, nuk i fryjnë gjërat ata, me sytë tanë ne kemi parë transformimin e madh që është bërë në këtë vend».

Dua të theksoj se vendimi që mori Komiteti Qendror për punimin bashkërisht të materialeve të tre plenumeve të fundit të tij, ishte i drejtë. Kështu që punimi i materialeve të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror, për realizimin e planit të vitit 1978, u lidh me materialet e Plenumit të 2-të dhe veçanërisht me

1. Plenumi i 4-t i KQ të PPSH, që u mbledh në datën 30 dhe 31 janar 1978, mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi dhënien llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978».

ato të Plenumit të 3-të lidhur me edukimin dhe me ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik, politik e tekniko-profesional të kuadrove tanë. Është e rëndësishme që të kuptohen mirë këto materiale.

Si duhet të kuptohen? Unë dua të vë në dukje këtë gjë, që kuadrot, në të gjithë sektorët, ta kenë të qartë se plani ynë është një plan unik që përfshin të gjitha fushat e problemet, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Asnjë nga fushat e veprimtarisë shoqërore nuk duhet neglizhuar, asgjë të mos lihet pas dore, por çdo punë e aktivitet të lidhet me bujqësinë, me industrinë, me përparimin e tyre. Ne themë që edhe kënga, vallja, aktivitetet kulturore e sportive kontribuojnë në bujqësi ose në industri, kuptohet, në mënyrë indirekte. Çështjet e zhvillimit me plan të ekonomisë lypset të shihen kurdoherë të lidhura ngushtë me problemet e edukimit, të kulturës, të ngritjes në një nivel më të lartë të aftësive e të formimit të kuadrove etj.

Të ndalemi, për shembull, në sektorin e bujqësisë. Në këto situata kësaj doje të ekonomisë sonë i vihen përpara detyra të mëdha, të cilat duhet të kryhen me sukses. Në përgjithësi, përshtypja ime është që kuadrot tanë të bujqësisë përpiqen, lodhen, ndihmojnë dhe fitojnë eksperiencë nga puna në këtë sektor. Kjo është pozitive, por sot prej tyre kërkohet një punë më e thelluar shkencore dhe shkenca, shokë, bazohet në vëzhgimet praktike. Nga praktika njeriu mëson shumë. Këtë gjë e tregon dhe historia e njerëzve të mëdhenj.

Ja t'ju them diçka për një njeri të shquar, të qu-

ajtur Klod Bernar¹, i cili ka jetuar në shekullin e 19-të. Ai ka zbuluar metodën e eksperimentimit praktik në mjekësi, gjë që bëri që mjekësia të marrë një hov të madh zhvillimi. Klod Bernari ka qenë një njeri që nuk e donte shkollën, por ishte i dhënë pas bujqësisë. Që kur ishte i vogël, i qe qepur patates. Me zor ai mbaroi shkollën fillore dhe liceun. Mendja i punonte për pataten dhe shpeshherë largohet nga shkolla. Më në fund e çuan në universitet, bëri një vit dhe e la e s'u tha gjë prindërve. Kështu e shtyu punën e shkollës deri në fund. Megjithatë, ky u bë njeriu që i dha rrugë mjekësisë moderne. Në bazë të sistemit të Klod Bernarit punojnë sot të gjithë. Bernari vinte në dukje që «në qoftë se nuk vëzhgojmë se ç'ngjet dhe nuk i ndjekim këmba-këmbës rastet konkrete që na jep jeta praktike, ne nuk do të mundemi t'i shërojmë mirë njerëzit nga sëmundjet e ndryshme».

E përmenda këtë shembull për të theksuar se nuk mjafton vetëm të kesh mbaruar universitetin, por është e domosdoshme të lidhesh mirë me jetën praktike. Pra agronomi të lidhet me bujqësinë, me njerëzit me përvojë të madhe praktike në këtë fushë, të njohë mirë tokën, strukturën e saj, veglat, farën etj., etj. Këto gjëra, në radhë të parë, duhet t'i bëjë ky, sepse ka mbaruar universitetin dhe ka njohuri teorike mbi këto probleme; di se ç'rëndësi ka çdo hallkë në bujqësi. Prandaj, në qoftë se nuk interesohet e nuk vëzhgon, atëherë ai do të harrojë edhe ato që ka mësuar ose do të mbetet prapa e nuk do të ecë më tej. Pra nuk mjaft-

1. Klod Bernar (1813-1878), fiziolog francez.

ton të kesh vetëm njohuri teorike për bujqësinë, por është e domosdoshme që ato t'i pasurosh me përvojën e përditshme të atyre njerëzve të thjeshtë, të cilët me praktikën e tyre të vërtetojnë jo vetëm ato që ke mësuar, por të hapin një horizont tjetër më të madh. Praktika është ajo që, në qoftë se je i aftë dhe do që të punosh, të ndihmon të arrish në konkluzione të mëdha shkencore, të cilat e çojnë punën përpara.

Do të kthehem prapë në çështjen e mjekësisë. Tashmë flitet, po me zë shumë të ulët, se mund të shërohet kanceri. Dhe në të vërtetë po shërohen disa forma të leucemisë, të kancerit në gjak. Po sa shumë kohë ka kaluar e sa shumë është punuar për të arritur këtë sukses, kur ke parasysh që ishte një kohë që nuk dihej se ç'ishte gjaku!

E dini ju kush e ka vënë në dukje nga të parët në Evropë qarkullimin e gjakut? Këtë nuk e ka bërë ndonjë mjek apo ndonjë shkencëtar, por Shekspiri, dramaturgu i madh anglez. Ai ka shkruar se gjaku qarkullon në trup. Penës së tij i përkasin shumë vepra. Një nga këto është dhe drama me titullin «Koriolani». Shekspiri thotë: «Unë dërgoj gjithçka me anë të lumcnjve të gjakut deri në zemër, deri në tru dhe në sajë të enëve të gjakut të trupit të njeriut, nervat më të fortë dhe venat më të holla marrin nga unë atë që është e nevojshme për të jetuar». Kurse i pari idenë e qarkullimit të gjakut e ka dhënë Avicena¹. Natyrisht, ky problem nuk mbeti me kaq. Specialistët e mjekësisë e studiuuan dhe e zhvilluan këtë ide më tej.

1. Avicena (980-1037), filozof e mjek persian.

Ose problemi tjetër mbi përbërjen dhe sëmundjet e gjakut. Në gjak ka globula të kuqe dhe globula të bardha. Të dhënat praktike dhe laboratorike dëshmojnë se globulat e bardha janë si një ushtri e madhe që luftojnë kundër mikrobeve në organizëm. Kur u zbulua mikroskopi, mjeku francez Bruse e konsideronte atë si një lodër pa vlerë shkencore; e shumta një lodër për të argëtuar markizat, ashtu sikurse bëri ai në kohën e madam Pompadurit dhe Fontenelës. Mirëpo nga ai mikroskop doli mikroskopi elektronik, me anën e të cilit sot janë bërë observime të atilla që nxjerrin se globulat e bardha luajnë një rol të rëndësishëm për organizmin e njeriut. Ato në një mënyrë matematike lajmërohen se ku ka zënë vend mikrobi dhe sulen si një ushtri e organizuar mirë mbi «armikun».

Këto globula që sulmojnë «armikun» janë të vogla, por brenda tyre ka pjesë përbërëse edhe më të vogla akoma që lëshojnë një vello dhe me të e mbërthejnë «armikun» në bërthamën e tyre dhe e hedhin poshtë. Edhe kjo gjë u zbulua në sajë të observacioneve të njëpasnjëshme me mikroskopin elektronik.

Me mijëra fëmijë vdisnin përpara nga leucemia. Pse? Sepse globulat e bardha merrnin formën e draprit, domethënë, brenda në organizëm ndodhte një infeksion i rëndë. Çdo globulë përbëhet prej 140 pjesëzash të vogla, të cilat janë të radhitura në formën e një zinxhiri dhe ndjekin njëra-tjetrën sipas një rënditjeje të pandryshueshme. Në qoftë se kjo radhitje prishet, për shembull, në qoftë se pjesëza e 123-të kalon atje ku ndodhet pjesëza e 109-të, ose anasjelltas, atë-

herë shfaqet anemia. Kjo ishte një arsye tjetër që fëmijët vdisnin me shumicë.

Këta shembuj i përmend për të theksuar edhe një herë që njerëzit tanë me arsim të lartë, veçanërisht e kam fjalën për ata që kanë mbaruar Institutin e Lartë Bujqësor, duhet të mbështeten shumë në përvojën praktike, pa dyshim edhe në diturinë e fituar, por këtë ta shohin në zbatim. Por, që të arrihet një gjë e tillë, agronomi, zootekniku, veterineri e të tjerë duhet të lidhen ngushtë me fshatin, me bujqësinë. Të them të drejtën, na vjen keq kur dëgjojmë që shumë agronomë, pedagogë, mësues e të tjerë, venë në mëngjes në orën 7 në fshat dhe kthihen prapë në qytet në mbrëmje me autobus urban. Jo, kësaj nuk i thonë dashuri dhe pasion për punën. Kujtoni, shoqe dhe shokë, Pjer Kyrinë që zbuloi radiumin. Ai flinte në një barakë ku hynte era ditë e natë dhe në këto kushte punonte me një vullnet të jashtëzakonshëm. Shkonte vetë dhe mernte në kurriz atë lëndë të rëndë mbi të cilën i duhej të bënte studime. Në përgjithësi, siç ju thashë dhe më lart, kjo është historia e njerëzve të shquar.

Pra, njerëzit tanë të bujqësisë duhet t'i qepen tokës, të punojnë pa u lodhur e të kryejnë studime e përgjithësime shkencore, se janë të gjitha mundësitë që puna në këtë sektor e kudo të ecë edhe më mirë. Kjo ishte dhe arsyeja që ne vendosëm të punoheshin bashkë problemet e realizimit të planit dhe të edukimit të kuadrove.

Në përgjithësi, në bujqësi, si edhe në të gjithë sektorët ne kemi suksese, të cilat nuk duhet t'i nënvlehtësojmë. Por kemi edhe të meta e këto të meta që-

ndrojnë kryesisht në organizim dhe në kontrollin e punëve. Organizim dhe kontroll, këto janë dy fjalë që mund t'i përsëritim si slogane, por, po nuk i zberthyejmë, po nuk u kuptua rëndësia e tyre, punët nuk do të ecin mirë. Për këtë, në radhë të parë, është e domosdoshme të njohim situatën në të gjitha aspektet e saj. Komiteti i Partisë, sekretarët, organizata e Partisë, kryesia e kooperativës, drejtorja e ndërmarrjes, të gjitha duhet ta njohin mirë situatën, siç i thonë një fjale, ta kenë atë në pëllëmbë të dorës. Një gjë e tillë ka rëndësi, sepse në këtë mënyrë mund të kuptosh se ku je me realizimin e detyrave. Domethënë, nëse unë kam përpara këtë problem për të zgjidhur, duhet medoemos të marr masa që ta zgjidh. Kjo nuk bëhet e qartë me dy-tri fjalë, por me një punë të vazhdueshme, plot durim e këmbëngulje.

Çdo fenomen, proces, detyrë ose problem zhvillohet, ndryshon, ka dinamizmin e vet, ashtu siç zhvillohen e transformohen njeriu dhe mendimet e tij. Pra, problemet nuk qëndrojnë në mënyrë statike, prandaj është e domosdoshme njohja mirë e situatës dhe e dukurive të reja që dalin. Por, që të realizohet kjo, secili kuadër duhet ta analizojë gjendjen vetë ose në bashkëpunim me të tjerë, të shikojë të gjitha pluset dhe minuset, pastaj të gjejë rrugën se si duhet të veprojnë. Në qoftë se nuk vepron në këtë mënyrë, atëherë do të thotë se po ecet kuturu.

Pastaj, rëndësi të madhe ka edhe se si u shtrihen problemet të tjerëve. Nuk mjafton që ne, 10 apo 15 veta, ta kemi të qartë një problem, të cilit iu futëm, e studiuam dhe dimë se si është situata, dimë menta-

litetin e njerëzve, dimë ku na çalon e ku nuk na çalon puna, dimë se ç'mjete e ç'mundësi kemi. Problemin duhet ta njohin dhe ta kenë të qartë edhe njerëzit e tjerë që do të merren me zgjidhjen e tij. Kjo punë nuk është aq e thjeshtë dhe nuk mund të bëhet në mënyrë rutinë. Jo. Ne themi që një kuadër e njuh mirë situatën, kur ai si komunist, si kuadër, në sektorin ku drejton, punon bashkë me njerëzit, njuh mirë kapacitetin, zotësinë, energjitë ose plogështinë e secilit anëtar të kolektivit që drejton; njuh edhe gjendjen e tyre familjare, di vështirësitë, hidhërimet e gëzimet e tyre etj., etj. Domethënë, në qoftë se Partia, kuadrot u qëndrojnë afër njerëzve, atëherë ata e kanë më të lehtë të gjykojnë, të mendojnë e të gjejnë format më të mira për të punuar me ta dhe për t'i vënë në lëvizje për realizimin sa më të mirë të detyrave.

Pra, ne duhet t'i njohim njerëzit, t'u shtrojmë probleme dhe t'ua bëjmë ato sa më të qarta. Dhe që të arrihet kjo, këto probleme nuk shtrohen ashtu, në këmbë, as duke u larguar në mbrëmje nga fshati, por duke jetuar atje, duke u lidhur ngushtë me jetën e njerëzve ku punon. Ka disa raste që prania e kuadrit, e specialistit në fshat, në çdo kohë është tepër e domosdoshme. Sikur mjekët, për shembull, të ikin çdo mbrëmje në qytet, «të çajnë ferrën», si thotë populli, një gjë e tillë mund të ketë pasoja të rënda. Mund të ndodhë që pikërisht natën, një fëmijë të sëmuret e të vdesë, në qoftë se nuk jepet në kohë ndihma e mjekut. E shikoni ç'mund të ndodhë kur ai kthehet mbas dite në qytet? Këtë duhet ta kuptojnë mirë kuadrot. Prandaj t'ua shtrojmë dhe t'ua bëjmë të qartë rëndë-

sinë e kësaj çështjeje njerëzve jo vetëm nga ana teoretike, por edhe nga ana praktike.

Rëndësi të veçantë ka, gjithashtu, edhe organizimi i punës. Për këtë qëllim duhet të ecim si ushtria në kohë lufte, të organizuar mirë në brigada e në skuadra. Skuadra ka «ushtarë» dhe «komandantin» e saj, kurse brigada ka në krye një «shtab» që drejton në sektor, ku bëjnë pjesë agronomë, zooteknikë, veterinerë, të cilët kanë një plan pune që e ka edhe «shtabi» më lart. Në kooperativë, kryetari, ashtu si komandanti në kohë lufte, ka planin dhe forcat e punës, «ushtrinë», të cilën duhet ta organizojë e ta drejtojë për të vënë në jetë këtë plan, duke punuar edhe vetë me nerva të tendosur. Kështu duhet menduar e vepruar nga ana e tij. Kryetari i kooperativës asnjëherë të mos jetë i qetë kur punët nuk shkojnë mirë. Në qoftë se ka njeri që nuk duhet ta zërë gjumi për mosrealizimin e detyrave në kooperativë, në radhë të parë, do të jetë kryetari, sepse atë e ka vënë Partia drejtues që të zbatojë atje si duhet planin ekonomik e financiar. Dhe plani është vendosur, pasi janë marrë parasysh të gjitha vërejtjet e sugjerimet e bazës dhe pasi janë bërë gjithë ato studime për probleme të ndryshme, gjë që e vunë qartë në dukje në fjalën e tyre, si shoqja Naunka, ashtu edhe shoku Ligor.

Është e domosdoshme që të gjithë kuadrot, në çdo hallkë të punimeve në bujqësi, të mendohen mirë dhe me kohë për detyrat që kanë, në mënyrë që edhe masat për kryerjen e tyre të merren atëherë kur duhet. Për këtë të bëhet më parë një plan pune i detajuar, domethënë, të parashikohet, për shembull, që plu-

gimet do të bëhen në këtë kohë; prashitja në këtë ose në atë fazë; shërbimet kulturore apo ujitja do të bëhen në këtë ose në atë muaj; plehu do të hidhet në këtë afat dhe në këtë thellësi e kështu me radhë të gjitha shërbimet e tjera.

Lufta që kemi përpara në bujqësi është e madhe, por luftën e bëjnë dhe e fitojnë njerëzit, e fitojnë organizimi, njohuritë, shpirti sulmues dhe disiplina e ndërgjegjshme. Kjo disiplinë e ndërgjegjshme formohet kur i tërë ky proces zhvillohet në mënyrën që thamë. Por një gjë e tillë nuk bëhet gjithmonë e nga të gjithë. Ne nuk kërkojmë idealen, por ama të gjitha këto punë nuk mund t'i lihen vetëm brigadierit. Me këtë nuk dua të shfajësoj brigadierët, në përgjithësi, por g'është e vërteta një brigadier ka 60-70 veta për të drejtuar në punë, ka 80-100 hektarë tokë në ngarkim. Çdo ditë i kërkohet të matë e të shikojë sa është punuar, sa shërbime janë kryer e sa jo. Ai duhet të shënojë, gjithashtu, ditë-punët për çdo anëtar të brigadës, të kontrollojë cilësinë e punës së secilit, të shënojë normat e punës, të pagës etj., etj. Ose ka raste që brigadierit i duhet të shkojë në sektor për këtë ose për atë problem, sidomos për të siguruar mjetet mekanike, plehun, ujin për ujitjen e bimëve etj. Të gjitha këto pra, përbëjnë atë fushë të gjerë të punës së brigadierit. Por në këtë punë të madhe e të përditshme duhen edhe ndihma, kontrolli dhe organizimi edhe nga sektori ku veprojnë disa brigada. Po nuk qe e organizuar si duhet puna në sektor, ajo do të çalojë edhe në brigada dhe do të krijohet terren për veprime spontane të dëmshme. Sektori kërkohet të drejtojë me kompetencë e operativitet

dhe të ushtrojë kontroll të fortë që prodhimi të realizohet me shpenzimet e parashikuara në plan, në kontot për çdo kulturë. Ne jemi të bindur se brigadieri apo ndonjë tjetër as që do të hapë gojën për të kërkuar më shumë bazë materiale, në qoftë se përgjegjësi i sektorit do t'i kryejë mirë detyrat që ka ndaj brigadës, ose do të dijë të gjejë formën më të mirë e më të përshtatshme dhe pa u ngrënë kohën, t'i sqarojë e t'i edukojë brigadierët me të cilët ka të bëjë.

Brigadieri duhet të jetë aq i qartë, sa të jetë në gjendje t'i bindë që të kryejnë si duhet detyrat që kanë edhe skuadërkomandantët e tërë pjesëtarët e tyre të brigadës. Që detyrat të kryhen mirë, rëndësi ka organizimi i punës nga ana e brigadierit. Ai duhet të ketë kurdoherë plan pune që duhet t'ua bëjë të njohur dhe t'ua ndajë mirë detyrat skuadërkomandantëve. Pastaj rëndësi vendimtare ka kontrolli i zbatimit të detyrave. Mirëpo kontrolli nuk është e mundur të bëhet nga një njeri apo nga dy njerëz, por nga të gjithë. Në radhë të parë, secili nga ne duhet të jetë vetë i ndërgjegjshëm në kryerjen si duhet të detyrës që i është ngarkuar, pastaj të kërkojmë një gjë të tillë nga të tjerët. Ky është kontrolli i parë dhe vendimtar, pas këtij vjen kontrolli i shokut. Në qoftë se ne vetë do të punojmë me ndërgjegje dhe do të japim shembullin personal, atëherë kontrolli është fare i lehtë dhe nuk të vjen zor t'i thuash tjetrit që ke në krah: Ej, shok, çfarë bën ashtu, përdore mirë shatin, prashite mirë bimën etj. Kur kjo punë do të bëhet nga të gjithë, atëherë edhe për skuadërkomandantin detyra do të jetë më e lehtë, po kështu edhe për brigadierin dhe, si rezultat, puna do

të ecë mirë, plani do të realizohet dhe cilësia e çdo punimi do të jetë e kënaqshme. Skuadërkomandanti e di, ta zëmë, që një shoqe është energjike, kurse një shok pranë saj është një çikë i mefshtë, prandaj ai nuk shkon te shoqja për kontroll e ndihmë, por vete te më i dobëti dhe i thotë: «Pa dale të të shikoj pak ty si po e ngul shatin? A... , jo kështu shok. Ja, shikoje atë shoqen! Merr shembull prej saj dhe puno edhe ti si ajo, ngule thellë veglën që ke në dorë» etj., etj. Duke vepruar në këtë mënyrë, drejtuesve të punës do t'u mbetet kohë dhe për punët e tjera, se edhe ekonomizimi i kohës, njohja e metodës dhe e stilit të kontrollit të detyrave kanë shumë rëndësi.

Një metodë pune e mirë, efikase, një organizim e kontroll i mirë i detyrave, e lehtëson brigadierin nga punët e shumta. Nuk është çështja që brigadieri vetëm ta pyesë skuadërkomandantin për këtë ose për atë problem, por nga ky i fundit ai duhet të njohë edhe pikëpamjet që ka ai për njerëzit, për «ushtarët», ashtu siç bëhet në luftë nga një oficer i mirë që është i lidhur me ushtarët e tij dhe i njeh cilët janë më të hedhur, më të guximshëm, që nuk kanë frikë, që janë të zhdërvjellët, që çdo vendim janë në gjendje shpejt ta zbatojnë, që janë në gjendje t'i marrin me shkathtësi krahet armikut, që nuk ecin qorrazi në detyrën që u ka caktuar eprori, por në praktikë me zgjuarësi gjejnë vendin më të përshtatshëm për të kapërcyer më lehtë, për të pasur vetë më pak humbje e për të vrarë sa më shumë armiq. I tillë duhet të jetë edhe skuadërkomandanti, t'i njohë mirë «ushtarët» e tij në fushë që të jetë në gjendje t'ia paraqesë qartë situatën brigadierit.

Kështu ky do të dijë se ku të vejë e kë të kontrollojë dhe, po të punohet kështu, ai do të krijojë besim te raportimet që i bën skuadërkomandanti për ditë-punët e për çdo gjë tjetër. Po të veprohet me këtë mënyrën që thashë, brigadieri do të gjejë kohë që të vejë të kërkojë lart edhe në sektor zbatimin e detyrave që kanë edhe ata ndaj tij, do të mendojë, gjithashtu, edhe për lopët, për foragjeret, për plehun dhe për të gjitha problemet e tjera që duhet të zgjidhë brigada.

Organizimi në punë, pra, duhet të jetë, si në ushtri. Në luftë është edhe prapavija, e cila luan, gjithashtu, një rol të madh. Se, le të jesh trim sa të duash, një ose dy ditë mund të luftosh edhe pa ngrënë, por pastaj do bukë; po nuk hëngre, nuk ke forca të sulmsh. Prandaj prapavija duhet të funksionojë dhe bile mirë. Por që të funksionojë në rregull ajo, duhen respektuar kërkesat e vendosura. Nuk mund të vejë kushdo në repart e të hajë si në derën e pashait, se çdo gjë është e normuar. Kështu duhet të ndodhë edhe në bujqësi, të tëra janë me plan dhe të normuara: farërat, plugimet, plehu, ujitja e të gjitha shërbimet e tjera. Mirëpo, çfarë bëhet në realitet? Ka raste që veprohet siç e kupton planin apo si duan kryetari i kooperativës ose sekretari i organizatës së Partisë. «T'u vëmë rëndësi drithërave», mund të thonë ata. Po kush thotë që të mos u vihet rëndësi drithërave? Rritja e rendimentit të drithërave është një çështje me shumë rëndësi, prandaj i duhet kushtuar gjithë vëmendja. Por kjo, ama, nuk do të thotë që të lihen pas dore ulliri, luledielli e bimët e tjera bujqësore. Përkundra-

zi, edhe këto kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe në çdo kohë, por sidomos aktualisht.

Pse themi ne që është e rëndësishme t'u kushtohet vëmendje të gjitha bimëve bujqësore, sidomos aktualisht? Këtë, besoj, e keni të qartë, pasi ju jeni njohur me materialet e plenumeve të fundit të Komitetit Qendror. Ne kemi pasur marrëdhënie të mira me Kinën, pavarësisht se e dinim shumë kohë më parë se ç'ishte udhëheqja e saj; marrëdhëniet tona me të deri tani janë zhvilluar me hope, me ngjitje e me zbritje. Partia jonë kurdoherë ka ndjekur një vijë të drejtë marksiste-leniniste, si në çdo fushë edhe në atë të ekonomisë. Në këtë drejtim kemi pasur njëfarë ndihme edhe nga Kina. Por duhet të kuptohet drejt që kjo s'ka qenë ndonjë ndihmë e madhe, në krahasim me forcat e mëdha që ka vënë populli ynë për ndërtimin e ekonomisë e të kulturës. Për shembull, Azotiku kushtoi shumë milionë dhe populli ynë ka sakrifikuar mjaft për ndërtimin e tij, kurse ndihma që na dha Kina për ta ndërtuar atë nuk zë më shumë se 12-15 për qind të këtyre shpenzimeve. Përveç kësaj është fakt se dhe ne e kemi ndihmuar Kinën më tepër sesa na ka ndihmuar ajo, duke pasur parasysh edhe mundësitë e saj.

Megjithatë ne i jemi mirënjohës Kinës edhe për atë ndihmë që na dha në ato momente të vështira për vendin tonë, të krijuara pas tradhtisë së revizionistëve sovjetikë, kurse Kina nuk është mirënjohëse për ndihmën e madhe që ne i kemi dhënë asaj. «Fatet e socializmit në vendin tonë janë në rrezik, — na ka thënë me gojën e tij Mao Ce Duni, — ose shkatërrohet socializmi, ose fitojmë ne, prandaj duhet të na ndihmoni,

dhe ju, shqiptarët, jeni të vetmit që mund të na ndihmoni në këto situata». Dhe ne, pa marrë parasysh asgjë, e ndihmuam Kinën. Dhe kur, në ç'momente? Në një kohë kur nga të katër anët ne vetë jemi të rrethuar nga armiq të tërbuar të socializmit, të lirisë e të pavarësisë së vendit. Kurse Kina mban tani të tjera qëndrime ndaj vendit tonë.

Prandaj, siç u theksua edhe në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror, tashti ne duhet ta ndërtojmë socializmin duke u mbështetur tërësisht në forcat tona. Dhe, kur themi kështu, problemi duhet kuptuar në tërë gjerësinë dhe thellësinë e tij. Në radhë të parë, duhet kuptuar mirë që bujqësia, baza e ekonomisë sonë, është e domosdoshme të ecë përpara me ritme intensive. Të punohet që niveli i jetesës së popullit jo vetëm të mos ulet për asnjë çast, por edhe në këto situata, të shkojë vazhdimisht duke u ngritur. Po kështu edhe rezervat shtetërore dhe eksportet tona të vijnë duke u shtuar.

Është fakt se prodhimet bujqësore që eksportojmë ne janë mallra që sot blihen në shumë vende të botës. Bota kapitalisto-revizioniste është në krizë dhe vështirësi ekonomike, ndërsa në vendin tonë ku ndërtohet socializmi nën udhëheqjen e një partie të vërtetë marksiste-leniniste, nuk ka papunësi, nuk ka ngritje çmimesh. Misri, domatja dhe çfarëdo prodhimi tjetër bujqësor që eksportojmë ne, të gjitha priten me interes. Për sa u përket artikujve të tjerë të eksportit tonë, do të gjejmë ca vështirësi, por me siguri do të gjejmë tregje jashtë, dhe kemi filluar të gjejmë.

Pavarësisht nga kjo, ne duhet ta kuptojmë rrethi-

min kapitalist e revizionist ashtu siç është në realitet. Të gjithë armiqtë na kanë halë në sy, por tani për tani nuk mund të na sulmojnë dot ushtarakisht. Megjithatë ata përpiqen të gjejnë format dhe mënyrat që të na dëmtojnë dhe të pengojnë ecjen tonë përpara. Delegacionet tona të tregtisë e të industrisë kanë katër muaj që po rrinë në Kinë, gjë që nuk ka ngjarë kurrë jo në mes nesh e Kinës, por as në marrëdhëniet në mes vendeve kapitaliste, për të nënshkruar marrëveshjen tregtare. Dhe, megjithëse ne i kemi pranuar kushtet që na kanë vënë përpara kinezët në çështjet e tregtisë, ata prapë e kthejnë fjalën. Qëllimi i tyre, me sjelljet dhe qëndrimet që mbajnë ndaj nesh, është i qartë: ata duan që delegacioni ynë të ngrihet e të ikë dhe pastaj të na thonë: «Ju vetë ikët, se nuk donit të nënshkruanit marrëveshjen!». Ky është një sabotim nga ana e tyre, me tërë kuptimin e fjalës. Shokëve të delegacionit tonë ata u thonë: «Këtë mall nuk e japim; për këtë tjetrin nuk kemi eksperiencë, këtë kështu e atë ashtu»; ose: «Mallrat të livrohen sipas çmimeve ndërkombëtare». «Mirë, u thonë tanët, e bëjmë edhe kështu.» Të marrim, për shembull, kromin: ne ua kemi shitur atë shteteve të tjera me këtë apo atë çmim, sipas rastit. Por kinezët u thonë shokëve tanë: «Jo, ne nuk jua blejmë me këtë çmim, por me çmimin që u themi ne! Po të doni, thonë kinezët, ndryshe nuk jua blejmë fare!». E shikoni se çfarë formash e mënyrash po përdorin?

Por ne, pavarësisht nga veprimet sabotuese të kinezëve, do të çajmë. Dhe tregje për ta shitur kromin kemi gjetur, jo me çmimin që na thanë kinezët, por

siç na leverdis neve. Ne kemi, gjithashtu, parasysh se, si gjithë ekonomia në botë, edhe metalurgjia është duke kaluar një krizë të madhe. Gjermania e Franca, për shembull, nuk shfrytëzojnë gjithë kapacitetin e metalurgjisë së tyre, veçse 50 apo 60 për qind të këtij kapaciteti. Prandaj edhe çmimi i kromit është ulur ca. Kështu ndodh edhe me çmimet e mjaft mallrave të tjera që ne eksportojmë në vendet kapitalisto-revizioniste.

Një gjë duket sheshit në këtë drejtim dhe që ne duhet ta kemi parasysh: koordinimi i veprimtarisë së armiqve kundër nesh. Ja një shembull: Ne e dimë që Jugosllavia ka nevojë të madhe për energji elektrike dhe ne kemi mundësi ta furnizojmë atë, por, duke qenë se tashti ajo është bërë motërma, është bërë «e dashura» e Kinës, me të cilën është në një vijë, ka ndryshuar qëndrimin për blerjen e energjisë elektrike nga ne. Duke parë që nga Kina neve na bëhet presion, Jugosllavia, që më parë na lutej t'i jepnim energji elektrike, tash na thotë: «Unë e blej energjinë tuaj elektrike, por me kusht që të kontraktujmë çdo 10 ditë». Po ku është parë ndonjëherë që të bëhen kontratat midis shteteve me afate kaq të shkurtra, dhjetëditore? Po sikur pas dhjetë ditësh të ndodhë që Jugosllavia të na thotë se nuk e do më energjinë tonë elektrike, atëherë ç'të bëjmë ne me të sa të organizojmë kontraktim me të tjerë, ku ta shesim? Prandaj, kontratën duhet ta bëjmë të paktën për gjashtë muaj, kërkojmë ne nga Jugosllavia. Edhe Rumania na kërkon energji elektrike. «Mirë, i themi, hajde t'jua japim nëpërmjet Jugosllavisë». «Jo, thonë jugosllavët, nuk kemi

linja të lira, i kemi të ngarkuara, nuk e çojmë dot në Rumani energjinë elektrike shqiptare». Ne e dimë se ajo e çon atë që ç'ke me të, po të dojë, dhe jo në Rumani, por edhe më larg.

Nga të gjitha këto del se në këto situata armiqtë përpiqen të na mposhtin, të na dobësojnë ekonomikisht. Por, siç mendojnë dhe përpiqen të veprojnë të gjithë armiqtë ndaj nesh, kështu bëjnë edhe kinezët, që kanë marrë rrugën kapitaliste, rrugën revizioniste, duke menduar se Shqipëria tashti ka mbetur në mes të rrugës. Por ata gabohen.

Shqipëria as ka mbetur dhe as do të mbetet kurrë në mes të rrugës! Këtë e ka provuar jeta. Mbështetja në forcat e veta është një parim mbi të cilin ne jemi bazuar kurdoherë. Ju e dini, se, kur vendi ynë ka qenë me të vërtetë i mjeruar, brenda dy vjetësh, pasi erdhëm nga mali, ne i ndërtuam të gjitha ç'ishin shkaktërruar, shtëpitë e djegura, rrugët e prishura, urat etj., etj. Po me se i ndërtuam? Me forcat tona, me krahun tonë, pa asnjë ndihmë nga jashtë filloi ndërtimi i një jete të re nga ne në momente jashtëzakonisht të vështira, kur çdo gjë nisej nga e para. Vrulli revolucionar në atë kohë e çonte peshë popullin tonë për të ecur përpara me një forcë të madhe. Dhe gjithë kjo punë bëhej atëherë, kur gjoja ne ishim miq me jugosllavët, të cilët jo vetëm nuk na ndihmonin, por na vidhnin e na dëmtonin. Kurse aktualisht jemi shumë më të pasur, shumë më të fortë, për arsye se kemi ngritur një industri mekanike e minerare nxjerrëse e përpunuese të zhvilluar mirë. Sot në vendin tonë shfrytëzohen pasuri të tilla me vlerë të madhe, siç janë mine-

ralet e kromit e të hekur-nikelit, të bakrit, të naftës e të gazit etj. dhe në këtë drejtim ne do të ecim me ritme gjithnjë e më të larta në të ardhmen. Këto janë lëndë të para që tashti po i përpunojmë në vend, por kemi edhe minerale gjysmë të përpunuara.

Prandaj armiqtë, kushdo qofshin këta, duke përfshirë edhe kinezët, megjithëse s'lenë gjë pa bërë, nuk do të mundin kurrë të na pengojnë dot në këtë drejtim.

Midis vendeve imperialiste e revizioniste ekzistojnë kontradikta. Shumë kontradikta ka ndërmjet tyre edhe për sa i përket Shqipërisë. Të tërë duan ta gëlltisnin vendin tonë, por asnjëri nuk e lë tjetrin ta bëjë një gjë të tillë. Pastaj, që ta gëlltisësh Shqipërinë, është një çikë e zorshme, sepse, po u fute brenda te ne, nuk del dot dhe këtë armiqtë e dinë mirë. Të tërë kanë arrihur në një shkallë të tillë sa të kuptojnë qartë se çdo gjë që thotë Partia jonë, bazohet në realitetin konkret. Ato nuk janë as përralla, as mburrje. Këtë e ka treguar kurdoherë populli shqiptar, e tregon edhe tash me punën dhe me besnikërinë e tij ndaj Partisë për të mbrojtur vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Vijën e drejtë të Partisë duhet ta mbrojmë, por, që ta mbrojmë, duhet jo vetëm të realizojmë planin e shtetit në prodhim e kudo gjetkë, por edhe të krijojmë ato kushte që kemi parashikuar për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit. Sigurisht, një gjë e tillë bëhet e mundur me punë, me djersë. Nuk duhet të ekzistojë te ne eufori, por as pesimizëm nuk duhet të ekzistojë. Duhet punë, duhet kuptim i thellë politik e ideologjik i problemeve, duhet organizim, duhet kontroll. Bëhet te ne dhe punë politike e ideologjike me njerëzit, të

cilët gjithmonë e më mirë po përgatiten edhe nga ana teknike, vetëm se Partia duhet t'i bëjë këta njerëz të ndërgjegjshëm që t'i kuptojnë situatat në të gjitha këto drejtime. Të mos mendohet se të tërë i kuptojnë këto njëlloj dhe përnjëherë.

Në radhë të parë, ne, udhëheqja e Partisë dhe tërë anëtarët e saj, duhet t'i njohim, t'i studiojmë dhe t'i kuptojmë vetë si duhet këto situata dhe problemet që na dalin. Pastaj të punojmë që t'i zgjidhim si duhet ato, të mos na zërë gjumi, kur punët nuk venë mirë. Në qoftë se veprojmë kështu, qimja e kokës nuk do të na preket në asnjë situatë, sado e vështirë që të jetë.

Situata është e vështirë në të gjithë botën, kurse këtu, te ne, siç e shikoni, është shumë e mirë, dhe jashtëzakonisht optimiste. Të gjithë e dinë se në Jugosllavi çdo ditë ngrihen çmimet. Natyrisht, në fuqi atje është një regjim kapitalist, që ka krijuar një gjendje kaotike. Në Itali kurrë ndonjëherë nuk është parë një kaos i tillë si ky që ekziston sot. Partia «Komuniste» Italiane ka tradhtuar plotësisht dhe ka rënë në ujdi me reaksionin, ajo do që të marrë pjesë në pushtet në ujdi me forcat antikomuniste reaksionare, shfrytëzuese të popullit italian. Në Francë po ashtu e njëjta gjendje, atje po bëhen zgjedhjet dhe thuhet se do të fitojnë partitë e majta. Të majtët janë revizionistët me socialistët. Këta, si revizionistët, socialistët, edhe ata që quhen centristë, janë vënë të gjithë kokë e këmbë në shërbim të borgjezisë kundër interesave të proletariatit francez.

Në këto situata, duke pasur parasysh krizën e rëndë

që ka mbërthyer botën dhe shtetet kapitalisto-revizioniste që rrethojnë vendin tonë, është e domosdoshme që çështjen e planit ta studiojmë me kujdes, ta zbërthejmë me kujdes, ta shpjegojmë mirë e në detaje dhe pastaj të vihem ta organizojmë e ta kontrollojmë vazhdimisht punën. Kjo është kryesorja. Organizimi i mirë i punës dhe kontrolli i vazhdueshëm duhet të jenë në një nivel të lartë, ndryshe do të kemi të meta e dobësi në ekonomi dhe dihet se ekonomia luan një rol vendimtar në situatat e krijuara. Sikur të mos ketë furnizim të rregullt në treg, çfarë do të ndodhë? Do të dëgjohen pëshpëritje. Sigurisht, jo menjëherë, por, në qoftë se zgjatet kjo situatë, pëshpëritjet do të fillojnë. Ne duhet t'i bëjmë të qartë njerëzit se që të përballohen situatat, nuk mjaftojnë vetëm përpjekjet e organeve drejtuese. Duhet të tërë të përpiqemi, sepse, në qoftë se nuk përpiqemi të tërë me mish e me shpirt për kryerjen e detyrave, nuk ka se si të mos krijohen vështirësi. Nuk mund t'ia hedhësh fajin tjetrit, pa shikuar më parë fajin tënd. Të tillë edukatë duhet të krijojmë ne te masat e gjera të popullit, që të shohim edhe të mirat, edhe të metat. Të metat t'i kritikojmë, të mirat t'i lavdërojmë e të punojmë për të ecur gjithmonë përpara.

Ne kemi marrë një varg masash që kurrë të mos ndodhemi në befasi. Kemi vendosur të bëhen një numër studimesh shkencore, por jo studime për studime, por studime që të gjejnë zbatim në të gjithë sektorët e jetës, që nga bujqësia deri në industri, në naftë e kudo për të nxitur prodhimin. Një gjë e tillë është bërë me propozimet e ardhura nga baza, të cilat janë studiuar në dikastere, janë kthyer e rikthyer në Komitetin

Qendror të Partisë dhe në Qeveri dhe tash është marrë vendimi. Nëpër rrethe të krijohen grupe specialistësh nga më të mirët që do të punojnë për vënien në jetë të këtij vendimi. Janë me qindra probleme për të cilat duhet të jepet rezultati brenda afatit të caktuar. Kjo punë studimore e shkencore, siç thashë më lart, nuk bëhet për t'u futur në sirtar, por për ta çuar ekonominë tonë përpara. Ky grup specialistësh është një pjesë e fuqishme dhe e organizuar e revolucionit tekniko-shkencor. Me revolucionin tekniko-shkencor nuk kuptojmë vetëm organizimin e një grupi specialistësh të degëve të ndryshme të ekonomisë sonë për të bërë studime shkencore. Jo! Ai, siç na mëson Partia, duhet të përfshijë të gjithë punonjësit, të gjithë specialistët e teknikët. Të gjithë, atje ku punojnë, të mendojnë, të ndërtojnë atë metodë dhe stil pune dhe ato mjete të perfeksionuara që të rritet rendimenti, të ulet kostoja, të shtohet prodhimi dhe të lehtësohet puna e punëtorit dhe e kooperativistit.

Revolucioni tekniko-shkencor është detyrë e çdo njeri nga ne, kudo ku punojmë. Domethënë asnjëri të mos ecë si kuajt e arabasë, por të gjithë të mendojnë si e si ta rregullojnë apo ta bëjnë sa më mirë punën. Shembuj pozitivë kemi sa të duash ne. Pikërisht ky është revolucionin tekniko-shkencor, domethënë të punosh, të vrasësh mendjen që të përmirësosh mjetet e punës, të cilat ndikojnë në ngritjen e rendimentit, në shkurtimin e kohës që duhet për të prodhuar diçka. Kjo, gjithashtu, bën që ajo që prodhojmë të kushtojë më lirë dhe njeriu të lodhet më pak. Por kjo është e

domosdoshme. Pa, këtë nuk ecin përpara si duhet prodhimi, ekonomia, mirëqenia.

Në këtë punë ne kemi kurdoherë parasysh edhe dëmet që na shkaktoi veprimtaria armiqësore e Abdyl Këllezit, i cili grumbulloi një numër të konsiderueshëm specialistësh në Tiranë e në rrethe jo thjesht për të punuar e për të studiuar, por për të krijuar burokracinë dhe borgjezinë e re ala titiste, vetadministruese.

Të gjitha këto studime shkencore të argumentuara neve na shërbejnë edhe për planin aktual, por do të na shërbejnë edhe për planin e ardhshëm. Kina ka detyrim kontraktor për të na dhënë disa kredi për nja dhjetë ndërmarrje. Do të na i japë apo nuk do të na i japë këto kredi, s'dihet, por 98 për qind mendojmë se nuk do të na i japë. Sido që të jetë, në baltë nuk do të mbetemi. Partia jonë mendon që të gjitha ato objekte dhe të tjera që do të futen në planin e ardhshëm pesëvjeçar, duhet t'i ndërtojmë me forcat tona. Në qoftë se Kina na i jep, bukur, por edhe në qoftë se nuk na i jep, ne i kemi marrë masat. Prandaj këto studime duhet të bëhen edhe me këtë qëllim, që t'i dalim përpara punës, domethënë ta parashikojmë çdo gjë nga ana shkencore, nga ana materiale, nga ana e mundësive fizike. Pra, t'i bëjmë llogaritë edhe nga ana monetare, se sa do të na kushtojnë.

Disa artikuj, pajisje dhe makineri të ndryshme neve do të na duhet t'i sjellim nga jashtë, domethënë t'i blejmë. Po me se do t'i blejmë? Do t'i blejmë duke realizuar këtë plan, duke marrë rendimentet e parashikuara në grurë, bile edhe më të larta sesa kemi parashikuar; po kështu në misër, në luledielli, në pa-

mbuk etj., për të mos importuar vaj e pambuk. Po, në qoftë se nuk importojmë pambuk dhe vaj, nëse nuk do të importojmë një pjesë të madhe të çeliqueve që na kushtojnë me miliona dollarë, atëherë ne do të krijojmë atë mundësi dhe forcë ekonomike sa t'i themi Kinës: «Mbeç me shëndet! Ti nuk do që të na ndihmosh për hidrocentralin e Komanit? Mirë, ne do ta ndërtojmë vetë këtë hidrocentral. Shqipëria është në gjendje sa të blejë tri-katër turbina që duhen për ndërtimin e tij, sepse kemi realizuar planet, kemi krijuar një ekonomi të shëndoshë, që tash me eksportimet tona jemi në gjendje t'i blejmë ato makineri e pajisje që do të na duhen për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë!».

Prandaj, shokë, duhet kuptuar nga të tërë rëndësia politike e realizimit të planit në të gjithë zërat. Kjo është një betejë e madhe, është një luftë e vështirë që ne duhet ta fitojmë. Të shqetësohemi seriozisht kur çalon puna, t'i vëmë shpatullat asaj dhe të jemi të bindur se do t'i realizojmë detyrat e caktuara. Në këtë mënyrë do ta ndiejmë veten njëqind mijë herë më të fortë jo vetëm ekonomikisht, por edhe fizikisht. Do ta ndiejmë veten shumë më të fortë, sepse nuk ka forcë më të madhe se satisfaksioni kur shikon që e ke kryer siç duhet detyrën që të kanë caktuar, pavarësisht se ke ndenjur edhe net të tëra pa gjumë. Ajo të jep atë forcë e atë gjallëri shpirtërore, saqë lodhjen fizike e mposht më lehtë.

E theksoj edhe një herë që plotësimi i detyrave të planit ka të bëjë me fatet e atdheut tonë socialist; kjo është një detyrë jo vetëm me karakter kombëtar,

por edhe ndërkombëtar. Them është detyrë edhe me karakter ndërkombëtar, për arsye se vija e drejtë e Partisë sonë ka çarë male dhe oqeane dhe sot nga marksistë-leninistët, nga elementët përparimtarë të të gjithë botës, bile edhe nga ideologët borgjezë, po diskutohet vija e Partisë sonë që u kundërvihet revizionizmit modern sovjetik dhe atij kinez. Shumë njerëz në botë thonë: «Kush ka të drejtë, Partia e Punës e Shqipërisë, apo Partia «Komuniste» e Kinës? Partia e Punës e Shqipërisë, apo Partia «Komuniste» e Bashkimit Sovjetik?». Pa mburrje mund të themi se shumica dërrmuese e tyre mendojnë se Partia jonë e Punës ka të drejtë.

Ne jemi të bindur se po ecim në rrugë të drejtë, por këtë po e pohojnë edhe të tjerët. Ne shohim që, megjithëse gazetarë borgjezë nuk shkruajnë me dashamirësi për ne, në gazetatat e tyre ata detyrohen të thonë realitetin. Kjo ndodh edhe për shkak të karakterit kontradiktor që ekziston midis argumentimeve shkencore, bindëse që bëjmë ne dhe diskureve false që bëjnë revizionistët. Një gjë e tillë i bën njerëzit të thonë që vija e shqiptarëve është më e arsyeshmja dhe bazohet në themele të forta, kurse ato që thonë kinezët nuk janë të arsyeshme e as nuk kanë bazë. Ç'është kjo «botë e tretë», thonë këta njerëz? Ruxhero Orlando, një gazetar i vjetër italian, thotë: «Titoja vajti në Nju-Jork, gjoja si udhëheqës i «vendeve të paangazhuara». Po ç'janë këto «vende të paangazhuara»? Ky përcaktim nuk ka asnjë përmbajtje», përfundoi ai. Kështu është edhe me «botën e tretë».

Vendi ynë është një vend i vogël. Por ne, shqip-

tarët, jemi ata që kemi ngritur lart dhe e mbajmë fort në duar flamurin e marksizëm-leninizmit. Në Kongresin e 19-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (ishte kongresi i fundit që asistoi Stalini dhe në të cilin ishim edhe ne në tribunë), më kujtohet që Stalini nuk foli më shumë se shtatë minuta. Në mes të tjerash mbaj mend që ai tha: «Flamurin kombëtar, atë flamur të lirisë, të demokracisë, që borgjezia dikur e mbante në dorë, tani e ka hedhur tej. U përket komunistëve dhe elementëve përparimtarë në botë që ta ngrenë e ta mbajnë lart!». Atëherë revizionistët nuk kishin dalë hapur me tradhtinë e tyre. Por pas vdekjes së Stalinit çdo gjë ndryshoi në Bashkimin Sovjetik.

Sot flamurin e marksizëm-leninizmit e mbajmë lart ne, komunistët shqiptarë, dhe shokët tanë të partive të reja marksiste-leniniste. Ky është realiteti; ato që thonë të tjerët janë pallavra, blofe.

Në këto situata, përpara këtij rrebeshi, neve na dalin detyra të mëdha dhe të shenjta, si në fushën politike e ideologjike, ashtu dhe në atë ekonomike, detyra të cilat Partia jonë do t'i kryejë me nder. Detyrat në planin ndërkombëtar do t'i kryejmë si duhet pasi t'i kemi kryer mirë dhe si duhet detyrat në planin kombëtar. Me këtë ndjenjë, me këtë kuptim të thellë patriotik marksist-leninist duhet t'i përvishemi ne punës. Po përpara çdo pune të mendojmë thellë, Partia na ka dhënë «kyçet» e problemeve, me të cilat mund të hapim çdo «derë». Këto «kyçe» janë teoria jonë, që hap çdo «portë», vetëm duhet mësuar që «çelësi» të përdoret mirë, se kështu të hapet horizonti për të ëcur kurdoherë drejt përpara.

Rrethi juaj është një nga rrethet e rëndësishme në vendin tonë. Këtë duhet ta keni të qartë dhe që këtej të kuptoni përgjegjësinë e madhe që keni. Rrethi juaj është një nga hambarët më të mëdhenj të vendit. Ato që tha Ligori për Korçën janë të vërteta, por, në përgjithësi, edhe në këto fusha të Myzeqesë, në Fier e në Lushnjë, ka një hov të madh në punë. Në disa drejtime bujqësia këtu ia kalon edhe asaj të Korçës. Ai rreth ka pasur një zhvillim dhe një përparim të madh në bujqësi dhe këtë nuk e mohon njeri. Tokat atje janë me të vërtetë të sistemuara shumë mirë. Korçari në realitet është punëtor. Por sot nuk mbeten pas edhe myzeqarët. Ligori pak a shumë i njeh mirë fushat e Korçës, se është djalë i asaj toke e i atyre fshatrave. Është fakt se korçarët kanë një metodë të mirë në punët e bujqësisë. Kjo përvojë e tyre duhet të na shërbejë të gjithëve në punë, këtu dhe kudo gjetkë. Por, edhe këtu ka shembuj që flasin për një punë të mirë. Ja, eksperiencia e Donofrosës u bë historike, por të tillë shembuj ka shumë dhe në rrethe të tjera të vendit tonë. Ka rëndësi të përfitojmë nga përvoja e mirë e njëri-tjetrit dhe të mobilizohemi për ta vënë atë sa më parë në jetë që të realizojmë detyrat e planit. Një mosrealizim në Fier, një mosrealizim në Lushnjë etj. rëndon në balancën e planit tonë të përgjithshëm, sidomos në drithëra dhe në blegtori.

Komiteti Qendror i Partisë kurdoherë ka theksuar rëndësinë e madhe që duhet t'u kushtojmë pemëtarisë dhe olivikulturës. Ulliri është një nga drurët që njihet për shekuj me radhë në zonën bregdetare të vendit tonë. Të parët tanë i kanë thurur këngë kësaj peme.

Bota helenistike, ullirin e kishte si pemën më të shenj-të. Kush nuk ka folur në Greqinë e lashtë për ullirin? Aristoteli, Sofokliu, Homeri, i cili tregon se shigjeta e Ulisit, që shpoi syrin e Ciklopit, ishte prej druri të ullirit. Ky është i fortë, rron shumë gjatë. Ulliri prodhon çdo vit dhe prej tij marrim vajin. Të mos harrojmë se vendi ynë, si gjithë vendet e tjera të Mesdheut, është i favorizuar me këtë pemë, prandaj të na vijë keq kur mbjellim blloqe të mëdha me ullinj dhe nuk u bëjmë shërbimet e duhura, por i braktisim.

Kujdes i veçantë duhet treguar edhe për zhvillimin e blegtorisë, degë me rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Vendi ynë ka tradita të lashta në blegtorinë. Por çdo herë që flitet për këtë degë të rëndësishme të ekonomisë sonë, ngrihet mungesa e bazës ushqimore, se në këtë drejtim ka nënvlerësim. Në plan është caktuar një sasi e mjaftueshme prej rreth 100 mijë hektarësh, mbase edhe diçka më shumë, për foragjeret në të gjithë republikën. Mirëpo, shtojë sa të duash sipërfaqen e foragjereve, në qoftë se nuk përmirëson farërat, në qoftë se nuk bën përpjekje për të rritur rendimentin e tyre, baza ushqimore prapë nuk mund të sigurohet. Në disa zona po mbillet për këtë qëllim lakra, e cila ka rendimente të larta dhe vlera ushqimore, gjithashtu, të larta; po kështu edhe sorgumi e plot bimë të tjera që ju i dini më mirë. Po pse nuk e mbjellin me shumicë kudo lakrën? Kjo ndodh se ka njerëz që nuk e kuptojnë rëndësinë e sigurimit të bazës ushqimore për bagëtinë. Sido që të jetë, arsyet duhen gjetur dhe këto na çojnë në kërkimin e shkaqeve e të pengesave të atilla që ka mundësi të ka-

përcehen, siç janë mungesa e krahëve të punës, mobilizimi i pamjaftueshëm, si dhe interesimi i paktë për farërat. Të tëra këto pengesa janë të kapërcyeshme, prandaj punëve t'u shkohet deri në fund.

Nuk mund të rrohet vetëm me bukë, shoqe dhe shokë; organizmi i njeriut i do të gjitha llojet e ushqimeve: zarzavate, mish, gjalpë, qumësht, vezë, fruta etj. Në qoftë se nuk kuptohet rëndësia e prodhimit të zarzavateve, do të thotë që nuk kuptohet as rëndësia e bukës, se kush ha zarzavate, nuk ha bukë shumë, kështu që drithi tepëron dhe hambarët qëndrojnë vazhdimisht plot. Buka është flori, por edhe zarzavatet janë flori, sepse të krijojnë mundësi të harxhosh më pak bukë; ato të krijojnë edhe një forcë të madhe në organizëm, se kanë shumë vitamina dhe vlera të tjera ushqimore me rëndësi jetike. Edhe ushqimet e tjera, si qumështi, gjalpi e mishi kanë që të tëra rëndësinë e tyre.

Prandaj bujqësia duhet të shikohet me një sy të gjerë, jo duke neglizhuar këtë apo atë prodhim, por duke përqendruar të gjitha forcat në punë e duke kontrolluar zbatimin e detyrave. A mund ta bëjmë ne këtë gjë? Po si jo? Ne nuk kemi ndenjur duarlidhur. Rezultate kemi, por çështja shtrohet që puna të bëhet më mirë dhe mundësitë për këtë i kemi. Vetëm në kooperativën e Lapardhasë kemi 100 kuadro të lartë, si dhe 250 kuadro të mesëm të bujqësisë. Po si thoni, akoma më të kemi?! Pra, mund të thuhet që nuk kemi kuadro?! Megjithatë ne bëjmë akoma përpjekje që punonjësit e bujqësisë të kenë që të gjithë, në masë, shkollë të mesme bujqësore. Pra, nuk jemi në gjendje

t'i realizojmë detyrat që na janë vënë përpara për t'i kryer? Sigurisht mund t'i realizojmë, shokë, dhe të jemi të sigurt se do t'i realizojmë.

Partia ka besim të madh te populli dhe këtu qëndron forca e saj. Të gjitha mundësitë janë për realizimin e detyrave të planit. Në popull ky problem është kuptuar politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht. Tash shtrohet me forcë çështja e organizimit më të mirë të punës. Të gjithë ne, shokët e udhëheqjes, jemi të bindur, se rrethi juaj do të punojë i mobilizuar për të realizuar detyrat. Unë ju uroj të arrini suksese, duke realizuar e duke tejkaluar planet në të gjitha degët e ekonomisë.

Situata politike në vendin tonë është shumë e kënaqshme. Tradhtia kineze nuk ka shkaktuar as më të voglën tronditje në masat e gjera të popullit tonë.

Situatat e krijuara në botë janë të vështira, por këto nuk na trembin. Pse? Sepse te ne ekziston unitet i fortë në Parti, dhe kjo është çështja kryesore. Po pse ekziston ky unitet? Sepse vija e Partisë është e qartë, se komunistët janë të bindur për vijën që ndjek Partia, se normat leniniste po zbatohen kudo me besnikëri. Edhe gabime e të meta në punën tonë, natyrisht, ka, por ato, porsa konstatohen, në mos sot, nesër, korrigjohen në rrugë të drejtë. Gjithashtu, lidhjet e Partisë me popullin janë të shëndosha. Këtu kurdoherë duhet të kemi kujdesin më të madh, shkëputja nga populli sjell dobësinë.

Populli e do Partinë, ka besim të madh tek ajo, tek anëtarët e saj. Por këtë çështje duhet ta shikojmë me sy kritik, të jemi kurdoherë të urtë e të matur në

mendime, në vendime, në zgjidhjen e problemeve. Të mos jemi të fjetur, por të mos jemi as të rrëmbyer, as prepotentë. Të mos mendojmë, siç e vura në dukje dhe më lart, se të gjithë njerëzit i kuptojnë çështjet përnjëherë. Ka që i kuptojnë përnjëherë, ka ca që nuk është nevoja fare t'ua thuash se i nuhatin çështjet, por ka edhe të tjerë që i kuptojnë javash. Po si do të veprojnë komunistët me ata që i kuptojnë javash detyrat? Të punojnë me ta që t'i edukojnë, t'i bindin. Prandaj, siç na mëson Partia, duhet të punohet vazhdimisht me kujdes me njerëzit.

Ne duhet të mendojmë për sot, për nesër edhe për të ardhmen, që Partia të jetë e pavdekshme dhe socializmi të ndërtohet e të fuqizohet nga dita në ditë në vendin tonë, edhe pse ky ndodhet në mes të një pellgu të madh armiqësor. Vija e Partisë sonë është e zgjuar, e pjekur, e çeliktë.

Ne kemi bindjen se edhe organizata e Partisë e rrethit tuaj do t'i kryejë me sukses të gjitha detyrat.

Të rrojë Partia!

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në revistën:
*Studime politiko-shoqëro-
re», nr. 8, 1985, f. 20*

*Botohet i plotë sipas shënime-
ve të mbajtura në këtë takim,
që gjenden në AQP*

BLEGTORINË TA KENI MIRË NË QENDËR TË VËMENDJES

*Nga biseda në takimin me kuadro drejtues
të rrethit të Tepelenës*

15 mars 1978

Gjatë rrugës për në Gjirokastrë, shoku Enver Hoxha ndaloi edhe në qytetin e Tepelenës ku u takua e zhvilloi një bisedë me kuadro drejtues të Partisë e të pushtetit në rreth. Në fillim ata e informuan shkurtimisht për rezultatet e arritura nga populli i këtij rrethi, në fusha të ndryshme të ekonomisë e të kulturës. Pas kësaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Tepelena është zmadhuar e zbukuruar shumë. Shikoj se janë bërë mjaft ndërtesa të mira banimi e social-kulturore. Dhe, siç më raportuat, ndryshime të mëdha kanë ndodhur veçanërisht te njerëzit, të cilët janë revolucionarizuar dhe punojnë të mobilizuar për të vënë në jetë direktivat e Partisë.

Rrethi juaj është kryesisht bujqësor, por sidomos blegtoral, prandaj dëshiroj të ndalem një çikë më shumë në këtë çështje të fundit.

Partia, si gjithë degëve të tjera të ekonomisë, vë-

mendje të veçantë i ka kushtuar edhe zhvillimit të blegtorisë në mbarë vendin tonë. Rrethi i Tepelenës, duke pasur pasqyrsh traditën e mirë të popullit të këtyre anëve për rritjen dhe për mbarështimin e bagëtive, sidomos të të imëtave, duhet të kishte rezultate më të larta në këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë tonë popullore.

Përse nuk po punohet sa duhet këtu për një problem me kaq rëndësi të madhe ekonomike, siç është ky i blegtorisë? Direktiva e Partisë për përmirësimin racor të bagëtive ka qenë dhe është e drejtë. Ata që duhet ta kuptonin dhe ta kuptojnë më mirë se kushdo tjetër këtë direktivë, mendoj unë, duhet të jenë edhe tepelenasit. Labi tepelenas brez pas brezi ka pasur një dashuri të madhe për bagëtitë, është kujdesur shumë për to. Në të kaluarën ai s'mund të rronte dot, sidomos, pa delet dhe pa dhitë, sepse e tillë ishte gjendja. Ka rëndësi të veçantë që ta duash bagëtinë dhe të jesh i lidhur me të, siç e kanë dashur atë gjithmonë tepelenasit.

Prandaj, është e pakuptueshme për mua dhe për këdo mungesa e kujdesit që është treguar këtu për përmirësimin e racës. Të jetë labi tepelenas konservator në këtë drejtim? Unë mendoj se jo. Bagëtitë ai vazhdimisht i ka dashur, se ato e kanë mbajtur gjallë, i siguronin qumështin, djathin, gjizën, gjalpin, lëkurët me të cilat jetonte. Pra s'ka arsye që të mos e përqafojë ai direktivën për përmirësimin racor të bagëtisë. Kur Partia hodhi parullën që të bëhet transformimi i bagëtisë, të përmirësohet raca që të marrim për çdo kokë më shumë mish, lesh e qumësht, po të ishte bërë më

parë mirë puna sqaruese dhe bindëse nga ana e Partisë në rreth, nga ana e kuadrove veçanërisht e atyre të sektorit të blegtorisë, populli i rrethit tuaj do të ishte me siguri nga të parët që do ta përqafonte këtë parullë dhe përmirësimet në këtë drejtim sot do të ishin më të mëdha.

E theksoj edhe një herë se është e çuditshme dhe e pakonceptshme për mua çështja e moszbatimit të së resë në blegtori nga tepelenasit. Labi, si gjithë populli shqiptar në krahinat e tjera të vendit, është njeri i zgjuar. Në rrethin e Tepelenës janë bërë shumë ndryshime, si në çdo drejtim, edhe në botën e brendshme të njerëzve. Tek ata kanë zënë vend koncepte e norma të reja të moralit të shoqërisë sonë socialiste dhe nga dita në ditë po bëhen përparime në këtë drejtim. Labi që theu zakone prapanike, që nxori deri vajzën në skenë për të dhënë shfaqje, që e lejon atë të martohet me dashuri, pra, kur ka pranuar këto norma të reja të jetës sonë, që as mund të konceptoheshin në të kaluarën, si mund të mendojmë që ai të mos pranojë të bëjë ndërzimin artificial për përmirësimin racor të bagëtisë, që do t'i sigurojë atij më shumë të ardhura dhe, si rrjedhim, edhe një jetë më të mirë? Pse, nuk e kupton fshatari lab se ç'duhet të bëjë që të realizohet kjo direktivë, të blejë desh race dhe t'i ushqojë këta në mënyrë të veçantë? Labi i di të gjitha këto; ai i njeh mirë delet, e kupton kur ato vijnë në afsh, kusht me rëndësi ky që ndërzimi artificial të ketë rezultat. Bariu tepelenas, kur bagëtitë janë në kullotë ose kur pijnë ujë, e di që ato hanë dhe pinë më me qejf, kur çobani i bie cules. Ai e di, gjithashtu, se kur duhet të futen

në vathë e të tjera e të tjera shërbime që i bëjnë ato të japin më shumë prodhime. Deri dhe qenin ai e mëson që të mos rrijë në mes të dhenve, por t'u vijë atyre rreth e rrotull që të mos ua prishë qetësinë, të mos i shqetësojë, pse çdo shqetësim ndikon negativisht, në uljen e prodhimtarisë së tyre. Bariu lab, pra, ka një eksperiencë të madhe në punët e blegtorisë.

Prandaj, moszbatimi i së resë në blegtori, kryesisht mosfutja në masë e ndërzimit artificial për përmirësimin e racës, veçanërisht të bagëtisë së imët, këtu, në Tepelenë, nuk ka të bëjë me konservatorizmin e bariut lab, por me mungesën e organizimit të mirë të punës, me pamjaftueshmërinë e shpjegimit të domosdoshëm shkencor dhe me moskrijimin e bindjeve të shëndosha të blegtorët për rezultatet e mira që do të arrihen me këto masa. Është e vërtetë, siç e thashë dhe më parë, që bariu ka eksperiencë, por kjo duhet vlerësuar drejt, nuk duhet as të nënvleftësohet, as të mbivlerësohet.

Te ne janë krijuar kudo stacione për ndërzimin artificial të bagëtive e janë marrë edhe masat e nevojshme për ta realizuar sa më mirë këtë detyrë me rëndësi që ndihmon në zhvillimin dhe në përmirësimin racor të tyre. Por, për të pasur sukses, varet kur bëhet dhe si bëhet ndërzimi. Kjo punë kërkon një kujdes të vazhdueshëm, ndryshe nuk arrihen rezultate. Arsyet mund të jenë të ndryshme, duke përfshirë edhe ato me natyrë biologjike, për shkak të sëmundjeve apo të mungesës së bazës ushqimore, siç ndodh edhe te njeriu. Prandaj ju këshilloj t'i mbani kurdoherë sytë të specialistët dhe të veterinerët e mesëm që e kanë për detyrë ta ndjekin këmba-këmbës zhvillimin racor, të

zbatojnë me rreptësi normat e ushqimit, të strehimit e të mbarështimit të bagëtive. Rezultatet, natyrisht, nuk duhen pritur që të vijnë menjëherë; ato duhet të shihen në synimin për të pasur kafshë të përmirësuara për mish, për qumësht, por sidomos për lesh.

Një rëndësi të veçantë ka edhe adaptimi i racës së re me kushtet e ambientit, jo vetëm klimatike, por edhe me ato të kullotës. Në këtë drejtim duhet bërë, gjithashtu, një kujdes i veçantë.

Mendoj se shfaqjet e konservatorizmit në këtë fushë janë të kapërcyeshme, sepse në rrethin tuaj ekziston një faktor i rëndësishëm që jua thashë pak më parë: dashuria e fshatarësisë suaj për bagëtinë. Veçse kjo nuk mjafton, ndaj duhet punuar vazhdimisht me durim që të binden punonjësit e blegtorisë për detyrat që duhet të kryejnë. Ata duhet të kuptojnë se është e domosdoshme të krijohet një racë e tillë deleje që të na japë më shumë qumësht, lesh dhe mish. Kjo kërkim të mblidhen veterinerët, zooteknikët e barinjët më të dalluar e më me eksperiencë e të bisedohet me ta shtruar; t'u kërkohet të reflektojnë përse merren vetëm 30-40 kilogramë qumësht për kokë dhe aq pak lesh nga dhentë dhe ç'duhet bërë për të ecur përpara? Të gjithë ata të vihen në lëvizje që t'u punojë mendja në këtë drejtim.

Rol të rëndësishëm për arritjen e rendimenteve të larta në blegtori luan, sigurisht, edhe baza ushqimore. Prandaj duhet të punohet më mirë për sigurimin e më shumë njësive ushqimore për hektar, se edhe në foragjere rendimentet i keni të ulëta. Në sipërfaqen e tokës së caktuar për prodhimin e ushqimeve të bagëtisë, që

në rrethin tuaj bëhen nja 1 000 e ca hektarë, duhet të merren 70 deri 80 kuintalë njësi ushqimore për hektar, duke mos lënë pas dorë shumëllojshmërinë e bimëve foragjere, si: lakër, sorgum, jonxhë, tërfil etj. Kjo do të sjellë që edhe rendimenti i këtyre bimëve të rritet e, si rrjedhim, edhe raca e bagëtive të përmirësohet. Pas një studimi të kujdesshëm, duhet të mbillen medoemos me plan, duke përcaktuar edhe llojet e foragjereve që duhen kultivuar sipas përbërjes së tokës. Pra është e domosdoshme që specialistët të mendohen mirë për të gjitha këto; të caktohet bile dhe se ku do të mbillet tërfili dhe ku lakra foragjere, duke ua bërë të qarta arsyet kooperativistëve për këto punë. Për shembull, jonxha kërkon tokë nën ujë, prandaj kjo bimë nuk duhet mbjellë në toka mbi ujë. Pasi të jenë parë e të jenë studiuar të gjitha këto kërkesa me kujdes, të bëhen mirë llogaritë, të bëhet planifikimi dhe, më së fundi, të mobilizohen forcat për ta realizuar atë. Po të bëhet kjo, ju s'do të veni më, sipas forcës së zakonit, në Sarandë me bagëtitë tuaja, se çdo ushqim do ta keni siguruar në rreth, në sasi dhe në cilësi. Këtë çështje ta mbani mirë parasysh.

Lidhur me këtë problem të mos harrojmë edhe diçka tjetër. Ushqimet për bagëtitë të kombinohen me kujdes nga specialistët, sipas organizmit të kafshës. Për shembull, po të mungojë kalciumi në ushqim, nëna që do të lindë qengjin ose kecin nuk ka si ta sigurojë këtë element dhe atëherë kocka dhe gjaku i pjellës së saj nuk do të jenë normalë. Po s'u përdor ushqimi i kombinuar, fiziku dhe mbarështimi i bagëtisë nuk mund të zhvillohen normalisht. Pse është ngritur

në vendin tonë socialist jeta mesatare e njerëzve deri në 68 vjeç dhe në rrethin tuaj bile ka arritur deri 72 vjeç, kurse para Çlirimit njerëzit mezi jetonin deri në 40 vjeç? Sepse ndryshuan kushtet e jetesës, ushqimi, intelekti dhe kultura e njerëzve tanë.

Kudo në Shqipëri janë bërë ndryshime, siç janë bërë edhe te ju. Edhe lesh nga çdo dele tani ju merrni diçka më shumë se në të kaluarën, por puna është të arrijmë të marrim 3-4 kilogramë e më shumë për kokë. Për këtë arsye thashë që specialistët tanë duhet të rrahin mendime me njëri-tjetrin, që kjo punë të vihet në rrugë të drejtë.

Përmirësimin racor duhet ta shikoni në drejtime të caktuara dhe të diferencuara. Për shembull, nga kjo ose ajo racë, fjala vjen, të synohet arritja e rendimenteve të larta në lesh: 2, 5, 6 e deri në 8 kilogramë për kokë; nga tjetra të arrihet të marrim më shumë qumësht apo mish. Pra, të përmirësohet raca si rezultat i zbatimit shkencor të ndërzimit artificial dhe mbarështimit të mirë që ajo të japë më shumë lesh dhe mish ose lesh dhe qumësht. Në disa kooperativa bujqësore të rrethit të Korçës, për shembull, merren rendimente më të larta në lesh dhe në mish. Por këto rezultate nuk arrihen me çfarëdo lloj bagëtie, jo me çfarëdo race deleje e në kushte të çfarëdollojshme klimatike e ushqimore. Rrethi juaj do, fjala vjen, raca të veçanta që duhet t'ua sigurojë qendra. Por për këtë të interesoheni dhe të ngulni këmbë edhe ju, por me baza, duke bërë më parë studime të sakta e të hollësishme dhe pastaj të paraqitni kërkesat. Puna mund të fillojë edhe me këto raca që keni, të cilat, me një mbarështim më të mirë,

mund të japin më shumë prodhime. Se çfarë duhet të bëni ju konkretisht për këtë, kjo është një punë që kërkon studim.

· E përsërit se, që të mund të krijoni raca të përshtatshme për mish, për qumësht apo për lesh, rëndësi ka ndërzimi artificial. Për këtë është e nevojshme të bëhet seleksionimi i deshve dhe skartimi i atyre me cilësi të ulëta racore. Kjo kërkon që më parë të grumbullohen e të likuidohen deshtë e racave të vendit, se, po të lihen, këta e dobësojnë llojin e bagëtive që jemi duke përmirësuar me desh të racës. Rrethi juaj ka një numër të konsiderueshëm bagëtish, më tepër se 80 000 kokë të imëta dhe 4 800 lopë, duke përfshirë edhe kreret e oborreve, prandaj është e domosdoshme që blegtorinë ta keni mirë në qendër të vëmendjes.

Direktiva e Partisë për zhvillimin e lopës, për shtimin numerik dhe për përmirësimin racor të saj, është e drejtë. Por për ta zbatuar duhet vepruar me mend, duke pasur parasysh si kushtet natyrore, ashtu edhe leverdinë. Dihet se lopa vërtet të jep shumë, por ajo do ushqim.

Në rrethin tuaj rendimenti mesatar i qumështit për çdo lopë s'kalon më shumë se 800 kilogramë. Ky është një rendiment mjaft i ulët. Nuk ka asnjë leverdi që nga kjo kafshë të merren 700-750 kilogramë qumësht në vit. Me një rendiment të tillë lopa është antiekonomike. Rendiment i lartë arrihet në qoftë se lopës i jepet të hajë sasinë e ushqimit që i nevojitet. Një lopë, për sa i përket sasisë së qumështit, dihet se zëvendëson disa dele. Por, për të marrë prodhim të lartë, faktor tjetër me rëndësi veç ushqimit është edhe raca. Lopët «Lara-

mane», «Xhersej» dhe «Gensej» kanë prodhimtari shumë më të lartë, prandaj këto duhet të shtohen më shumë te ne.

Lidhur me ruajtjen dhe me kullotjen kolektive të bagëtive të imëta të oborreve kooperativiste duhet të tregohemi të matur e të vëmendshëm për një kombinim të drejtë të interesit të përgjithshëm dhe të atij personal. Duhet punuar kurdoherë me kujdes në këtë drejtim, duke pasur parasysh mirë psikologjinë e fshatarit, që është i lidhur pas interesit personal. Kjo nxjerr nevojën e një pune të vazhdueshme edukative për ta tërhequr gradualisht atë drejt interesit të përgjithshëm. Ai akoma nuk e kupton mirë se të ardhurat e tij kryesore duhet e do t'i vijnë nga kooperativa bujqësore. Megjithatë oborri nuk duhet prekur, se, ai është akoma i nevojshëm, ndryshe ne do ta likuidonim. Akoma s'është arritur të kuptohet politikisht dhe ekonomikisht nga fshatarësia kooperativiste, në nivelin që kërkon Partia që çdo gjë për të është prona e përbashkët dhe jo prona e vogël e oborrit. Fshatari është mësuar si me tokën edhe me kafshën, prandaj, shokë, duhet punuar vazhdimisht me të, se prona e vogël e bren si krimbi ndërgegjen e tij. E theksoj se vetëm nëpërmjet një pune bindëse ideologjike, ne do të mundim ta tërheqim fshatarin gradualisht drejt kuptimit të rëndësisë që ka për të ardhmen e tij prona socialiste.

Për oborret kooperativiste ne kemi dhënë edhe udhëzime që ato mund të bashkohen, por kurdoherë të jenë të kooperativistit. Kjo punë mund të bëhet në këtë mënyrë: familjet kooperativiste mund të caktojnë një grup përfaqësuesish që ta ndjekin këtë punë. Nga-

strat e çdo oborri që do t'i bashkojnë, mund të bëjnë të gjitha rreth 50 hektarë. Grupi përfaqësues, pasi të mendojë, do të propozojë se çfarë do të mbillet në këto sipërfaqe, për shembull, grurë, misër, perime apo foragjere. Pasi të bien dakord, të gjithë anëtarët e kooperativës firmosin dhe kjo punë merr formën e prerë. Atëherë, këtë sipërfaqe toke kooperative e punon me traktor, i bën shërbimet e nevojshme dhe, në fund, llogarit shpenzimet e bëra. Për punimin dhe për shërbimet e kryera bëhen llogaritë dhe pjesa që mbetet u kthehet anëtarëve.

Kjo formë organizimi është vënë në zbatim në rrethin e Korçës. Toka e oborrit përsëri është e fshatarit, vetëm se me bashkimin bëhet një punë më e organizuar. Kjo mënyrë organizimi me tokat e oborreve kooperative ka disa anë pozitive, pse ndihmon në rritjen e ndërgjegjes së anëtarëve, lehtëson punën e tyre, u jep mundësi për një pjesëmarrje më të madhe në punët e kooperativës, e, si rrjedhim, ndikon në rritjen e prodhimit. Rëndësi ka që ky organizim të bëhet mirë dhe të mos deformohet, siç ndodhi kur shkurtuam sipërfaqen e oborreve. Udhëzimi që u dha për ngastrat e bashkuara të oborreve që ato të përdorëshin për nevojat e kooperativistëve nuk u zbatua. Atëherë, anëtarët, lopët dhe bagëtitë e tyre filluan t'i futnin fshehurazi për të kullotur në arat e kooperativës. Për pasojë, ata dënohen me gjoba për këto shkelje dhe gjobat vijnë gjithnjë duke u shtuar. Prandaj, në këto punë, duhet bërë kujdes i madh.

Më mirë duhet të ndiqet e të zbatohet edhe udhëzimi për bagëtitë e tufëzuara. Te kooperativistët, jo

vetëm të mos krijojmë pakënaqësi, por, përkundrazi kjo masë të ndihmojë për t'ua lehtësuar atyre punën e për të marrë më shumë prodhime. Por, kjo të vlejë sidomos për të rritur ditët e punës së çdo anëtarit në kooperativë. Tani që bagëtitë personale po i tufëzojmë dhe po u sigurojmë ushqimin, të mbahen mirë llogaritë. Për këtë punë duhet treguar kujdes i madh dhe në asnjë rast të mos ndodhë, fjala vjen, që, po të ngor-dhin 10 lopë të kooperativës, këto t'ua ngarkojnë bagë-tive të oborrit. Të mos rëndohen anëtarët me shpen-zimet e kooperativës. Fundja, në ndonjë rast, më mirë të rëndohet kooperativa me ca shpenzime që do të bë-hen për bagëtitë e oborrit.

Jua them këto, shokë të Tepelenës, se kooperati-vistë nga Maçkullora e fshatra të tjera të vendit më kanë shkruar që udhëzimet atje nuk po zbatohen si duhet. Gjithmonë në këto punë, siç e vura në dukje më parë, duhet mbajtur parasysh psikologjia e fsha-tarit, fakti se sa shumë është i lidhur ai me pronën e tij. Lidhur me këtë më kujtohet rasti i një plaku që kooperativa e kishte caktuar të punonte në stallën e lopëve. Midis të gjithave ai kishte më shumë kujdes për lopën e vet që e kishte futur në kooperativë; asaj i jepte më tepër për të ngrënë se të tjerave.

Me këto dua të theksoj se as oborri, as bagëtia personale nuk duhen braktisur, prandaj rregullat dhe udhëzimet që janë dhënë lidhur me këto duhet të zbatohen drejt.

Së pari, sepse duhen bërë përpjekje që bagëtitë e oborreve të japin sa më shumë prodhime, me qëllim që si shteti, edhe kooperativa të çlirohen nga furni-

zimi i anëtarëve me qumësht, lesh dhe mish. Tufat me bagëtitë e oborreve përbëjnë një pasuri të konsiderueshme, prandaj duhet bërë ç'është e mundur që të rritet prodhimi i tyre.

Së dyti, të mos harrojmë një gjë, se fshatari nuk e zhduk menjëherë ndjenjën e pronës private ndaj tokës dhe dyshimin se me tufëzimin do t'i kolektivizohen bagëtitë personale. Prandaj të punohet drejt që ky dyshim apo mosbesim gradualisht të zhduket. Ndryshe është puna me punëtorët që janë të lidhur ngushtë me pronën e përbashkët socialiste.

Puna me fshatarin kërkon kujdes të veçantë nga Partia dhe nga kryesitë e kooperativave. Në këtë drejtim duhet organizim dhe rritje e kërkesës së llogarisë. Për shkeljet që mund të ndodhin, përgjegjësve t'u hiqet veshi, ndërsa me kooperativistët të bëhet më shumë punë politike bindëse, të hidhen më pak njerëz në gjyqe, se, nga sa na informojnë, në fshatra po jepen shumë gjoba. Prandaj të bëhet më shumë kujdes dhe punë edukative parandaluese, që të kemi sa më pak të dënuar, pse nuk është aspak e drejtë të dënohen njerëzit edhe për gjëra të vogla. Një fshatar më shkruante para ca kohësh që gjykata e kishte dënuar se kishte qëlluar me dackë një fëmijë që nuk sillej mirë. Këto gjëra nuk duhet të ndodhin më. Të tilla veprime nuk na përshtaten neve dhe ato nuk duhet të zëvendësojnë kurrë punën edukative të Partisë me njerëzit.

Në Tepelenë, pa dyshim, vëmendje u duhet kështu edhe problemeve të bujqësisë, grurit e sidomos misrit. Ju e mbillni 41 për qind të sipërfaqes me grurë mbi grurë, kurse 50 për qind të saj me misër në toka

mbi ujë. Grurë mbi grurë ne do të mbjellim, por për këtë qëllim tokat duhet t'i bëni qilizëm, pra të shtoni shërbimet, kurse tokat e misrit mbi ujë t'i pakësoni, sepse nuk merr gjë prej tyre.

Megjithëse rrethi juaj, siç e thashë, është një rreth bujqësor e blegtoral, ju keni këtu edhe industri se keni pranë minierën e qymyrgurit. Kjo ka rëndësi të veçantë për Tepelenën. Por, duke pasur parasysh se atje punon një numër i madh inxhinierësh e kuadrosh të tjerë dhe puna ecën më mirë, kjo nuk do të thotë që me këtë minierë të mos merreni. Memaliajn ne e kemi një nga minierat më të vjetra e më të mirën e vendit tonë, si për sasinë, por sidomos për cilësinë e qymyrit që nxirret atje; prandaj, në asnjë mënyrë nuk duhet nënvleftësuar puna që duhet bërë atje nga Partia dhe nga pushteti në rreth. Është e domosdoshme që vazhdimisht të ushtrohet kontroll, se pastaj krijohen probleme. Nuk duhet të harroni, shokë, se ju mbani një peshë të rëndësishme për energjetikën në vendin tonë, prandaj i kushtoni vëmendje të vazhdueshme kësaj miniere. Megjithatë, bujqësia dhe blegtoria, natyrisht, kërkojnë një preokupacion të veçantë nga ana juaj, prandaj me këto ju duhet të merreni më shumë.

Çështjeve ekonomike u kushtoni rëndësi të madhe. Ngrihuni një çikë nga situatat e rrethit dhe i shikoni realizimet e mosrealizimet në shkallë republike. Analizoni gjendjen, nxirrni mësimë dhe mendoni se ç'do të thotë për gjithë republikën, në qoftë se rrethi juaj, rrethi fqinj ose më tej të mos e realizojë planin. Kur realizoni planin e qymyrit etj. ju i keni bërë një shërbim të madh republikës, i keni shërbyer ndërtimit të socia-

lizmit në vendin tonë. Deficitet, pra, nuk duhen parë vetëm në shkallë rrethi. Për to nuk mjafton t'u vrasë ndërgjegjja, por duhet të mobilizoni të gjitha forcat për realizimin me çdo kusht të detyrave të planit, sepse mosrealizimet në shkallë rrethi dobësojnë gjithë ekonominë e vendit.

Çdo çështje, siç jua theksova, Partia duhet ta zgjidhë me durim e kujdes, sidomos me fshatarësinë. Në çështjet politike jo vetëm nga ju, kuadrot e Partisë, por nga të gjithë duhet treguar pjekuri. Të gjithë ne që jemi këtu, jemi lebër dhe na ka dalë nami se jemi të pushkës. Por këtë çështje duhet ta shikojmë në prizmin marksist-leninist, se s'janë vetëm lebërit të pushkës; i pushkës është i gjithë populli shqiptar. Pastaj, trimi duhet të jetë kurdoherë i thjeshtë, kokulur e jo fodull. Lufta për ndërtimin e socializmit është e madhe, e fortë e me vështirësi nga më të ndryshmet. Dje ne luftuam nëpër gërxhe për një çështje të madhe, për çlirimin e vendit nga okupatorët dhe tradhtarët. Por edhe sot rrugës ka shumë «gërxhe» dhe për kapërcimin e tyre lufton gjithë Shqipëria, i madh e i vogël. Në këtë luftë ne duhet të jemi të vendosur, por edhe modestë, sepse mungesa e modestisë sjell grindje, mëri, hasmëri, ringjall hierarkinë, prepotencën, dhe bën të mos kuptohen mirë kontradiktat joantagoniste të shoqërisë sonë socialiste.

Çdo problem ta zgjidhim me forma të përshtatshme dhe në rrugën marksiste-leniniste që na mëson Partia. Të metave t'u shikojmë deri në fund, t'u gjejmë rrënjët dhe shkaqet pse ngjasin. Një njeri i thjeshtë kurrë nuk nxehet e nuk ofendon, problemet i trajton me gjak-

ftohtësi. Një gjykim e vendim i matur e me gjakftohtësi bën më shumë efekt, ndërsa atë që e kritikon, në qoftë se kritikën e bën të padrejtë, «e vret». Po i bëre kritikë të drejtë shokut, edhe pse në moment mund të mos e kuptojë gabimin, më pas ai do ta bluajë patjetër në mendje, do të ulë kokën dhe, kur t'i ftohen gjakrat, do të shohë qartë, do të njohë gabimin e do të korrigojë.

Marrim vesh se në mjaft raste ka grindje, mëri e zënie për hiçgjë në mes njerëzve tanë; ka raste që nuk flasin me gojë edhe njerëz të një fisi. Po pse ngjasin këto gjëra? Sepse ka mungesë të kuptimit politik të problemeve nga ana e të tillë njerëzve, gjë që dobëson unitetin e popullit, prandaj duhet pasur shumë kujdes në këto çështje.

Në qoftë se kishim njëqind herë nevojë për unitet, kur Bashkimin Sovjetik e udhëhiqte Stalini në rrugë të drejtë, kur ishim në miqësi me Kinën e kur ne mendonim se ajo ishte në rrugë të drejtë, me aq sa e njihnim, tani ne kemi nevojë një mijë herë më shumë për unitet të shëndoshë në popull. Populli duhet mbajtur afër, duhet sqaruar e bindur për një varg problemesh. Kjo realizohet kur Partia është kurdoherë në krye të punëve dhe për çdo gjë vepron me drejtësi, se populli sytë i mban kurdoherë te Partia. Populli do zgjidhje të drejtë për çdo gjë, le të jetë kjo për ndonjërin zgjidhje e hidhur; vështirësia do të kapërcehet dhe do të kuptohet gradualisht. Nga drejtuesit kërkohet drejtësi, sepse, po nuk u veprua me objektivitet në kritikën ose në zgjidhjen e problemeve personale, pakënaqësitë që krijohen nga veprimet e gabuara të drejtuesve shtohen dhe ka njerëz që u duket sikur padrejtësinë ua bën Partia.

Ka shumë halle e probleme për të cilat njerëzit ankohen e kërkojnë t'u zgjidhen nga Partia dhe pushteti, prandaj gjatë pritjes së popullit, njerëzit duhen dëgjuar me durim; të sqarohen me të urtë, pa çka se ka edhe nga ata që vijnë nga njëzet herë në takim. Kjo punë kërkon kujdes, njerëzit të priten e të përcillen me ngrohtësi. Forconi Partinë dhe lidhjet e saj me popullin, shokë!

Gjendjen e vendit e kemi të mirë. Mësimet e Partisë sonë po dëgjohen me kujdes në të gjithë botën. Efekti i vendimeve të Kongresit të 7-të është i madh kudo. Jehona e punimeve të këtij kongresi, duke bërë një krahasim të figurshëm, është si hedhja e një bombe të fuqishme në një rezervuar të madh pas plasjes të së cilës shikon shpërndarjen e valëve me shpejtësi në të katër anët e rezervuarit. Kështu ndodhi pas argumentimit shkencor, marksist-leninist, që u bëri ngjarjeve botërore Partia jonë në Kongresin e saj të 7-të. Sot me miliona njerëz studiojnë kudo me vëmendje qëndrimin e Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit dhe revizionistëve të vjetër titistë e hrushovianë, si dhe revizionistëve të rinj kinezë dhe po e kuptojnë gjithnjë e më qartë se kush është në rrugë të drejtë dhe kush është në rrugë të gabuar.

Gjithë bota përparimtare është me ne, kurse me revizionistët janë forcat reaksionare, ata që janë shitur për para, ata që kanë flakur tej marksizëm-leninizmin. Opinioni përparimtar botëror është me ne. Kjo është një ndihmë e madhe për ne që kemi miq kudo, por, siç thotë populli, duhet punë, sepse i zoti e nxjerr gomarin nga balta. Po të jemi të fortë politikisht, do të

jemi të fortë edhe ekonomikisht dhe anasjelltas. Prandaj kërkohet mobilizim akoma më i madh i energjive mendore e fizike të të gjithë njerëzve. Ju duhet ta organizoni punën mirë me të gjithë njerëzit, me të gjitha levat e Partisë. Kurrë të mos mendoni se 10, 100 apo 200 njerëz që drejtojnë mund të na nxjerrin nga situata. Jo. Këta duhet ta organizojnë mirë punën, të punojnë me durim e këmbëngulje me të gjithë njerëzit për t'i frymëzuar ata që të kenë besim në forcat e Partisë dhe të shtetit tonë, dhe me ndërgjegje të lartë të mobilizohen për realizimin e detyrave.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

DUA T'I SHOH TË GJITHA VENDET E TË ÇMALLEM ME GJIROKASTRËN

*Nga bisedat gjatë ditës së parë të vizitës
në Gjirokastrë*

16 mars 1978

Shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga shoqja Nexhmije Hoxha dhe nga drejtuesit e Partisë e të pushtetit në rreth, në paraditen e 16 marsit 1978, nisi vizitat në Gjirokastrë. Gëzimi i banorëve të qytetit, që kishin mbushur rrugët, ishte i papërmbajtur. I rrethuar nga ky entuziazëm i madh, duke ecur më këmbë, shoku Enver Hoxha zbret në sheshin «Çerçiz Topulli» për të vendosur kurora në monumentin e këtij luftëtari të shquar të lëvizjes sonë kombëtare, si dhe te bustet e dy heroinave të popullit, Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima.

Prej këtej, shoku Enver Hoxha u drejtua për në varrezat e dëshmorëve që ndodhen në hyrje të qytetit, mbi një kodër të bukur të rrethuar me gjelbërim. Aty shokun Enver e pritën prindër e të afërm të dëshmorëve, veteranë, punonjës të qytetit të Gjirokastrës dhe nga krahinat përreth, me të cilët takohet e bisedon.

SHOKU RESUL ZANI¹: Kjo është nënë Feroja².

SHOKU ENVER HOXHA: O... , nënë Fero! Si je me shëndet? Si e ke djalin, nusen? Po fëmijët si i kanë ata?

NËNË FERROJA: Mirë jemi të gjithë, bir i nënës!

SHOKU RESUL ZANI: Kjo është motra e dëshmorit Astrit Karagjozi.

SHOKU ENVER HOXHA: Hajde këtu të të puth e të të përqafoj se më ka marrë malli! Po nënën si e ke me shëndet, mirë është?

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Mirë është, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Plaku ka vdekur, më erdhi shumë keq.

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Ju faleminderit për ngushëllimet që na dërguat kur na vdiq.

SHOKU ENVER HOXHA: Nënës bëji shumë të fala e puthi dorën nga unë!

Duke iu drejtuar një tjetri: Si je, mirë? Ç'punë bën ti? *Bashkëbiseduesi përgjigjet*: «Jam shofer». *Shoku Enver Hoxha ia kthen duke qeshur*: «Dukesh që je shofer, se ma këpute dorën».

Po Çome shoferi nga Varoshi, si është, apo ka vdekur?

SHOKU RESUL ZANI: Ka vdekur, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , paska vdekur!

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Gjirokastrës.

2. Fero Hormova.

Çomeja ishte shofer e i binte rreth e qark gjithë vendit. E kam pasur shok në kohën e rinisë.

SHOKU RESUL ZANI: Kjo këtu është vajza e Qani Ficos¹, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe Qaniu ka qenë shok i vjetër imi. Qaniu i kishte leshrat të kuqe. Ngjarjet e rinisë mbahen mend mirë. E shikoni, edhe flokët e Qaniut më kujtohet se ç'ngjyrë kishin!

Ndërkaq shoku Enver ndalon dhe pyet një shoqe:

Po ti e kujt je? («Jam nusja e djalit të Myrteza Tushes»²). Unë njoh më shumë xha Bidon, në lagjen Palorto. Ishte njeri i mirë. Më kujtohet një ngjarje me xha Bidon, kur isha i vogël. Baba Çeni, xhaxhai im, më dërgoi te xha Bidoja dhe më porositi: «I thuaj Bidos të të japë dy pako me qirinj!». Dhe unë shkova me vrap tek ai e i kërkova të më jepte dy pako me qirinj, siç më kishte porositur baba Çeni. «Ik or tutje, nga erdhe», më bërtiti xha Bidoja. «Si të iki, i thashë unë. Dua qirinjtë, m'i jep se do ta kesh keq me baba Çenin, po nuk m'i dhe». Ai hapi një sirtar dhe më tha: «E sheh këtë?». Ishte një pisqollë. «Po baba Çeni ka pallë», iu kërcënova unë. Ai qeshi dhe më thirri: «Hajde, mo këtu!». U fut në qilar dhe që andej doll me dy pako qirinj. Bashkë me pakot më dha edhe tri copë llokume në një fishek dhe më pëshpëriti në vesh: «Thuaji Hysen Hoxhës që Bido Tushja është dhelpër dhe e kupton përse i do sot qirinjtë ai».

1. Melo Fico.

2. Drita Tushe.

Të nesërmen ishte Dita e Flamurit, prandaj i duheshin qirinjtë baba Çenit. Natën ai vuri nga një qiri të ndezur në çdo dritare. Ishte koha kur Gjyrokastër qe pushtuar nga të huajt.

Kjo është një nga ato historitë e vjetra.

Pastaj shoku Enver Hoxha iu drejtua disa burrave të moshuar, qymyrxhinjve të dikurshëm:

Edhe ju keni vuajtur shumë në të kaluarën, por ditë të mira solli Partia për ju, si për gjithë ne të tjerët.

SHOKU RESUL ZANI: Ky është djali i Murat Finos¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, mirë? Rron Murati?

SHOKU ENGJËLL FINO: Jo, ka vdekur.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur isha 9 vjet më parë në Gjyrokastër e takova Muratin.

SHOKU RESUL ZANI: Ky është djali i Hasan Lumanit (Babameto), e ka shtëpinë në Cfaqë.

SHOKU ALI MANAJ²: Kjo shoqja, shoku Enver, është sekretare e parë e komitetit të rinisë të rrethit³.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, moj shoqe, a je mirë? Ju keni këtu një shoqe të mirë në komitetin e Partisë, Rashide Gjinin. Ku është Rashideja? (*Rashideja i del përpara shokut Enver.*)

1. Engjëll Fino, në atë kohë telekronist i rrethit të Gjyrokastërës.

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjyrokastërës.

3. Zogë Arseni.

Pa hajde këtu, moj Rashide! Pse na rri larg?
Afrohu! Si je, mirë?

*Pyet një tjetër: Po ti nga je? «Jam nga Stegopuli»,
përgjigjet ajo.*

Kam qenë në Stegopul kur isha i vogël. Pranë shtëpisë ku rrija ishte një doktor, i cili kuronte vëllanë tim të sëmurë. Më kujtohet që doktori kishte një vajzë që e quanin Viktori, të cilën më vonë, kur u rrit e martoi me një mësues që i binte violinës. Po aty ishte edhe një kako Frosó dhe pak më tutje ndodheshin një rrap dhe një kafene. Atje shkonte babai im dhe e hiqte nganjëherë kafënë me priftin e fshatit.

Duke iu drejtuar një kalimtari tjetër, shoku Enver e pyet: «Po ti nga je?». «Nga Fushëbardha», përgjigjet ai.

Kur dëgjon këtë emër thua se ky fshat s'ka tjetër gjë, veç fushës së bardhë e pa vlerë. Por jo, s'është ashtu. Në Fushëbardhë ka fosforite.

Tani të shkojmë dhe t'u vendosim kurorë shokëve, partizanëve trima, heronjve të pavdekshëm të popullit tonë.

Shoku Enver Hoxha vendos kurorën dhe nderon me grusht, duke kaluar një nga një para varreve të partizanëve të rënë. Pastaj, duke iu drejtuar të afërmeve të dëshmorëve e gjithë të pranishmëve tha:

Të rrojë Partia! Të pavdekshëm në shekuj djemtë dhe vajzat tona që luftuan për lirinë e Shqipërisë! Mirupafshim!

Nga varrezat e dëshmorëve shoku Enver Hoxha ngjitet në kalanë e Gjirokastrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shikoni çfarë kalaje!
Hajde zaptoje po deshe!

Kur ishim të vegjël, nuk na linin të futeshim këtu, në kala. «Mos u futni, se do t'ju dalë e do t'ju hajë lugati!», na thoshin.

SHOKU LEFTER DILO¹: Në kohën e bombardimeve, pesë muaj kanë qëndruar njerëzit këtu brenda.

SHOKU ENVER HOXHA: Dijetarët e huaj ngulin këmbë se këtu ka thesare të fshehura. Akoma nuk e keni gjetur thesarin e Ali pashë Tepelenës?!

SHOKU LEFTER DILO: Siç duket, do të jetë zbuluar në Janinë ky thesar.

SHOKU ENVER HOXHA: (Me shaka) Nuk dihet, edhe ju mund ta gjeni këtu. Për këtë thuaju edhe shokëve të pushtetit: «Jam i sigurt se ka një thesar këtu brenda, prandaj më jepni fonde që të gërmoj». (Të qeshura.)

SHOKU LEFTER DILO: Ky është monumenti «Partizani».

SHOKU ENVER HOXHA: Pa dale ta shoh një çikë mirë! I hiqni pak këto drita ju, shokë operatorë! Dua ta shoh pa drita, se kështu i kemi parë partizanët gjatë luftës. Shikoni sa bukur është punuar ky monument! Paskali² e ka bërë?

SHOKU LEFTER DILO: Po, ai.

Shoku Enver, të hyjmë një çikë këtu brenda! Kjo është një dhomë-muze e kalasë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, hyjmë. Po me kë-

1. Në atë kohë drejtor i muzeve të rrethit.

2. Odhise Paskali (1903-1965), Skulptor i Popullit.

to punë, si ia çon, Lefter? Dëshiroj të të përgëzoj për punën e mirë që po bën për muzetë. Unë i lexoj shkri-
met e tua që boton herë pas here në gazetën «Pararoja»
të Gjirokastrës. Një punë me pasion si ty duhet të bëjnë
të gjithë ata që merrin me muzetë, me kërkimet, me
mbledhjen e materialeve, si dhe me kronikat.

... Është punë e vështirë kjo, por me vlerë të madhe,
se u shërben artit dhe kulturës sonë, edukimit patriotik
të njerëzve tanë.

*Këtu shoku Enver Hoxha takohet me disa puno-
njës të shtypit që kishin shkuar në Gjirokastër me
rastin e vizitës së tij.*

— U... , ku je ti Ajet, kam mjaft kohë pa të parë.

SHOKU AJET SIMIXHIU: Tani, shoku Enver, pu-
noj në gazetën «Zëri i popullit».

SHOKU ENVER HOXHA: Paske ardhur edhe ti,
Miti¹. Epo, medoemos, je me sektorin e shtypit ti.

Si je tani me shëndet? Mua mirë më dukesh.

SHOKU MITI TONA: Faleminderit, mirë jam tani.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem shumë që je
mirë...

*Për disa çaste shoku Enver Hoxha ulet në një stol,
buzë mureve të kalasë. Duke soditur prej aty Gjiro-
kastrën, u drejtohet gazetarëve, kinooperatorëve e tele-
kronistëve:*

... Hajde të ulemi një çikë këtu, buzë mureve të ka-
lasë. Si ju duket Gjirokastra jonë juve, shokë gazetarë,
kinooperatorë e telekronistë? («Shumë e bukur», për-

1. Dhimitër Tona, shef i sektorit të shtypit në aparatën e
KQ të PPSH.

gjigjen njëzëri të gjithë ata.) Ne gjirokastritët nuk themi gjë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ashtu është, ne të shtëpisë nuk flasim.

SHOKU ENVER HOXHA: Vetëm ju themi: shihni dhe shkruani, ose bëni fotografi. Kjo pamje flet vetë. Gurë e tëra, nga këmbët deri te koka.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Enver, ky është Hektori i Hakiut [Toska], që punon inxhinier në televizion.

SHOKU ENVER HOXHA: U... si je more? Hajde një çikë këtu të të përqafoj.

Rashide, hajde ma jep dorën ti dhe rri këtu afër!

SHOQJA RASHIDE GJINI: Sa e bukur duket Gjirokastra, që këtej nga kalaja, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: E bukur, duket, shumë e bukur! Ti shtëpinë e ke këtej nga Dunavati, apo jo?

SHOQJA RASHIDE GJINI: Po, nga Dunavati e kam.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtej shkohet deri në Kucullë? Dhe, prej andej pastaj te Lukurama.

SHOKU LEFTER DILO: Kanë grisur aq e aq pantallona fëmijët duke rrëshqitur andej, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ashtu është, shumë pantallona kemi grisur ne andej dhe po kaq baca kemi ngrënë nga anetë. Megjithatë, mua aneja nuk më ka rrahur shumë, sepse më shikonte si të vetëm. Një çikë më tepër nga gjithë ne të tjerët ajo donte Sanon. Epo, më përpara i donin më shumë çupat. *(Të qeshura.)*

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po shikoj, shoku Resul, se njerëzit kanë filluar të përdorin edhe tjegullat në çatitë e shtëpive.

SHOKU RESUL ZANI: Jo, jo, shoqja Nexhmije, këto shtëpi kështu kanë qenë; ne nuk i përdorim tje-gullat për të mbuluar çatitë.

(Të gjithë shikojnë Gjirokastrën që prej aty duket si në pëllëmbë të dorës.)

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu, ulur në këtë stol, buzë mureve të kalasë, e ndiejmë veten si në divanin e pashait! Pa të ngrihemi tani dhe të shikojmë pjesët e tjera të kësaj kalaje të lashtë.

SHOKU LEFTER DILO: Shoku Enver, të kthehe-mi prapa, se këtej nuk kalohet, është e mbyllur porta.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa më shiko një çikë në sy! Ato mos m'i thuaj mua! Po ç'më mbani kështu sikur jam plak! E di ti, Lefter, që drënjë do të thotë dru i fortë, abanoz? Edhe ne ashtu jemi, të fortë si abanozi. Ju nuk e kuptoni që unë nuk vij dot çdo vit se kam punë, pa kisha për t'u ngjitur deri këtu në kala sa herë që të vija. Prandaj, më lini të kaloj e t'i shoh të gjitha vendet e të çmallem. Unë kam mall të madh për këto, prandaj dëshiroj t'i shkel, kurse ju më thoni: «Është mbyllur porta, është kështu e është ashtu!»- Siç duket, po më merrni si të kaluar nga mosha dhe kujtoni se e kam të vështirë të kaloj andej. Jo, për-kundrazi, unë e ndiej veten shumë mirë. Në rrugët me kalldrëm s'ecën dot çdo njeri me lehtësi, veçanërisht një që nuk është mësuar në të tilla rrugë. Kurse unë që jam mësuar nuk e kam të vështirë. Mos më mbani sikur jam plak, u thashë edhe një herë, se jam i fortë. Folë, more Isuf¹, është kështu apo jo?

1. Isuf Kalo, mjek.

SHOKU ISUF KALO: Po shoku Enver, ju mbaheni si një i ri. Pastaj këtu është shumë bukur.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, te muri atje ka qënë një varr. Më kujtohet se si njëherë, kur ishim të vegjël, qëlluam me gurë te ky mur dhe, duke goditur fort atje lart, ranë ca kocka. Ne i mblodhëm dhe i çuam në qytet. «Ku i gjetët këto?», na thanë. Ne u treguam se i kishim gjetur në murin e kalasë. Ishin kokalla njeriu. Në kala, me sa dukej, ishte bërë murosje. Ndërtuesit e kalasë donin që muret e saj të ishin të forta si njeriu, pse njeriu është më i fortë se çdo gjë, abanoz.

Sa bukur duket lagjja Pllakë! Ja, atje janë shtëpitë e Latos, të Bajramit. Më tutje janë shtëpitë e Muslim Kores, shoferit tim, se këtej e kam shoferin, nga Korajt.

Edhe nga kjo portë kam hyrë, kjo është Porta e Sahatit.

Duke kaluar te Pazari i Vjetër, rrëzë kalasë, në lagjen Pllakë, shoku Enver ndalet te një shtëpizë e vogël e rrethuar me mur.

Shumë bukur është këtu, shumë bukur! Na bëni një fotografi këtu, përpara portës së kësaj shtëpie të mbuluar me rrasa guri! Është kënaqësi të vish këtej e të shikosh këto vende!

Pa shiko moj Sano, a është Feruzeja¹ brenda? Ejani të shkojmë të pimë një kafe tek ajo!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po për të gjithë ne, ajo nuk do të ketë kafe, se jemi shumë, po sa për ty do të ketë.

1. Feruze Hoxha, nëna e dëshmorit Riza Hoxha.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, sa për mua do të ketë kafe. (Të qeshura.)

Feruze, këtu je, moj?!

NËNË FERUZEJA: Po, këtu jam, të keqen motra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po si të kam, je mirë?

NËNË FERUZEJA: Mirë jam të keqen, mirë. Po ku je, more Enver?...

Ti Nexhmije si je? Bëre mirë, Enver, që na solle edhe Nexhmijen këtu.

SHOKU ENVER HOXHA: Po unë nuk do të vija vetëm, moj Feruze, me gjithë Nexhmijen do të vija; nuk do ta mbaj mbyllur, siç ju mbanin ju në të kaluarën.

NËNË FERUZEJA: Na kënaqe shumë, na zbukurove dynjanë. Rrofsh!

SHOKU ENVER HOXHA: E mbaj mend mirë gjithë këtë vend. Kam ardhur edhe këtu te shtëpia juaj.

E shikon që u pamë edhe një herë e u çmallëm bashkë, moj Feruze?

NËNË FERUZEJA: U pamë e u kënaqëm, të keqen motra, dhe prapë do të shihemi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ata të teto Zenos i ke në fotografi? Unë kam fotografinë e nëndajkos; ka dalë edhe Sanoja atje. Nur fare ka dalë ajo, kurse unë kam dalë si kokollon.

SHOQJA SANO HOXHA: Jo moj, mirë ka dalë, bukur, po thotë ashtu që të mos e hanë me sy. (Të qeshura.)

SHOKU ENVER HOXHA: Na duhet edhe të qeshim. Njeriu duhet ta gëzojë jetën.

Po këtë fëmijën e keni mirë me shëndet, Feruze?

Sikur ty të ka ngjarë, se edhe ti, kur ishe e re, ke qenë e bukur.

NËNË FERUZEJA: E bukur, po kush na linte në atëherë të dilnim. Na mbyllnin brenda.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, atëherë mbylleshin brenda vajzat dhe as bukuria u dukej e asgjë s'mësoje për to. Tani ndryshuan kohët.

Këto vajzat ju shkojnë në shkollë?

NËNË FERUZEJA: Jo, janë të vogla, shkojnë në kopsht.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të na thuash ti, vogëlushe, një vjershë për Partinë?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Hajde Brikena, na thuaj një vjershë për Partinë, se do të të marrin në film, do të dalësh edhe në televizor.

(Brikena e vogël recitoi vjershën për Partinë.)

SHOKU ENVER HOXHA: Të lumtë! Ta duash Partinë gjithnjë! *(Shoku Enver e përgëzon dhe e përqafton.)*

Po edhe unë kam mbesa e nipa tashti, Feruze, por këtu në xhep kam vetëm fotografinë e Valbonës, të mbesës sime. Po t'i mbaja të gjitha fotografitë e tyre me vete, duhej të kisha shumë xhepa. Pa shikoje, moj Feruze, fotografinë e Valbonës, si e kam?

NËNË FERUZEJA: Sa e bukur, sa e bukur qenka!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Valbona këtu ka dalë me kurorë lulesh në kokë. Edhe fotografitë e fëmijëve të tjerë, unë i kam me vete, këtu në çantë. Ja, shikoj, nënë Feruze. Ky është djali i Pranverës, ky tjetri i Ilirit.

SHOKU ENVER HOXHA: Valbona më mori mbrë-

më në telefon dhe më tha: «E di ti gjyshi ku jam unë?». «Ku je?», i thashë. «Jam në Tiranë», më tha. «Kurse unë jam në Gjirokastrë», i thashë. (Të qeshura.)

NËNË FERUZEJA: Kështu të bukur kemi qenë të gjithë, kur ishim të rinj e të vegjël (të qeshura). Ky është djali, Tomori.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, more Tomor, mirë? Po nga erdhe tashti, nga puna erdhe?

SHOKU TOMOR HOXHA: Po, sapo mora vesh për ardhjen tuaj në shtëpinë tonë, u nisa menjëherë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pasi vizituam kalanë, thashë t'i bëj edhe Feruzesë një vizitë. Dhe kështu bëra. Ja, u ulëm këtu e pimë një kafe bashkë.

Babai juaj, Dyli, na la, Tomor, por të rroni ju, me fëmijë e me të gjithë!

SHOKU TOMOR HOXHA: Faleminderit, të rroni ju, shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, shikojini të gjithë këta djem-burra, të tërë janë të rinj, energjikë, të gjithë të periudhës së Partisë.

Tani do të çohemi. U gëzova shumë që je mirë me shëndet, Feruze, dhe që gjithë këta nipër e mbesa i ke mirë. Qofshi mirë kurdoherë! Qofsh mirë Feruze! Rrofsh dhe i martofsh fëmijët! Ti je edhe më e re nga unë, prandaj të gjithë do t'i gëzosh. Nuk e kam fjalën për fëmijët e tu, po për nipat e mbesat. Edhe unë do të rroj e do ta martoj këtë mbesën që shikon në fotografi. Gjuloja¹, që ishte tjetër brez, rrojti 90 vjeç, kurse unë i takoj një brezi më të ri, prandaj do të rroj edhe ca

1. Gjylo Hoxha, nëna e shokut Enver Hoxha.

më shumë derisa ta martoj Valbonën e të pres edhe një kalama nga ajo.

Tani Feruze do të më lejosh se do të shkoj.

NËNË FERUZEJA: Po si do të ikësh?! Rri edhe një çikë, mor të keqen!

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, do të iki tashli. Mir-upafshim, qofshi mirë, të fala të gjithëve!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këto biseda. që gjenden në AQP

THESARET MË TË MËDIIA JANË POPULLI DHE PARTIA

Fjala në mitingun me popullin në Gjirokastrë

17 mars 1978

Shumë të dashura mëma, baballarë, motra e vëllezër,

Shokë dhe shoqe,

Pionierë dhe pioniere të qytetit e të të gjithë rrethit të Gjirokastrës,

Në emër të Partisë, të shokëve udhëheqës dhe në emrin tim personal ju përshëndes me zjarr nga zemra të gjithëve. Jam shumë i gëzuar që ndodhem sot në gjirin tuaj. Kam dashur të vij më shpesh këtu, pranë jush. «Po, he, mund të thoni ju, ç'u bëre, pse s'erdhe më parë?» Është e tepërt të them se dëshira ime për të ardhur më shpesh në mes tuaj, nuk varej vetëm nga unë, por edhe nga puna që më ka besuar Partia. Kur inauguruat obeliskun dhe muzetë e rëndësishme rreth e rrotull tij, më qante zemra për të ardhur, por punët më penguan. Megjithëkëtë, siç ju shkruaja atëherë, zemrën e kisha te ju.

Kam lexuar një libër me titull: «Jeta fillon në 50 vjeç» të shkruar nga një mjek i huaj i dëgjuar. Autori i librit shkruan se kur kalojnë të 50-60 vjetët, njerëzit, që nuk jetojnë në vendlindje, duhet të kthehen shpeshherë atje dhe shpjegon arsyt. Kur lind foshnja, thotë ai, të gjitha pjesët përbërëse të organizmit të saj, mishi, kockat, nervat, muskujt, gjaku etj., ndikohen nga ambienti rrethues. Edhe lëndët ushqyese që merr organizmi, bashkë me ujin dhe me qumështin e nënës, mbajnë vulën e vendlindjes. Deri edhe drita e diellit dhe ajri i vendit, ku ka lindur njeriu, kanë veçoritë e veta për organizmin. Rrugët, sokaqet dhe sheshet ku brendh fëmija ndikojnë në zhvillimin e organizmit të tij. Kështu rriten e forcohen muskulatura, kockat, mushkëritë etj. Pas 50-60 vjetësh vendi i lindjes rrezaton në celulat e trupit të njeriut po ato elemente që ka rrezatuar në fëmijërinë e tij dhe kështu e gjallëron dhe e përtërin atë.

Shoqja Rashide, sekretarja e komitetit të Partisë të rrethit, më tha: «Ke 9 vjet pa ardhur, shoku Enver». E di që kam 9 vjet, por megjithëkëtë edhe ardhja me vonesë më bëri 10 vjet më të ri, prandaj them se tani unë nuk jam më 70, por 60 vjeç. Po të kisha ardhur edhe më përpara, do të isha 50 vjeç.

Ju e dini që unë jam i ri, por ç't'u bëj shokëve drejtues të rrethit që më thonë: «Shtroje postiqen dhe ulu!». Unë iu binda atyre, por mund të flas edhe në këmbë.

Do t'ju flas pa kartë, se karta sikur të vë disa kufij, duke të detyruar të shprehësh vetëm ato që ke menduar më parë, kurse unë dua të bashkëbisedoj

lirisht me ju. Të flasësh kështu lirisht në bisedë ka dy rreziqe: ose mund ta shkurtosh atë, ose mund ta zgjatësh më shumë nga ç'duhet. Herën tjetër, kur isha këtu¹, ju mbajta pak vonë dhe ndoshta ju folën plakat kur u kthyet në shtëpi, por, këtë herë janë marrë masat, janë ftuar edhe ato këtu, prandaj mos kini frikë, se, duke u vonuar vetë, s'kanë ç'ju thonë as juve. (Të qeshura.)

Natyrisht, të dashur shokë dhe shoqe, ju dëshironi të dëgjoni nga unë se si shkojnë punët brenda dhe jashtë vendit tonë. Megjithëse shpeshherë edhe këtu vijnë shokë udhëheqës nga Tirana dhe ju vënë në korrent të situatave, gjë që ndikon shumë për t'ju ngritur juve politikisht e ideologjikisht dhe për t'ju bërë që të rroni me ngjarjet e brendshme dhe të jashtme, edhe unë dëshiroj t'ju vë në dijeni për realizimet e mira dhe për sukseset që po arrihen në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë.

Atdheu ynë i shtrenjtë është një vend i thesareve dhe thesaret më të mëdha janë populli dhe Partia. Populli ynë është një popull i pavdekshëm, që nuk u zhduk në shekujt e kaluar dhe do të përparojë në shekujt e ardhshëm. Dijetari i madh Darwin, në veprën e tij «Mbi prejardhjen e llojeve», tregon evolucionin e bimëve e të kafshëve. Ai ka vërtetuar se në luftën për ekzistencë që bëhet në botën e kafshëve, rron më i fuqishmi, kurse i dobëti zhduket. Kështu, gjatë evolucionit, për miliona vjet me radhë janë zhdukur plot kafshë të mëdha. Ju, djemtë dhe vajzat e shkollave,

1. Maj, 1969.

keni dëgjuar për gjarpërinj e kafshë të tjera trupgjigante që kanë ekzistuar dikur në tokën tonë, por që u zhdukën më pas.

Në jemi kundër teorisë borgjeze që pranon si forcë kryesore lëvizëse të shoqërisë luftën për ekzistencë dhe seleksionimin natyror, sepse ne nuk e pranojmë shtrirjen e ligjit të luftës për ekzistencë nga bota e bimëve dhe e kafshëve edhe në shoqërinë njerëzore. Forca kryesore lëvizëse e shoqërisë së ndarë në klasa nuk është lufta për ekzistencë, por lufta e klasave. Lufta e klasave, si forcë lëvizëse e shoqërisë, ka sjellë në histori ato zhvillime që Marksisi dhe Engelsi i studiuuan shkencërisht.

Pavarësisht se kemi qenë një popull i vogël, shekujt nuk na kanë mundur dot, as nuk na kanë zhdukur. Historia shkruan edhe për shtete dhe popuj të fuqishëm, kultura e të cilëve kishte lulëzuar 30, 40 e 50 shekuj më parë dhe megjithatë janë zhdukur, ndërsa fiset ilire, sidomos një pjesë e tyre, shqiptarët, qëndruan në këmbë përpara rrebesheve të historisë.

Populli ynë krijoi atë vitalitet të mrekullueshëm, atë guxim, atë trimëri, atë vendosmëri që e bënë t'u rezistonte jo vetëm transformimeve të natyrës, por edhe invadimeve të panumërta; të mbronte e të zhvillonte kulturën e tij të lashtë, që rrezatonte edhe në kulturat e vendeve të tjera. Populli ynë, në unitet si komb, qëndroi i bashkuar në këto troje, në këto maqe, në këto fusha, në këto lugina, ruajti zakonet, ruajti kulturën e gjuhën dhe i zhvilloi ato më tej. Nuk e asimiluan atë as kultura e grekëve të vjetër, as ajo e

romakëve, as kultura otomane dhe as invadimet e kohëve moderne.

Nga rreziqet e shumta që i kanoseshin, populli ynë doli i fortë si Anteu, që përmendet në mitologjinë greke, sepse i mbante këmbët mbi tokë, mbi truall, që e donte me gjithë shpirt. Prandaj edhe thashë se populli ynë është një nga thesaret më të mëdha të këtij vendi. Këtu në Gjirokastër themi: «Bëmë baba të të ngjaj». Është populli ynë ai që nxori nga gjiri i tij Partinë, Partinë Komuniste të Shqipërisë, sot Parti e Punës, e mbrujtur dhe e edukuar me ideologjinë e marksizëm-leninizmit dhe me virtytet më të mira të popullit që e lindi.

Unë nuk do t'ju them juve si lindi dhe si u formua Partia. Por, rëndësi ka ta dimë, dhe këtë ta dimë mirë e ta kemi parasysh kurdoherë, që kjo Parti lindi nga gjiri i popullit. Ne, bijtë tuaj, djemtë e vajzat tuaja, mbanim në supet tona të përbashkëta mjerimin shekullor, varfërinë, vuajtjet, të cilat, ashtu si gjyshërit tanë, donim t'i shkundnim. Por si t'i shkundnim? Me luftë. Pikërisht kjo ishte rruga e vërtetë për popullin tonë dhe jo vetëm për popullin tonë, por për gjithë proletariatin botëror, për gjithë popujt e ngritur në revolucion.

Nga eksperiencia e luftërave të proletariatit e të popujve Marks, Engeli dhe Lenini nxorën teorinë që bota e vjetër kapitaliste duhet të përmbysset dhe në vend të saj të lindë bota e re socialiste. Proletariati me aleatën e vet, fshatarësinë e varfër, duhet të rrëzojë borgjezinë dhe të marrë pushtetin. Me se? Me pushkë. Ndryshe sundimtarët s'e japin pushtetin. Par-

tia jonë e vogël ishte, por kishte në gjak guximin, trimërinë, pjekurinë e popullit dhe, përmbi të gjitha, të klasës punëtore. Klasa jonë punëtore ishte e vogël, por ne kishim teorinë e madhe të Karl Marksit e të Leninit, e cila frymëzoi Partinë dhe Partia popullin. Robëria, i tha ajo popullit, nuk hiqet nga zverku, po nuk e copëtuam me duart tona; liria nuk fitohet kurrë pa luftë e pa sakrifica. Populli e dëgjoi Partinë dhe Partia i priu dhe i prin popullit. Popull e Parti janë në unitet të plotë. Kjo është fitorja më e madhe e kohës sonë.

Nuk kanë qenë të pakëta, motra e vëllezër, për-pjekjet e luftërat e panumërta të popullit tonë, të gjyshërve e të stërgjyshërve tanë në të kaluarën kundër armiqve gjakpirës. Por me gjithë luftërat e pareshtura nuk ishte arritur akoma ajo pjekuri politike e popullit që u arrit shumë më vonë, në Luftën Nacionalçlirimtare; nuk ekzistonte akoma ajo udhëheqje e proletariatit që do ta çonte popullin drejt fitores së plotë.

Më 1878 u bë në Prizren mbledhja e Lidhjes Shqiptare, nën kryesinë e patriotit të shquar Abdyl Frashëri, vëllait të Samiut dhe të Naimit. Ajo u bë për të mbrojtur dhe për të unifikuar tokat shqiptare, kombin shqiptar, për të shpëtuar popullin shqiptar nga robëria e osmanëve, nga robëria e intrigat e fuqive imperialiste, nga shovinistët serbë e malazezë, nga Traktati i Shën-Stefanit etj. Abdyl Frashëri ishte ai që parashtroi hap-tazi kërkesën për formimin e një shteti autonom shqiptar në kuvendin e Gjirokastrës, që u mbajt më 23 korrik 1880. Për të përkujtuar këtë kuvend kënga e popullit thotë:

*«Kurvelesh e Gegëri
Ç'u mblodhë në Ergjëri!
Ky Abdyl bej Frashëri
Ç'u përpoq i varfëri.»*

Në kuvendin e Gjirokastrës u deklarua se Shqipëria do të rrojë e lirë, e bashkuar dhe autonome.

Mbledhja historike e Prizrenit formuloi programin politik të lëvizjes kombëtare shqiptare, i cili do të realizohej, në radhë të parë, me armë, por edhe me dituri e me diplomaci. Anembanë Shqipërisë u krijuan çetat e lëvizjes shqiptare. Kryetari i Lidhjes, Abdyl Frashëri, u tha Fuqive të Mëdha që u mblodhën në Kongresin e Berlinit: «Puna juaj me traktatin e Berlinit mbaron; puna jonë si shqiptarë nga kjo ditë fillon». Kongresi i Berlinit, siç e tregon historia, ishte një mbledhje e Fuqive të Mëdha të kohës. Në kurrizin e popujve, veçanërisht të popullit tonë, këto fuqi kërkonin të ushqenin ambiciet e njëra-tjetrës. Më vonë Fuqitë e Mëdha e copëtuan Shqipërinë. Tokat e kombit shqiptar ato ua dhanë Serbisë, Malit të Zi etj.

Eshtrat e Abdyl Frashërit, ideologut, udhëheqësit, organizatorit, aktivistit, diplomatit dhe luftëtarit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sot në mëngjes kanë hyrë në atdheun e tij, nga Kapshtica e Korçës. Populli, që po e pret me nderime të thella dhe me brohoritje entuziaste, do ta çojë trupin e tij, nëpërmjet Kolonjës e Dangëllisë, në shtëpinë-muze të Frashëllinjve, ku do të rrinë deri në datën e caktuar, kur do të përkujtohet mbledhja e Prizrenit dhe pastaj do të organizohet varrimi solemn në Tiranë.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë marrë vendime që varret e Naimit, Abdylit e Samiut të bëhen në parkun e bukur e të madh të Tiranës. Ne i jemi mirënjohës popullit turk, që i ka ruajtur eshtrat e patriotëve shqiptarë, si dhe qeverisë turke, e cila lehtësoi ardhjen në atdhe të eshtrave të Abdylit. Po këstu ne i shprehëm mirënjohjen dhe falënderimet tona edhe popullit grek, i cili i kishte ruajtur me kujdes eshtrat e Hasan Prishtinës, që na u dhanë nga qeveria greke. Eshtrat e Samiut, për fat të keq, ndodhen akoma në Turqi. Ne kemi shpresë se populli turk dhe qeveria turke do të na i japin edhe eshtrat e filozofit e patriotit tonë të madh Sami Frashërit, i cili, me shpirt e me zemër, luftoi derisa vdiq për këtë popull, për tokën e tij, për malet, për kodrat, për bagëtinë që ka kënduar me aq dashuri Naimi. Samiu ka qenë një nga filozofët dhe filologët më të mëdhenj në Perandorinë Turke, por kjo nuk do të thotë se ai është turk. Pikërisht për arsye të madhështisë së Samiut, disa qarqe me influencë në Turqi thonë: «Samion nuk jua japim dot, sepse e kemi nga figurat tona më të mëdha». Samiu është vërtet një figurë e madhe, që u shqua për diturinë e tij në kohën e Perandorisë Turke, por ai ka lindur këtu, është bir i këtij trualli dhe ka luftuar për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë, prandaj, edhe eshtrat e tij, sot ose nesër, duhet të prehen në tokën e të parëve.

E hapa këtë parantezë, të dashur nëna, baballarë, motra dhe vëllezër, për të treguar atë luftë heroike që kanë bërë të parët tanë, rrugën dhe gjakun e të cilëve ne nuk e harrojmë. Amanetet e tyre ne i kemi

parasysh, por çdo gjë do të bëhet kur të piqen kushtet, kur t'i vijë koha e saj. Që të bëhet revolucioni, thoshte Lenini, duhet t'i vijë koha dhe të krijohen kushtet. Kështu është edhe për të gjitha ngjarjet e fenomenet e tjera në natyrë e në shoqëri. Një fjalë e urtë e popullit thotë: «Flet më mirë kush flet i fundit», prandaj të ecim si duhet dhe kur duhet.

Në situatën e mrekullueshme të vendit tonë ne duhet të punojmë që ta bëjmë popullin çdo ditë e më të lumtur, çdo ditë e më të gëzuar; të vazhdojmë të ndërtojmë shoqërinë tonë të re, të kalitim njeriun tonë të ri, të ngritur politikisht e ideologjikisht, që i kupton gjërat dhe është i ndërgjegjshëm për ta forcuar e për ta mbrojtur përherë atdheun e vet socialist. Dhe atdheu mbrohet vetëm duke pasur në udhëheqje një parti marksiste-leniniste, të fortë e të çeliktë si kjo jona.

Duhet të kuptojmë mirë se uniteti në mes popullit dhe Partisë nuk duhet të ketë asnjë të çarë. Tek uniteti Parti-popull qëndron forca jonë. Gojëdhëna tregon që, për të provuar se bashkimi bën fuqinë, një plak i urtë u dha djemve të tij tre-katër shufra të bashkuara e u tha: «Provoni, more djem, t'i thyeni këto!». E provoi secili nga djemtë veç e veç, por asnjëri s'mundi t'i thyente. Pastaj plaku i ndau shufrat dhe i dha secilit nga një. Djemtë i thyen pa vështirësi. «Ja ç'do të thotë të jeni të bashkuar», u tha plaku të bijve. Edhe neve, Partia na mëson që unitetin e saj me popullin ta kemi të çeliktë. Vetëm kështu ne kemi ecur e do të ecim gjithnjë përpara. Forcimit të mëtejshëm të këtij uniteti i shërbejnë kuptimi i thellë i problemeve politike, ideologjike, ekonomike e shoqërore, zhvillimi i

drejtë i luftës së klasave edhe kundër atyre që ne i quajmë mbeturina në ndërgjegje, si edhe edukimi i njerëzve, me durim, me bindje, me arsyetim.

Njerëzit tanë e duan njëri-tjetrin. Por nuk përjashtohen rastet kur dikush, për këtë apo për atë arsye, me të drejtë ose pa të drejtë, edhe zemërohet me tjetrin. Nuk mund të pretendohet se nuk do të ndodhin të tilla gjëra, sepse njerëzit nuk janë të tërë njësoj e nuk mund të mendojnë njësoj. Por, edhe kur ngjasin shfaqje të kësaj natyre duhet të mendojmë për unitetin në radhët e popullit, për unitetin e popullit me Partinë. Gjithë puna jonë duhet të synojë në forcimin e unitetit.

Armiqtë janë gati t'i shfrytëzojnë në interes të tyre ato «gjërat e vogla», që ne u themi mbeturina. Mbeturinat janë premisa për të krijuar mosmarrëveshje, të cilat, në qoftë se nuk i zgjidhim drejt, me urtësi, me dashamirësi, me bindje, me takt e me durim, por veprojmë me kryelartësi, me arrogancë e prepotencë dhe duke thirrur: «Do të veprosh kështu si të them unë!», atëherë armiku do të na gjejë të çara dhe kontradiktat në mes nesh do të acarohen, duke u bërë të rrezikshme. A ka njeri të ndershëm që ta dojë thyerjen e unitetit tonë, që do të ishte një fatkeqësi e përgjithshme? Në asnjë mënyrë nuk ka. Vetëm armiqtë, të cilëve ua kemi treguar dhe do t'ua tregojmë kurdoherë vendin, e sulmojnë unitetin tonë.

Partia jonë trashëgon virtytet më të larta morale të popullit. Për trajtimin e arsyeshëm të njerëzve që gabojnë ose që kryejnë faje, ajo ka përvetësuar dhe ka zbatuar teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Në radhë të parë ajo punon pa u lodhur që nje-

rëzit t'i ruajë nga gabimet. Por, edhe ata që bëjnë gabime të përpiqemi që t'i ndreqim me durim, me durim e deri në fund, me durim e t'i shpëtojmë nga thellimi i gabimeve. Ka disa «ferra» që i zënë këmbët atij njeriu që nuk ecën drejt. Atëherë, ç'do të bëjmë ne që ai të mos çirret? Të marrim «kosën», «t'i presim ferrat» e t'i pastrojmë rrugën. Partia dhe populli kanë mbajtur qëndrime të drejta në këto drejtime, prandaj ne kemi rezultate të mëdha, si në edukimin e njerëzve, ashtu dhe në arritjet ekonomike.

Ekonomia jonë, qoftë industria apo bujqësia, është fuqizuar e modernizuar shumë në rrugën socialiste. Aktualisht nuk jemi më si në ato kohë kur zbritëm nga malet dhe ndonjë armik i klasës, qoftë ky kulak ose saraf, thoshte me qesëndi: «Erdhi «qeveria e rignonit»!»! Kjo donte të thoshte erdhi qeveria e malit, që s'ka asnjë vlerë. Por kohët kanë ndryshuar; «qeveria e rignonit» është bërë tashmë qeveri e çelikut, veçse «ççliku» nuk e harron «rignonin». Partia jonë vuri si detyrë, në radhë të parë zhvillimin e industrisë, të industrisë së rëndë, të fabrikave, të kombinateve, të hidrocentraleve, të industrisë mekanike etj. I ndërtoi dhe i vuri këto në shfrytëzim për të mirën e popullit. Për popullin tonë kanë kaluar kohët e vuajtjes e të atyre vështirësive, kur edhe maja e gjilpërës duhej t'i vinte nga jashtë. Tani importimet janë shkurtuar dhe po shkurtohen vazhdimisht për arsye se në vendin tonë është ngritur industria jonë e re, e cila është bërë një bazë e fuqishme që u jep mundësi Qeverisë dhe popullit të realizojnë planet që kemi përpara e të përgatitim planet e ardhshme.

Këtë industri, siç e dini, e kanë vënë në lëvizje djemtë dhe vajzat e popullit. Shumë prej jush, që jeni mbledhur në këtë miting, jeni të rinj, por ka edhe të moshuar që e mbajnë mend të kaluarën. Këtu në Gjirokastrë ka qenë një fabrikë e vjetër cigaresh, e cila aso kohë dukej diçka e madhe. Tash Gjirokastra është mbushur me fabrika shumë më të mëdha e më moderne. Këtej, rreth e rrotull nga ana e Labërisë, janë zbuluar disa minerale. S'është çudi që të zbulohen akoma edhe minerale të tjera. Dihet se miniera krijon fabrikën, fabrika krijon klasën punëtore dhe klasa forcon Shqipërinë. Partia e ka për detyrë që bijve të popullit t'u japë arsim, kulturë e dituri, të përgjithshme e teknike, që ata të jenë në gjendje të marrin në duart e tyre fatet e industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të mbarë atdheut.

Bujqësia jonë ka hyrë në rrugën e socializmit. Dihet se bujqësia është baza e ekonomisë, kurse industria është udhëheqësjja e saj. Pa bujqësinë nuk mund të zhvillohet si duhet dhe sa duhet industria, prandaj të dyjave t'u vëmë rëndësi të madhe. Në këto momente duhet t'i vëmë rëndësi veçanërisht bujqësisë, sepse ajo, siç thonë, është «fabrikë pa çati». Në rezultatet e saj ndikojnë edhe kushtet atmosferike. Sa kohë që kalon, me masat që kemi marrë e po marrim, kushtet atmosferike po i bëjmë më pak të dëmshme. Bujqësinë ta forcojmë në mënyrë të tillë që edhe në rast se situatat do të duan që të mos importohen më disa artikuj ushqimorë siç janë vaji, sheqeri ose ndonjë artikull tjetër, të jemi në gjendje për t'i plotësuar nevojat me prodhimet tona. Ne duhet të ecim dhe do të ecim pikërisht në

këtë rrugë. Kështu, sido që të ndodhë, jo vetëm buka nuk do të na mungojë kurrë, jo vetëm që rezervat nuk do t'i prekim, por edhe do t'i zgjerojmë ato. Drithin do ta shtojmë çdo vit e më shumë; do të shtojmë, gjithashtu, edhe rezervat e tij që të kemi mundësi të eksportojmë misër. Kjo është një detyrë shumë e madhe që Partia i shtron bujqësisë. Kooperativistët tash janë të bindur më tepër se kurrë se kolektivizimi ishte shpëtimi i fshatarësisë, ishte fuqizimi i socializmit, ishte forcimi i aleancës së pathyeshme të tyre me klasën punëtore.

Klasa punëtore mendon për fshatarësinë kooperativiste, por dhe fshatarësia kooperativiste, gjithashtu, mendon për klasën punëtore. Mbi këtë bashkësi interesash reciprokë Partia lufton që fshati t'i afrohet qytetit. Ne po ecim në xhade të drejtë, që akoma nuk e kemi shtruar të tërë, por gradualisht ajo po shtrohet. Këto i them për të rinjtë dhe të rejat e qytetit që ta duan me gjithë shpirt fshatin, se puna në fshatin e sotëm, për të gjitha ato arsye që thashë më përpara, është shumë e rëndësishme. Në qoftë se themi të mbrojmë atdheun, të forcojmë ndërtimin e socializmit dhe të kalitim Partinë, këto kërkesa nuk mund të plotësohen pa fuqizuar fshatin.

Fshati sot ka ndryshuar krejtësisht në të katër anët e Shqipërisë; ai është bërë i bukur e i përparuar. Të huajt habiten kur venë në fshatrat tona dhe kur shohin, për shembull, se vetëm në Lapardhanë e Vriornasve të dikurshëm tash ka rreth 100 kuadro me arsim të lartë, si: agronomë, zooteknikë, veterinerë, rritës të bletëve e të tjerë dhe nja 250 kuadro me arsim të

mesëm që kanë mbaruar shkollat bujqësore. Fshati, pra, ka përparuar shumë. Atje tani ka mami, ka mjekë, ka shkollë me shumë mësues, ka kuadro të specialiteve të ndryshme etj., ka shtëpi e vatra kulture ku këndojnë e vallëzojnë të rinjtë e të rejat. Kështu është kudo te ne. Po a do të qëndrojmë në vend? Jo. Rruga e Partisë është e tillë që edhe kooperativistja më e thjeshtë të mbarojë shkollë të mesme bujqësore. Shikoni çfarë ndryshimesh ka bërë kjo Shqipëria jonë, nën udhëheqjen e Partisë! A ka kënaqësi më të madhe se ajo kur tërë Shqipëria sheh të dalin vashëzat e saj në skenë, të zgjidhen edhe në udhëheqje të Partisë e të shtetit, të mbushin universitetin, të jenë baras me burrat në jetë, në punë e në shoqëri, të jenë po aq të zgjuara, po aq të guximshme e punëtore sa edhe burrat?!

Në fshat jeton pjesa më e madhe e popullsisë së Shqipërisë, atje janë thesaret e mëdha që prodhon toka. Sa më tepër ta duash tokën, sa më shumë t'i shërbesh asaj, aq më me bollëk të shpërblen ajo. Më kujtohet i ziu Miho nga Haskova, kur sillte një gomar me misër, kalliri i të cilit ishte sa një bixhgo! Kështu prodhohej para Çlirimit, kurse tashti shërbimet dhe kërkesat ndaj tokës kanë ndryshuar. Nuk kënaqen më dropulliti e mashkulloriti me 60 kuintalë misër për hektar. Jo, jo. Ohu! Ata duan më shumë prodhim. Kush e sjell shtimin e prodhimit? E sjell kuptimi e zbatimi i vijës së drejtë të Partisë, e sjell ngritja politike e punonjësve. Atë e bëjnë të mundur masat e shumta që kanë marrë Partia dhe pushteti i diktaturës së proletariatit për të ujitur e për të sistemuar tokat, për

të rritur mekanizimin, për të shtuar plehrat kimike etj. Partia ka punuar me njerëzit dhe i ka mësuar ata se si ta punojnë tokën, si ta duan bimën, si të kontrollojnë rritjen e saj e të tjera. Ashtu si i shërben nëna foshnjës që ka në gji, ashtu edhe fshatari duhet t'i shërbejë tokës.

Çdo prodhim yni, qoftë ky bujqësor apo industrial, duhet të jetë i cilësisë së mirë. Ju, shoqe punëtorë, që punoni në tezgjahe apo që bëni triko me akrilik; ju që qepni rroba të gatshme ose që prodhoni sende të tjera të bukura, keni dëshirë të madhe që nga duart tuaja të dalin prodhime sa më tërheqëse e sa më të mira. Në këtë drejtim ju keni përkrahjen e plotë të Partisë e të Qeverisë, prandaj duhet të përvetësoni ideologjinë e çeliktë, të qartë, të mençur e marksiste-leniniste të Partisë sonë. Këtë ideologji dhe politikë që mbështeten tek ajo, t'i zbatoni me konsekuencë në jetë. Politika e Partisë na ka dhënë rezultate të mëdha e të gjithanshme. Por, e mira, thotë populli, nuk ka fund. Ne duhet të ecim vazhdimisht drejt shoqërisë komuniste.

Secili, atje ku është, të punojë me gjithë shpirt, me zjarr, me mençuri dhe të kontribuojë për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor. Ne e shikojmë zhvillimin e revolucionit në çdo gjë, kurdoherë dhe në çdo drejtim: revolucion në fshat, revolucion në fabrikë, revolucion në familje. As luftën kundër mbeturinave në familje të mos e harrojmë, sepse, sa më e shëndoshë të jetë familja, sa më shumë dashuri të ekzistojë në mes pjesëtarëve të saj, aq më përpara do të ecë shoqëria. Të jemi në revolucion kudo, kurdoherë dhe në

të gjitha drejtimet do të thotë të dhjetëfishohen të ardhurat ekonomike sot dhe të qindfishohen nesër. Çdo gjë është në gjendje të bëjë forca e mendjes dhe e krahut të njeriut të lirë të shoqërisë socialiste. Njeriu ynë mund të prodhojë gjithçka dhe këtë njerëzit tanë e kanë provuar me vepra. Ata nuk kanë shpikur avionin, por, të shtyrë nga nevojat për të marrë sa më shumë nga puna e tyre e për të jetuar sa më mirë, kanë krijuar gjëra me të vërtetë me vlerë. Njerëzit tanë, edhe më përpara i ka karakterizuar shpirti krijues, por aktualisht ekzistojnë të gjitha mundësitë që ata të avancojnë shumë më tepër dhe ta zhvillojnë revolucionin në të gjitha aspektet e jetës sonë. Çdo gjë ne do ta arrijmë me punë, me djersë, me forcat tona mendore e fizike, me mjetet që na ka dhënë në dorë Partia. Këto mjete ne duhet t'i shtojmë e t'i perfeksionojmë çdo ditë që nga duart tona të nxjerrim prodhime sa më të mira, sa më të bukura, sa më të nevojshme dhe sa më të lira që popullit të mos i mungojë asgjë.

Kemi bërë përparime të mëdha, por siç thashë dhe më parë, e mira nuk ka fund, ndaj arritjet tona duhet t'i shohim me sy kritik. Ja, për shembull, ndodh që patate e qepë të thata nuk gjen dot kollaj në treg. Po pse nuk ka patate? Nuk ka, se vetëm Korça e ka zanat kultivimin e tyre. Mirëpo Korça nuk mund ta ushqejë gjithë Shqipërinë. «More, prodhoni sa më shumë patate», u themi përherë shokëve në bazë. «Po, po, do të prodhojmë», na përgjigjen ata dhe e harrojnë porosinë e nuk marrin masat e duhura, prandaj mosvlerësimi i drejtë i këtij problemi shkakton mungesa në treg.

Rëndësi t'i vëmë bukës, por rëndësi t'i vëmë edhe deles e lopës, se pa qumësht e pa gjalpë nuk rritet dot kalamani dhe nuk jetojmë dot as ne. Shit sa të duash kunguj e spinaq në treg; këto vërtet që kanë vlerat e tyre ushqyese, por duhet edhe vaji. Prandaj ata që kanë ullinj t'i vënë gishtin kokës e t'i bëjnë atij të gjitha shërbimet për të marrë prodhim çdo vit e jo të kënaqen me ç'u jep ai një herë në dy ose në tre vjet. Ata që mbjellin luledielli t'i bëjnë yzmet kësaj bime, se luledielli jep vaj. Ju duhet ta dini që ne importojmë vaj. Po pse të importojmë vaj kur Donofrosa edhe në mal e në toka pa ujë ka arritur të marrë nga kjo bimë deri 25 kuintalë për hektar, në një kohë kur ka raste që edhe në fushë mezi merren 10 apo 11 kuintalë?!

Të gjitha sukseset ne i kemi arritur duke u mbështetur në forcat tona. Ndonjë mund të mendojë që kemi pasur edhe ndihmë nga jashtë. Po, kemi pasur, por ndihma e jashtme, në raport me forcat tona, po të shprehej me shifra, nuk ka qenë më tepër se 15 për qind, resti ka qenë djersa jonë. Edhe në qoftë se kanë ardhur disa inxhinierë të huaj, pranë tyre ka pasur shumë më tepër nga tanët.

Nga viti në vit dalin nga universiteti kuadro të rinj. Këta janë djemtë dhe vajzat e popullit të pajisur me dituri dhe zotësi, që ndërtojnë hidrocentralin e Fierzës, nga më të mëdhenjtë në Evropë, që e kanë projektuar specialistët tanë me në krye Petrit Rado-vickën. Kryeinxhinieri i tij është djali i Raship Hoxhës¹, mundet që e njihni.

1. Fahrudin Hoxha.

Kemi edhe specialistë kinezë në Fierzë që japin ndihmën e tyre, por nuk janë ata që «e nxjerrin gomarin nga balta» siç themi ne, por është vetë i zoti i shtëpisë ai që e nxjerr. Kinezët na ndihmuan dhe vazhdojnë punën për ndërtimin e kombinatit metalurgjik; por atje punojnë 10-12 mijë veta e me qindra inxhinierë e ekonomistë nga tanët. Ndihma e huaj është anësore. Ndihmën e huaj ne e kemi marrë duke menduar se shtetet që na e kanë dhënë ishin në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Veç kësaj, ndihma ka qenë reciproke. Në qoftë se Kina na ka dhënë ndihmë, dhe për këtë ne i jemi mirënjohës, edhe ajo duhet të jetë mirënjohëse për ndihmën që i kemi dhënë ne. Mao Ce Duni ka thënë: «Shokë shqiptarë, Kina është në rrezik të madh; armiqtë kanë hedhur në dorë pushtetin dhe partinë. Ne nuk dimë kush do të fitojë, prandaj duam të na ndihmoni!» Dhe ne, shqiptarët, ishim të vetmit që e mbështetëm Kinën në kohën kur të tërë e lanë në baltë. Ne e kemi dëgjuar me veshët tanë Mao Ce Dunin kur ka thënë, se ndihma që i ka dhënë Shqipëria Kinës është si mali i Himalajës. Këto fjalë të Mao Ce Dunit kanë shprehur të vërtetën. Ai vërtet ka qenë edhe poet, por vlerësimi i tij për ndihmën tonë Kinës nuk ishte thjesht hiperbolë.

Ne, shqiptarët, jemi njerëz të thjeshtë e nuk e kemi zakon të mburremi. Hakën të tjerëve nuk ua hamë, por ama nuk duam që edhe neve të na e hanë hakën të tjerët. Tjetrin nuk e lëmë të na shkelë. Historia na ka mësuar që mikun ta duam dhe ta mbrojmë në qoftë se edhe ai qëndron kurdoherë mik e dëshiron të ecë drejt, së toku me ne. Kur miku ndryshon rrugën, është

keq për të, se ne nuk na tërheq dot në hendek. Partia e Punës e Shqipërisë ecën kurdoherë drejt. Parimi i saj ka qenë dhe do të jetë vazhdimi pa u lëkundur i rrugës marksiste-leniniste. Leberit thonë: «Po u shkëput delja nga tufa, e ha ujku». Edhe ne themi: Po u lëkund dhe po u shkëput Partia nga rruga e saj marksiste-leniniste, atëherë e merr lumi. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar, që udhëhiqet prej saj, do të ecin në rrugën që kanë përcaktuar Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini.

Rruga jonë asnjëherë nuk i ka ardhur për hosh Titos, po neve na u prish puna! (*Të qeshura.*) Qëndrimet e tij prej renegati dhe agjenti të imperializmit i kemi demaskuar dhe do të vazhdojmë t'i demaskojmë. Nga kritikata e marksistë-leninistëve të vërtetë lëkura e Titos është bërë si «sholla e Nikës». Titoja, ky shërbëtor i Uashingtonit, e ka shitur krejt Jugosllavinë, me kuptimin e vërtetë të fjalës. Nuk është rasti t'ju fut këtu në hollësira, por mjafton t'ju them që nga gazetata e ndryshme po marrim vesh se në Jugosllavi çmimet rriten çdo ditë e më tepër. Tradhtia e Titos e ka çuar vendin e tij në kapitalizëm, në një shoqëri ku sundojnë kapitalistët e huaj. Udhëheqësit jugosllavë janë kthyer në rrogëtarë që marrin paga të majme. Titoja ka krijuar borgjezinë e re jugosllave, e cila rron në bollëk.

Këlij sistemi të sajuar titistët i kanë dhënë njëfarë boje dhe i kanë ngjitur disa etiketa «marksiste» për ta maskuar, që i thonë «vetadministrim jugosllav». Ata orvaten t'u mbushin mendjen të tjerëve se gjoja ky sistem na qenka i bazuar në një teori marksiste! Këtë teori «marksiste» revizionistët e kanë kopjuar

nga Trocki e nga Buharini; ajo është teoria e anarko-sindikalistëve, e Bakuninit dhe e Prudonit. Titoja nuk bëri gjë tjetër veçse e mori teorinë e tyre dhe e zbatoi në Jugosllavi që ky vend të rikthehej në kapitalizëm.

Ka kohë që kapitalet e huaja kanë vërshuar në Jugosllavi. Këto kapitale e kanë zënë Jugosllavinë në grykë dhe po i marrin frymën. Politika që është ndjekur e po ndiqet në Jugosllavi ka krijuar varfërimin e popullit. Në fshatrat e saj sundojnë bejlerët, agallarët e kulakët. Atje s'ka kooperativa bujqësore. Kombësitë janë në grindje të përhershme me njëra-tjetrën; çështja nacionale atje është ngatërruar «si leshtë e arapit». Serbi kërkon të sundojë prapë mbi të tjerët; kroati, slloveni, malazezi thonë që edhe ne jemi në pushtet e nuk duam të sundohemi nga serbi.

Shqiptarët, që banojnë në Jugosllavi, janë shumë të shtypur, por nuk e kanë humbur ndjenjën e atdeshdashurisë. Ata përpiqen të shfrytëzojnë disa të drejta që janë shpallur në kushtetutën e Jugosllavisë. Ne nuk përzihehi në punët e brendshme të këtij vendi, por kemi kërkuar dhe vazhdojmë të kërkojmë që vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi të gëzojnë të gjitha të drejtat kushtetuese, që ata të mos diskriminohen e të mos shtypen, të mos u mbyllen shkollat shqipe e të mos u prishen zakonet etj. Këto të drejta ne do t'i mbrojmë ngaherë, se nuk kemi frikë t'u dalim zot vëllezërve tanë.

Ne e kemi dashur Stalinin, se ai ishte një marksist i madh; e donim Partinë Bolshevike, se ajo ishte Partia e Leninit; e donim Ushtrinë e Kuqe se ajo çliroi botën nga nazizmi. Pasi vdiq Stalini, dolën në skenë kalan-

derë të tillë si Hrushovi me shokë, që filluan luftën kundër marksizëm-leninizmit, për ta kthyer Bashkimin Sovjetik në kapitalizëm. Partia jonë, pa marrë parasysh se kush do të vinte me ne, e zhveshi pallën kundër tyre. Le të ndodhte çfarë të ndodhte, ne morëm përsipër të vazhdonim rrugën tonë të drejtë dhe ishim të bindur që populli do ta aprovonte qëndrimin tonë. Po të kesh popullin përkrah, je më i fortë nga të gjithë. Çfarë na ndodhi, çfarë pësuam nga ato që na kanosën revizionistët? Asgjë. Përkundrazi u bëmë më të fortë dhe me djersën tonë sollëm ditë më të mira. Po të prananim zgjedhën e tyre, këtu vendi do të ishte mbushur me rusë edhe me ruska.

Ne, shqiptarët, s'e kemi duruar dhe s'e durojmë dot robërinë. Ne jemi me parimin që të mos ndërhyhet në punët e të tjerëve dhe gjithsecili të rrijë në shtëpinë e tij. Edhe kur të huajt kanë tentuar për të na pushtuar, lëkura u ka mbetur në ato male, atje në kufi. Tashti që jemi më të fortë, aq më tepër nuk i lëmë armiqtë të shkelin tokën tonë.

Në Kongresin e 7-të të Partisë, siç e keni dëgjuar e studiuar, u shprehën pikëpamjet tona për teorinë dhe praktikën e revolucionit, për karakterin klasor të forcave politike, për kontradiktat themelore të epokës sonë etj. Duke u mbështetur në parimet e materializmit dialektik e historik, duke pasur parasysh rendin ekonomik-shoqëror të vendeve të ndryshme dhe duke gjykuar sipas kriterit klasor proletar, Partia jonë shprehu mendimin e saj se, sot kur flitet për botën, duhet të kihet parasysh vetëm dy ndarje të saj: bota kapitaliste dhe bota socialiste. Këto dy botë kanë qenë e do

të jenë në luftë të vazhdueshme e të papajtueshme me njëra-tjetrën derisa të shkatërrohet bota e vjetër kapitaliste.

Partia jonë tha, gjithashtu, se të dyja superfuqitë, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, në të njëjtën masë dhe në të njëjtën shkallë, përfaqësojnë armikun kryesor për socializmin, për lirinë e pavarësinë e kombeve. Kjo është pikëpamja strategjike më e drejtë për revolucionin botëror e bazuar në marksizëm-leninizmin, në faktet, në jetën. Të shtrembërosh të vërtetën e të mashtrosh popujt se gjoja imperializmi amerikan ndodhet në rënie dhe është bërë «si një mi i trembur» që shkon në rrugë dhe për të cilin të tërë thërrasin: «Vriteni miun! Vriteni miun!», do të thotë të orvatesh të mbulosh diellin me shoshë. Si qenka dobësuar kaq shumë imperializmi amerikan, kur prania e tij ushtarake në shumë vende të botës rrezikon njerëzimin?! Është thënë që imperializmi amerikan «është një tigër prej letre»! Ç'tigër prej letre është ai, kur i mpreh dhëmbët atomikë çdo ditë; kur ka sulmuar e ka vrarë popujt e Koresë, të Vietnamit, të Laosit e të Kamboxhias, kur ka hedhur kthetrat në Azinë Qendrore e kudo?! Partia e Punës e Shqipërisë nuk mund të pranojë teori të tilla të dëmshme, pavarësisht se kush i shpik e i mbron ato.

Partia jonë ka të drejtë të shprehë mendimin e saj se ka dy botë e jo tri. Të pranosh se ka dy apo tri botë është një çështje e madhe ideologjike, prandaj çdo parti ka jo vetëm të drejtë, por edhe detyrë të përcaktojë mendimin dhe qëndrimin e saj. Partia e Punës e Shqipërisë nuk u pyet kur u shpall e ashtuquajtura

teori e tri botëve, prandaj ajo ka të drejtë të shprehet për këtë problem të madh. Kur ka marrëveshje të shkruara dhe të firmosura që, për të përcaktuar qëndrimet e drejta për çështje të mëdha ndërkombëtare, politike e ideologjike, duhet të bëhen konsultime të një partie me një tjetër dhe, kur njëra parti e shkel këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme, atëherë partia tjetër ka të drejtë të caktojë vetë qëndrimin e saj. Kështu veprroi Partia jonë në Kongresin e saj të 7-të kur shprehu mendimin e vet kundër «teorisë së tri botëve».

Po të studiohen dokumentet e Partisë sonë del se edhe në mbledhjet e Moskës, më 1957 e më 1960, ajo u ka futur dru pikëpamjeve revizioniste mbi kontradiktën themelore të epokës, domethënë mbi injorimin e kontradiktës midis socializmit e kapitalizmit ku mbështetet «teoria e tri botëve». Atëherë mbrojtësit e tanishëm të kësaj teorie nuk u ngritën e të na thoshin: «Daleni, more shokë shqiptarë, se nuk është e drejtë pikëpamja juaj». Ne nuk kemi refuzuar kurrë të diskutojmë me miqtë, përkundrazi gjithmonë u kemi kërkuar atyre që të diskutojmë për probleme të ndryshme. Ne kemi mendimin që marksistë-leninistët duhet të diskutojnë me njëri-tjetrin, se cili qëndrim ose cila pikëpamje është e drejtë dhe cila nuk është e drejtë. Në qoftë se ndonjë parti nuk dëshiron të konsultohet me ne, ky nuk është faji ynë. Po kështu edhe në qoftë se ndonjë parti pretendon të dëgjohet vetëm fjala e saj, sepse ajo është më e madhe, ne nuk mund t'i bindemi, se kemi personalitetin tonë, dinjitetin dhe forcën tonë. Sido që jemi të vegjël në numër, ne jemi kriararë,

se ideja jonë është shumë e madhe dhe s'ka forcë në botë që ta mposhtë. Ne ndjekim rrugën tonë marksiste-leniniste. Ideja e madhe, kur nuk degjeneron dhe kur mbrohet fort, në mos sot, nesër, i qëron lakrat nga kokat e njerëzve. Ne e mbajmë drekun drejt që të ecim përpara. «Puno, djersit, vigjilo!», na mëson Partia që armiqtë të mos mundin të na bëjnë gjë.

Armiku është çakallos nga koka, por vendi ynë i ka marrë masat e mbrojtjes kundër tij. Kishte armë sa të donte Amerika, bile nga më modernet, por ja që në Vietnam nuk fitoi dot. Ç'bomba nuk hodhi, ç'nuk provoi; të mos them me qindra, por me dhjetëra lloje avionësh përdori, pa folur për mjetet e tjera dhe, më në fund, e humbi luftën, iku me bisht në shalë. U mund imperializmi amerikan se kundër tij ishte populli. Armiqtë neve s'kanë ç'na bëjnë, në radhë të parë se popullin e ka bërë Partia të fortë, se Partinë e kemi të çeliktë, se janë marrë dhe vazhdimisht po merren të gjitha masat mbrojtëse. Gatishmëria jonë është përgatitur në mënyrë të tillë që, sa të jepet sinjali i alarmit, çdo shtetas niset menjëherë në pozicionin e tij të mbrojtjes dhe brenda kohës së caktuar të gjithë luftëtarët gjenden në vendin e duhur. Le të hidhet armiku me parashuta, se këto cucat tona sokoleshja do t'i rrëzojnë desantët si rosat.

Situata ndërkombëtare është e turbullt. Armiqtë, në radhë të parë imperializmi amerikan dhe social-imperializmi sovjetik, janë shumë të egër; ata luftojnë për hegjemoni botërore, për të pushtuar vendet e tjera, për të ripushtuar tregjet. Lufta për hedhjen në dorë të tregjeve kërkon njëfarë qetësie, por kjo qetësi rela-

tive nuk tregon se janë zbutur kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik; përkundrazi ato janë acaruar. Por në këtë situatë dalin dhe kalanderë të tjerë, që duan të bëhen ortakë në grabitjet e imperialistëve e të socialimperialistëve. Ky qëllim i bashkon, siç thotë populli, «dy kamberë në një derë», dhe fillon kështu konkurrenca dhe grindja në mes tyre. Lufta për grabitje rëndon në kurriz të popujve.

Lindja e Mesme është bërë pré e sovjetikëve, e amerikanëve dhe e grabitqarëve të tjerë. Në këtë ndërmarrje të ndyrë borgjezisë ndërkombëtare i shërben edhe borgjezia e shitur vendëse. Kështu, për shembull, vepron dhe intrigon borgjezia e brendshme në Afrikë, ku sunduesit e këtyre vendeve «hanë kumbullat» dhe popullit të thjeshtë i «mpihen dhëmbët». Kush kanë mbetur pa atdhe? Palestinezët. Kush fiton miliarda dollarë, duke zbatuar politikën e përçarjes? Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tjera kapitaliste. Krahas tyre, edhe «bota e dytë» pushton tregjet e huaja dhe shet armë për t'u vrrarë popujt dhe për të realizuar fitime.

Vërtet situata ndërkombëtare paraqitet e turbullt, por popujt e gjithë botës, me marksistë-leninistët dhe me proletariatin në krye, janë në lëvizje. Kjo lëvizje e bën situatën të jetë revolucionare. Teorinë e revolucionit e ka shpjeguar Marksi, e kanë shpjeguar edhe Lenini e Stalini. Në të katër anët e botës kapitaliste dhe revizioniste ka shpërthyer një krizë e madhe ekonomike, politike, shoqërore e ushtarake. Kush ia shkakton botës borgjezo-revizioniste këtë krizë? Ia shkak-

tojnë lëvizjet e masave të gjera të popujve dhe të proletariatit, të cilët janë në revolucion. Kur e vëmë tenxheren në zjarr për të zier diçka, ujët fillon të vlojë, molekulat vihen në lëvizje gjithnjë e më shumë dhe, nga kjo lëvizje, dëgjohet një zhurmë e lehtë që shoqëron shndërrimin e ujit në avull. Lëvizja dhe avulli sa vjen e shtohen. Po të mos hapet pak gryka e tenxheres, presioni i avullit e hedh kapakun në hava. Kështu ngjet edhe me lëvizjen revolucionare të popujve: edhe atje «kazani zien», bëhen greva e demonstrata kundër kapitalizmit dhe qeverive kukulla të tij.

Le të marrim, për shembull, Italinë. Pas Luftës së Dytë Botërore në këtë shtet janë krijuar 40 qeveri. Për të formuar qeverinë e fundit, që është sot në fuqi, u deshën tre muaj. Ka pasur raste që janë dashur edhe 6 muaj pazarllëqe midis partive politike për të rënë në ujdi dhe për të formuar një qeveri. Në Francë, në Angli, bile edhe në Amerikë ndodh po kështu. Janë të dëgjura grevat e minatorëve të qymyrit në Amerikë, që Karteri¹ i kërcënoi rreptë.

Në botën e sotme po ngjet pikërisht ajo që ka parashikuar Lenini, kur shkruan se në imperializëm, në momente të caktuara, krijohet situata revolucionare; kur shtresat e ulëta nuk e durojnë dot më të vjetrën dhe shtresat e larta nuk mund të sundojnë më si përpara. Situata revolucionare përbën kushtin objektiv më të domosdoshëm të revolucionit. Por, që të shpërthejë revolucioni, nuk mjaftojnë vetëm kushtet objektive, por janë të domosdoshme edhe kushtet subjektive,

1. Xhimi Karter, në atë kohë president i SHBA.

siç i quan Lenini. Në kushtet subjektive përfshihet edhe udhëheqja politike e forcave revolucionare, partia komuniste.

Në të gjitha vendet borgjezo-revizioniste partitë ish-komuniste kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin e u shndërruan në shërbëtorë të borgjezisë. Të ashtuquajturat Parti Komuniste të Spanjës, të Francës, të Italisë, të Belgjikës etj., vetëm emrin kanë komuniste se në të vërtetë janë fund e krye revizioniste. Ka edhe vende të tjera ku partitë ish-komuniste kanë tradhtuar. Të gjitha këto parti janë bërë pa cipë fare, se i mohojnë haptazi diktaturën e proletariatit e luftën klasore proletare. «Nuk mund të shkohet me luftë në socializëm, — thonë ata, — por me paqe e bashkëpunim klasor, prandaj le të bashkohemi të tërë me borgjezinë, me kapitalistët, me fashistët, me policët dhe, të gjithë së toku, oburra të vemi në socializëm!».

Mirëpo ku të le borgjezia reaksionare të shkosh në socializëm urtë e butë? Ai mend, që nuk e tremb borgjezinë, nuk është socializëm. Borgjezia e pranon bashkëpunimin kur revolucionarët nuk janë më revolucionarë; kur ata pranojnë të bëhen shërbëtorë të saj dhe kur u thonë punëtorëve: «Pushoni, mos u ndieni për të gjallë!», sikurse u tha tani në fund sekretari i përgjithshëm i partisë revizioniste të Italisë, i cili ra në ujdi me partinë e demokristianëve. «Tashti, o punëtorë, duhet të bëjmë pak sakrifica», tha ai. Një punëtor, që e dëgjonte, e pyeti: «Akoma të bëjmë sakrifica? Po ne tërë jetën po sakrifikojmë». «Pritni, u përgjigj renegati, se kështu do të vejë puna dorisa të marrim fuqinë». Sido që këto parti kanë tradhtuar,

teoria marksiste-leniniste e revolucionit proletar nuk e humb vlerën kurrë. Marksizëm-leninizmi, kjo doktrinë e gjithëfuqishme, siç e quan Stalini, është i pavdekshëm. Këtë e provon krijimi i partive të reja marksiste-leniniste që luftojnë në rrugë të drejtë.

Sot po bën ca vapë, prandaj ju lutem më lejoni të vë pak kapelën. Edhe dielli, ashtu sikurse gjirokastritët, është i nxehtë këtu.

Unë nganjëherë dal jashtë temës në bisedë, sidomos kur kam shumë kohë pa komunikuar me ata që më dëgjojnë, prandaj fjalitë e mia të gjata mos m'i vini re, veçanërisht ju mësuesit e gjuhës. Kur fola njëherë pa kartë këtu në Gjirokastër, i dashuri mësuesi ynë, Thoma Papapano, më dëgjonte atje lart. Pasi fola, vajta që ta takoj basho Thomanë dhe e pyeta: «Si t'u duk fjalimi, o xha Thoma?». «Nga brendia më pëlqeu, m'u përgjigj ai, por disa fraza sikur s'mbaheshin në këmbë.»

E përqafova mësuesin tonë të dashur dhe qesha fort bashkë me të.

Këtu mund të rrimë gjatë së bashku e të flasim shumë, se unë s'kam të ngopur nga malli. Rashideja tha që herën tjetër kishe dy vjet pa ardhur në Gjirokastër, kurse kësaj here u bënë nëntë. Meqenëse herën tjetër fola dy orë, tani duhet të flas nëntë orë. *(Të qeshura.)*

Situata te ne, shokë e shoqe të dashura, në përgjithësi është optimiste, por nuk duhet të jetojmë në eufori, në gëzim pa baza. Të gëzuar dhe entuziastë të jemi, por të kemi kurdoherë parasysh që të jetojmë me situatat brenda dhe jashtë; të forcojmë punën në çdo sektor të jetës brenda vendit dhe të jemi vigjilentë për ngjarjet që zhvillohen jashtë. Është detyra jonë të

shtojmë miqësinë me popujt, se kjo miqësi ka rëndësi të madhe.

Shqipërinë socialiste e duan shumë jo vetëm marksistë-leninistët, por gjithë popujt e botës. Për studimin e materialeve të Partisë sonë jashtë ka një interesim të madh; njerëzit nxitojnë t'i marrin e të njihen me to. Në Azi, në Afrikë, në Amerikën e Veriut e kudo materialet e Partisë sonë lexohen me zell. Jashtë po bëhet diskutim i madh ideologjik e po mbrohet teza që Partia e Punës e Shqipërisë ka të drejtë, se vija e saj është e pagabuar etj. Të gjithë revolucionarët e vërtetë janë të bindur për atë që Partia jonë është marksiste-leniniste dhe se Shqipëria po ndërton socializmin.

Të gjithë na admirojnë. Për vendosmërinë tonë, me mijëra janë ata që na thonë: «More, si bëni ju kështu, ku e merrni gjithë këtë kurajë, si e keni arritur këtë unitet të plotë me popullin, si i keni arritur këto suksese në arsim e kulturë, si i keni përgatitur kaq mirë këta kuadro?». Ne ua shpjegojmë të huajve, por ka prej tyre që nuk para i kuptojnë të gjitha, sepse nga koha që e njohin ata Shqipërinë ka shkuar ujë i madh nën urë. Në biseda me shokët tanë jashtë shtetit, miqtë thonë se e ardhmja që ëndërrojnë ata, është të ndjekin rrugën e Shqipërisë socialiste, por ankohen se armiqtë i intrigojnë dhe i përçajnë. Shokët tanë u rekomandojnë studimin e eksperiencës sonë të pasqyruar në materialet e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Optimizmi në jetë është kurdoherë i nevojshëm se të jep gjallëri, të jep forca për të punuar më mirë. Për të arritur objektivat që i kemi vënë vetes duhet djersë e sakrifica. Të mos mendojmë tashti se po notojmë në

bollëk, jo, ne nuk jemi në këtë gjendje. Rreziqet kundër nesh ekzistojnë, prandaj duhet të punojmë shumë, që t'i mposhtim ato.

Doja të thosha disa fjalë edhe për ju, gjirokastritët, se ndryshe do të më thoni: «Na erdhe këtu, o shoku Enver, po si nuk na the dhe një fjalë për Gjirokastrën dhe për punën tonë?». Në këtë miting ka edhe shokë e shoqe nga rrethet e tjera të Shqipërisë, por nuk ma merr mendja se do të më akuzojnë që tashti po flas si gjirokastrit. (Të qeshura.) Ju punoni mirë. Organizata e Partisë dhe masat punonjëse të rrethit të Gjirokastrës kanë arritur rezultate të mira në realizimin e detyrave në ekonomi dhe në të gjitha fushat e tjera. Rrethi juaj ka rezultate të mira jo vetëm në industri e në bujqësi, por edhe në dituri. Kudo ka vendosmëri të madhe e disiplinë të fortë në punë, në fabrika e në kooperativa. Përparim të madh kanë bërë edhe vëllezërit tanë patriotë minoritarë të Dropullit, që janë të bashkuar si mishi me thoin me vëllezërit e tyre shqiptarë; përparim kanë bërë njerëzit tanë në Labëri dhe në gjithë krahinat e tjera të rrethit. Por, krahas sukseseve të arritura, këtu në Gjirokastrë ka edhe të meta, dobësi e boshllëqe. Ka rrethe që janë më mirë se ju. Unë nuk po i numëroj të tëra, por mund t'ju përmend vetëm Shkodrën, që, siç e dini, është një nga rrethet ku më përpara ka pasur shumë vështirësi. Tani Shkodra e ka stabilizuar situatën. Ekonominë, bujqësinë, industrinë i ka mirë; ajo qëndron në krye dhe ne mund ta marrim si shembull në përgjithësi.

Ju i keni të gjitha mundësitë për të ecur më përpara. Në radhë të parë keni njerëzit. Unë do të bëj një

mbledhje me kuadrot e këtij rrethi. Atyre do t'u flas pak,¹ se më të shumtat që kisha i thashë në këtë miting. Kuadrove mund t'u them disa fjalë, por edhe disa «hala», kurse juve sot nuk ju thashë shumë «hala». Sido që unë, nuk ju thashë gjë, ju i kuptoni vetë, se jeni njerëz me ndërgjegje të lartë politike e patriotë, prandaj të metat që ekzistojnë duhet t'i zhdukni për të mirën e atdheut, për të mirën e socializmit.

Me besim të madh në forcat tuaja, të dashur shokë e shoqe, të punoni në bazë të vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë dhe të plenumeve të Komitetit Qendror që janë mbajtur pas kongresit, sidomos të Plenumit të 4-t, ku u fol veçanërisht për realizimin e detyrave të planit.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli i qytetit të Gjirokastrës dhe i krahinave të saj!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë, me shkurtime, në gazetën «Zëri i popullit», nr. 66 (9239), 18 mars 1978

Botohet i plotë sipas shënimeve të mbajtura në këtë miting, që gjenden në AQP

1. Shih në këtë vëllim, f. 137.

POPULLI DHE PARTIA KANË FORCA TË MËDHA PËR TA NDËRTUAR VETË SOCIALIZMIN

*Nga biseda në takimin me kuadro drejtues
të rrethit të Gjirokastrës*

18 mars 1978

q

Në këtë takim merrnin pjesë edhe disa kuadro drejtues të Partisë e të pushtetit të rretheve të Tepelenës e të Përmetit.

Si jeni shokë, jeni mirë? Shiko, shiko sa shumë kuadro ka Gjirokastra! Dhe mendoni që këtu nuk janë të gjithë, por vetëm një pjesë, përfaqësuesit e tyre.

Pasi sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, shoku Ali Manaj e informoi shokun Enver Hoxha për punën që bëhet në rrethin e Gjirokastrës lidhur me zbatimin e vendimeve historike të Kongresit të 7-të të Partisë e të plenumeve të fundit të Komitetit Qendror, folën edhe shokë të tjerë.

I pari u ngrit shoku Timo Muçi, Hero i Punës Socialiste, kryetar i kooperativës bujqësore malore «Misto Mame».

SHOKU ENVER HOXHA: Po ku je, more Timo, se nuk të shoh mirë nga dritat e këtyre fotorepor-

terëve. Si je me shëndet? Ke vënë ndonjëçikë mish, apo ashtu i hollë je? I hollë, por i thantë ama. E kam ndjekur punën e kooperativës suaj, ecni mirë ju. Pa të dëgjojmë edhe ty të na flasësh pak për kooperativën që drejton.

SHOKU TIMO MUÇI: Sa kemi Partinë dhe ju, shoku Enver, gjithmonë përpara do të ecim. Dëshiroj t'ju informoj edhe për vënien në jetë të një porosie që na keni dhënë ju, me rastin e 50-vjetorit të gjimnazit «Asim Zeneli» në Gjirokastrë, ku e përmendni krahinën e Lunxhërisë si një nga krahinat që duhet të zërë një vend me rëndësi në rreth për pemëtarinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të të ndërpres pak, shoku Timo, se dua t'u them këtyre shokëve diçka. Ne gjirokastritët, e kam fjalën për ata të moshës sonë, nëse e lagnim gojën nganjëherë me ndonjë fik apo me ndonjë gorricë, këto i kishim nga të Lunxhërisë. Edhe me bukë na mbante puna e fshatarëve të palodhur e të varfër të Dropullit. Kështu ka qenë koha atëherë. Por tani situatat kanë ndryshuar si kudo në vendin tonë, ashtu edhe në Gjirokastrë.

SHOKU TIMO MUÇI: Ja çfarë tha një plak 92-vjeçar duke parë blloqet e pemëve, ku sapo kishin filluar të lulëzonin qershitë dhe bajamet: «Në të kaluarën ne nuk na linin bejlerët e agallarët që t'i punonim këto toka, tha ai. Fliste dhe lotët i binin në faqe. Tani jam i lumtur e më gëzohet zemra kur shikoj këto kodra me blloqe plot pemë që duken si sixhade».

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të kem qenë nja 10 vjeç, me sa më kujtohet, kur jam ngjitur për pjetë Erindit. Kam pirë ujë atje te çezmat. Ashtu është, ash-

tu siç thotë ai plaku, që të gjitha ato toka ishin lënë djerrë. Kurse sot, siç thatë ju, mbulohen nga blloqe plot me pemë. Shumë mirë, gëzohem shumë.

SHOKU TIMO MUÇI: Vetëm ekonomia jonë çdo vit hap rreth 40 hektarë toka të reja për pemëtarinë. Në dy muajt e parë të këtij viti prodhimin e qumështit e realizuam 127 për qind, kurse perimet i plotësuam 94 për qind. . .

SHOKU ENVER HOXHA: Shikoni se mos na lini prapë pa qepë të thata! Edhe hudhra na është zhdukur, jo vetëm këtu, por në të gjithë Shqipërinë; kështu që jemi detyruar të sjellim hudhra nga jashtë. Merrni masa që të kemi jo vetëm qepë, por edhe hudhra, se kjo me të vërtetë bie erë, por ja që duhet në kuzhinën tonë.

SHOKU PAVLLO KONOMI¹: Të gjithë bashkëfshatarët e mi, të Dropullit të Sipërm, sapo dëgjuam fjalën tuaj në mitingun e djeshëm të qytetit, më dërguan mua t'ju sjell juve të falat e tyre të përzemërta. . .

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe në Byronë Politike na kanë raportuar për punën tuaj shumë të mirë. Shoku Hysni [Kapo] ka qenë tani afër në Dropull dhe na ka folur për mobilizimin dhe për entuziazmin tuaj në punë.

SHOKU PAVLLO KONOMI: Ne i premtuam shokut Hysni, po ju premtojmë edhe juve se vendimet e direktivat e Partisë do t'i vëmë kurdoherë në jetë.

1. Në atë kohë, kryetar i këshillit popullor të kooperativës së zmadhuar «Llesh Pal Çupi» të Vriserasë.

SHOKU FEIM XHEBRO¹: Unë, shoku Enver, ju sjell përshëndetjet në emër të të gjithë kuadrove ushtarakë të rrethit tonë.

Në vazhdim ai foli për punën që bëhet lidhur me forcimin e disiplinës e të gatishmërisë ushtarake, për forcimin e lidhjeve me terrenin, për stërvitjen ushtarake, për fortifikimet etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani të informohemi një çikë për rrethin e Përmetit, se për gjendjen në rrethin e Tepelenës u informova para disa ditësh, pasi gjatë rrugës për këtu ndalova nja dy orë në Tepelenë.

*Shoku Qemal Bregasi, në atë kohë, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Përmetit, informoi për arritjet e punonjësve të këtij rrethi. Pastaj e mori fjalën shoku Viktor Jani*².

SHOKU ENVER HOXHA: Nga ç'fshat i Zagories je ti?

SHOKU VIKTOR JANI: Jam nga Topova.

SHOKU ENVER HOXHA: Nexhmija e njeh më mirë se unë krahinën tuaj, sepse ka qenë atje në kohën e luftës.

Dje, kur fola në miting, doja të vija në dukje edhe punën e mirë që keni bërë ju, shokë të Zagories, për të rrënjosur te të rinjtë dashurinë për fshatin. Kjo është një nga veprat më të bukura që keni bërë, por më doli nga mendja. Se, e thashë edhe atje, kur njeriu ka shumë për të folur, edhe harron ndonjë gjë; pas-

1. Kuadër ushtarak.

2. Në atë kohë kryetar i kooperativës bujqësore «Alqi Kondi» të Zagories.

taj, edhe një çikë të kaluar nga mosha jemi. Ju keni bërë mjaft përparime dhe ne ju kemi ndjekur gjithmonë me kujdes. Prandaj, më parë se të flasësh ti, unë po ju them se keni arritur suksese në punën tuaj. Vazhdoni të punoni mirë e më mirë për të pasur kurdoherë fitore sa më të mëdha.

SHOKU VIKTOR JANI: Krahina jonë është mallore. Po bëjmë përpjekje që t'i realizojmë edhe drithërat e bukës, se për sa i përket blegtorisë ne jemi më mirë...

SHOKU ENVER HOXHA: Mos harroni, se vendi juaj është edhe vendi i kumbullave e i pemëve të tjera frutore.

SHOKU VIKTOR JANI: Mirë e kemi filluar punën edhe me pemëtarinë, 30 hektarë i kemi mbjellë me kumbulla, mollë, arra etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Molla duhet të rritet mirë në Zagorie, apo jo? Po rrushi, si duket, a piqet mirë atje?

SHOKU VIKTOR JANI: Vitin që vjen ne parashikojmë të marrim prodhimin e parë në rrush në 10 hektarët që mbollëm në vitin 1975. Ne kultivojmë, gjithashtu, fasulen kokërrmadhe për eksport.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ju duhet ta kultivoni fasulen kokërrmadhe, ose siç i thonë në greqisht, pllaqi.

SHOKU VIKTOR JANI: Gjithashtu ne grumbullojmë edhe bimë mjekësore; disa prej tyre janë për eksport.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju kanë ardhur në bibliotekën e fshatit libra të mjekësisë popullore, si, për shembull, libri që flet edhe për bimët që thatë ju?

SHOKU VIKTOR JANI: Po, na ka ardhur, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Të keni në bibliotekën tuaj jo një, por shumë libra të tillë, që ju jo vetëm t'i mblidhni këto bimë mjekësore, por edhe të dini t'i përdorni. Këta libra t'i studioni me kujdes dhe të kuptoni se përse përdoret njëra e përse tjetra.

Dje, në fjalën time në miting, përmenda vetëm rignonin. Me atë desha të ironizoja armiqtë, që na quanin ne «qeveri e rignonit», dhe t'u thosha atyre se vërtet na quanin ashtu, por ne i bëmë ata dhiozmë për jahni. (Të qeshura.) E dini ju ç'është jahnia, apo jo?

SHOKU LLAMBI GJIKA¹: Gjendja moralo-politike e popullit te ne është e shëndoshë...

SHOKU ENVER HOXHA: Nga ç'sektor je ti, shoku Llambi?

SHOKU LLAMBI GJIKA: Jam nga sektori i Peshkëpisë.

SHOKU ENVER HOXHA: A..., nga Peshkëpia! «Në qafë të Peshkëpisë / lufton i biri i Xhixhisë», siç thuhet në një këngë popullore. (Të qeshura.)

SHOKU LLAMBI GJIKA:... Të shumë janë në kooperativën tonë djemtë dhe vajzat që kanë mbaruar shkollën e mesme e të lartë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po shkollat në gjuhën greke a funksionojnë në rregull? Mësuesit e tyre a e dinë mirë gjuhën dhe ua mësojnë atë siç duhet nxë-

1. Në atë kohë, përgjegjës sektori në Kooperativën Dujqësore të Tipit të Lartë të Dropullit të Poshtëm.

nësve? Po gazeta «Llaiko Vima» dhe literaturë e përkthyer në gjuhën greke a ju vijnë rregullisht?

SHOKU LLAMBI GJIKA: Po, shoku Enver, shkollat funksionojnë në rregull; mësuesit e zotërojnë gjuhën dhe përpiqen t'ua mësojnë atë sa më mirë nxënësve. Te ne vjen rregullisht gazeta «Llaiko Vima» dhe literaturë tjetër e përkthyer në greqisht...

SHOKU ENVER HOXHA: Shoku Ali Manaj, tha se nuk ka më shokë të tjerë për të diskutuar. Tashti ju prisni që t'ju them diçka edhe unë, prandaj do t'ju flas pak.

Siç ju thashë dje në miting, ku bësoj se ishit të gjithë, situata edhe në rrethet tuaja, si kudo në vendin tonë, paraqitet e kënaqshme. Këtë e vërtetojnë edhe raportet e shkurtër, por konkrete, që na bënë shokët që folën.

Rezultatet që keni arritur na gëzojnë të gjithëve, na entuziazmojnë. Ato na shtojnë forcën dhe besimin se gjendja jo vetëm te ju, por në mbarë vendin tonë do të shkojë duke u përmirësuar e duke u kalitur vazhdimisht. Në radhë të parë, do të kaliten njerëzit tanë me ideologjinë marksiste-leniniste. Por do të ecë përpara edhe ekonomia, e cila është e lidhur ngushtë dhe varet kryesisht nga njerëzit, nga punëtorët, nga kooperativistët dhe nga kuadrot. Është për këtë arsye që, siç e kam vënë në dukje edhe herë tjetër, ne menduam që problemet e Plenumit të 4-t të lidheshin me atë pikë të rendit të ditës të Plenumit të 3-të që trajtoi përmirësimin e mëtejshëm të punës me kuadrin.

Gjithë këtë përparim që kemi në ekonomi ia detyrojmë, në radhë të parë, vijës së drejtë të Partisë,

ideologjisë sonë, të cilën, është fakt se kuadrot e kanë përvetësuar dhe punojnë dita-ditës gjithnjë e më shumë për ta rrezatuar atë edhe në popull. Përveç ngritjes së nivelit politik e ideologjik të kuadrove tanë, ne vëmë re edhe një ngritje të nivelit të tyre teknik e profesional, se tok me politikën dhe me ideologjinë, s'ka dyshim që është e domosdoshme të ecë përpara edhe zhvillimi i teknikës, e cila duhet zotëruar mirë.

Partia ka folur vazhdimisht për revolucionin tekniko-shkencor, që ka një rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë. Këtë revolucion Partia jonë e ka kuptuar kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste. Krejt ndryshe e kuptojnë atë revizionistët modernë. Revolucionit tekniko-shkencor ata i atribuojnë ato detyra që mund të realizohen vetëm nëpërmjet luftës së klasave dhe mendojnë se me zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor mund të merret edhe pushteti nga proletariati. Revizionistët modernë pretendojnë se në kohën e sotme në vendet kapitaliste nuk ekziston më proletariati i dikurshëm, por klasa punëtore që, sipas tyre, ka të ardhura të mira dhe klasa kapitaliste. Duke u nisur nga niveli i forcave prodhuese në kapitalizëm dhe nga zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor në ato vende, revizionistët modernë thonë se teoria marksiste-leniniste për marrjen e pushtetit me dhunë nga proletariati është vjetruar. Ata përpiqen «të vërtetojnë» se pushtetin tani e kanë në dorë teknokratët, teknikët. Por cilët janë këta? Revizionistët thonë se këta janë djemtë e popullit, por, në fakt, ata janë bijtë e pronarëve të fabrikave, të minierave, të hekurudhave, të energjisë elektrike etj., etj. Prandaj ka një ndryshim të madh li-

dhur me kuptimin e revolucionit tekniko-shkencor nga marksistë-leninistët dhe nga revizionistët modernë.

Ne sot, në sajë të punës së gjithanshme që ka bërë Partia, shohim një hov të madh në ngritjen teknike të njerëzve tanë. Kohët e fundit Byroja Politike dhe Qeveria kanë marrë në shqyrtim një studim të imët, që ka ardhur nga ju, nga baza. Edhe ky studim i bërë në mënyrë të thellë, konkrete e shkencore dhe me afate të caktuara për një numër të madh problemesh të rëndësishme shkencore dhe teknike të vendit, vërteton atë që thashë më parë: ngritjen e nivelit tekniko-shkencor të njerëzve tanë. Të tilla studime shërbejnë e duhet të shërbejnë si një pjesë përbërëse kryesore e revolucionit tekniko-shkencor e që do të ndihmojnë për të realizuar detyrat që kemi përpara, si në këtë pesëvjeçar, ashtu edhe në pesëvjeçarin e ardhshëm, për të cilin, së shpejti, ne do të përcaktojmë orientimet në vija të përgjithshme për të filluar menjëherë, qysh tani, nga puna për përgatitjen e tij. Ato mund të na shërbejnë edhe më vonë se pesëvjeçari i ardhshëm.

Pra, marksizëm-leninizmi, që është shkencë mbi shkencat, hap për njerëzit tanë horizonte të mëdha, hap atë perspektivë të madhe që ata të mendojnë, të shpikin dhe të krijojnë për ta çuar gjithnjë e më përpara zhvillimin e ekonomisë, ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Në këtë drejtim po mendohet seriozisht nga kuadrot dhe masat tona punonjëse, që nga baza e deri në organet qendrore. Edhe planin pesëvjeçar që jemi duke realizuar, natyrisht, edhe ne në qendër e kemi parë dhe e kemi studiuar, por, e kanë hartuar kryesisht kuadrot në bazë, e kanë diskutuar punëtorët e çdo sektori.

Çdo plan pesëvjeçar, pasi përgatitet nga baza, e shohim edhe ne. Pastaj ai kthehet përsëri në bazë. Tash do të krijohen grupe specialistësh nga njerëzit tanë më të mirë e më të aftë për revolucionin tekniko-shkencor. Por mos mendoni se me largimin e tyre nga frontet ku punojnë do të boshatisen vendet nëpër fabrikat, uzinat e ndërmarrjet tona të sektorëve të ndryshëm. Jo, se afër një mijë veta që mund të jenë këta që do të marrin me këtë punë, në një masë prej rreth 40 mijë specialistësh që ka përgatitur Partia deri më sot në vendin tonë, nuk përbëjnë ndonjë boshllëk të madh për fabrikat apo ndërmarrjet. Kurse, në shkallë kombëtare, për objektivin që i kemi caktuar vetes, ky grup specialistësh është një forcë me kapacitet të madh tekniko-shkencor.

E dëgjuat çfarë tha shoku i Peshkëpisë, se sa shumë kuadro kanë dalë vetëm nga minoriteti dhe sa të tjerë do të dalin po andej? Pa llogaritni pastaj edhe sa kuadro kanë dalë nga mbarë Shqipëria! Të gjithë ata nuk do të qëndrojnë, si në kohën e Abdyl Këllezit, të mbyllur nëpër zyra, sa për të shfletuar disa libra, por do të dërgohen në bazë si, fjala vjen, atje ku është minerali, nafta etj. Ata do të vijnë edhe në kooperativat tuaja bujqësore për t'u marrë konkretisht me ato subjekte studimi që na duhen dhe do të rrinë në bazë një vit, dy vjet apo sa të jetë nevoja, derisa ta nxjerrin nga duart e tyre atë punim me vlerë, për të cilin do të ngarkohen në këtë apo në atë sektor.

Me këtë nuk dua të them që këta kuadro të mos venë në familje herë pas here për të parë njerëzit e tyre të afërt. Të kuptohemi drejt. Çështjen e kam që kuadri duhet «të shtrojë mirë gunën» atje ku është caktuar të

punojë. Ja, oficerët tanë që punojnë kudo e stërvitin gjithë këtë ushtri të madhe të popullit, i kanë marrë familjet atje ku punojnë vetë, megjithëse ka edhe disa prej tyre që nuk i marrin. Po kështu, edhe nëpër rrethe ka disa kuadro, si: mësues, mjekë, mami, agronomë, zooveterinerë, ekonomistë e të tjerë, që janë caktuar të punojnë në fshatra, por familjet nuk i kanë çuar atje. Edhe në Tiranë ka kuadro që janë caktuar të punojnë në fshatrat përreth, por familjet i mbajnë në kryeqytet. Ata, në mëngjes, në orën 8 nisen nga shtëpia për të shkuar në fshat, dhe në orën 5 pasdite kthehen prapë në Tiranë me autobusin urban. Le të marrim rastin e një mjeku që është caktuar të shërbejë në Ndroq. Sikur pa pritur, natën, të sëmuret atje një njeri ose një gruaje t'i vijë koha për të lindur e të ketë nevojë për asistencë urgjente mjekësore, kush do t'i shkojë në ndihmë? Ku ta gjejnë mjekun?

Qëndrime të tilla te ne, nuk duhet të ndodhin. Njerëzit tanë e kanë për detyrë të veprojnë, siç na mëson Partia, të punojnë kudo ku ka nevojë atdheu, si në qytet ashtu edhe në fshat, i cili, aktualisht është edhe i bukur e me gjithë të mirat. E dini shokë që ne kemi ndërtuar në shumë fshatra apartamente banimi? Po për kë i kemi ndërtuar ato? Për qytetarët që caktohen të punojnë atje, për kuadrot si mësues, ekonomistë, mjekë e të tjerë. Mirëpo, ka nga këto apartamente që tani rrinë bosh, sepse disa prej këtyre kuadrove bëjnë naze dhe hezitojnë të vendosen përgjithnjë atje.

Shtëpi banimi në fshat ne nuk ndërtojmë vetëm për mësuesit e mjekët, por edhe për vajzat e djemtë e rinj që venë vullnetarisht në fshat për të punuar e për

të jetuar atje përgjithmonë. Ne kemi ndërtuar dhe vazhdojmë të ndërtojmë shtëpi për këtë qëllim se në fshatrat tona kanë vajtur për të jetuar shumë vajza e djem të rinj nga qyteti. Janë krijuar edhe disa fshatra të reja. Si kudo në Shqipëri, edhe në fshat, janë bërë përparime të mëdha dhe jetohej pothuajse njëloj si edhe në qytet.

Këto përparime vijnë pikërisht nga vija e drejtë e Partisë, nga zbatimi i përpiktë i saj. Por direktivat e Partisë duhen kuptuar mirë, ato duhen tretur e asimiluar dhe pastaj duhet menduar e mësuar për t'i zbërthyer e për t'i vënë në jetë ato. Ka rëndësi të dish t'i zbërthesh direktivat. Njerëzit tanë nuk duhet të presin që t'ua zbërthejnë të tjerët, por secili t'i zbërthejë vetë ato. Mos e nënvleftëso kurrë veten, duke menduar se të mungon eksperiencia, thotë Partia; ki atë sedër revolucionare që duhet të karakterizojë njeriun tonë; mendo se, qofsh kooperativist i thjeshtë apo kuadër, ke dijeni e përvojë të madhe agroteknike dhe këto mos i lër të flejnë në kokën tënde, por vuri në zbatim. Pastaj, përpiku vazhdimisht ta pasurosh atë eksperiencë që ke, hap veshët mirë kur flasin ata që dinë më tepër se ti dhe zbatoji ato që mëson në jetë; bëju kritikë atyre pikëpamjeve e veprimeve që nuk janë të drejta; ki guxim dhe mos u tut, po kurdoherë vepro me guxim; guxim, dhe vetëm guxim, siç thoshte një revolucionar francez.

Tregojnë se ky revolucionar, deri në momentin që vajti përpara gijotinës, guxoi të fliste. Edhe kur erdhi koha që t'i pritnin kokën, ai prapë me guxim i tha xhelatit: «Më lër ta puth edhe një herë shokun tim që kam në krah». «Jo, nuk të lë», iu përgjigj xhelati. «Bu-

dalla, ia ktheu ai, por kur të bien kokat tona në shportë, do të më ndalosh ta puth?!».

Me këtë dua të them se ne duhet të kemi guxim për mbrojtjen e mendimeve të drejta dhe këtë t'ua mësojmë edhe të tjerëve. Guxim për të kritikuar atë që gabon duhet pasur në çdo drejtim, në çështjet politike e teknike. Kjo forcon te ne unitetin dhe zhduk mendjemadhësinë, fodullëkun e të metat e tjera. Në këtë mënyrë ne i mësojmë njerëzit tanë ta duan shoqi-shoqin sinqerisht, të mos e përkëdhelin e të mos i fërkojnë krahët, por ta ndihmojnë njëri-tjetrin për të ecur me guxim e me hapa të sigurt përpara.

Këto gjëra që thashë janë ca si të përgjithshme. Por edhe këto na duhen. Kemi nevojë të mësojmë nga njëri-tjetri. Edhe ne përpiqemi të njohim problemet ekonomike. Shpeshherë, kur ndiejmë nevojën e tyre, thërresim në Byronë Politike, në Sekretariat apo në Qeveri për shembull, shokun Spiro Lengo¹ e të tjerë, që i dinë mirë problemet ekonomike, të cilat kanë rëndësi kapitale.

Ne jemi në dijeni të plotë të gjendjes në vendin tonë jo vetëm në përgjithësi, por edhe në detaje. Po ta shohim problemin vetëm në përgjithësi, atëherë mund të duket sikur çdo gjë shkon për bukuri e kudo është shesh me lule. Jo. Vërtet se edhe te ne ka lule shumë, por ama në vendin tonë nuk «lulëzojnë 100 lule» si në Kinë. (Të qeshura.) Te ne, në idologji, ka vetëm një «lule», dhe vetëm kjo e bën vendin tonë të lulëzojë pa ndërprerje.

1. Spiro Lengo, në atë kohë zëvendësministër i Bujqësisë, kuadër nga minoriteti grek, nga Dropulli.

Këtu jemi mes kuadrosh dhe Partia, si në Plenumin e 2-të, ashtu edhe në Plenumin e 3-të, ju vuri në dijeni e jua bëri të qartë se ç'mendon ajo për vijën politike dhe ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Republikës Popullore të Kinës. Ato çka u janë thënë lidhur me këtë parti dhe me këtë shtet janë mendime të bazuara e të konkretizuara nga ana e saj për një kohë të gjatë, prej 14-16 vjetësh me radhë. Partia jonë e dinte, e shikonte, vigjilonte dhe në rrugë të drejtë marksiste-leniniste përpiqej ta ndihmonte Partinë Komuniste të Kinës. Ajo e mbronte atë në ato momente kur dukej sikur udhëheqja kincze ishte në brazdën e drejtë të marksizëm-leninizmit. Ne e mbështetnim atë duke menduar se kjo ndihmë u shërbente revolucionit e socializmit. Por politika e ndjekur nga Partia Komuniste e Kinës, ishte një politikë e lëkundshme, për arsye se nuk kishte në timon teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Thuhej se në Kinë ndërtohej socializmi. Edhe ne vetë e kemi pohuar këtë gjë dhe na e donte zemra të ishte kështu. Në fakt, atje dukej sikur filloi të realizohej një kurs i tillë, sepse u bë një revolucion i madh, u thye okupatori japonez, u hodh në det Çan Kai Shia dhe u krijua Republika Popullore e Kinës, e cila u cilësua si një demokraci e re. Ne kishim bindjen dhe shpresat se kjo demokraci e re do të ndiqte rrugën e demokracisë popullore, domethënë, do të fillonte punën për ndërtimin e socializmit. Në realitet atje nisën të realizohen disa reforma të një regjimi demokratiko-borgjez përparimtar dhe puna mbeti me kaq.

Partia jonë është e re, si të thuash në vite, por ka eksperiencën e një partie «plakë», se ajo ka vuajtur shumë, është ndeshur dhe ka kapërcyer shumë vështirësi. Ajo ka ndjekur me vëmendje politikën e Partisë Komuniste të Kinës; shikonte dhe bënte pyetje: «Pse veprohet kështu për këtë apo për atë problem në Kinë?! Pse ndaj atij rasti Partia Komuniste e Kinës mbajti atë qëndrim?!». Ne bënim vazhdimisht pyetje të tilla dhe kërkonim të merrnim përgjigje në rrugë të drejtë për një varg çështjesh të rëndësishme parimore. Koha kalonte dhe punët sa venin e trasheshin. Ne, si marksistë, kemi kërkuar të bisedonim me udhëheqësit kinezë, të shkëmbejmë mendime së toku për ato probleme që na shqetësonin me të drejtë. Mirëpo udhëheqësit kinezë nuk na jepnin mundësi për këtë gjë. Në këto kushte, Partia jonë detyrohej t'ua jepte mendimin e saj me shkrim, por ata na përgjigjeshin se «nuk duam të bëjmë polemikë me shqiptarët».

Kjo ishte një e drejtë e tyre. Por, si shokë dhe si miq ishte me vend që edhe ne t'ua thoshim haptazi vërejtjet tona, siç ua thamë: «More shokë, këtu e keni drejt; këto mendojmë se i keni gabim, prandaj urdhëroni të bisedojmë, sepse takimet dhe shkëmbimi i mendimeve midis partive të vërteta komuniste marksist-leniniste është një çështje parimore». Këtu nuk ishte fjala për blerjen e një frigoriferi apo të një makine, të cilat po të duash bliji, po të duash mos i bli, por për çështje të tilla themelore si: Do ta bësh reformën agrare deri në fund, apo nuk do ta bësh? Do të zhvillosh luftën e klasave siç duhet, apo do t'i lësh kulakët, pa-

shallarët, agallarët dhe gjithë të pasurit e fshatit e të qytetit të livadhisin e të bëjnë si të duan edhe pas vendosjes së diktaturës së proletariatit? «Ne do t'i lëmë fshatarët e pasur dhe çifligarët në pronat e tyre», pohohet në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës. Bile, që në vitin 1949 udhëheqësit kinezë thanë: «Këta elementë do t'i lëmë edhe 30 vjet akoma, e, të shohim, mbase edhe më tutje».

«Atëherë çfarë reforme agrare është kjo?», pyetnim ne. Jo, kjo nuk ishte në rrugë të drejtë. Mund të prananim ne që pas vitit 1944, pas gjithë atij gjaku të derdhur, të linim Vrionët dhe agallarët e tjerë të fshatit të bënin ligjin edhe për 30 vjet në diktaturën e proletariatit?! Ne nuk mund ta konceptonim një gjë të tillë. Po të kishim industrialistë të mëdhenj, ne do t'u kishim vënë fshesën, siç ua vumë edhe industrialistëve të veçjël, kurse kinezët kapitalistët i bënë nëndrejtorë të ish-pronave të tyre dhe, veç rrogave të majme, u jepnin edhe një përqindje të konsiderueshme nga fitimet e tyre si rentë. Edhe këtë ne nuk mund ta kuptonim.

Pra, ne nuk mund ta kuptonim kurrsesi socializmin në këtë mënyrë. Një praktikë të tillë antisocialiste s'na e mësojnë as Marksi, as Engelsi, as Lenini e as Stalini. «Janë kushtet e Kinës që na detyrojnë të veprojmë kështu», thoshin kinezët. Por kushtet e Kinës nuk janë krejtësisht të ndryshme nga ato të vendeve të tjera sa që të diktojnë ndërtimin e një shoqërie të tillë socialiste ku elementëve të klasave shfrytëzuese t'u lihet e drejta të drejtojnë e të bëjnë ligjin në shtetin e proletarëve! Vërtet, atje ka veçori, siç ka çdo vend tjetër; tek ata këto veçori ndoshta mund të ishin një çikë më të thek-

suara, por, sidoqoftë kushtet e Kinës nuk duhet të çojnë në shkeljen e parimeve marksiste-leniniste të ndërtimit të socializmit. E them këtë se në Kinë zbatimi i teorisë marksiste ndryshonte si nata me ditën në krahasim me praktikën tonë. Kështu mund të flasim për shtrembërime të parimeve të marksizëm-leninizmit, në praktikë, nga Partia Komuniste e Kinës edhe për shumë probleme të tjera të rëndësishme.

Nga lajmet mësova se tash së fundi në Kinë është bërë mbledhja e Asamblesë Kombëtare Popullore. Ju jeni në dijeni për organizimin e puçit nga ana e Hua Kuo Fenit me shokë dhe për luftën kundër «katërshes». Në të vërtetë atje nuk është vetëm çështja e luftës kundër «katërshes», por e miliona njerëzve revolucionarë, demokratë e komunistë, që persekutohen. Atje ekziston një kaos kaq i madh, sa edhe mbledhjen e asamblesë mezi e bënë. Ju mund të pyesni se cilët janë ata që e përbëjnë këtë asamble. Nga vetë të dhënat që japin kinëzët del se, në këtë forum të lartë shtetëror, 200 deputetë janë nga ata që kanë qenë tregtarët më të mëdhenj të Kinës përpara revolucionit popullor dhe Revolucionit Kulturor, nga ata njerëz që në kohën e Liu Shao Çisë zinin vende të rëndësishme në administrimin e ndërmarrjeve; merrnin, siç thashë, një rentë nga pronat e tyre, dhe tash zgjidhen deputetë. Industrialisti më i madh i Shangait është zgjedhur deputet, bile edhe nënkryetar i Asamblesë Kombëtare Popullore të Kinës.

Shumë nga ju, gjithashtu, e dinë që Mançuria ka qenë një mbretëri, e cila në bashkëpunim me Çan Kai Shinë mbështeti Japoninë në luftën kundër Mao Ce

Dunit. Mbretin e Mançurisë e quanin Pu Ji. Kur u përmbys monarkia, ky u dorëzua, por Mao Ce Duni, në vend që Pu Ji-së t'i tregonte vendin, e bëri profesor në universitet. Kështu që Pu Ji-ja i mbylli sytë i nderuar. Kurse vëllai i tij, pra, vëllai i mbretit, tani na u bë deputet dhe ka në dispozicion një shtëpi me 15 dhoma. Ky deputet kërkoi të paguante qiranë e shtëpisë, por Hua Kuo Feni e ka lajmëruar se nuk duhet të paguajë qira. Në një kohë kur populli kinez jeton në vështirësi, kur punëtori nuk gjen mish, kur orizin e ka të racionuar, kur mezi blen një palë ndërrresa dhe paguhet me 30 juanë në muaj, princi jeton në bollëk, në një vilë e, me siguri, merr edhe ndonjë rrogë kush e di se sa të majme, sepse rrogat e larta në Kinë janë 7-8 e deri në 20 herë më të larta nga paga mesatare e punëtorit. Dhe, veç këtyre ai s'pagan as qira. Çfarë t'i thuash kësaj, socializëm?! Jo, për ne ky nuk është socializëm.

Po «teoria e tri botëve», ç'është? Kjo «teori» është një mbulesë për të fshehur mohimin që i bëjnë ata revolucionit proletar dhe synon të zhdukë në Kinë e kudo luftën e klasave, si dhe luftën nacionalçlirimtare të popujve të shtypur. Vija kineze bën thirrje për bashkimin e borgjezisë me proletariatin dhe të popujve të vegjël me borgjezinë e madhe të vendeve të tyre. Përkrahësit e «teorisë së tri botëve» predikojnë, gjithashtu, bashkimin me «botën e dytë» dhe me imperializmin amerikan, duke e motivuar këtë qëndrim me sulmin e mundshëm nga ana e sovjetikëve. Pra, kjo teori bën thirrje për mbështetje tek imperializmi amerikan, siç bën në fakt edhe vetë Kina. Ajo, duke u mbështetur tek imperializmi amerikan, te borgjezia perëndi-

more, te Mobutu¹, tek iksi ose tek ipsiloni, tek të gjithë këta pasanikë të mëdhenj që sundojnë mbi popujt e tyre, te këta klerikë, dervishlerë e shehlerë, ka një qëllim: të bëhet një fuqi imperialiste.

A mund të jetë dakord Partia jonë me një shtet të tillë që quhet socialist, por që, në fakt, duke ndjekur këtë politikë e duke u mbështetur në të tilla teori, po ecën revan drejt socialimperializmit?! Siç e thashë edhe dje në miting, natyrisht jo haptazi, kinczët na qenkan zemëruar se Partia e Punës e Shqipërisë ka sulmuar idetë e Mao Ce Dunit për «botën e tretë»! Në të vërtetë ka qenë Mao Ce Duni ai që ka sulmuar idetë e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër «botës së tretë», se këtë «teori» Maoja e përkrahu në vitin 1974, kurse Partia e Punës e ka sulmuar atë që në vitin 1960. Pastaj, nuk është aspak e vërtetë që këtë «teori» e ka krijuar Mao Ce Duni; atë e ka shpikur imperializmi për të treguar se vendet e kësaj «bote» ekonomikisht duhet të jenë në mëshirën e tij.

Mao Ce Duni e përvetësoi këtë «teori» dhe tash thuhet sikur na e paska shpikur ai. Mirë, po e zëmë sikur e ka shpikur ai, po pastaj, pa ta shohim se çfarë ka shpikur? Ai shpiku pikërisht një teori antimarksiste, duke u përpyetur t'i japë një ngjyrë marksiste dhe duke e konsideruar këtë «botë të tretë» si forcën e vetme më të madhe lëvizëse të revolucionit. Po vallë cilët janë këta që përbëjnë këtë forcë të madhe të revolucionit? Shahu i Persisë, Begini² i Izraelit, Pinoçeti i Ki-

1. President i republikës së Zairesë.

2. Menahem Begin, kryeministër i Izraelit në vitet 1977-1983.

lit e të tjerë si këta?! Popujt, ku sundojnë këta reaktionarë, shfrytëzohen deri në palcë, luftojnë kundër regjimeve në fuqi dhe në këtë luftë ata duhen mbështetur!...

Për këto probleme unë nuk u zgjata në miting, dhe arsyen përse nuk flasim akoma, ju e kuptoni. Komiteti Qendror ia tha gjithë Partisë arsyen e një qëndrimi të tillë nga ana jonë. Me komunistët ne duhet t'i themi, t'i sqarojmë këto probleme që ata të armatosen. Megjithëse edhe pa folur akoma, Partia, anëtarët e saj, që janë të ngritur ideologjikisht, i kanë nuhatur këto qëndrime.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë kanë forca të atilla që të jenë në gjendje ta ndërtojnë vetë socializmin. Ne nuk ngecëm atëherë kur nuk kishim gjëkafshë fare dhe mbi qafë na qëndronin jugosllavët, që na vodhën e na grabitën edhe ato pak mallra që kishim. Kurse sot ne i kemi të gjitha mundësitë për të ecur përpara me forcat tona, vetëm se këto forca duhet t'i mobilizojmë dhe t'i organizojmë sa më mirë.

Për të gjitha këto arsye, vëllezër e motra, shokë e shoqe komuniste, kur Kongresi dhe Komiteti Qendror na thonë se planet që hartojmë janë reale, ne duhet të punojmë që t'i realizojmë ato, duke mobilizuar të gjitha forcat që këtë direktivë ta vëmë në jetë, sepse është për të mirën e popullit tonë, për mbrojtjen e socializmit e të atdheut, për mbrojtjen e Partisë, për fuqizimin e revolucionit. Këtë çështje ta kuptojmë drejt si marksistë.

Ne jemi të vegjël, si popull dhe si Parti, por është

marksizmi, të cilit ne i qëndrojmë kurdoherë besnikë, ai që na jep forcë dhe një forcë kolosale. Shumë popuj, të frymëzuar nga kjo ideologji janë ngritur në këmbë, pikërisht se marksizëm-leninizmi ka një forcë të tillë që frymëzon miliona e qindra miliona njerëz në të gjithë botën. Ne jemi pjesëtarë të vegjël, por energjikë të kësaj armate të madhe të revolucionit dhe këtë energji duhet ta tregojmë si kurdoherë me luftën tonë të vendosur. Të mos ligështohemi kurrë, sepse shokët tanë jashtë, marksistë-leninistët e vërtetë kudo në botë, po organizohen dhe po luftojnë me vetëmohim.

Sot lexova një telegram që më erdhi nga Dar-es-Salam, nga Tanzania, ku ambasadori ynë më shkruante: «Sapo dorëzova 500 kopje të «Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë» dhe materiale të tjera të Partisë sonë. Në çast, në sy të shokëve tanë, libraria «u sulmua» nga një numër i madh studentësh e profesorësh dhe brenda dy orësh të gjitha kopjet u shitën. Prandaj, me vaporin që do të vijë me bitum, në qoftë se mundeni na dërgoni 500 kopje të tjera, ose edhe më shumë».

Ç'tregon një gjë e tillë? Kjo tregon se politika, vija që ndjek Partia jonë kanë një efekt të madh te marksistët e te popujt në botë. Puna jonë të bëjë efektin e saj brenda në vend, por të ndihet, aq sa kemi mundësi, edhe te shokët tanë që luftojnë në kushte të vështira në botën kapitaliste e revizioniste.

Në shumë vende të botës është duke nxjerrë kokën fashizmi. Besoj se e keni marrë vesh ç'po ngjet në Itali, që është një nga shtetet kapitaliste më bankrute në çdo pikëpamje: morale, ekonomike dhe shoqërore; banditizmi zhvillohet sheshit, gjë që i përgatit rrugën fa-

shizmit. Gjendja ka arritur deri atje sa para dy ditësh banditët rrëmbyen në Romë Aldo Moron, një personalitet politik borgjez nga më të rëndësishmit në këtë vend, që ka qenë 5 herë kryeministër dhe tani ishte kryetar i Partisë Demokristiane. Banditët e rrëmbyen Moron, pasi vranë rojat që e shoqëronin. Ata i kishin marrë të gjitha masat për këtë veprim: para se ta rrëmbenin Moron, kishin prerë të gjitha telat e telefonave të lagjes ku ai banonte.

Po pse ngjet kjo në këtë vend kapitalist? Ngjet për atë arsye që thotë Lenini, se imperializmi është faza e fundit e kapitalizmit, është kapitalizmi në kalbëzim. Ky sistem është në kalbëzim, sepse në vendet ku ai është në fuqi, masat e gjera të proletariatit dhe të popujve janë ngritur në luftë revolucionare dhe ia kanë bërë të pamundur jetën borgjezisë së madhe. Por, kur borgjezia e ka të pamundur të sundojë me ato forma e mjete që ka sunduar deri tani, atëherë asaj nuk i mbetet asnjë rrugë tjetër, veçse të vendosë diktaturën fashiste ose ndryshe do të shpërthejë revolucionin. Mirëpo që të shpërthejë revolucionin, përveç faktorëve objektivë duhet të ekzistojë edhe faktori subjektiv. Por, siç e thashë edhe dje në miting, mua më duket se në vendet kapitaliste mungon pikërisht faktori subjektiv, partia e proletariatit. Partitë ish-komuniste në vendet kapitaliste kanë tradhtuar e janë shndërruar në parti revizioniste. Në qoftë se ato do të ishin në pozita të drejta revolucionare, me kushtet që janë krijuar në shumë vende kapitaliste, do të kishte shpërthyer me kohë revolucionin.

Është e vërtetë se në disa nga këto vende janë

krijuar parti komuniste marksiste-leniniste, por ato janë akoma të reja, prandaj u duhet kohë për të fituar eksperiencë. Megjithatë kurrë të mos humbasë shpresa për revolucion, sepse situatat e krijuara e që do të krijohen në të ardhmen do t'i acarojnë akoma më shumë kontradiktat midis proletariatit dhe kapitalistëve.

Kohërat janë vërtet të turbullta, por ato janë njëkohësisht edhe revolucionare. Në këto kushte neve, shqiptarëve, na vihet detyra që të jemi sa më të fortë e për këtë, para së gjithash, duhet të realizojmë planet. Prandaj, zotimet që morët t'i vini në jetë, e për këtë organizoni mirë jo vetëm punën, por dhe kontrollin. Organizimi, shokë dhe shoqe, ka një rëndësi të madhe. Pas një direktive të drejtë duhet organizuar mirë zbatimin e saj, na mëson Stalini. Direktiva mund të jetë shumë e drejtë, por, në qoftë se nuk organizohet mirë puna për zbatimin e saj, ajo nuk vlen. Gjithashtu duhet pasur kujdes që organizimi të shkojë si duhet që nga qendra lart e deri në bazë.

Për çdo mungesë në këtë drejtim ju duhet të na kritikoni edhe ne të qendrës, se edhe ne mund të bëjmë gabime. Nganjëherë neve na mungon ai organizimi i përsosur i punës në nivelin që duhet apo ai koordinim i problemeve që kërkohet, gjë që mjaft herë ju pengon edhe juve të bazës. Kjo nuk është një autokritikë formale që bëj për punën time dhe të shokëve të Partisë e të Qeverisë, por është një autokritikë reale. Edhe të metat tona ne i shohim në sy dhe duhet t'ia themi Partisë. Ne ju kuptojmë shumë mirë ju të bazës; ju, djersini më shumë se ne; hasni ditë e natë vështirësi të shumta; ndesheni me kontradikta joantagoniste dhe

i kapërceni ato me punë të palodhur. Vigjilenca në terren nga të gjithë është e madhe, prandaj edhe detyrat duhet të zërthehen mirë nga secili.

Ne në qendër, përpigemi me sa është e mundur që të jemi korrektë me ju dhe t'ju ndihmojmë që t'i kapërceni vështirësitë që mund t'ju dalin përpara në zërthimin e zbatimin e direktivave. Ja, për shembull, ju i prodhoni zarzavatet, mirëpo sektori i transportit pretendon se nuk ka mundësi t'i transportojë. Po pse nuk ka mundësi ai, kur Qeveria ia ka planifikuar dhe i ka siguruar edhe bazën materiale? Përse nuk ka marrë masa ministri përkatës që ta evadojë qymyrin që është duke u prishur në pjacalen e Memaliajt? Po ministri i Tregtisë së Jashtme pse nuk merr masa që të realizojë sa më parë kontratat, të gjejë vaporët dhe të eksportojë sa më shpejt kromin? Për këto gjëra përpigemi dhe luftojmë të gjithë ne, dita-ditës.

Mos kujtoni se në dikasteret qendrore të gjitha punët shkojnë si në gjalpë. Po kështu edhe në bazë, fjala vjen, në miniera, ka të meta, prandaj autokritikë duhet të bëjmë jo vetëm ne të qendrës, por edhe ju të prodhimit. Dhe të tërë të bëjmë një autokritikë joformale, por reale, një autokritikë që të japë konkretisht rezultate të mira. Krahas autokritikës duhet zhvilluar edhe kritika, e cila duhet të jetë kurdoherë e drejtë, e shëndoshë, konstruktive, pra që të shërojë një gjendje të pakënaqshme. Edhe në bazë ka të meta e dobësi, ka neglizhencë, rutinë e indiferentizëm. Sigurisht, të gjitha këto nuk janë karakteristika të përgjithshme, por, megjithatë, ekzistojnë, prandaj duhet luftuar kundër tyre.

Duke pasur parasysh situatën që po kalojmë, të gjithëve na vihet për detyrë t'i marrim mirë punët në dorë. Gjithsecili të bëjë si duhet detyrën që i është ngarkuar; të mendojë jo vetëm për punët e tij, por edhe për atë që ka në krah apo nën vartësi për ta bërë edhe atë të aftë. Dhe, që ta bëjë të aftë, në radhë të parë duhet të mësojë e të përparojë vetë çdo ditë. A është e drejtë që unë të vij këtu te ju i papërgatitur dhe t'ju them gjepura? Në një rast të tillë unë e kuptoj se ju me të drejtë mund të më thoshit: «E po ç'na the në këtë mes, shoku Enver?». Prandaj, përpara se të vij këtu, jo vetëm që duhet të përgatitem mirë, por të kem parasysh që edhe ju vetë tani jeni shumë më të ngritur se dikur. Sot jemi larg nivelit që kishim gjatë kohës së luftës e të viteve të para të Pasçlirimit, kur vetëm disa nga ne kishin njëfarë kulture. Të tjerëve u mungonte ajo, por kishin vullnetin, gjallërinë e hovin për të ecur përpara. Megjithatë, edhe në ato kushte të vështira brenda dy vjetëve ne rindërtuam tërë Shqipërinë, rrugët dhe urat e shkatërruara, shtëpitë e djegurat shkrumb e hi në qytete e fshatra.

Tani mendoj të mos zgjatem më tej për këto probleme që të mos i ha racionin pjesës tjetër të fjalimit që kam përgatitur dhe që është regjistruar¹. Këtë pjesë unë e përgatita në bazë të eksperiencës së punës suaj që Byroja Politike edhe unë përpiqemi sa të jetë e mundur më shumë ta sintetizojmë dhe t'juaj sjellim përsëri

1. Autori ka parasysh fjalën e mbajtur në këtë takim, që u botua me titullin: «Kur e sotmja qëndron mbi themele të çelika, e ardhmja është e siguar».

poshtë për ta gjykuar dhe për ta zbatuar. Një kjo. E dyta, meqenëse çdo vit nuk vij dot këtu, gjatë kohës që do të dëgjoni fjalën e regjistruar nga unë, ju kërkoj leje që bashkë me shokët, sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit Ali Manaj dhe me kryetarin, Resul Zani, të vemi të vizitojmë një qendër punëtore këtu afër. Në qoftë se je dakord edhe ti, Nexhmije, dhe unë besoj se je dakord, të vemi të vizitojmë Ndërmarrjen e Veshjeve, për arsye se atje shumica e punëtorëve janë gra. Kështu mëj shoqja Rashide?

Meqenëse nuk keni kundërshtim, duke e mbyllur fjalën, ju uroj nga zemra suksese ju, shokëve e shoqeve të rrethit të Gjirokastrës, të rrethit të Përmetit e të rrethit të Tepelenës.

Gjithë shokët e udhëheqjes së Partisë dhe unë, gjithashtu, kemi besimin e plotë se këtë vit do të shënojmë përparime të reja në çdo lëmë, edhe në bujqësi, sepse dhe kushtet atmosferike kanë qenë më të favorshme. Partia na porositi se për situatat që po kalojmë, duhet të punojmë me nerva të tendosur. Gjithë këto pasuri kolosale që disponojmë, siç janë guximi, trimëria e mençuria e popullit, na sigurojnë se detyrat që kemi përpara do t'i realizojmë dhe planet do të tejkalohen.

Të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

**KUR E SOTMJA QËNDRON MBI THEMELE
TË ÇELIKTA, E ARDIMJA ËSHTË
E SIGURUAR**

*Fjala e mbajtur me kuadrot e rrethit
të Gjirokastrës*

18 mars 1978

Të dashur shokë e shoqe,

Ne, komunistët e kuadrot, duhet të mendojmë vazhdimisht, çdo orë, çdo ditë, çdo muaj dhe çdo vit për të ardhmen e lumtur të popullit tonë, për forcimin e vazhdueshëm të shoqërisë socialiste, për konsolidimin e fitoreve që kemi arritur e që do të arrijmë nën udhëheqjen e Partisë sonë marksiste-leniniste. Asnjëherë dhe asgjë të mos bëjmë pa e peshuar mirë dhe pa e parë në këtë prizëm. Perspektiva ndërtohet duke pasur si bazë të sotmen. Në qoftë se e sotmja ndërtohet drejt, në qoftë se ajo qëndron mbi themele të shëndosha, të çelikut, pra, në qoftë se muret e bedenat e kësaj kalaje ngrihen mirë e janë të forta, atëherë e ardhmja është e sigurt. Ndryshe ka mundësi të dëmtohet ajo që është krijuar. Asnjëherë nuk duhet të lejojmë të na

dëmtohen ato që kemi fituar. Prandaj çdo mendim, çdo veprim duhet të jetë i peshuar, i zbërthyer dhe i zbatuar mirë. Mendimi dhe veprimi, të gërshetuar drejt me njëri-tjetrin, duhet të sjellin frytet e parashikuara, frytet materiale, politike, ideologjike dhe morale. Ndryshe, popullit tonë, i cili ka luftuar dhe lufton për të sotmen e lumtur e për të ardhmen akoma më të sigurt e më të begatshme, nuk mund t'i sigurohet vazhdimësia e ndërtimit dhe e forcimit të socializmit.

Nga historia dhe nga ngjarjet në botë, ne duhet kurdoherë të nxjerrim konkluzione të drejta, të nxjerrim psenë e atyre që i kanë shkaktuar ato ngjarje, ato evenimente që përbëjnë historinë e një populli ose historinë e popujve. T'i shohim këto ngjarje në prizmin e materializmit dialektik dhe historik dhe vetëm në këtë prizëm. Në këtë mënyrë u shërbejmë interesave të klasës punëtore, diktaturës së saj, ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Ngjarjet në botë dhe brenda vendit, qofshin këto politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake, të thjeshta ose të koklavitura, nuk duhen vështruar thjesht si një kronikë ose si një film që na kalon përpara syve. Ne duhet të thellohemi në to dhe të shikojmë arsyet e konsekuencat, të dimë ç'influencë, për mirë apo për keq mund të kenë këto në botë dhe brenda vendit tonë, në mënyrë që të përfitojmë nga evenimentet, të nxjerrim deduksionet e nevojshme dhe t'i armatosim Partinë e popullin me armët më të mprehta, për të luftuar kundër të metave e vështirësive që na dalin përpara dhe për të konsoliduar fitoret e arritura.

Popujt, kudo në botë, po ecin drejt revolucionit

Ne konstatojmë se bota është në lëvizje. Popujt, kudo në botë, po ecin drejt revolucionit, drejt çlirimit ekonomik, politik e ushtarak nga zgjedha e neokolonialistëve, e imperialistëve të çdo ngjyre, qofshin këta imperialistë kapitalistë ose imperialistë revizionistë, qofshin këta në Perëndim apo në Lindje, në Evropën Qendrore, në Azinë Qendrore apo në Azinë e Largme.

Revolucioni ecën kurdoherë përpara dhe popujt, proletariati, luftojnë kundër kapitalizmit dhe kundër të gjitha rrymave politiko-ideologjike që përpiqen të skllavërojnë mendjet e masave të gjera punonjëse. Këto rryma politiko-ideologjike janë organizuar në parti të ndryshme të borgjezisë dhe të revizionizmit dhe së bashku, në forma të ndryshme, me slogane të ndryshme, me plane të ndryshme, luftojnë për të penguar revolucionin. Sigurisht është e pamundur që ta ndalojnë revolucionin, por ato i shkaktojnë atij dëme, vështirësi, disa herë e mbytin në gjak, herë-herë, në disa vende, e detyrojnë të futet në qorrsoqaje e disa herë e detyrojnë të bëjë zigzage.

Të gjitha këto veprime të kapitalit botëror, në luftë me proletariatin dhe me popujt që aspirojnë për liri, për demokraci, për sovranitet, për socializëm, shkaktojnë turbullira dhe transformime në vende të ndryshme.

Arsyet e këtyre ndryshimeve janë rezultat i luftës klasore, i kundërshtimit të rreptë midis shtypësve dhe të shtypurve, i kontradiktave të pashmangshme e të

pashuara midis kapitalit dhe proletariatit. Këto kontradikta rriten e acarohen vazhdimisht dhe vjen koha që zhvillimi i tyre kthehet nga sasiore në cilësore. Shpërthimi cilësor, në fund të fundit, është revolucioni. Kapitalistët, revizionistët e bishtrat e tyre, për t'u shpëtuar revolucionit dhe socializmit, për të mos e lëjuar klasën punëtore që të bëhet hegjemone, të marrë fuqinë dhe ta shtypë e ta shkatërrojë xhunglën kapitaliste, u përshtaten situatave, u përshtaten momenteve. Përpara këtij tufani, përpara kësaj furtune që ngrihet në shtrofkën e tyre, janë të detyruar të krijojnë e të adoptojnë forma qeverisjeje të maskuara, deri edhe me formula e me slogane të majta, por që në realitet janë të djathta. Nga ana e tyre gjithçka bëhet që të mbahet gjallë pushteti i borgjezisë kapitaliste, pushteti i kapitalit, të ruhen fitimet që ajo ka krijuar me djersën dhe me gjakun e popujve.

Prandaj, të gjitha këto ndryshime, që ne i vërejmë çdo ditë e në të gjitha kontinentet, duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh dhe t'i studiojmë thellë arsyet, metodat dhe mënyrat prapa të cilave fshihen qëllimet e borgjezisë kapitaliste për të zgjatur jetën dhe sundimin e saj.

Le të shohim faktet që ndodhin si në vendet revizioniste, ashtu edhe në ato kapitaliste.

Shumë vende revizioniste, para se të bëheshin të tilla, kanë qenë vende socialiste. Duke filluar që nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore të Evropës, ndryshuan regjimet: reaksioni revizionist, trockist, anarkist, puçist, oportunist i djathtë rrëzoi pushtetin socialist dhe shkatërroi diktaturën e proleta-

riatit. Borgjezia e re, e krijuar gradualisht në këto vende dhe në forma të ndryshme, mori pushtetin në dorë dhe bëri transformimin e vendit nga një vend socialist në një vend revizionisto-kapitalist dhe pastaj nga një vend revizionisto-kapitalist, si Bashkimi Sovjetik, në një vend socialimperialist. Një vend i tillë po fillon të bëhet edhe Kina.

Ky transformim që ngjau në këto vende ish-socialiste, ndonëse e dëmtoi jashtëzakonisht rëndë revolucionin, nuk mundi e nuk do të mundë kurrë ta mposhtë atë. Ideologjia revizioniste, që u shërben klikave udhëheqëse të këtyre vendeve, po përpiqet me një mijë mënyra dhe me një mijë forma të hedhë baltë e të errësojë shkencën marksiste-leniniste, por ajo po pëson disfatë, ashtu siç kanë pësuar disfata edhe teoritë e socialdemokracisë gjatë gjithë kohës, sepse ato janë në kundërshtim me teorinë e Marksit, Engelsit e të Leninit. Transformimi që është bërë në këto vende ish-socialiste nuk është i përjetshëm, por do të duhet kohë që revolucioni të triumfojë atje përsëri, të mposhtë revizionizmin, socialimperializmin dhe të rivendosë diktaturën e proletariatit. Një gjë e tillë bëhet vetëm me luftë, me një luftë të gjatë e të përgjakshme, ku dy forca, që janë në kundërshtim të papajtueshëm e në armiqësi për vdekje me njëra-tjetrën, do të ballafaqohen midis tyre.

Në këto vende, nga njëra anë, qëndron borgjezia e re revizioniste, e cila ka në dorë aparatet shtypëse dhe aparatet politike që i ka kthyer në armë të diktaturës fashiste, kurse, nga ana tjetër, qëndron proletariati, klasa punëtore që shfrytëzohet e shtypet. Kjo gjendje acarë kontradiktat e krijuara, përgatit revolucionin, i cili

do të ngjitet, qoftë edhe javash-javash e nëpërmjet shumë pengesash, por do të zhvillohet dhe ky zhvillim, siç theksova edhe më lart, do të kthehet nga sasiore në cilësore. Kështu, pra, do të vijë koha që revolta, pakënaqësia e popullit, të arrijë deri në atë shkallë sa udhëheqja e re revizioniste, borgjezia e re, të mos mundë të drejtojë me format e reja shtypëse që ka krijuar, të mos ketë asnjë mundësi të ndalë valën përvëluese të revolucionit.

Në këto vende revizioniste, ku është bërë transformimi i përkohshëm nga socializmi në kapitalizëm, aktualisht, nuk po duket në sipërfaqe një lëvizje revolucionare. Por unë mendoj se ekziston në ilegalitet të rëndë e në formim, sepse është e pamundur që elementi revolucionar, elementi komunist i vendosur, që luftoi dhe fitoi në kohën e revolucionit me ideologjinë e marksizëm-leninizmit, me flamurin e partisë marksiste-leniniste, të mos ketë lënë gjurmë të klasa punëtore dhe të masat e popullit të këtyre vendeve. Unë mendoj se gjurmët ekzistojnë dhe janë të thella e gradualisht do të bëhet konvergjenca, kohezioni i tyre në një fuqi të madhe që do të ngrihet në luftë kundër asaj klase që përmbysi diktaturën e proletariatit në këto vende. Aktualisht, ky kohezion dhe ky koncentrim akoma nuk duket, për arsye të shtypjes barbare që bëhet nga diktatura fashiste e klasës së re borgjezo-revizioniste.

Por neve na duhet t'i hyjmë akoma më thellë kësaj çështjeje për të zbuluar të gjitha arsyet, shkaqet e fenomenet e huaja që kishin penetruar në këto vende dhe që e kalbëzuan, si të thuash, regjimin socialist. Pra, të zbulojmë psetë, arsyet që e lejuan penetrimin e feno-

meneve të huaja për socializmin dhe penguan marrjen e masave për një forcim politiko-ideologjik e organizativ të punës së partisë, të ndërtimit të socializmit dhe të zhvillimit e të përparimit të kulturës socialiste, në mënyrë që ta pengonin këtë veprimtari minuese të elementit kapitalist të dobët, i cili gjeti të çara, gjeti terren disi të favorshëm dhe u zhvillua i maskuar me forma të ndryshme, duke brohoritur për socializmin, duke brohoritur për partinë komuniste, por që në realitet përgatiste terrenin për përmbysjen e regjimit socialist dhe për likuidimin e partisë komuniste marksiste-leniniste.

Pikërisht partitë marksiste-leniniste të vendeve ku revizionistët morën fuqinë dhe realizuan transformimin e përkohshëm kapitalist kishin shumë dobësi, të cilat nuk vlerësoheshin sa duhej. Nga këto parti nuk studioheshin dhe nuk analizoheshin në thellësinë e në gjerësinë e tyre problemet, dhe për pasojë nuk dillej me konkluzione të drejta për të shëruar një situatë të vështirë e të rrezikshme që krijohesh për to.

Fjalë dhe slogane thuheshin plot nga këto parti, ekzistonin norma marksiste-leniniste, ekzistonin komunistë revolucionarë të vendosur, ekzistonte një klasë punëtores e shëndoshë dhe një udhëheqje e dalë nga masat punonjëse në këto vende. Flitej, gjithashtu, për një demokraci proletare nga më të mirat, flitej kundër burokratizmit e veprimeve arbitrare në dëm të socializmit, flitej për një politikë të gjerë, bindëse, sqaruese, mobilizuese, flitej kundër rutinës e shumë e shumë të këqijave që janë mbeturina të jetës së vjetër kapitaliste, mbeturina mikroborgjeze në mendjet dhe në zem-

rat e njerëzve dhe që shfaqeshin në jetën e përditshme të ndërtimit të socializmit. Natyrisht, këto parti nuk rrinin duarlidhur, por të gjitha këtyre sëmundjeve, ilaçet nuk u bënë efekt, sepse këtyre fenomeneve negative, këtyre sëmundjeve, nuk u bëhej një studim i thellë dhe i gjerë ashtu si duhet. Si rrjedhim nuk përcaktohej diagnoza e vërtetë, se ata që e bënë këtë ishin të infektuar vetë nga këto sëmundje dhe, kur u lihet të infektuarve të përcaktojnë diagnozën e sëmundjes, atëherë sëmundja bëhet më e rëndë dhe shërimi më i vështirë. Kështu ngjau me partitë ish-marksiste-leniniste, me vendet ish-socialiste, ku revizionistët arritën të marrin fuqinë në dorë.

Prandaj, nga gjithë kjo eksperiencë ne duhet të përfitojmë dhe punët tona t'i shqyrtojmë imtësisht, duke i pasur parasysh këto shkaqe, këto arsye që sollën katastrofën në vendet ish-socialiste që përmenda më lart. Duhet të kuptojmë se këto ndryshime nga e djathta, këto fenomene negative, që dëmtuan revolucionin dhe shkatërruan socializmin në këto vende, nuk u shfaqën përnjëherë, në një kohë, por ato evoluan gradualisht derisa morën një formë të atillë që, duke marrë shkak nga një eveniment i madh historik, siç ishte, për shembull, vdekja e Stalinit, e cila qe një humbje e madhe për revolucionin, zhvillimi në rrugën e socializmit u ndërpre dhe u krijua një gjendje regresive, reaksionare. Revizionistët hrushovianë, udhëheqës të kësaj murtaje, që deri në këtë kohë kishin qëndruar të maskuar, filluan të dalin mbi ujë me slogane që gjoja i përshtateshin situatës që u krijua pas vdekjes së Stalinit. Natyrisht, kjo situatë ishte e trishtueshme jo vetëm për

popujt sovjetikë, që humbën udhëheqësin e tyre të madh marksist-leninist, por edhe për gjithë botën përparimtare, revolucionare që humbi një udhëheqës të madh marksist-leninist, nxënësin besnik të Karl Marksit dhe të Vladimir Iliç Leninit.

Revizionistët sovjetikë, menjëherë pas vdekjes së Stalinit, morën masa të gjithanshme për të realizuar qëllimet e tyre antimarksiste. Për këtë ata gjetën mbështetje tek ato shtresa të infektuara të shoqërisë që nuk pranonin diktaturën e proletariatit, ligjet, disiplinën e ideologjinë e saj dhe që aspironin për një liberalizëm të madh në çdo fushë të veprimtarisë shoqërore. Përfaqësuesit e të gjitha këtyre shtresave, që ishin krijuar në errësirë, ishin hrushovianët, të cilët, pas vdekjes së Stalinit, filluan të dilnin në skenë duke pretenduar se ruanin tiparet e komunistit, se kishin edhe një të kaluar gjoja bolshevike. Ata paraqiteshin tash si bolshevikë «të rinj», të aftë për të përshtatur ideologjinë «marksiste-leniniste» në situatat moderne. Pikërisht këta njerëz iu vunë punës për ta përgatitur popullin dhe proletariatin sovjetik për ta pranuar këtë kthesë regresive që ndodhi në këtë vend.

Po ç'ndodhi me proletariatin sovjetik e Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit, që kreu Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, që mundi hitlerianët, që çliroi popujt nga robëria fashiste dhe ishte bërë shpresa e revolucionit botëror? Atdheu i parë i proletarëve të botës dhe Partia Komuniste Bolshevike nuk ishin të përgatitur dhe nuk u treguan vigjilentë sa duhet për të kuptuar hilenë revizionisto-kapitaliste që po luhej në kurriz të

tyre dhe për të marrë të gjitha masat për t'iu bërë barrikadë kësaj murtaje.

Nuk ka rëndësi si u mor pushteti nga revizionistët hrushovianë, që e përmbysën diktaturën e proletaria-tit me puç në Kremlin. Rëndësi të madhe kanë pikë-pamjet e atyre kundër të cilëve u bë ky puç, domethënë njerëzve të grupit të Molotovit, të cilët nuk ishin në gjendje të rezistonin, bile kontribuan, pas vdekjes së Stalinit, që këta revizionistë, me Hrushovin në krye, të arrinin në një akt të tillë.

Stalini kurdoherë ka propaganduar e ka zbatuar ligjet e revolucionit proletar, të diktaturës së proletaria-tit dhe normat leniniste të partisë, por njerëzit e tjerë që ishin rreth tij, që nga më kryesorët e deri tek ai më me pak përgjegjësi, sa ishte gjallë ai, të gjithë fshiheshin, maskoheshin prapa tij. Pikërisht këta njerëz kishin krijuar kultin e Stalinit për të mbuluar veprimet e tyre të mbrapshta, kishin shkëlur ligjet e revolucionit proletar dhe normat e Partisë Bolshevike, pra ishin këta që e akuzuan Stalinin për kult të individit.

Stalini ishte njeri i thjeshtë, kurse këta nuk ishin të tillë, sepse ishin borgjezë, revizionistë. Për këta komplotistë revolucionin nuk e bënë masat e popullit, por disa njerëz, prandaj i vinin rëndësi të madhe vetes së tyre. Këta veten e tyre e ruanin, veprën e tyre e mbronin dhe e maskonin duke ngritur kultin e Stalinit, i cili e luftonte këtë kult, por këtë duhej ta luftonte gjithë partia. Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk e kuptoi si duhet mësimin bolshevik të Stalinit se mbi të gjitha ishte partia, një parti që të zbatonte normat e

vërteta revolucionare marksiste-leniniste, që të vinte në jetë mësimet e Leninit të madh.

Revizionistët hrushovianë e akuzuan Stalinin për sektarizëm dhe Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit si një parti sektare, si një parti që nuk u përshtatej situatave. Cilat ishin këto situata që përballoi Stalini dhe përpara tij Lenini? Këto situata ishin të rënda për revolucionin proletar që fitoi për herë të parë në Bashkimin Sovjetik, për socializmin që u ndërtua në Bashkimin Sovjetik, për botën që u kërcënua dhe u hodh në zjarr nga kapitalizmi botëror, nga nazizmi gjerman. Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe Stalinin në mënyrë të veçantë u është dashur të përballonin këtë situatë kaq të vështirë, si në planin kombëtar, ashtu dhe në planin ndërkombëtar.

Presioni i imperializmit, i kapitalizmit botëror, ishte shumë i madh mbi Bashkimin Sovjetik, ku kishte triumfuar revolucioni dhe ishte bërë burim frymëzimi për proletariatin botëror. Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike u duhej t'u bënin ballë jo vetëm intervenicionit, jo vetëm rrethimit dhe presionit ideologjik, politik, bile edhe ushtarak, por u duhej t'i rezistonin edhe sulmit që erdhi nga kapitalizmi dhe fashizmi botëror. Të gjitha këto situata të vështira e kritike i përballuan me sukses.

Po si mundi t'i përballonte kjo parti situata të tilla? Duke qenë oportuniste e djathtë, duke bërë lëshime brenda dhe jashtë? Jo! Në asnjë mënyrë! Një gjë e tillë do të kishte qenë një katastrofë si për vetë Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe për gjithë njerëzimin. Por këtë katastrofë e evituan Stalini me guxim e urtësi

dhe Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit me qëndrimet e saj të drejta. Por nga brenda, javash-javash, elementët kapitalistë vepronin të maskuar, nën flamurin e marksizëm-leninizmit, për minimin e ndërtimit të socializmit dhe për restaurimin e kapitalizmit.

Natyrisht, diktatura e proletariatit në Bashkimin Sovjetik duhej të godiste me forcë armiqtë e brendshëm, trockistët, buharinistët, zinovievistët, tukaçevskët e të tjerë, të cilët, të gjithë së toku, ishin në shërbim të kapitalit botëror e të gjithë së toku donin që Bashkimi Sovjetik të ndërronte ngjyrë, të kthehej në një demokraci borgjezo-kapitaliste. Kundër gjithë këtij llumi duhej bërë medoemos një luftë revolucionare.

Mirëpo pikërisht këtë luftë revolucionare nuk donin dhe me të s'mund të pajtoheshin as kapitalizmi botëror, as revizionistët e maskuar, trockistët, buharinistët e të tjerë. Maskat e tyre ne i gjejmë sot në fytyrat e revizionistëve hrushovianë. Prandaj, pas vdekjes së Stalinit, këta u ngritën në një kor të përbashkët me armiqtë e jashtëm dhe e quajtën epokën e madhe të Stalinit si një epokë të terrorit, që, me vdekjen e tij, mori fund. Hrushovianët u përpoqën dhe i gënjyen popujt sovjetikë dhe proletariatin sovjetik se tash e tutje, pas lufte, në Bashkimin Sovjetik duhej të ekzistonte një liri «e plotë», «e vërtetë». Këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, këta revizionistë e renegatë, shfrytëzuan pikërisht atë forcë kolosale ekonomike e politike që kishte krijuar Partia Komuniste, e drejtuar nga bolshevikët e vërtetë, me Leninin dhe me Stalinin në krye, duke ndjekur një vijë të drejtë, kurdoherë të bazuar në doktrinën e Marksit. Pa këtë vijë nuk mund

të ishte krijuar ajo forcë e madhe ekonomike dhe ushtarake që mundi hitlerianët.

Është fakt, gjithashtu, se në Poloni, megjithëse u vendos diktatura e proletariatit, megjithëse ishte në kufi me Bashkimin Sovjetik, me një aleat që e ndihmonte, prapëseprapë atje socializmi nuk eci me ritmet e kërkuara. Kur Partia e Bashkuar Punëtore e Polonisë me Boleslav Bierutin në krye qëndronte në pozita të mira, edhe socializmi shkonte duke u forcuar. Në Poloni Partia Komuniste u bashkua me partitë e tjera borgjeze. Ka mundësi që ky bashkim të ishte i nevojshëm, por puna bolshevike e Partisë Komuniste të Polonisë duhej të ishte e atillë që jo vetëm ta asimilonte atë pjesë të atyre partive që u inkuadruan në të, por ta edukonte thellësisht me normat marksiste-leniniste. Se deri në ç'masë e bëri këtë punë ajo, ne nuk mund ta gjykojmë, por një mendim mund të japim, që nuk e bëri si duhet. Në Poloni u zhvillua industria, u rrit proletariati, u propaganduan idetë përparimtare në masat, por elementët borgjezë, kapitalistë, në një mënyrë ose në një tjetër, përsëri gjendeshin në fuqi. Atje nuk u bë reforma agrare dhe nuk u realizua kolektivizimi. Përveç kësaj, në Poloni ekzistonte dhe ajo armiqësi tradicionale e borgjezisë polake kundër Rosisë cariste. Kjo armiqësi e kësaj borgjezie, e cila nuk kishte ngrënë grushtin e fortë të proletariatit polak dhe të partisë së tij, e kishte shtuar urrejtjen akoma më shumë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Lenin-Stalinit. Dhe, pas vdekjes së Bierutit, ne shohim që në Poloni të ngjajnë turbullira, të vijnë në fuqi Gomulkët, Ciran-kieviçët e të tjerë elementë të borgjezisë, elementë anti-

marksistë, kapitalistë, të cilët, tok me hrushovianët, të realizojnë ndryshimin, transformimin e regjimit socialist në një regjim kapitalist, borgjez, fashist.

E njëjta gjë ndodhi edhe në Hungari. Edhe atje u bë bashkimi i Partisë Komuniste të Hungarisë me partinë socialdemokrate dhe u kujtua se ky bashkim mori fund e çdo gjë u arrit me sukses. Pra, u mendua se anëtarët e partisë socialdemokrate, që ishte një parti borgjeze, u bënë komunistë. Në fakt, këta njerëz qëndruan në pikëpamjet e tyre të vjetra dhe diktatura e proletariatit në këtë vend nuk u zhvillua në bazë të ideologjisë leniniste, nuk mori format e përshtatshme të një zhvillimi normal, në përputhje me kushtet konkrete të Hungarisë dhe në rrugën që mësojnë Marksi dhe Lenini. Kështu, me ardhjen në fuqi të hrushovianëve, Rakoshi dhe shokët e tij, që ishin elementë pozitivë në Partinë e Punonjësve të Hungarisë, u diskredituan dhe u sabotuan deri në atë shkallë sa që në Hungari, siç e dimë, shpërtheu kundërrevolucioni dhe u desh të ndërhynin tanket sovjetike për të risjellë në fuqi kundërrevolucionarët me etiketë marksiste-leniniste, por që nuk ishin veçse revizionistë, shokë armësh të revizionistëve hrushovianë.

Kurse në Jugosllavi puna vajti më për lumë. Titizmi, që Partia jonë e ka luftuar e do të vazhdojë ta luftojë me ashpërsi, është një nga agjenturat më të rrezikshme të kapitalit botëror, e veçanërisht të imperializmit amerikan. Titizmi e ka likuiduar plotësisht ish-Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe ka krijuar një strukturë kapitaliste. Kjo strukturë kapitaliste e anarkosindikaliste, që quhet vetadministrim dhe që s'ka as-

gjë të përbashkët me marksizmin e socializmin, i vjen drejtpërdrejt në ndihmë kapitalit në kalbëzim, jo vetëm për ruajtjen e kapitalizmit brenda në Jugosllavi, por edhe si «model» që i duhet kapitalit botëror për sabotimin e revolucionit. Kjo strukturë kapitaliste dhe mbistrukturë antimarksiste në arenën ndërkombëtare mbulohet me pseudoteorinë e «botës së paangazhuar». Karteri, aty nja një javë më parë, priti Titon në Shtëpinë e Bardhë dhe e cilësoi atë si një burrë të madh shteti e numëroi edhe arsyet: kritikoi Stalinin, krijoi sistemin e vetadministrimit dhe se udhëheq «botën e të paangazhuarve».

Këto tri orientime bazë shërbëtori Tito vazhdon t'i zbatojë për padronin e madh, imperializmin amerikan.

Kina e Hua Kuo Fenit, që ka hyrë në aleancë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror, e priti me pompë në Pekin renegatin Tito; ata u puthën si vëllezër e shokë me njëri-tjetrin, lidhën marrëdhënie partie dhe bënë motërma dy frontet antimarksiste: «botën e tretë» dhe «botën e të paangazhuarve». Në këtë rrugë këta «dy kalanderë në një derë» kanë bekimin e Uashingtonit.

Për sa i përket Kinës, historia e saj, evolucioni i ndërtimit të «socializmit» në këtë vend kanë karakteristikat e tyre. Por, pas vdekjes së Maos, ne shohim përsëri që atje të ngjajnë turbullira. Pse ngjajnë këto turbullira? Kush i shkakton këto? Këto turbullira i shkaktojnë të djathtët. Po pse? Këto po i shpjegojmë, po i studiojmë dhe po thellohemi në to, për arsye se atje as diktatura e proletariatit nuk ishte një diktaturë

e vërtetë në duart e klasës punëtore dhe as partia komuniste nuk cete në rrugën e një partie marksiste-leniniste.

Këto janë në përgjithësi arsyet që bënë të mundur regresin në vendet dhe në partitë që përmenda më lart. Neve na bie detyrë kurdoherë t'i studiojmë dhe të thellohemi në këto probleme, në këto fakte e ngjarje të hidhura të historisë së lëvizjes komuniste e punëtore dhe të nxjerrim sa më drejt, sa më realisht arsyet, shkaqet dhe pasojat e tyre, të arrijmë në konkluzione të sakta, bindëse dhe t'i bëjmë ato armë për të mos lejuar kurrë që një fatkeqësi e tillë t'i ndodhë vendit tonë.

Le të marrim tash anën tjetër, domethënë vendet kapitaliste. A është sot imperializmi në fazën e tij të mëparshme? Jo, nuk është. Imperializmi po bën evolucion, sepse është i detyruar ta bëjë këtë si kapitalizëm në kalbëzim. Këtë e ka parashikuar Lenini. Imperializmi është faza e fundit e kapitalizmit dhe epoka që kalojmë është epoka e revolucioneve proletare. Kjo është e qartë. Dhe, kur themi që kjo epokë është epoka e revolucioneve proletare, me këtë duhet të kuptojmë se presionet e masave të gjera të popujve, presionet e forta të proletariatit në të gjitha vendet kapitaliste, janë të atilla që kapitalizmi i vjetër është detyruar të gjejë, dhe ka gjetur, një formë tjetër qeverisjeje, shtypjeje e shfrytëzimi.

Përpara Luftës së Dytë Botërore ekzistonte kolonializmi. Pas Luftës së Dytë Botërore ky kolonializëm mori formë tjetër, gjoja më demokratike, por po aq shtypëse e po aq shfrytëzuese dhe u quajt e quhet

neokolonializëm. Tash ky neokolonializëm shfrytëzon popujt e botës, duke u dhënë këtyre gjoja njëfarë lirie, njëfarë independence, njëfarë sovraniteti, por në të vërtetë të gjitha këto janë fiktive, janë false, për arsye se mbi këto shtete, mbi këta popuj sundon një zgjedhë e dyfishtë: zgjedha e kapitalit të brendshëm dhe zgjedha e kapitalit të huaj. Të dy këto kapitale janë të ndërvarura, në aleancë njëri me tjetrin, për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt dhe për të penguar masat e gjera dhe proletariatin që të hidhen në revolucion.

Sot ne shohim që edhe në këtë pjesë të botës të ngjasin transformime që, nga njëra anë, shprehin kalbëzimin e sistemit imperialisto-kapitalist dhe, nga ana tjetër, tregojnë gjallërinë e masave të gjera të popujve dhe të proletariatit. Në këto vende kapitali, siç e theksova më lart, ka krijuar forma të reja të qeverisjes. Këto forma i maskon me një politikë gjoja të re ekonomike, me një ideologji të re revizioniste moderne, me një jetë të re ala amerikane, «më të lirë», kuptohet, më të shthurur, me gjoja një demokraci të madhe, por në realitet me një «demokraci» nën grushtin e policisë, të sigurimit, të CIA-s e të ushtrisë së armatosur deri në dhëmbë, që janë në duart e borgjezisë kapitaliste dhe të imperializmit amerikan, francez, anglez etj., etj.

Dihet se në Perëndim shtetet e ndryshme kapitaliste nuk kanë harmoni as brenda, as jashtë midis njëri-tjetrit. Brenda ka kontradikta të thella dhe këto i shkakton lufta revolucionare e proletariatit dhe e popujve, e cila është akoma difuze. Por kjo luftë nga sasia do të kthehet në cilësi dhe, në momentin më të përshtatshëm, kur të piqen të gjitha kushtet, do të

shpërthejë revolucionit, ashtu siç e ka parashikuar Lenini. Fakt është se për t'i rezistuar kthimit nga sasia në cilësi, grupet kapitaliste të ndryshme të një vendi, të pleksura me kapitalizmin e huaj, krijojnë brenda në vend kontradikta të tjera. Këto kontradikta u shtohen kontradiktave të mëdha që ekzistojnë midis masave punonjëse që shfrytëzohen dhe klasave sunduese që shfrytëzojnë. Stabilitetin në këto vende kapitaliste e prish kalbëzimi në rritje. Ky është një proces që po zhvillohet dhe që do të shkojë duke u zhvilluar më tej. Për ta ndaluar këtë proces kalbëzimi, revizionistët modernë, partitë e socialdemokracisë, partitë e kapitalit, me të gjitha format e tyre, dhe shteti kapitalist borgjez, të gjithë, së toku dhe në ujdi, përpiqen të gjejnë forma e mënyra të atilla të menduari, të jetuari e të vepruari për ta degjeneruar masën dhe proletariatin, për të dobësuar e për të ulur hovin e tyre revolucionar.

Një rol të veçantë në vendet kapitaliste në ndihmë të kapitalit luajnë revizionistët modernë. Kështu, për shembull, në Francë partia revizioniste franceze flaku tej të gjitha parimet bazë të marksizëm-leninizmit dhe të arritjes së revolucionit proletar. Kjo parti e Marshe-së, që s'e lidh asgjë me marksizmin, predikon revolucionin, por jo revolucionin me dhunë, por me reforma, në rrugë parlamentare e pluraliste, domethënë plotësisht në kundërshtim me mësimin e Leninit për revolucionin. Partia revizioniste franceze i vë kryq diktaturës së proletariatit, ajo predikon unitetin e të gjitha partive borgjeze, kapitaliste, trockiste për ta marrë fuqinë dhe për të bërë gjoja transformimin e shtetit borgjezo-kapitalist në një shtet socialist. Këto që

predikon kjo parti «komuniste» kanë për qëllim ta çoroditin proletariatin, ta mbajnë këtë të lidhur pas vetes dhe ta lejojnë që të ngrejë zërin vetëm për disa rivendikime ekonomike dhe jo politike, ta drejtojnë në një luftë reformiste e jo revolucionare.

Në Itali, po ashtu, partia revizioniste italiane po përpiqet të bëhet një shërbëto e denjë e kapitalit italian dhe një aleate e imperializmit amerikan. Kjo parti është pro pranisë së bazave amerikane në Itali, pro bazave të NATO-s, ashtu siç është pro pranisë së NATO-s edhe Partia Komuniste e Spanjës. Në raste të tjera kam folur për këto parti veçanërisht, por këtu dua të ndalem në çështjen e evolucionit të diktaturës frankiste në Spanjë.

Diktatura frankiste në Spanjë pësoi një evolucion. Pas vdekjes së Frankos vdiq, si të thuash, edhe diktatura e tij. Ajo pësoi një transformim, ose më mirë të themi një zbutje. Në fillim kjo diktaturë ishte gjakatare, ajo vriste e priste dhe shtypte egërsisht, pa mëshirë popullin dhe çdo gjë që ishte për çlirimin dhe përparimin. Mirëpo, pavarësisht se Frankoja me diktaturën e tij fashiste shtypte çfarëdo përpjekje demokratike të proletariatit dhe të masave, gjithë zhvillimi i kapitalizmit botëror, për të ruajtur veten nga shkatërrimi dhe nga vdekja, influenconte, gjithashtu, edhe në shtetin spanjoll. Kështu, me kalimin e kohës, diktaturës fashiste të Frankos i është dashur të mos ketë më atë virulencë që ka pasur dikur dhe sa kohë kalonte aq më e zbutur tregohej kjo diktaturë nën presionin e proletariatit dhe të masave punonjëse që lëviznin. Falanga e vjetër, që ishte më e zjarhtë, u

plak dhe erdhi brezi i ri i falangistëve, të cilët donin njëfarë lirie «demokratike» si ajo e Francës, si ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si ajo e Italisë. Ne shohim që edhe në mbrëmjen e jetës së Frankos të bëhen greva edhe demonstrata dhe, megjithëse shtypeshin me zjarr e hekur këto greva e demonstrata, përsëri bëheshin dhe kjo tregon vitalitetin e proletariatit spanjoll.

Pra, influenza e borgjezisë kapitaliste, me format dhe me ideologjinë e saj liberale, për t'u mbrojtur nga revolucioni, e detyronte edhe diktaturën fashiste të kalonte nëpër një evolucion. Kështu, kur vdiq Frankoja, mendohej se në Spanjë mund të ndodhte një luftë civile, por kjo nuk ndodhi për fat të keq. Fronin e Frankos e zuri një mbret i ri, i cili, që në ditët e para të karrierës së tij, deklaroi zgjedhjet e përgjithshme. Me këtë donte t'i tregonte popullit se gjoja ndryshoi diktatura fashiste e Frankos. Por, në realitet, kjo ishte një formë për ta gënjyer popullin spanjoll. Mbreti Huan Karlos, që erdhi në fuqi, ishte një nga frankistët e vjetër, i cili në postin e kryeministrit solli Suarezin. Ç'ishte Suarezin? Suarezin ishte një anëtar i falangës, por nuk ishte veçse 38 vjeç, kurse mbreti ishte 35 vjeç, pra në duart e këtyre dy djemve të rinj u la populli spanjoll që kishte evoluar dhe donte të çlirohej nga diktatura e egër fashiste.

E gjithë kjo situatë solli edhe transformimin reaksionar të partisë së Ibarrurit. Partia e Ibarrurit ishte ajo që bëri luftën kundër Frankos, kurse tashti është kthyer në një shërbëtoreshë të borgjezisë, duke tradhtuar interesat e popullit dhe të proletariatit spanjoll. Karril-

joja, sekretari i përgjithshëm i kësaj partie revizioniste, e legalizoi partinë, pranoi reformat e Suarezit, pranoi mbretërinë, pranoi edhe flamurin e mbretërisë spanjolle dhe deklaroi: «Nuk duam të ndërtojmë socializmin me format e vjetra, ne s'jemi më për revolucionin me dhunë (siç predikonin Marksi e Lenini), ne quhemi eurokomunistë dhe dëshirojmë të shkojmë në socializëm në pluralizëm, së bashku me të gjitha partitë e tjera. Doktrina marksiste-leniniste për revolucionin është vjetruar».

Pra shohim që edhe në botën e kapitalizmit dhe të imperializmit herë-herë të bëhen transformime me maska të majta, por që janë kurdoherë të djathta, për arsye që të pengohet revolucioni, të gënjehen masat e popullit, të gënjehet proletariati. Dhe në këtë mes kanë hyrë dhe i shërbejnë me zell kësaj çështjeje edhe pseudomarksistët, revizionistët që militojnë në radhët e ish-partive komuniste të Evropës Perëndimore dhe të botës tjetër kapitaliste, me përjashtim të partive të reja komuniste marksiste-leniniste.

Në këtë rrugë të mbrojtjes së kapitalizmit e të imperializmit, dhe veçanërisht të imperializmit amerikan, konkurren edhe teoria e «tri botëve», partizanët e së cilës mohojnë revolucionin dhe pengojnë luftën e popujve për liri e për pavarësi.

Nga të gjitha këto evenimente e nga shumë të tjera si këto, që nuk janë kaq të thjeshta, ne duhet të nxjerrim shumë mësimë për të tashmen dhe për të ardhmen e socializmit në vendin tonë.

Problemet e etapës duhen zgjidhur me kujdes e pjekuri, pa harruar asnjëherë perspektivën

Shokë,

Si është situata te ne? Situata në vendin tonë është shumë e fortë. Partia te ne është në binarët e shëndoshë të marksizëm-leninizmit. Socializmi në Shqipëri ndërtohet me sukses, fryma patriotike socialiste revolucionare është në ngjitje. Të gjitha këto fitore ne duhet t'i konsolidojmë dhe vazhdimisht të punojmë që të ecim përpara, kurdoherë të udhëhequr nga busulla e marksizëm-leninizmit. Marksizëm-leninizmin duhet ta përvetësojmë thellë si teori, por nuk mjafton vetëm kjo. Këtë teori ne duhet ta zbatojmë në të gjitha drejtimet e zhvillimit të shumanshëm të shoqërisë sonë, duke pasur mirë dhe gjithmonë parasysh faktin që shoqëria jonë socialiste shqiptare ndërtohet dhe zhvillohet në një oqean armiqësor kapitalisto-revizionist, që përpiqet me të gjitha mënyrat të influencojë direkt ose indirekt për të na penguar dhe që mund ta pengojë ecjen tonë përpara.

Kjo është arsyeja që Partia e ka theksuar dhe e thekson vazhdimisht këtë çështje. Komunistët, udhëheqja e Partisë dhe e shtetit tonë, të gjitha evenimentet e ngjarjet në botë duhet t'i njohin, t'i studiojnë, të ngrihen mbi këto evenimente dhe prej tyre të nxjerrin konkluzione qofshin të mira ose të hidhura për ne. Të mirat të na shërbejnë për të forcuar situatën, të hi-

dhurat po ashtu të na shërbejnë për të marrë të gjitha masat që asgjë e keqe të mos ngjasë në vendin tonë. Kjo është një luftë e vazhdueshme, e rreptë, e shumanshme që duhet të bëjë Partia jonë. Një gjë e tillë kërkon pjekuri të madhe, gjakftohtësi, dashuri për socializmin, për Partinë, për atdheun, për gjërat që kemi realizuar dhe për njerëzit tanë, kërkon një mendim të pastër dhe të qartë për konsolidimin e unitetit të popullit, politikisht dhe ideologjikisht, nën shembullin e unitetit të çeliktë të Partisë. Po nuk i pamë këto gjëra në këtë mënyrë, atëherë mundësia që te ne të infiltrojnë dhe të na dëmtojnë krimbat borgjezo-revizionistë është më e madhe.

Partia jonë duhet kurdoherë t'i ketë parasysh këto rreziqe që i turren asaj dhe vendit tonë socialist. Ajo duhet të bëjë një luftë të vazhdueshme kundër këtyre rreziqeve dhe kjo është një luftë politiko-ideologjike dhe ekonomiko-organizative. Për këtë arsye rëndësi të dorës së parë ka edukimi i shëndoshë i kuadrove të Partisë dhe i masave të gjera të popullit, sepse janë Partia dhe populli që duhet të kuptojnë se socializmi ndërtohet vetëm nën udhëheqjen e një partie që zbaton kurdoherë me përpikëri e në çdo situatë parimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, se socializmi ndërtohet me sukses dhe mbrohet nga çdo armik, në rast se marksizëm-leninizmi, kjo shkencë, të vërtetat e saj të përgjithshme gërshetohen si duhet me situatat e ndryshme, nëpër të cilat kalon vendi gjatë zhvillimit të tij.

Partia duhet të kuptojë dhe t'ua bëjë të qartë masave se çdo etapë e zhvillimit, e përparimit, krijon

kushte të reja në shoqërinë tonë socialiste. Në qoftë se këto kushte të reja krijohen ashtu siç kërkohet, atëherë vendi shkon i sigurt drejt progresit. Në qoftë se këto kushte nuk kuptohen dhe zhvillohen shtrembër, atëherë vendi nuk shkon drejt progresit, por drejt regresit. Të dyja këto eventualitete Partia duhet kurdoherë t'i ketë parasysh dhe të luftojë me këmbëngulje e pareshtur për progresin kundër regresit.

Sëmundjet e këqija që mund të infektojnë Partinë, klasën punëtore, fshatarësinë e inteligjencien tonë, janë aq të shumta dhe aq të koklavitura, saqë vetëm një parti e vërtetë marksiste-leniniste mund t'i klasifikojë ato, të njohë rrezikshmërinë e tyre që s'është e njëjtë për të gjithë. Por karakteristikë e përgjithshme e këtyre sëmundjeve është që ato akumulohen dhe grumbullohen në një të tërë për të dëmtuar trupin e shëndoshë. Njëkohësisht, për secilën nga këto sëmundje që shfaqen në jetën e njerëzve tanë në periudhën e ndërtimit të socializmit, Partia duhet të dijë të përcaktojë diagnozën e vërtetë dhe të japë kurën e efektshme për shërimin e tyre.

Në vendin tonë klasa punëtore, nën udhëheqjen e Partisë së saj marksiste-leniniste të Punës, është në drejtim. Ajo ka vendosur diktaturën e proletariatit dhe ka realizuar e realizon çdo vit e çdo pesëvjeçar planë të rëndësishme ekonomike e kulturore, që kanë ndryshuar strukturën dhe superstrukturën e vendit tonë. Ne ndërtojmë dhe punojmë për konsolidimin e socializmit, kemi krijuar, edukuar dhe edukojmë çdo ditë njeriun e ri me botëkuptimin socialist. Ne kemi ndërtuar një industri të rëndë e të lehtë dhe krahas saj kemi vënë

mbi baza të shëndosha bujqësinë socialiste, bazën e ekonomisë sonë, të cilën e udhëheq industria. Në vendin tonë zhvillohet e përparon një kulturë e re socialiste, realiste në të gjitha format. Në Shqipëri po rriten breza të tërë të rinjsh që kanë lindur në socializëm, që ndërtojnë vetë socializmin, që janë edukuar në shkollën e Partisë sonë e të prindërve të tyre, të cilët luftuan dhe për çlirimin e vendit dhe sot luftojnë për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, për mbrojtjen e fitoreve të arritura, për ruajtjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të vendit.

Të gjithë këta breza, të vjetër dhe të rinj, në unitet të plotë, marrin pjesë në ndërtimin e socializmit dhe punojnë së bashku që shoqëria jonë të ecë kurdoherë përpara për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit, për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës dhe të arsimit me një brendi të thellë ideologjike marksiste-leniniste, duke ruajtur gjërat më të mira të popullit, format dhe tiparet më të bukura të tij. Dhe është fakt se kultura jonë është ndërtuar e zhvilluar në përshtatje me strukturën e re socialiste, se ajo ka ditur t'i harmonizojë vetitë morale të popullit tonë, mendimin e mprehtë e ndjenjat e tij të holla me ideologjinë marksiste-leniniste.

Të gjitha këto fitore të Partisë e të popullit përbëjnë një bazë të fuqishme, e cila duhet të ruhet e shëndoshë dhe e pastër, se ka rrezik që të ligështohet. Rreziket për ta dëmtuar këtë bazë janë ato që theksuam pak më lart, prandaj Partia duhet me doemos t'i skartojë nga rruga e saj këto rreziqe, nga rruga e ecjes përpara drejt forcimit të socializmit, drejt shoqërisë komu-

niste pa klasa. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, del qartë në pah roli i madh i Partisë, i vijës së saj, e cila duhet të jetë gjithmonë një vijë marksiste-leniniste, në përputhje me kushtet e vendit tonë, me etapat dhe me problemet e etapës, që duhen zgjidhur me kujdes e me pjekuri pa harruar asnjëherë perspektivën, të ardhmen ku duhet të mbërrijmë. E tashmja, e menduar mirë, e thelluar mirë, e zbatuar mirë, përgatit pikërisht një perspektivë të qartë e të ndritur. Në qoftë se mund të shprehemi kështu, ne ngjitim njëra pas tjetrës shkallët e transformimit të shoqërisë sonë. Ne rrëzuar feudalizmin dhe shporrëm okupatorët, shpallëm Republikën Popullore, filluam ndërtimin e socializmit, punojmë për ta konsoliduar këtë ndërtim të socializmit dhe ngjitemi për të shkuar në shoqërinë komuniste. Për të arritur në shoqërinë komuniste do të duhen akoma dekada, sepse duhet që, në radhë të parë, revolucioni ynë të mos pësojë asnjë disfatë dhe, kur them revolucionin, kam parasysh të gjitha aspektet e tij, të cilat duhet të ecin në mënyrë të harmonizuar përpara dhe, nga ana tjetër, në botë, jashtë kufijve të vendit tonë, duhet të krijohen kushte të favorshme revolucionare. Kjo do të thotë që vendet dhe popujt të fitojnë lirinë e vërtetë, independencën e vërtetë, sovranitetin e vërtetë dhe të jenë futur në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Në çdo kohë e vazhdimisht, Partia me mësimet e saj na edukon që zhvillimin ekonomik-shoqëror, kulturën e arsimit dhe mbrojtjen e atdheut t'i zhvillojmë sipas një vije, sipas një plani të menduar mirë, të balancuar, domethënë në bazë të një plani që të reali-

zohet me forcat krijuese mendore dhe fizike të popullit tonë. Komunistët luftojnë që ky popull të jetë i lidhur me Partinë si mishi me kockën, të ketë besim të plotë te Partia e tij, jo për faktin e thjeshtë se kjo është në fuqi, por sepse është pararoja e klasës punëtore, është arma e mprehtë e klasës punëtore, e formuar me njerëzit më të vendosur, më të përparuar, më të sakrificës, që rrojnë, mendojnë dhe luftojnë kurdoherë për interesat e popullit.

Në rrugën që kemi ecur dhe në sukseset që kemi arritur, ne gjithmonë duhet të shohim edhe mungesat, gabimet e vështirësitë që kemi hasur në këtë rrugë dhe që i kemi skartuar me shumë mënyra.

Është e domosdoshme që Partia, populli dhe brezat e rinj të kuptojnë se jeta është një luftë, një luftë klasash. Klasat më përparimtare, me klasën punëtore në ballë, luftojnë vazhdimisht, luftuan dje kundër klasave shfrytëzuese, të cilat u përmbysën, luftojnë edhe sot kundër elementëve e mbeturinave të këtyre klasave. Partia dhe njerëzit tanë të mos mendojnë kurrë se u zhduk rreziku i restaurimit të klasave shfrytëzuese, qofshin këto të veshura edhe me kostum revizionist. Në fakt, Partia fizikisht nuk i zhduku këto klasa, me përjashtim të atyre elementëve që kishin bërë atëherë ose bëjnë sot faje të rënda kundër popullit, kundër diktaturës së proletariatit, kundër pasurisë së përbashkët, kundër shoqërisë socialiste. Të tjerët, Partia i vë të punojnë si të gjithë, që nëpërmjet punës t'i edukojë e t'i shpëtojë. Por kurdoherë Partia, populli dhe brezat e ardhshëm duhet të kenë mirë parasysh faktin që të mos lejojnë asnjëherë që këta elementë të klasave

shfrytëzuese, pa kaluar një provë apo sakrificë të madhe, të vihen në poste drejtuese të pushtetit tonë. Një gjë e tillë duhet kuptuar drejt, se përbën një rrezik të madh për fatet e diktaturës së proletariatit, se forcat reaksionare, të mundura politikisht, ideologjikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht, nuk heqin dorë kurrë, për asnjë moment, nga mendimi për rimarrjen e pushtetit nga ana e tyre dhe vendosjen e pushtetit borgjez.

Prandaj klasa punëtore, fshatarësia dhe inteligjencia jonë popullore duhet ta ruajnë dhe ta mbrojnë pushtetin e diktaturës së proletariatit nga përpëlitjet dhe dinakëria e mbeturinave të klasës borgjeze, si dhe nga elementët e rinj revizionistë, që lindin edhe në periudhën e pushtetit tonë. Ata duhet të kenë parasysh se këta elementë mundohen të gjejnë format dhe mënyrat se si të veprojnë që ta kalbëzojnë këtë pushtet, si të depërtojnë gradualisht në atë terren ku ka dobësi, atje ku puna e Partisë, propaganda dhe edukata e saj, realizimet e Partisë në ekonomi e në të gjitha fushat nuk vihen mirë në dukje dhe nuk përdoren e nuk shfrytëzohen si duhet nga njerëzit. Dhe, që të mos ndodhë kjo, duhet që të gjithë njerëzit të rriten me frymën e diktaturës së proletariatit.

Diktatura e proletariatit shpreh atë vijë të drejtë marksiste-leniniste që cakton Partia për të gjithë sektorët e jetës së vendit. Zbatimi i kësaj vije është ecja përpara, edukimi i masave të gjera të popullit me frymën e realizmit socialist, janë përpjekjet që bëhen për edukimin e transformimin e elementëve të klasave që humbën pushtetin, e sidomos të bijve të këtyre klasave. Partia punon që edhe këta të rinj t'i bëjë punë-

torë të mirë, t'u spastrojë ndërgjegjen dhe të rikrijojë tek ata njeriun e shoqërisë sonë, domethënë të mos i lejojë që këta të rinj, me prejardhje jo të mirë, të mendojnë ose të luftojnë prapa krahëve, në mënyrë sekrete, për të goditur pushtetin e diktaturës së proletariatit.

Në këtë luftë klasore të gjatë, të vështirë, por heroike, që ka zhvilluar Partia jonë me sukses, janë goditur qindra elementë të padëshirueshëm e të dëmshëm për shoqërinë tonë, janë kritikuar, gjithashtu, njerëz për faje të ndryshme, ose edhe janë dënuar sipas fajit që kanë bërë. Mirëpo të gjithë këta elementë nuk janë të izoluar dhe këtë gjë duhet ta kemi kurdoherë parasysh. Një pjesë e mirë e tyre rron në shoqërinë tonë, punon në shoqërinë tonë, ndodhet në gjirin tonë. Ata kanë rrethin e fisin e tyre, kanë pasardhësit e tyre, të cilët, kush më shumë e kush më pak, janë pezmatuar disi për dënimin me arsye të babait apo të vëllait që ka gabuar. Natyrisht, në përgjithësi, këta njerëz nuk e aprovojnë veprimtarinë e keqe të personit të familjes së tyre, por Partia e ka për detyrë të punojë me këta që jo vetëm ta njohin dhe ta dënojnë gabimin e njeriut të tyre, por të edukohen, të nxjerrin mësim nga ky apo ai rast dhe të mos u mbetet në ndërgjegje pezmatimi, qoftë edhe në mënyrë latente. Këtë duhet ta arrijmë me punën tonë të vazhdueshme e plot durim, sepse në një moment të vështirë për këtë person, ky pezmatim zmadhohet dhe merr forma më të acaruar, forma të cilat e infektojnë dhe e sëmurin më shumë ndërgjegjen e tij, e turbullojnë mendimin e tij politik dhe në këtë mënyrë ai influencon për keq në rrethin e tij të vjetër dhe të ri.

Partia duhet të vazhdojë punën e saj për edukimin e diferencuar të njerëzve, domethënë të mos i konsiderojë të gjithë në një nivel, me të njëjtën ngritje ideologjike, politike, kulturore dhe arsimore. Ajo nuk duhet të mendojë se ndjenjat, aspiratat, dëshirat e të gjithë njerëzve të vendit tonë janë të prera si me thikë dhe fjala e Partisë zë vend në të gjithë njëlloj. Partia të mos niset nga mendimi se ata persona që nxjerrin pak kokën lart ose e ulin pak kokën poshtë, nuk janë në vijën e Partisë dhe përnjëherë ndaj tyre të mbahen qëndrime. Ka raste që, kur është fjala për edukimin e njerëzve, kujtohet se të gjithë duhet të mendojnë njësoj dhe propaganda nuk bën përpjekje të atilla që njerëzit t'i marrë ashtu siç janë dhe jo vetëm ashtu siç duhet të jenë. Këtë çështje e kam theksuar edhe herë të tjera.

Propaganda jonë duhet t'u adaptohet shoqërisë dhe njerëzve. Ka elemente të propagandës dhe të edukimit, që janë të fiksuara, të njëllojta për të gjithë, por ka edhe nuanca, ka edhe zhvillim të këtij edukimi dhe të kësaj propagande, e cila duhet të evitojë shabllonizmin, të evitojë rutinën dhe burokratizmin.

Në qoftë se nuk tregohet kujdes për këto çështje, të gjitha këto krijojnë një situatë të sëmurë në ata njerëz të lëkundur, të cilët nuk janë plotësisht të disponuar, pavarësisht se pak a shumë e duan jetën e re socialiste, pavarësisht se luftojnë e punojnë për këtë jetë, por ndjenjat e tyre nuk janë akoma të kanalizuarra në rrugën e klasës, mendimet e tyre nuk janë të gjitha të qarta si duhet dhe si do Partia. Prandaj de-tyra e Partisë dhe e propagandës së saj është që dhe

këta njerëz t'i edukojë, t'i kalitë, t'i gdhendë, t'i sqarojë në mendime dhe t'i shëndoshë. Kështu gjithë shoqëria, në përgjithësi dhe në pjesën e saj dërrmuese, të mbështetë me gjithë shpirt, me të gjitha forcat fizike dhe mendore, ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe vijën e Partisë.

Por a bëhet kjo punë si duhet nga ana e organizatave të Partisë, nga ana e organizatave të bashkimeve profesionale, të gruas, të rinisë etj.? Sigurisht, në këtë drejtim nga të gjitha këto organizata bëhet një punë e madhe, por unë e kam fjalën këtu, që nuk bëhet sa e si duhet ajo punë e imët, e vogël, e diferencuar që kërkon Partia. Mendimi im është se nga kuadrot e Partisë dhe nga kuadrot e organizatave të masave nuk bëhet kurdoherë një përpunim i gjerë e i thellë i vijës së Partisë, në mënyrë që kjo të çohet në masat e gjera të popullit me një frymë luftarake, revolucionare që të ngrejë peshë njerëzit, t'i aktivizojë e t'i gjallërojë ata. Kjo punë politiko-edukative marksiste-leniniste, ky aksion revolucionar i përditshëm, orë e minutë, nuk duhet ta lodhë e ta mërzhitë njeriun, por ta gjallërojë atë, t'i hapë atij horizonte për punë krijuese, për një punë të këndshme dhe të frytshme njëkohësisht. Njëpunjet një punë politiko-edukative të menduar mirë ta bëjmë njeriun e ri të shoqërisë socialiste që të vijë e Partisë e në rrugën që e udhëheq ajo të gjejë një ushqim të atillë që ia bën atij jetën të lumtur, të gëzuar. Në këtë mënyrë luftohet edhe kundër mbeturinave të vjetra, për të cilat asnjëherë nuk duhet të mendojmë se janë zhdukur.

Të marrim, për shembull, çështjen e fesë. Lidhur me këtë çështje ka njerëz në Parti e në komitete partie,

pale në popull, që mendojnë se influenca e fesë dhe mbeturinat e saj u likuiduan me mbylljen e kishave dhe të xhamive, me heqjen e priftërinjve e të hoxhallarëve dhe u shkëputën lidhjet e tyre me popullin. Një mendim i tillë është i gabuar dhe i dëmshëm. Zhdukja e këtyre institucioneve fetare nuk e likuidoi, por vetëm e dobësoi influencën ataviste të besimeve fetare. Është e vërtetë se, si rezultat i propagandës së Partisë dhe i zhvillimit kulturor e ideologjik të masave të gjera, janë arritur suksese të dukshme në formimin ateist, sidomos të brezave të rinj. Edhe nga brezat e vjetër ne trashëgojmë tradita të mira të një qëndrimi indiferent e kritik ndaj institucioneve fetare, të cilat, përgjithësisht, në historinë e popullit tonë kanë mbështetur pushtuesit, bajraktarët, bejlerët, agallarët e mëdhenj e kulakët. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se kultura në masat e gjera të popullit nuk është akoma e zhvilluar në atë shkallë të thellë dhe të gjerë për të kuptuar nga pikëpamja filozofike kotësinë e teologjisë dhe se është shkenca marksiste-leniniste ajo që e ka demaskuar këtë kotësi dhe filozofinë idealiste që mbështet teologjinë. Prandaj duhet reflektuar drejt nga të gjithë se influenca e fesë nuk zhduket aq kollaj. Do të kalojnë disa breza dhe prapëseprapë Partisë do t'i duhet të luftojë me mbeturinat e fesë që do të shfaqen në forma të ndryshme, në përshtatje me zhvillimin e vendit tonë, duke pasur parasysh edhe influencën nga jashtë, mbasi për këto çështje nuk mund të mos llogariten presioni dhe influenca e jashtme.

... Sa më i vrullshëm të jetë zhvillimi ynë ekonomik, politiko-ideologjik dhe sa më të organizuara të jenë

propaganda dhe puna edukative e Partisë me njerëzit, aq më pak do të zënë vend këto mbeturina të fesë. Por të mos harrojmë se feja, pavarësisht se te ne nuk ka qenë aq virulente, siç ka qenë në vendet e tjera, për arsyt që kemi shpjeguar, prapëseprapë është pleksur me ngjarjet, me zakonet, me mendimet e shoqërisë shqiptare në periudha të ndryshme dhe ka mundur të influencojë në këto ngjarje, në këto ndodhi e në karakterin e njerëzve tanë, ku më shumë e ku më pak.

Prandaj neve na vihet si detyrë që në mënyrë të zgjuar, të mençur e të organizuar mirë t'i luftojmë këto mbeturina dhe të mos i lëmë kurrë në harresë, të mos i nënvlerësojmë asnjëherë, sepse shohim që në vendet ku sundon revizionizmi modern, qoftë në Bashkimin Sovjetik ose në vendet e tjera, ku pushtetin nga duart e proletariatit e mori klasa e re borgjezo-kapitaliste, kisha dhe xhamia kanë rifilluar e zhvillojnë hapur aktivitetin e tyre. Pra komunistët duhet të luftojnë me urtësi në këtë drejtim dhe kjo çështje nuk duhet neglizhuar.

Gjithashtu Partia nuk duhet të mendojë që të gjithë anëtarët e saj, të cilët për fajë të ndryshme janë dënuar, janë përjashtuar nga Partia, janë bindur të tërë se ndaj tyre qëndrimi i Partisë ka qenë i drejtë. Jo, ata e kanë vështirë t'i njohin me të vërtetë e t'i pranojnë plotësisht gabimin dhe fajin që shkaktuan përjashtimin e tyre nga Partia. Në përgjithësi, në vetvete ata ruajnë mendimin dhe ndjenjën se kanë pasur të drejtë, ndërsa Partia që i dënoi, duke i përjashtuar nga radhët e saj, nuk ka pasur të drejtë. Partia jonë kurdoherë ka vepruar me kujdes e urtësi në këtë drej-

tim. Mund të jetë bërë edhe ndonjë gabim në këtë rrugë, por është korrigjuar. Shumë herë Partia i ka rikthuar kërkesat e këtyre njerëzve, ka bërë studime të hollësishme për këtë gjë. Ajo kujdeset shumë dhe ka rekomanduar që të tregohet kujdes me këta njerëz, të cilët kanë qenë në Parti dhe tashti s'janë, që këta të qëndrojnë afër Partisë, për arsye se e njohin vijën e saj, njohin të mirat e kësaj vije, por duhet t'i bëjmë të njohin edhe gabimin.

Direktiva që ka dhënë, dhe që e përsërit gjithmonë Partia, është që këta elementë, të cilët nuk janë një e dy, por gjatë gjithë këtyre vjetëve janë bërë disa qindra, duhet të mbahen afër. Në qoftë se kjo direktivë nuk mbahet parasysh, nuk zbatohet si duhet, atëherë ne vetë lejojmë të krijohet një kontingjent i tillë njerëzish, që janë të mësuar e me përvojë, por që kanë qenë dhe shumë prej tyre vazhdojnë të jenë të molepsur, të cilët mund të shtojnë kontingjentet e njerëzve të pakënaqur, që aktualisht, ndoshta, nuk e tregojnë pakënaqësinë e tyre, por në momente të vështira që mund t'i ngjasin Partisë, këta elementë grumbullohen dhe ndodh, siç ka ndodhur në vende të tjera ku u shkatërrua socializmi dhe u restaurua kapitalizmi, të tentojnë të marrin në dorë pushtetin.

Në vendin tonë fshatarësia është e lidhur ngushtë me klasën punëtore dhe punon e ndërton socializmin në fshat. Me sytë e saj fshatarësia kooperativiste shikon përparimet. Me mendjen e saj, me duart e saj, me mjetet moderne të bujqësisë që i kanë siguruar Partia e pushteti popullor, me kuadrot që i kanë përgatitur këta, me të dhënat e shkencës agroteknike, ajo

e ka transformuar krejtësisht fshatin, bujqësinë, jetën. Kudo në fshat shikon lulëzim. Megjithatë, ne nuk duhet të flemë mendjen e të vetëkënaqemi, duke menduar se edukata marksiste-leniniste kuptohet në gjithë thellësinë dhe gjerësinë e saj dhe se ka një kuptim të plotë e të rrënjosur mirë për socializmin në fshat nga fshatarësia kooperativiste. Fakt është se mjaft kooperativistë po gjobiten nga gjyqet popullore të fshatit. Dhe përse gjobiten? Këta gjobiten për arsye se dëmtojnë pronën e përbashkët të kooperativës, sidomos duke futur në arat e kooperativës kafshët e oborrit të tyre. Dënimi me gjoba krijon pakënaqësi tek ata që dënohen. Por a mund të evitohet kjo? Natyrisht, mund të evitohet, por, të kuptohemi, jo me një të rënë të shkopit. Një gjë e tillë mund të evitohet vetëm me një edukim politik, ideologjik dhe me masa tekniko-organizative.

Këto masa tekniko-organizative i ka përpunuar Partia dhe ka udhëzuar që të zbatohen, por këto nuk po zbatohen si duhet. Në këtë drejtim neglizhohet dhe neglizhenca për zbatimin e këtyre udhëzimeve të Partisë prish ndërgjegjen e fshatarëve dhe mban gjallë ndjenjën e pronës së vogël private, të oborrit, të kafshëve që është lejuar me ligj të mbahen në këtë oborr. Fshatari nuk arrin dot t'i ushqejë këto kafshë dhe kështu që ai i fut në arat e kooperativës, pra dëmton. Po kë dëmton? Ai dëmton veten e tij, por këtë gjë ai nuk e kupton, se në ndërgjegjen e vet ka mbetur diçka nga ndjenja e pronës private, e pronës së tij të vogël, duke menduar të marrë diçka më tepër nga ajo lopë e nga ato dhen, paçka se dëmton pronën e të gjithëve.

Ne duhet të punojmë që edukata me të vërtetë revolucionare marksiste-leniniste të përfshijë të gjitha masat, që nga fshatarësia, inteligjencia e deri te klasa punëtore, sepse konstatojmë që elementë të klasës punëtore, punëtorë të rinj, shkelin disiplinën proletare, disiplinën teknike dhe bëhen pengesë për realizimin e planit. Gjithashtu vëmë re që përqindja më e madhe e atyre që shkelin disiplinën e planit nëpër fabrika, nëpër uzina etj., janë të rinj punëtorë. Ndodh që shumica e atyre që dënohen për ato që quhen «krime të vogla» janë të rinj dhe pjesa dërrmuese e tyre — fëmijë të njerëzve tanë, të punonjësve. Atëherë në këtë çështje Partia duhet të ndalet dhe të mendojë pse ndodh një gjë e tillë. Dhe kjo vjen se diçka çalon në punën tonë, në kujdesin tonë, në organizimin dhe në punën edukative që zhvillojmë me njerëzit. Kjo do të thotë se ne nuk e bëjmë si duhet këtë edukatë, nuk e kemi këtë kujdes në ato forma dhe në atë mënyrë që fola më lart.

Prandaj, për asnjë moment nuk i lejohet Partisë që t'i shpëtojnë nga syri këto dobësi në punë, këto pika të dobëta, këto njolla të errëta, të cilat, në rast se nuk i heqim, zmadhohen e hapen si vaji në kartë dhe shkaktojnë atë rrezik që mund t'i turret Partisë dhe socializmit në një moment të papritur. Po të lejohet që të tilla gabime të trashen e të marrin përpjesëtime të mëdha, kjo do të tregonte se organizatat e Partisë nuk janë në pozita revolucionare, se i ka zënë gjumi ose janë dehur nga vetëkënaqësia, se nuk janë shkundur në çdo moment për të spastruar pluhurin që i mbulon gjatë punës, se nuk e kanë zhvilluar si duhet luftën e klasave. Zhvillimi drejt i luftës së klasave,

domethënë zbatimi i vijës së Partisë në prizëm revolucionar, duhet të kuptohet jo si imponim i vijës, por, përkundrazi, adoptim, përqafim, përvetësim me dëshirë, me vullnet e zjarr revolucionar i parimeve të ndritura të socializmit shkencor, të detyrave të mëdha që shtron Partia për të mirën e atdheut, për të mirën e popullit. Prandaj, të punohet me kujdes që të kuptohen si duhet ç'është diktatura e proletariatit, ç'janë ligjet e saj, ç'është demokracia e popullit, ç'është disiplina proletare etj. Në qoftë se punohet që këto të kuptohen si duhet, atëherë ne do të dimë të luftojmë ato të këqija që thashë më lart, do të dimë t'i edukojmë njerëzit tanë në frymën e drejtë, do të dimë të shërojmë plagët dhe mbeturinat e së kaluarës, kështu që do të korrim suksesin e merituar, duke qeruar skorjet, pse skorje do të ketë vazhdimisht, por, sa më përpara të ecim në këtë frymë revolucionare marksiste-leniniste, aq më të pakta do të jenë ato.

Vija e Partisë duhet të kuptohet drejt nga të gjithë, ajo nuk është as oportuniste dhe as sektare. Është thënë se rreziku aktual është oportunizmi i djathtë: Kjo është e vërtetë, por oportunizmi i majtë, sektarizmi, është jo më pak i rrezikshëm se oportunizmi i djathtë. Vija e Partisë është në luftë me të dyja këto ekstreme. Ideologjia e Partisë sonë është ajo ideologji që e lufton oportunizmin, por ajo lufton njëkohësisht edhe sektarizmin.

Disave u duket se tash janë momentet për të qenë sektarë. Ata gabohen, pse sektarizmi aktual — të supozojmë për një minutë se është dhe duhet të jetë në rendin e ditës — shkakton te njerëzit një pakënaqësi;

një shtrëngesë dhe një obligim jashtë normave të Partisë. Sektarizmi shkaktohet nga ata që mendojnë se janë të plotfuqishëm, që janë mendjemdhënj e prepotentë. Duhet kuptuar se mjaft njerëz këtë prepotencë e këtë mendjemadhësi e fshchin gjoja me luftën kundër disa shfaqjeve oportuniste. Pra sektarizmi shton radhët e të pakënaqurve, të cilët në këto momente nuk ndihen, por në ndonjë moment të rrezikshëm ata bëjnë gjëmën, kur mendojnë se u erdhi koha dhe të thonë: «Tash po marrim frymë lirisht». Ata shokë që mendojnë se sektarizmi në këtë moment nuk është i rrezikshëm, përgatitin oportunizmin e së nesërme. Prandaj Partia lufton e duhet të luftojë në të dy krahët, si oportunizmin aktual, ashtu edhe sektarizmin aktual dhe këshillon e udhëzon të mbahen qëndrime të drejta marksiste-leniniste.

Partia godet pa mëshirë armikun e klasës. Në të gjitha udhëzimet e veprimtarinë e saj ajo vazhdimisht porosit që të ruhet e të forcohet uniteti me popullin. Uniteti i shëndoshë i popullit rreth Partisë ruhet, zhvillohet e forcohet kur vija e Partisë zbatohet me urtësi, pa devijime, as nga e majta, as nga e djathta, domethënë kur Partia dënon sektarizmin dhe oportunizmin e, kur them dënon, kam parasysh me edukim e me masa të drejta organizative, e vetëm kur duhet me masa administrative. Masat administrative kurdoherë vijnë në fund, kur mbushet kupa, kurse edukimi duhet të jetë i përditshëm. Në jetë, siç e thashë dhe më parë, karakteret e njerëzve mbruhën në forma të ndryshme, me intensitet të ndryshëm dhe gjatë punës njëri e kupton dhe ecën më drejt, tjetri ecën pak shtrembër,

pra ky duhet sjellë në rrugë të drejtë, njëri ecën shpejt, tjetri ngadalë, ose qëndron në vend e kështu me radhë. Pra, për të gjitha këto çështje, po të thellohet e të zbatohet si duhet vija e Partisë nga anëtarët e saj, nga aktivistët dhe nga masat e gjera të popullit, atëherë do të shihet se ajo i përmban të gjitha këto forma dhe metoda pune të përshtatshme që shëndoshin njeriun dhe konsolidojnë fitoret e socializmit në vendin tonë.

Asnjë situatë të mos na gjejë në befasi

Të gjitha këto probleme i ngre për të theksuar që Partia dhe udhëheqja e saj duhet të tregojnë vazhdimisht kujdes për të parë si zbatohet vija e Partisë në të gjitha aspektet e saj dhe të marrin masat e përshtatshme që çdo gjë të zbatohet në kohë e drejt dhe të krijojnë te masat e gjera të popullit kënaqësi për punën, për jetën. Ato duhet të zhvillojnë mendimin krijues, të edukojnë ndjenjën e dashurisë midis njerëzve, të një dashurie revolucionare, jofisnore, por proletare, të edukojnë te njerëzit mendimin e pastër të drejtësisë proletare, të masës në çdo gjë. Partia të luftojë kundër të këqijave që lindin e zhvillohen në një karakter të paformuar dhe të punojë pareshtur që karakteri i njerëzve të brumoset me një ideologji marksiste-leniniste dhe me virtytet e larta njerëzore.

Të gjitha këto i them që Partia të ketë parasysh se realizimet ekonomike luajnë një rol vendimtar në përparimin e shoqërisë sonë dhe zhvillimi ekonomik du-

het të udhëhiqet nga një politikë e drejtë, e urtë, tej-pamëse. Kurrë nuk duhet të ecet kuturu, qorrazi, pa i matur mundësitë dhe pa përcaktuar objektiva të qartë për sot dhe për të ardhmen.

Ne duhet të përpiqemi që kurdoherë vendi ynë, ekonomia jonë, shoqëria jonë, të ecin përpara dhe të zhvillohen. Në rast se nuk luftohet e nuk punohet në këtë rrugë, atëherë jo vetëm socializmi nuk ndërtohet, por bazat e kësaj shoqërie dobësohen, dobësohet dhe ai kohezion që mban të gjallë e të fortë popullin tonë, si popull e si komb. Ata popuj që nuk ecin përpara, janë të destinuar të zhduken. Këtë e vërteton historia shumëshkullore mijëravjeçare e njerëzimit.

Ne, shqiptarët, jemi një popull i atillë që në shekuj kemi luftuar, kemi punuar, kemi ecur përpara, kemi pasur edhe disfata, por nuk jemi zhdukur. Nga fiset ilire jemi të vetmit ne, shqiptarët, që rrojmë dhe ecim përpara dhe tani po ndërtojmë edhe socializmin. Kjo është një karakteristikë e veçantë dalluese për një popull me vitalitet, për një popull që ka ditur ta mbajë gjallë veten e tij, që e ka kuptuar se zhvillimi të jep jetë, progresi të jep forcë, të shtyn përpara, se ai transformon njeriun, ekonominë, kulturën dhe bën të kalohet nga një shoqëri në një shoqëri tjetër më të përparuar. Prandaj këto veti jo vetëm që nuk duhet t'i lëmë të humbasin, por, përkundrazi, t'u japim një ndriçim e lulëzim të paparë, sepse tani na udhëheq një Parti e tillë e pararojës, që i zhvillon këto me ritme revolucionare, i rrënjos këto në ndërgjegjen e në jetën e punonjësve, i bën këto parime dhe këtë praktikë revolucionare mish e gjak të njerëzve; të cilët ecin përpara;

rrojnë të gëzuar, luftojnë me guxim e besim, kapërcëjnë vështirësitë, ndërtojnë, përparojnë.

Prandaj ne, anëtarët e Partisë së Punës të Shqipërisë, duhet në çdo kohë dhe në çdo veprim të mendojmë për popullin tonë, për atdheun tonë, t'i ruajmë këtë popull dhe këtë atdhe nga rreziqet e shumta që u turren nga brenda e nga jashtë, sepse gjithmonë rreziqet e brendshme janë të lidhura me ato të jashtmet. Kur situatën brenda e kemi të shëndoshë, të pastër, revolucionare, atëherë çdo e keqe zë më pak vend dhe situata e jashtme, regresive, kundërrevolucionare influencën më pak brenda. Prandaj ne duhet të interesohejmë vazhdimisht, në rrugë të drejtë revolucionare marksiste-leniniste, për të tashmen që të mos u ngjasë gjë e keqe në të ardhmen atdheut tonë socialist, Partisë sonë heroike e brezave të rinj të vendit tonë.

Partia duhet t'i kuptojë etapat e zhvillimit të shoqërisë socialiste, duhet të kuptojë që zhvillimi, qoftë ekonomik, kulturor, politik ose ideologjik, krijon mendime të reja, krijon dëshira e kërkesa të reja, lind aspirata e shpresa, të cilat nuk duhen nënvlerësuar, mbasi ato përbëjnë këtë jetë të pasur materiale dhe shpirtërore të njerëzve, që duhet kurdoherë ta ndërtojmë dhe ta ruajmë të pastër e të shëndoshë.

Brezat e ardhshëm të vendit tonë, të cilët do të rrojnë në një periudhë më të përparuar se kjo jona, duhet ta kuptojnë këtë zhvillim dialektik, këtë zhvillim materialist të shoqërisë sonë, nga kemi ardhur, si jemi zhvilluar, ç'vështirësi kemi kapërcyer, ç'vijë kemi zbatuar, ç'orientime kemi përpunuar, cilat kanë qënë themelet e kësaj shoqërie të përparuar, të mirat

e së cilës ata do t'i gëzojnë. Pra, njerëzit e brezit të ri të mos mendojnë se situata ku ata rrojnë ka ardhur ashtu vetvetiu, ose se kjo është një situatë statike që nuk do të ndryshojë më tej. Jo, ajo do të ndryshojë, por **Partia duhet të edukojë brezat e ardhshëm që ndryshimet të bëhen kurdoherë drejt progresit, drejt shoqërisë pa klasa, drejt komunizmit dhe jo drejt degjenerimit, sikundër ngjau në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ish-socialiste. Partia jonë, brezat e sotëm e të ardhshëm, do të luftojnë tok me proletaria-tin ndërkombëtar dhe me popujt që edhe në vendet kapitaliste të shpërthejnë revolucione, të shembet shoqëria e vjetër borgjezo-kapitaliste shtypëse dhe në vend të saj të ndërtohet një shoqëri e re, shoqëria socialiste.**

Pra, Partia jonë, anëtarët e Partisë sonë, kudo ku rrojnë e ku punojnë, nuk duhet të ecin si «kuajt e arabasë», nuk duhet të kenë një shikim të kufizuar të detyrës, por si komunistë duhet ta zgjerojnë këndin e shikimit të tyre jashtë punës së caktuar, jashtë detyrës së caktuar dhe të kuptojnë, se roli e misioni i tyre është i madh, se përgjegjësia e tyre është e rëndë. Puna e komunistit nuk mbaron vetëm me realizimin e kësaj ose të asaj detyre të veçantë që i është caktuar. Komunisti ka për detyrë të udhëheqë, të udhëheqë popullin, klasën në rrugë të paçara, të gjejë zgjidhjen e problemeve të ardhshme dhe të krijojë mjetet për ta ndërtuar këtë rrugë të re në unitet mendimi e veprimi. Vetëm kështu do të zbatohet vija e tashme dhe e perspektivës e Partisë sonë, që ndriçohet nga mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Kurrë nuk duhet ta harrojnë këtë detyrë të madhe anëtarët e Partisë

dhe kurrë nuk duhet të bëjnë gjëra të pamatura, të papeshuara në veprimet e sjelljet e tyre, në familje, në punë dhe në shoqëri. Në mendimet dhe në veprimet e tyre çdo gjë duhet të jetë e ekuilibruar. Ata që mendojnë e veprojnë kështu, ata i shërbejnë më mirë Partisë, e ngrenë më lart rolin e saj të madh, mendojnë për interesat e popullit, për të ardhmen e tij.

Vetëm në këtë mënyrë bëhen më të qarta vija e zbatimi i saj, bëhet më e qartë propaganda, më e ndritur shkëlqen politika e Partisë dhe më me sukses luftohet burokratizmi, luftohen indiferentizmi, plogështia, rutina, interesi personal, që shumë herë vihet mbi interesin e përgjithshëm, evitohen meritë me njërin e me tjetrin, evitohen hatëret, zakonet e këqija e sjelljet e pahijshme. Të gjitha këto përbëjnë atë kompleks problemesh të jetës që vetëm një njeri me qartësi politike dhe ideologjike mund t'i zgjidhë drejt, mund të shërojë të këqijat, mund të skartojë të ligat nga ndërgjegjja e vet, nga jeta e shoqërisë.

Një marksist-leninist e kupton se zhvillimi ecën përpara nëpërmjet luftës së klasave, e cila është motori i fuqishëm i ndërtimit të shoqërisë së re socialiste, dhe se kjo luftë klase zhvillohet në gjirin e popullit, por edhe brenda në Parti. Kjo do të thotë se në gjirin e shoqërisë sonë ekzistojnë kontradikta, të cilat duhet të dimë t'i zgjidhim drejt. Edhe në të ardhmen do të ekzistojnë të tilla kontradikta. Eksperienca e fituar do të na bëjë që të kemi sa më pak kontradikta joantagoniste dhe të punojmë me durim e vazhdimisht që këto t'i zgjidhim drejt. Pra do të jetë e pamundur që në këtë luftë të mos ndeshemi me mbeturina, me men-

talitete të vjetra, që mund të reklamohen si «moderne», por në fakt janë përsëri regressive, po aq të rrezikshme sa edhe mbeturinat e mentalitetet e vjetra. Degjenerimi modern, që ideologjitë antimarksiste në shërbim të shoqërisë kapitaliste përpiqen ta përhapin, përmban në vetvete mbeturinat e së kaluarës, të veshura me forma të reja degjenerimi, nëpër të cilat kalon imperializmi që kalbëzohet dhe që kërkon të mos japë shpirt, duke bërë çmos për të degjeneruar e për të korruptuar masat e gjera të popullit dhe të proletariatit që luftojnë për ta shkatërruar atë përgjithmonë.

Partia jonë marksiste-leniniste duhet të bëhet barrierë e pakapërcyeshme, sa të jetë e mundur më e fuqishme, çdo ditë e më e fuqishme, kundër këtyre të këqijave. Ajo duhet të farkëtojë një unitet të shëndoshë të kuadrove të vjetër me kuadrot e rinj, të nxitë kuadrot e vjetër, që do t'u lënë stafetën të rinjve, këtë stafetë madhështore të brezit të luftës, që të bëjnë çmos të vazhdojnë të luftojnë e, po të jetë nevoja, të bëjnë sakrifica të reja për të ardhmen e brezit të ri, për brezat e ardhshëm.

Partia, gjithashtu, me punën e saj të bëjë që brezi i ri të njihet me kohën kur rrojtën prindërit e tyre, të kuptojnë vështirësitë që kapërcyen ata, metodat që përdorën ata dhe t'i çmojnë ato metoda të mira, disa herë të rrepta, se një gjë të tillë e kërkonin situatat. Por, kurdoherë, ajo ka qenë një rreptësi revolucionare, marksiste-leniniste. Kurrë ajo s'ka qenë një rreptësi shtrënguese, përkundrazi ka qenë rreptësi për të krijuar një situatë të shëndoshë, një të ardhme të re ku eksperiencia e të moshuarve me atë të brezave të rinj të pleksen

në një unitet plot serenitet, plot sinqeritet, plot dashuri për njëri-tjetrin, dashuri që e karakterizon unitetin e Partisë dhe unitetin e kombit tonë.

Asnjë situatë, cilado qoftë, të mos i gjejë klasën tonë punëtore revolucionare, popullin tonë përparimtar, Partinë tonë marksiste-leniniste, të papërgatitur e në befasi. Të mos ketë në asnjë kohë të çara, siç ngjau dhe siç po ngjet në vendet ish-socialiste, ku me vdekjen e një ose dy personaliteteve krijohet një situatë e rëndë, regresive për gjithë partinë dhe për gjithë vendin. Në asnjë mënyrë nuk duhet të ndodhë një gjë e tillë në vendin tonë, kur koha do të bëjë ligjin e vet me jetën e kuadrove të brezit të Luftës Nacional-lirimtare e të luftës të viteve të para e të vështira të ndërtimit të shoqërisë socialiste.

Duhet ngulitur thellë në ndërgjegjen e njerëzve, që të gjithë të na ta kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht se populli është i pavdekshëm, se klasa punëtore është klasa më e përparuar dhe udhëheqësja e vendit e se Partia dhe vetëm Partia është maja e mprehtë e shpatës së klasës punëtore, e cila nuk ndryshket kurrë. Ajo qëndron kurdoherë e shkëlqyer dhe e fortë, në rast se teoria e saj, vija e saj kuptohet dhe zbatohet drejt. Këtu duhet të përqendrojmë të gjitha forcat tona, pse ky është kyçi që ndihmon e do të ndihmojë të zgjidhë drejt të gjitha problemet e tashme dhe ato të ardhshme.

Botuar për herë të parë, me shkurtime, në gazetën «Zëri i popullit», nr. 67 (9240),

19 mars 1978

Botohet i plotë sipas origjinalit, që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

BUKURIA QËNDRON NË TIJESHTËSINË, ASI TU SI TRIMËRIA NË URTËSINË

*Nga bisedat gjatë vizitës në ndërmarrjen e veshjeve
«Bule Naipi» të Gjirokastrës*

18 mars 1978

*Te porta e ndërmarrjes shoku Enver u prit nga
kuadro drejtues dhe nga një numër punëtoresh të da-
lluara.*

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni shoqe? Gëzohem shumë që erdha të takohem me ju këtu, në ndërmarrjen tuaj, me këtë kolektiv grash e vajzash punëtoresh. Ja, po shoh këtu se të gjitha janë gra e vajza të reja.

Pasi drejtorja e ndërmarrjes informoi për përbërjen e kolektivit punonjës, për disa arritje në realizimin e planit dhe për prodhimet e reja, modelet e të cilave qenë ekspozuar, shoku Enver Hoxha tha:

Mirë, tani t'i shikojmë këta artikuj që keni ekspozuar.

Si jeni ju shoqe? Ç'janë këto gjëra të bukura që keni ekspozuar?

SHOQJA MARIANTHI GOGO¹: Këto janë veshje

1. Përgjegjëse reparti.

për fëmijë të vegjël, të gjitha të punuara me akrilik.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë të bukura janë. Shikoje Nexhmije këtë fund, sa i bukur që është! Gëzohen fëmijët për gjëra të bukura.

Duke i parë këto prodhime akriliku, m'u kujtua një bisedë që pata njëherë me disa gra e vajza të një fshati. Kur isha në Korçë, para disa vjetësh, shkova një ditë nga Dishnica. Qëndruam pak nën një hije, përballë një fushe të madhe të lëruar, ku po punonin si flutura plot gra e vajza të reja që kishin ulur kokën. Atij që më shoqëronte i thashë të m'i thërriste një çikë që të vinin aty ku ishim ulur, se doja të bisedoja me to. Dhe ato erdhën të gjitha me vrap drejt nesh. U përqaftuam dhe bëmë një copë herë muhabet nën hijen e pemës. Ato më folën për bukuri për grurin, për panxharsheqerin, për rendimentet e larta që kishin arritur, për jetën e re në fshat, për prodhimet bujqësore e blegtorale e për të gjitha me radhë.

Po mirë, u thashë, po ndonjë ankesë nuk keni? «Kemi, thanë ato. Këta që merren me tregti këtu, në Korçë, nuk na sjellin në fshat akrilik.» Shoqeve kooperativiste u thashë se kishin të drejtë që ankoeshin, prandaj i porosita drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit të rrethit të Korçës që t'u çonin edhe atyre akrilik në dyqanet e fshatit. Kështu u ndava nga ato vajza që ishin aq punëtore, por të pakënaqura se nuk u kishin shpurrë akrilik në fshat.

Po, me të vërtetë, të gjitha këto triko, funde e fustane të punuara me akrilik po më pëlqejnë. Edhe ngjyrrat e tyre janë tërheqëse. Por janë punuar edhe bukur; bile, ju në Gjirokastrë i keni punuar më mirë se ato të

Korçës. Kujdesuni që t'i kënaqim fëmijët tanë e të na rriten jo vetëm të shëndetshëm, po edhe të bukur.

Sa kushton kjo bluzë?

SHOQJA MARIANTHI GOGO: 65 lekë të reja.

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, 65 lekë të reja, se po të ishte me lekët e vjetra, bluza do të kushtonte sa dy paketa cigare. Ne do të përpiqemi që në të ardhmen këto të kushtojnë edhe më lirë, që gratë të blejnë bluza dhe jo cigare, në mënyrë që burrat të mos e pinë, se e di që gratë nuk duan që burrat të pinë duhan. (*Të qeshura.*)

Ka këtu gra dhe vajza punëtore nga Seloja? Pyes, sepse ata të Selos e kanë punuar mirë drurin, sidomos bucelat që përdorte Gjirokastra për t'i mbushur me ujë; të gjitha që andej vinin. Po ti, shoqe, nga je?

SHOQJA MARIANTHI GOGO: Unë jam nga Suha.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , nga Suha! Ju të Suhës keni vuajtur shumë; ua pinte gjakun çifligari Bufe Hasani. Ju punonit dhe e fitonit bukën me djersën tuaj. Ke mbaruar ndonjë shkollë ti?

SHOQJA MARIANTHI GOGO: Po, kam mbaruar shkollën teknologjike.

SHOKU ENVER HOXHA: E shikoni këtë vajzën suhjote që ka mbaruar për teknologje? Shikoni, pra, si kanë ndryshuar kohët! Ja, këtë e bëri lufta e popullit që udhëhoqi Partia.

(*Duke parë punime të ndryshme prej druri.*) Sa gjëra të bukura ka këtu! Ky është dybeku, ku rrahin qumështin dhe andej del gjalpë. E shikon sa gjëra të bukura bën Gjirokastra, Nexhmije?

Po kush i bën këto prodhime të bukura me dru panje e ahu?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Këto i punon mjeshtri Koço Beruka.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku është Koçoja?

SHOKU KOÇO BERUKA: Ja ku jam, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Të përgëzoj, Koço, për punën që bën. Pa dale të të shikoj një çikë më mirë në fytyrë, se nuk më lënë dritat e shokëve që na marrin në film e në fotografi. Edhe fytyrën ti, Koço, e paske si artist!

SHOKU KOÇO BERUKA: Këto punime që shikoni, shoku Enver, nuk janë vetëm të mijat, por edhe të nxënësve.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë bukur! Të përgëzoj si për prodhimet e bukura, ashtu edhe për kujdesin që tregon në përgatitjen e punëtorëve të reja. Është gjë shumë e mirë kjo. Mësoji, mësoji!

Po drurin që përdorni për këta artikuj ku e merrni?

SHOKU KOÇO BERUKA: Ky dru që përdorim ne gjendet në Fushëbardhë.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe shportat që po shikoj janë shumë të bukura. Po me ndonjë ngjyrë nuk i bëni dot këto apo i duan kështu, të bardha?! Mirë, si t'i duan blerësit, ashtu bëjini!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kur kam ardhur këtu në vitin 1969 ishte vetëm një repart i vogël dhe nuk punonin më shumë se 20 apo 30 vajza. Sot këtu punojnë 1 400 punëtorë dhe, nga sa shihet, prodhimet që nxjerrin janë me të vërtetë të bukura.

SHOKU ENVER HOXHA: Ndërmarrja juaj është bërë një qendër me rëndësi të madhe ekonomike, sidomos për Gjirokastrën.

Jam shumë i gëzuar që shoh këtu vajza jo vetëm të qytetit, por edhe nga fshati, që punojnë e nxjerrin nga duart e tyre prodhime të dobishme për gratë e gjithë Shqipërisë. Gruaja, përveç të tjerave, dëshiron të ketë edhe një bluzë të mirë. Këto dëshira i di unë nga Nexhmija. Po edhe ne, burrat, tashti nuk jemi më konservatorë, na ka edukuar Partia dhe dëshirojmë që gratë tona, jo vetëm të punojnë e të prodhojnë, po edhe të vishen mirë. Çdo grua, pra, e do që ta ketë një fustan apo një bluzë të mirë, të punuar me shije, por, natyrisht, me shije të shëndoshë socialiste, jo të huaj, të degjeneruar. Ato le të jenë të thjeshta, po kjo nuk do të thotë që prodhimet që nxjerrim të mos jenë të bukura, me qëndizma gjithfarë nuancash të ndryshme. Ne jemi kundër formave e «zbukurimeve» ekstravagante që më shumë e shëmtojnë njeriun, sesa e zbukurojnë, prandaj ne nuk i duam të tilla prodhime. Nuk ka gjë më të bukur se thjeshtësia! Bukuria qëndron në thjeshtësinë, ashtu si trimëria në urtësinë. Ekstravaganca, fodullëku janë të huaja për ne dhe të dëmshme. Kush është ekstravagant e fodull, vjen koha dhe e thyen zverkun.

Ju, shoqe, siç jua thashë edhe pak më parë, nxirrni nga duart tuaja prodhime të mira, të thjeshta e të bukura; keni mbaruar shkollën dhe jeni të afta të drejtoni. Prandaj, si drejtuesit e ndërmarrjes, edhe ju, shokët e rrethit, përpiquni që këto shoqe t'i ngreni në përgjegjësi. Ja, shikoni shoqen Rashide Gjini, që ju e

kishit drejtoreshë! Tashti kjo është sekretare e komitetit të Partisë për problemet e agjitacionit dhe të propagandës. Edhe atje ajo përpiket dhe punon, nderon Partinë, nderon dhe gjithë punonjëset e ndërmarrjes suaj nga radhët e të cilave doli.

Gjirokastra sot ka ndryshuar shumë, si gjithë qytetet e vendit tonë. Më kujtohet njëherë kur erdhëm këtu pak vjet pas Çlirimit, se edhe unë kam ardhur në Gjirokastër në atë kohë, jo vetëm Nexhmija. Nexhmijen e solla atëherë «në të parë» këtu. *(Të qeshura.)* I ramë pazarit anembanë, por gjë s'gjetëm për të vënë në gojë. Kishte vështirësi në ato kohë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kur erdha për herë të parë pas Çlirimit, këtu, në Gjirokastër, isha vetëm. Ndenja atëherë nja katër ditë, mirëpo gjatë gjithë atyre ditëve ra shi, bënte ftohtë dhe ishte lagështi e madhe. Rrugicat nuk ishin rregulluar si sot, por ishin të mbushura plot me gurë, saqë ishte e vështirë të ecje se rrëshqisje. Kur u ktheva në Tiranë, më tha Enveri: «E, si t'u duk Gjirokastra?». «E si të më dukej, gurë monato», i thashë. «Si thua kështu për Gjirokastrën?! ma ktheu ai, ti nuk i njeh njerëzit, e kështu e ashtu.» «Po unë nuk të thashë gjë për njerëzit, iu përgjigja, por për gurët». Kur erdhëm pastaj në vitin 1969, Enveri më tha: «E shikon se si është bërë tani Gjirokastra?».

SHOKU ENVER HOXHA: Po kur erdhëm herën e dytë si t'u duk?!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Atëherë Gjirokastra ishte zbukuruar, çdo gjë në qytet kishte ndryshuar nga vitet e para pas Çlirimit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, ti këtu ke parë vetëm Gjirokastrën, Pogonin e Zagorien, por, po të shikosh Dropullin, Labërinë, Lunxhërinë e krahinat e tjera, do të habitesh fare. Nejtë, i ka parë burri yt, dhe unë s'të kam lënë gjë pa të molloisur. (*Të qeshura.*)

Para se të largohesha, desha t'ju thosha nja dy fjalë.

Jam shumë i gëzuar që erdha këtu, në ndërmarrjen tuaj. Ju uroj shëndet dhe suksese në punë! Të punoni në mënyrë të atillë që nga duart tuaja të nxirni gjithmonë prodhime me cilësi të lartë. Sa të jetë e mundur të përfitonit nga përvoja e mjeshtërive, të bëheni specialiste! Neve na duhen sa më shumë specialistë në të gjitha fushat. Industria jonë e lehtë në të ardhmen do të shtohet, sepse edhe populli ynë shtohet. Gjithashtu rriten kërkesat, se rritet edhe mirëqenia.

Tani, me keqardhje do t'ju lë, se na duhet të ikim. Qofshi mirë të gjitha! Të fala u bëni të gjitha punëtoreve!

Të rrojë Partia! Mirupafshim!

Pasi largohet pak më këmbë sheh aty afër një burrë dhe e pyet: «Ju, kush jeni?». «Jam vëllai i Niko Xharahut¹», përgjigjet ai.

O... , gëzohem shumë. Nikon e kam pasur kuzhinier, ishte i zoti, gatuante mirë. Po ti më dukesh se je më i ri nga ai.

Po ju kush jeni?

SHOKU MEHMET ELEZI: Jam Mehmet Elezi².

1. Leo Xharahu.

2. Në atë kohë gazetar.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , ju jeni Mehmet Elezi! I lexoj shkrimet e tua; ato më pëlqejnë. Shkruani mirë. Po ju?

SHOKU PAVLLO GJIDEDE: Jam Pavllo Gjidede¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe shkrimet e tua më pëlqejnë, shkruani mirë.

Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
kësaj vizite, që gjenden
në AQP*

1. Gazetar.

KARAKTERI KOMBËTAR UA RRI EDHE MË TEPËR VLERËN KULTURËS E ARTIT

*Nga biseda me disa kuadro kryesorë të rrethit
të Gjirokastrës*

18 mars 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Sot u kënaqa me shoqet punëtore në Ndërmarrjen e Veshjeve. Atje kishte shumë gra e vajza të reja, të cilat, natyrisht, nuk i njihja, por njihja mjaft nga prindërit e tyre. E ndjeva veten të lumtur që mora kontakt me njerëzit.

Në mbledhjen me ju kuadrot, sot në mëngjes, nuk u zgjata shumë, se shokët e tjerë udhëheqës kanë ardhur herë pas here këtu në Gjirokastrë dhe kanë folur me hollësi me ju për të gjitha problemet që na shqetësojnë. Unë nuk do t'i shtroja problemet më mirë nga shokët, prandaj nuk kisha pse t'ju lodhja më tepër. Mbledhjet ku rrihen probleme që na shqetësojnë, janë të mira, por duhet pasur parasysh që të mos bëhen të lodhshme e të mërzitshme. Sa të jetë e mundur të bëhen vetëm mbledhjet që janë të domosdoshme dhe të mos zgjaten shumë.

Sot i dëgjova me vëmendje shokët që folën, midis tyre kishte edhe kuadro të rinj.

Jam shumë i kënaqur që u takova me popullin. Gjatë rrugës për në lagjen Hazmurat, sido që grumbulli i njerëzve nuk të linte të ecje lirisht, prapë muhabetin me Malo Zeren e bëra. Te shtëpia e Abdi Zeres pashë Malon që po më avitej. «Po si je more Malo, e pyeta, si mbahesh?». «Mirë, m'u përgjigj Maloja dhe shtoi: Hajde brenda!». «Jo, i thashë, më mirë të rrimë këtu!», dhe u ula bashkë me të në sofat. «Qëndro sonte këtu te unë», m'u lut ai. «Po çfarë të bëjmë, i thashë, të rrimë në shtratin e Pumos e të pimë nga një gotë raki?». «Kështu ma do zemra», tha Maloja, i cili ishte mik me furrxhinjtë e me kasapët, që i siguronin mëlçi të zezë. Ai e vinte atë në skarë, e piqte mirë e mirë dhe pastaj e përdorte si meze me një gotë raki.

Maloja është në moshën time. Kur ishim të vegjël luanim bashkë. Këtu pranë ishte një përrua, ku ne bënim «luftë». Ata, më të rriturit, i kishim komandantë, kurse ne, më të vegjlit, ishim ushtarë. Mbaj mend që një herë unë dhe Maloja, në të kthyer, u futëm në bodrumin e teto Bedullës. «O teto Bedullë, a na bën një kafe», i thamë ne. «Po pse more t'ju bëj kafe, ku ju kisha?», na e ktheu ajo. «Në luftë!», i thashë unë. «Shkoni ore, largojuni këtej», na thirri teto Bedulla.

Nganjëherë bënim edhe prapësira, që m'i kujtoi Maloja sot. Në atë kohë luanim edhe me barut. Kështu vazhduam derisa u mësuam të bënim më vonë luftën e vërtetë, e cila ishte një fitore e madhe për ne se i qëruam një herë e mirë armiqtë.

Përmeti me siguri është zbukuruar më shumë, shoku Qemal¹ që nga koha kur unë kam qenë atje me rastin e 25-vjetorit të Kongresit të Përmetit, në vitin 1969. Përmeti është një qytet historik.

Do të dëshiroja të vija në Përmet vitin e ardhshëm, që është 35-vjetori i Kongresit po nuk di a do të kem mundësi.

Të pimë për shëndetin e Partisë! Për shëndetin tuaj! Të na rrojë Partia! Të rroni ju! Gëzuar të gjithëve!

Gëzuar Sano! Sanoja ka ardhur më shpesh këtu, ajo është tamam gjirokastrite.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Sanoja ka ardhur gjithnjë në Gjirokastrë për të parë festivalet folklorike.

SHOKU ENVER HOXHA: Besoj se edhe festivali i sivjetëm do të bëhet në Gjirokastrë dhe do të jetë i bukur.

SHOKU RESUL ZANI: Këtu do t'i bëjmë ngaherë festivalet folklorike. Edhe shokët janë dakord që të bëhen vazhdimisht këtu.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur duan të gjithë shokët edhe unë nuk kam kundërshtim. Mirëpo njerëzit mua më shkruajnë letra e më qahen pse të bëhen gjithnjë festivalet në Gjirokastrë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të gjitha qytetet tona kanë diçka karakteristike nga historia. Vlora, për shembull, ka shpalljen e Pavarësisë; Beratit shpalljen e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë e kështu me radhë.

1. Qemal Bregasi.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, secili qytet ka diçka karakteristike nga historia. Sidoqoftë rëndësi të madhe ka vetë folklori dhe jo vendi ku bëhet një manifestim i tillë. Partia e ngriti artin popullor në një shkallë të paparë. Disave u dukej çudi e madhe që këndoheshin kaq shumë kënga popullore. Nuk e kam fjalën vetëm për armikun Fadil Paçrami, por edhe për disa të tjerë që nuk ishin të tillë e megjithatë thoshin: «Opera të këndojmë, se ato janë klasike». Natyrisht, unë nuk e nënvleftësoj këtë gjini të lartë muzikore dhe autorët e operave, si kompozitorët Bize, Verdi ose Maskanji; përkundrazi, i çmoj, prandaj nuk them të mos këndohen operat e tyre, por duhet të kemi parasysh edhe nivelin kulturor e artistik të të gjithëve në këtë drejtim. Është fakt që operat nuk kuptohen nga të gjithë, kurse këngën popullore labçe, myzeqare apo e çdo krahine qoftë ajo, e kuptojnë të tërë, sepse e kanë të tyren dhe e ndiejnë. Që të kuptosh një opera të një kompozitori si këta që përmenda, duhet të kesh njëfarë kulture. Unë kam lexuar «Bohemën», një libër i shkruar bukur, prandaj dhe «Bohema» është një nga operat që më pëlqen ta shikoj më tepër.

Që të të pëlqejë një muzikë e huaj, duhet të njohësh dhe të kuptosh edhe përmbajtjen e saj. Po të dëgjosh Bahun, për shembull, duket që muzika e tij bie erë misticizmi e feje. Bahu është një kompozitor gjerman që ka kompozuar kuartete, pjesë muzikore për katër zëra, por ai ka kompozuar edhe duete, për dy zëra. Po ta dëgjosh me kujdes muzikën e tij, do të shikosh se ajo i ruan karakteristikat e muzikës popullore gjermane. Ose të marrim Bizenë. Në librin «Arleziانا», në bazë

të të cilit është kompozuar opera me të njëjtin titull, flitet për një vajzë që dashuron një djalë. Meqenëse familja e saj nuk deshi t'ia jepte vajzën këtij djali, ky hidhërohet aq shumë, sa hipën në një vend të lartë prej nga hidhet poshtë dhe vdes. Përmbajtja e librit në fjalë mua më duket e thjeshtë; edhe muzika e kompozuar sipas subjektit të tij për mua është e kuptueshme. Pse? Së pari, sepse atë libër unë e kam lexuar në frëngjisht. Autori i tij është një nga shkrimtarët e mëdhenj francezë¹. Së dyti, sepse kam studiuar në Francë, tamam në ato anë për të cilat bëhet fjalë në vepër, në Montpellier etj. dhe i kam parë ato fusha, kullota, ferma dhe natyrën e atyre anëve në përgjithësi. Ata që nuk e njohin përmbajtjen e librit e kanë të vështirë ta kuptojnë dhe ta ndiejnë «Arlezianën».

Tefta Tashkoja më thoshte gjithnjë kur këndonte: «Si të duket kjo këngë?». «Kënga jote është e bukur, moj Teftë, i thosha unë, por këngët tona më pëlqejnë më tepër.»

Këngët popullore tashti këndohen në masë. Në fillim, natyrisht, nuk kishim vegla muzikore të mjaftueshme, nuk kishim curle e të tjera, por tashti kemi ecur përpara dhe i kemi të gjitha.

Këngët që këndojmë ne janë të popullit tonë, shprehin ndjenjat e pastra të tij: shpresat, gëzimin, guximin, hidhërimin, urrejtjen e ndjenja të tjera. Ata që i kanë ekzekutuar në skenë pjesët tona muzikore, i kanë dhënë të bukura dhe harmonioze. Kur i kemi parë,

1. Opera «Arleziana» e Zh. Bizesë është ndërtuar sipas një vepre të shkrimtarit Alfons Dode.

ndonjëherë kemi vënë re se kanë bërë dhe ca ndryshime në kostumet.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Në disa raste kanë bërë ndryshime të tepëruara në veshje, gjë që nuk është e drejtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk duhen bërë ndryshime pa vend. Disa gjëra duhen ndrequr, sepse ashtu si zhvillohet vetë jeta jonë edhe muzika popullore ecën përpara. Por ka edhe gjëra që duhet të ruhen siç kanë qenë.

Kaq të bukura janë këngët, vallet dhe kostumet tona popullore, saqë, kudo ku kanë vajtur ansamblet tona kanë lënë përshtypje shumë të mira. Të mos flasim për festivalin e Dizhonit ku ne fituam çmimin e parë, por edhe për koncertet e artistëve tanë në shtete të tjera. Kudo suksesi ka qenë shumë i madh. Në Turqi këngët dhe vallet tona kanë lënë përshtypje të mira. Edhe në Kosovë, gjithashtu, është pëlqyer interpretimi i këngëtarëve dhe i valltarëve tanë popullorë. Kur kanë shkuar ansamblet tona në Kosovë, njerëzit e shumtë nuk gjenin bileta të hynin në shfaqje, edhe se autoritetet ua kishin shpërndarë ftesat njerëzve të tyre. Popullit ata gati nuk i shitën fare bileta. Megjithatë, ata të paktë që i panë e i dëgjuan atje koncertet tona, duartrokitën, sigurisht një çikë me tertip, përpara një arti kaq të bukur.

Nuk e di, në qoftë se i patë të xhiruara në film koncertet e ansambllit tonë në Suedi, por çdo gjë atje dukej e bukur. Gazetat suedeze shkruanin: «Valltarët shqiptarë janë të lehtë si penda, por toka dridhet nën këmbët e tyre». Sa bukur e në mënyrë poetike i kanë

shprehur aftësitë e valltarëve tanë gazetarët e huaj! Këto vlerësime të të huajve na inkurajojnë shumë.

Përshtypje jashtëzakonisht të mira ka lënë, gjithashtu, ansambli ynë në Greqi. Kjo tregon për nivelin e lartë artistik të këngëve e të valleve tona popullore. Ndjenjat që shpreheshin gjatë interpretimit, kostumet, teknika etj. të gjitha këto lanë edhe atje mbresa të thella te njerëzit.

Po të shikojmë marrëdhëniet tona me Greqinë mund të themi se këto janë duke u zhvilluar në një atmosferë të favorshme. Qeveritarët grekë po tregohen dashamirë me ne. Ndjenjat e miqësisë së popullit grek për popullin tonë dhe të popullit tonë për popullin grek kanë krijuar kushte për shkëmbime normale ekonomike e kulturore midis dy vendeve tona.

Populli ndien kënaqësi të madhe kur shikon veten e tij në skenë; ai gëzon kur ndjenjat e tij kaq të pastra, të holla, të gjalla e fisnike janë ngritur kaq bukur në art dhe interpretohen me mjeshtëri. Populli ynë, arti dhe kultura e tij e bukur njihen dhe respektohen jashtë, ku një tok gazetash të specializuara kanë folur me shumë dashamirësi e simpati për Partinë tonë. Kjo gjë ne na gëzon e na bën krenarë. Por, në të njëjtën kohë, kjo shtron edhe detyrën para punonjësve tanë të kulturës e të artit që folklori ynë të ecë gjithmonë përpara, të zhvillohet, duke ruajtur fort kombëtarën në këngë, në valle e në veshje. Një gjë e tillë e rrit edhe më tepër vlerën e folklorit tonë.

Muzika e bukur është një ushqim i këndshëm shpirtëror. Ka të huaj, për shembull, si kompozitori i famshëm List, që u shqua sidomos kur kompozoi rap-

soditë hungareze, në të cilat ngriti në art vallet e popullit hungarez e ato të ciganëve. Muzika e Listit dëgjohet me kënaqësi nga të gjithë, se shpreh hovin shpirtëror të popullit. Por njerëzit ndiejnë neveri të madhe për muzikën e çakërdisur «pop», «hulahup» etj. Në shumë vende kapitaliste, muzika ka pasur një zhvillim të madh, por tani ka rënë. Italianët, për shembull, kanë genë të famshëm për operat, por muzika e tyre sot është larguar nga tradita. Verdi, që ishte kundër pushimit austro-hungarez etj., pëlqehet, sepse në operat e kompozuar prej tij ka frymëzim; në to pasqyrohet me të vërtetë shpirti liridashës i popullit kundër okupatorit, prandaj ato luhen me sukses në shumë skena të botës edhe sot e kësaj dite. Nëse këngët, muzika apo vallet janë ose jo të mira, është populli ai që thotë fjalën e tij me objektivitet dhe bën vlerësimin e duhur.

Po të lexosh letërsinë botërore mëson se kudo ka pasur shumë shkrimtarë. Por ka pasur shkrimtarë e shkrimtarë. Personalisht kam lexuar libra që vënë në dukje zhvillimin e letërsisë franceze të shekujve të 16-të, të 17-të, të 18-të, të 19-të dhe të 20-të. Gjatë kësaj kohe prej afër pesë shekujsh kanë dalë shkrimtarë të shumtë, por disave prej tyre sot nuk u gjendet asnjë libër në qarkullim dhe nuk përmenden fare, janë zhdukur në thellësitë e shekujve. Por ka shkrimtarë të tillë si: Molieri, Volteri, Rusoi, Dideroi e mjaft të tjerë që shekujt nuk i kanë hedhur dot në harresë. Këta kanë mbetur të paharruar, se ishin të tillë filozofë, shkrimtarë e mendimtarë që me idetë e tyre të mëdha ndihmuan të shëmbej një epokë dhe të përgatitej një tjetër më e përparuar. Shumë nga ju mund të keni le-

xuar ose të keni parë në film disa nga veprat e Balzaku, që arrijnë në 120 vëllime. Nexhmija dhe unë i kemi lexuar të gjitha. Balzaku e ka paraqitur lakuriqë e të pangopur borgjezinë e madhe, me të gjitha njollat dhe poshtërsitë e saj. Cilido që dëshiron të njohë me të vërtetë këtë degjenerim, le të lexojë këtë letërsi. Ajo mbetet e pavdekshme. Marksi thoshte se i mbante nën jastëk veprat e këtij shkrimtari të madh. Borgjezia franceze e kësaj periudhe ishte aq e poshtër, sa të gjithë njerëzit më dallkawkë dhe pa vlerë i bëri anëtarë të Akademisë, kurse kolosë të tillë si: Balzaku, Volteri, Molieri e të tjerë nuk i pranoi në Akademi.

Një ditë lexoja një kritikë që ishte bërë për arsye se Balzakun nuk e kishin pasë zgjedhur anëtar të Akademisë, e cila, që kur ishte krijuar, në shekullin e 16-të, kishte vetëm 40 kolltuqe, pra 40 vende. «Borgjezët nuk i kishin dhënë një kolltuk Balzaku, thoshte kritika, megjithatë ai e ka siguruar atë vetë, kolltukun e përhershëm të 41-të. Në çdo vit shkojmë e përulemi me respekt përpara tij, prandaj ai nuk ka aspak nevojë ta ketë kolltukun në një ndër ata të 40-të që ka Akademia».

Të gjitha këto jua them për të treguar se si i kanë vlerësuar klasat sunduese njerëzit e shquar, artin dhe kulturën, si dhe për të treguar punën e madhe që ka bërë Partia te ne për të zhvilluar artin dhe kulturën e popullit tonë. Kjo kulturë është e pasur, por dhe e lashtë; prandaj atë duhet ta zbulojmë jo vetëm në fushën arkeologjike, por edhe në aspektin shpirtëror e në drejtime të tjera. Ne jemi në realizim të kësaj dotyre

dhe kemi akoma shumë për të bërë. Borgjezia te ne nuk e çante kokën në këtë drejtim.

Të tërë kemi mësuar në shkollë për Hoxhë Tahsinin, por asgjë nuk na ishte thënë nga ato çka dimë tani për të, si rezultat i punës së mirë të njerëzve tanë që kanë kryer studime të dokumenteve historike, të cilat bëjnë fjalë për figurën e këtij savanti dhe patrioti të shquar. Nga shkolla e vjetër ne nuk kemi mësuar se Hasan Tahsini, i lindur në katundin Ninat të rrethit të Sarandës ishte një omnisien, që zotëronte dije për shumë shkenca, duke filluar që nga filozofia, astronomia etj. Ai kishte njohuri nga të tëra shkencat. Ky njeri arriti të bëhej profesor dhe rektor i Universitetit të Stambollit, një nga universitetet kryesore të botës myslimane të asaj kohe, pas të cilit vinte ai i Damaskut e pastaj i Kajros.

Kultura arabe, ashtu si kultura helenike, ishte një kulturë e gjerë, e cila ka shkëlqyer në lashtësi. Kultura arabe është shquar jashtëzakonisht në filozofi, në skulpturë, në astronomi e në medicinë. Më i madhi mjek i mesjetës së hershme dhe të asaj më vonë ka qenë Ibn-Sina ose, siç e quajtnë latinët, Avicena. Ky ishte edhe filozof e enciklopedist i shquar. Ai mbronte tezën se materia është e përjetshme, por besonte në zotin. Sami Frashëri ynë ka qenë, gjithashtu, një dijetar i madh, që ka shkruar të vetmen enciklopedi turke. Ai ka qenë filozof dhe historian, i frymëzuar nga iluministët, por edhe nga filozofia e arabëve dhe e persianëve. Por edhe Hoxha Tahsini ka qenë një filozof i madh si Samiu.

Tani që kanë mbaruar shkoillat me qindra të rinj e të reja, janë zbuluar të dhëna që të parët i kanë pasë

mbyllur në papafingo dhe i kanë lënë atje brez pas brezi. Prandaj, shokë, është e domosdoshme që të gjitha dokumentet të shikohen me kujdes për të nxjerrë prej tyre konkluzione me vlerë për figura e fakte që akoma s'njihën mirë.

Sot Partia dhe Qeveria po përgatitin kuadro për të gjithë sektorët e ekonomisë, të kulturës etj. Këta po specializohen dhe punojnë me pasion në degët e tyre. Partia do të vazhdojë t'i nxitë të gjithë këta që të mësojnë sa më shumë, se, kur i kemi kuadrot me shumicë, atëherë mund të bëjmë edhe specializimin e tyre.

Njerëzit tanë kanë bërë një punë të mirë e shumë të lavdërueshme për grumbullimin e folklorit. Instituti i Folklorit ka bërë klasifikimin e materialit, studimin e tij etj. Duke filluar që nga fëmijët tanë, ne duhet t'i nxitim që të qëmtojnë në thesarin e madh të popullit e të nxjerrin në dritë zakonet, ritet, këngët, përrallat, proverbat etj. që nuk janë mbledhur akoma, por që kanë shumë vlerë. Tani për këtë punë po specializohen edhe kuadro, por kjo nuk mjafton. Duhon aktivizuar të tërë. Populli në këngët e vallet e ndryshme ka shprehur ndjenjat e tij të gëzimit, të kënaqësisë, të hidhërimit, të dashurisë dhe të urrejtjes. Shumica e këtyre njihen, por ka edhe që nuk njihen akoma, prandaj duhen qëmtuar. Ai i ka kënduar dashurisë së pastër të vajzës apo të djalit, dashurisë për tokën dhe për familjen, por ka kënduar me urrejtje edhe për armikun e keqbërësin, ka treguar se si beu dhe agai i kanë rrjepur lëkurën e të tjera e të tjera. Tash kultura jonë e do që njohuritë të hidhen në letër e të botohen. Të

gjithë specialistët e ndryshëm duhet të merren me këto çështje, të lexojnë monografitë dhe botimet që dalin në dritë.

Homeri i përgatiti veprat e tij, «Iliadën» dhe «Odisenë», duke mbledhur ato gojëdhëna popullore ku u këndoheshin trimërive të fiseve të vjetër të peloponezasve dhe akeasve, duke treguar se si ata kaluan në Trojë, rrëmbyen atje Helenën e bukur, si u zhvilluan të tëra ato luftëra e të tjera. E gjithë vepra e tij përbën një epike madhështore. Në ato studime që kemi parë, duket se Homeri këndoi këngët e vjershat që këndoheshin nga populli. Disa thonë që Homeri nuk ka ekzistuar, por e vërteta është se ai ka ekzistuar dhe ka jetuar në ishullin e Kios dhe është autori i «Iliadës» dhe i «Odisesës». Në to bëhet fjalë për gjithë ato luftëra, për dijet e mëdha, për pikëpamjet e heronjve, të mitologjisë e të perëndive të bukurisë, të tregtisë, të gjuetisë, të luftës, siç ishin, Afërdita, Zeusi e të tjerë. Pra këto vepra pasqyrojnë kulturën helenike.

Sot dhe «etërit» e mëdhenj të kulturës sonë duhet t'u futen më thellë studimeve të kulturës në këtë drejtim, se forca kemi. Për këtë duhen shfrytëzuar sidomos «brigadat» e arsimtarëve që punojnë kudo. Këta të aktivizohen që t'i gërmojnë këto gjëra, t'i studiojnë dhe t'i hedhin në kartë. Kjo ka rëndësi të madhe për ne dhe duhet bërë, siç e kanë bërë edhe të tjerët, prandaj le të përfitojmë nga eksperiencia e tyre. Kultura e popullit duhet të përdoret edhe në kompozimet që bëhen, por ama, duke ruajtur tiparet e vërteta popullore të saj. Këto janë çështje të shumanshme dhe duhet të kihen parasysh.

Këtu, në Gjirokastrë, ka disa njerëz që u vihen me zell këtyre punëve. Lefter Diloja, për shembull, është një kërkues i pasionuar e realizues. Ju mos vështroni se çfarë thonë disa burokratë, që nuk kanë vullnet të angazhohen vetë në punë dhe japin porosi: «Materialet e zbuluara na i dërgoni neve». Dhe, pasi i hedhin në dorë, thonë: «Nuk ia vlen të botohen».

Mua më pëlqejnë shkrimet me kulturë të Pano Çukës¹, që është një njeri i ditur. Ne i njohim ato ngjarje e vende për të cilat shkruan Panoja, se i kemi jetuar. Kur shkruan ai, për shembull, për priftërinjtë e Dropullit e të Stegopullit, ne shikojmë në to realitetin ateist, prandaj shkrimet e Panos janë të bukura dhe lexohen me kënaqësi.

Këtu në Gjirokastrë ka pasë jetuar një plak i quajtur mulla Hodo, që vetë nuk e kam arritur, por disa vjersha me thumba të tij i kam dëgjuar. Ai të gjithë bejlerëve u ngrinte nga një bejte. Kur rronte doktor [Omer] Nishani më këndonte bejte nga ato të mulla Hodos. Por sa ka si ky? Këto duhen kërkuar e gjetur dhe në këtë drejtim duhet të ndihmojmë të gjithë.

Shqiptarët janë trima, por edhe grekët trima janë. Edhe ata kanë humor të këndshëm. Besoj se në Dropull ka pasur njerëz me humor therës, por duhet gërmuar që edhe këta të zbulohen e të njihen.

Në Vlorë, për shembull, ka qenë Musa Selimi, që ka shkruar histori në vargje. Këtu në Gjirokastrë ka qenë një vjershëtar i verbër, i quajtur Vehip. Unë e kam njohur atë, se më dërgonte aneja t'i çoja nga një

1. Shkrimtar minoritar.

tas me trahana. Kur kthehesha me pushimet e shkollës nga Liceu i Korçës ose nga Franca, gjithnjë shkoja dhe e takoja xha Vehipin e shkretë. Nga zëri më dallonte menjëherë që isha unë dhe më thoshte: «Paske ardhur, Enver?». «Po», i thosha dhe i lutesha të më bënte ndonjë vjershë. «Po për kë do që të të bëj vjershë?», më pyeste ai. «Më bëj një për Robespierin», i thosha unë. «Po ç'ishte ky Robespieri», më pyeste ai përsëri.

Dhe, kur unë i tregoja se kush ishte, xha Vehipi, në çast, bënte një vjershë për Robespierin, për Sen-Zhystin ose për ndonjë tjetër. Këto vjersha, natyrisht jo të gjitha, i kam të shkruara, se më pëlqenin.

Nexhmija po lexon tashti një libër të një shkrimtari turk. Ky është mësues dhe tregon për jetën që bëhej në vitet 50-të në fshatrat e Anadollit. Ai e ka shkruar aq bukur këtë libër, sa, kur e lexon, ndien një dhembshuri të madhe e kujton vuajtjet e popullit tonë në të kaluarën.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Albanologët, që kanë ardhur këtu, kanë shkruar gjëra interesante për Shqipërinë. Edhe të tjerët që vizitojnë vendin tonë shkruajnë. Pas disa vjetësh, kur t'i lexojmë këto shkrime, do të na duken prapë mjaft interesante.

SHOKU ENVER HOXHA: Drejt e ka Nexhmija, duhet treguar kujdes për shkrimet e të huajve që kanë qenë këtu më parë ose që e vizitojnë sot Shqipërinë, sepse ata kanë shkruar gjëra interesante. Ato duhet të ruhen se kanë rëndësi edhe nga pikëpamja e zhvillimit të një vendi, se pasqyrojnë si ka ecur populli përpara, transformimet që janë bërë në jetën shoqërore dhe

ekonomike të tij si dhe çfarë ndryshimesh të tjera do të bëhen në të ardhmen.

Djemtë e vajzat, nipërit dhe mbesat, stërnipërit dhe stërmbesat tona, që do të rrojnë në një Shqipëri jashtëzakonisht të lulëzuar, duhet të njihen me periudhën kur kanë jetuar prindërit e gjyshërit e tyre dhe të mos harrojnë bazën nga jemi nisur. Këto duhet t'i dinë mirë edhe njerëzit tanë që t'i kuptojnë dhe të përpiqen pa u lodhur për një të ardhme gjithmonë e më të lumtur për popullin dhe jo si disa të rinj që nuk punojnë e nuk sillen sipas normave të shoqërisë sonë socialiste. Na vjen keq kur shikojmë në statistikat tona të kriminalistikës njerëz të moshave të reja. Këta të rinj të implikuar në akte rrugaçërie janë djemtë tanë. Pse implikohen disa prej tyre në krime? Sepse puna politike që bëhet me ta nuk është e shëndoshë dhe se nga ana e prindërve ka shfaqje indiferentizmi për edukimin e fëmijëve. Nëna e babai tani rrojnë mirë, se kanë nga tri-katër rroga në shtëpi; kështu që të rinjtë janë të çliruar nga obligimet ekonomike në familje. «Punë e madhe nëse e theva disiplinën, mendon me mendjelehtësi një i ri i paedukuar mirë; sot nuk do të vete në punë, as nesër; detyrime nuk kam as për nënën, as për babanë, prandaj le të marr njëqind lekë më pak; kjo nuk më prish asnjë punë». Të tillë të rinj që mendojnë kështu, vërtet nuk e ndiejnë dëmtimin material, por ama prishin ndërgjegjen e tyre, gjë që u kushton tërë jetën.

Për fenomenet, ngjarjet dhe proceset shoqërore ka rëndësi të madhe të shkruhet mirë, bukur e thjeshtë. Të studiohen shfaqjet e ndryshme në jetë, në rrjedhën

e madhe të socializmit, në përpjekjet që bëhen për të pastruar rrugën nga «ferrat» e nga «gurët», në luftën që zhvillohet për të hedhur poshtë shantazhet e për të hapur horizonte. Në këtë drejtim rëndësi të veçantë ka përhapja e kulturës dhe e artit, sepse këto zhvillojnë shpirtin e njerëzve, ngjallin optimizmin, kurajën dhe besimin në vijën e Partisë.

Kultura dhe arti ynë socialist nuk vuajnë as nga ksenofobia dhe as nga ksenomania, përkundrazi, populli ynë njih dhe admiron kulturën botërore përparimtare. Kurse edhe heqësit kinezë mendonin ndryshe për këtë problem, si dhe për shumë të tjera që ne i kemi përmendur edhe më parë, duke mbajtur një qëndrim përbuzës ndaj kulturave të tjera. «Kultura jonë, thoshin ata, qëndron mbi të gjitha; ajo qëndron më lart se të tjerat si malet e Himalajës». Çështja nuk është vetëm që kinezët kanë dënuar Bethovenin. Ky fakt mund të mos ketë shumë rëndësi, po ta marrim të shkëputur, dhe të mos shohim cili ka qenë ky kompozitor. Bethoveni jetoi në kohën e Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez dhe të luftërave të Napoleonit. Në këto vite ai arriti edhe kulmin e krijimtarisë së tij. Ai ishte një kompozitor dhe revolucionar.

Nuk ishte «katërshja sektare» ajo që mori vendim që në Kinë të braktiset kultura përparimtare botërore. Jo, ky qëndrim është rrjedhim i koncepteve të Mao Ce Dunit, i cili flet me simpati për perandorët e perandoreshat kineze dhe për kulturën e lashtë të kohës së tyre dhe injoron kulturën e madhe të njerëzimit. Historia njih popuj e kultura dhe më të lashta e më të mëdha se të Kinës, por atje as i përmendin fare këto. Fobia

për gjithçka të huaj nuk tregon aspak shpirtin internacionalist të Partisë Kineze të ashtuquajtur marksiste-leniniste.

Iluministët francezë kanë qenë njerëz të shquar, por kanë pasur edhe pika të dobëta. Një ndër ta ka qenë Rusoi, i cili ka trajtuar probleme të natyrës, të shoqërisë, të fshatarësisë e të lirisë. Vepra e tij përshkohet nga ide iluministe, por ai është kundër arsimit të gruas. Po të lexosh «Emilin» e Rusoit, do të shikosh se ai ka pikëpamjen që gruaja duhet të rrijë në shtëpi, të lajë rrobat, të kujdeset për rritjen e fëmijëve dhe të merret me punë të kësaj natyre. Edhe në shkrimet e Dideroit, që ishte iluminist dhe një nga autorët e organizatorët e Enciklopedisë Franceze, është shprehur diskriminimi ndaj grave. Robespieri, gjithashtu, ishte kundër grave, por ky kishte të tjera gjëra të mira. Si duhet të bëjmë pra, për vlerësimin e këtyre figurave të mëdha historike, t'i hedhim në kosh? Jo, marksizëm-leninizmi vlerësimin e veprimtarisë së njerëzve e shikon në mënyrë të gjithanshme, dialektike, me të mirat dhe me të ligat që kanë, duke marrë atë që është e mirë dhe duke kritikuar atë që është e keqe.

Në mitologjinë greke flitet për «hauret e Avgjisë», të cilat ishin bërë aq pis nga plehu i bagëtive, sa nuk kishte mundësi të pastroheshin ndryshe, veçse duke u lëshuar ujët e lumit, i cili i rrëmbeu të gjitha papastërtitë. Marksizëm-leninizmi është një shkencë që ka aq shumë fuqi saqë me «fshesën» e tij i «pastron» të gjitha «plehrat» dhe mban e ngre lart të mirat që u vlejné progresit, shoqërisë socialiste.

Te kinezët nuk e kemi parë një qëndrim të tillë.

Ata kalojnë në anën e kundërt: përçmojnë popujt e tjerë dhe kulturën e tyre. Që të bëhen superfuqi, duan ta kenë mirë me imperializmin amerikan, duan të shtien në dorë teknikën dhe teknologjinë e tij. Kinezët mendojnë kështu: «Një ditë ne do të bëhemi fuqi e madhe në botë, se në çdo katër-pesë njerëz mbi tokë njëri është kinez». Prandaj atyre u duket çudi se si guxojnë shqiptarët të mos jenë dakord me teoritë e tyre. Ata gjykojnë kështu si imperialistë, si shovinistë, si fuqi e madhe dhe nuk e kuptojnë se Shqipëria është një shtet i lirë, sovran dhe i pavarur, që ka autoritetin e vet dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste me eksperiencë, e cila nuk u është nënshtruar kurrë presioneve e shantazheve të huaja.

Në politikën kineze, shokë, vërehet një kthesë e madhe nga e djathta. Udhëheqësit kinezë po bëjnë traktativa të maskuara dhe të pamaskuara me të gjitha vendet kapitaliste për të marrë kredi, duke filluar që nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e deri te fuqitë e tjera imperialiste. Të gjitha këto shtete imperialiste janë të interesuara t'i shesin Kinës sa më shumë mallra, se në Kinë ka një treg të madh. Por, me gjithë këto «ndihma» të imperialistëve, nuk do të realizohet dot çndrra e Çu En Lait për ta bërë Kinën një shtet të zhvilluar e me ekonomi moderne deri në fund të shekullit. Imperialistët «do ta ndihmojnë» Kinën deri në atë masë sa ajo të mos bëhet e rrezikshme për ta dhe për interesat e tyre. Kina ka hyrë dhe po ecën në rrugën kapitaliste. Ajo dëshiron të mbretërojë në grumbullin e «ujqve», duke e quajtur veten socialiste e duke u përpjekur të gënjejë popujt dhe marksistët për

të shuar revolucionin në botë. Udhëheqësit kinezë po hedhin formula sa të duash për të treguar se gjoja luftojnë për paqe e të tjera dokrra si këto, por marksistët e vërtetë dhe popujt përparimtarë nuk do të bien në grackën e tyre.

Skandale po shikohen në të gjitha shtetet kapitaliste e revizioniste. Skandale vërtetohen edhe në marrëdhëniet e të ashtuquajturave shoqëri shumëkombëshe. Kështu, për shembull, veprojnë shtetet kapitaliste në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Ata thonë: «Ti, Jugosllavi, je në një shoqëri me ne dhe, sipas marrëveshjes që kemi, 49 për qind të kapitaleve të investuara në ekonominë tënde janë tonat, kurse 51 për qind janë të tuat. Gjatë kësaj kohe ti detyrohesh karshi nesh pesë, gjashtë apo shtatë herë për kreditë që ke marrë, prandaj edhe të ardhurat e tua duhet të na vijjnë neve, se na takojnë në bazë të marrëveshjeve që mbron shteti yt, ushtria jote». Këto borxhe herë jepen nga vendet kapitaliste, herë nga shoqëri të mëdha, nga trustet, tamam ashtu siç i kanë parashikuar ato Marksi dhe Lenini kur kanë trajtuar rendin kapitalist dhe imperializmin. Skandale si ato të Lokhidit, marrja e rryshfeteve nga firma të mëdha kapitaliste për avionët etj., vërtetohen kudo e vazhdimisht në vendet e ndryshme borgjezo-revizioniste. Të gjitha këto kredi e «ndihma», kushdo që i jep dhe në çdo formë që merren, janë në favor të borgjezisë dhe të shteteve kapitaliste. Janë trustet e mëdha që u imponohen qeverive për të dhënë leje për furnizimin e këtij ose atij shteti me aq ose kaq avionë, topa, luftanije etj., etj. Përqindjen më të madhe të të ardhurave të ekonomisë ame-

rikane e futin në xhepat e tyre milionerët dhe miliarderët si Rokfeleri e të tjerë, siç bëjnë në Angli Armstrongu me shokë.

Kina kërkon të marrë nga Perëndimi teknologjinë e prodhimit të armëve për të pajisur ushtrinë e saj dhe për ta bërë atë të fortë, por kjo nuk mjafton, se për një ushtri moderne duhen të gjitha: jo vetëm armët, por edhe pajisjet e prapavijës.

Prandaj ju, shokë të sektorit të prapavijës, duhet të keni parasysh se edhe neve na duhen për kohë të keqe sheqeri, vaji, mielli e kështu me radhë. Në rast lufte të gjithë ne do të jemi ushtarë të veshur me uniformë. Prandaj, në punën e përditshme të mendojmë për ndërtimin e socializmit, për problemet ekonomike, por edhe për mbrojtjen e atdheut. Ne jemi të fortë politikisht, ideologjikisht e ushtarakisht, por Partia punon që të bëhemi akoma më të fortë. Se jemi të fortë, prandaj na respektojnë e na duan miqtë, ndryshe nuk do të na respektonin kaq shumë. Por për këtë arsye nuk na prekin dot edhe armiqtë.

Titistët e kanë shitur vendin e tyre tek të gjithë. Morëm vesh që gjashtë anije lufte amerikane kaluan këto ditë në Kotorr. Me t'u dukur anija e parë e huaj në Detin Jon, dolën menjëherë katër katerat tanë dhe komandanti amerikan i anijeve u detyrua të urdhërojë ndërrimin e kursit deri në tre milje në drejtim të Italisë. Ai e ktheu kursin, se e di mirë që ne, shqiptarët, nuk ta përtojmë, po të na shkelësh kufirin, se nuk e durojmë shkeljen e sovranitetit dhe, po na u futën në ujërat tona arbitrarisht, i godasim menjëherë.

Ne duhet të jemi të fortë, shokë, dhe fakt është

se jemi të fortë, sidomos tani që i qëruam gjembat që kishim brenda vendit. Prapë duhet me qenë vigjilentë vazhdimisht. Por ne do të jemi edhe më të fortë, kur në të gjithë sektorët e ekonomisë, të luftohet frontalisht për realizimin e tejkalimin e planeve.

SHOKU SPIRO LENGU: Ne, shoku Enver, i kemi kurdoherë parasysh porosinë tuaja dhe kemi punuar me njerëzit që kanë ardhur nga jashtë në Shqipëri për të parë të afërmit e tyre, sepse bëhet propagandë e kundërt me realitetin në Shqipëri. Mjafton të them se aq sa prodhonte më parë gjithë rrethi ynë, sot prodhon vetëm një kooperativë bujqësore e tipit të lartë.

SHOKU ENVER HOXHA: Vetë realiteti dhe puna jonë bëjnë efekt të madh në botë, si tek ata që na duan, ashtu edhe tek ata që nuk na duan. Do t'ju tregoj një rast që më ka ndodhur mua njëherë kur vizitova Minierën e Mborje-Drenovës në rrethin e Korçës. Kur po kthehesha nga miniera, populli më kishte dalë përpara. Atëherë zbrita nga makina dhe si u takova me njerëzit fillova t'u flas. Në mes tyre pashë dy burra që mbanin syze me rrathë të verdhë. Ata kishin tiparet e njerëzve që vijnë nga Amerika. Ju e dini që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë populluar me njerëz që kanë vajtur atje nga vende të ndryshme të botës, kurse autoktonët ose i kanë zhdukur, ose i kanë asimiluar duke u imponuar kulturën e huaj.

Gjatë bisedës me të pranishmit, herë pas here u hidhja nga një sy atyre dhe thosha me mendje: «Nga Amerika do të kenë ardhur edhe këta?». Në bisedë me popullin theksova sukseset që kishte arritur vendi ynë dhe përmenda se jashtë thonë sikur këtu, te ne, ka urë,

vuajtje, shtypje, sikur të vjedhin, të vrasin e ç'nuk të bëjnë.

Njëri prej tyre më thotë: «Me leje, zoti Enver, a mund të them edhe unë nja dy fjalë?». «Posi jo, iu përgjigja, këtu te ne ka demokraci, mund të flasë kush të dojë». «Keni folur shumë drejt, zoti Enver, tamam sikur keni qenë atje dhe i keni dëgjuar vetë, nisi të tregojë ai. Kështu është, siç thoni ju. Unë u largova nga vendi shpejt dhe djemtë i lashë të vegjël. Por, tani që u ktheva, të dy i gjeta oficerë në ushtri: të madhin kolonel dhe tjetrin kapiten (më duket se kështu tha). Kur vendosa të vija në vendlindje, atje më thanë: «Ku do të vesh more? Po a di ti se në Shqipëri nuk kanë as bukë të hanë; se atje do të të vrasin gruaja dhe djemtë?». Dhe unë, para se të nisesha, mbusha valixhet me sallam, me bukë, me konservë dhe me nja dy lecka. Kur arrita këtu, punonjësit e doganës më pritën të buzëqeshur. Më pyetën nga isha dhe u tregova që jam nga Boboshtica e se kam 30 vjet që kam ikur. Vajta që të më kontrollonin, por nuk më kontrolluan fare. As valixhet nuk m'i hapën. Pastaj ia hipa një taksie dhe u nisa për në Boboshticë. Gjatë rrugës kërkoja me sy kënetën e Maliqit, por ajo nuk dukej gjëkundi. Në shtëpi gruaja dhe djemtë, që nuk më njihnin fare, më pritën me gëzim. Gjithë fshati kishte dalë të më priste, të gjithë të qeshur e të gëzuar. Unë e humba fare nga emocionet. U ulën të hanim. Tavolina ishte plot; aty u shtruan nga të gjitha gjellët. «Hape valixhen, i thashë gruas, dhe hidhja çenit të gjitha ato që janë atje!». Pas darkës vajta për të fjetur. Gruaja më kishte shtruar krevatin me stromë të re, me çarçafë të bardhë

e me një jastëk të butë. Çdo gjë vajti shumë mirë, më mirë nuk kishte ku të shkonte. «More, thashë me vete, mos m'i bëjnë këto për të më marrë paratë?». Nga merakuri e hoqa portofolin nga xhepi dhe e vura nën jastëk. Nga çasti në çast prisja të vinte njeri e të më sulmonte. Por më kot e kalova natën pa gjumë, se çdo gjë shkoj për mrekulli. Kur u ngrita në mëngjes ata përsëri u sollën njëllor me mua, të gëzuar e me të gjitha të mirat. E ndieja veten të turpëruar, more zoti Enver, por faj nuk kisha unë, se andej kështu na kishin thënë. Këto që po ju them juve, përfundoi ai, nuk ia kam thënë as gruas, se më ka ardhur rëndë».

Kështu ndodh shpesh me ata që vijnë nga jashtë dhe s'kanë shumë faj, sepse e tillë është propaganda andej. Prandaj me ta duhet punuar me kujdes. Ata vërtet e shikojnë vetë realitetin tonë, siç e thashë dhe më lart, por edhe puna sqaruese e bindëse me ta ka rëndësi të madhe.

SHOKU ALI MANAJ: Shoku Enver, ju lodhëm shumë, prandaj mendoj ta mbyllim bisedën për sonte.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, unë ndiej kënaqësi dhe gëzim kur takohem me njerëzit, kur bisedoj e shkëmbej mendime me ta. Megjithatë jam dakord me ju, se ne këtu jemi e do të takohemi prapë bashkë.

Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

TASHI QË U ÇMALLA ME NJERËZIT, ME RRUGËT E ME SOKAQET, MË DUKET SE U BËRA MË I RI

*Nga bisedat gjatë vizitës në lagjen Palorto të qytetit
të Gjirokastrës*

19 mars 1978

Më 19 mars, të diel paradite, shoku Enver Hoxha, duke ecur më këmbë, bëri një shëtitje nëpër sokaqet e lagjes Palorto. Banorët e saj, sapo merrnin vesh ardhjen e tij, nxitonin për t'u përshëndetur me të. Shumë nga ata shoku Enver Hoxha i njihje edhe personalisht, disa prej të cilëve edhe si shokë të fëmijërisë.

Ja, moj Nexhmije, kjo është lagjja ku kam lindur dhe kam banuar unë në fëmijëri! Sulo, fotografoi këto vende! Çdo gjë këtu më ngjall kujtime të bukura nga fëmijëria ime. Ja, kjo është furra ku pjek Xhevati. O Xhevat!

SHOKU RESUL ZANI: Xhevati nuk është në furrë, shoku Enver, se ka shkuar në provat që bëhen për koncertin që do të jepet këto ditë për nder të vizitës suaj në rrethin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , po, se Xhevat!
këndon.

Duke zbritur nëpër rrugët e shtruara me kalldrëm shoku Enver Hoxha takohet me gra e burra të moshuar që kanë dalë nëpër porta. Kur sheh Teftën, motrën e dëshmorit Astrit Karagjozi, i flet menjëherë:

Hajde të piqemi një çikë, si je, mirë? Ia dhe të falat nënës?

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Ia dhashë, si nuk ia dhashë të falat. Ajo u gëzua shumë dhe më tha: «Enveri marrtë nga ditët tona!».

SHOKU ENVER HOXHA: Mbahet ndonjëçikë?

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Po çka, shoku Enver, si pleqëri. Tashti u plakëm edhe ne, që jemi fëmijët e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Dëgjo këtu, një nga këta djemtë që filmon do të vijë tashti një çikë në shtëpinë tuaj, të marrë në film shtëpinë dhe oborrin. Ajo ka qenë shtëpia e teto Lules nga Kardhiqi, kushërirë e nëndajkos simc. Por, shiko, të jesh edhe ti atje, kur të filmohet shtëpia.

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Shtëpia është e tyre, shoku Enver, le të vijnë e të bëjnë si të duan.

SHOKU ENVER HOXHA: Qofshi mirë, bëju të fala njerëzve të shtëpisë dhe nënës.

SHOQJA TEFTA KARAGJOZI: Faleminderit shumë! Të na vish më shpesh. Na merr malli. Të gjithëve na merr malli, se ke kohë që s'ke ardhur në Gjirokastër. Duam të të shohim, duam të çmallemi me ty.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është edhe kritikë, i pranoj kritikën.

T'i marrim një çikë shtruar të gjitha këto sokaqet, një nga një. Shikoj, moj Nexhmije, këto rrugica ku

ka bredhur burri yt! Kjo këtu është shtëpia e xha Jahos.

SHOQJA SANO HOXHA: Kjo është shtëpia e xha Vehbiut, kurse ajo atje është e Nevzat Skëndulit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, kurse ajo tjetra është e Bastriut. Te kjo shtëpi kam pasur një shok, djalin e xha Salikos, me të cilin luaja tërë ditën.

Në lagjen tonë, këtej nga ne kishte evgjitë, por djemtë e tyre të moshës sime unë i kisha shokë. Kur isha i vogël kam qenë një çikë i prapë, si fëmijë. Do t'ju tregoj se ç'bëra një ditë me djalin e xha Salikos. Atë ditë aneja më kishte dhënë një vezë të pazier. I shkreti djalë nuk kishte parë kurrë vezë me sy. «Këtë vezë dua ta fsheh për ty, i thashë. Kur të vijë, shoku tjetër e ta kërkojë, po nuk e gjeti, haje ti». «Mirë», tha ai dhe menjëherë hoqi qylafin me dhigël. Unë ia vura vezën në kokë dhe ai e mbuloi me qylafin e tij. Kur erdhi shoku tjetër, e kërkoi vezën andej-këtej, por nuk e gjente dot. Ky që e kishte nën qylaf ishte tërë gëzim, se do ta hante për vete. Mirëpo unë, një t'i rënë i bëra me dorë mbi qylaf dhe veza u thyel Kup-tohet, si u bë i shkreti, si mos më keq. Nëna e tij, e cila qe një çikë e çalë, erdhi e na foli: «Po ç'keni bërë kështu, more të prapë?». Ç'të bënim? E morëm shokun, e lamë dhe vazhduam të luanim përsëri bashkë.

SHOKU SULO GRADECI: Shoku Enver, ngjitemi në këto dy shkallë dhe pastaj zbresim poshtë, te shtëpitë e Bakiratëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, mirë, ngjitemi. Po kjo është shtëpia e baba Fanes, e kallajxhiut.

E shikoni sa bukur është këtu? Këto thesare nuk i keni ju në Dibër, Nexhmije, thuaj si të duash...

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kemi të tjera gjëra ne, por edhe male e gurë kemi plot.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni, por jo si këto. Pa shiko si janë këto këtu?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të bukura janë, por edhe tonat janë të bukura.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ti nga je?

SHOKU PALI KUKE¹: Jam nga Borova, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , nga Borova historike; kam qenë atje.

Kjo është shtëpia e Zilfo Bakirit. Zilfo, brenda je more?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Brenda jam, brenda. Urdhëroni!

SHOKU ENVER HOXHA: Po ku je, more Zilfo! Hajde mo t'u haptë përherë dera! Si je me shëndet?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Mirë jam, me gjithë të mirat.

SHOKU ENVER HOXHA: Po kjo shtëpi e kujt është? («Është e Nazif Mizirit!», përgjigjet një grua e moshuar.)

SHOQJA FETE MIZIRI: Na urdhëroni brenda! Se shtëpi gjirokastrite kemi, siç e doni ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, brenda nuk vijmë se duam të rrimë këtu në oborr, njëllor është. Rri këtu afër meje ti. Paskeni një shtëpi të bukur e të pastër.

1. Operator në televizion.

Po hajde, ulu dhe ti këtu afër, Zilfo, sepse më ka marrë malli shumë. Je i fortë?

SHOKU ZILFO BAKIRI: I fortë jam, jam edhe katër vjeç më i ri nga ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Po sa fëmijë ke? A i ke të rritur?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Kam katër fëmijë të rritur.

SHOKU ENVER HOXHA: Po gruan nga e ke marrë?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Nga Çanajt, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: More Zilfo, rron Zija!

SHOKU ZILFO BAKIRI: Jo, ka vdekur.

SHOKU ENVER HOXHA: Po atë portën e madhe ku e ke? Unë doja të vija nga porta e madhe, e kërkova me sy, por nuk e pashë gjëkund. Hajde buçko, hajde! Edhe vetullat të janë zbardhur, o Zilfo dhe prapë thua: «jam i ri». (Të qeshura.) Po këpucë bën akoma?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Jo, tani kam dalë në pension.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë, kur erdha në Gjirokastrë, të kam takuar në Fabrikën e Këpucëve.

E kujton ndonjëçikë anenë time?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Po si nuk e kujtoj?! Nga herë! Kjo është Neboja, gruaja ime.

SHOQJA NEBO BAKIRI: Si jeni për vete, shoku Enver, fëmijët si i keni?

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, mirë janë. Ju si

i keni fëmijët? Shiko, këtë burrin, burrë bakull, buçko e ke, siç duket ti e kanaqeps nga një çikë. I bën ndonjë vezë me gajgana? (Të qeshura.) Bëj shaka se, këto gjëra janë për kalamanët, pa ne u moshuam tani, ku duam t'ia dimë për ato.

Babanë e Zilfos nëna ime e ka pasur djalë të hallës. Më kujtohet kur vinim te hallë Limja, siç e quanin nënën e tij. Ajo ishte një grua plakë, e bukur dhe e zgjuar.

Babai i Selimit¹ ishte i gjatë e i hollë. Edhe Selimi vetë ishte i gjatë, por dhe i trashë nga trupi. Plaku im i kishte vënë një emër: e thërriste «zvingo». (Të qeshura.)

U gëzova shumë që erdha këtu. Më kishte marrë malli për njerëzit që banojnë në këtë lagje, për kopsh-tijet, për rrugët dhe sokaqet.

SHOQJA NEBO BAKIRI: Edhe ne gëzohemi shumë që na erdhët e ju pamë që jeni mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jeni mirë nga dynjallëku?

SHOQJA NEBO BAKIRI: Shumë mirë, ku ka më mirë se sa jemi ne sot.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe më mirë do të jemi. Kemi vuajtur, por në të ardhmen do të jemi akoma më mirë.

Ç'fëmijë ke, djem a çupa?

SHOQJA NEBO BAKIRI: Kam tri çupa dhe një djalë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk je pishman që ke

1. Selim Bakiri.

tri çupa. (Të qeshura.) Marrin ylefë këto. I ke të martuara?

SHOQJA NEBO BAKIRI: Vetëm një vajzë kam të martuar dhe djalin.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ato të dyja do të martohen. Po djalin ku e ke me punë?

SHOQJA NEBO BAKIRI: E kam inxhinier kimist. Një çupë e kemi me punë në Tiranë, të dytën e kemi arsimtare dhe të voglën e kemi në bujqësi. Ja, kjo këtu është!

SHOKU ENVER HOXHA: A..., ti je, gëzohem! Shumë mirë. Të lumtë!

Si thoni, shokë, do të na falni të ngrihemi tashti! Nuk kam kohë e mundësi të vij të bëj kudo vizita nëpër shtëpi, po të paktën të bëj një shëtitje rreth e qark sokaqeve të lagjes, se dua të çmallem me të gjithë. Mirupafshim! Qofshi mirë!

Po shtëpia e xha Hyso Bakirit, ku është Zilfo?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Ajo është djegur, shoku Enver, bashkë me të Fikos. Ja, këtu ka qenë shtëpia e xha Hysos. Në vend të saj është ngritur kjo shtëpizë që shikoni.

SHOKU ENVER HOXHA: Merre një çikë në fotografi shtëpinë e xha Hysos, more Sulo!

I drejtohet një gruaje: Po juve nga jeni? «Jam nga Zagoria», përgjigjet ajo.

«Kjo është motra e Pirro Bitës», thotë dikush.

O..., motra e Pirro Bitës. Bëna një fotografi, more Sulo, me motrën e Pirros! E kemi atje në aparatin e Komitetit Qendror Pirron. Hajdeni edhe ju të tjerët këtu, të dalim në fotografi!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kur të kthehem, do t'i themi Pirros që të takuam.

SHOKU ENVER HOXHA: Duke iu drejtuar një burri: Po ti, që je me leshra të bardha, besoj do të jesh moshatar me mua, apo jo? (Të qeshura.) Megjithatë mund të jesh edhe më i ri, po leshrat ama të janë zbardhur fare. («Jo, jo, s'jam i ri, moshatar me ju jam», i përgjigjet ai.)

More Zilfo, të kujtohen shollat me proka? Nuk ke nja dy proka t'u vësh këtyre këpucëve të mia? Do të ishte më mirë në këto rrugë të ecje me të tilla këpucë.

(Në këtë kohë dikush po e mban shokun Enver nga krahu, por një grua plakë që e pa bërtiti: «Mos na e mbani nga krahu, se e kemi të ri, nuk e kemi plak Enverin!».)

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu u them edhe unë, moj motër, këtyre shokëve, por nuk më lënë. (Në këtë çast shoku Enver e hedh tej shkopin.) Ja, edhe shkopin e hodha. Unë mund të eci fare mirë pa shkop. (Të qeshura e duartrokitje.)

Shiko, shiko, ky këtu është Azisi. Të njoha Azis. Po si je me shëndet?

SHOKU AZIS HOXHA: Mirë, mirë jam! Po na mori malli shumë, more shoku Enver. Sa mirë që u takuam!

SHOKU ENVER HOXHA: Duke iu drejtuar një tjetri: Po ti i kujt je? («Jam i baba Ramos», përgjigjet ai.) U... , i baba Ramos! Po qenke ngjitur këtu lart ti! Mirë, mirë. Duke iu drejtuar një tjetri:

Kush je ti more xhaxho? («Jam Ahmet Dudumi»,
përgjigjet ai.)

SHOKU ENVER HOXHA: Po ti je më i vjetër nga unë, megjithatë mbahesh mirë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Mirë thonë, një qytet i tërë prej guri është Gjirokastra.

SHOKU ZILFO BAKIRI: Çdo gur i këtij vendi ka një histori më vete. Kanë dert këta gurë?

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, nuk kanë, ashtu siç nuk kemi dert edhe ne pleqtë. Tash që u çmalla me njerëzit, me rrugët e me sokaqet, më duket se u bëra më i ri.

Tashti dua të shkoj një herë nga shtëpia e xha Kamberit, e Bejko Gaxhellos, e xha Nure Çanoles, kurse te shtëpia e Naim Finos nuk zbres dot, se është akoma më poshtë.

E mbaj mend mirë se, në këtë vend ka qenë një shesh. Sheshi i Xhepit, i thoshin. Atje, në huqumet, grekët kishin një depo me armë. Një natë, pasi kishin ikur ata, depoja mori zjarr. Tërë atë natë bamb e bumb kërcisnin fishekët në Gjirokastër. Në mëngjes ne, të vegjlit e lagjes, shkuam atje dhe mbushëm xhepat e torbat me plumba. Pastaj vinim te ky vend dhe luanim me plumbat e gjetur, me xina (maja pene) e me pulla, që ua merrnim nënave nga jelekët.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po të dëgjojnë fëmijët, menjëherë do të thonë: xhaxhi Enveri, kur ka qenë si ne, paska luajtur me kopsa.

SHOKU ENVER HOXHA: Po këto ishin lodrat tona, moj Nexhmije, ne nuk kishim me se të luanim atëherë. Partia sot fëmijëve tanë ua ka krijuar të gj-

thë mundësitë për t'u dëfryer e për t'u kalitur me lodra të bukura.

Po ti e kujt je?

SHOQJA VIOLETA SINOIMERI: Jam e Sotir Mal-tos, punoj llogaritë në ndërmarrjen ushqimore.

SHOQJA RASHIDE GJINI: Këtë shoqe e kemi dhe aktiviste të dalluar; është kryetare e Frontit të bllokut.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, shumë mirë!

Kjo është shtëpia e xha Seferit, apo jo? («Po, po, ajo është», përgjigjet një burrë.) Më kujtohet që këtu ka qënë një shkallë, por tashti nuk e shoh. Qenka prishur shkalla?! («Është prishur sepse zgjeruam rrugën», përgjigjet dikush.)

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është shtëpia e Mexhit Kokalarit, e atij që shkruan herë pas here në «Pararoja».

Po Avdulla Kënaçi ku është me punë? («Në «Zërin e popullit»», përgjigjet dikush.)

(*Dy të moshuar nxitojnë për ta takuar shokun Enver.*)

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, more Fetah! Ore, po sapo more vesh që isha këtej, erdhe menjëherë?

Kjo është shtëpia e Çanoles. Paska ndryshuar, qenka bërë e re. Fotorafoje edhe këtë shtëpi, Sulol!

SHOKU ZILFO BAKIRI: Shtëpitë e vjetra të Çanoles kanë rënë, janë prishur fare.

SHOKU ENVER HOXHA: Ah, sa do të doja të mos ishin prishur shtëpitë e vjetra të Çanoles! Ato ishin të

bukura, me karakteristikat e arkitekturës gjirokastrite.

Po Beduni rron?

SHOKU ZILFO BAKIRI: Rron, shoku Enver, është në Fier.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ishim të vegjël me Bedunin, dilynim nga kodra me cangadhet që kishte xha Nuroja.

SHOKU ZILFO BAKIRI: Beduni ka ardhur këtu këto ditë. Kur e takova, e pyeta: «Sa kohë ke pa ardhur në Gjirokastër, more Bedun?». «Kam nja 30 vjet, më tha. Tashti nuk mbaj mend as rrugët!».

SHOKU ENVER HOXHA: Kurse unë i mbaj mend mirë të gjitha rrugicat e shtëpitë. Po shtëpitë e Gaxhellos ku janë? U... , ja ku qenkan! Po edhe këto qenkan bërë të reja. Sidoqoftë, penxheret i kanë ruajtur, siç kanë qenë, të paktën kështu më duket mua. Atëherë xha Bejkoja punonte me kuaj. Kur kalonte me ta, bënte zhurmë sa e dëgjonte e tërë mëhalla; kështu që kur zbritnim ne poshtë Sokakut të të Marrëve, pleqtë na thoshin: «E more, si kuajt e Bejko Gaxhellos ecni!». Dëgjoheshim shumë kur ecnim, se i kishim këpucët me proka.

Po te shtëpia e Ajdinit që është djegur, kanë bërë gjë?

SHOKU FETAH HOXHA: Jo nuk kanë bërë gjë, ashtu është, siç ishte.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa vjeç u bëre, o Fetah?

SHOKU FETAH HOXHA: 70 vjeç për 71.

SHOKU ENVER HOXHA: U... , po të jesh ti 70 vjeç, unë jam 60!

Po ja, sa vjeç jam unë, sipas teje?

SHOKU FETAH HOXHA: Ti je nja 65 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: (*Duke qeshur.*) A shejtan, shejtan. Ti i ke nja 76. Je më i madh nga Haxhoja ti, e di mirë unë këtë. Ja, këtu (*Duke drejtuar gishtin tregues në kokë.*), e kam të tiposur në mendje. Po pse të mos thuash, ke hakë, se xha Faroja e Dedeja (Hoxha) kanë vdekur dhe nuk i pyesim dot.

Duke iu drejtuar Sulo Gradecit:

Sulo, shko atje, hap shtëpinë e Naim Finos dhe merr një çikë oborrin në film. Pastaj, zbrit pak më poshtë, në një portë tjetër, se është shtëpia e Aqifit. Fotografoje shtëpinë dhe sidomos shkallët, në qoftë se janë akoma. Unë kam 65 vjet që nuk i kam parë, por më kujtohen mirë aina si kanë qenë. Kush rri në ato shtëpi tashti, Fetah?

SHOKU FETAH HOXHA: Ato i kanë blerë disa që kanë ardhur nga Gumenica.

SHOKU ENVER HOXHA: (*Duke parë telekronistin e Gjirokastrës që po xhironte.*) U, ti Engjëll xhiroke edhe në film, shkruan dhe në gazetë! Shkruan mirë. I lexoj shkrimet e tua, më pëlqejnë. Kam qenë shok me Muratin, babanë tënd. Kur dilnim nga shkolla, rrinim e luanim atje tej, te sheshi. Unë isha biçim qytetar, kurse Murati me Hadërin edhe punonin, edhe këndonin. Atje ku rrinim vinte i ziu Xhemal, që kur e ngacmonim, na fuste nga një shqelm bythëve. I ziu Xhemal, nxihej i tëri po t'i thoshe: «Thuaj, të vdektë gruaja!». Andej nga ara vinte me kalë Hadëri e na thoshte: «E more ju, mjaft me këto libra! Ja, ju do të na nxirrni në dritë!». Kali lëshonte mender bajgat dhe ai na thoshte: «Hajde, mblidhni këto dhe i hidhni nën

strehël!». «Ore Murat, ky Hadëri mos është një çikë i çakërdisur?», i thosha unë. «Jo, më thoshte ai. Dale se t'i mësoj unë këto gjëra ty, javash-javash».

Duke çarë përmes turmës së njerëzve, shokut Enver Hoxha i del përpara një pionier dhe e përqafton.

PIONIERI¹: Xhaxhi Enver, unë kam vizatuar një veturë.

SHOKU ENVER HOXHA: (*Pasi e puth.*) U... , po kjo qenka vetura ime! Po çfarë do të bëhesh ti, shofer?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ky mund të bëhet piktor i madh!

PIONIERI BLEDI GONXHI: Kurse te kjo letra tjetër kam vizatuar Qemal Stafën.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Sa bukur e ke vizatuar! Po i kujt je ti, more djalë?

PIONIERI BLEDI GONXHI: Jam i Agim Gonxhit.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Hajde të dalim bashkë në fotografi!

SHOKU ENVER HOXHA: *Duke iu drejtuar një grupi të rejash*: Si jeni, shoqe, mirë? («Mirë jemi, shoku Enver», *përgjigjen ato gjithë gëzim.*) Shikoni sa sekretare të mirë të Partisë që kemi! Rashideja ka dalë nga gjiri juaj, punëtore ka qenë, pastaj u bë drejtoreshë dhe tashti është sekretare partie. E ngriti Partia gruan shqiptare.

Kjo është shtëpia e Tartales, kjo tjetra është e Furrxhiut, kurse kjo e Naxhos. More Fetah, po si është Naxhoja?

SHOKU FETAH HOXHA: Mirë është, mirë.

1. Bledi Gonxhi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po djalin¹ Naxhoja e ka në Paris, shofer. Domethënë, djali i Naxhos na u bë parisian! Djali i Rashipit ishte i sëmurë, por tani është fare mirë me shëndet. Shyqyr që nuk pati gjë. Ai është edhe djalë i zoti.

Po të rronte tani xha Faroja, o Fetah, do t'i thoshim «hipi» se i kishte leshrat dhe mjekrën të gjatë, si Çerçizi.

Këto shtëpitë këtu janë të Abdurrahimit, të Azizit.

Duke iu drejtuar një gruaje që kishte një fëmijë në dorë: Ç'është kjo pëllumb apo pëllumbeshë? («Është vajzë», përgjigjet ajo.)

Të të rrojë! *Pastaj i drejtohet një burri?:* Po ti kush je? («Jam nga Zhulati, por banoj këtu, në lagjen Palorto». përgjigjet ai.)

Qofsh mirë e pleqëri të bardhë! Ke fëmijë, je mirë nga dynjallëku?

SHOKU REXHO BASHA: Kam plot fëmijë dhe nga dynjallëku jam shumë mirë. Sa të kemi Partinë dhe ty, shoku Enver, të gjithë «Gjolekë» na ke.

SHOKU ENVER HOXHA: Të rrojë Partia!

Nuk ia marrim njëherë bashkë këngës së Gjolekës?

SHOKU REXHO BASHA: Po si more, shoku Enver, hajde t'ia themi kështu kokë më kokë. Dhe të dy këndojnë. *Plaku nga Zhulati ia merr, shoku Enver ia kthen; të tjerët aty afër bënin iso:*

*«Doli Gjolekë spanoi
Tafil Buzit të m'i thoi:*

1. Dashamir Hoxha.

2. Rexho Basha.

*Gjoleka s'e turpëroi,
Përmes dyzetmijëve shkoi,
Kastanasit ç'ia martoi;
Me të dyja ç'e qëlloi,
Nzori shpatën edhe shkoi*

SHOKU ENVER HOXHA: Ia morëm edhe njëherë këngës. (Të qeshura.) Ka qenë burrë Gjoleka, trim i fortë. Edhe ne, partizanët, rrugën e tij ndoqëm. Rroftë Partial

*Vazhdon shëtitjen duke biseduar me xha Muçon¹:
Po ty, Muço, si të kam, mbahesh ndonjëçikë?*

SHOKU MUÇO HOXHA: Çka, bereqaves, mirë mbahem. Edhe nga hyzmeti deri tani jam mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Fëmijët i ke mirë, të respektojnë?

SHOKU MUÇO HOXHA: Mirë i kam. A më respektojnë thua? Më respektojnë që ç'ke me të!

SHOKU ENVER HOXHA: O Muço, a e hedh ndonjë gotë raki, te pati në kohën e drekës?

SHOKU MUÇO HOXHA: E hedh, o Enver, por jo në drekë, në darkë.

SHOKU FETAH HOXHA: Rakinë e rrushit nuk ia lënë djemtë, por tashti Muçoja ka marrë raki dëllinje. Ata nuk e pëlqejnë këtë raki, kështu që tani nuk i bien më në qafë Muços. (Të qeshura.)

SHOKU ENVER HOXHA: Po si e ka shijen kjo rakija e dëllinjës?

1. Muço Hoxha.

SHOKU MUÇO HOXHA: Shijen e ka të mirë. Të bën mirë edhe për azmë ajo.

SHOKU ENVER HOXHA: E more Muço, sa mirë që u takuam! Na kishte marrë malli, more xhani im i dashur! Gëzohem që je mirë dhe ke pleqëri të bardhë! Ti rri poshtë te pati, apo jo?

SHOKU MUÇO HOXHA: Po, po atje rrimë. Kurse sipër rrinë ata të Nexhmos!

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem që je mirë e qofsh mirë! Të fala bëju njerëzve në shtëpi. *U drejtohet njerëzve të tjerë:* Qofshi mirë të gjithë, t'ju dëgjoj zënë e mirë!

U... , Jorgoja². Si je me shëndet, more Jorgo, mirë je?

SHOKU JORGO SULIOTI: Jam shumë mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa hajde këtu, hajde këtu midis meje dhe Nexhmijes të dalim në fotografi.

Duke u larguar nga kjo lagje kaq e dashur, shoku Enver i përshëndet gjithë banorët:

Mbëçi me shëndet shokë! Qofshi të gëzuar! Të fala shumë të gjithëve. Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura gjatë kësaj vizite, që gjenden në AQP

1. Nexhmo Hoxha.

2. Jorgo Sulloti, Hero i Popullit.

TRADITAT PATRIOTIKE TI RUAJMË TË PASTRA E TI ÇOJMË MË TEJ

Nga bisedat gjatë vizitës në fshatin Mashkullorë

20 mars 1978

Te basorelievi kushtuar luftës së Çerçiz Topullit me shokët e tij trima, shoku Enver Hoxha bëri homazhe dhe vuri një kurorë me lule të freskëta. Vizitën e parë ai e bëri në muzeun e fshatit. Atje takohet e bisedon me një grup veteranësh. Takimi nisi me një bisedë me një grup kooperativistësh dhe përfundoi me një miting të madh popullor.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni, shokë, a jeni mirë? («Jemi shumë mirë», përgjigjen ata njëzëri.)

Gëzohem shumë, që jeni mirë. Hajdeni shokë, afrohuni të gjithë këtu!

NËNË LALE MYRTAJ: Të na rrosh sa malet Enver, me Nexhmijen, me fëmijë e shokë! Të na rrojë Partia e Punës!

SHOKU ENVER HOXHA: Xha Vehipi na la. e kisha shok e mik atë. Si i ke mbesat? Mirë janë? («Nuk dëgjon plaka, por mirë i ka mbesat», përgjigjet një shoqe aty pranë.)

Po ajo që është mësuese ku punon tani, këtu? («Jo, në Tiranë!», *përgjigjet dikush.*)

Më kujtohet, kur isha një herë në Kukës për vizitë, në pranverën e vitit 1970, takova atje xha Vehipln. U përqaftuam, shkëmbyem nja dy fjalë me të dhe pastaj e pyeta: «Po ti, more xha Vehip, ç'kërkon këtu? Ç'të ka sjellë që nga Mashkullora deri në Kukës?». «Kam ardhur të shikoj një çikë mbesat që janë këtu me punë, një mësuese e një me rininë», m'u përgjigj ai. «Mirë e ke bërë», i thashë. Pastaj iu ktheva shokut sekretar të Partisë të rrethit dhe i sugjerova: «Nuk ia jep këto mbesat xha Vehipit që t'i marrë atje poshtë, në Mashkullorë?». Xha Vehipi që më dëgjoi, i gëzuar më tha: «Po ku e dije ti që këtë gjë doja unë?». Si përfundim, xha Vehipit mbesat iu transferuan në Gjirrokastër se detyrohej të merrte gjithë atë rrugë për t'i parë ato si ishin me shëndet e si punonin.

Duke iu drejtuar gruas së një dëshmori:

Ma jep një çikë dorën moj nënë, ma jep se, kur mbaj të shtrënguara duart tuaja, më duket sikur mbaj e shtrëngoj duart e djemve e të burrave tuaj që kanë dhënë jetën për atdheun.

NËNË FETE ÇANI: Të na rrosh sa malet, bir!

SHOKU ENVER HOXHA: Të na rrojë Partia!

Kam ardhur këtu të takohem me popullin e kësaj zone, t'ju shikoj dhe të gëzohem me ju, të shikoj rrapin historik. Ky rrap shekullor do të rrojë edhe qindra vjet të tjerë. Siç e dini, rrapit i ka rrënjët të forta si vetë Mashkullora dhe njerëzit e saj.

NËNË FETE ÇANI: Edhe ju, shoku Enver, ashtu jeni, i fortë si shkëmbi. Rrofsh e marrç nga ditët tonal

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit!

Shikoj këtu gjithë këta shokë veteranë. Po cilët janë, nuk m'i tregoni një çikë emrat e tyre?

Pasi e njohin me radhë me secilin nga veteranët, shoku Enver Hoxha tha:

Gëzohem shumë që takohemi e që jeni mirë!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kooperativa e Mashkullorës tani u zmadhua, sepse përfshin 8 fshatra të kësaj krahine.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, 8 fshatra janë bashkuar në këtë kooperativë. Nuk jua them për t'ju bërë qejfin, po kooperativa juaj është nga më të mirat në rreth.

Tani shkojmë të bashkohemi me popullin që të mos e bëjmë të na presë. *Duke iu drejtuar nënë Lales e nënë Fetes, ndërsa janë duke ecur për te Rrapi i Mashkullorës:* Ju nëna më rrini afër e mos m'u ndani!

Kur arrijnë te rrapi, ku janë grumbulluar shumë njerëz, shoku Enver Hoxha thotë:

Më mirë rrimë pajdash, si thoni? Sikur bisedojmë më çpenguar kështu, apo jo? («Po, po, më mirë është të ulemi pajdash», *përgjigjet xha Aliu me shokë.*)

O, xha Aliu, vëllai i Kasëmit! Pak më parë më the se u plaka. Po kjo s'është e vërtetë, se ti je i fortë, si drënjë.

Xha Ali, a ka dert mali këtu lart dhe ky rrapi ku po qëndrojmë?

XHA ALI XHEKO: Jo, nuk ka.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ti s'ke dert. Hiç mo u tremb, se do të rrojmë nga 100 vjet.

XHA ALI XHEKO: Jam i moshuar unë. Kam pasur profesor Thoma Papapanon.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është, jemi një çikë të moshuar, po prapë jemi akoma të rinj.

XHA ALI XHEKO: Unë jam 20 vjet më i madh se ti, jam 80 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo more, zotërote je 70 vjeç e unë jam 60. (Të qeshura.) Xha Ali, po i ulim nga 10 vjet, s'është ndonjë gjë e madhe, na i falin këta, djemtë.

Bëra mirë që erdha?

XHA ALI XHEKO: Bëre shumë mirë!

SHOKU ENVER HOXHA: Unë kam ardhur edhe herë tjetër në Mashkullorë, po jo deri këtu, te rrapi; kam qëndruar poshtë, në haur, atje ku ka luftuar Çerçizi.

Në këtë kohë, kur sheshi te rrapi ishte mbushur plot me njerëz, shoku Enver Hoxha, mbajti këtë fjalim:

Të dashur shokë mashkulloritë dhe mashkullorite, Dhe, kur them mashkulloritë dhe mashkullorite përshëndes edhe të gjithë kooperativistët e kooperativistet e 8 fshatrave që përbëjnë këtë kooperativë të dalluar!

Sot jemi në mars:

*«Dolli shkurti, hyri marsi,
Gjirokastër u vra bimbashi»*

Në këtë muaj, siç e dini, 70 vjet më parë, tok me ju, mashkulloritët, luftoi Çerçiz Topulli kundër osma-

nëve. Lufta u bë poshtë, në haur, por këtu, në Mashkullorë, te ky rrap, ishin luftëtarët mashkulloritë që u ndeshën me ushtarët e osmanllinjve që erdhën nga Janina, siç e thotë poeti anonim që ka thurur vargjet:

*«Nga Janina, vjen mezapi
Në Mashkullorë, te rrapit. . .»*

Kështu thuhet në këngë, se osmanllinjët kishin për qëllim të likuidonin çetën dhe të digjnin fshatin heroik të Mashkullorës. Më poshtë kënga vazhdon:

*«Te rrapit, në Mashkullorë,
Foli Çerçizi me gojë:
«Milazim, largo taborrë,
Se të bëj të kuq me bojë!
Çerçiz Topulli më thonë!»»*

Dhe këtu u ndez lufta e ashpër, në të cilën 20-25 ushtarë osmanllinj u gjakosën dhe lanë kockat këtyre kodrave, kurse trimave tanë u mbeti vetëm një i vrarë, luftëtari Hajredin Tremishti. Pra, 1 me 20. Vërtet 2 milionë e gjysmë jemi ne sot, por barazohemi me 200 milionë, prandaj frikën kurrkujt s'ia kemi.

Për mua, djalin tuaj dhe të Gjirokastrës, kjo ditë është një ditë e lumtur, që nuk do ta harroj kurrë derisa të vdes, se jam në mes jush, ashtu siç kanë qenë shokët e mi trima të Luftës Nacionalçlirimtare, që luftuan me heroizëm të madh për çlirimin e Shqipërisë. Ja, mëmat e tyre e shumë të tjera, i kam sot këtu afër.

Kur kam qenë i vogël, në shkollë, na erdhi njëherë një mësues patriot, që e quanin Jani Minga. Ky

Ishte një patriot i njohur, një nga mësuesit e shquar të Rilindjes, që tërë jetën luftoi për gjuhën shqipe. Kur u ngrit flamuri në Vlorë dhe Ismail Qemali formoi Qeverinë e parë në Shqipërinë e pavarur, Jani Minga u bë ministër i Arsimit. Ai pra, siç thashë, erdhi të vizitonte shkollat tona, mejtepet, siç i thoshin atëherë në Gjirokastër, dhe na mbajti një fjalë. Mua më është rrënjosur në kokë fjala e tij e parë. E dini si tha ai? Nuk tha «Mashkullorë e Gjirokastrës», por «Gjirokastër e Mashkullorës». Me këtë ai donte të vinte në dukje se këtu, në Mashkullorë, u bë një luftë heroike.

Ajo luftë dhe luftërat e tjera të popullit tonë na mësuan ne, brezat e ardhshëm, si të luftojmë për mbrojtjen e popullit dhe të atdheut. Nën at na këndonin qysh në djep historinë e gjyshërve e të baballarëve tanë dhe na thoshin: «Biro, lufto për këtë tokë, për këtë vatan, mos lër këmbë armiku ta shkelë!».

Luftërat e Bajos dhe të Çerçizit, të Koto Hoxhit, të Hasan Xhikut dhe të shumë e shumë patriotëve të tjerë, kanë qenë luftëra me pushkë dhe me penë, që do të mbeten të paharruara në historinë e popullit tonë. Populli ynë ka kaluar vuajtje të mëdha; njerëzit tanë herë vishnin opinga lëkure në këmbë, kur kishin, po shumë herë ecnin edhe zbathur e me nga një gunë të çjerrë e një llabane në kokë; por «Maliherin» dhe «Mauzerin» s'i lëshonin nga dora, ato kurdoherë u këndonin si bilbil. Ata ndoqën rrugën e luftëtarëve të shquar të të gjithë Shqipërisë, edhe të luftëtarëve nga Kosova, e cila sot është e ndarë nga Shqipëria. Por ajo ka dhënë burra trima e gra trimëresha, që kanë luftuar tok me tërë burrat e gratë e Shqipërisë. Këta luftëtarë kanë

pasur në krye mendimtarët e shquar Abdyl Frashërin, kryetarin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Sami dhe Naim Frashërin.

Sami Frashëri, patrioti i madh i Rilindjes, ka qenë një nga dijetarët më të shquar të vendit tonë. Ai, për kohën e tij, ishte një nga filozofët më të mëdhenj të Turqisë. Samiu, burri i Frashërit, njeriu i nderuar i vendit tonë, është edhe hartues i Enciklopedisë së madhe të Turqisë. Gurin e varrit të tij, që ndodhet në Stamboll, e kanë bërë në formën e një libri, për t'ia përshtatur figurës së tij si dijetar i shquar.

Njëqind vjet më parë ai parashikonte në librat e tij se ç'do të bëhej kjo Shqipëri. Samiu ishte njeri me kulturë të gjerë; ai shquhej në fushën e shkencës e të diturisë. Ishte edhe një gjuhëtar i zoti që e donte shumë gjuhën shqipe, dhe luftoi me pasion që ta përhapte atë në të katër anët e vendit.

Kurse, vëllai i tij, Abdyl, ishte politikan e organizator i madh. Ai ka ardhur edhe këtu, në viset tona. E ku nuk ka vajtur ai! Në të katër anët e Shqipërisë, në të katër anët e Kosovës, për të bashkuar vendin, për të bashkuar popullin, për ta bërë të lirë, për të flakur tej zgjedhën e otomanëve, për të shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi, nga lakmia e shovinistëve serbë, malazezë e grekë.

Po të ngjitemi më lart, në histori, këto vende e këto gërxhe kanë nxjerrë burra trima si: Gjolekën, Balil Neshën, Çelo Picarin, Tafil Buzin e shumë të tjerë. Ata kanë qenë njerëz të pushkës e të penës, por kanë qenë edhe administratorë të zotë.

Për lirinë e kësaj toke pra, kanë luftuar sa e sa

trima që me veprën e tyre kanë mbetur të gjallë në kujtesën tonë. Të gjithë e dimë këngën e Tafil Buzit dhe të Zenel Gjolekës:

*«Doli Gjolekë spanoi
Tafil Buzit 'të m'i thot
Gjoleka s'e turpëroi
Përmes dyzetmijëve shkoi
Kaftanasit ç'ia martoi
Me të dyja ç'e qëlloi
Nxori shpatën edhe shkoi»*

Gjoleka ishte një fshatar i thjeshtë, por trim i madh që udhëhoqi masat fshatare në luftën kundër osmanëve. Edhe Tafil Buzi ishte njeri i pushkës, por ky kishte dhe aftësi si administrator. Në kohën e tij drejtonte Yskydarin e Stambollit. Të tillë njerëz të shquar ka nxjerrë vazhdimisht Shqipëria.

Prandaj, të gjitha këto tradita të mëdha historike të popullit tonë: luftën e Bajo Topullit, të Mihal Gramenos, të Çerçiz Topullit e të mashkulloritëve, të fushëbardhasve, të zhulatasve etj., etj., luftën për alfabetin, për gjuhën tonë, t'i ruajmë kurdoherë të pastra.

Gjithë këta burra trima luftuan dhe u përpoqën, gjithashtu, që të hapnin kudo shkolla shqipe. Bajo Topulli ishte jo vetëm njeri i pushkës e luftëtar i zoti, por edhe mësues e udhëheqës shpirtëror i masave popullore. Ai ka marrë pjesë dhe në Kongresin e Manastirit, kongres me rëndësi të madhe për lëvizjen tonë kombëtare, për mbrojtjen dhe për zhvillimin e kulturës e të gjuhës shqipe.

Ishin rilindësit tanë të mëdhenj pra, që frymëzuan kryengritjet historike kundër osmanëve. Këta dhe luftërat e popullit tonë frymëzuan edhe popujt e tjerë të Ballkanit kundër sundimit otoman. Kur filloi kryengritja kundër sulltan Hamitit nga xhonturqit, forca lëvizëse e saj ishin shqiptarët e Manastirit. Ata kishin frymëzuar dhe Mustafa Qemalin.

Mirëpo, pas rrëzimit të sulltan Hamitit, xhonturqit e kthyen fletën. Veçanërisht ne, shqiptarët, ata na kishin halë në sy. Xhonturqit kërkonin që në Shqipëri të mbylleshin shkollat; që njerëzit tanë të mos mësonin gjuhën e nënës; që Shqipëria të mos ishte e lirë, autonome. Ata kishin shumë frikë nga cari i Rusisë e nga perandori i Gjermanisë dhe, për t'u bërë qejfin atyre, pasi u thyen, thanë: «Këtë Shqipëri ta copëtojmë e t'ua japim haraç serbëve, malazezëve» etj.

Atëherë, gjithë populli ynë u ngrit në këmbë nën udhëheqjen e patriotëve trima të cilët bënë thirrje: «Të rrokim armët, vëllezër!». Dhe nga të katër anët e vendit u krijuan komitete. Ato frymëzuan Bajon, Çerçizin, shumë nga ju, pleqtë tanë, që të dilnit nëpër male e të luftonit dhe të hapnit kudo shkolla në gjuhën shqipe, gjë që i kushtonte popullit aq mundim e vuajtje.

Despoti i Korçës e masakroi Papa Kristo Negovnin. «Ti despot na e vrave Papa Kriston», tha Bajo Topulli. Dhe pas pak kohësh, ai me çetën e tij, ia numëroi në ballë dhe e la të vdekur në vend. Po për kë e bënë ata këtë sakrificë? Për shkollën shqipe. Këta trima i gjeje kudo. Ja, ju, pleqtë i keni njohur ata. Mali i Gjerë ishte shtëpia e tyre. Ata zbritnin këtu poshtë dhe hanin një krodhë nga buka juaj e paktë, atë

krodhë të misërt që ishte aq e ëmbël, sepse ne të zejtë mezi e bënim atüherë edhe misrin, gjithçka na mungonte. Edhe atë pak misër që merrnim nga toka që e punonim pothuajse gjithmonë me qetë që kërkonim hua, na e rrëmbente agai, na e rrëmbente beu.

Populli i revoltuar ngrinte krye kundër atyre sundimtarëve të egër e të shitur tek të huajt, si Myfit Beu me shokë, që i thithnin gjakun dhe djersën. Myfit Beu, i tronditur, i dërgonte në atë kohë valiut të Janinës, jo një telegram, por disa një pas një: «Vali, dërgo ushtri, se është ngritur Kazaja e Gjirokastrës në këmbë dhe do ta zaptojnë qytetin». Myfit bej Libohovës i kishte hyrë frika në bark nga ehalia¹, por edhe valiut të Janinës i dridheshin këmbët. Prandaj ky i përgjigjej Myfit Beut: «Mblidh shehlerët, lajmëro baba Alinë dhe atje, në teqe, t'i bindni këta rebelë, se unë nuk kam forca të të dërgoj». Po kush i bindej Myfit Beut? Askush. Kështu që Myfit Beu s'kishte ç'të bënte veçse t'i dërgonte telegram pas telegrami valiut që të merrte masa. Kur vinin ushtritë e otomanëve, i pritnin me pushkë trimat shqiptarë si Balil Neshë me shokë, të cilit populli i ka kënduar:

*«Balil, o Balil nuri
Në qafë të Peshkëpisë,
Ç'u vra i biri i Xhixhisë
Për lirinë e Shqipërisë...»*

(E kishe njohur Balil Neshën, xhaxho? pyet shoku

1. Populli.

Enver Hoxha një plak të moshuar. «E kam njohur, ishte trim i madh», përgjigjet ai.)

Me jetën dhe luftën e trimave të kësaj çete të rrethit tonë, të atyre që u përpoqën për të mirën e këtij vendi, ka rëndësi të njihen të rinjtë e të rejat e sotme dhe të mos i harrojnë heroizmat e shquara të tyre.

Një nga episodet më të shquara e më heroike të çetës trime të Çerçiz Topullit ishte Lufta e Mashkullorës, që është edhe një ngjarje e shënuar në historinë e luftërave të popullit tonë për liri. Ato luftime heroike u bënë në këto brinja e gërxhe, që tashti i kenë mbushur me pemë, e për këtë ju lumtë dora juve, grave dhe burrave të fshatit! Edhe Çerçizi me Bajon ju urojnë nga varret e tyre; Hajredin Tremishti ju uron; djemtë dhe vajzat që ranë në Luftën Nacionalçlirimtare, gjithashtu, ju urojnë që këto kodra po i bëni kopshtije. Tash, në këtë përvjetor historik, dhe çdo vit, ne kujtojmë jo vetëm këta, Çerçizin me shokë, por edhe djemtë e vajzat tuaja që ranë në Luftën Nacionalçlirimtare. Varret e tyre Partia e pushteti popullor i kanë bërë aq të bukura, sepse kujtimi i tyre është i shenjtë për popullin tonë.

Ne, më të vjetrit, kemi jetuar edhe kohën e satrapit Zog dhe i kemi mirë parasysh vuajtjet e asaj kohe. Por edhe të rinjtë që nuk e kanë jetuar atë periudhë të zezë, duhet të njihen me të. Ne duhet t'u flasim atyre për vuajtjet e papërshekruara të popullit tonë në ato kohë të vështira. Atëherë unë kam qenë i ri. Isha pa punë dhe rrija në Tiranë. Flija në dhomën e një hoteli me Jonuz Topullin. Hotel «Berlini» quhej.

Në kohën e Zogut të tëra hotelet të tillë emra kishin: «Berlini», «Londra», «Roma».

Një natë xha Jonuzi më tha: «Enver, këta qena s'po na lejojnë të vemi të marrim eshtrat e Çerçizit dhe të Muço Qullit, kemi gjetur belanë me ta, por do të përpiqemi».

Qeveria tradhtarë zogiste krijonte vështirësi pas vështirësish për të penguar sjelljen nga Shkodra të eshtrave të këtyre dy patriotëve. Jo vetëm Ahmet Zogu me Musa Jukën nuk donin, por nuk donte edhe kleri katolik i Shkodrës që eshtrat e këtyre heronjve t'i merrnim e t'i çonim në vendin e tyre, atje ku kishin lindur e kishin luftuar. Më në fund, një natë tjetër, xha Jonuzi më tha: «E fituam. Bëmë ç'bëmë, pas dhjetë ditësh do të nisemi. Në komisionin e ngritur për këtë qëllim patëm edhe disa diskutime.». «Pse patët diskutime, o xha Jonuz?», e pyeta unë. «Sepse disa thoshin të mos e marrim djalin e Halilit me vete. (Ishte fjala për mua, se babanë tim e quanin Halil.) Ai është komunist».

Xha Jonuzi u ishte përgjigjur: «Nuk dua të di unë është komunist, apo s'është komunist. Unë di që është djalë gjirokastriti dhe nipi i patriotit Hysen Hoxha, i cili ka qenë bashkëluftëtar i Bajos e i Çerçizit. Hysen Hoxha ka qenë në Cepo, siç ishin edhe qindra të tjerë të armatosur nga fshatrat tuaja me «Mauzer» e «Maliher», prandaj ai do të vijë me ne».

Kështu vajtëm në Shkodër. Tok me disa fshatarë, zhveshëm palltot, përveshëm llërët, gërmuam tokën e fushës së Shtoit dhe i nxorëm eshtrat e shenjta të Çerçizit nga Gjirokastra e të Muço Qullit nga Erseka

e Kolonjës, një tjetër patriot e gazetar i shquar ky, shok i Çerçizit.

Duke nxjerrë eshtrat e këtyre patriotëve të mëdhenj na kujtohej vaji:

*«Thonë në Karadak të shkretë
Mblodhi kushulla militë
Vranë Çeçon vet i tretë
Çerçiz rovoli me dhjetë
Hipe në pajton të shkretë...»*

Ata hipën në pajton që të vinin kundër Esat Pashës, por i vranë tradhtisht dhe i varrosën atje. Populli i Shkodrës na priti shumë mirë, me entuziazëm, pavarësisht se Musa Juka dhe kleri katolik kishin bërë propagandë kundër nesh. Unë pata nderin që nga ballkoni i bashkisë t'i flisja popullit të Shkodrës për lirinë e përparimin e tij dhe për trimërinë e atyre burrave, eshtrat e të cilëve i kishim përpara.

Por sot, motra e vëllezër, Shqipëria është e çliruar në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe të Luftës Nacionalçlirimtare, luftë kjo që është e lidhur si një zinxhir i pakëputur me të gjitha luftërat e të parëve tanë. Lufta Nacionalçlirimtare, ishte më e madhja dhe më e lavdishmja luftë që ka bërë gjatë gjithë jetës së tij populli ynë. Të gjithë, i madh e i vogël, kur u formua Partia heroike Komuniste e Shqipërisë u ngritën në këmbë, në revolucion, se vendi ishte i okupuar; se qeveritarët ishin mufliza, të poshtër, kusarë e gjakatarë. Nën udhëheqjen e Partisë populli u mobilizua dhe u hodh në Luftën e madhe Nacionalçlirim-

tare, kundër okupatorit, kundër ballistëve e të gjithë tradhtarëve të tjerë të vendit, të cilët u bashkuan me të huajt.

Armiqtë e popullit dhe të atdheut donin që vendi të ishte i robëruar, që të rronin vetë, kurse populli të vuante për bukën e gojës; që në këtë vend të shtroheshin italianët, të zaptounin fushat tona, të na poshtëronin dhe të na zhduknin si komb, të zhduknin gjuhën dhe zakonet tona. Por nuk është aq e lehtë të merresh me shqiptarët. Ja, lëviz dot ky rrap i këtu? Lëvizin dot ato male? Jo, kurrë nuk lëvizin! Populli shqiptar kurdoherë në shekuj ka qëndruar dhe qëndron si këto male e si ky rrap dhe kurrë nuk ka pranuar që të ulë qafën e t'i vihet zgjedha nga të huajt.

Lufta me fashistët italo-gjermanë ishte me të vërtetë e ashpër dhe e vështirë, luftë me shumë sakrifica. U derdh lumë gjaku i djemve dhe i vajzave tona, u dogjën krahina të tëra, veçanërisht këtej; fshatrat e bagëtia u prishën e u bënë shkumb e hi. Por asgjë nuk i trembi shqiptarët. «Liria mbi të gjitha, çlirimi i popullit, këputja e zinxhirëve të robërisë, pa të gjitha të tjerat i vëmë në vend», thoshte populli dhe u hodh në luftë nën udhëheqjen e Partisë.

Dhe kështu u bë, çdo gjë e vumë në vend dhe rrojmë shumë e shumë më mirë se përpara. Të gjithë e shohim se çfarë ka ndodhur. Çdo gjë ka ndryshuar si dita me natën. Sidomos ne, që jemi një çikë të kaluar nga mosha, e kuptojmë më mirë se ku kemi qenë e ku kemi arritur. Edhe të rinjtë e të rejtat kanë mësuar për të kaluarën e vendit nga historia, por ne ndryshe nga ata, i kemi jetuar vetë vuajtjet e asaj kohe.

Sot edhe ju, me përpjekje e me punë të pandërprerë, keni arritur suksese të mëdha në shumë drejtime. Në këto toka ju merrni tani nga 60 kuintalë misër për hektar, bile, ka brigada e sektorë që marrin këtu edhe 100 e 110 kuintalë misër për hektar. Sikur t'i thoshit ndonjërit, në vitet e para të Pasçlirimit, se punojmë që të marrim 110 kuintalë misër për hektar në këto kodra e gërxhe, ai me siguri nuk do ta besonte. Por ja që këto tash u bënë realitet dhe njerëzit tanë rrojnë e po e shohin vetë me sytë e tyre këtë mrekulli dhe thonë: «...kjo Parti i bëri gjithë këto gjëra, ajo me të vërtetë na hapi sytë. Ku ishim më përpara e ku jemi sot!».

Mashkullora ka bërë ndryshime të mëdha edhe në fushën e kulturës e të arsimit. Sa e sa djem e vajza kanë mbaruar shkollat e mesme e të larta! Sa shumë mësues, inxhinierë, oficerë e të tjerë, kanë dalë nga kjo Mashkullorë! Në kohën e luftës buka dhe qepa na kanë mbajtur, se tjetër nuk kishim. Sakrificat e mëdha kemi bërë për lirinë e kësaj toke. Njëzet partizanë të vinin ty¹, xhaxho, në shtëpi dhe ti i mbaje me atë që kishe. «Shtrihuni, o djema, këtu përtokë, se s'kam shtroje, u thoshe, dhe hani këtë krodhë bukë.» Ja, këto ishin sakrificat e njerëzve që e donin si ju me gjithë shpirt atdheun.

Nga fshati juaj kanë dalë njerëz të luftës për çlirim e të luftës së ndërtimit të socializmit që punojnë kudo, punojnë edhe në Tiranë, deri edhe në aparatet e Komitetit Qendror. Shoqja ime Nexhmija, që punon

1. I drejtohet një të moshuarit.

në aparatin e Komitetit Qendror, ka afër një bashkëpunëtor, që është këtej, nga Mashkullora, Sevo Tarifën, që të gjithë e njihni. Këtij Partia i ka besuar punë të madhe, është djalë i zgjuar, djalë i zoti. Po sa ka këtu të tillë si ai? Ka plot të tjerë.

Prandaj, u themi shokëve më të rinj që janë në udhëheqje: «Shikoni, djema, se neve na u zbardhën flokët, punoni që Shqipëria edhe në të ardhmen të qëndrojë e tillë, e papërkulur, e fortë si malet!». Në mënyrë të veçantë të rinjtë duhet t'i mësojmë, t'i edukojmë, t'u japim në dorë pushkën e kalemin që stafetën ta lëmë në duar të sigurt. Ne, nga ana jonë, do t'u rrimë në krahë dhe do t'i ndihmojmë ata me aq sa të mundim, qoftë edhe sikur me shkop të ecim; por prapë, nga një fjalë e nga një këshillë edhe do t'ua themi derisa të rrojmë, që Shqipëria të mos ketë mortje kurrë.

(Xhaxho, i thotë shoku Enver një të moshuari, në qoftë se e pi duhanin, ndize një herë se këtu jemi në haj-somer. Apo e ke lënë, se unë kam kohë që e kam lënë.

«Jo, jo, unë e pi, dhe e pi mirë», përgjigjet ai. Atëherë, pi, se këtu tymin e merr cra, por jo fjalët, se ato futen në mendje! ia ktheu shoku Enver.)

Vendi ynë përparon nga ana e ekonomisë, nga ana e diturisë, nga ana e ndërgjegjes së pastër të njerëzve tanë, që i kuptojnë gjërat shumë mirë e shumë drejt. Por nuk mjafton vetëm të mësosh. Ato që mëson duhet t'i kuptosh mirë e t'i zbatosh. Është e nevojshme të udhëzohen e të këshillohen njerëzit, dhe sidomos këta, të rinjtë e të rejat, që kanë forca më shumë, që t'i vënë në zbatim direktivat e orientimet e Partisë.

Qëllimi ynë është lulëzimi i atdheut, lulëzimi i jetës së popullit, mirëqenia e tij. Të mos kënaqemi me këto që kemi arritur. Këto, natyrisht, janë diçka, janë një bazë e mirë, por e ardhmja do të jetë akoma më e mirë dhe këtë të ardhme do ta krijojmë ne, me punën, me mendjen dhe me duart tona, ashtu siç e kemi krijuar deri më sot. Tani na duket se kemi bërë plot gjëra të mira dhe kështu është në të vërtetë. Por puna është që të bëjmë akoma më shumë. Pse do të arrijmë më shumë? Sepse këta djem të rinj e vajza të reja që porriten në vitet e pushtetit popullor, janë më të mësuar nga ne. Dhe ne vetë po përpiqemi që këta t'i mësojmë sa më mirë se vetëm kështu ata do të punojnë e do të prodhojnë më shumë e më mirë. Prandaj themi ne që e ardhmja e popullit tonë do të jetë më e lumtur.

Ne sot kemi arritur të marrim 35 kuintalë grurë dhe 40 apo 50 kuintalë misër për hektar. Po pse kemi arritur tani të tilla rendimente të larta? Kjo tokë ishte edhe në të kaluarën; e njëjta fushë ishte në Palokastër e në këtë luginë edhe më përpara. Është fare e qartë se atëherë nuk dinim shumë nga agroteknika që ta punonim tokën dhe nuk kishim as mjete me se ta punonim; nuk kishim traktorë, nuk kishim makina bujqësore. Kishim vetëm një parmendë prej druri, pa, sa për qetë, këta dikush i kishte e dikush nuk i kishte. Dikush kishte një ka, dikush tjetër disa bagëti të imëta që jepnin nga 20-30 litra qumësht në vit dhe gjysmë kile ose e shumta 1 kile lesh, vetëm sa për të bërë një brucë dhe një llabane.

«Ç'e bëre brucën me llabane
O more Muço Turani
Të ndiq Golemi prapa»

(I di këto këngë ti xhaxho, apo jo? *i thotë shoku Enver një të moshuari.* «I di, ore, i di mirë», përgjigjet ai.)

Mirëpo kohët ndryshuan dhe sot kemi shumë njerëz të mësuar. Mësimi të nxjerr në dritë. Vënia në jetë e mësimëve, e shkencës, sjell përparimin, rrit mirëqenien e popullit. Pas Çlirimit importuam traktorë e makina që shpejtojnë e lehtësojnë punën dhe shkurtojnë kohën e mbjelljeve, të korrjeve; ngritëm fabrika e prodhuam pleh dhe morëm masa për shtimin e bagëtisë etj., etj.

Dëshiroj t'ju flas një çikë dhe për bagëtinë. Për këtë sektor ne nuk kemi treguar kujdesin e duhur. Ju më duket se i keni nja 20 mijë kokë bagëti të imëta. Mirëpo, edhe sikur t'i bëni 40 mijë, mendoj se nuk është keq, as për ju, as për gjithë vendin. Por, për ta arritur këtë shifër duhet luftë, duhen përpjekje, se vetëm kështu do ta realizojmë çdo gjë.

Është fakt se bujqësia në vendin tonë ka bërë shumë hapa përpara. Ky përparim e zhvillim u bë dhe po bëhet i mundur për arsye të politikës së drejtë të Partisë sonë si në çdo fushë, edhe në bujqësi. Populli ynë, populli i Mashkullorës, populli i të gjitha fshatrave të Shqipërisë kishte hequr të zitë e ullirit për një copë tokë; fshatari e donte tokën që ia kishin rrëmbyer pasanikët. Dhe, kur vendosëm pushtetin e ri të popullit, u bë Reforma Agrare; toka iu dha fshatarit dhe ai u gëzua, e jeta e tij u bë më e mirë. Menjëherë pas

kryerjes së Reformës Agrare Partia shtroi çështjen e krijimit të kooperativave bujqësore. «Shiko, vëlla fshatar, i tha ajo, toka është jotja, po në vend që të kesh 2 hektarë ose 3 hektarë, bëji më mirë 2 mijë hektarë!» «Po si ore u bëkan 2 mijë hektarë?!», thoshte ai. «Po t'i bashkojmë të gjithë hektarët që ka secili, të tëra do të bëhen tonat, kështu që do t'i punojmë së bashku, pse bashkimi bën forcën. Në këtë mënyrë do të ecim më përpara dhe do të jetojmë akoma edhe më mirë». Po të mos i kishim ngritur kooperativat, do të na kishte vajtur dëm lufta që bëmë dhe gjaku i derdhur e nuk do të kishim arritur këto suksese që kemi arritur në bujqësi. Në ato vende ish-socialiste ku nuk u bë kolektivizimi, ku nuk u ngritën kooperativat, atje ku nuk u ndoq rruga që na mësojnë Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini, bujqësinë e kanë në dorë një pakicë njerëzish të pasur. Atje është rivendosur kapitalizmi, kurse te ne një gjë e tillë nuk ka ndodhur e nuk do të ndodhë kurrë, sepse edhe në këtë çështje ne udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi. Por, rëndësi të madhe ka se ky popull i zgjuar, i vendosur e trim, e kuptoi domosdoshmërinë e zbatimit të kësaj direktive të madhe të Partisë, e kuptoi se kjo ishte për të mirën e tij e të socializmit në vendin tonë. Pra, në përgjithësi, fshatarësia e kuptoi këtë direktivë të Partisë, por, në fillim pati dhe nga ata që thoshin: «More pa dale, si ta bëjmë këtë gjë? Mos është më mirë kështu, se unë i kam këta 2 hektarë tokë, e i punoj vetë...» etj., etj.

Më kujtohet njëherë, kur vajta në një kooperativë bujqësore të Tiranës. U futa në një stallë ku mbanin

lopët dhe atje gjeta një plak, ja si zotërinë tënde¹. Ai, në atë kohë, po kashaiste lopët. «Si je, xhaxho, i thashë unë, si shkoni me kooperativën?». «Mirë jemi», më tha ai. «Sa lopë ke këtu?», e pyeta prapë unë. «Kam nja 25 lopë», ma ktheu ai. «Po ti, ke sjellë ndonjë lopë këtu?», i thashë përsëri. «Po, kam sjellë, ja kjo është lopa ime», dhe ma tregoi. Domethënë, prapë ai s'e harronte lopën e tij. «Do të më thuash drejt një gjë, e pyeta, kur u hedh bar gjithë këtyre lopëve, kësaj tënde i hedh ndonjëçikë më shumë?». Ai menjëherë m'u përgjigj: «More, shoku Enver, po djalit tënd ti i jep një copë bukë më shumë se atyre të të tjerëve?». E shikoni, shokë, sa e fortë është ndjenja e pronës private?

Po të ishte Çerçizi gjallë, edhe atij do t'i kënaqej shpirti për të gjitha këto ndryshime që janë bërë këtu, se për të mirën e popullit luftoi edhe ai. Ata të Topullit bënë një familje të madhe, por familja e tyre ishte një familje patriotësh që derdhën gjakun për lirinë e përparimin e këtij vendi.

Unë nuk kam ardhur këtu që t'ju mbaj fjalime e t'ju flas në mënyrë zyrtare. Jo, dua të them nja dy fjalë e të këmbëjmë ndonjë mendim, ja, kështu sikur bëjmë muhabet. Apo jo, moj nënë²? Prandaj t'i mbledhim edhe këmbët e të rrimë këmbëkryq. Vetëm se nuk pi cigare, se po të pija, do ta kisha ndezur një herë. Po ti³ ndize, se je më i ri, dridhe një herë, po dridhe mirë!

1. I drejtohet një të moshuari.

2. I drejtohet një gruaje të moshuar.

3. I drejtohet një veterani.

Fjalën, pra, e kisha të çështja e tokës dhe e pronës personale, për të treguar se sa shumë ishte i lidhur fshatari ynë me të. S'ishte punë e lehtë ta shkëputje fshatarin nga prona e tij vetjake, ishte e zorshme, por, siç thashë, fshatari ynë e kuptoi dhe Partia punon që ai ta kuptojë akoma më mirë rëndësinë e pronës së përbashkët, epërsinë e saj të madhe që i sjell mirëqenien popullit.

Sigurisht, siç thashë, jo të gjithë e kuptuan menjëherë rëndësinë e kolektivizimit. Prandaj edhe Partia nuk u shpejtua, por punoi javash-javash dhe me durim, si për këtë problem, ashtu edhe për të tjerat. Në çdo gjë duhet të mos nxitohemi, të tregohemi të matur, të punojmë me durim. Kështu na kanë mësuar Lenini dhe Stalini. Mua më ka thënë vetë Stalini: «Mos u shpejtoni me kolektivizimin, shoku Enver, ecni me kujdes dhe javash, që të bindet vetë fshatari; mos e detyroni, se po u bind vetë, ai nuk kthehet kurrë nga rruga». Edhe ne kështu vepruam: e filluam javash-javash. «Do të hysh ti në kooperativë?». «Po, dua.». «Po ti tjetri?». «Jo, nuk dua.». «Mirë, atëherë, rri!». Kishte, pra, edhe nga ata që s'donin të hynin në fillim. Pastaj e panë se këta që hynë në kooperativë, merrnin më shumë të ardhura e jetonin më mirë, prandaj, erdhi koha e u bindën edhe ata e u bashkuan me shumicën.

Problem tjetër që na pengonte në ecjen tonë përpara ishte feja, mendimet e zakonet e prapambetura. Por, edhe këtij problemi ia dolëm mbanë. Mbase ju kujtohet një këngë që këndohej për Kavajën: *Kavaja çerek Stambolli*.

Qytet ishte ajo, megjithatë, atje kishte shumë fanatizëm. Kur ishin hequr perçet në të gjithë Shqipërinë në Kavajë gratë vazhdonin t'i mbanin akoma ato. Më në fund, edhe gratë e vajzat e këtij qyteti u bindën për drejtësinë e këshillës së Partisë, u mblodhën dhe vendosën t'i heqin dhe t'i djegin perçet. Në fillim burrave nuk u pëlqente kjo gjë, por javash-javash edhe kjo vështirësi u kapërcye.

Njëherë vajta në Gosë të Kavajës. Në këtë ndërmarrje bujqësore kishte edhe derra, për të cilët kujdesej një plak. «Si je, more xhaxho, i thashë, mirë je?». «Mirë jam», m'u përgjigj ai. Plaku nuk më njohu mua. «Po nga je ti, këtej, nga Kavaja?». «Po», më tha. «Po derrat si i ke?». «Mirë i kam dushmanët», dhe shtyu me shkopin që mbante në dorë një derr që iu afrua. «Po pse, ore xhaxho, i quan «dushmanë». Derrat janë të mirë, kanë rëndësi për ekonominë tonë, se na japin mish, bile na japin më shumë mish se bagëtitë e tjera». «Ashtu është, mor vëlla, ashtu është, po kush je zotërote?», më pyeti më në fund. «Unë jam Enver Hoxha», i thashë. «U... , tha plaku si i hutuar, qofsh shëndoshë!». «Po që derri të të japë më shumë mish, ai do një çikë më shumë kujdes dhe hyzmet, more xhaxho». «Është e vërtetë kjo, prandaj edhe unë u bëj hyzmet», m'u përgjigj ai. «Po si ua bën?» (se e merrja me mend se çfarë hyzmeti u bënte). «Ja, e shikon këtë shkopin e madh, më tha, vetëm me këtë l ngas unë derrat, nuk i zë kurrë me dorë!». «Jo, more xhaxho, e këshillova, e ke gabim, duhet të mësohesh me ta, derrat janë njëlloj si gjithë kafshët e tjera. Do të vij pas disa muajsh këtu prapë dhe do të të shoh». Dhe, pas 8

muajve ai nuk u binte më derrave me shkop, por i kapte me dorë, ua pastronte mirë vendin e kujdesej më shumë për ushqimin e tyre. Domethënë u bind plaku se nuk kishte asnjë arsye që derrin të mos e zinte me dorë dhe ta prekte me shkop. Prandaj Partia thotë se çdo gjë arrihet me edukim dhe bindje.

Kolektivizimi i bujqësisë te ne hapi rrugën e përmirësimit të mëtejshëm të gjendjes ekonomike, shoqërore e kulturore të fshatit tonë. Çështja e bujqësisë për Republikën tonë Popullore Socialiste ka pasur dhe ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Prandaj Partia e Qeveria, gjithë populli, pleq e të rinj, gra e burra, veçanërisht ju, kooperativistët, e jo vetëm ju, por edhe ne që rrojmë në qytete, duhet ta kuptojmë rëndësinë e madhe që ka përparimi i bujqësisë për vendin tonë. Paj një bujqësi të përparuar, as industria nuk mund të ecë me ritmet që duam.

Në radhë të parë, vëmendje dhe kujdes i madh duhet treguar nga ju për drithërat, grurin e misrin, por edhe për lulediellin, në qoftë se e mbillni, për perimet, frutat etj. Për sa i përket blegtorisë, ju duhet të shkëlqeni se jeni «ustallarët» e kësaj dege të ekonomisë kooperativiste. T'i ruani traditat e vjetra që keni pasur për bagëtinë, kujdesin e dashurinë për to. Ta shtoni bagëtinë, duke u mbështetur në eksperiencën e madhe që kanë trashëguar barinj të tuaj; dhe ju keni këtu një eksperiencë të përparuar. Por këtë ta bëni paj lënë pas dore diturinë, shkencën e sotme, me qëllim që bagëtitë t'i keni të racave sa më të larta e sa më të mira. A doni që fëmijët të jenë të shëndetshëm e t'u skuqë fytyra, që kur të zbresin poshtë e t'u ngjiten këtyre

maleve me një frymë, tërt të mos ua bëjë veshi? Pajtjetër që doni, si nuk doni? Prandaj, që të na rriten të fortë e të shëndoshë fëmijët, duhet qumësht, duhen gjizë e djathë në napa, duhen gjalpë dhe kos, duhet lesh për t'u veshur, por duhen edhe lëkurë për këpucë, se tashti nuk bëjmë opinga si dikur, por kemi ngritur shumë fabrika që na prodhojnë këpucë të bukura.

Partia ka bërë kujdes të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm dhe të shpejtë të blegtorisë, duke përgatitur kuadro me arsim të posaçëm, që të dinë se si duhet të përmirësohet raca e bagëtive, si të zbatohet ndërzimi artificial etj. Përmirësimi i racës në bagëtitë e imëta ka një rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj duhet të përpiqemi që të kemi raca sa më të mira për mish, për lesh e për qumësht. Por, kur themi të kemi racë për lesh, nuk them ta bëjmë siç bënin disa fshatarë në kohën e Zogut, që venin qethnin delet e të tjerëve. Jo, ne duam lesh nga delet tona, s'i biem njeriut në qafë. Por, ama, nuk na lejohet të marrim 1 kile e gjysmë lesh për kokë, po të marrim 5-6 kile. Bile dhe kjo s'është ndonjë shifër e madhe, sepse ka të barinj që kanë arritur të marrin edhe 8-9 kile lesh nga një dele. Ka kooperativa dhe stacione të përmirësimit të racës në Shqipëri, si në Korçë, në Shkodër e gjetkë që kanë arritur të marrin mesatarisht, nga të gjitha bagëtitë e imëta, 5-6 kile lesh. «Po pse, ore shokë, duhet të thonë ju, të rrimë ne, mashkulloritët, që kemi rrojtur tërë jetën me këto dele dhe të na e kalojnë korçarët? Jo, ore jo!». Kështu duhet të ndodhë, shokë, duhet të kemi një çikë sedër, sedër që të na shtyjë të ecim përpara.

Unë mendoj se ju duhet të merrni masa që gje-

ndja e blegtorisë të ju të ndryshojë. Për këtë ju këshilloj të mbështeteni në ato që thonë veterinerët për përmirësimin e racës së bagëtisë. Deshtë e vjetër mistrecë, më mirë t'i dërgoni në kasaphanë dhe t'i zëvendësoni me desh të shëndoshë të racës. Dhe ndërzimi më i mirë dhe më i kontrolluar është ndërzimi artificial. Vetëm kjo mënyrë kërkon një kontroll mjekësor të shëndoshë e, që të ketë sukses, duhet të bëhet në kohën e duhur.

Domethënë, për të mirën e kooperativave ju duhet ta shtoni blegtorinë, bagëtinë e imët, pa harruar edhe përmirësimin e racës. Se, siç thashë, ne duam jo vetëm lesh më shumë, por edhe qumësht e mish më shumë. Ju merrni 45-50 litra qumësht në vit nga disa dele, por mendoj dhe ka mundësi të merrni edhe më shumë. Po lesh sa merrni? 2 kilogramë për kokë. Kjo do të thotë se keni ecur përpara, veçse kjo ecje është si hapi im dhe i këtij xhaxhos që kam këtu pranë, i ngadalshëm. Kur them që të ngrini rendimentin nuk e kam fjalën për kaq, Partia dëshiron që hapi juaj përpara të jetë më i madh. Pra, bagëtinë e imët ta shtoni e ta përmirësoni, siç thamë, por këtu duhet të mbani edhe lopë, se keni toka të rënda dhe të mira. Mbillni jonxhë, por sidomos lakër. Ju e dini më mirë se unë që ushqimi ka rëndësi për bagëtinë, siç ka rëndësi për to edhe kujdesi e ndërzimi etj. Të tëra këto e bëjnë racën më të mirë. Kur të vij herë tjetër këtu, kam bindjen se do të gjej ndryshime më të mëdha.

Unë nuk do të rri më 9 vjet pa ardhur në rrethin tuaj si këtë herë, se për këtë mungesë «më dhanë dru» në Gjirokastrë. Mirë, por edhe unë e dini ç'u bëra? E

dimë që gjirokastritët janë një çikë të kursyer, prandaj u thashë: «U ankuat që kisha 9 vjet pa ardhur këtu?! E po mirë atëherë, edhe unë këtë herë do të rri 9 ditë». (*Duartrokite.*) Besoj se nuk do të ma bëjnë, siç ua bëri njëri disa miqve që nuk ia kishin parë kurrë derën, veçse kur i vdiq plaka. Është një histori e gjatë kjo, por unë do t'jua tregoj shkurtimisht. «U bënë nja tre-katër shokë dhe thanë: «Nuk vemi tek ai, siç e kemi zakonin e të rrimë ca ditë, me këtë rast që i vdiq plaka?» I he kështu bënë. Vajtën në shtëpinë e tij dhe e ngushëlluan. Natyrisht, atë ditë, të zotët e shtëpisë i mbajtën për drekë. Miqtë pinë raki, hëngrën bukë, pastaj u kumbisën një copë herë dhe apostafat u ngritën vonë pasdreke. I zoti i shtëpisë e mori vesh që këta nuk kishin ndër mend të iknin atë natë, prandaj i tha nuses së djalit: «Bëna gjellë për sonte». «Si urdhëron!», i tha nusja. Miqtë hëngrën mirë e mirë edhe darkën. Të nesërmen u ngritën vonë e hëngrën mëngjesin, pastaj edhe në drekë kthyen përsëri nga një gotë dhe kështu, që thoni ju, këta na ndenjën nja tri ditë mysafirë në këtë familje. Të tri ditët i mbajti mirë miqtë, i shkreti plak. Pastaj, vetë këta thanë: «Hajde tani, të kthehemi në shtëpitë tona se e tepëruam». Pra, edhe këta dolën nga shtëpia, i dhanë dorën të zotit të shtëpisë dhe e falënderuan se kishin mbetur të kënaqur nga mikpritja. Po sa bënë 2-3 hapa, plaku i shtëpisë i thirri dhe u tha: «Pa hajdeni, afrohuni një çikë se kam një fjalë për t'ju thënë!». Dhe ata u kthyen. «Çfarë ke?», e pyetën miqtë. «Putheni këtë prag të derës sime, se nuk do ta kaloni dot më!». (*Të qeshura.*)

Partia, përveç bujqësisë, vëmendje të madhe i ku-

shton edhe zhvillimit të industrisë. Të dyja këto degë të ekonomisë janë të lidhura ngushtë e duhet të ecin krahas njëra-tjetrës, ato janë si dy këmbët e njeriut. Dhe ekonomia jonë duhet të ecë me të dyja këmbët, edhe me bujqësinë, edhe me industrinë.

Duam grurë, duam të hamë mirë, por duam të vëmë edhe rezerva në depo, që t'i kemi për kohë të këqija. Sikur dikush, të guxojë të na sulmojë, do të ngrihet i tërë populli në luftë e nuk do të lëmë këmbë armiku të shkelë tokën tonë. Të gjithë, në det do t'i hedhim, mu në rërë do t'i palosim. I ke parë ti, xhaxho¹, ato qendra zjarri që po ndërtojmë këtu rreth e qark fshatit e kudo? («Po, po si nuk i kam parë», *përgjigjet ai.*)

E, që t'i kalojë armiku ato, duhet të futet në vërë të gjilpërës. Mirëpo, po të futet te vëra e gjilpërës, do t'i fluturojë koka.

Por, siç thashë, ne edhe industrinë do ta zhvillojmë akoma më shumë dhe do të prodhojmë gjëra të bukura për fëmijët, për të rinjtë e të rejat, për gratë dhe për burrat, me mineralet që do të nxjerrim nga toka jonë, të cilën akoma nuk e kemi zbuluar plotësisht se çfarë mban brenda në thellësi të saj. Shqipëria është e vogël, por e pasur. Këta djemtë tuaj, që mbarojnë shkollat, me pëllëmbë duhet ta gjesdisin këtë tokë, me «aletet» që kanë, për të zbuluar ku ka naftë, ku ka gaz, ku ka krom, ku ka flori, manganez e ç't'ju them unë tjetër, se në vendin tonë ka nga të gjitha këto. Shumë minerale kemi gjetur e kemi zbuluar gjer tani,

1. I drejtohet një veteranit.

por duhet të zbulojmë akoma më tepër që t'i shtojmë rezervat, se ne nuk mendojmë dhe nuk punojmë vetëm për sot, por mendojmë e punojmë për të rrojtur gjithnjë mirë e më mirë. Çdo gjë Partia e mendon, e peshon dhe e llogarit si nikoqire e kujdesshme, e rregullon punën në mënyrë të tillë që jo të kemi të hamë sot e nesër të mbetemi me gisht në gojë, por të kemi vazhdimisht, bile çdo vit e më shumë.

Që të shkojë përpara çdo sektor i ekonomisë sonë duhet të mendojmë e të punojmë që t'i bëjmë ballë çdo vështirësie dhe t'i kapërcejmë ato me sukses. Partia i la mënjanë metodat e vjetra që përdreshin për stërvitjen dhe për përgatitjen e ushtrisë. Ajo ka dhënë direktivën e madhe që gjithë populli të jetë ushtar. Të tërë ju, në ditët e caktuara merrni pushkët, vishni rrobat ushtarake dhe stërviteni nga oficerët, por, në fakt, ju jeni vetë oficerë. Këtë, shokë, nguliteni mirë në mendje, pa ju, as Komandanti i Përgjithshëm, as Komanda e Përgjithshme, as oficerët e të gjitha njësive nuk mund të kenë sukses në luftë. S'ka dyshim që ne do të jemi në vijë të parë, por kërkojmë që edhe ushtari më i fundit të zotërojë Artin Ushtarak të Luftës Popullore dhe, në stërvitjet që bën ta njohë mirë vendin, t'i njohë me pëllëmbë këto gërxe e male. Ne kërkojmë nga të rinjtë e nga të gjithë që, në çdo rast, kudo ku të venë, edhe kur të shkojnë, fjala vjen, për të parë të afërmit e tyre, të hapin sytë e ta shikojnë me kujdes vendin rreth e rrotull; të vënë re ku është gërxi, ku është qafa, ku është mali, ku është hende-ku, ku është ky ose ai objekt, me qëllim që t'i dinë

mirë e në hollësi se ku janë «vrimat», që, kur të na futet «miu» në dhokan, «trëk», ta kapim brenda.

Gjithë populli pra, duhet të përgatitet mirë ushtarakisht, ta njohë pëllëmbë më pëllëmbë vendin, sepse jemi të rrethuar nga armiq të egër, imperialistë e revizionistë. Edhe titistët i kemi armiq, pavarësisht nga marrëdhëniet që mbajmë me ta. Jugosllavia është shitur kokë e këmbë tek të huajt, prandaj ky vend jeton i zhytur në borxhe të mëdha. Kurse me sovjetikët dhe me amerikanët nuk kemi fare marrëdhënie.

Me Greqinë nga ana qeveritare, kemi marrëdhënie normale, dhe kjo është një gjë e mirë. Por në të kaluarën kemi vuajtur shumë nga shovinistët grekë. Ju e mbani mend se si na dogjën Hormovën.

Edhe Italia, me të cilën kemi marrëdhënie shtetërore, na ka sulmuar dy herë në të kaluarën. Në ka vend më kaotik në botë, është ajo. Kusarët e terroristët atje janë sheshit, vrasin e vjedhin. Çdo ditë populli në Itali bën greva e demonstrata. Një krizë e rëndë e ka mbërthyer fort këtë vend, përditë çmimet ngrihen në qiell dhe masat vuajnë nga uria dhe papunësia.

Ne sot jemi populli më i lirë në botë dhe për këtë të gjithë na pyesin: «More, po si bëni ju kështu? Të tërëve me dru në kokë u keni qëndruar. Ju lumtë!». Dhe ne u përgjigjemi: «Veprojmë kështu, se jemi të fortë, se popullin e kemi në këmbë, të kalitur dhe të edukuar mirë, se kemi një Parti të fortë si çeliku që është e lidhur ngushtë me popullin. Ne jemi të fortë se bukën e prodhuam vetë, sepse ecim me plan dhe çmimet nuk i ngremë kurrë. Te ne nuk ka papunësi, përkundrazi kemi nevojë për forca punëtores». Kurse në

vendet kapitaliste numri i të papunëve ka arritur rreth 110 milionë veta. Pra, gjithë kjo masë njerëzish në këto vende s'kanë bukë të hanë dhe bëjnë demonstrata. Mirë bëjnë, po çështja është që klasa punëtore dhe gjithë masat e shfrytëzuara të ngrihen në beteja të atilla që t'u zënë grykën e t'i përmbysin ata që i shtypin dhe të marrin vetë fuqinë në dorë e të vendosin pushtetin e tyre.

Që vendin tonë të mos guxojë ta prekë kush, që ai të jetojë në shëkuq i lirë dhe në begati, ne po marrim masa që të forcohem edhe ushtarakisht, ashtu siç po forcohem ekonomikisht. Atë qeder që kemi ne për ekonominë, për zhvillimin dhe për forcimin e bujqësisë e të industrisë, që jeta e popullit të bëhet çdo ditë e më e mirë, atë qeder duhet të kemi vazhdimisht, ditë e natë edhe për stërvitjen ushtarake. Kurdoherë ta kemi syrin pishë dhe gishtin në shënjestër. Armët që kemi, dhe kemi armë të çdo lloji, gjithsecili t'i mësojë mirë, të dijë t'i përdorë me lehtësi që të jetë i përgatitur kur të jetë nevoja. Kështu armiqtë s'kanë ç'na bëjnë, na marrin të keqen. E kundërta, do të ndodhë, po ta lëmë veten e të bëhemi të dobët, në kurriz do t'i kemi.

Ç'po ngjet sot në botë? Për këtë çështje nuk dëshiroj të zgjatem, sepse këta pleqtë që kam pranë u lodhën një çikë, vetëm ju vë në dukje se kudo ka turbullira të mëdha. Pse ngjasin këto turbullira? Sepse ata që janë majmur me gjakun e punonjësve duan të vazhdojnë t'i rrjepin popujt gjithnjë e më shumë. Mirëpo popujt kudo janë zgjuar dhe kanë filluar t'u kundërshtojnë. Kundërshtimi i popujve shkakton kundër-

goditje nga ana e sundimtarëve kapitalistë. Kështu, goditu një herë, goditu dy herë, pesë apo njëzet herë, siç na mëson Lenini, dhe «kapaku i kuisisë» do t'ia bëjë më në fund «fap» e do të hidhet në hava, pastaj na e morën të keqen kapitalizmi dhe imperializmi. Ata do të përmbysen me siguri nga popujt. Kjo ditë do të vijë, natyrisht, jo përnjëherë. Të gjitha vendet përbëjnë hallkat e një zinxhiri të vetëm. Por vjen një moment, siç na ka mësuar Lenini, që një ose disa hallka të këtij zinxhiri dobësohen dhe fillojnë të këputen nga revolucionin proletar: «trëk» një këtu, «trëk» një atje dhe në këto vende do të vendoset më së fundi shteti i punëtorëve dhe i fshatarëve. Brezat e ardhshëm do të arrijnë të shikojnë që të këputen njëra pas tjetrës jo një, por me dhjetëra hallka të zinxhirit të kapitalizmit. Për këtë po lufton sot proletariati kudo në botë.

Partia jonë është e vogël, por e fortë, se ndjek një politikë të drejtë marksiste-leniniste. Edhe të tjerët e shikojnë se politika dhe qëndrimet tona janë të drejta. Njerëzit kanë sy e veshë, njihen me realitetin dhe e kuptojnë se kush ka të drejtë, Shqipëria apo Kina. Shumica në botë pohojnë se drejt e ka Shqipëria dhe jo Kina. «Kjo ka shkarë nga binarët, dëgjojmë të deklarojnë ata, kurse Shqipëria qëndron në rrugë të drejtë». Njerëzit e konstatojnë këtë realitet dhe thonë të çuditur: «Si ecën dhe si vepron Shqipëria që qëndron kaq e fortë dhe e patundur?». «Kazani» zien, nga të katër anët e botës jo vetëm në Evropë, në Afrikë e në Azi, por edhe në Amerikën e Veriut dhe në atë të Jugut. Dhe në këtë «zierje të kazanit» opinionin përparimtar botëror, vlerëson qëndrimin e drejtë të Partisë së Pu-

nës të Shqipërisë që u tregon vendin kapitalistëve e revizionistëve. Ne nuk mburremi për këtë, por e kemi për nder dhe e konsiderojmë si detyrën tonë.

Autoriteti i vendit tonë në botë, shokë, është i madh. Ky autoritet e ka burimin në forcën e popullit dhe në vijën e drejtë të Partisë. Prandaj ta duam Partinë me gjithë shpirt, të jemi të lidhur me të si mishi me kockën. Edhe Partia ta dojë, gjithashtu, me shpirt popullin dhe t'i shërbejë atij me besnikëri. Komunistët duhet të jenë kurdoherë të ndershëm, të sjellshëm, kurrë të mos e zemërojnë e ta bëjnë të pakënaqur popullin. Kjo nuk do të thotë që kur ndonjëri bën një veprim të gabuar ose thotë ndonjë fjalë të keqe, të mos i thuhet: «Po dale, more mik, nuk duhet të veprosh kështu, eja në rrugë të drejtë!». Këtë duhet ta bëjmë medoemos. Sigurisht, ata që bëjnë ndonjë veprim të gabuar ose flasin keq, domethënë ata, në çardhakun e të cilëve fryjnë akoma lloj-lloj erërash, janë të paktë. Me këta njerëz duhet të punojmë që t'i ndreqim, në mënyrë që situatën brenda ta kemi vazhdimisht të fortë e Shqipërinë ta mbajmë kurdoherë të shëndoshë e të lulëzuar. Në këtë mënyrë me shembullin tonë ne ndihmojmë edhe shokët tanë revolucionarë, kudo në botë, që vuajnë nën sundimin e egër kapitalist.

Pse e duam ne Stalinin? Pse kemi pasë folur dhe flasim me respekt e dashuri për Leninin, për Stalinin e për Ushtrinë e Kuqe që udhëhoqën ata? Sepse Lenini dhe Stalini na ndihmuan me ideologjinë e tyre, se Ushtria e Kuqe, gjatë Luftës së Dytë Botërore vërtet nuk erdhi në Shqipëri por megjithatë, pa Stalinin dhe

pa Ushtrinë e Kuqe nuk thyheshin dot gjithë ato hordhi gjermane. Ushtria e Kuqe, e udhëhequr nga Stalini, u dha «sëpatën e madhe», por edhe ne u dhamë fashistëve italo-gjermanë një «sëpatë» jo të vogël. Ne vërtet u çliruam vetë, por ndihma e Ushtrisë së Kuqe që drejtohej nga Stalini ishte e madhe. Edhe lufta jonë sot është një eksperiencë e çmuar që u shërben popujve të tjerë.

Shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër,

Sot bëmë së toku një muhabet të ngrohtë e të lezetshëm. Unë ju fola një çikë më shumë, prandaj të më falni, por ja që më kishte marrë malli e dëshiroja t'ju shikoja e të këmbenim dy fjalë me njëri-tjetrin. Po edhe shokët e udhëheqjes së Partisë më thanë: «Shko në Gjirokastër, shko edhe në Mashkullorë; folu atje shokëve dhe shoqeve kooperativistë e u jep shumë të fala të gjithëve nga ne; uroi për sukseset dhe këshilloi nga ana e Partisë që të mos kënaqen me ato rezultate që kanë arritur, por të ecin akoma më përpara, t'i realizojnë të gjitha planet ekonomike, kulturore, arsimore e ushtarake që u janë caktuar!». Dhe unë erdha, ju pashë, bisedova dhe mbeta jashtëzakonisht i kënaqur nga ky takim me ju. Prandaj, nuk do ta harroj kurrë këtë ditë, këtë pritje kaq të nxehtë tuajën. Kjo shpreh atë dashuri të madhe që keni ju për Partinë, për atdheun dhe për mua, që jam një ushtar i Partisë dhe i popullit.

Të rrojë Partial

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë!

Të rrojnë mashkulloritët e mashkulloritet dhe fshatarët e fshatrave të bashkuara në kooperativën tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
kësaj vizite, që gjenden
në AQP*

PUNA JEP REZULTATE MË TË MIRA KUR BASHKOHET ME DITURINË E ME SHKENCËN

*Nga biseda në takim in me një grup kuadrosh
të Mashkullorës*

20 mars 1978

Në fillim, kryetari i kooperativës së bashkuar të Mashkullorës Flamur Çani informoi për arritjet e kooperativistëve dhe për ndryshimet e thella që kanë pësuar fshatrat e kësaj ekonomie dhe jetesa e banorëve të tyre. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Siç ju thashë më parë, kur fola para popullit të rrapi, unë e kam ndjekur punën tuaj dhe kam pasur një ide të qartë për gjendjen e kësaj kooperative. Por sot, që dëgjova kryetarin e kooperativës, i cili na foli thjesht, ashtu siç duhet, dhe na dha një pasqyrë të qartë për rezultatet e mira që keni arritur, u kënaqa ca më shumë. Këtë situatë kaq të gëzueshme e të shëndoshë që është krijuar këtu, te ju, do t'ua raportoj shokëve të mi në Tiranë dhe kudo që do të më bjerë rruga të shkoj e të-bisedoj, do t'i përmend si shembull realizimet tuaja të mira, sidomos në drithërat e bukës.

Por mos harroni të më njoftoni kur ta rritni më

shumë edhe sasinë e leshit që do të merrni nga bagëtitë e imëta. Pastaj, jo si lokalist, por ama me gojën plot, do t'u them të gjithëve që «Atje, në kooperativën bujqësore «Cepo» të Mashkullorës së Çerçizit, marrin 4 kilogramë lesh për çdo dele». Po, këtë kam shumë dëshirë ta them!

Rëndësi të madhe për të pasur rezultate të mira ka kombinimi i eksperiencës, i punës praktike me njohuritë shkencore. Puna është ajo që të nxjerr në dritë, por puna jep fryte më të mira kur bashkohet me diturinë, me të dhënat e shkencës e të teknikës së përparuar. Natyrisht, të rinjtë e të rejat duhet të venë për këtë qëllim në shkollat bujqësore që të mësojnë, por, i këshilloj ata që të njohin mirë dhe eksperiencën e bujqve të vjetër. Ata ta kuptojnë se është pikërisht eksperiencia e madhe praktike e punonjësve të bujqësisë e kthyer në dituri, në shkencë, ajo teori me të cilën ata njihen, e mësojnë dhe e përvetësojnë në shkolla e në kurse, dhe pastaj bëjnë përpjekje për ta vënë në zbatim.

Ka bujq që, më parë se ta mbjellin grurin apo misrin, e provojnë tokën me dorë dhe, duke u bazuar në eksperiencën e tyre të madhe, njohin nëse ka ardhur apo nuk ka ardhur akoma koha për ta mbjellë. Pra ata, në bazë të kësaj eksperience, e dinë mirë se kur duhen mbjellë gruri apo misri, dhe, kur vërejnë që toka, nuk ka këtë apo atë kusht, atëherë thonë që nuk është akoma koha për të mbjellë drithërat. Për këto që thonë ata i ka mësuar praktika e tyre dhe e paraardhësve të tyre, dhe kjo u jep siguri e rezultate në punë.

Gjithë eksperiencia praktike e njerëzve kthehet brez pas brezi në shkencë. Edhe Karl Marksi, teoricieni më i madh që ka parë historia, njeriu që me konkluzionet e tij shkencore vuri në lëvizje njerëzimin, zhvillimin e të cilit ai e ndiqte këmba-këmbës, duke përgjithësuar eksperiencën praktike të luftërave të proletariatit, argumentoi në mënyrë shkencore se si do të merret në dorë pushteti nga ana e tij. Lufta e proletariatit të Parisit që u ngrit në këmbë, dhe, megjithëse i rrethuar nga ushtritë gjermane të Kajzerit e Bismarkut, luftoi, mori në dorë fuqinë dhe krijoi pushtetin që u quajt Komuna e Parisit, ishte një eksperiencë e çmuar që i shërbeu Marksit për zhvillimin e teorisë së revolucionit. Kur ndodhi kjo ngjarje Marksi ishte në Londër dhe kishte formuar Ligën e Komunistëve. Komunarët e Parisit formuan këshillin dhe atëherë ai tha: «Komunarët e Parisit po sulmojnë qiejt». Nga kjo Marksi arriti në konkluzionin se Komuna e Parisit është forma më e përshtatshme e diktaturës së proletariatit. Lenini këtë konkluzion e zhvilloi në sovjetët, kurse Partia jonë e realizoi në këshillat nacionalçlirimtarë. Ç'dua të them me këtë? Dua të them se shkencën është konkluzion i praktikës, se teoria bazohet në praktikën e madhe të njerëzve.

Edhe ju keni eksperiencë të pasur për blegtorinë, domethënë keni dituri të gjerë në këtë fushë. Arsyeja përse i bie zamares, përse i bie fyellit, bariu që ruan kopenë, e di mirë. Ai mund të thotë se i bie edhe për qejfin e tij dhe kjo nuk përjashtohet, por nuk i bie vetëm për këtë. Kur bariu i çon bagëtitë për të pirë ujë apo në kullotë në kodra, ai ia merr shtuar melo-

disë me fyell, që bagëtia të ndiejnë kënaqësi, të qetësohen, të hanë, të pinë me qejf dhe të japin më shumë qumësht. Nga të gjitha këto raste ka dalë konkluzioni se bagëtia e do muzikën, se bagëtia e imët edhe lopët, kur hanë ose kur pinë, duan qetësi etj., etj. Sigurisht, barinj të kanë vënë re në praktikë këtë që unë e kam mësuar nga librat. Edhe qenin që ruan bagëtinë, bariu nuk e lë t'i bjerë kopesë përmes, por të shkojë anës e anës, jo sepse ka frikë, se në kope s'ka ujë, por sepse, duke vepruar kështu, nuk e shqetëson tufën e dhenve apo të dhive.

Njerëzit vërtet e duan muzikën, por të mos harrojmë se edhe bagëtia e do muzikën. Prandaj porositim që nëpër stalla të vini nganjëçikë muzikë të lehtë, kur lopët hanë, u vini të dëgjojnë ndonjë këngë të butë, një labçe të shtruar, fjala vjen, se edhe ju këngën shtruar e merrni.

Meqenëse ra fjala për këngët dua t'ju them se ato që këndon grupi artistik i Mashkullorës, unë i kam të regjistruara të gjitha në magnetofonin tim dhe i dëgjoj herë pas here, sepse më pëlqejnë. Por, t'ju them të drejtën, nuk më pëlqejnë ato këngë ku flitet shumë për mua, prandaj duhet të flitet më pak. Bukur e këndon ju një këngë që i kushtohet ushtrisë, zile ju shkon fare ajo. Mua po e po që më pëlqen kënga juaj, por edhe Nexhmijes i pëlqen. Kjo është dibrane, por e kam bërë edhe atë gjirokastritë. Edhe fjalët e këngës i keni ujdishur bukur: «Nuk do të ketë më kufi...»¹.

SHOKU FLAMUR ÇANI: Ja, ai shoku atje që ia

1. Varg i një kënge popullore.

merr¹, dhe ky tjetri² i bëjnë këto këngë, kurse ky këtu³, ia kthen.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju lumtë!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: A ia marrim edhe ne këtu një herë këngës?

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'kisha për të thënë, i thashë të gjitha. Prandaj, mirë thotë Nexhmija, nuk ia marrim një herë këngës shtruar të gjithë? Afrohuni më shumë! Po shikoni, mos e merrni me zë të lartë se nuk ju shoqëroj dot, se zërin unë e kam të ulët. Po cilën këngë do të këndojmë atë të ushtrisë, apo ndonjë tjetër?

(«Më mirë këndojmë një tjetër, shoku Enver», i përgjigjen ata.)

Mirë, një tjetër. Unë nuk di të këndoj mirë, zakonisht këndoj vetëm dhe, kur këndon vetëm, herë ia merr, herë ia kthen, prandaj mos ma vini re sot. Hajdini dhe ca këtej se dua që t'ia themi këngës të gjithë.

Sot u kënaqa shumë këtu!

T'ia marrim këngës tani, shtruar-shtruar.

Grupi i Mashkullorës bashkë me shokun Enver fillojnë të këndojnë këngën e Çerçiz Topullit...

I drejtohet atij që ka pranë:

Ti ia ktheje mirë, po, po, më kënaqe. Kurse unë, e di si ta kthej, si pas orës 12⁰⁰ domethënë pasi jemi lodhur.

-
1. Ismail Dada.
 2. Niaz Çani.
 3. Mufit Matushi.

Hajde, merrjani një herë asaj kënge të vjetër që fillon me këto vargje që mbaj mend!

*«Doli Gjolekë spanoi
Tafil Buzit të m'i thoi...»*

(«Nuk e dimë atë», përgjigjen disa.)

Mirë, atëherë merrjani një kënge që dini ju.

(Të gjithë ia nisën të gëzuar këngës për Abdyl Frashërin...)

Ju lumtë goja! Ashtu siç është tamam historia flet edhe kënga. Bismarku ka qenë një kancelar dinak dhe i egër. Ai ka thënë që nuk merrej me kasollet e Shqipërisë. Mirëpo Abdyl, siç thotë kënga popullore, u ul në skami dhe i tha: «Ne nuk jemi as grekë, as bullgarë, as nga Mali i Zi, por jemi shqiptarë dhe duam të rrojmë në liri!». Ç'padrejtësi të mëdha kanë bërë me popullin dhe me atdheun tonë Fuqitë e Mëdha imperialiste!

Nga vizita këtu, në Mashkullorë, të gjithë mbetëm shumë të kënaqur. Unë nuk do ta harroj asnjëherë këtë ditë që ju shokë e shoqe ma bëtë kaq shumë të gëzuar, duke shprehur kështu, me këtë pritje të ngrohtë, dashurinë e madhe që keni për Partinë.

Të gjithëve ju uroj nga zemra shëndet e dashuri për Partinë dhe për atdheun. Edhe ne do të punojmë për ta merituar këtë dashuri e besim që ju ushqeni për Partinë.

Personalisht ju jap fjalën se, derisa të rroj, do të luftoj me gjithë shpirt për popullin tonë trim.

Kur del përjashta i drejtohet popullit:

Atje brenda ia morëm edhe këngës. Këndoni mirë ju mashkulloritët. Edhe unë ia mora këngës tok me ta, por këndova ashtu, siç i thonë një fjale, si pas orës 12⁰⁰.

Ju faleminderit të gjithëve për këtë pritje kaq të përzemërt që më bëtë!

Të na rrojë Partia! Të rroni ju!

Mirupafshim, shokë, mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

**NË ÇDO NDËRTIM E RESTAURIM,
NË GJIROKASTËR, TË RUAJMË
KARAKTERISTIKAT E QYTETIT**

*Nga biseda me kuadro drejtues të rrethit
të Gjirokastrës*

21 mars 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Mendova të mblidheshim e të shkëmbejmë ca mendime këtu së toku. Keni ju ndonjë gjë për të na thënë? Si ju venë punët, shokë?

SHOKU ALI MANAJ: Koha e keqe, me shira të pareshtura po na pengon ca në përgatitjen e ugareve, sidomos për mbjelljen e lulëdiellit.

SHOKU ENVER HOXHA: Zakonisht muaji mars në vendin tonë është me lagështi. Sipas buletinit që dëgjuam mbrëmë, deri në datën 30 mars koha do të vazhdojë të jetë me reshje. E morët veten me jonxhën, planin e së cilës nuk e realizuat dot vitin e kaluar?

SHOKU ALI MANAJ: Sivjet ne do ta realizojmë planin, por Ministria e Bujqësisë na e ka ulur mjaft sipërfaqen e kësaj bime, meqenëse vitin e kaluar nuk e realizuam rendimentin e parashikuar.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po ç'argumente ju dhanë në Ministrinë e Bujqësisë për këtë pakësim që i bënë sipërfaqes së jonxhës, në rrethin tuaj?

SHOKU RESUL ZANI: Asnjë argument tjetër nuk na dhanë, veç arsyes së mosrealizimit të planit si global dhe veçanërisht të rendimentit. Përveç Dropullit, që e kishte traditë këtë kulturë, filluan ta mbjellin edhe Mashkullora, Ndërmarrja Bujqësore dhe Vriseraja.

SHOKU ENVER HOXHA: Jonxhës Gjirokastra ia kishte marrë dorën mirë, bile ia kishte kaluar edhe rrethit të Dibrës, që më përpara mbante rekordin në këtë bimë.

Ti, shoku Neshet, je kryetar i komitetit ekzekutiv të qytetit. Ke gjë për të na thënë për qytetin e Gjirokastrës?

SHOKU NESHET HOXHA: Sivjet popullsia në qytet ka arritur në 20 000 banorë, megjithëse disa mijëra njerëz janë larguar.

SHOKU ENVER HOXHA: Në kohën tonë Gjirokastra kishte vetëm 12 000 banorë. Tani, megjithëqë janë larguar shumë njerëz, prapë ka rritje të popullsisë në qytet.

SHOKU NESHET HOXHA: Këtë vit po përpiqemi të përgatitemi mirë për festivalin folklorik që do të bëhet në vjeshtë. Me këtë rast mendojmë të ndërtojmë edhe unazën e qytetit me kalldrëm ku të punojë rregullisht një linjë autobusi.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo rrugë do të jetë shumë e gjatë. Prandaj mendimi im është se nuk ka arsye të synohet që e gjithë kjo të bëhet me kalldrëm, se kushton shumë, por rrugë e zakonshme. Do të jetë

e mjaftueshme që ajo të pastrohet nga gurët dhe popëlat, të mbushen gropat dhe kaq. Pra, të ndërtohet e të sistemohet si gjithë rrugët e tjera malore për të plotësuar nevojat e popullit.

SHOKU NESHET HOXHA: Me kalldrëm do ta shtrojmë rrugën atje ku e kërkon vetë terreni, do të ngrihen edhe disa mure. Për këtë qëllim kemi marrë edhe disa kopshte në anë të rrugës.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Pse të ndërtohet me kalldrëm gjithë kjo rrugë? Ajo mund të ndërtohet edhe duke hedhur rërë të imët bituminoze.

SHOKU ENVER HOXHA: Është e vërtetë që rruga me kalldrëm bëhet e bukur. Unaza mund të ndërtohet kështu deri në njëfarë vendi, pastaj ajo le të shtrohet me rërë bituminoze, ashtu siç thotë Nexhmija, ose me asfalt. Një rrugë e ndërtuar në këtë mënyrë nuk e prish aspak bukurinë e qytetit.

SHOKU NESHET HOXHA: Ne kemi filluar ta ndërtojmë rrugën me kalldrëm nga pazari që shkon te Angonatët, por sistemimin e saj mendojmë ta çojmë deri te Hasanajt. Pastaj do të punojmë për rrugën nga shtëpitë e Kokalarajve deri te Kallajxhinjtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se doni ta bëni këtë lagje një çikë më të bukur, rregulloni e meremetoni muret e rrëzuara dhe pastroni mirë ambientet rreth saj, sidomos nga shtëpitë e Vehapit, të Çanoles, të Kamberit e deri te Bejko Gaxhella. Po të duhet, të shkohet edhe më tej. Ky pellg shtëpish ka disa karakteristika të veçanta me vlerë arkitekturore, që tërheqin vëmendjen e vizitorëve, prandaj duhen mbajtur

e ruajtur mirë si vetë shtëpitë, ashtu dhe ambientet përreth tyre.

Autobusi urban i unazës mund të shkojë deri te shtëpia e Hasanajve, në qoftë se është nevoja dhe të ndalet aty. Pastaj, banorët që jetojnë më tutje, domethënë ata që vijnë nga pellgu i shtëpive të Bakiratëve, të Nures e të Hasanajve, le të ecin ca më këmbë derisa të arrijnë te stacioni i autobusit. Kjo nuk është ndonjë distancë e madhe, më duket mua; njerëzve nuk do t'u duhen më shumë se 5 minuta për të marrë autobusin.

Ti, Neshet, the se doni ta kaloni unazën nga shtëpitë e Angonatëve. Nga sa di unë, kjo rrugë ka kohë që është ndërtuar me kalldrëm deri te Bahçeja e Teqesë nën kala. Atëherë ç'duhet një rrugë e tillë nga kjo anë?

SHOKU NESHET HOXHA: Kjo rrugë do të shkojë deri te Përroi i Shamajve që të lidhet me unazën.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirëpo, kini parasysh se kalldrëmet janë shumë të shtrenjta. Kështu që një ndërmarrje e tillë nuk ka leverdi nga ana ekonomiko-financiare.

Sistemimet e pastrimet e ambienteve ju mund t'i bëni me punë vullnetare. Ka plot punë të tilla të vogla, por që kanë rëndësi, nëpër qoshe të qytetit, që banorët mund t'i bëjnë vetë, pra të pastrojnë, të sistemojnë, të mbjellin lule e pemë në avllitë e shtëpive, anës rrugës etj. Për sistemimet pra, të mos vërë dorë shteti; ato duhet t'i bëjnë banorët që jetojnë rreth e rrotull.

Pardje, kur zbrita nga Lulajt, hodha sytë te sokaku që shkon nëpër shtëpitë e Pleshtit, të Hashorvajve etj. dhe mendova se për sistemimin e rregullimin e këtij sektori nuk do të duhet të punojnë vullnetarisht, me

kazma e lopata, më shumë se 100-150 veta. Për këtë qëllim shteti atje mund të vërë në dispozicion një teknik të mesëm ndërtimi, që të drejtojë punën nga ana teknike, për të prerë skarpitet dhe për të zgjeruar e për të pastruar rrugën. Në qoftë se në këtë rrugë ka ndonjë mur të vogël të rrëzuar, edhe ky mund të meremetohet. Një rrugë si kjo, mendoj unë, nuk është aspak nevoja të bëhet me kalldrëm. Njerëzit që ecin në rrugën që kalon nëpër shtëpitë e Pleshtit dhe del tek ato të Hashorvajve, futen pastaj në rrugën që përshkon Varoshin.

Ti, shoku Neshet, ke përgjegjësi kryesore për çdo gjë dhe për çdo problem që del këtu. Natyrisht, edhe shoku Resul duhet ta ketë syrin patjetër edhe në qytet. Por, nganjëherë, për shkak të problemeve të shumta në shkallë rrethi, siç janë ato të bujqësisë, të industrisë e të gjithë sektorëve të tjerë, ai nuk ka mundësi t'i kushtojë sa duhet kohë dhe vëmendje qytetit.

Më kujtohet Nexhmoja, babai yt Neshet, kur punonte këtu, në qytet. Ti ke qenë i vogël në atë kohë e s'të kujtohet gjë, besoj se nuk je më shumë se 46 vjeç, apo jo? Nexhmoja atëherë, kur i kishte edhe këmbët të forta, vinte dyqan më dyqan dhe pyeste njerëzit: «Si jeni, ç'nevoja keni?». Ai interesohej për çdo gjë dhe njerëzve, që ishin ngarkuar me pastërtinë e qytetit, kur kjo s'ishte në rregull, u thoshte: «Pse i keni lënë pa fshirë këto rrugë?». Ose dyqanxhinjve u tërhiqte vëmendjen: «Pse nuk i pastroni xhamet?» etj., etj. Të njëjtën punë bënte edhe mulla Hysen Hoxha në kohën e tij, kur ishte kryetar i bashkisë. Dhe mendoj se mirë vepronin ata.

Edhe ti, si kryetar i komitetit ekzekutiv të qytetit, mund të dalësh herë pas here nëpër mëhallë, të futësh kokën në shtëpi, të marrësh takim me njerëzit, t'i pyesësh ata si janë, a kanë ndonjë ankesë apo jo, si u shërbejnë shitësit, furrxhinjtë, punëtorët e komunales e të tjerë. Ndonjërës edhe mund t'i thuash: «Pa na lejo, moj ane, të hyjmë një çikë brenda ta shohim shtëpinë.». Dhe të shikosh nëse i mbajnë mirë apo jo, t'u bësh vërejtjet e rastit. Mbase do të duhen edhe dy ditë që të vesh nga Pazari i Ri deri në Pllakë për të parë gjendjen. Sipas rastit, të këshillosh të zotët e shtëpive për ato që nuk kanë bërë ose t'i përgëzosh kur mbajnë pastërti, rregull etj. Në rast se shikon që ndonjëri nuk e mban pastër ambientin, se përpara shtëpisë ose në oborr ka plot plehra, gurë, barëra të këqija etj. t'i thuash: «Ç'janë gjithë këto papastërti; nuk ma jepni mua ca fshesën dhe kazmën t'jua pastroj?». Me një fjalë, t'i futësh një çikë në sedër ata njerëz. Me siguri zonjat e shtëpisë, kur të dëgjojnë këto fjalë, menjëherë do të thonë: «U! Ç'është kjo? Si ta pastrosh zotrote oborrin tonë, ne do ta bëjmë vetë këtë punë». «Mirë, bëjeni, thua ju ti, por herë tjetër të mos ju gjej kështu, se do të kaloj prapë këtej t'ju kontrolloj».

Pra, fjalën e kam këtu që duhet të ushtrohet kudo kontroll për çështje të tilla, që ju shokët e qytetit të jeni ekzigjentë; që banorët të shikojnë kujdesin dhe interesimin e Partisë dhe të pushtetit për pastërtinë, rregullin, zbukurimin dhe mirëmbajtjen e qytetit. Dhe këtë kontroll, Neshet, duhet ta bësh më shumë ti, si i ngarkuar për këto probleme. Po të vesh herë pas here e të takohesh me banorët nëpër lagje, ata do të të bëjnë

edhe kërkesa; do të të parashtrajnë ankesa e qarje dhe ti do t'u përgjigjesh e do t'u japësh rrugëzgjidhje problemeve që i shqetësojnë ata. Kështu që për të tilla gjëra ata nuk kanë pse të venë të ankohen më lart, duke filluar që nga komiteti ekzekutiv i rrethit e deri në organet e qendrës në Tiranë, siç ndodh tani. Askush nuk i ndalon, le të venë edhe në rreth, le të drejtohen edhe në qendër, por nuk është mirë që te ne të ketë njerëz që të mendojnë se vetëm lart të mbarohet puna e të zgjidhet halli. Për problemet që i takojnë qytetit është e domosdoshme t'u përgjigjesh ti. Por, në qoftë se ti nuk je i lidhur me njerëzit e nuk ua vë veshin ankesave të tyre, atëherë ata s'kanë ç'bëjnë dhe, natyrisht, do të drejtohen më lart.

Si kryetar i komitetit ekzekutiv të qytetit, ti duhet të mbash lidhje të ngushta me seksionet e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Ato, megjithëse punojnë pranë aparatit të komitetit ekzekutiv të rrethit, mos harro se nuk janë vetëm për Libohovën, për Lunxhërinë apo për Dropullin etj., por, si për gjithë rrethin, janë edhe për ju, duhet të përgjigjen edhe për qytetin. Kështu, për shembull, seksioni i tregtisë duhet të përgjigjet për furnizimin e tërë rrethit, por njëkohësisht ai ka përgjegjësi të dyfishtë edhe për qytetin. Prandaj, shefi i seksionit të tregtisë, nuk mund të të thotë ty, fjala vjen: «Ç'na ndërhyjnë në punët tona?». Po të flasë me këtë gjuhë, edhe ti mund t'i thuash: «Unë e kam për detyrë të interesohem me docios për çdo gjë që ka të bëjë me qytetin».

Përveç kësaj në çdo lagje ka këshilltarë, të cilët duhen aktivizuar. Po kështu edhe pensionistët. Këta

pastaj, nga ana e tyre, informojnë dhe ngrenë probleme për gjendjen në lagje, për ankesat e kërkesat e banorëve. Pra, mblihd të dhëna nëpërmjet tyre dhe bashkë me të tjerat që ke nga takimet me qytetarët, të shkosh në seksionin e tregtisë e t'u kërkosht punonjësve të këtij seksioni kryerjen e detyrave që kanë për qytetin. Atyre duhet t'u dridhen këmbët kur t'u vihen në dukje mosrealizimet në plotësimin e kërkesave të qytetarëve. Asnjë prej punonjësve të këtyre seksioneve të mos mendojë se «Ne ta kemi mirë me Resulin, me kryetarin e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, pra, sa për Neshetin, që është kryetar i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit mund të bëjmë si të bëjmë». Po të ketë qëndrime të tilla nga ata, atëherë edhe ti t'u thuash: «Ne, të qytetit duam që, në bazë të planit, populli të furnizohet në rregull; dyqanet të mbahen pastër dhe mallrat të ruhen mirë, se për tregtinë e qytetit kemi edhe ne përgjegjësinë tonë».

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shërbimet komunale. Në qoftë se ky seksion pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit përgjigjet për detyrat që ka për fshatrat e ndërmarrjet bujqësore, kjo nuk do të thotë që të neglizhohë kryerjen e detyrave që ka për qytetin. Pra, ashtu si për tregtinë, edhe për sa u përket problemeve të komunales, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit duhet të ushtrojë kontroll e të kërkojë llogari. Domethënë, mbi seksionet të ketë kontroll të dyfishtë edhe nga rrethi, por edhe nga qyteti, sigurisht, për problemet që i përkasin këtij të fundit.

Ose të marrim seksionin e financës, i cili varet nga

komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit. Të ardhura ka edhe qyteti, ashtu sikundër ka shpenzime. Mirëpo për këto të ardhura dhe shpenzime të qytetit ti, si kryetar i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit, ke, gjithashtu, përgjegjësitë e tua, pavarësisht nga përgjegjësia që ka rrethi. Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit të kërkon ty llogari, si për realizimin e të ardhurave, ashtu edhe për atë të shpenzimeve që i takojnë qytetit. Rrethi ka plotësisht të drejtë të të thotë: «Pse ke prishur më shumë fonde nga sa të janë caktuar për këtë ose për atë zë?». Ose «Pse nuk i ke derdhur në financë këto të holla që ke realizuar?» etj., etj.

Ju, anëtarët e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, për mbarëvajtjen e punës duhet të mblidheni rregullisht me ata të këshillit popullor të qytetit, jo për të bërë muhabetë të kota, por për të shqyrtuar pikërisht këto probleme që preokupojnë Neshetin dhe dy-tre punonjësit e tjerë që ka aparati i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit. Ju mbani lidhje dhe kontakte të vazhdueshme me banorët e qytetit, si dhe me këshilltarët e lagjeve, të cilët, kur kanë probleme, vijnë kohë pas kohe e ju raportojnë, qoftë për detyrat që realizohen, qoftë edhe për ato që nuk realizohen, për të cilat ju, gjersa vjen koha e mbledhjes, merrni masa për t'i kryer. Të gjitha problemet që dalin, gjatë intervalit midis dy mbledhjeve, ju i ngrini ato edhe në mbledhjet e këshillit popullor, edhe në atë të komitetit ekzekutiv të tij, i diskutoni mirë e mirë dhe tregoni rrugën që duhet ndjekur për zgjidhjen e tyre.

Kështu, për shembull, atij që është këshilltar nga mëhalla e Pllakës, apo nga Meçitja, këshilli popullor i kërkon llogari për detyrat që i ka ngarkuar. Gjatë diskutimeve bëhen vërejtje, si, fjala vjen: «Fërse nuk rregullohet një çikë rrugica që kalon nga shtëpitë e Xhano Përroit deri te pusi i vjetër i teqesë, rrugicë që të çon në zonën industriale për disa minuta, por që, siç është tani, njeriu nuk kalon dot në dimër se është tërë baltë, kur dihet që punonjësve u duhet të humbasin gjithë atë kohë, duke u ngjitur nga rruga me kalldrëm që është goxha e gjatë, deri te shtëpitë e Kotonit, ku u duhet të marrin autobusin për të shkuar në ndërmarrje?».

Ja, pra kjo është gjendja. Në këtë pellg shtëpish mund të banojnë 100 deri në 150 punëtorë e punëtore që venë çdo ditë në punë. Prandaj, a nuk do të ishte me vend ndërtimi i kësaj rrugice, që u vjen në ndihmë këtyre banorëve, që ata të mos rrëshqasin në baltë, ose të rrëzohen në përrua?! (Një gjë e tillë nuk ndodh, se s'ka ngjarë as më përpara, ngaqë banorët e njohin rrugën edhe symbyllur, kur i thonë fjalës. Këtë e di mirë, sepse më kujtohet kur merrja ujë në Kruan e Meçites për vëllanë që e kishim të sëmurë; edhe natën kur kalonim me shokët andej, asnjëherë nuk u rrëzuam.) Sidoqoftë shokë, është mirë të ndërtohet kjo rrugë që u shërben shumë punëtorëve që banojnë andej, sesa të shtrohet një rrugë tjetër me kalldrëm vetëm për bukuri.

Të tilla probleme ju, shokët e qytetit, duhet t'i kenë vazhdimisht parasysh, t'i diskutoni me popullin, i cili mund të kontribuojë edhe vetë për rregullimin

e tyre me punë vullnetare. Natyrisht, duhet pasur kujdes nga ana juaj që njerëzve t'u bëni thirrje për punë vullnetare në një kohë që është e përshtatshme për ta dhe, mbasi t'i keni marrë më përpara të gjitha masat, pra të keni përgatitur mirë planet e punimeve që do të bëhen, të jenë siguruar veglat e nevojshme etj., pra të mendohet me kujdes çdo gjë për organizimin e punës vullnetare. Nuk duhet ecur kuturu: «Hajde, oburra, të vemi të bëjmë punë vullnetare!». Dhe atje, kur të mblidhen njerëzit për të punuar, të mos marrë vesh i pari të dytin.

Domethënë, për këto punë, si, për shembull, për të bërë rrugën që përmenda, duhet biseduar më parë me njerëz kompetentë. Ti Neshet, fjala vjen, të shkosh bashkë me ata për të parë gjendjen në vend; të planifikohet me kujdes çdo nevojë, që nga mjetet e punës që do të duhen e deri te njerëzit, në mënyrë që të llogaritet pastaj edhe se sa shpenzime kërkon ndërtimi i një objekti të tillë. Si të jenë bërë mirë të gjitha këto llogari, atëherë problemi t'i bëhet i ditur komitetit të Partisë dhe, pasi të merret edhe miratimi i tij, nëpërmjet organizatave të masave të organizohen dhe të aktivizohen gjithë ata të rinj e të reja të këtij pellgu. Kështu, ca të diela me kohë të mirë, duke i grumbulluar të gjitha forcat, kjo punë mund të kryhet shumë mirë. Në këtë mënyrë shpëtohen nga ujërat e nga balta ata punëtorë që banojnë andej. Veç kësaj, atyre u kursehet ca edhe koha që harxhojnë çdo ditë për të shkuar në punë. Ka shumë probleme të tilla, për të cilat, po të veprohet në këtë mënyrë, ka mundësi të

zgjidhen. Por, siç thashë, duhet menduar mirë e duhet punuar me kujdes për çdo gjë.

Ju, punonjësit e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit, duhet të shkëputeni nga shkresurinat e raportet dhe të ndiqni hap pas hapi zgjidhjen e problemeve të ndryshme që ka qyteti. Të punoni ashtu siç bënin në Gjirokastër dyqanxhinjtë e vegjël të pemëve e të zarzavateve, në kohën e rinisë sonë, si: Murati, Nexhmoja, Sako Berberi, ose Sefer Koçi, babai i zëvendësministrit të Arsimit e të Kulturës, Fejzi Koçit. Ditët e pazarit ata ngriheshin që në mes të natës dhe shkonin zinin urën e lumit, ku do të kalonin fshatarët e Lunxhërisë, me kafshët e ngarkuara me pemë e zarzavate dhe ua blenin ato. Pastaj, shkonin në dyqan, i spërkatnin me kujdes me ujë që t'u ruanin freskinë e bukurinë dhe i ekspozonin bukur rrushtë, fiqtë, pjeshkët, domatet, piperkat etj. Kështu, banorët e qytetit sapo dilnin në mëngjes në pazar, venin e ua blenin. I bënin yzmet punës atal

Kështu duhet të jenë të preokupuar për punën, bile ca më tepër akoma punonjësit tanë të pushtetit popullor. Me këtë dua të them që ata të mos e vënë festën në sy dhe, duke qenë të sigurt se rrogën e marrin, të kufizohen vetëm me punën brenda orarit të caktuar, pa çka se ka një varg problemesh, moszgjidhja e të cilave dëmton mbarëvajtjen e punës dhe ekonominë. Aq u bën disa shitësve, në qoftë se fishken lakrat, kalben pjeshkët apo kastravecet. As që bëhen merak që shteti humbet dhe populli nuk furnizohet me produkte të freskëta. Sigurisht, kjo nuk është tipike, por ka raste që ndodh, prandaj duhet të punojmë që t'i

edukojmë njerëzit tanë që të shqetësohen shumë për punën e tyre dhe t'i shërbejnë sa më mirë popullit.

Tani desha t'ju shpreh disa mendime lidhur me rregullimin sa më të mirë të qytetit-muze të Gjirokastrës. Sipas mendimit tim, do shumë kohë që qyteti të ndërtohet e të restaurohet, siç mendojnë dhe si dëshirojnë Partia e populli. Megjithatë ju, të këshillit popullor të qytetit, të punoni shumë në këtë drejtim duke aktivizuar edhe punonjësit e komunales e arkitektët. Ju duhet të bisedoni e të diskutoni me ta për problemet e mirëmbajtjes e të përtëritjes së ndërtesave të vjetra, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit. Siç e theksova më lart, puna duhet të fillojë më parë me meremetimin e shtëpive të vjetra e jo me ndërtimin e rrugëve me kalldrëm. Të vjen keq kur shikon të prishura e të rrëzuara porta e mure me vlerë artistike. në vend që ato të jenë në këmbë, siç kanë qenë.

Ja, ju i vutë re vendet ku kalova pardje në lagjen Palorto? Një fotografi që botuar edhe në gazetë. Atje ju shikoni një portë me një ndërtim artistik dhe një shtëpi të vjetër me disa tipare të bukura karakteristike e me interes të madh për këdo. Të tilla objekte mendoj se duhen meremetuar e restauruar. Restaurimi i ndërtesave si kjo, me gjithë anekset përkatëse, ka shumë vlerë. Është e vërtetë se këpucët e reja hijeshojnë rrobat dhe trupin, por, kur i ke rrobat të grisura, të rrofshin këpucët. Kështu është edhe me ndërtesat përreth rrugëve të qytetit. Kur këto i ke të prishura, apo portat gati në të rënë, nuk kanë vlerë shumë kalldrëmet. Nuk janë këto kryesoret. Unë nuk e nënvle-

rësoj rëndësinë e kalldrëmeve. Jo, ato u japin bukuri rrugëve të qytetit, por, si në çdo punë, më parë duhet nisur nga kryesorja, dhe më vonë të bëhen objektet e dorës së dytë, se të tëra përnjëherë nuk kemi mundësi t'i bëjmë dot. Para se të filloni këto punë, duhen llogaritur mirë mundësitë që kemi. Kjo na vë detyrën që t'u vëmë më parë syrin disa objekteve apo pikave më të rëndësishme.

Në përgjithësi është punuar me kujdes për mirëmbajtjen e objekteve të ndryshme me vlerë. Ju kenë ndërtuar këtu shumë gjëra të bukura, por në sokaqet që vizitova (dhe në disa prej tyre kisha që në vitin 1927 pa kaluar, pra 51 vjet përpara), ka pasur disa ndërtime që atëherë më dukeshin më të bukura. Unë jam nga Gjirokastra e më kujtohet mirë se si kanë qenë ato. Por vura re se rregullimet e bëra, në disa raste, kanë dëmtuar arkitekturën e vjetër, por të bukur, të një numri shtëpish.

Ja, për shembull, te rruga e Çanoles, mjeshtrit e vjetër muratorë në hyrje të shtëpive të Vehapit, të Kamberit apo të Fuatit etj. kishin ndërtuar porta të bukura, që të trija me harqe, përpara të cilave kishte sufara me dërrasa guri. Tani në vend të tyre është bërë nga një mur dhe portat janë nxjerrë në mes të rrugës. Unë çuditëm, pse i kanë nxjerrë kaq përpara!? Kur ngjitesha për te shtëpia e xha Nuro Çanoles, në atë kohë, të dilte përpara një portë me hark me dy sofa dhe që mbyllej me dy kanate, me kamare në mur e me një çekan në njërin kanat për të trokitur, që të dëgjonin të zotët e shtëpisë. Pasi hyje nëpër portë, ngjiteshe më lart nëpër një rrugë me kalldrëm, kaloje në një avlli,

që e zonja e shtëpisë e kishte mbushur plot me lule, me manxuranë, barbroza etj. dhe anash kishte mbjellë trëndafila të fushës. Pra, shtëpia ishte ndërtuar me karakteristikat e një ndërtese qyteti, por e rrethuar me një ambient të tillë që të jepte përshtypjen sikur ishte në fshat.

Me këtë dua të them se ka disa gjëra që, përpara se të vihet dorë mbi to, duhen parë me kujdes. Ne theksojmë se nuk duhet të prishim asgjë që cenon karakteristikat e qytetit, prandaj, para çdo ndërtimi, është e domosdoshme të njihet mirë tërë ambienti rreth e përçark, vrimë më vrimë, si të thuash.

Këto ambiente me ndërtime që duhen ruajtur për vlerat e karakteristikat e tyre, duhet të bëhen objekt i fotografëve; ato duhet të fotografohen e të filmohen dhe të ruhen me kujdes, përpara se të vihet dorë në to. Prandaj duhet t'i aktivizoni edhe punonjësit e televizionit e të kinostudios që mund të bëjnë filma në vendet më interesante dhe karakteristike të qytetit, si, për shembull, një kodër të bukur me një grup shtëpish karakteristike etj. Fotografitë me pamjet e këtyre ambienteve të shumëzohen dhe të shpërndahen për të bërë ekspozita dhe të jeni të bindur se, kur t'i shikojnë njerëzit, me siguri që do të mahniten prej tyre.

Krahas kësaj ju duhet të porositni edhe këshilltarët e t'u thoni se, po panë ose po dëgjuan zhurmën e çekanit të muratorit në ndonjë vend në lagje, t'ju lajmërojnë menjëherë. Atëherë t'i, si kryetar i komitetit ekzekutiv të qytetit, porsa merr këto sinjale, del për kontroll dhe drejtohesh atje ku të kanë informuar dhe pyet atë që fillon të bëjë ndërtimin: «Çfarë po

bën kështu?». «E po ja, do të nxjerr një çikë portën këtu më përpara», mund të të përgjigjet ai.

«Po përse, ia kthen ti, shumë mirë e ke portën këtu tek është». Pra, nga kjo del se duhet vajtur e kontrolluar kudo ku bëhen orvatje për të bërë rregullime e ndryshime në shtëpitë karakteristike sipas dëshirave e interesave të ngushtë të personave të veçantë, por që cenojnë arkitekturën e ambientit.

Kur kalova nga shtëpia e xha Kamberit, afër Kokalarajve, pashë se atje ishin bërë ca rregullime. Më kujtohet se, kur futesha te porta me hark e kësaj shtëpie, të zinte syri një shkallë të lartë prej guri, që nuk kishte parmakë. Ma kërkoi syri atë shkallë, po nuk e pashë. Siç duket, e kanë prishur dhe kanë hapur ndonjë derë më poshtë, në vend që t'i vinin një parmak dërrase dhe të mbetj siç ishte. Ose kjo shtëpi është prishur fare e prandaj ndoshta nuk pashë gjë.

Problemet e qytetit kanë rëndësi, këto nuk duhen marrë kështu në përgjithësi, por edhe me detaje.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Keni byro arkitektësh këtu?

SHOKU RESUL ZANI: Po, kemi një grup arkitektësh prej katër vetash.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Unë mendoj se arkitektët e kësaj byroje, në bashkëpunim me atë të Institutit të Projektimeve në Tiranë, duhet të kenë një plan se si të ndërtohet qyteti i Gjirokastrës në të ardhmen. Këta të fiksojnë me kujdes ato ndërtesa ekzistuese që duhen ruajtur dhe vendet ku duhet të ngrihen të reja. Ky plan duhet të përgatitet. Pastaj, në bazë të këtij plani, të bëhen me radhë të gjitha ato punime

e restaurime që thotë shoku Enver. Kështu, kur është rasti për aksione të mëdha, siç janë festivalët folklorike, që bëhen në Gjirokastrë në çdo pesë vjet, e keni të qartë se çfarë duhet të bëni që më parë. Për këto ndërtime të reja, mendoj unë, arkitektët tanë duhet të këshillohen edhe me qytetarë, sidomos me njerëz me gusto për këto punë dhe të mos bëhen ndërtime si të munden e ku të munden.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po duhet pasur parasysh kjo që thotë Nexhmija. Të punohet me plan dhe duke e menduar mirë çdo gjë.

Blok shtëpish me interes është dhe ai i Selfatëve, që formon një mëhallë të tërë. Atje është shtëpia e Aqif Selfos, Hasan, Zenel dhe Xhevdet Selfos. Rrëth e rrotull këtyre shtëpive, në kohën e rinisë sime, ka pasur kopshte të bukura që hijeshonin gjithë mëhallën. Poshtë Selfatëve, kur vete tek Teqeja e Vjetër, ka qenë një portë e madhe me dy kolona. Mendoj që pamja e këtyre shtëpive të rregullohet e të bëhen si ato të Selfatëve. Ky bllok shtëpish duhet restauruar e rregulluar e të bëhet i bukur siç ka qenë.

Restaurime duhen bërë edhe nga furra e Karagjozatëve deri te shtëpitë e Çerçizit, ku është një tjetër bllok shtëpish po aq i bukur sa edhe Mangalemi i Beratit. Në këtë bllok janë bërë disa rregullime, por duhet punuar akoma se është një zonë që ruhet dhe duhet të ruhet. Në këtë drejtim duhet të ndihmojë shumë Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Akoma më i bukur është blloku i shtëpive të Angonatëve, pastaj ai mbi kokën e të cilit janë shtëpitë e Topullarëve. Në rrugët e kësaj zone ju mund të ndër-

toni disa kalldrëme. Restaurimi i shtëpive të bëhet me shpenzimet e pronarëve të tyre. Ambienti përreth të sistemohet e të pastrohet. Edhe sofatë e portave të lyhen me gëlqere, në mënyrë që turistëve që do të vijin për vizitë në Gjirokastrë, kur të shoqërohen për në Dullgë, t'u tërhiqet vëmendja nga pamja e jashtme e shtëpive. Pastaj, po patën interes, le të venë e të shohin ambientet brenda tyre. Pas kësaj vizite, turistët, që përgjithësisht janë djem dhe vajza të reja, po të duan, mund të ngjiten edhe më lart, deri në shtëpitë e Çerçizit.

Kur isha këtu me Nexhmijen, para 9 vjetësh, dhashë një porosi që në këtë vend të bëhej një shkallë për t'u ngjitur nga poshtë-lart te shtëpitë e Topullarëve. Mirë është të punohet për këtë. Këto shkallë me gurë mendoj të jenë të gjera por, natyrisht, duke mbajtur parasysh që me ndërtimin e tyre të mos priset asnjë shtëpi. Shkallët të zbresin nga kjo shtëpi-muze deri poshtë, ku ngrihen shtëpi të tjera të kësaj mëhalle, që fillojnë me ato të Sheraf Karagjozit. Këto duhet të ndërtohen si shkallët e Universitetit në Tiranë, domethënë të jenë të gjera, për t'u dhënë vizitorëve përshtypjen e madhështisë së shtëpisë-muze të patriotëve të shquar të Rilindjes, Bajo e Çerçiz Topullit. Poshtë kësaj ndodhen gjithë ato shtëpi të tjera të bukura me karakteristikat e tyre të veçanta. Ky bllok shtëpish mund të lidhet me rrugë të ndërtuara me kalldrëm deri te shtëpitë e Topullarëve.

Mendja dhe dora e artistëve tanë duhet të punojë edhe për rregullimin e bllokut të ndërtesave që ndodhen nga furra përballë Dullgës, në drejtim të shtëpive

karakteristike të Beso Gegës, të Gjebresë, të Namik Alites dhe të Resanjëve, që janë si kala. Të mendohet nga ata jo vetëm për përtëritjen e tyre, por edhe për shkëmbinjtë mbi të cilët janë ndërtuar ato. Shtëpia e Qeribashëve, për shembull, që qëndron mbi shkëmb, mendoj se duhet nxjerrë në dritë; rreth e rrotull saj të mbillen e të shtohen kulprat, ndërsa muret të lyhen me gëlqere. Rruga që këtu e gjer te shtëpia e Resanjëve mund të ndërtohet me kalldrëm. Kush të dëshirojë, mund të shkojë ta vizitojë këtë pellg shtëpish edhe nga ana e Kucullës, se andej ka ç'të shohë, janë shtëpitë e Beso Gegës, të Gjebresë e të gjithë atyre që përmenda, të cilat përbëjnë një bllok tjetër karakteristik, restaurimi i të cilit do të nxjerrë në dukje një ansambël shumë të bukur.

Ju, më duket, keni vënë dorë në bllokun e shtëpive të Kabilatëve, por, në qoftë se akoma nuk është vënë dorë, mendoj ta keni parasysh këtë porosi.

SHOKU RESUL ZANI: Në këtë bllok shtëpish ne kemi menduar të ndërtojmë një hotel me karakteristikat e qytetit tonë muze për strehimin e turistëve që do të vijnë për ta vizituar atë.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë mendoj të bëni kujdes, ta pleqëroni mirë punën, para se të veproni për ndërtimet me karakter social në këtë vend, sepse aty është një numër i madh shtëpish karakteristike. Tamam si kala janë ndërtuar sarajet e Nelo Kabilit bashkë me ato të Zekatëve. Në kohën e tyre këto familje kanë qenë mbështetje e Ali pashë Tepelenës, prandaj edhe i kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në këtë mënyrë. Shtëpia e Zekatëve, sidomos është një monument i bukur

arkitekturor. Sarajet e Nelo Kabilit mund të bëhen si pikë turistike, por, natyrisht, duke pasur parasysh që të ruhet jo vetëm pamja e jashtme e një ndërtese si kjo, por edhe ambienti i brendshëm me të gjitha karakteristikat e tij, gjë që ka rëndësi të madhe nga pikëpamja muzicale. Prandaj, është më mirë të mos ndërmerret një veprim i tillë, se objekti do të ndryshojë krejt dhe do të humbasë karakteristikat e tij origjinale.

Unë kam vizituar disa kështjella të vjetra kur kam qenë në Francë dhe kam vënë re se atje tregohet një kujdes i madh jo vetëm për ruajtjen e pamjes së jashtme të këtyre monumenteve të vjetra të epokës kur janë ndërtuar, por edhe për të gjitha ndërtimet e brendshme me anekset e tyre. Prandaj, në të tilla shtëpi të ruhet në formën origjinale çdo gjë brenda tyre, deri edhe divanet. Edhe shkallët e rrumbullakëta të ndërtuara me gurë të ruhen me kujdes, se pikërisht në këto karakteristika qëndron bukuria e këtyre ndërtesave të vjetra. Po i prishe këto karakteristika, si në ambientin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm, ato nuk kanë më vlerë muzeale. Vlera e tyre qëndron edhe në pamjen e jashtme, edhe në të brendshmen. Ky bllok shtëpish, duke përfshirë shtëpitë e Idriz Gurit, të Shahanjve etj., por sidomos këto që përmenda, duhen ruajtur siç janë.

Një grup tjetër shtëpish që duhet restauruar e mbajtur me kujdes është edhe ai i Guratëve. Këto janë mbi shtëpitë e Nelo Kabilit dhe ngrihen pa vajtur akoma te urat e mëdha; pastaj ngjiten në breg deri te Çuberatë etj. Këto shtëpi janë ndërtuar në kodrën mbi përrua, por bashkë me shtëpitë e njërit nga familja e

Lulove, ngjiten lart faqeve të përroit në mënyrë impozante, sikur të ishin minare.

Restaurimi i shtëpive të këtij blloku ka rëndësi të madhe, se turistëve që do të venë në Dullgë, do t'u hapet përpara një bukuri e rrallë. Përmbi këtë bllok ndodhen shtëpitë e Qeribashit dhe përballë tyre janë ato të Karagjozatëve, të Selfatëve dhe të Ciut. Secili nga këto blloqe ka karakteristikat e veta dhe, po të rregullohen siç kanë qenë, do të bëhen po aq të bukura sa edhe shtëpitë e Angonatëve. Kështu në qytet nuk do të kemi vetëm një bllok si këto të Angonatëve, po shumë të tilla që do ta bëjnë qytetin shumë më interesant për vizitorët.

E bukur është edhe shtëpia e Nure Çanoles, po, kur vete në atë të Çuberatëve, vë re se edhe ato janë jashtëzakonisht të bukura.

SHOKU RESUL ZANI: Në lagjen Teqe është një bllok tjetër shtëpish me karakteristika të veçanta.

SHOKU ENVER HOXHA: E shikoni, pra, sa gjëra të bukura që ka në Gjirokastër?

Pastaj, të vijmë më poshtë, në lagjen Pllakë. Shtëpive të kësaj lagjeje, që janë ruajtur mirë, u duhet kushtuar vazhdimisht vëmendje. Në këtë lagje është dhe Pazari i Vjetër, që është me të vërtetë historikisht i vjetër, siç ka emrin. Atje duhen bërë disa rregullime, se është një vend i bukur me vlerë turistike. Eanorët e kësaj zone, pra që nga shtëpia e Abdyl Hoxhës dhe derisa zbret te shtëpia që ndodhet në fund fare, merrren vesh mirë, kur i flasin njëri-tjetrit nga lart-poshtë dhe anasjelltas. Shtëpitë këtu lidhen në mes tyre me thiropulla dhe gjithë ky ansambël duket i bukur si Man-

galemi i Beratit. Prandaj këto gjëra duhen mbajtur me kujdes, të ruhen dhe të mos prishen.

Gjatë ndërtimeve që janë bërë në kala nuk është pasur parasysh ruajtja e karakteristikave të ambientit. Për shembull, te platforma që shikon poshtë nga Cfa-ka, kangjellat me hekura s'venë fare. Do të ishte mirë që në vend të tyre të ishte ndërtuar një mur me gurë, me bedena dhe me kamare si të kalasë! Ose, sahati i qytetit që është ngritur në kala, është mbuluar me eternit, gjë që nuk shkon në atë ambient të gurtë.

Në lagjen Cfa-kë, pa u futur shumë thellë në të, të del përpara një tjetër bllok që përfshin shtëpitë e Sejdo Omarit, të Muhedin Beut, të një ish-avokati, si dhe shtëpitë e kunetërve të Çerçiz Topullit, Kasem Kukës me vëllezëri, të cilat, gjithashtu, paraqesin interes për të huajt.

Më tutje është Sheshi i Mejdanit, që mendoj se duhet mbajtur mirë. Këtë punë mund ta bëjnë fare mirë pionierët. Anët e këtij sheshi zbukurojnë muret e bahçeve. Si nga njëra anë, ashtu edhe nga ana tjetër, atje të zë syri shtëpi si ato të xha Bazo Gjeberos, të Hasim Xhikut etj. Kur t'i shikojnë turistët këto shtëpi, me siguri do të thonë se janë të bukura. Në kohën e rinisë sime atje kisha vënë re disa shtëpi të larta, përveç atyre të Hasim Xhikut, në familjen e të cilit kisha një teze të nënës. Këto shtëpi ishin më të ulëta e të ndërtuara me çatma. Që këtej shkoje te shtëpia e Bazo Gjeberos. Kjo shtëpi ka disa zbukurime që duhen përtërirë.

Duhet të mendohet, gjithashtu, edhe për Manalatin që ka karakteristika të tjera, të ndryshme nga të

lagjeve që përmenda. Në këtë lagje shtëpitë janë të vogla se janë ndërtuar nga banorët e varfër të kësaj pjese të qytetit. Mirëpo gjatë luftës njerëzit atë e kanë quajtur «Stalingrad», pasi armiku nuk futej dot brenda. Prandaj, çdo restaurim që do të bëhet, si kudo, duhet të ruajë edhe këtu formën që ka pasur. Për këtë qëllim duhet konsultuar me shokë që kanë jetuar në ilegalitet në këtë lagje dhe, pasi të japin ata mendimet e tyre se si duhet restauruar ndonjë gjë, atëherë të fillojë puna. Të punohet me kujdes që, kur të vijjnë turistët të shikojnë shtëpitë, sokaqet e të tjera objekte në këtë lagje, të kuptojnë se gjatë luftës atje nuk hynte dot vërtet as miza.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Në vendin tonë vijnë shokë nga partitë marksiste-leniniste e miq të huaj. Kur të kenë rastin të vizitojnë Gjirokastrën dhe të shikojnë edhe këtë lagje, atyre t'u bien në sy jo vetëm pastërtia dhe ndërtimet interesante, por dhe si shërbenin ato në funksion të qëllimeve të luftës, të punës e të mbrojtjes së ilegalëve, të njësiteve guerile etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë lagje duhet të pastrohen e të sistemohen medoemos edhe rrugët. Disa prej tyre mund të bëhen me kalldrëm e disa me asfalt, por rëndësi ka të mbahet parasysh që çdo ndërtim t'i japë lagjes pamjen e përgjithshme, ashtu siç ka qënë: qendër e rëndësishme e luftës, vend ku ilegalët dhe partizanët strehoheshin dhe mbroheshin nga sulmet e armikut. Qëllimi është, siç vuri në dukje edhe Nexhmija, që, kur ta shohin të huajt këtë ambient, të kuptojnë rëndësinë e kësaj lagjeje edhe nga pikëpamja ushtarake. Ka plot vende të tilla te ne, të cilat, qoftë

nga pozita natyrore, goftë edhe nga ndërtimet që kanë bërë njerëzit, kanë shërbyer gjatë luftërave për t'u mbrojtur nga armiku. Kushdo që viziton, për shembull, Mashkullorën që e pamë dje, menjëherë krijon përshtypjen dhe e kupton qartë se armiku e ka shumë të vështirë të depërtojë në një vend të tillë.

Ruajtja dhe restaurimi i ndërtesave të vjetra, karakteristike, e theksoj edhe një herë, është një problem me rëndësi jo vetëm nga pikëpamja arkitekturore, por edhe historike e politike. Prandaj kujdesi për to duhet të jetë i vazhdueshëm.

Ustallarët, që kanë punuar për ndërtimin e shtëpive të qytetit të Gjirokastrës në të kaluarën, kanë qenë mjeshtër të rrallë e me përvojë të madhe. I kam parë vetë, kur isha i ri, shumë nga këta ustallarë që kanë bërë ndërtime këtu. Ata kanë qenë me tërë kuptimin e fjalës mjeshtër, «inxhinierë» të vërtetë, njerëz me horizont dhe me përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve. Megjithëse shtëpitë në Gjirokastrë janë ndërtuar një mbi një, asnjëra nuk ia zë pamjen tjetrës. Ustallarët kanë pasur kujdes të madh për punën që bënin. Kështu, shtëpive të ndërtuara në fund të rrugicës, ata nuk ua kanë mbyllur horizontin me shtëpitë që kanë ndërtuar lart më vonë. Dhe, kur ka qenë rasti, që ndonjë shtëpie më poshtë do t'i pengohej pamja e horizontit nga ajo që ndërtohej e re më lart, me mjeshtëri muratori i ka bërë një prerje kësaj të fundit. E shikoni çfarë ustallarësh me horizont kanë qenë ata?

Pastaj, mjeshtërit muratorë në punën e tyre kanë pasur parasysh jo vetëm këtë, por edhe një gjë tjetër me rëndësi, sidomos për atë kohë, që nga penxheret e

avllitë e shtëpive më lart të mos shikoheshin dot lëvizjet e njerëzve në avllitë dhe në dhomat e shtëpive që ndodheshin më poshtë. Gjithmonë ata e kishin merak ruajtjen e pamjes të të gjitha shtëpive që ndërtonin. Këto tregojnë se ata kanë qenë ustallarë të mbaruar ndërtimi, të pajisur me shijet e një arti popullor të zhvilluar. Por nga ana e jetesës ata ishin me të vërtetë proletarë; asgjë nuk kishin tjetër kur punonin, përveç një fute me xhep të madh përpara ku vinin mistrinë dhe çekiçin; për punën e madhe që bënin, mezi merrnin dy lekë e gjysmë ditën.

Në këtë kuadër të përgjithshëm duhet ta shikoni ju qytetin, sipas mendimit tim. Unë mendoj se duhen bërë studime të kujdesshme për këtë problem, të caktohen edhe afate për kryerjen e këtyre studimeve. Kur e bën studimin mirë dhe e njëh gjendjen si duhet, atëherë edhe Qeverisë mund t'i paraqiten kërkesa të argumentuara, duke i parashtruar mendimin që «Gjirokastrën ne duam ta ndërtojmë me këtë plan dhe për realizimin e këtij plani kemi marrë parasysh jo vetëm mundësitë tona ekonomike, por edhe kontributin vullnetar.» Pra, Qeverisë t'i paraqitet projektplanin dhe mendimi që parashikojmë për realizimin e tij, për shembull, brenda këtyre 10-15 vjetëve. Çdo gjë duhet ta bëjmë me planifikim.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Këtu më duket se ka disa çështje që duhen parë me kujdes të madh e të punohet kudo me shije artistike. Ditën që shkuam në kala, vura re se në qytetin e Gjirokastrës ka disa vende që kanë nevojë të duket më shumë dora e njeriut.

Në Gjirokastrë ka kohë që ka ardhur uji i pijshëm,

por dihet se më përpara populli ka vuajtur për një komb ujë. Prandaj ata që ishin në gjendje, kanë pasë ndërtuar muslluqe. Edhe kjo është një nga karakteristikat e qytetit që mendoj se nuk duhet të humbasë.

SHOKU RESUL ZANI: Muslluqet që kanë qenë ne i kemi restauruar të tërë, i ruajmë me kujdes dhe i kemi vënë në inventar, shoqja Nexhmije.

SHOKU ENVER HOXHA: Me një fjalë, çështja është që as këto të mos prishen. Rëndësi ka që çdo gjë me vlerë muzeale të ruhet e të restaurohet, duke filluar që nga gjërat më të vogla, por që janë kuptimplote, e deri te objektet e mëdha.

Art më vete është vendosja e dritave natën për të parë objektet që kanë interes të ekspozohen. Natyrisht, energjinë elektrike ne kurdoherë do ta kursejmë, prandaj dritat nuk mund t'i ndezim vazhdimisht, por në raste festash ose net të tjera kur duhet, do ta bëjmë këtë sakrificë. Për shembull, siç po e shoh edhe vetë, mirë i kenë vendosur dritat në kala. Kushdo që e shikon atë natën, kjo i duket diçka e bukur, artistike, si një anije gjigante. Por drita mund të vendosen edhe gjatë në qytet, fjala vjen për të parë ndonjë bllok shtëpish interesante, sidomos në raste festash e vizitash të miqve e të turistëve të huaj. Kështu, për shembull, do të jetë gjë e bukur të vendosen drita në bllokun e shtëpive të Angonatëve, veçse projektorët të instalohen më mirë poshtë, në përrua, në mënyrë të tillë që njerëzit të mos shikojnë dritat, por objektin që ndriçojnë ato.

Për të gjitha këto që thamë duhen nxitur që të interesohen edhe punëtorët, edhe intelektualët, sidomos mësuesit dhe nxënësit. Të gjithë këta ta vrasin një çikë

mendjen për këto probleme dhe, nën drejtimin e arkitektëve që keni në qytet dhe të atyre që nuk punojnë në Gjirokastrë, por që ju mund t'i ftoni të vijnë, të zgjidhen këto çështje. Mendoj se si ata që nuk janë gjirokastritë, edhe ata që kanë lindur në Gjirokastrë, duhet ta kenë për nder të kontribuojnë në këto drejtime. Këta ju mund t'i ftoni që të vijnë t'ju ndihmojnë nga 10-15 ditë, kur t'ju krijohet mundësia.

SHOKU RESUL ZANI: Arkitekt Sokrat Moskoja na erdhi para ca kohësh me një grup prej nja 10 vetash për të na ndihmuar, sidomos për zgjerimin e Sheshit të Çerçizit, mbasi, siç e patë vetë, shoku Enver, është shumë i ngushtë. Kur të realizohet kjo, do të kemi parasysh që vendin poshtë sheshit ta ndërtojmë si depo mallrash për nevojat e tregtisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo mund të bëhet kështu si thoni ju, por duhet pasur kujdes që ndërtimet në këtë vend të bëhen me garanci të plotë për jetën e njerëzve. Për këtë qëllim soleta duhet të ndërtohet shumë e fortë. Mund të bëhet edhe me kolona, por çdo gjë duhet ndërtuar me betonarme, se këtij sheshi, në perspektivë do t'i duhet të përballojë pesha të rënda, kur, në raste festash, mitingjesh etj., atje do të grumbullohen me mijëra e mijëra njerëz.

Për sa i përket restaurimit dhe mirëmbajtjes së objekteve me rëndësi arkitekturore një detyrë të veçantë ka Instituti i Monumenteve të Kulturës. Ky institucion jo vetëm të mos e pakësojë aspak kujdesin për të gjitha këto blloqe shtëpish që përmenda më lart, por t'i studiojë ato me vëmendje një nga një e të hartojë planimetrinë e çdo blloku, duke parashikuar edhe ndër-

timet që duhen bërë për restaurimin e tyre, pse një bllok mund të bëhet në një mënyrë, një tjetër mund të bëhet krejt ndryshe. Kujdes duhet të kenë këtu, gjithashtu, drejtuesit e komunalës, sidomos ata të gjelbërim-zbukurimit. Këta duhet të nxiten që të shkojnë t'i shikojnë këto blloqe shtëpish dhe, në bazë të ambientit, të mendojnë se çfarë pemësh e shkurresh ornamentale duhen mbjellë për t'i hijeshuar sa më mirë ato në mënyrë që, kur të vijnë turistët për t'i parë, të kënaqen nga bukuria e tyre.

Partia këtu në Gjirokastrë duhet ta ketë syrin vazhdimisht në këto ndërtime, të japë udhëzimet e nevojshme për ruajtjen e karakteristikave të qytetit, se Gjirokastra është me të vërtetë një muze i bukur që, kur e shohin të tjerët, mahniten. Po të jetë nevoja edhe shkolla e ndërtimit të rihapet. Sidoqoftë duhet bërë një punë e studiuar mirë, se në qytet ka akoma shumë gjëra për të bërë. Por çdo punë duhet kryer me radhë e hap pas hapi, duke pasur parasysh edhe mundësitë që kemi. Të mendohet mirë se cilat ndërtime duhen realizuar më përpara. Natyrisht, puna të fillojë më parë në ato objekte që janë më të domosdoshme që të mos na shkatërrohen. Për çdo ndërtim të mendohet mirë e në detaje: të bëhen më përpara rrugët apo të restaurohen shtëpitë?! Jo vetëm kaq, por të përcaktohet dhe se nga cilat shtëpi do të fillohet konkretisht. Të bëhet sa më parë restaurimi i disa shtëpive të vjetra, që të shmanget prishja e mëtejshme e tyre, pastaj të fillojë ndërtimi, qoftë edhe i një rruge që, siç thashë, do t'u shkurtonte kohën banorëve të një lagjeje për të shkuar apo për t'u kthyer nga puna. E përsëris edhe një herë

atë që thashë pak më parë, se ka më interes, më duket mua, që të restaurohet një bllok i tërë, sesa ndërtimi apo zbukurimi i një rruge me kalldrëm. Prandaj, është e domosdoshme të bëhen studimet që përmenda për zbatimin në jetë të të cilave dhe shteti do të japë ndihmën e nevojshme.

Natyrisht, për të realizuar gjithë këto detyra, do të dalin edhe vështirësi. Por, çështja është që këtë bërthamë që keni, pra degën e monumenteve të kulturës duhet ta përdorni mirë. Në rast se keni mungesa në njerëz, t'i plotësoni sipas mundësive që thamë. Por, elementët e kësaj bërthame, me të cilët ju duhet të konsultoheni, duhet të jenë njerëz me tru në kokë dhe me shije artistike. Ne si shtet të tregojmë kujdes që këtë qytet të lashtë ta bëjmë me të vërtetë dhe me tërë kuptimin e fjalës një qytet-muze. Prandaj, gjithë punonjësit e kësaj bërthame duhet të fillojnë studimet për restaurimin dhe mirëmbajtjen e banesave, dhe jo të merren me gjëra të vogla, si, për shembull, me ndarjen e dhomave e të ambienteve sipas shijes së atyre që janë brenda. Këtë punë le ta bëjë ndërmarrja komunale. Ata, pra, të kujdesen për shtëpitë, rrugët e ambientet e qytetit, të bëjnë planin e punës dhe të marrin masa për të kontrolluar hap pas hapi zbatimin e tij.

Ja, kështu, sikurse jemi mbledhur ne sonte këtu e po shkëmbejmë së bashku mendime për këtë problem, punonjësit e kësaj ndërmarrjeje duhet të bëjnë, gjithashtu, diskutime më të gjera me njëri-tjetrin. Për këtë qëllim, të ndajnë punën midis tyre: njëri, fjala vjen, të merret me shtëpitë e Selfatëve, tjetri me ato të Karagjozatëve, një i tretë me të Qeribashëve e kë-

shtu me radhë, deri në realizimin e plotë të planit të restaurimeve.

Gjithashtu, për këtë qëllim, mendoj unë, këta punonjës duhet të marrin edhe mendimin e banorëve, të konsultohen sidomos me njerëz të mësuar si: Muharrem Gegën, Mufit Jupin, Kadri Baboçin e të tjerë, të këmbëjnë mendime me ta, ose mund të thërrasin nga Tirana punonjës të vjetër të ndërtimit, që janë marrë me të tilla punë dhe kanë përvojë të madhe si: Eqrem Dobin, Sali Angonin, Sokrat Moskon e të tjerë. T'u kërkojnë këtyre që, kur të jetë e mundur, të shkëputen për ca ditë nga punët që kanë në Tiranë dhe të vijnë në Gjirrokastër e të ndihmojnë me përvojën e dituritë e tyre për organizimin e kësaj pune. Këta njerëz mund të vijnë këtu me dëshirë për këtë punë dhe, tok me ju, të shikojnë objektet më interesante, të reflektojnë dhe mendimet që kanë t'i hedhin në letër. Është mirë që së bashku të bëni diskutime të përgjithshme për çdo objekt që do të studiohet dhe të përcaktoni të gjitha masat që duhen marrë për kryerjen e kësaj pune. Për shembull, në këtë ose në atë bllok shtëpish lind nevoja të bëhen muret, të shikohet sa metra të gjatë do të jenë këta, sa të lartë do të bëhen, në çfarë vendi do të nxirren gurët për ndërtimin e pastaj të llogaritet se sa do të kushtojë gjithë kjo punë etj.

Të kihet parasysh, siç thashë më lart, se shteti do të financojë vetëm për rregullimet e meremetimet që u duhen bërë shtëpive me vlerë muzeale nga jashtë dhe jo për ato brenda, për shembull, ndërtimin e një muri, të një kalldrëmi, rregullimin e një avllie apo të një çatmaje. Studimi në këtë fushë duhet të parashi-

kojë në detaje çdo gjë të nevojshme për vënien në jetë të tij. Fjala vjen, këtu na duhet kaq bojë jeshile ose gëlqere, atje duhet të vëmë kaq saksi me lule etj. Por, natyrisht, jo çfarëdolloj lulesh, por nga ato që i shkojnë kësaj ose asaj shtëpie ose të mbjellim këto ose ato shkurre. Dhe, si të diskutohen të gjitha këto probleme, të bëhet plani i restaurimit të një blloku, i cili do të realizohet gradualisht brenda tre-katër ose pesë vjetësh.

Në bazë të studimeve dhe të fondeve që do të vihen në dispozicion nga ana e shtetit, të fillojë puna për zbatimin e planit të restaurimit, natyrisht me një plan perspektiv, duke caktuar dhe se cilat objekte duhet të kenë prioritet. Së pari, siç e thamë edhe më lart, do të bëhen ato shtëpi apo mure që bien më shumë keq në sy, ose ato që kanë rrezik të prishen, po nuk u vu dorë me kohë mbi to. Shtëpia e Qeribashëve, për shembull, që është me vlerë turistike, mendoj se nuk ka nevojë për të ngritur mure dhe as për ndonjë lloj tjetër ndërtimi, se gjithçka atje është ruajtur mirë, por ka nevojë të mbillen vetëm ca sarmaçe, ndërsa mureve rreth e rrotull mund t'u bëhet ndonjë riparim. Disa nga këto punime mund të bëhen shumë mirë me punë vullnetare, veçanërisht nga rinia, kurse për disa të tjera të caktohen edhe fondet.

Për të realizuar këtë objektiv duhen gjetur mundësi, duhen investuar edhe fonde jashtë atyre që destinohen për strehim. Për copëtimin brenda të ambienteve të këtyre shtëpive, kuptohet, kur na intereson, në vend që të bëjmë shpenzime të mëdha për të ndërtuar tre-katër apartamente të reja, mund të ndihmojmë që

të kryhen edhe ndarje brenda këtyre shtëpive, me shumë pak shpenzime dhe, ato që mbeten, mund të përdoren për restaurimin e zbukurimin e tyre të jash-tëm. Në disa raste, të bëjmë ashtu siç bënte kako Pi-noja, në kohën e vegjëlisë sime, kur stoliste nusët e reja, duke u vënë ca rruaza në qafë, ca llambro në fytyrë etj., etj. Kështu duhet zbukuruar gradualisht qyteti, karakteristika kryesore e të cilit, në përgjithësi, është e shëndoshë; por ai ka nevojë vetëm për disa riparime artistike.

Përveç këtyre, në të njëjtën kohë, ka edhe një numër punimesh të tjera të nevojshme që duhen kryer, për të cilat mendoj se më përpara duhet konceptuar mirë rëndësia e tyre. E kam fjalën për mbajtjen mirë të të gjitha ambienteve rreth këtyre monumenteve që do të restaurojmë, për zbukurimin e të cilave një rol të veçantë luajnë gjelbërimet, mbjellja e pemëve etj., me një fjalë kultura e ambienteve. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me ndërtim muresh e kalldrëmsh, por edhe me shumë punime të tjera. Të gjitha këto duhen marrë parasysh në kompleks.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Unë kisha dhe nja dy sugjerime për të bërë. Çuditë si nuk ka lule këtu, kur dihet që populli i qytetit të Gjirokastrës i do shumë ato. Prandaj ndoshta ndërmarrjes komunale i nevojitet të ngrejë ndonjë serrë për këtë qëllim.

Përveç luleve, në qytet duhet të ketë një çikë më shumë edhe gjelbërim, sesa ka sot. Mundësitë janë. Ka shumë vende ku mund të mbillen dhe të shtohen ato. Për shembull, në Ndërmarrjen e Veshjeve, vura re se oborri nuk kishte gjelbërim sa duhet.

Edhe ekspozita më duket se ishte përgatitur shpejt e shpejt. Përgatitja e një ekspozite duhet bërë me kujdes. Këto punë kërkojnë mjeshtëri, nuk i bën dot çdo njeri. Ato i bëjnë njerëz me kulturë dhe me shije artistike, që merren vazhdimisht me të tilla punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është. Jo vetëm në përgatitjen e ekspozitave, por edhe në lokalet e tregtisë kërkohet më shumë kulturë. Tregti të kulturuar, më mirë se kudo në vendin tonë, bën rrethi i Shkodrës. Shtësit e dyqaneve dhe punonjësit e tjerë të tregtisë në këtë qytet, mbase nuk kanë mbaruar shkolla, por shërbejnë me kulturë dhe këtë e kanë në thua, pse, siç duket, kanë tradita në këtë drejtim.

Kultura tregtare ka rëndësi edhe për shitjen e shpejtë të mallit, se, kur klienti e shikon dyqanin të pastër e të rregulluar mirë dhe mallrat të sistemuara bukur e të ruajtura me kujdes, nuk del kollaj pa blerë diçka.

Shumë pastër dhe mirë duhen mbajtur, gjithashtu, ambientet e hoteleve dhe të ushqimit social etj. Kjo është një punë me rëndësi e sektorit të tregtisë, të cilën duhet ta vëmë mirë në vijnë. Në këto drejtime të jemi shumë ekzigjentë. Duhet punuar për edukimin e njerëzve që punojnë në këta sektorë. Përveç kësaj, kërkohet edhe kontroll i fortë e i vazhdueshëm dhe këtu nuk duhen bërë lëshime.

Mirë, me kaq t'i japim fund bisedës për sonte. Ju faleminderit. Mirupafshim nesër!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

**MIQËSIA JONË ME POPULLIN GREK ËSHITË E
LIDHUR ME GJAKUN E DERDHÛR NË LUFTËN
PËR LIRI E PAVARËSI KUNDËR
TË NJËJTËVE ARMIQ**

*Fjala në mitingun në Grapsh me popullin
e krahinës së Dropullit*

22 mars 1978

Të dashur shokë dhe shoqe, mëma dhe baballarë,
vëllezër dhe motra dropullitë,

Jam shumë i lumtur që ndodhem pranë jush. Koha
sot na bëri shi dhe u lagëm, por kjo nuk na pengon
aspak për të realizuar takimin tonë. Ne nuk kemi
pasur frikë as nga mitralozat, as nga mortajat dhe as
nga topat e armikut, prandaj nuk ka përse të trembemi
nga shiu dhe nga bubullimat.

Efkaristo poli! Ego, o Enveris, dhen kséro elenika¹.
Më vjen keq që nuk e mësova dot gjuhën e bukur
greke kur isha në shkollë. Kur them që nuk e mësova

1. Greqisht — faleminderit shumë! Unë, Enveri, nuk di greqisht.

dot greqishten, kam parasysh se nuk arrita t'i lexoj në gjuhën e tyre Homerin, Sofokliun, Aristotelin, Demokritin, këta dijetarë dhe filozofë të mëdhenj të kulturës së pavdekshme greke, që më kanë tërhequr shumë kur i kam lexuar në gjuhën frënge dhe në shqip.

*Tora kalla*¹, po flas shqip, se gjuha shqipe është, gjithashtu, e bukur, është gjuha e popullit shqiptar, e atdheut tonë të përbashkët, e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj nga zemra për ardhjen tuaj këtu, se na ka marrë malli dhe dua t'ju shoh e të më shihni. U bë shumë kohë që nuk ju kisha parë, por me mendje e me zemër ju kam kujtuar dhe ndier vazhdimisht. Unë i kam ndjekur me vëmendje punën dhe realizimet e gjithë minoritetit e të rrethit të Gjirokastrës.

Minoriteti grek e populli shqiptar, dhe veçanërisht populli i rrethit të Gjirokastrës, kanë qenë e janë të lidhur ngushtë si mishi me thoin, ata në çdo kohë janë dashur dhe kanë përkrahur njëri-tjetrin. Natyrisht, këtu nuk e kam fjalën për bejlerët dhe për agallarët e poshtër të Gjirokastrës, që ishin armiq të popullit, por po flas për popullin fukara të Dropullit e të Gjirokastrës, që historikisht kanë qenë pranë njëri-tjetrit.

Më kujtohet kur na vinte në shtëpi xha Mihoja, një plak i varfër minoritar, burrë i shkurtër e i paktë nga trupi dhe i nxirë nga mjerimi dhe na sillte një gomar me misër. Kur Mihoja i shkretë na e binte atë pak misër, ne gëzoheshim pa masë. «*Ella dho pedhi*

1. Greqisht — tashti mirë.

mu!»¹, më thoshte ai, më hipte mbi *gajdhurin*² e tij dhe pastaj nxirrte nga shallvaret e çjerra dy shklebonj të vegjël. «Merri, djalë, më thoshte, *dhen ehome, tipota dhen ehome»³*.

Dashuria jonë për popullin e minoritetit nuk është shlyer kurrë, ajo u çelikos me krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Partia jonë, e formuar nga bijtë e Shqipërisë dhe të minoritetit, luftoi që të forcoheshin e të kaliteshin në shekuj uniteti dhe dashuria në mes nesh.

Shqiptarë e minoritarë luftuan e sakrifikuan së toku gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe fituan. Ata fituan Shqipërinë dhe e bënë të tyren. Si dëbuan të huajt, shporrën agallarët, shporrën bejlerët dhe i dhanë fuqinë në dorë popullit, që ai të vendoste ligjin e tij dhe të ndërtonte atë shoqëri për të cilën kishte derdhur gjak e djersë, kishte vuajtur. Populli, me Partinë e tij të lavdishme në krye, ngriti pushtetin e tij popullor dhe ndërtoi shoqërinë socialiste që gëzojmë sot.

Që në ditët e para të Çlirimit Partia mendoi se gjithë popullin shqiptar duhej ta bënte të ndërgjegjshëm për detyrat që i viheshin përpara dhe të krijonte ato mundësi, që hap pas hapi të zhvilloheshin forcat prodhuese e të ndërtoheshin marrëdhëniet e reja në prodhim në mes të njerëzve, me qëllim që të përmirohej e të përparonte jeta e vendit. Dhe koha provoi që Partia mendoi drejt.

1. Greqisht — hajde këtu djali im.

2. Greqisht — gomarin.

3. Greqisht — nuk kemi, asgjë nuk kemi.

Partia orientoi që në ekonomi degë udhëheqëse të jetë industria, por bazë të mbetet bujqësia, prandaj udhëzoi që t'i vihet vazhdimisht rëndësi bujqësisë. Ç'donte të thoshte t'i vinim rëndësi bujqësisë? Kjo donte të thoshte që fshatarët të merrnin tokën, sepse kjo u përkiste atyre dhe askujt tjetër. Për këtë qëllim u bë Reforma Agrare. Pastaj Partia tha: Do t'i lëmë kështu si kanë qenë përpara këto fusha? Jo, nuk do t'i lëmë kështu, por t'i bëjmë pjellore, të thajmë kënetat, të ndërtojmë kanale që të ujitim tokat, të sjellim mekanizma dhe më vonë të ndërtojmë fabrika plehrash, të shtojmë bagëtinë, të zgjerojmë pemëtarinë. Këto tha Partia, dhe ne, të gjithë, me besim te fjala e saj, iu përveshëm punës. Dhe ju, dropullitë, ishit nga ata fshatarë heroikë të Shqipërisë socialiste që iu vutë punës të parët.

Të më falin burrat dropullitë, për të cilët kam respekt, por ç'është e drejta duhet t'u heqim kapelen grave të Dropullit, sepse ishin ato që iu qepën kësaj toke, këtyre fushave. Nuk dua të them se burrat dropullitë s'kanë qenë punëtorë, se edhe ata të shkretët, për të siguruar bukën, kanë provuar në kurrizin e tyre të zezat e kurbetit. Atyre u qante zemra dhe shpirti kur merrnin rrugën e mërgimit dhe i linin gratë e reja e fëmijët e vegjël këtu. Shpresa se jashtë, duke shitur forcën e krahut të tyre, mund të fitonin diçka për familjen, i bënte ata të shtegtonin nëpër botë. Mirëpo shpresat e tyre treteshin si kripa në ujë, kur shikonin pasojat e krizave të mëdha të shkaktuara nga luftërat imperialiste, që e bënin edhe më të madh mjerimin e tyre.

Kur vendosëm pushtetin, Partia dhe Qeveria menduan që në ditët e para për zhvillimin e bujqësisë në të gjitha fushat e Shqipërisë, dhe veçanërisht në fushën e Dropullit. Pse u mendua veçanërisht për Dropullin? Mos vallë për arsye se kështu deshi Enver Hoxha, si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë? Jo, qëndrimi ynë ndaj pakicave kombëtare nuk është aspak rastësi, por e ka shpjegimin e vet në faktin se Partia jonë është udhëhequr e udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste në çështjen nacionale, se shqiptarët dhe minoritarët kishin vuajtur shumë, bile minoritarët edhe më shumë se shqiptarët dhe minoritarët luftuan dhe fituan së bashku.

Unë nuk dua t'i numëroj me radhë tërë ato që ka bërë Partia për gjithë Shqipërinë dhe veçanërisht për Dropullin, se ju këto i dini mirë. Ja, këtu, përpara nesh, shtrihet kjo fushë kaq e bukur, kaq pjellore, e qëndisur nga duart e arta të kooperativistëve, siç janë të qëndisura bukur fustanet e dropulliteve. Megjithëse sot nuk ka diell, ne e soditim me kënaqësi fushën e bukur të Dropullit, që e kanë zbukuruar rendi ynë socialist, idetë e mëdha marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë, mendja dhe duart tuaja, vëllezër dhe motra dropullite.

Ne krenohemi kur dëgjojmë dhe shikojmë përparrimet e mëdha që ka bërë gjithë krahina juaj. Ne mburremi kur dëgjojmë për rendimentet e larta që keni arritur ju në grurë, në misër, në jonxhë, në duhan, kur shohim këtu të rriten lopë që japin qumësht me zasi të mirë dhe që në sajë të punës e të kujdesit tuaj do ta rritin më tej prodhimtarinë e tyre. Dropulli i di-

kurshëm, që nuk kishte as pleh, sepse bajgat e bagëtive dropulliti i ngjiste në mure për t'i tharë e për t'i djegur, aktualisht është i siguruar me ngrohje, plehun që merr nga bagëtitë e përpunon dhe e hedh në ara tok me plehun kimik, për prodhimin e të cilit Partia ka ngritur uzina të fuqishme.

Jemi jashtëzakonisht të gëzuar që nga gjiri i popullit të minoritetit kanë dalë luftëtarë të shquar, partizanë, heronj e heroina të popullit, që s'kanë kursyer as jetën për lirinë e tij. Edhe në ditët tona kanë dalë bij të denjë si Ilia Qiqi e shumë të tjerë që kanë dhënë jetën për ndërtimin e socializmit. Ata, të bashkuar me popullin si mishi me thoin, kanë shkuar në krahinat më të thella të atdheut dhe atje kanë dhënë diturinë e tyre, që e kanë marrë në shkollat e Dropullit, në shkollat e Gjirokastrës dhe në shkollat e gjithë Shqipërisë.

Komunistët kanë punuar me gjithë shpirt që në çdo fshat të Dropullit të ketë shkollë në gjuhën greke. Si marksist-leninist, unë them që duhet të ruhet e të zhvillohet gjuha greke, gjuha amtare e popullit të minoritetit. Këtë e kërkon internacionalizmi proletar, e kërkon Partia jonë e Punës e Shqipërisë që i qëndron kurdoherë pa u tundur këtij parimi, sepse është gjuha e mëmës. Kalamani minoritar duhet ta mësojë greqishten, kurse ju të rriturit s'duhet ta harroni atë. Ju duhet të doni, po me atë forcë edhe gjuhën shqipe, gjuhën e atdheut tonë të përbashkët socialist, sepse djemtë dhe vajzat tuaja nuk do të punojnë, nuk do ta përhapin diturinë vetëm këtu, në minoritet, por atë do ta rrezatojnë në tërë atdheun e tyre, në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Gjuha shqipe

është edhe e nevojshme, edhe e dashur për ju. Unë ndiej kënaqësi të madhe që, për të komunikuar me ju, nuk është nevoja të kem një përkthyes pranë, se ju të tërë e kuptoni shqipen.

T'i doni dhe t'i respektoni mësuesit e shkollave të minoritetit për këtë detyrë të madhe që kanë kryer dhe po kryejnë, sepse janë ata që ju kanë edukuar, ju kanë mësuar dhe ju kanë brumosur qysh në bankat e shkollës me idealet e larta të komunizmit, për t'u bërë patriotë dhe për të dashur atdheun tonë të madh socialist.

Është absolutisht e domosdoshme, vëllezër dhe motra, që unitetin rreth Partisë ta kemi kurdoherë të çeliktë, sepse vetëm Partia na nxori në dritë, vetëm ideologjia e Partisë na dha forcë, na dha shpirt, na dha kurajë, na hapi sytë e na tregoi si duhej të luftonim, të punonim, të lidheshim me njëri-tjetrin dhe të ndërtonim jetën e re. Dhe jeta e re te ne lulëzon. Socializmi në vendin tonë ndërtohet me sukses. E ardhmja e Shqipërisë do të jetë akoma më e bukur. Ne nuk e kemi zakon të mburremi, por të gjithë e dinë se ato që thotë Partia jonë, ato plane që bëhen, zbatohen. Është fakt se planet që hartohen për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së Dropullit, të Gjirokastrës, të Vlorës, të Tiranës etj., realizohen me sukses.

Unitetin e popullit me Partinë duhet ta kalitim vazhdimisht. Po si bëhet kjo kalitje? Kjo bëhet duke kuptuar mirë ideologjinë tonë, duke kuptuar mirë internacionalizmin proletar, duke e dashur shoku-shokun sinqerisht, duke i luftuar ligësitë, mëritë dhe duke qëndruar krah për krah me njëri-tjetrin, siç porosiste Marksi kur shkroi Manifestin: Proletarë, shtrëngoni su-

pet njëri me tjetrin, mos lini asnjë të çarë në radhët tuaja dhe marshoni frontalisht kundër borgjezisë që ta shtypni! Edhe ne, shqiptarët, kështu na mëson Partia, që të mbajmë radhët të shtrënguara, të ecim përpara sup më sup. Dhe duke ecur përpara, socializmi ndërtohet, vendi lulëzon, shpirti i njerëzve zbukurohet. Kjo është rruga e lumturisë së popullit tonë dhe këtë ne po e ndërtojmë me sukses.

Ju, shokë minoritarë, jeni njerëz të zgjuar, çështjet i kuptoni drejt politikisht dhe ideologjinë e Partisë e përvetësoni. Këtë e shikoj jo vetëm në përgjithësi, por edhe konkretisht te shokët e mi minoritarë që janë në udhëheqje të Partisë. Kuadrot minoritarë punojnë me shkathtësi e me pjekuri, ata drejtojnë ndërmarrje dhe sektorë pune me rëndësi të madhe për vendin e për Partinë tonë, sepse janë besnikë të këtij populli, besnikë të Partisë dhe nuk kursejnë as jetën për atdheun, ashtu sikurse nuk e kanë kursyer shokët e tyre që ranë në luftë. Edhe disa kuadro minoritarë të Partisë, që nuk jetojnë më, kanë punuar me besnikëri dhe në rrugën marksiste-leniniste për Shqipërinë socialiste.

Për këtë tokë edhe ju, fshatarë minoritarë, keni luftuar, prandaj e doni me gjithë shpirt, dhe Partia ju thotë: Ta doni me gjithë shpirt! Partia do t'ju ndihmojë me të tëra forcat që këtu të krijohet jo vetëm kaq sa është krijuar. Mos u kënaqni me këtë, por të krijoni një bollëk më të madh. Pse e them këtë? E them, sepse jemi të sigurt në forcat tona. Populli, me Partinë në krye, çau malet, mundi armiqtë. Të shumtë e të egër ishin ata që na pushtuan e na dogjën, po ne i mu-

ndëm. Armiku propagandonte se këta «çunakë» nuk do të jenë në gjendje të qeverisin, por shteti ynë i punëtorëve e i fshatarëve i vuri nën këmbë të gjithë armiqtë që ngritën dorën kundër tij. Goditja jonë mbi ta qe aq dërrmuese, sa ata nuk do ta marrin dot kurrë veten.

Partia na mëson që çdo gjë ndërtohet me punë, po punën duhet ta bashkojmë me diturinë. Që të punohet mirë ara, që të rritet mirë bagëtia, duhen bashkuar edhe eksperiencia, edhe dituria. Por nuk mjaftojnë vetëm këto, se përveç këtyre duhen edhe shiu, edhe dielli. Për diellin këtë muaj kemi nevojë, se tokat janë rënduar nga shiu dhe duhet t'i përgatitim për mbjelljen e misrit. Po koha do të na hapet. Ja, që tashti më duket se po na del dielli. Megjithatë, ne nuk presim çdo gjë nga koha, se jemi nga ata njerëz të vullnetshëm e punëtorë që edhe kushtet e këqija atmosferike mund t'i përballojmë. Pse mund t'i përballojmë? Sepse kemi guxim e besim të madh në vetvete, pse kemi mjete pune dhe jemi të pajisur me eksperiencë e me dituri. Eksperiencën e përgjithshme dhe praktikën e punës së përditshme të mos i neglizhojmë, se janë ato që kanë nxjerrë edhe shkencën. Lufta e madhe e popujve e bëri Karl Marks të hartonte teorinë e tij të pavdekshme, e cila udhëheq sot popujt në revolucion.

Për të ecur përpara Partia na thotë që të shkëmbejmë eksperiencën e mirë të njëri-tjetrit. Kjo është arsyeja që vijnë te ju grupe nga të katër anët e Shqipërisë për të marrë eksperiencë dhe këtej shkojnë, gjithashtu; njerëz në krahinat e tjera të vendit. Praktika e gjithsecilit, e bashkuar me diturinë dhe me shkencën agroteknike, çon përpara prodhimin.

Jeta jonë është e bukur. Vendi ynë ecën përpara dhe është i pathyeshëm.

Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, kapitalizmi botëror në tërësi, hiqen sikur janë të fuqishëm e të pamposhtur, por në të vërtetë ata janë të krimbur. Imperialistët dhe socialimperialistët janë një grusht njerëzish të urryer, kurse popujt janë miliona e qindramilionë njerëz që ziejnë kundër zgjedhës së klasave sunduese dhe duan ta heqin qafe këtë zgjedhë duke u hedhur në revolucion për të marrë fatet në duart e veta. Ashtu siç e kanë përshkruar Marksii dhe Lenini, popujt e botës dhe proletariati në të pesë kontinentet, në përputhje me ndryshimet e kushteve të jetës materiale, zgjidhin detyrat e zhvillimit progresiv, revolucionar, duke u ndeshur në luftë klasore me borgjezinë dhe me forcat e saj, me policinë, karabinerinë etj. Grevat madhështore të miliona punëtorëve, që manifestojnë kundërshtimin e tyre nëpër rrugë, tregojnë se ata kërkojnë të rrëzohet pushteti i kapitalit, se vuajnë nga papunësia e nga plagë të tjera të rënda. Në botën borgjezo-revizioniste ka sot rreth 110 milionë njerëz pa punë. Banditizmi e kusaria janë sheshit. Borgjezia, që e ka të vështirë të sundojë, kur proletariati dhe popujt e shtypur lëvizin, orvatet të vendosë diktaturën fashiste. Kundërshtimi i forcave të proletariatit me borgjezinë, i popujve me imperializmin në tërësi dhe me sundimtarët e brendshëm, krijon kontradikta antagონiste, zgjidhja e të cilave sjell përmbysjen e kapitalizmit. Këto kontradikta do të acarohen dhe do të çojnë në shpërthimin e revolucionit. Dhe kjo kohë do të vijë. Revolucioni do ta hedhë përtej zgjedhën kapitaliste.

Lenini në librin e tij të famshëm «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm», ka shkruar se kur piqen kushtet objektive dhe subjektive, revolucionin nuk ka se çfarë e ndalon, atë nuk mund ta shtypin as ushtria, as policia, as topat e borgjezisë. Revolucioni do të shpërthejë kur populli ta kuptojë se duhen shtypur ata që e shtypin dhe kur ata që shtypin nuk do të mund të sundojnë më si përpara. Kur fiton revolucioni, forcën e merr në dorë populli, siç e mori në vendin tonë dhe vendosi regjimin e demokracisë popullore, që na çon drejt ndërtimit të socializmit.

Partitë ish-komuniste e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe janë shndërruar në parti revizioniste. Ato kanë përqafuar teorinë e kapitalit dhe mashtrjnë anëtarët e tyre dhe klasën punëtore, duke u thënë se, tani, gjoja, nuk ka nevojë të ngrihen në revolucion, sepse në socializëm mund të shkohet bashkë me borgjezinë me anë të reformave, çka do të thotë që t'u kërkojnë lëmoshë sundimtarëve. Po të veprojmë edhe ne kështu, do të duhej t'u kishim kërkuar lëmoshë agallarëve e bejlerëve të djeshëm. Do të duhej t'i thoshim Myfit Beut¹: «Aman, o Myfit Bej, na jep një krodhë bukë!». Kështu u thonë partitë revizioniste anëtarëve të tyre dhe proletariatit t'u kërkojnë lëmoshë kapitalistëve.

Partitë marksiste-leniniste të vërteta, që janë formuar dhe që janë akoma të reja, duke qëndruar në pozita revolucionare konsekuente, u bëjnë thirrje pro-

1. Myfit bej Libohova, ministër i Financave në qeverinë e A. Zogut.

letarëve dhe të gjitha masave punonjëse që të ngrihen në luftë kundër kapitalit, kundër partive të borgjezisë, se vetëm me armë në dorë fiton revolucioni dhe jo me reforma.

Ç'do të thotë reformë? Reformë, për të cilën flasin revizionistët, në thelb, do të thotë të kënaqesh me disa thërrime, duke mbajtur sundimtarin në kurriz. Nga të ardhurat e pronës të marrësh vetëm një përqindje shumë të vogël e jo atë që të takon, kurse pjesën tjetër ta futë në xhepin e vet kapitalisti, i cili kështu është në gjendje të krijojë një ushtri të fortë që të shtypë e të mbajë nën zgjedhë ata që prodhojnë. Ai krijon, gjithashtu, aristokracinë punëtore, ata krerë të sindikatave të shitur te padronët dhe që kanë vetëm fjalë. Këta mashtrues e zjarrfikës të revolucionit u thonë punëtorëve: «Kini durim dhe rrini urtë! Prisni, se do t'i rregullojmë punët, sa të vijmë ne në qeveri tok me kapitalistët e pastaj diçka do të rregullojmë!».

Kapitalizmi i përdor revizionistët si mjet për të shuar revolucionin, po revolucioni nuk shuhet. Ai është një proces objektiv, që zhvillohet në bazë të ligjësive objektive. Karl Marksi ka argumentuar shkencërisht që kapitalizmi, si rend ekonomik-shoqëror, do të zhduket si rezultat i luftës së proletariatit dhe të masave popullore që udhëhiqen nga partitë e tyre të vërteta komuniste. Kur dhe ku do të zhduket? Do të zhduket atëherë kur të jenë krijuar kushtet objektive e subjektive të shpërthimit të revolucionit dhe atje ku hallka e zinzirit imperialist do të jetë më e dobët.

Shikoni ç'po ngjet me dy superfuqitë: imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përpiqen të

rindajnë pasuritë e botës. Në këtë ndërmarrje ata kanë kontradikta me njëri-tjetrin. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë t'i mbajnë dhe t'i shtojnë pasuritë që kanë, domethënë të mbajnë nën sundim dhe t'i shtypin popujt e atyre shteteve që janë nën ndikimin e tyre bile edhe popujt të tjerë. Bashkimi Sovjetik, nga ana e vet do që të rrëmbejë edhe ai, ç'të mundë, duke shtypur e duke skllavëruar popujt të tjerë, siç edhe ka ndodhur. Kështu pra, edhe njëra, edhe tjetra superfuqi kërkojnë të zaptojnë botën.

Në kuadrin e kontradiktave të ashpra ndërmjet këtyre dy fuqive imperialiste, nuk mohohet që ato bëjnë edhe marrëveshje për probleme të veçanta. Por si në rastin kur superfuqitë kanë kontradikta, ashtu edhe kur bien në ujdi, ata që e pësojnë janë popujt. Mirëpo popujt nuk e durojnë shtypjen. Ata ngrihen, luftojnë dhe kjo luftë do t'i ngjitë shkallët një nga një, deri në shpërthimin e revolucionit. Kur popujt të jenë ngjitur në krye të shkallëve, atëherë do t'i zhdukin të tërë ata armiq e tradhtarë që janë fshehur nën «shkallë».

Partia e Punës e Shqipërisë ka fituar një simpati të jashtëzakonshme tek të gjithë popujt, tek të gjithë proletarët kudo, në Afrikë, në Azi, në Amerikën e Veriut e ca më tepër në Amerikën e Jugut dhe në Evropë. Proletarët dhe popujt e shtypur e duan Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe interesohen të dinë se si ky vend i vogël u bën ballë armiqve të tij të shumtë imperialistë dhe revizionistë. Duke dashur të dinë se ku qëndron forca e tij, ata kanë arritur në konkluzionin se kjo forcë qëndron tek ideologjia marksiste-leniniste, te Partia e Punës e Shqipërisë dhe te

populli i pamposhtur shqiptar. Nuk janë vetëm popujt, proletarët dhe komunistët marksistë-leninistë që i drejtojnë sytë nga ne, motra e vëllezër, por ka edhe elementë përparimtarë borgjezë që e respektojnë dhe kanë simpati për Shqipërinë, për qëndrimin e saj të vendosur, të drejtë, paqedashës dhe guximtar.

Shqiptarët dhe pakica kombëtare greke në Shqipëri e kanë dashur dhe e duan popullin grek, sepse ai është një popull i ndershëm, i dashur dhe i zgjuar, që ka luftuar për lirinë dhe për pavarësinë e tij. Me popullin vëlla grek ne kemi bashkuar armët dhe kemi luftuar së toku, në kohët e kaluara dhe në kohët moderne. Poeti ynë i madh, Naim Frashëri, i cili ka pasë mësuar në gjimnazin «Zosimea» në Janinë, ka shkruar një vjershë të bukur për dashurinë dhe për miqësinë e popullit shqiptar me popullin grek. Ajo vjershë është e gjatë dhe nuk e mbaj mend mirë, që t'jua thosha edhe juve këtu, por ju mund ta lexoni dhe vetë¹. Në kohët e vështira për popullin grek, populli shqiptar ka luftuar tok me të. Revolucionin Grek të vitit 1821 të udhëhequr nga

1. Është fjala për poemën «Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve», e shkruar në greqisht dhe e botuar në shqip për herë të parë më 1912. Në këtë poemë me frymëzim politik patriotik, poeti kombëtar shqiptar, Naim Frashëri, shpreh ndjenjat e vërteta të miqësisë së singertë që populli shqiptar ka ushqyer ndaj popujve fqinjë, dhe përpiqet të ngjallë te këta ndjenjën e mirëkuptimit dhe të miqësisë në mes tyre. Në këtë poemë, ndër të tjera, ai shkruan: «Ne me sllavët e me grekët, me të gjithë fqinjët tanë,/ Duam të rrojmë ngaherë me harmoni, si vëllezër,/ Veç e drejta e secilit gjithënjë të respektohet». (Naim Frashëri, «Vepra të zgjedhura», vëll. I, Tiranë, 1980, f. 486).

kapedan Aleksandër Ipsilanti, Theodor Kollokotroni, Bubulina, që ishte një grua e fortë dhe e shquar e këtij Revolucionit, të gjithë e tradhtuan, por shqiptarët jo. Cari i Ruisë, bullgarët dhe serbët tradhtuan, kurse shqiptarët me Marko Boçarin e Xhavellën nga Suli luftuan deri në fund krah për krah me vëllezërit grekë. Rezistenca e Ipsilantit dhe e Kollokotronit mori fund në More, ku ishin bërthamat e të vjetërve shqiptarë.

*«Arvanites penemeni,
Pu ine o Ali Pashas, kajmeni!?»*

Ali Pasha, siç e dini, ishte një feudal, por interesat e tij në ato momente ujdin me interesat e Revolucionit Grek. Kur ishte formuar «Filiqi Eteria»², Kollokotroni tha: «Ta ftojmë edhe Ali Pashën në këtë Eteri.».

— Ta ftojmë, — tha edhe Marko Boçari, megjithëse Aliu i kishte vrarë suliotët.

— Të na ndihmojë më mirë nga jashtë, — tha një tjetër.

Shumë të tjerë këtej, nga Shqipëria, luftuan krah për krah me grekët dhe për ta kënga popullore thotë:

*«Ju vaporë që po shkoni
në çdo port shkoni qëndroni,
Bubulinës i thoni:*

1. Greqisht — O shqiptarë trima të ndjerë,
More ku e kenë, Ali Pashanë, o të mjerë?

2. «Shoqëria e miqve», që kishte për qëllim organizimin e revolucionit çlirimtar grek.

*Lajm i keq moj Bubulinë
Të vranë Qafëzezlinë»*

(Qafëzezliu ishte nga Kolonja dhe luftonte tok me grekët për çlirimin nga turqit.)

Dhe Bubulina përgjigjet:

*«Sikur të mos e kishin vranë,
burrë do ta kisha marrë».*

Miqësia jonë me popullin grek është e lidhur me gjakun e derdhur në luftën për liri e për pavarësi kundër të njëjtëve armiq. Aktualisht qeveritarët grekë deklarojnë se janë për përmirësimin e marrëdhënieve me Shqipërinë dhe, në fakt, ne jemi duke i përmirësuar ato. Ata kanë gjetur kurdoherë mirëkuptim te populli shqiptar dhe të Qeveria shqiptare. Me Greqinë kemi shkëmbime tregtare e kulturore. Pas disa ditësh do të vendosim linjën ajrore Tiranë—Athinë. Së shpejti do të vijë për të dytën herë në Shqipëri ministri i Tregtisë i Greqisë për të nënshkruar një marrëveshje tregtare. Këto marrëdhënie janë shumë të dobishme për të dy popujt tanë, të cilët duan të forcojnë miqësinë, të jetojnë si gjitonë të mirë. Asgjë e keqe nuk mund t'i vijë Greqisë nga ana jonë dhe këtë e di populli grek. Popujve tanë e keqja mund t'u vijë nga armiqtë e lirisë e të pavarësisë së popujve. Ndjenjat e popullit grek e të popullit shqiptar puqen, secili i do të mirën tjetrit, natyrisht, duke qenë gjithkush në vendin e tij, gjith-

kush në punën e tij. Ne dëshirojmë ta zhvillojmë mbi këto baza miqësinë e sinqertë.

Politikën e Shqipërisë nuk e pëlqejnë vetëm ata që na kanë halë në sy, pse ne themi të vërtetën, pse ne përparojmë, pse ne dimë të mbrohemi nga armiku. «Mikun duaje, por armikun urreje», thotë populli ynë. Atyre që janë përpjekur të dëmtojnë interesat e popullit shqiptar, kurrë nuk u ka dalë mirë, se populli ynë ka ditur të luftojë pa frikë kundër armiqve të tillë si fashistët e nazistët, imperialistët amerikanë e socialimperialistët sovjetikë e të tjerë. Populli shqiptar, me Partinë e vet në krye, i ka marrë të gjitha masat për mbrojtjen e vendit. Ne jemi përgatitur në mënyrë të tillë, saqë, po të guxojë armiku e të futë gishtin, do të lërë krahun. Prandaj, le ta dinë mirë të gjithë ata që nuk na duan se, në qoftë se dikur, ky apo ai agresor ka arritur ta pushtojë Shqipërinë, sot ai do të mbytet që në det e nuk do të mund të zërë vend as në rërë, as në sterc.

E keni dëgjuar emrin e Abaz Kupit, atij zogistit, që në kohën e luftës ua mbathi këmbëve nga frika e popullit? Disa ballistë, atje në mërgim, i thanë atij para disa vjetësh: «Tashti erdhi koha të pushtojmë Shqipërinë». Por Abaz Kupi ua ktheu: «Uluni një çikë, se komunistët shqiptarë i njoh mirë unë. Nuk jeni ju nga ata burra që mund të vemi atje e të mateni me komunistët, prandaj rrini, se mirë jeni këtu; hani këtë krodhë bukë e mos u ndieni.»

Armiqtë, sido që flasin kundër nesh, e njohin forcën tonë.

Megjithatë, neve na vihet për detyrë që të punoj-

më vazhdimisht, të ushtrohemi ushtarakisht, të prodhojmë sa më shumë e të vigjilojmë. Kurdoherë duhet të jemi vigjilentë. Ne jemi miq të mirë me ata që duan të jenë miqtë tanë, por nuk flemë para atyre që nuk na duan. Masat paraprake të luftës kundër armikut shërbejnë si ato kundër sëmundjeve ngjitëse. Secili duhet të ketë kujdes të respektojë normat higjienike se ndonjë mikrob mund të futet në trup dhe të infektojë gjakun. Në një rast të tillë, njeriu duhet të marrë përnjëherë ilaçet që të shërohet dhe është shumë më mirë që ilaçet të përdoren në kohën e duhur, se kur sëmundja avancon, ka më tepër rreziqe. Por edhe më mirë e më e domosdoshme se kurimi, për jetën dhe shëndetin e njeriut është profilaksia se ruan organizmin nga mikrobet. Natyra ka krijuar në gjakun e njerëzve dy elemente: globulat e kuqe dhe globulat e bardha. Këto të fundit janë «punonjësit e sigurimit». Kur marrin sinjalin dhe shohin se organizmit i kanoset rrezik nga ndonjë mikrob, ato lëshohen pa vonesë, e mbërthejnë «armikun» me një perde të bardhë, e futin brenda dhe e asgjësojnë.

Kështu duhet t'i marrim edhe ne masat profilaktike për mbrojtjen e atdheut, domethënë të mësojmë që tani se si të përdorim mitralozin e topin, të njohim Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, që është një art i veçantë. Le të kenë armiqtë tanë armë të mëdha e të fuqishme, këto nuk na trembin, se nuk pinë ujë në tokën tonë. Për mbrojtjen kundër raketave të tyre ne kemi bërë punimet nën dhe. Që të na pushtojë armiku, duhet të shkelë në tokën tonë, por, po vuri këmbët këtu, atij do t'i thyhen edhe këmbët, edhe dhë-

mbët. Pra, po i zunë këmbët dhe armikut në truallin tonë, tek ai do të drejtohet mitralozi i vendosur në qendrat e zjarrit, që ju i dini, dhe ushtarët e tij do të palosen, siç palos drapri grurin. Por ndërsa kallirin e grurit e futim në hambar, armikun e futim në tokë dhe pastaj do të duhet të vijë përsëri një «gjeneral i ushtrisë së vdekur», për të marrë kockat në thasë najloni.

Meqë ra fjala, grurin ta korrni shpejt dhe ta futni në hambar, sepse na duhet për t'u ushqyer dhe për të mbushur depot. Të prodhojmë sa më shumë, që të kemi boll jo vetëm për të ngrënë e për të vënë zahire për tërë vitin, por edhe për të shtuar rezervat në depo, se imperialistëve e socialimperialistëve nuk u zihet besë. Ne vërtet jemi të fortë dhe të sigurt në mbrojtjen tonë, por armiqtë veprojnë hapët e nën rrogos. Lumi, ai Drinoja atje, mund të flejë, por armiku nuk fic. Nganjëherë Drinoja, kur sjell ujë shumë, e kapërcen shtratin, por tashti që ju i keni vënë një pritë të mirë, i thoni: «Të shkosh këtej nga duam ne!». Kështu i thamë edhe lumit Drin në Veri, që ju duhet ta keni parë në televizor, sepse në fshatrat e Dropullit të Poshtëm, në qoftë se nuk gabohem, ka nja 280 televizorë.

E keni parë ujin e Drinit se si del nga tuneli? Këtë vepër e bënë djemtë dhe vajzat tona, punëtorët, teknikët dhe inxhinierët tanë të talentuar. Së shpejti do të vihet në shfrytëzim turbina e parë që po montohet; më pas edhe e dyta, e treta dhe e katërta. Diga e hidrocentralit të Fierzës është një nga më të mëdhatë në Evropë; liqeni i saj do të shtrihet e do të zgjatet

deri në Kosovë, në Jugosllavi. Ky hidrocentral i madh, jo vetëm që do të realizohet në kohë, por ne kemi në plan që të ndërtojmë një tjetër akoma më të madh, në Koman, dhe do ta ndërtojmë.

Të dashura motra e vëllezër, mëma dhe baballarë,

Sot pashë këtu disa të moshuar, por nga zemra duket që janë të rinj. Po të më pyesni mua për moshën, do t'ju thosha: jam 50 vjeç, se më tepër se kaq nuk e ndiej veten. Lufta për ndërtimin e socializmit na ka rinuar. Nga kjo luftë njeriu nuk mposhtet as fizikisht, as shpirtërisht, përkundrazi, organizmi merr një gjallëri të veçantë. Ju e keni vënë re që, kur filloni punën me sulm në brigadë për t'i marrë prodhimet sa më parë, nervat rrinë të tendosur dhe, megjithëse lodheni një çikë fizikisht, nga kënaqësia, e ndieni veten të lehtë, sikur keni fletë në supe. Dëshira e madhe për përmirësimin e jetës, për zbukurimin e vendit dhe për forcimin e republikës sonë popullore ju jep krahë, ju bën më të rinj.

Në Shqipëri nuk vdesin më njerëzit nga sëmundjet dhe skamja në moshën e re si në kohën e regjimeve antipopullore. Kur e shikoje fshatarin përpara që vinte 35 ose 40 vjeç, të dukej plak, kurse tash edhe ai që është 70 vjeç është drënjë. Njëri atje më shtrëngoi dorën dhe nuk e ndiente, por unë kisha dhimbje se, të them të vërtetën, nuk kam punuar si ju me shat e me lopatë, prandaj ju admiroj për ato duar të shkathëta e të forta me kallo që keni. Por, megjithëse

nuk i kam duart me kallo, Partia më ka mësuar të punoj e të luftoj sa të jem gjallë, me ato mundësi që kam, për lumturinë e këtij populli kaq të mirë.

Në këtë rrugë që po ecim, ne do të kemi një zhvillim akoma më të madh politik. Zhvillimi dhe kalitja e ndërgjegjes politike të njerëzve tanë kanë rëndësi të dorës së parë. Le të thotë Ten Hsiao Pini, që ka ardhur përsëri në fuqi në Kinë, se politika na qenka brima e fundit e kavallit. Politika është e para dhe ajo na duhet neve për të ecur përpara. Në qoftë se njeriu ynë është i qartë politikisht, atëherë ai mund të bëjë çdo gjë, në të kundërtën, në qoftë se ai nuk është i qartë politikisht, shtëpinë dhe Shqipërinë do t'i marrë lumi. Ne e vëmë politikën proletare në plan të parë, prandaj Shqipërinë nuk do ta marrë kurrë lumi.

Politika tok me ideologjinë udhëheqin tërë veprimtarinë tonë. Po cila politikë dhe ideologji na udhëheqin ne? Ne na udhëheq vetëm politika proletare, ideologjia marksiste-leniniste. Ten Hsiao Pini thotë se ata zbatojnë parimin e «lulëzimit të njëqind luleve e të konkurrimit të njëqind shkollave», por, po lulëzuan njëqind «lule» e po konkurruan njëqind «shkolla» vajti «gruri». Po të lihet luleverdha të lulëzojë në grurë ose të rritet kuskuta në jonxhë, do të marrin fund edhe gruri edhe jonxha.

Tani e kemi shtruar muhabetin. Ju më thatë ulu dhe unë u ula, por dijeni se, kur ulem, flas më shumë, prandaj, kur të lodheni do t'ju lutem të më thoni: «Mjaft fole, Enver!».

Te «njëqind lulet e njëqind shkollat» e kinezëve e kisha fjalën, o shoku Spiro? Spiron, shoqe dhe sho-

kë, që është nga këto anë, e kemi një nga specialistët më të mirë në Ministrinë e Bujqësisë.

«Njëqind lulet» nuk të nxjerrin në dritë. Po të duash të rrosh me erë, mund të mbështetesh te kjo parullë, por me erë dihet se nuk rrohet. Merri sa të duash erë trëndafilit, po nuk i fute bukë barkut, nuk ngopesh dhe s'ke fuqi. Këtu nuk është fjala që të mësohen njëqind zanate, se këtë ku ta gjesh, do të bëheshe omnisien, që të zotëroje shumë shkenca, por «lulëzimi i njëqind shkollave» ka kuptimin e lulëzimit të njëqind ideve të ndryshme, të shumë partive politike në një vend, që çoroditin mendjen e njerëzve. Ten Hsiao Pini do që të ketë shumë parti politike. Po të ishte këtu, në Shqipëri, Teni do të thoshte: «Sikur të krijohej partia e Myfit Beut, partia e Bame Mezinit, partia e ndonjë fajdexhiu tjetër, partia e agallarëve» etj., etj. Po të lejohej me të vërtetë krijimi i këtyre partive, merreni me mend se çfarë do të bëhej këtu, do të mbretëronin ideologji të ndryshme dhe marksizëm-leninizmi nuk do të ishte më ideologji sunduese. Kjo është arsyeja që ne jemi kundër «lulëzimit të njëqind luleve e të konkurrimit të njëqind shkollave». Ne jemi për një shkollë të vetme, për shkollën marksiste-leniniste.

Politikën tonë dhe planin ekonomik ne i hartojmë në bazë të ideologjisë marksiste-leniniste. Planin pesëvjeçar është real. Tash kemi përpara detyrat e mëdha për realizimin e planit të vitit 1978, i cili është diskutuar gjerësisht në rrethe e në bazë. Ne kemi synuar që ky plan të jetë sa më i ngjeshur dhe rendimentet që parashikohen të merren mbi bazën e tij, në

bujqësi ta zëmë, të jenë të larta. Dhe në fakt, rendimentet tona të larta janë. Në kooperativat dhe fushat tuaja ka sektorë që kanë marrë nga 100 apo 110 kuintalë misër për hektar. Ky kallamboq, siç i thoshin misrit dikur, është prodhuar me sasi të tilla që në kushtet tona as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk i kanë arritur.

Fermeri amerikan vërtet merr rendimente të larta në disa bimë, për arsye se ka mekanizime të mëdha, ka edhe plehra shumë, por fshatarët në Shtetet e Bashkuara janë zhdukur, disa prej tyre janë futur punëtorë në industri, ca fshijnë rrugët, të tjerët mbajnë barkun me dorë, shtrëngojnë rripin. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë krijuar edhe ca shoqëri «bami-rëse», që u japin të papunëve çdo mbrëmje nga një tas me ujë të nxehtë, gjoja me «supë», por këto «ndihma» nuk e zgjidhin problemin. Me miliona janë atje njerëzit që vuajnë. E vërteta është se atje realiteti i zyrtë dhe varfëria burojnë nga ekzistenca e rendit kapitalist.

Te ne bëhen plane të realizueshme, të bazuara në rezultate që janë arritur me punë të palodhur nga fshatari ynë. Kooperativistët tanë mund t'i marrin rendimentet e parashikuara në grurë, në misër, në jonxhë, në luledielli etj. Në Pesjak mund të merret duhan më shumë, pse atje nuk janë më zotër Hasanajt, por fshatarët e Suhës, siç janë zotër edhe kooperativistët e Dropullit. Duke realizuar dhe duke tejkaluar detyrat e planit për arsyet që përmenda më lart, do të fuqizohet më shumë ekonomia jonë socialiste dhe do të forcohet akoma më tepër shteti i diktaturës së proletariatit.

Pas Çlirimit të vendit, kur zbritëm nga mali, nuk kishim asgjë, ekonomia jonë ishte e rrënuar. Komiteti Qendror i Partisë dha orientime për mëkëmbjen, ri-ndërtimin e ndërtimin e vendit, dhe, hap pas hapi, çdo vit e më mirë, arritëm në lartësinë e sotme. Ndonjë mund të thotë: «Ju dha ndihmë Stalini». Po, Stalini, për të cilin kemi shumë respekt, na ka ndihmuar, se ishte marksist-leninist i madh. Unë kam vajtur shumë herë te Stalini dhe i kam kërkuar ndihma. Mbaj mend që një herë ai më ka thënë:

«Shoku Enver, ne vetë jemi të djegur e të përvëlur nga lufta, por për Shqipërinë do të japim diçka. Mos na e vini re, në qoftë se tani për tani nuk kemi shumë mundësi t'ju ndihmojmë, por ato që do të kemi, do t'ju japim me gjithë zemër». «Shoku Stalin, neve na duhen armë për t'u mbrojtur nga armiqtë», i thashë unë. «Do t'ju japim edhe armë!», ishte përgjigjja e tij. «Po ne, shqiptarët, nuk kemi mundësi t'i paguajmë», e sqarova, duke e hedhur tej turpin. «Asgjë nuk do të paguani për këto; vetëm Partia juaj të ketë kujdes, që të jetë e lidhur me popullin!». «Kemi menduar ta kolektivizojmë fshatin», i thashë, në vazhdim të bisedës me të. «Ta kolektivizoni, por mos u shpejtoni. Këtë punë e kryeni javash-javash dhe kur të bindet vetë fshatari, se kooperativa është shpëtimi i tij, është socializmi, është pushteti i pavdekshëm i popullit. Duhet ta bindësh fshatarin gradualisht e me durim; kush të dojë, le të futet në fillim, të tjerët do të binden më pas. Do të kolektivizohen 3, 5, 15, e më vonë 50 fshatarë. Të jeni të sigurt që do të vijë një kohë dhe të tërë

do të kërkojnë të futen në kooperativa, sepse të mirën do ta shohin me sytë e tyre».

Dhe ne kështu bëmë. Në fillim, në qoftë se ju kujtohet, filluam me hapa të matur, duke bashkuar tokat, bagëtitë e me radhë. Pastaj, kur fshatarët krijuan bindjen për të mirat e kolektivizimit, u futën të tërë në kooperativat bujqësore.

Rruga e kolektivizimit të bujqësisë, që na ka mësuar Lenini, është shpëtimtare, se prona kolektive zhduk ndjenjën e pronës private, që si një vemje e rrezikshme i është futur njeriut në shpirt me shekuj. Ndjenja e pronësisë mbi tokën është veçanërisht e theksuar te fshatarët, të cilët kanë luftuar tërë jetën për një copë tokë. Prandaj Lenini ka shkruar që para se të kryhet kolektivizimi, duhet bërë reforma agrare, që toka t'u jepet fshatarëve. Dhe ne kështu vepruam. Tokën, kafshët dhe mjetet e punës, si qetë, plugjet etj. ua morëm pa shpërblim agallarëve dhe ua dhamë fshatarëve. U shpërndanim edhe nga fare pak pleh kimik që nevojitej për bimët bujqësore. Të tillë pleh ne nuk kishim atëherë, por një sasi të paktë e blenim nga jugosllavët që na e shitnin shumë shtrenjtë. Në qoftë se jugosllavët e blenin për vete një, neve na e shitnin dhjetë. Të gjithë e dini si na i grabitën ata mallrat e tregut pas Çlirimit.

Lenini na ka mësuar që, kur bëhet kolektivizimi në fshat, duhet t'u lihet fshatarëve një sipërfaqe e vogël toke pranë oborrit për shfrytëzim vetjak, sepse ndjenja e interesit të ngushtë privat do të zhduket jo menjëherë, por gradualisht. Psikologjia e pronës private, na mësojnë Karl Marksi, Lenini dhe Stalini do të

zhduket, siç do të zhduken borgjezia dhe kapitalizmi. Duke punuar e duke forcuar mirë kooperativën, do të forcohet më tepër edhe prona e përbashkët. Kur të merren në të gjithë fushën për çdo hektar nga 50 kuintalë grurë, nga 100 kuintalë misër, nga 20 kuintalë duhan e të tjera e të tjera, kooperativisti do të thotë: «Në drejt të vejë kjo copë tokë që kam në shfrytëzim vetjak, se nuk më mban kjo mua, por të ardhurat e mëdha nga puna në kooperativë».

Prodhimi i përbashkët në pronën e përbashkët, bëhet burimi kryesor i mirëqenies, megjithatë Partia tani nuk këshillon të likuidohet oborri kooperativist. Dita me ditë, vit për vit po shtohet prodhimi nga prona kooperativiste. Me kalimin e kohës prodhimi i oborrit do ta humbasë gjithnjë e më shumë peshën e rëndësinë, do të bëhet diçka më pak e ndjeshme në krahasim me prodhimin e madh të kooperativës. Sidoqoftë, sot për sot, lënia e oborrit në shfrytëzim vetjak është një ndihmë për kooperativistët, të cilët duhet të kuptojnë se futja e sa më shumë ditë-punëve në kooperativë jep të ardhura disa herë më tepër se oborri.

Nuk është e drejtë që një krah pune të rrijë e të vrasë kohën duke ruajtur vetëm dhjetë kokë bagëti të imëta ose një lopë që ka familja në pronësi vetjake. Është më mirë që këto të tufëzohen e të kullosin së toku me bagëtitë personale të kooperativistëve të tjerë. Kështu, duke punuar më mirë e më shumë në kooperativë, do të realizohet një e ardhur më e madhe si në dobi vetjake, ashtu edhe në dobi të përgjithshme.

Njeriu i shoqërisë sonë socialiste nuk duhet të mendojë vetëm për interesin vetjak, por, në radhë të pa-

rë, të shqetësohet për interesin e përgjithshëm, pse kur janë mirë të gjithë, edhe secili veçanërisht është mirë. Po nuk qenë mirë të gjithë, asnjë vlerë nuk ka nëse është në gjendje të mirë vetëm ndonjëri. Prandaj Partia thotë që interesi i përgjithshëm qëndron mbi çdo gjë.

Tash nga Partia është dhënë orientimi që bagëtia e oborreve të tufëzohet. Për këtë qëllim janë përcaktuar edhe disa kushte. Kryesia e kooperativës dhe organizata e Partisë duhet ta zbatojnë sa më mirë këtë orientim. Për administrimin e tufës duhet të mbahen mirë llogaritë; qumështi të jepet me kohë. Po kështu edhe të hollat, leshi etj., të shpërndahen aq sa i takon secilit. Në qoftë se ngordh një bagëti, atëherë të bëhet llogari që të mos dëmtohet vetëm pronari i saj, por dëmin ta përballojnë të tërë kooperativistët nga pak. E mira është e të gjithëve, por edhe e keqja duhet të ndahet bashkërisht, se, kur e heqin të gjithë, pasoja e së keqes nuk ndihet shumë. Bagëtitë e oborreve duhet të ushqehen mirë, sepse edhe ato duhet të japin prodhime si bagëtitë e kooperativës. Çështja e tufëzimit në asnjë mënyrë të mos konsiderohet si shpronësim. Tufëzimi bëhet për lehtësi të kooperativistëve.

Kur u shkurtuan sipërfaqet e oborreve në përdorim vetjak u dha porosia që gjithë kjo tokë të mbillej me foragjere ose me bimë të tjera dhe prodhimet t'u jepeshin kooperativistëve. Për përdorimin e kësaj toke do të vendosnin, pra, vetë kooperativistët, të cilët do të caktonin nëse do të mbillej me foragjere, me bimë industriale, me labot, me qepë, apo me ndonjë bimë tjetër. Pasi të vendosej si më sipër dhe të mbilleshin ato bimë që nevojiteshin për anëtarët, atyre do

t'u bëheshin shërbimet e duhura siç u bëhet të mbjellave të kooperativës. Pastaj prodhimet do t'u ndaheshin kooperativistëve. Kështu do të shikohej qartë se të ardhurat e realizuara në këtë mënyrë, do të ishin më të mira nga të atyre stremëve që kishte kooperativisti në përdorim vetjak. Mirëpo kjo direktivë e drejtë në shumë raste, u vu nën gunë nga kryesitë e kooperativave dhe lopës ose bagëtive të imëta të kooperativistit nuk iu siguroa ushqimi. Atëherë, lindi problemi: Ku t'i ushqenin kooperativistët bagëtitë? Në këto kushte disa kooperativistë filluan t'i futnin në tokat e kooperativës. Kështu, pa dashur, fëmijës që ruante bagëtitë i prishej ndërgegjja aq e pastër. Shfaqje të kësaj natyre janë vërtetuar jo vetëm te ju, por edhe gjetkë.

Kur vendosim diçka duhet të marrim masa politike, teknike dhe organizative të drejta që t'i evitojmë shkeljet e statutit të kooperativës. Si t'i evitojmë, me gjoba?! Partia është kundër vënies së gjobave vend e pa vend. Gjykatat popullore të fshatrave duhet të jenë të matura në gjykimin e kundërvajtjeve në bujqësi. Partia në fshat duhet të punojë, në radhë të parë, politikisht që njerëzit ta kuptojnë mirë interesin e përbashkët dhe jo të zbatohen dënimet me gjobë, me rast e pa rast. Partia jonë është kundër qëndrimeve të tilla. Ne themi se politika proletare qëndron në plan të parë dhe kjo është shumë e drejtë. Edhe në zbatimin e dënimeve bëhet politikë. Secili prej nesh, me urtësi dhe me durim, t'u shpjegojmë të afërmve, motrës dhe vëllait, tetos dhe xhaxhait, që të respektojnë normat e vendosura për ruajtjen e pasurisë së përbashkët. Janë vënë shumë gjoba dhe ka raste që nuk janë paguar. Po

përse vihen gjoba pas gjobash kot? Partia na porosit që t'i shikojmë më me kujdes këto shfaqje dhe të bëjmë ç'është e mundur që ato të evitohen.

Me popullin duhet të sillemi kurdoherë me respekt e dashuri, duke ruajtur fort unitetin e tij me Partinë. Shpjegimi me durim i një faji dhe bindja për të mos e kryer më, vlen shumë më tepër se gjobat e gjykatës. Populli çdo gjë e kupton drejt, prandaj ia thuaj të vërtetën siç është dhe mos ki frikë se mos ai nuk të përkrah. Po t'u thuash njerëzve tanë që kemi këtë hall, ata të mbështetin plotësisht. Me popullin kurdoherë të flitet haptazi, sepse, po nuk e patëm këtë me vete, do të thotë se nuk jemi në vijë të drejtë. Pa masat punonjëse venitet marksizëm-leninizmi, fishket Partia. Pse është e fortë Partia jonë? Se është e lidhur me popullin, se i thotë popullit kurdoherë të vërtetën. Partitë revizioniste nuk ia thonë popullit të vërtetën, se i tremben gjykimit të tij, prandaj dhe janë krimbur.

Ne jemi të fortë. Këtë të vërtetë nuk e kuptojnë vetëm ata që nuk e njohin forcën e popullit. Revolucionin e bën populli; po kështu edhe ndërtimin e socializmit. Popullit që, nën udhëheqjen e Partisë, bën revolucionin dhe ndërton socializmin, nuk duhet t'i fshihet asgjë. Pengesat, vështirësitë dhe rreziqet populli duhet t'i njohë, prandaj t'i thuhet hapët, se është ai që do t'i kapërcejë. T'i thuhet popullit: «Sëmundja është këtu, prandaj të mobilizojmë të gjitha forcat dhe mjetet që ta shërojmë atë! E mira është këtu, prandaj të punojmë për ta konsoliduar këtë të mirë!». Kështu ka bërë e kështu do të bëjë edhe në të ardhmen Partia jonë. Kjo është arsyeja që organizatat-bazë të Partisë, ku-

do, kërkojnë mendimin e popullit për të gjitha çështjet, që nga më të voglat e deri te më të rëndësishmet, se e dinë që vetëm kështu kalitet uniteti ynë. Planet që vendosim ne për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës do të realizohen me sukses, sepse kanë mbi vete vulën e mendimit popullor.

Do t'ju flas pak edhe për artin e kulturën. Nuk dua t'ju bëj qejfin, por arti juaj popullor, këngët dhe vallet tuaja, shquhen për muzikalitetin, për ritmin e bukur, për elegancën, pra është, siç i thonë, një art i kulturuar. Kur dalin dropullitet e dropullitët në skenë, përnjëherë vihet re një hare e madhe në spektatorët e në skenat tona. Jashtë kanë bërë përshtypje të mira të gjitha këngët dhe vallet tona popullore. Ju keni parë në televizor që, kur vajti në Greqi Ansambli ynë i Këngëve dhe i Valleve Popullore, korri kudo një sukses shumë të madh. Populli dhe qeveritarët grekë e kanë pritur me shumë dashamirësi dhe entuziazëm Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve Popullore të Shqipërisë, të gjithë i pëlqyen shumë këngët dhe vallet tona, si dhe kostumet kombëtare, për të cilat kanë shkruar me ngrohtësi poetë, shkrimtarë e artistë në gazetatat e në revistat e Greqisë. Një gazetar ka shkruar për karakteristikën e valltarëve tanë, për ato cilësi që janë vënë në dukje shpesh nga të huajt: «Kur kërcejnë shqiptarët janë të lehtë si pendë, por toka dridhet nën këmbët e tyre». Kudo që kanë shkruar, vajzat dhe djemtë tanë kanë korrur sukses të madh. Ata kanë dhënë koncerte edhe në Jugosllavi, në Francë, në Suedi e gjetkë dhe kanë lënë përshtypje shumë të mira. Me ekzekutimin e shkathët ata u kanë treguar popujve të

këtyre vendeve se socializmi i zhvillon lart kulturën dhe artin e mrekullueshëm të popullit.

Unë ju përgëzoj ju, dropullitët, për ruajtjen e zhvillimin e këngëve dhe të valleve tuaja, për kostumet tuaja të bukura. I ruani këto se janë të vlefshme, jo vetëm për ju, po për të gjithë Shqipërinë socialiste. Ruajeni folklorin tuaj, grumbullojeni atë dhe shkruajeni në greqisht, bile të përkthehet edhe në shqip. Ne kemi minoritarë që mund të na ndihmojnë shumë në këtë drejtim, si Pano Çuka, shkrimet e të cilit më pëlqejnë shumë, por ka dhe të tjerë që mund të shkruajnë. Të tillë janë, sidomos, shumë nga mësuesit e minoritetit, të cilëve do t'u lutem të mbledhin gojëdhënat, këngët, përrallat e popullit të Dropullit, t'i regjistrojnë, se ato janë një thesar për mbarë popullin tonë. Të shkruajnë ata historinë e këtij populli heroik e luftëtar, që ka punuar, ka vepruar dhe ka jetuar në vëllazëri tok me popullin shqiptar. Mjerimet dhe vuajtjet e tij në të kaluarën duhet t'i dinë edhe të vegjlit tanë që rrojnë në lumturi, në socializëm. Të mos harrohen vuajtjet e të parëve dhe të dihet vlera e veprës së tyre. Kur brezi i ri shikon të mirat e socializmit, po të mos i tregohet e kaluara, ai nuk ka si të mësojë si kanë jetuar, luftuar e vuajtur të parët e tij. Prandaj ne duhet t'i tregojmë brezit të ri edhe të mirat e të parëve, në radhë të parë, por edhe vuajtjet e tyre, të gjyshërve e të gjysheve, të baballarëve e të nënave.

Më kanë thënë që kur janë kthyer në Greqi poetët e shkrimtarët grekë, që kanë vizituar vendin tonë, kanë folur ndershmërisht dhe kanë shkruar sinqerisht për realitetin tonë. Ata kanë shkruar se kanë qenë in-

formuar keq për gjendjen e minoritetit në Shqipëri, dhe se për jetën e minoritarëve tanë kanë shpifur vetëm disa njerëz të ligj.

Ata njerëz janë të ndershëm, prandaj kanë thënë të vërtetën, po ka të tjerë që, megjithëse janë shqiptarë, nuk shqetësohen për vendin e tyre. Nuk flas këtu për disa njerëz që kanë vajtur në kurbet para shumë vjetësh, as për qentë ballistë që u dhamë dërmën, por e kam fjalën për disa të emigruar që e kanë harruar atdheun...

U shkruani letra të dashurve tuaj për realitetin dhe të mirat që keni këtu, për jetën e bukur që bëni këtu, që të gëzohen edhe ata, dhe ndonjërit t'i kthjellohet ndonjë mjegull që ka në kokë, sepse ka njerëz që kërkojnë të përhapin mjegull në radhët e emigrantëve shqiptarë, prandaj shkruajuni të afërmve tuaj për të vërtetën ashtu siç është këtu, që të kënaqen.

Ah! Ç'më vjen keq që u bëtë qull¹.

Kisha për të thënë edhe diçka. Dëshira ime është që t'i shoh Dropullin dhe gjithë këto kodra këtu sipër, rrëzë malit, të pyllëzuara me pemë frutore dhe me dru-rë. Këtu duhet të jetë pyll *monato*².

Të dashur vëllezër dhe motra,

Në emër të Komitetit Qendror unë edhe një herë ju uroj përzemërsisht gjithë të mirat. Ta doni Partinë me

1. Mitingu i madh popullor zhvillohej në natyrë dhe shiu vazhdonte të binte.

2. Greqisht — krejt.

gjithë shpirt, sepse ajo na nxori në dritë dhe do të na sjellë të mira akoma më të mëdha. Partia është ajo që na mëson dhe na armatos si ta kemi kurdoherë Shqipërinë të lirë, që malet t'i bëjmë të bukura si fushat, që hambarët t'i kemi plot, që fëmijët të na rriten të shëndetshëm e të lumtur. Kur punon me djersë në shoqërinë socialiste dhe krijon bollëkun, asgjë nuk e prek dashurinë midis njerëzve. Për këtë dashuri, për këtë unitet të mbështetur në marksizëm-leninizmin, luftojnë Partia dhe populli.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli!

Të rroni ju, motra e vëllezër, pioniere e pionierë të dashur të Dropullit të Poshtëm e të Sipërm. Si të mos djersitemi ne për jetën e bukur të këtyre fëmijëve të vegjël?! Këta janë lulet tona më të bukura.

Të rrojnë gjithë minoritarët patriotë që punojnë në të katër anët e atdheut socialist!

T'u dërgojmë atyre përshëndetje të përzemërta këtej nga Grapshi.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Dy popuj
miq», f. 254*

*Botohet i plotë sipas shënime-
ve të mbajtura në këtë miting,
që gjenden në AQP*

NË SHQIPËRI ZBATOHEN PLOTËSISHT TË DREJTAT E MINORITETIT

*Nga biseda me kuadro të kooperativës
bujqësore të Vrisesasë dhe asaj të Grapshit¹*

22 mars 1978

Patriotizmi i popullit të krahinës së Dropullit është i madh, është një patriotizëm socialist. Drejt e tha një shok në mbledhjen me kuadrot në Gjirokastër, në të cilën asistova para disa ditësh, se shovinizmi në marrëdhëniet midis popullsisë së minoritetit dhe asaj shqiptare është zhdukur prej kohësh. Unë e aprovova gjykimin e tij dhe thashë se nuk do të ekzistojë kurrë te ne as shovinizëm grek, as shovinizëm shqiptar. Nuk ka pse të jetë Dropulli ndryshe nga Gjirokastra, nga Vlora, nga Shkodra. Ikën ato kohë kur vetë populli shqiptar shtypej nga feudalizmi, nga satrapi Ahmet Zog, nga bejlerët e nga agallarët, që shtypnin edhe popullsinë minoritare.

Fjalët e ngrohta të atyre që folën në këtë takim

1. Këtë takim shoku Enver Hoxha e zhvilloi pas mitingut të popullit të krahinës së Dropullit.

shprehin më së miri ndjenjat e popullit heroik të minoritetit, zemra e të cilit rreh me të njëjtin ritëm që rreh dhe zemra e gjithë popullit tonë. Shqiptarë e minoritarë jemi një e të pandarë. Të drejtat që gëzon minoriteti në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, unë vë dorën në zjarr dhe shpreh sigurinë që nuk i gëzon asnjë minoritet tjetër, në cilindo shtet të botës. Në botë nuk ekzistojnë më vende të tjera me të vërtetë socialiste, që të zbatojnë një politikë leniniste me pakicat kombëtare. Për demagogji kushtetutat borgeze e revizioniste shpallin barazinë e të drejtave të pakicave kombëtare, por në realitet barazia reale nuk ekziston. Vetëm në Shqipëri, ku zbatohet me konsekuencë marksizëm-leninizmi, janë të siguruara plotësisht të drejtat e barabarta të minoritetit me pjesën tjetër të popullit.

Pakica kombëtare ekzistojnë edhe në Jugosllavi, në Rumani, në Hungari e gjetkë, por edhe kur këto vende konsideroheshin socialiste, të drejtat e pakicave kombëtare ishin të shpallura vetëm formalisht, në kartë. Në Bashkimin Sovjetik, ku revizionistët e kanë shkallmuar rendin socialist, thonë se gjoja ndërtojnë komunizmin. Po çfarë komunizmi është ai, kur faktet e pamohueshme tregojnë se hrushovianët e kanë kthyer mbrapsht Bashkimin Sovjetik, në një burg popujsh dhe kanë rivendosur atje kapitalizmin. Ne kurrë nuk do të kthehemi prapa, socializmin do ta forcojmë mirë në vendin tonë. Dhe socializmi forcohet, masat zhvillohen politikisht, ideologjikisht, moralisht, kur vazhdon procesi i ngritjes dhe i përhapjes së kulturës, i zhvillimit të gjithanshëm të ekonomisë, i rritjes së pa-

reshtur të mirëqenies nga një stad në stadin tjetër etj., etj. Pastaj, në një fazë më të avancuar, shoqëria jonë do të kalojë në komunizëm. Arritja në komunizëm varet nga ne, por varet edhe nga kushtet e jashtme, nga rrethanat ndërkombëtare, nga situata revolucionare e popujve të tjerë.

Nuk po ju flas gjatë për Jugosllavinë, ku shqiptarët që jetojnë në trojet e veta janë persekutuar e janë vrarë mizorisht. Atje edhe sot e kësaj dite janë gjetur rrugë e mjete «demokratikë» për t'i sikterisur kosovarët, për t'i shpërndarë në të katër anët e Jugosllavisë dhe për t'i dërguar në Turqi e gjatë, larg trullit të tyre. Kosovarët kanë emigruar në gjithë Evropën. Në këto rrethana është e kotë të flitet për barazi në të drejtat që gjoja ata kanë me kombësitë e tjera.

Në Shqipëri gjen zbatim të plotë internacionalizmi proletar dhe zbatohen plotësisht të drejtat e minoritetit. Në bazë të Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, pakicave kombëtare u sigurohet zhvillimi i kulturës dhe i traditave popullore, përdorimi i gjuhës së tyre dhe mësimi i saj në shkollë, zhvillimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Çdo veprim që shkel të drejtat e minoritetit dënohet me ligj.

Në Dropull, që nga sekretari i organizatës së Partisë, anëtarët e byrosë, kryetari i kooperativës, kryetari dhe anëtarët e këshillit popullor e deri te mjekët, mamitë e mësuesit, janë minoritarë. Pardonje po lexoja në shtyp se në Jugosllavi do të bëhet mbledhja e Komitetit të Lidhjes Komuniste të Krahinës Autonome të Kosovës, ku do të zgjidhen organet drejtuese dhe de-

legatët për konferencën e 12-të të LK të Kosovës. Raportin në mbledhjen e kryesisë së Komitetit Krahinor të Kosovës, që «drejtohej» nga një shqiptar, e mbajti Petar Jakshiçi, i ardhur nga Serbia, kurse raportin për ndryshimet në statut edhe për kuadrot e mbajti Vojislav Popoviçi, edhe ky i ardhur nga Serbia. Kësaj i thonë: Ti, shqiptar mos fol, por «mba tufën», siç tregojnë për Qaqen, që i thoshin: Mos fol ti, por mba tufën!

Kam pasur një xhaxha, që quhej Hysen Hoxha, i cili ka qenë kryetar i bashkisë në Gjirokastrë. Kur erdhën trupat greke¹ unë isha i vogël, por më kujtohet që vinin te xhaxhai Janaq Shkrapë e plot të tjerë dhe i thoshin: mulla Hysen, qëndro si kryetar i bashkisë, mos ki frikë, se ti na ke ne dhe nuk do të lejojmë të të bëhet asgjë e keqe. Në ato kohë nuk kishte parti dhe njerëzit ishin të ndarë në të krishterë e myslimanë, por ndjenjat e minoritarëve grekë, të të krishterëve dhe myslimanëve, ishin aq të pastra dhe aq dashamirë, sa që uniteti i minoritetit me popullin e Gjirokastrës nuk u thye. Asgjë e keqe nuk u bë dhe nuk pati minoritarë që të thoshin: «Dale, ore, se na erdhi vëllai ynë nga kufiri». Çfarë tregon kjo? Kjo tregon atë që ndjenjat e pastra të njerëzve të mirë të popullit nuk ndryshojnë as në kohë të mirë, as në kohë të keqe, ata e ndiejnë afrimin, sepse kush ka zemrën të mirë, nuk ia do të keqen tjetrit. Përkundrazi, ai që është i lig ia do të keqen tjetrit, se kërkon të sundojë mbi të.

1. Më 1912-1916 ushtritë greke pushtuan krahinat tona të Jugut.

Çdo popull nuk do as të sundojë mbi një popull tjetër, as do që të jetë i sunduar, por ka dëshirë të rrojë në miqësi me të tjerët. Ata që duan të sundojnë mbi popullin janë kapitalistët, që socializmi në vendin tonë i zhduku politikisht. Fizikisht ata jetojnë, por diktatura e proletariatit i ka paralajmëruar të kenë mendjen dhe i ka vënë të punojnë jo në vende drejtuese, se për të komanduar të tjerët, ata le «të puthen me Milon», por të punojnë në punë të vështira dhe të qëndrojnë kokulur. Po të tregohemi liberalë e oportunistë me armikun e klasës, ai është gati ta rimarrë fuqinë në dorë dhe ta shtypë popullin prapë si më parë. Po të ndodhte kështu, fajtorë para popullit dhe Partisë do të ishin ata që tregohen të mefshtë në zhvillimin e luftës së klasave.

Vuajtjet dhe pësimet na kanë bërë të nxjerrim mësimë dhe të jemi kurdoherë të gatshëm për t'u mbrojtur. Ne duhet të dimë të organizojmë mirë mbrojtjen dhe ekonominë tonë njëkohësisht. Ekonominë dhe mbrojtjen t'i kuptojmë të dyja politikisht dhe ideologjikisht. Interesat, dëshirat dhe ndjenjat e minoritetit te ne nuk kanë asnjë fije ndryshimi nga ato të mbarë popullit shqiptar. Këtë realitet të madh që kemi krijuar do të vazhdojnë ta mbrojnë së toku shqiptarët dhe minoritarët.

Forcimi ekonomikisht dhe politikisht i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, mbajtja lart nga ana e saj e flamurit të marksizëm-leninizmit, e kanë rritur autoritetin tonë në botë. Neve nuk na rritet mendja nga sukseset që kemi arritur, por, të nxitur nga këto suksese, e kemi për detyrë, për aq sa kemi

mundësi, të ndihmojmë edhe miqtë tanë, edhe popujt revolucionarë. Janë pikërisht kuptimi i politikës së drejtë të Partisë, kuptimi politik dhe ideologjik i formës së re më të avancuar të kolektivizimit të bujqësisë, siç është Kooperativa e Tipit të Lartë të Grapshit që kanë sjellë këto suksese edhe këtu te ju.

Populli shqiptar ka bërë sakrifica të mëdha për lirinë e popullit grek në kohën e luftës. Ju e dini që atdheu ynë, duke mbrojtur partizanët grekë dhe duke u bërë prapavija e tyre, u rrezikua nga forcat e anglezëve. Skobi, megjithëkëtë ai pranoi të bënte sakrifica në favor të popullit grek.

Ne kurrë nuk ia kemi dashur të keqen Greqisë, prandaj u kemi thënë edhe qeveritarëve të saj se e keqja nuk u vjen nga ne. Unë dhe të gjithë shokët kemi bindje, se edhe populli grek kurrë nuk na e do të keqen, se është një popull liridashës si yni.

Me qeveritarët e Athinës i kemi këmbyer haptazi mendimet, ata i njohin qëndrimet tona dhe e dinë nga ç'ideologji udhëhiqemi ne. Qëndrimet tona në fushën e politikës së jashtme ata i aprovojnë. Ne mendojmë se s'kanë arsye që të përzihen në punët e Qipros as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as Bashkimi Sovjetik. Këto dy fuqi të mëdha duhet t'i lënë popullin grek dhe popullin turk të këtij ishulli që të merren vesh vetë me njëri-tjetrin. Këtë pikëpamje tonën të drejtë e aprovojnë qeveria greke, ajo e Qipros dhe ajo e Turqisë. Kush ishin ata që i ngatërruan komunitetet greke dhe turke në ishullin e Qipros? I ngatërruan imperialistët. Edhe tashti imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, për interesat e tyre, bëjnë presione

mbi Greqinë dhe kërkojnë ta vënë këtë në grindje me Turqinë, pse secili kërkon të dominojë në Mesdhe.

Superfuqitë përpiqen të sigurojnë secila për vete Mesdheun, pa menduar aspak për interesat e popullit grek e të popujve të tjerë të këtij pellgu. Kur ato shikojnë se qeveria greke u reziston intrigave të tyre, për të bërë presion, e kthejnë fletën nga qeveria turke ose anasjelltas. Duke njohur këtë veprimtari të ndyrë të këtyre dy superfuqive, ne themi se ato janë armiqtë kryesorë të popujve, prandaj popujt duhet të hapin sytë.

Ne kemi qenë kurdoherë të drejtë në marrëdhëniet me të tjerët dhe e kemi thënë hapur fjalën tonë. Autoriteteve jugosllave u kemi deklaruar «me ju ne kemi marrëdhënie diplomatike, kulturore dhe tregtare mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të dobisë reciproke dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, por ideologjikisht ne nuk pajtohemi me ju, pse ju jeni revizionistë, renegatë dhe tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Luftën ideologjike dhe politike kundër armiqve tanë ne nuk e pushojmë kurrë».

Në Beograd u zhvillua mbledhja për të ashtuquajturin sigurim evropian. Më përpara për këtë çështje kanë qenë mbledhur në Helsinki dhe ju e dini deklaratën tonë për atë mbledhje, që ishte një komedi, një instrument për të fshehur pasigurinë evropiane e jo për të garantuar sigurimin evropian. Tani janë mbledhur në Beograd me tamtame të mëdha, dhe për këtë shkruajnë artikuj e mbajnë fjalime. U mbushën 8 muaj që të deleguarit e qeverive të ndryshme të Evropës

nuk bëjnë gjë tjetër, veçse llogje, duke ngrënë e duke pirë nëpër darka.

Në kohën kur u mund Napoleoni, në afërsi të Lajpcigut, fitimtarët e internuan atë në ishullin e Elbës, që ndodhet midis Korsikës dhe Italisë. Përfaqësuesit e shteteve fituese mbi Francën u mblodhën në Kongresin e Vjenës që të caktonin kushtet e paqes. Në këtë kongres mosmarrëveshjet midis fituesve erdhën duke u shtuar, secili synonte të realizonte përfitime sa më të mëdha për vete. Për të sheshuar kontradiktat, diskutimet vazhduan pambarim, duke organizuar ballo çdo natë, prandaj Kongresi i Vjenës u quajt edhe «kongresi i ballove». Kur fitimtarët po grindeshin me njëri-tjetrin, Napoleoni, një mëngjes të bukur, i hipi varkës, doli në Tulon dhe marshoi drejt Parisit. Ushtria e Bourbonëve i doli përpara gjoja për ta ndaluar, por të gjithë ish-mareshalët e tij, që qëndronin në krye të ushtrisë franceze, në vend që ta kthenin prapa Napoleonin i dorëzuan shpatat dhe ai u fut drejt e në Paris.

Edhe mbledhja e Beogradit doli fyçkë. Ajo botoi një komunikatë, ku njoftohet se pjesëmarrësit në këtë takim do të mblidhen një herë tjetër në Lisbonë. Në mbledhjen e Beogradit shtetet pjesëmarrëse nuk arritën të merreshin vesh, se atje u imponoheshin Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndodhi pikërisht ajo që kishim parashikuar ne. Shumë miq të huaj na thanë: «Kishit të drejtë ju, shqiptarët: ç'menduat ju për Helsinkin doli, gjithashtu, edhe ç'thatë për Beogradin doli».

Politikën tonë të drejtë e të hapur e njohin të gjitha qeveritë e botës, megjithatë disave prej tyre

kjo politikë nuk u leverdis. Por, pavarësisht nga kjo, ato kanë kontradikta në mes tyre, e, në radhë të parë, me dy superfuqitë, se e shohin që këta ua kanë «me kuç në bark», siç themi ne gjirokastritët. Prandaj, në kohë të vështira, kur e shohin veten ngushtë, thonë: «Më mirë e kanë shqiptarët që s'marrin pjesë në këto mbledhje, ata po tregohen realistë, prandaj u del shpesh parashikimi».

Politika e drejtë dhe realiste e Partisë sonë na bën ne shumë të fortë dhe na jep mundësi të zbulojmë e të vlerësojmë me realizëm kontradiktat e dy fuqive kryesore imperialiste dhe të shteteve të tjera kapitaliste të botës. Ne jemi një vend i vogël, por të gjithë e dinë që ky vend i vogël qëndron fort si një shpellë e mbrojtur mirë. Për t'u futur në këtë «shpellë» duhet të bësh «vrima» të thella në «shkëmb». Kanë kohë armiqtë që po punojnë për të depërtuar në «shkëmbin» tonë të fortë, po nuk e çajnë dot. Përkundrazi, në luftë të ashpër me armiqtë uniteti ynë forcohet akoma më shumë. Ne përpiqemi dhe do të përpiqemi çdo ditë që ta bëjmë edhe më të fortë situatën brenda vendit, që armiku kurrë të mos jetë në gjendje të realizojë qëllimet e tij të rrezikshme.

Kur shoku Pavlo¹ tha në mbledhje që gjokset tona do të bëhen barrikadë kundër armikut, ai foli me zemër të çiltër e me ndjenja të pastra. Armiku do të ndeshet me barrikatat tona të çeliktat, sepse populli do të mbrojë me gjak jetën e lirë, atdheun e tij të lavdishëm socialist, vendin e tij sovran e të pavarur.

1. Pavlo Konomi.

Shqipëria tash ka hyrë në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Shndërrimet historike kanë krijuar kushte të reja për zhvillimin e revolucionit socialist. Socializmi është jeta e lumtur e njerëzve punonjës me pikëpamje të qarta politike e idcologjike.

Shoku Hysni Kapo, kur ka qenë në Vrisera e gjetkë në kooperativat tuaja, më ka thënë se ju keni bërë përparime të mëdha. Sukseset e arritura kanë sjellë një kënaqësi të jashtëzakonshme e një entuziazëm të madh në popull. Arritjet e perspektivat tona, përsosja e figurës morale të njeriut tonë të ri kanë bërë që të tjerët të na shohin me respekt e admirim. Ne luftojmë për Shqipërinë tonë socialiste, por njëkohësisht nuk harrojmë interesat e revolucionit, se e dimë që jemi një pjesë e armatës së madhe të revolucionit në botë.

Organizimi i kooperativave bujqësore të tipit të lartë te ne është bazuar në leninizmin. Kur e mori këtë vendim Partia jonë, ajo studioi me hollësi stadin e zhvillimit të ekonomisë sonë bujqësore socialiste dhe mësimet e Leninit e të Stalinit për ngritjen e pronës së grupit në nivelin e pronës së të gjithë popullit. Në trajtimin e çështjeve ekonomike të socializmit Stalini ka hedhur ide për disa forma organizimi që ai nuk i kishte precizuar në shkrimet e tij, por i kishte shprehur vetëm si etapa të zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Në këto kushte Komiteti ynë Qendror vrau mendjen dhe arriti në përfundimin që duhet të kalonim nga kooperativa e thjeshtë bujqësore në kooperativën e tipit të lartë. Ky avancim përpara do të arrihej me anën e pjesëmarrjes së shtetit në këto kooperativa,

nëpërmjet investimeve, fuqizimit të bazës materialo-
-teknike, përsosjes së drejtimit organizativo-ekonomik
etj. Kështu do të krijohet mundësia e rritjes me shpej-
tësi të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe e zhvilli-
mit më të vrullshëm të pemëtarisë etj.

Kur të jenë ngushtuar më tej dallimet esenciale
midis fshatit e qytetit, kur të jenë pjekur kushtet e
ngritjes së pronës së grupit në atë të të gjithë popullit,
atëherë edhe kooperativat e tipit të lartë do të shndër-
rohen në pronë të përbashkët. Ky shndërrim nuk për-
fshin vetëm anët ekonomike e organizative, por edhe
ato politike, ideologjike, morale etj. Prandaj Partia
nuk shpejtohet në këto punë. Kjo do të bëhet kur
socializmi të ketë fituar dhe të jetë konsoliduar në të
gjithë sektorët e jetës sonë.

Unë nuk jam specialist për çështjet e bujqësisë,
kurse ju jeni specialistë. Megjithatë, dëshiroj t'ju them
që të mos e neglizhoni diturinë e agronomëve, të vete-
rinerëve, të mësuesve etj. Unë e di që ju nuk e nën-
vleftësoni diturinë dhe i dëgjoni me kujdes për t'i
zbatuar mirë këshillat e specialistëve, por dua të vë në
dukje që edhe agronomët, veterinerët, mësuesit etj. t'ju
dëgjojnë me vëmendje e respekt ju dhe të mos mjaft-
tohen me atë dituri që kanë. Dituria është një fushë
shumë-shumë e gjerë. Sa rron njeriu, aq mëson, prandaj
shkolla dhe libri të gërshetohen me punën dhe me
eksperiencën. Ato gjëra që duhet të dijë njeriu, nuk
i mëson dot vetëm në shkollë, por edhe në jetë, duke
lexuar libra edhe pas shkollës, i mëson pra, tërë kohën,
në punë dhe në kolektiv. Partia na këshillon që, në
radhë të parë, të lexojmë e të studiojmë ata libra që i

shërbejnë punës. Agronomi, inxhinieri, mjeku, ekonomisti e mësuesi duhet të mos kënaqen me ato që kanë mësuar në shkollë, por të studiojnë vazhdimisht e të futen thellë në praktikën e gjërave. Kur kooperativisti punon arën apo hap hendekun një metër të thellë, specialisti shikon strukturën e tokës, të cilën e vëzhgon, e studion dhe, në bazë të eksperiencës e të kulturës që ka, arsyeton sa ujë e sa pleh duhet t'i hedhë, çfarë bimësh dhe sa thellë duhet t'i mbjellë etj. Gjithë puna është të ngremë masën e gjerë të kooperativistëve në atë nivel që kërkon zhvillimi i sotëm i bujqësisë. Me një e me dy lule s'vjen behari, prandaj duhet të bëjmë të zotë e të mësuar edhe kooperativistët më të thjeshtë.

Për vënien në jetë të detyrave të Kongresit të 7-të të Partisë kërkohet një organizim sa më i mirë i punës. Po ditëm të organizojmë punën, atëherë do të jemi në gjendje të zbatojmë trinomin: dituri, praktikë dhe organizim.

Brigadieri ka një detyrë jo të lehtë për të kryer. Mbi të rëndon përgjegjësia për mbarëvajtjen e punëve në brigadë. Por edhe sikur të çahet, ai vetë nuk mund ta bëjë si duhet punën, në rast se nuk ngre në këmbë gjithë skuadërkomandantët, gjithë anëtarët e brigadës dhe nuk punon që t'u futë këtyre në kokë diturinë e vet, në rast se nuk mjaftohet vetëm me dhënien e urdhrave, por gjen kohë t'u shpjegojë proceset e punës, shërbimet e bimëve si dhe arsyet përse duhet vepruar kështu. Brigadieri ka 70 veta që drejton; mund të ketë edhe 70 hektarë tokë. Prandaj, sado që të punojë ai, është e pamundur, qoftë edhe fizikisht, që të matë vetë

punën e të gjithëve, të shkruajë ç'i kërkohet, të interesohet për plehun, për këtë dhe për atë. Po pse u dashka të interesohet vetëm brigadieri për gjithçka? Ai më parë duhet të dijë të organizojë punën, t'i thotë skuadërkomandantes, fjala vjen: «Shiko ti, shoqe, ki pak kujdes për kontrollin e punës së skuadrës që ke, që kooperativistët ta hedhin shatin mirë, të mos prishin bimën kur ta rrallojnë dhe të mos e rrallojnë më tepër nga sa duhet». Ja, kjo është një punë që duhet ta bëjë komandanti i skuadrës, i cili nuk duhet të presë për çdo gjë vetëm urdhrat e brigadierit, por të veprojë edhe me iniciativën e vet. Kjo punë që bën brigadieri me skuadërkomandantët dhe këta të fundit me kooperativistët është edukim.

Të mos reduktohet edukimi i njerëzve në veprime formale. Të mos u lexojmë gazetën kooperativistëve sa për të shkuar radhën, por artikullin që shkruan, për shembull, shoku Spiro Lengo, ta bluajë mirë në kokë më parë kryetari i kooperativës, i cili pastaj të thërrasë gjithë brigadierët për t'u shpjeguar qëllimin, përmbajtjen dhe rëndësinë e tij. Nuk duhet t'i mbledhim njerëzit vetëm sa për t'ua lexuar artikullin, se këtë gjë ata e bëjnë më mirë vetë. Kryetari duhet t'i zërthejë në mënyrë të tillë direktivat e Partisë, saqë brigadierët t'i asimilojnë ato si ushqimin. Shpjegimi i një artikulli ose i një direktive në kooperativë duhet bërë fshatarçe. Pastaj të pyeten dëgjuesit nëse e kuptuan dhe të flitet më qartë e më gjerë për ato çështje që del se nuk janë kuptuar mirë. Në qoftë se artikulli ka diçka shkencore, që nuk e merr vesh mirë as kryetari,

atëherë të thërritet një specialist që e njih problemimin më me kompetencë. Kur kuptohen nga drejtuesit detyrat që dalin, të mblidhen pastaj skuadërkomandantët e me radhë deri kooperativistët, për t'ua shtruar ato.

Pas shtrimit të detyrës fillon kontrolli për zbatimin e saj. Drejtuesi i mirë duhet të gjejë kohë që ta përqendrojë kujdesin atje ku një brigadë ose skuadër nuk ecën mirë dhe të përcaktojë shkaqet përse nuk vete puna mirë, çfarë «sëmundje» është shfaqur: përtacia, indiferentizmi apo ndonjëri vuan nga ndonjë brengë shpirtërore e shkaktuar prej ndonjë fatkeqësie në familje. Kështu drejtuesi i ekonomisë së çdo shkalle, që ua di hallet kooperativistëve dhe i ndihmon nga afër, i këshillon etj., bëhet si vëlla i tyre. Kur vete brigadierit dhe mat e shënon punën e kooperativistit me drejtësi të madhe, kur ai ka bërë një punë edukuese të mirë dhe ka organizuar gjithçka në rregull, atëherë mund të themi se ai e ka kryer si duhet detyrën. Stalini thotë se direktiva vihet në jetë në qoftë se organizohet mirë puna për zbatimin e saj.

Duke përfunduar fjalën shpreh sigurinë se ju do t'i kryeni me sukses të gjitha detyrat patriotike, ekonomike, organizative që ju ka caktuar Partia. Ju premtoj se, kur të kthehem në Tiranë, shokëve të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror do t'u flas për të gjitha ato që pashë në Gjirokastër dhe në këtë kooperativë të tipit të lartë.

Ju them sinqerisht, se përshtypjet e mia për ju janë shumë të mira. Prej kohësh kam pasur një dashuri shumë të madhe për minoritarët, por ato që pashë

e jetova sot, kur asnjëri nuk lëvizi nga vendi, me gjithë shiun e pareshtur, nuk do t'i harroj kurrë.

Punë të mbarë e suksese!

Mirupafshim, të dashur shokë e shoqe!

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Dy popuj
miq», f. 271*

*Botohet i plotë sipas shënime-
ve të mbajtura në këtë takim,
që gjenden në AQP*

KËTU NË GUR ESIHTË SIKRUAR LUFTA E MADHE E SHQIPTARËVE PËR ÇLIRIM DHE PËR ARSIM

*Nga biseda gjatë vizitës në qendrën muzeale
dhe në obelisk në qytetin e Gjirokastrës*

23 mars 1978

Në qendrën e re muzeale, për të pritur shokun Enver Hoxha kishin ardhur edhe mësuesit e vjetër Sokrat Kutra, Muharrem Gega, Fotaq Kekezi e të tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po si jeni, more shokë, po si ju kam more vëllezër, a jeni mirë? Hajde uluni një çikë, se u lodhët, se erdhët deri këtu lart, në këtë kodër kaq të bukur.

Jam shumë i gëzuar që erdha deri këtu e të takohem me ju, në këtë vend ku mësonim kur ishim të rinj.

Çdo gjë rreth e rrotull këtij vendi është e njohur për mua. Ja, atje poshtë ishte koçeku. Të gjitha këto, Muharrem, ishin baraka të vjetra atëherë; pusi ishte andej, një aneks pak më tutje; kurse andej, nga ana tjetër, ishte salla me kolona në mes e mbushur plot me banka. Si tani e mbaj mend që nganjëherë, kur nuk isha i përgatitur mirë në mësim, për të mos i rënë në

sy mësuesit, shkoja ulesha në bankën e fundit të sallës. Këtë punë e bënin dhe të tjerë. Megjithatë, s'i shpëtonim dot syrit të mësuesit, i cili na thoshte: «Pa ngreu një çikë ti atje!». Dhe ne ngriheshim, por meqë nuk e dinim mësimin, flitnim me zë të ulët. «Folmë mua, mos i fol vetes!», na thoshte ai. Ne qeshnim.

Tani t'ia japim fjalën shokut Lefter¹, sepse është një nga punëtorët e palodhur për plotësimin e pasurimin e muzeve të Gjirokastres...

Edhe ti Pano² boton në «Pararoja» disa shkrime antifetare. I kam lexuar dhe më kanë pëlqyer. Ngjarjet i lidh edhe me fshatrat, disa nga të cilat unë i kam njohur dhe kam vënë re se çdo gjë në shkrimet e tua e ke paraqitur realisht. Më janë kujtuar disa sheshe, disa kafene aty rreth e rrotull fshatit, prifti me mjekër të zezë e të tjerë, tamam ashtu siç i përshkruan ti, prandaj them se ato janë shkrime të bukura.

SHOKU LEFTER DILO: Ja pushka dhe abetarja, si dy binjake, gjithmonë të pandara në duart e popullit shqiptar. Konkretisht kjo këtu është alfabetarja e Naum Veqilharxhit që u përhap në Gjirokastër, në Përmet dhe në të gjitha skajet e tjera të vendit tonë.

Këtu janë paraqitur disa dokumente të vitit 1778. Ky është alfabeti i Kosovës. Më tutje është një shkrim i Nikolla Qafës, që i përgjigjet flakë për flakë Kongresit të Berlinit për padrejtësinë që na bënë neve, shqiptarëve, Fuqitë e Mëdha në atë kongres. Shkrimi është me shkronja greqisht e fjalë shqip, me shkronja ara-

1. Lefter Dilo.

2. Pano Çuka.

bisht e fjalë turgisht të mulla Fejzo Avdallit nga Gjirakastra.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush është ky? Më duket si mulla Hodoja.

SHOKU LEFTER DILO: Jo, ky është mulla Fejzo Avdalli.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , po. Por ju, Lefter, duhet të punoni një çikë edhe me shkrimet e mulla Hodos, ato janë shumë satirike.

SHOKU LEFTER DILO: Këtë punë e kemi filluar, shoku Enver, dhe janë mbledhur disa nga vargjet e tij.

Ky është një objekt që e ka pasur Thanas Vaja në vitin 1784, ku është shkruar dhe emri i të birit të tij, që ka bërë edhe fjalorin shqip.

SHOKU ENVER HOXHA: E ka gdhendur shumë bukur!

SHOKU LEFTER DILO: Kjo është shkolla shqipe që ndodhet prapa këtij muri. Ja, Iliaz Hoxha, Papapanoja dhe mësues të tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa më afroni një çikë dritën këtu, se dua që t'i shikoj mirë këta patriotë. Ja, tamam, ky është xha Iliazi, ky më ka vënë emrin në vesh. *(Të qeshura.)*

Më kujtohet një ngjarje nga të vegjëlisë. Një ditë më mori baba Çeni nga dora dhe më tha: «Hajde këtu, djalo, se do të shkojmë te xha Iliazi». Atëherë ne rrinim te shtëpia që është te Sokaku i të Marrëve. Unë u gëzova shumë. Ishte dita e 28 Nëntorit, Dita e Flamurit. Më duket se ishte koha e okupacionit grek. Si arritëm, u futëm brenda në shtëpinë e xha Iliazit. Unë isha i vogël dhe, natyrisht, kur hymë e ndjeva se m'u skuq

fytyra, m'u bë flakë e kuqe. «Rri atje!» më tha plaku, dhe unë u ula ku më porositi ai. Hodha sytë rreth e rrotull dhe pashë se të gjithë burrat kishin zënë vend ulur. Në krye të odasë pashë një prift me mjekër të bardhë, veshur me raso të zezë dhe në gjoks mbante të varur një kryq. Unë rrija ulur, ashtu i druajtur, si gjithë kalamanët. Xha Iliazi tha disa fjalë. Pastaj plaka, gruaja e Iliazit, na solli nga një llokume të gjithëve. Pas pak xha Iliazi hapi dollapin e odasë, nxori andej një flamur dhe më tha: «Ti, djalë, merre këtë flamur, zëre nga të dy cepat, ngrije lart dhe, duke filluar nga prifti, jepua të gjithëve ta puthin». Dhe unë shkova me radhë te të gjithë. E puthi prifti, e puthi baba Çeni, xha Iliazi dhe disa pleq të tjerë që ishin atje. E putha edhe unë. «Tashti mbështille mirë, djalë, dhe vure atje lart, në oxhak». Pasi e vura, të gjithë thanë: «Rroftë Shqipëria!» etj. Pastaj dolëm. Kur ikëm, i thashë baba Çenit: «O baba Çen, po çfarë do ai prifti këtu?». «Po si, more, nuk e njeh priftin ti? Ai është babai i mësuesit tënd të shquar, Thomait».

E mbaj mend kur ishim këtu në Hazmurat, Papapanon, priftin që ngjitej e zbriste këtej, dhe sa herë që e takoja i puthja dorën.

SHOKU LEFTER DILO: Ky është orari origjinal i mësimeve për të gjitha ditët e javës. Ia kemi marrë basho Thomait. Këto janë fletëlavdërimi për shkollën shqipe, shkruar me dorë nga mësues Thomai.

SHOKU ENVER HOXHA: Si tani e kam parasysh shkrimin e Papapanos. Jo vetëm që shkruante mirë shqip, por dhe kaligrafinë e kishte të bukur.

SHOKU LEFTER DILO: Kjo është një gravurë për burgun e Stambollit, ku Sevasti Qiriazi shkon e veshur si djalë dhe përshëndet Koto Hoxhin, i cili i thotë: «Je djalë, apo je vajzë? Mua më dukesh tamam si djalë». «Jo, unë jam vajzë, por e veshur si djalë», i thotë ajo. «Atëherë, i thotë Kotoja, për mua nuk ekzistojnë më hekurat e burgut, kur këtu erdhi e më gjeti mua-kufo-më një vajzë shqiptare».

SHOKU ENVER HOXHA: Koto Hoxhi ishte patriot i madh. Më kujtohet si tani mulla Kamani. S'donte të na e linte xhaminë për të mësuar. «Si s'ua jep djemve të mësojnë? — i tha baba Çeni. — Po s'ua dhe, do ta pres ilefenë» (rrogën). Pastaj, bëri ç'bëri e na e dha.

SHOKU LEFTER DILO: Ky është një portret i Skënderbeut, i panjohur deri më sot.

SHOKU ENVER HOXHA: Përherë sytë e Skënderbeut janë si të shqiponjës.

SHOKU LEFTER DILO: Këto janë dy materiale për shkollën e Labovës, të shkruara nga Vangjel Karajani, vëllai i Minella Karajanit.

SHOKU ENVER HOXHA: Lele i thërritnin atij.

SHOKU LEFTER DILO: Po, Lele. Ai shkruan se ç'bënin kur u mësonin greqishten dhe «sa u gëzuam, shkruan ai, kur na erdhi ai mësuesi¹ me vetulla të zeza, me sy të zinj».

SHOKU ENVER HOXHA: Ishte njeri i mirë doktor Karajani. Unë kisha shok të birin e tij, Kiço Karajanin. Ata kishin dhe një nënë shumë të mirë, teto Niqin. Ishte një grua e shëndoshë dhe e dashur me të gjithë.

1. Është fjala për Thoma Papapanon.

Sa herë që shkonim tek ajo, nuk na linte pa na dhënë një kokërr vezë të kuqe, kur ishte ditë pashke, sepse kështu bënin atëherë. Në qoftë se e mbani mend, ja, këtu afër e kishte zyrën Karajani.

Kur u vra Avni Rustemi, në qoftë se ju kujtohet, ty Muharrem dhe juve të tjerëve, te «kafeneja e huqumetit», erdhën automobilat për të marrë burrat që të shkonin në Vlorë. Atje plasi revolucioni. I thashë Kiços: «Hajde, vemi edhe ne me të tjerët?».

«Mirë, po të pyesim një herë doktorin (babanë)», më tha ai. Dhe kështu bëmë. Shkuam te doktori. Sapo i treguam, ai na tha: «Si ore, do të vini ju? Ju jeni të vegjël. Ka kush vete atje të luftojë!». Kiçoja iu përgjigj: «Ne do të vemi në Vlorë!» dhe, në çast, që të dy ia mbathëm me të katra. Por plaku na ndoqi nga prapa, na mbërtheu nga palltot e nuk na lëshoi. Automobili ndërkohë u nis, prandaj nuk ia hipëm dot me gjithë dëshirën tonë të madhe. *(Të qeshura)*

Do t'ju tregoj edhe diçka tjetër.

Njëfarë Xhevat Kallajxhiu, një tradhtar, eksponent i Ballit, që u arratis në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shkroi njëherë një tregim. Ne, studentët, mblidheshim te klubi ynë «Studenti», ku erdhi edhe Xhevati. Dhe ç'bëri? Na e dha tregimin ta lexonim. Ç'është e vërteta, ne s'e donim atë. Aqif Selfos nuk iu durua e i tha: «More Xhevat, je munduar shumë që e shkrove këtë?». «Po, edhe jam munduar ca», iu përgjigj ai. Xhevati nuk e kuptoi hiç ironinë e hollë të Aqifit, ai pretendonte se kishte bërë një vepër të madhe. Por kjo «vepër», gjithë-gjithë kishte shtatë fletë. Pastaj kërcen dhe ia pret shkurt Selami Xhaxhiu: «Atë

heroin tënd më mirë ta kishe mbytur tek Ura e Lumit».

SHOKU LEFTER DILO: Kjo është shkolla e Labovës. Ky është lapidari i ngritur në kujtim të kësaj shkolle. Kurse këta janë armiqtë e shkollës: hoxhë çallmëmëdhenjtë, si thotë Gramenoja, priftërinjtë mjekërgjatë, dervishët e mefshtë, bejlerët e çmendur, agallarët mendjepaktë, pashallarët e fëlliqur. Këto janë epitetet që ka gjetur ai për armiqtë.

SHOKU ENVER HOXHA: More ç'ua ka gjetur, sipas kokës u kishte vënë dhe festen të gjithë armiqve!

SHOKU LEFTER DILO: Ky është telegrami dërguar valiut të Janinës kur u burgos Andrea Konomi. Në këtë kohë Idriz Guri shkruan në një gazetë të mërgimit: «Dashtë zoti na dërgoftë një shqiptar prefekt, se dhe këta halldupë na morën shpirtin. Duam të kemi një tonin, i cili pak a shumë, do të na mbrojë».

SHOKU ENVER HOXHA: Për Idrizin kam folur edhe herë tjetër, prandaj tash nuk do të zgjatem.

Ja, pikërisht këtu, në këtë vend, para ish-prefekturës së vjetër, atje ku sot është kinemaja, para gjithë popullit, në Ditën e Flamurit, ne dëgjuam zërin e fortë të Idrizit: «Poshtë kusarët!». Prefekti që ishte këtu, po ashtu edhe oficerët e xhandarmërisë u futën menjëherë brenda në prefekturë. Pas pak erdhën xhandarët ta çarmatosnin dhe ta arrestonin Idriz Gurin, por më kot se ai s'ishte nga ata burra që ta dorëzonte kollaj shpatën e as nga ata që binte lehtë në duart e tyre.

SHOKU LEFTER DILO: Ky është Sulo Dalipi çoban, autodidakt, mësues, kurse këta këtu janë mësues të ndjekur, si Urani Rumbo, Papapanoja e të tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk e harroj kurrë di-

tën kur për herë të parë takova mësuesin e shquar të gjuhës shqipe, Thoma Papapanon.

Ja, në këtë vend, në këtë dhomë e takova mësuesin tim të dashur. Në zemër ndieja gëzim të përzier me frikën e parë. Por fjalët e ëmbla të mësuesit tim dhe copa e kulaçit të misërt me pak djathë e një qepë që aneja ma kishte futur në qesenë e librave, kur më përcolli për në shkollë, sikur ma ngrohnin zemrën, ma hiqnin ndrydhjen. Për basho Thomanë ruaj kurdoherë shumë kujtime dhe një nderim të veçantë. Ai dhe mësuesit e tjerë na mësuan me pasion gjuhën amtare, historinë dhe gjeografinë e vendit tonë të dashur. Më kujtohen edhe vargjet kushtuar mësuesit Thoma Papapano:

*«Thoma Papapano mendjehollë
Nga shqipja s'hoqi dorë,
Thomai vetullkurore
Mori shkabën në dorë
Hipi, vate në Vlorë...»*

SHOKU LEFTER DILO: Kjo është stera historike, ku, me urdhër të mësuesve, më 19 maj të vitit 1909 u hodhën abetaret, katërshoret dhe shaptilografi nga fëmijët për t'i shpëtuar, sepse atë ditë në shkollë erdhi prefekti.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto që m'i thua, a i ke shkruar ti, Leter? Unë e di që ti shkruan, por them, kështu siç m'i thua mua, i ke të shkruara të tëra?

SHOKU LEFTER DILO: Po, po, shoku Enver, i kam shkruar. Kam një «enciklopedi» me 2 500 faqe.

Ja dhe një përshkrim i shfaqjes teatraleë në vitin 1909.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po kopje të këtyre materialeve keni?

SHOKU LEFTER DILO: Po, po, kemi kopje.

Kjo është një dëftesë interesante shkruar me dorë nga Sami Dalipi.

SHOKU ENVER HOXHA: Sami Dalipi ka qenë patriot dhe komandant i zjarrfikësve. «Bam» ia bënte pushka për ndonjë zjarr që binte dhe Samiu do të gjendej kurdoherë i pari për ta shuar.

Tani, o Muharrem, të ulemi një çikë këtu në këtë bankë, si dikur në klasë. Hajde këtu ti, Sokrat Kutra. Ti je më i moshuar nga ne. Pa na jep pak mësim! Jemi shumë të lumtur që ulemi këtu, Sokrat. Na ka marrë malli shumë për klasën ku kemi mësuar dhe bankat ku jemi ulur, kur ishim fëmijë. Çdo gjë të ngjall kujtime të bukura.

SHOKU MUHARREM GEGA: Pardje ti the se je bërë 10 vjet më i ri, nga 70 zbritë në 60 vjeç, kurse ne sot kemi zbritur nga një çerek shekulli, jemi rinuar fare.

SHOKU SOKRAT KUTRA: Atëherë le të bëjmë një orë mësim. Të kam dëgjuar shumë herë në fjalimet e tua dhe kam vënë re se ato janë shumë të mira nga përmbajtja, por bën edhe ndonjë gabim gjuhësor. Për shembull, përemrat pronorë nuk i përdorë kaq mirë. (Të qeshura.)

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, edhe përemrat e tjerë nuk i përdorë mirë. Ja, përemrin «ne» e bëj «neve», «neve» e bëj «ne».

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Edhe në vend të

përemrit pronor «ynë» përdor «jonë». Nuk thua populli ynë, por populli jonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ngaherë më korrigjon Nexhmija dhe më thotë: «Ndreqe një çikë këtë gabim!». Por kjo është *lapsus lingua*, megjithëse, gjithmonë ashtu gabim e them «jonë» në vend të «ynë». Po ashtu, si gjirokastrit, sado që mundohem në vend të «y-së», përdor «i-në». Unë nuk them dot «sy», por «si», ose jo «qymyr», po «qumur». Po të jap fjalën, zoti mësues, që këtej e tutje do të bëj përpjekje t'i mësoj më mirë, që të mos bëj gabime me gojë, se me shkrim nuk gabo.

SHOKU SOKRAT KUTRA: Të paktën sa të marrësh notën kaluese. (*Të qeshura.*)

SHOKU LEFTER DILO: Ja, këtu i kemi notat tuaja, shoku Enver. Këto janë notat që keni marrë në mësim gjatë një viti shkollor që keni bërë këtu. Të gjitha notat kanë qenë të shkëlqyera, vetëm këtu në lëndën e vizatimit ka një dysh.

SHOKU ENVER HOXHA: E po, edhe pa «dysha» nuk bëhet!

SHOKU LEFTER DILO: Ja dhe Fushëbardha në vitin 1923 që nuk pushon së kërkuari një shkollë, një mësues.

Kjo është letra juaj që i keni dërguar Papapanos.

SHOKU ENVER HOXHA: Si është plaka e Papapanos?

SHOKU SOKRAT KUTRA: Mirë është!

SHOKU ENVER HOXHA: Të fala shumë i bëni, i puthni dorën!

SHOKU LEFTER DILO: Ky është telegrami i krye-

tarit të klubit të shoqërisë «Drita», Hysen Hoxhës, dërguar nga Vlora në Gjirokastrë: «Për njohjen e independencës ka sigurime të forta. Të shpallni sa më shpejt e pa humbur minutën, independencën... dhe të ngrini Flamurin kombëtar». Dhe në fund pyet: «Enveri është shëndoshë?».

. *SHOKU ENVER HOXHA*: Me sa duket baba Çeni kishte merak për mua, se më kishte si djalë; ai i kishte të tërë fëmijët çupa.

Gjëra të bukura keni mbledhur, gjëra me vlerë.

SHOKU LEFTER DILO: Kjo është shtylla historike rreth së cilës janë hedhur valle. Më 14 prill 1908 ishte fitorja e madhe, se u njojt shkolla me dekret perandorak. Ja xha Hyseni, Çeçoja, Papapanoja.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja dhe xha Idrizi. (*Shoku Enver Hoxha vete e i puth të tërë këta.*)

Më kujtohet edhe një ngjarje me xha Idrizin. Një ditë baba Çeni më mori nga dora dhe më çoi te shtëpia e xha Idrizit. Atje na priti vetë ai. Ndenjëm në odanë e madhe. Unë rrija në fund të odasë, në bisht. Burrat filluan bisedimin andej-këtej, për këtë e për atë, dhe mua më harruan fare. Isha apo s'isha aty, ata as që u kujtuan. Më dhanë një llokume dhe përsëri vazhdonin të bisedonin. Filluan të flitnin pastaj me zë të lartë, të shaheshin e të grindeshin. Pas pak pashë se baba Çeni hoqi sarëkun dhe e hodhi atje tej, poshtë. Unë, i frikësuar dhe i habitur, e mora dhe ia çova. Atëherë baba Çeni, më tha: «Ik, ti, Enver, jashtë, se kemi punët tona ne». Mua m'u duk sikur do të ziheshin keq me njëri-tjetrin. Por, jo, ata nuk ziheshin kurrë, duheshin si vëllezër e shkuar vëllezërve, por shanin dhe

shfrynin kundër bejlerëve dhe agallarëve të Gjirokastrës, Karagjozatëve e të tjerëve, që po i pengonin në punën e tyre. Kjo ishte arsyeja që shkëmbyen disa fjalë me njëri-tjetrin dhe menduan që të shkonin e t'i rrihnin ata.

SHOKU LEFTER DILO: Ja edhe diçka interesante, shoku Enver, nga një fotograf i quajtur Marub:

*«Të tanë djelmnia në luftë po nget
Gjergj Kastrioti sot në Lezhë po i pret».*

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një fotografi e fotografit shkodran Marubi. Ai ka bërë një punë jash-tëzakonisht të madhe dhe me rëndësi të pavdekshme. Marubi i ka ruajtur me kujdes të madh të gjitha fotografitë që ka bërë gjatë gjithë jetës së tij, negativat e pozitivat e filmave. Ato janë të klasifikuara dhe përbëjnë një pasuri të vyer. Në Shkodër edhe sot ruhet me kujdes nga shteti fototeka e tij.

SHOKU LEFTER DILO: Tani, të gjitha këto, shoku Enver, përjetësohen në obelisk dhe në qendrën e re muzeale si një xhevahir në kraharorin e Gjirokastrës.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku janë shokët skulptorë që e kanë punuar këtë vepër?

Skulptorët Mumtaz Dhrami dhe Stefan Papamihali paraqiten dhe takohen me shokun Enver Hoxha.

Shumë të bukur e keni bërë! Mua dhe të gjithë shokëve na ka pëlqyer ky monument, shokë skulptorë. Këtu në këtë gur është shkruar historia e popullit patriot të qytetit dhe të të gjitha krahinave rreth e rro-

tull Gjirokastrës, lufta e madhe e shqiptarëve për çlirim dhe për mësim. Ky monument përfaqëson trimërinë, sakrificat e mençurinë e tyre. Këto ju i bëtë të pavdekshme në gur dhe në këto muze. Prandaj populli dhe Partia do t'jua dinë për të mirë dhe do t'ju jenë mirënjohës për këtë vepër. Të gjithë brezat e ardhshëm të vendit tonë, njëri pas tjetrit, do t'i vizitojnë këto vende të thjeshta, por të shenjta dhe do të frymëzohen për të kryer vepra akoma më të mëdha, për ta bërë Shqipërinë të fortë, të çeliktë, siç e kanë dashur ata, siç e kanë dashur shokët që ranë në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare e siç e ka dashur i tërë populli që u ngrit në këmbë për lirinë, për përparimin, për shkencën, për socializmin, për ecjen përpara drejt shoqërisë pa klasa.

Jam jashtëzakonisht i lumtur dhe i gëzuar që piqem sot me ju, me shokët e miqtë e mi të vjetër të vegjëlisë, të bankave të shkollës, me ju, shokë të Luftës Nacionalçlirimtare e të punës për ndërtimin e socializmit. U gëzova shumë që u poqa edhe me ju, dy nga autorët e këtij guri monumental, se më thatë që autori tjetër, Ksenofon Kostaqi, nuk ndodhet këtu. Edhe një herë ju shtrëngoj dorën në emër të Partisë për këtë vepër. Përpiquni që të bëni gjithnjë vepra të mira.

SHOKU MUMTAZ DHRAMI: Faleminderit. Ne do të bëjmë vepra akoma më të mira për lavdinë e popullit e të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të bëni vepra të mira e më të bukura për popullin dhe për Partinë që të pasqyrojnë vijën e drejtë të saj, trimërinë, guximin dhe mençurinë e popullit tonë. Vetëm për popullin dhe për

Partinë të ngrini monumente. Ku është edhe shoku tjetër?

SHOKU STEFAN PAPAMIHALI: Ne i jemi borxhli Partisë, shoku Enver, ajo na bëri që të arrijmë gjithë këto suksese.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani të bëjmë një fotografi përpara obeliskut. Një ta bëjmë vetëm me dy shokët skulptorë, pastaj me gjithë të tjerët.

Edhe ambienti përreth obeliskut është bërë i bukur. Si thua ti, Sokrat, i mrekullueshëm është bërë!

SHOKU SOKRAT KUTRA: Shumë bukur, por obelisku i jep një madhështi të veçantë kësaj kodre.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të vemi të dalim në fotografi atje, te shega.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, do të vemi edhe te shega që të bëjmë një fotografi me Nexhmijen.

Kush pandehte se do të të gjeja ty, Nexhmije, për bashkëshorte, ti nga Dibra, unë nga Gjirokastra, por u bë lufta që u njohëm bashkë dhe u martuam. *(Të qeshura.)*

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Do të bëjmë edhe një fotografi te obelisku, sepse edhe unë mësuese kam qenë.

SHOKU ENVER HOXHA: *(U drejtohet skulptorëve)* Ju, përreth obeliskut mund të bëni njëfarë amfiteatri, ndonjë vend të rrumbullakët, veçse jo vetëm për rininë, por edhe për ne të tjerët, pak të kaluar nga moshë, që të vemi e të rrimë në atë vend. Por ta bëni të bukur, ashtu si amfiteatrin e tempullit të Delfit. Atje është ndërtuar një nga amfiteatrot më të bukura. Më

parë shquhej amfiteatri i tempullit të Dodonës, por pas-taj këtij ia kaloi ai i Delfit.

Hajdeni nga kjo ana tjetër që të shikojmë se si duket Gjirokastra! Ne të gjithë gjirokastritë jemi këtu, prandaj të themi atë që mendojmë për Gjirokastrën, nuk ka kush na dëgjon. Shikoni sa bukur! Një pamje të tillë rrallë e gjen gjetkë.

Dhe këto kangjellat këtu, tamam si libër janë.

Ajo atje ishte një shtëpi që u dogj.

Sa mirë që është këtu në këtë vend të bukur! Nuk më iket që këtej. Sikur të mos frynte erë, kisha dëshirë të rrija ndonjë gjysmë dite. S'ngopem duke e parë këtë vend nga ku qyteti i Gjirokastrës duket shumë bukur.

Ja edhe Klubi i Opingarëve. Shenjën e opingës e mbanin si kokardë në xhaketat e tyre përfaqësuesit e vegjëlisë gjirokastrite.

Si je, o Cule, je mirë? Si mbahesh?

SHOKU RESUL HOXHA: Çka, jo dhe aq mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mbahu, bëj nga një çikë kujdes. Po nga një gotë raki pi?

SHOKU RESUL HOXHA: Doktorit thotë të pi nga një gotë.

SHOKU ENVER HOXHA: Dëgjomë mua këtu, raki nuk duhet të pish. Qenka liberal ai doktorit që të thotë kështu. Edhe Muçoja e pi nga një gotë në darkë, por ai më tha se pi raki dëllinje, jo rrushi.

Resul, kujdesu për shëndetin. Ti ke qenë njeri i varfër, i ndershëm. Tërë jetën me mushka ke punuar. Tani je i fortë akoma, prandaj përpiqu të rrosh edhe 20 vjet. Djalit e vogël mora vesh se e ke këtu, kurse tjetri t'u bë fare parizian.

More Cule, ç'qe ajo që më tha Fetahu! «Sa vjeç je», i thashë. «Jam 70 vjeç», më tha.

SHOKU RESUL HOXHA: I zbret ca vjet ai, i zbret. (Të qeshura.) Fetahu është 73 vjeç, kurse unë jam 71.

SHOKU ENVER HOXHA: 71 vjeç je ti?! Jo more, por kur ishim ne të vegjël, ti na ngordhje në dru. S'të kujtohet? (Të qeshura.)

SHOKU RESUL HOXHA: Ashtu ishte koha atëherë, kurse tashti ti më mund mua.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj, që thua ti, ore miku im, ti i ke nja 74 vjeç të mira.

SHOKU RESUL HOXHA: Unë jam 71 vjeç, Enver, kurse 73 është «mareshali». (Të qeshura.)

SHOKU ENVER HOXHA: «Mareshali» është nja 76 vjeç. Por dëgjomë mua. Edhe një herë po të them, nuk duhet të pish raki, se të pushon zemra.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ja ku qenka doktor Fejziu, ta pyesim: Bën të pijë xha Resuli raki, apo jo?

SHOKU FEJZI HOXHA: Shumë keq që pi raki, xha Resul. Më ka folur Dashoja për ju që keni qenë i sëmurë nga zemra, prandaj ju bëjnë shumë keq edhe rakia, edhe duhani.

SHOKU ENVER HOXHA: O Resul, po ta merrte mendja ty që unë që e kam pirë 55 vjet me radhë duhanin, dhe jo pak, por nga dy paketa në ditë, ta lija? Po ja, e lashë. Kam nja pesë vjet që e kam lënë dhe tash as që më shkon në mendje fare të pi. Dhe shiko sa mirë që jam me shëndet! Prandaj edhe ti duhet të lësh rakinë e duhanin.

SHOKU RESUL HOXHA: Edhe unë kam tre-katër

muaj që e kam lënë duhanin dhe do të bëj çmos që të mos e pi më.

SHOKU ENVER HOXHA: Po të lësh edhe rakinë ama. Kur unë pija duhan, më këshillonin ta lija, kurse unë ua ktheja: «Jo more, nuk e lë, sepse duhani bën që të të vijnë mendimet, të heq mërzinë» etj., etj. Por, kur e lashë, e kuptova se të gjitha këto llafe ishin hiçgjë. Prandaj të them edhe ty, mos pi më as duhan, as raki.

SHOKU LEFTER DILO: Vjet, në një mëngjes korriku, tri-katër gra vinin rrotull këtij vendi. Keni ndonjë gjë për të thënë, u thashë unë, pasi u kisha bërë shpjegimin. «Ç'të themi, thanë, po ja, duam ta shikojmë edhe një herë. Po ç'ishin këta gurë?», më thanë ato. «Gurë të prurë nga shpella e Golemit», u thashë unë.

«Po kjo Partia edhe gurëve u dha lezet, u dha shpirt», thanë ato dhe u larguan.

SHOKU RESUL ZANI: Gurin për obeliskun, siç ju tha shoku Muntaz, e kemi marrë në Golem.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë i bukur është! Ju lumtë dora këtyre djemve që e punuan!

SHOKU RESUL HOXHA: Tani, Enver, të na vish vit për vit, jo në 9 vjet një herë, të vish që të të shikojë populli se të do.

SHOKU ENVER HOXHA: Shiko, se vërtet 9 vjet kisha pa ardhur, por ama dhe unë jua punova kësaj radhe, 9 ditë ndenja këtë herë, për 9 vjet. S'keni ç'thoni për këtë. (Të qeshura.) Po të vij çdo vit dhe të rri nga një ditë, sikur nuk ka lezet.

Lefter, në qoftë se nuk gabohem, këtu ka qenë

bashkia e vjetër dhe atje ishte zyra e doktor Karajanit. Atëherë, kur Greqia pushtoi Korçën, shumë familje patriotë të Korçës erdhën këtej nga Gjirokastra dhe të gjithë të ardhurit i ndanë nëpër familje. Edhe mua më tha baba Çeni, se ai vetë ishte i sëmurë: «Shko merr hisenë tonë». E mbaj mend si tani atë natë, kur, bashkë me plot të tjerë, erdhëm këtu për të marrë në shtëpitë tona të ardhurit. Binte një shi i madh dhe ata të shkretët rrinin si mos më keq. Unë u thashë: «Mua më ka dërguar Hysen Hoxha, dua hisenë time». Kështu, mora dy-tri veta dhe i çova në shtëpi, te aneja. Hëngrën dhe u shtruan për të fjetur. Më vonë ata të gjithë ikën nga Gjirokastra dhe shkuan andej, nga Vlora.

SHOKU LEFTER DILO: Në këtë vend, shoku Enver, mendojmë të bëjmë muzeun e gruas.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë do të bëni, shumë mirë. Urani Rumboja duhet të ketë një vend kryesor në muze. Ajo ka qenë një grua e zgjuar, e zonja, heroike, e pamposhtur, e palodhur. Sido që ishte edhe pak e çalë nga këmba, por nuk donte t'ia dinte hiç nga kjo. Urania ka bërë shumë për zgjimin e gruas gjirokastrite, megjithëse në përgjithësi Gjirokastra nuk ka qenë shumë fanatike.

Njëherë i thashë anesë sime: «Ke shkuar, moj ane, ndonjëherë andej nga pazari?». «E ku të lë ki», më thoshte ajo. «Ki», e kishte fjalën për babanë. Emrin babait nuk ia zinte kurrë në gojë. «Po thuaje një herë emrin», i thosha unë, por jo, «ki» vazhdonte të thoshte ajo. Vetëm kur u plak i foli me emër babait, Halil.

Edhe xha Faroja ka qenë plak i mirë. Ishte nga ata burra që mbanin leshra të gjata. Po të rronte e t'i kishte sot leshrat ashtu, do t'ua vinim gërshërën leshrave të tij. Kur isha i vogël, sa herë që më rrihte ky miku (është fjala për xha Resulin), unë shkoja me vrap te xha Faroja dhe te Dedeja duke qarë, dhe xha Faroja u bërtiste këtyre.

SHOKU LEFTER DILO: Këtu, shoku Enver, bëhet fjalë për shoqërinë «Drita» dhe «Vëllazëria».

SHOKU ENVER HOXHA: Sa bukur i keni vënë këto këtu! I keni sistemuar shumë mirë.

SHOKU LEFTER DILO: Ky është «grushti» i shoqërive të Gjirokastrës kundër Kongresit të Berlinit, e përjetësuar nga Idriz Guri.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Janë të lezetshme këto.

SHOKU LEFTER DILO: Ky është shkopi origjinal. Të gjitha këto kanë vlerë të madhe, sidomos për rininë.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet të vazhdoni të kërkoni të tjera.

Mirë, mirë, i keni bërë të gjitha këto, shumë mirë! Ju lumtë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
kësaj vizite, që gjenden
në AQP*

TË JESH MËSUES ESHITË NJË DETYRË E SHENJTË

*Nga bisedat gjatë vizitës në shkollën
e mesme «Asim Zeneli»*

23 mars 1978

Pasi u takua me drejtuesit e shkollës, me nxënës e mësues, duke hyrë në korridor, shoku Enver Hoxha tha:

Këtu, Nexhmije, në këtë korridor të madh të shkollës, bënim teatër. Ja, atje në fund ngrinim skenën dhe të gjitha përgatitjet i bënim vetë me trarë, me dërrasa. Edhe skamitë vetë i rregullonim. Pasi fshinim dhe lanim tërë ambientin, gjithçka e vinim në vendin e vet. Para se të jepnim shfaqjen na duhej edhe një qilim. Po ku ta gjenim? Kishim një shok, Elmaz Konjarin, djalin e Fiqri Konjarit, i cili kishte mundësi të na e jepte. Atëherë vajtëm te ai dhe ia kërkuam qilimin. «Do t'jua jap, vetëm me një kusht, na porositi ai (dhe m'u drejtua mua) që ti, Elmazi dhe Aqif Zelfoja të flini atje, se kam frikë mos më digjet». «Mirë», i premtuam ne dhe u nisëm për në shkollë. Derisa u rregulluan të gjitha ato që duheshin për shfaqjet tona ne flinim këtu, në korridor, se kishim frikën e qilimit. Ç'të bënim, këtë porosi kishim. (Të qeshura.)

Në klasën-muze shoku Enver Hoxha u takua me nxënësit e nxënëset që gjeti aty.

Mirë se ju gjeta nxënëse e nxënës të dashur! Si jeni, jeni mirë? *Duke iu drejtuar një nxënëseje: E kujt je ti?*

NXËNËSJA TEUTA ZAZANI: Jam e Hasan Zazanit.

SHOKU ENVER HOXHA: A... , je mbesa e Farijes së Mezinut. Kam qenë në shtëpinë tuaj në Cfake, kur rronte gjyshi yt. Si është me shëndet Farija? Është mirë?

NXËNËSJA TEUTA ZAZANI: Mirë është, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Të fala shumë i bëj nga ana ime.

Pastaj shoku Enver pyet edhe nxënës të tjerë nga ishin dhe si shkonin me mësim.

SHOKU SOTIR VARDHAMI¹: Ju, shoku Enver, uluni në tavolinën e mësuesit, kurse shoqja Nexhmije të ulët në bankën ku keni ndenjtur ju kur ishit nxënës.

SHOKU ENVER HOXHA: Nexhmije, ulu atje ku të thotë drejtori. Qejfin nuk ta kam prishur kurrë, se ti kurdoherë gjëra të mira më ke thënë, gjëra të mira më ke këshilluar, por tashti dua të them edhe unë ndonjë gjë për ty, do të të bëj disa pyetje, si mësuesi nxënësit.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Jo, jo! *(Të qeshura.)*

SHOKU ENVER HOXHA: A... , s'ka tani, do të përgjigjesh, të vura në vendin e nxënësit. *(Të qeshura.)*

1. Në atë kohë, drejtor i shkollës së mesme «Asim Zenell».

Nexhmije, thuaju këtyre shoqeve të reja, nxënëseve të dalluara, disa fjalë, shprehu ndjenjat tona të përbashkëta se që të dy, edhe ti edhe unë, kemi qenë mësues.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Edhe unë kam emocione tani që po vizitoj këtë klasë, ku ka mësuar shoku Enver. Me të vërtetë u ula këtu në bankën e nxënëses, por unë kam qenë vetë mësuese për pak kohë dhe e kam dashur shumë këtë profesion. Për fat të keq, e ushtrova vetëm katër muaj, se u detyrova të hidhem në ilegalitet dhe së bashku me shokët e shoqet e tjera filluam punën për çlirimin e vendit. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Partia më ngarkoi, veçanërisht, të punoja me rininë. Dhe me shokun Enver për herë të parë jemi njohur në mbledhjen e parë të rinisë, kur u themelua Rinia Komuniste. Pastaj shoku Enver vinte në mbledhjet e Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste dhe aty të dy u njohëm edhe më shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Dhe pasi kishte kaluar ca kohë i thashë: «Moj shoqe, unë të dua ty, si mendon?». Nexhmija u skuq një çikë në atë kohë dhe s'foli. «Mendohu mirë për këtë që thashë, mos më jep përgjigje përnjëherë», shtova unë. (Të qeshura.) Kështu është jeta, moj vajza.

SHOKU SOTIR VARDHAMI: Orën, shoku Enver, që ju na keni dërguar dhuratë, ne e ruajmë me kujdes.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, kjo është ora e shtëpisë, thesari i shtëpisë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të them të drejtën, unë nuk kisha qejf ta hiqja këtë orë nga shtëpia.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'kishe ti? Ajo nuk ishte jotja, ishte e anesë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Kjo ishte e vetmja gjë që kishim si kujtim nga e kaluara në shtëpi. Megjithatë shoku Enver vendosi dhe jua dërgoi juve orën. Kështu që edhe nga kjo pikëpamje ajo është edhe më e shtrenjtë. Ne nuk kishim gjëra të tjera në shtëpi, veç disa sendeve të vogla. Është kështu apo jo, moj Sano?

SHOKU ENVER HOXHA: Unë i thashë anesë: «T'ua dërgojmë këtë orë nxënësve, nxënësve dhe mësuesve të shkollës «Asim Zeneli», ku kam mësuar unë?». «Dërgojuani bilave dhe djemve të asaj shkolle, dërgojuani», tha aneja. Dhe kështu bëra.

SHOKU SOTIR VARDHAMI: Edhe ne këtë dhuratë e ruajmë si gjënë më të shtrenjtë, shoku Enver. Këtu kemi klasën që është me rezultate më të mira në shkollë. Këtë klasë e përdorim si «klasë-flamur» dhe në bankën ku keni ndenjtur ju, qëndrojnë nxënësit që janë me përparim më të mirë gjatë atij muaji.

Ikën ato vite kur djemtë mundoheshin të luanin dhe rolin e shoqeve në aktivitetet e ndryshme kulturore-artistike, se, atëherë, të pakta ishin vajzat që vinin në shkollë, kurse tashti te ne gati 70 për qind e nxënësve të shkollës janë vajza.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një lumturi e madhe.

SHOKU SOTIR VARDHAMI: Shkolla jonë tani nuk është vetëm e qytetit, por edhe e fshatit. Kjo është e vetmja shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm në Gjirokastër që mbulon gjithë rrethin.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, ju uroj nga zemra për punën e mirë që keni bërë e po bëni.

Të jesh mësues në shkollë, t'u japësh dituri fëmi-

jëve, është një detyrë e shenjtë. Tash, mësimet e Partisë, fëmijëve u zhvillojnë intelektin, i bëjnë të aftë për punë, i bëjnë të aftë të jenë ushtarë të mirë, i bëjnë të aftë fizikisht. Të gjitha këto e bëjnë shkollën me të vërtetë një kudhër, ku «çeliku» mbruhet me të gjitha ato vetitë e një njeriu, ashtu siç e kanë dashur Marks, Engelsi, Lenini, Stalini dhe siç e do Partia jonë.

Prandaj, të dashur nxënës e nxënëse, mësoni me kujdes, zgjeroni dituritë që merrni në shkollë. Mësuesit tuaj kanë eksperiencë më të gjerë nga sa ka libri, prandaj u kërkoni atyre t'ua zgjerojnë mësimet, dituritë. Ata janë të gatshëm ta bëjnë një gjë të tillë. Kështu që, kur të dilni në jetë, të keni njohuri sa më të gjera, të cilat do t'ju nxitin juve vazhdimisht tërë jetën të studionit e të punonit dhe gjithë aftësitë tuaja në rritje t'i vini në shërbim të atdheut të dashur që të bëhet përherë më i zhvilluar e më i lulëzuar.

Mos harroni të mësoni për të kaluarën e lavdishme të vendit tonë, të të rënëve për liri, si dhe për të kaluarën e vajzave tona, për të kuptuar se sa shumë ndryshime kanë ndodhur te ne pas Çlirimit. Kujtoje ti, vajzë e Hasan Zazanit, gjyshen tënde, Farijen që ka vuajtur aq shumë në atë kohë. E mbaj mend si tash, se rrinim në një mëhallë. Ajo e shkreta ka qenë e mbyllur, se nuk e linte njeri të dilte nga shtëpia, vetëm nga vrima e derës shikonte ç'bëhej jashtë. Kurse tash ti, mbesa e saj, si dhe gjithë shoqet e tua, ke mësuar, je zhvilluar, u bërë pionierë dhe anëtare e rinisë; më vonë do të hysh në punë, dhe me punë e përpjekje, po ta meritosh, mund të pranohesh edhe në Parti.

Detyra jonë është që Shqipërinë, këtë atdhe të dashur që e çliruam, e shpëtuan dhe e zbukuruam, ta mbrojmë, ta zbukurojmë e ta forcojmë akoma më shumë. Bëmë sa mundëm ne të brezit të kaluar, të brezit të luftës, dhe prapë do të vazhdojmë të punojmë derisa të rrojmë, për të mirën e vendit tonë; derisa të kemi jetë ju do të na keni në krah. Ne do të jemi kurdoherë me ju, por jam i bindur se ju çapin do ta hidhni me siguri më të madh nga ne. Megjithatë edhe ne javash-javash do t'ju ndjekim me ato pak këshilla që do t'ju japim, me atë eksperiencë një çikë më të madhe që kemi dhe jemi të sigurt se ju do të keni respekt për prindërit dhe për gjyshërit tuaj. Edhe ne kemi respekt të madh për ju, të rinjtë e të rejat, sepse jeni gjaku ynë, jeni shpirti ynë, jeni ajo pjellë, për të cilën Partia ka vënë gjithë kujdesin që të bëheni të mirë, të bëheni të fortë, të bëheni të zgjuar, të bëheni punëtorë dhe ushtarë të mirë, që Shqipëria të mos ketë mortje kurrë, që atdheu të forcohet e të lulëzojë në shekuj. Të punojmë që tani që shoqëria jonë socialiste të kalojë, kur të përgatiten kushtet, në fazën tjetër më të lartë të shoqërisë, në komunizëm. Edhe kjo kohë do të vijë, se koha punon për ne, vetëm se duhet ta shfrytëzojmë si duhet, si na mësojnë mësuesit tanë të mëdhenj, me punë, me luftë, në vijë të drejtë marksiste-leniniste.

Ju uroj shëndet! Ju uroj punë të mbarë! Mos u lodhni kurrë për të mësuar, për të punuar dhe për t'u stërvitur nga ana ushtarake; kurrë të mos ndieni lodhje, as fizike, as mendore për t'u bërë njerëz të denjë për shoqërinë tonë socialiste, për ta çuar vendin gjith-

monë drejt sukseseve të reja më të mëdha, për ta pasur Shqipërinë kurdoherë të pamposhtur.

Edhe ju, shokë mësues, ju përgëzoj për punën e madhe që bëni. Të vazhdoni me këtë punë të nderuar, sepse Partia dhe populli shqiptar ju kanë besuar brezin e ri. Siç merr nëna miellin dhe me duart e saj gatuan brumin që të bëjë një kulaç të shijshëm e të ëmbël, edhe ju që keni në dorë këtë «brumë» kaq të shëndoshtë, keni për detyrë të përgatitni një brez të fortë shpirtërisht, fizikisht, mendërisht, sepse kështu e kërkon e ardhmja e vendit tonë.

Të na rrojë Partia!

Tani të shkojmë në dhomën përbri kësaj klase që ju e keni bërë kabinet të historisë, sepse ruaj një kujtim të paharruar për të.

Shoku Enver Hoxha së bashku me të gjithë ata që e shoqërojnë hyjnë në kabinetin e historisë.

Kjo dhomë në kohën e okupacionit të parë italian ka qenë spital ushtarak. Më kujtohet njëherë kur u shtrua këtu baba Çeni. Ai ishte plak në atë kohë dhe një natë vonë, kur po kthehej për në shtëpi, duke zbritur Sokakun e të Marrëve, theu këmbën, prandaj u shtrua këtu, në këtë dhomë të spitalit. Ja, në fund të dhomës ishte krevati i tij, mu këtu, te penxherja. Në atë kohë në shtëpi ne vuanim për bukë. Si gjithë populli i qytetit atëherë hanim bukë të gatuar me krunde të përzier me miell druri. Mirëpo këtu, në spital, të sëmurëve u jepnin nga një koromane të fortë, nga një galletë të thatë të rrumbullakët. Mbase edhe Sanoja e mban mend, se, kur vinim të shikonim baba Çenin që ishte shtruar këtu, ai na e jepte neve koromanen e tij,

nuk e hante, e ruante për ne, se i vinte keq. Unë i thërrisja nga penxherja: «O baba Çen, si je?». Ai ngrihej përgjysmë, hapte penxheren dhe më thoshte: «Merre këtë bukën!», dhe ma hidhte që këtej. Unë me vrap e merrja dhe e ndaja me Sanon e me Balen, vajzën e tij. Ishin kohë të vështira atëherë.

Kjo ishte arsyeja që dëshiroja të vizitoja këtë dhomë, që të kujtoja baba Çenin.

Këtu pranë ka qenë dhoma e mësuesve, kurse këtej ka qenë dhoma e drejtorit.

Ndërkohë, shoku Enver Hoxha dhe ata që e shoqërojnë dolën në oborrin e shkollës.

Këtu ka qenë një sokak i vogël dhe që andej dilje te porta. Porta dhe shkallët kanë qenë atje. Të kujtohet ty, Sano, ku ishin shkallët?

SHOQJA SANO HOXHA: Më kujtohen, shkallët ishin përjashta.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, përjashta ishin.

Atëherë mbeçi me shëndet, të dashur nxënës, të dashur mësues!

Rroftë Partia!

Rrofshi ju!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura gjatë kësaj vizite, që gjenden në AQP

SA MË PËLQEN TË SHËTIT NË KËTO RRUGË!

Nga bisedat me banorë të lagjes Palorto

23 mars 1978

Duke dalë nga shkolla, shoku Enver Hoxha eci nëpër rrugën e lagjes Palorto. Aty ai takohet me shumë banorë. Diku, i del përpara me bluzën e bardhë furrtaari Xhevat Avdalli, këngëtar i njohur popullor.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, more Xhevat? E nxore furrën?

SHOKU XHEVAT AVDALLI: E nxora. Sot kam shapkate dhe qahi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po si thua, ia marrim një herë këngës?

SHOKU XHEVAT AVDALLI: Si të duash ti, ia marrim.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa merrja një herë asaj: «Doli Rrapoja në Sinjë...» të shikoj se si do t'ia kthej unë.

SHOKU XHEVAT AVDALLI: Këtë këngë nuk e di.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, hajde t'ia marrim një kënge tjetër, cilën të duash ti.

«Dërgoi Gjoleka njerinë
Lum' i Vlorësë të vijë
Ç'u shkulën që në Radhimë,
Kaptuan Shënvasinë,
Ranë pëllgut në Delvinë
Mbi Sulo Kallapodhinë.»

Faleminderit shumë, Xhevat! Këtë do ta kem kujtim. Besoj se këta djemtë na kanë incizuar kur kënduam.

SHOKU XHEVAT AVDALLI: Vetëm fotografinë dua të ma dërgosh shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të ta dërgoj me doemos, Xhevat.

SHOKU XHEVAT AVDALLI: Në festivalin që do të bëhet në tetor, do të dalim me dasmën gjirokastrite. Do të bëjmë çmos që të dalë tamam, me bukë e lugë; do të vemi të marrim nusen, me të gjitha të mirat.

SHOKU ENVER HOXHA: Mos harroni që, duke thënë «mashalla», të gjithë ta kapërcejnë magjen me brumë! Mos harroni ta merrni edhe tepsinë, merreni që të hedhin nga një lek të tërë! (Të qeshura.) Hajde të ndahemi bashkë! Dalç faqebardhë!

SHOKU XHEVAT AVDALLI: Faleminderit, qofsh mirë, të na rrosh sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Sa më pëlqen të shëtis në këmbë në këto rrugë! Këtëj eci me sy mbyllur. Pa shikoni se si më fluturojnë këmbët mua këtu? Kjo ndodh sepse jam mësuar të eci në këto rrugë.

Kjo këtu është shtëpia e Skëndulajve.

SHOKU RESUL ZANI: Po, shoku Enver, dhe ruhet si monument.

SHOKU ENVER HOXHA: (Duke treguar një grup burrash që po e përshëndetnin plot entuziazëm). Ata janë dërrasaxhinjtë, i njoh që atje tej.

Këto janë shtëpitë e Kokonës, ato janë të Zekatëve, kurse kjo këtu është shtëpia jonë. Këtu rri Liloja, Sano, erdhëm; mbaji lotët tani! Hajde ç'kemi luajtur te ky kopshti këtu, kur ishim fëmijë!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: I kujt është ky kopsht?

SHOKU ENVER HOXHA: Ky është i Isuf Zekos, të cilit i këndonim një këngë:

*«Isuf Zekoja me pallë,
O Isuf, Isuf Arapi»*

Ai kishte edhe një vëlla, që e quanin Asllan. Isufi i thoshte atij:

*«O Asllan surrat me vëra,
Mulazim dot nuk të bëra.»*

I thotë nuk të bëra dot mulazim, se ai mbeti vetëm asqer.

Kjo është shtëpia e vjetër, ku ka banuar familja jonë ca kohë. Ka qenë shtëpia e baba Çenit, e cila tani nuk është siç ka qenë.

SHOQJA SANO HOXHA: Pasi na u dogj shtëpia që kishim më parë, erdhëm këtu. Por tashti ka ndryshuar, është zvogëluar. E ka bërë të re Liloja.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po. Liloja që rri tani aty e ka rrëzuar dhe ka ndërtuar një shtëpi të re më të vogël dhe më brenda shtëpisë së vjetër.

O Lilo! O djali i teto Samos! *(Në këtë kohë del e shoqja e Lilos)* Si je ti? Po Lilon ku e ke?

SHOQJA MIHARE ÇALI: Ja këtu është... këtu ishte, po ku vajti?

SHOKU ENVER HOXHA: Foli të vijë, ku është Liloja?

Sano, ky është mani i madh.

SHOQJA SANO HOXHA: Jo, ai nuk është mani i madh.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, drejt e ke, mani duhet të ishte atje. E tërë kjo ishte bahçeja. Ajo atje është shtëpia e Lame Çalit, kurse kjo është shtëpia e Nedretit.

(Ndërkaq, duke nxituar, afrohet Liloja.)

Si je, more Lilo, je mirë?

SHOKU LILO ÇALI: Mirë jam, shoku Enver. Si jeni ju, mirë jeni?

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë jam, mirë, por më kishte marrë malli për ju dhe për shtëpinë. Gëzohem që e ke marrë ti këtë shtëpi, se ti je një punëtor i vjetër, nga më të nderuarit. Shtëpinë e mban mirë, kujdesesh për të.

Ke punuar tërë jetën dhe ke vuajtur shumë. Që 12 vjeç ke hyrë në punë, te Papavangjeli për regjjen e lëkurëve. Edhe nëna jote ka qenë e varfër, ka vuajtur shumë. Edhe ajo atje ka punuar. Prandaj gëzohem që këtu, ku kam kaluar fëmijërinë time, rri ti tashti. Sa dhoma ke bërë?

SHOKU LILO ÇALI: Kam bërë katër dhoma dhe kuzhina pesë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po musllukun a e ruani?

SHOKU LILO ÇALI: Ja ku është, por tani s'duhet më. Kur s'kishte ujë, tërë lagjja këtu vinte merrte.

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, erdha e pashë, e nxora mallin.

Në këtë lagje ka pasur shumë evgjitë, siç u thoshim atëherë, kurse tani nuk u themi më kështu. Ata kanë qenë e janë njerëz shumë të mirë, punëtorë e të ndershëm. Veçanërisht këtu, në mëhallën tonë, siç e dini, ata kanë qenë njerëz shumë të ndershëm dhe shumë të besuar. Origjinën e tyre këta e kanë nga India. Kanë qenë një popull, siç ishte populli indian, me kulturë të madhe. Por kur themi që kanë ardhur nga India Veriperëndimore, të kuptohemi: është fjala për këtu e 1500 vjet apo 1600 vjet përpara, pra në kohë të lashta. Këta, si njerëz shumë të kulturuar, donin sidomos muzikën.

Në ato kohë të lashta ekzistonte një dinasti e madhe në Persi, që quhej dinastia e Sasanidëve. Atje ra, atëherë, kolera dhe me mijëra njerëz vdisnin nga kjo sëmundje e keqe që bëri kërدينë. Shahu i Persisë thirri për këshillim poetin e madh, që e keni dëgjuar, Firdusiun dhe i tha: «Firdusi, si do ta shpëtojme popullin nga kjo e keqe, se sokaqet janë mbushur me kufoma». «T'i djegim dhe t'i futim në gropë, tha Firdusiu, por të bëjmë çmos që popullin ta gëzojmë, ta bëjmë që ta largojë mendjen nga fatkeqësia. Duhet absolutisht të ngremë moralin e popullit. Për këtë është mirë të sjellim nga India me mijëra indianë, se ata janë

muzikantë nga më të mirët». Dhe shahu kështu bëri, solli me mijëra veta nga këta në Persi. Këta ishin ata që ne i quanim «evgjitë», të cilët ishin muzikantë të shquar. Por këta kishin edhe një zanat tjetër: ishin kovaçë të mirë, punonin hekurin.

Më vonë, erdhën turmat e Xhengiz Kanit të tmerrshëm, që krijoi një perandori të madhe. Forca e tij qëndronte te kali dhe te shpata. Me trimëri, me kalë dhe me shpatë ai zaptoi shumë vende dhe evgjitët i kishte nga njerëzit më të nderuar, pse ushtria e tij përdorte shpatat që ua bënë evgjitët. Ai përdorte edhe kuajt. Pa kuaj dhe pa shpata as Xhengizi, as djali i tij Kubilai, nuk mund të vinte deri në Rusi, ta zaptonte atë dhe vendet e tjera të asaj ane. Të ardhurit nga India, evgjitët, që nuk ishin pak, por mbi njëqind mijë, Xhengizi i vuri përpara dhe u tha: «Me mua të gjithë! Kujdes të kini kuajt, potkonjtë e kuajve!». Dhe kështu ndodhi; këta e ndoqën Xhengizin. Çdo mbrëmje, kur ky dhe i biri pushonin, indianët i binin violinës.

Kur u shkatërrua perandoria e Xhengizit, indianët u shpërndanë nga të katër anët e Evropës dhe u persekutuan. Një pjesë e mirë e tyre erdhi në Greqi, ku u vendos në More, një pjesë tjetër erdhi në Shqipëri. Grekët këta i quajnë «iftos», anglezët i quajnë «xhipsi». Unë kam lexuar mbi historinë e këtyre, se i dua shumë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Edhe ne, dibranët, kështu u themi, «xhipsi».

SHOKU ENVER HOXHA: Po, e di, edhe dibranët kështu u thonë. Pra, siç ju thashë, kam lexuar disa libra francezë e gjermanë që flasin për ta dhe kam

mësuar se kudo që shkuan janë persekutuar. Vetëm shqiptarët dhe grekët i kanë trajtuar mirë, nuk u bënë atyre asnjë të keqe.

Prandaj te këta njerëz shikojmë që i ruajnë disa tradita të mira: dashurinë për punën, për muzikën dhe thjeshtësinë. Në kohën e rinisë sonë ata punonin tërë ditën. Ymer evgjtit, Lilo, vetëm kurrizi i dukej, se fytyrën e kishte nën thesin një kuintal që ngarkonte në krahë, nga mëngjesi e deri në mbrëmje. E mban mend Ymerin, more Lilo?

SHOKU LILO ÇALI: E mbaj mend, si nuk e mbaj; edhe plakën e tij e mbaj mend. Ashtu, tërë ditën rras-kapiteshin në punë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu është, Lilo. Ymeri punonte shumë dhe ishte burrë i ndershëm. Këta vërtet kovaçë e hamej kanë qenë, por edhe jongarin kurrë s'e lanë; muzikën e duan shumë. Por, muzika tregon kulturë. Evgjtit janë njerëz optimistë. Unë nga ana ime i respektoj.

Po hajde, Lilo, të shikojmë edhe një çikë gropën e musllukut. Kjo këtu ka qenë e mbuluar, këtu ishte hajati. Dhe ashtu është, si the ti, Lilo; kur nuk kishte ujë Gjirokastra, këtu merrte ujë tërë mëhalla.

U kënaqa shumë.

SHOKU LILO ÇALI: Të lumshin këmbët! Të na rrosh sa malet me Partinë në krye.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: I drejtohet një gruajë të moshuar: Si je, si shkon, mirë?

SHOQJA HAZIZE DORACI: Mirë, mirë. Shoku Enver si jeni?

SHOKU ENVER HOXHA: U... , Hazizja! Si je, moj Hazize, mirë je?

SHOQJA HAZIZE DORACI: I kalova ata 30 vjet që më dhe atëherë; tashti do të më japësh edhe 30 të tjerë. (*Të qeshura.*)

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu siç jemi ti dhe unë, me siguri do të arrijmë qindin, pa luajtur. Po nuk i martova të katër kalamanët, që më kanë bërë fëmijët e mi, unë nuk iki nga kjo tokë.

Gruaja e Lilos gostit shokun Enver Hoxha dhe gjithë të tjerët.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, do të marr një gotë raki nga kjo! Hajde gëzuar!

SHOQJA HAZIZE DORACI: Nuk e di në ta pëlqeu vendin Nexhmija, apo jo?

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, e pëlqeu; dita unë kë zgjodha për shoqe jete. (*Të qeshura.*)

Qofshi mirë! *I drejtohet gruas së Lilos:* Lilos i bëj hyzmet se tërë jetën ka punuar shumë. O Lilo, kush rron nga Lame Çali?

SHOKU LILO ÇALI: Rrojnë djemtë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: *Pyet një burrë aty pranë:* Po ti, kush je? («Jam Kapo Çipi», *përgjigjet ai.*)

A je mirë me shëndet? Më kujtove Hasaf Çipin që e kam pasur mësues të nderuar. Ai ka qenë burrë i hollë, i gjatë dhe i ndershëm. Kur isha i vogël, vija këtu pranë, në shtëpinë e Anastasit, por ai iku që në kohën e grekut. Erdha deri këtu, se më kishte marrë malli shumë për njerëzit, bile edhe për këto sokaqet; kisha kohë pa ardhur, por tani do të vij më shpesh. Qofsh mirë, të uroj shëndet!

Si je, ti nënë, je mirë? («Mirë jam, zotrote je mirë?», përgjigjet ajo.)

Mirë, mirë jam edhe unë, por dhe ti shoh që mirë mbahesh. Kujdesen ndonjëçikë djemtë për ty?

SHOQJA MINE ÇALI (BERBERI): Shumë kujdesen, s'ka ku të vejë më mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jam shumë i gëzuar që të takova dhe që je mirë me shëndet. Djemve thuaju që gjithmonë të kujdesen për ty, të të shërbejnë mirë; se i ke rritur me halle.

SHOKU LILO ÇALI: Ja, ky është njëri nga djemtë e saj. Ky punon në turizëm¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, të kesh kujdes për nënën, se të ka bërë kokën.

Hajde, qofshi shëndoshë, qofshi mirë!

I drejtohet një gruaje të re²: Po ti, moj nuse, si je, je mirë? Sa fëmijë ke? («Një vajzë kam», përgjigjet ajo.)

Të të rrojë, të të rrojë! Mos ji pishman që ke vajzë; se tashti të kesh vajza është njëlloj si të kesh djem. Pastaj mund të na bësh edhe djalë.

SHOQJA HAZIZE DORACI: U gëzua shumë që të pamë. Març ditë nga të fëmijëve të mi! Dritë na e bëre Shqipërinë!

SHOKU ENVER HOXHA: Shtëpinë dhe oborrin përpara saj i ke mbajtur mirë, ashtu siç e keni traditë, plot me lule. Por, mësoje edhe nusen të vërë lule rreth e qark këtyre mureve, në sufanë e portës e kudo.

1. Pëllumb Berberi.

2. Vojsava Berberi.

SHOQJA HAZIZE DORACI: Të tëra këto lule që kam sjellë këtu, në shtëpinë tënde i kam marrë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë ke bërë! Të mbillni lule e ta zbukuroni vendin. Kur të dalësh beharit në oborr për një copë herë dhe nusja të të sjellë kafënë, do të të shtohet jeta nga bukuria e pastërtia.

Qofshi mirë! Mbeçi me shëndet!

Duke zbritur më poshtë e duke u përshëndetur me banorë të tjerë të lagjes, shoku Enver Hoxha u thotë nja dy grave:

Pa hapni një çikë portat t'ju shikoj oborret! Në përgjithësi mirë i mbani, po mos e harroni traditën, t'i mbani dhe më mirë. Ja, edhe kopshtet i keni punuar, keni mbjellë ca hudhra, ca qepë, një çikë labot dhe mirë keni bërë. Por mos lini pas dore edhe pastërtinë e bukurinë e ambientit rrotull shtëpisë. Unë e di që gjirokastritët janë nikoqirë dhe këtë e përsërit ngaherë. Bëj shaka kur them që gjirokastritët janë «të kursyer». Ata, në fakt, nuk janë aspak të kursyer, por janë nikoqirë, ekonomiqarë, nuk lënë asgjë t'u shkojë dëm apo të harxhohet tepër masës. Megjithatë kam qejf kur i ngas një çikë, dhe asnjëriut nuk i vjen keq.

Këtu, në këtë vend ka banuar Shahin Bakiri. Ai ishte një njeri i varfër që merrej me ndreqje ombrellash. Sa herë që i prishej ombrella anesë, më dërgonte te xha Shahini për ta ndrequr. Kur ia shpija ombrellën të na e ndreqte më thoshte: «Ore bir, gjithë populli i Gjirokastrës do diell, i vetmi jam unë që dua të bjerë shi, se, po të mos bjerë, nuk fitoj gjë dhe atëherë nuk kam të ha». Kështu më thoshte ai plak i

shkretë. Ishte fukara, por punëtor. Ja, si tashti më kujtohet, tamam këtu rrinte xha Shahini dhe, kur ikja, më porosiste: «Shiko, more bir, thuaji atij mulla Hysenit të mos më harrojë edhe mua, kur të fillojë të ndajë ndonjë ndihmë». «Jo, jo, nuk harroj, mos ki merak, xha Shahin», i përgjigjesha dhe ia thosha baba Çenit lutjen e tij. Prandaj, more shokë, dhe unë u ula tash këtu në sofatet e kësaj porte se më kishte marrë malli. Kam ardhur shumë herë deri këtu, kur isha i vogël.

NJË NËNË: Të paçim sa malet! Edhe gurët qeshin, Enver, kur shkon rrugës.

SHOKU ENVER HOXHA: Tashti po largohem, se kam akoma rrugë për të bërë. Ju uroj shëndet dhe jetë të lumtur të gjithëve. Juve nuseve ju këshilloj t'i mbushni shtëpitë me kalamanë. Mos u frikësoni për jetën e tyre. Prandaj edhe ju të moshuarit u thoni të rinjve që martohen, që të bëjnë shumë kalamanë, se jeta në të ardhmen do të bëhet akoma më e lumtur.

NJË NËNË: Jo të rinjtë që nuk kanë frikë, por edhe ne të vjetrat nuk kemi frikë për këtë. *(Të qeshura.)*

SHOKU ENVER HOXHA: Ja, ajo atje është shtëpia e Fejo Xhaxhiut. Për herë të parë atje kam lexuar bashkë me djalin e tij Selaminë, që e kisha shok, një libër me përmbajtje komuniste. Selamiu blente nga një libër të tillë, por ruheshim nga policia dhe sa herë që dëgjonim ndonjë lëvizje, shpejt e shpejt e fshihnim librin në dhipato sipër. Te kjo shtëpi pashë për herë të parë në jetën time edhe një fotografi të një udhëheqësi ushtarak sovjetik. Kjo ka ndodhur aty nga vitet 1922-1923, kur rronte akoma Lenini. Në atë fotografi ai ishte i veshur si oficer, me rrobat karakteristike të

rusëve. Por, siç ju thashë, këto gjëra i shikonim shpejt e shpejt e pastaj i fshihnim menjëherë se mos na dik-
tonte xhandarmëria.

Duke ecur pak më tutje, tregon një shtëpi tjetër.

Kjo shtëpi këtu, më kujtohet mirë, ka qenë shtëpia e kako Pinos.

SHOQJA SANO HOXHA: Kurse ajo tjetra është shtëpia e Karajanëve.

SHOKU ENVER HOXHA: *U drejtohet disa banorëve:* Si ju kemi, mirë jeni?

(«Mirë, juve si jeni? Të na rroni sa malet!», thonë ata.) I keni mirë kalamanët? Nga jeni ju?

(«Jemi nga Pogoni», përgjigjen banorët e ardhur në këtë lagje.)

Janë njerëz të mirë pogonasit. Të parët tuaj kanë qenë të varfër, por punëtorë të ndershëm. Pas Çlirimit jeta edhe në Pogon ka ndryshuar si në gjithë vendin tonë.

Qofshi mirë, mirupafshim! Mbeçi me shëndet, shokë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura gjatë kësaj vizite, që gjenden në AQP

TAKIMET ME POPULLIN KURDOHERË MË JAPIN KËNAQËSI

*Nga biseda me disa kuadro të rrethit
të Gjirokastrës*

23 mars 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet shokë?

Sot mbajti kohë e bukur, që më dha mundësi të shihem me njerëzit. Takimet me popullin kurdoherë më sjellin kënaqësi.

Ne ndjekim rrugën tonë të drejtë dhe nuk na prishtet puna se çfarë thonë armiqtë që bëjnë propagandë kundër nesh. Ata le të shikojnë punët e tyre që po u shkojnë lumë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ja si ndodhi tani në Itali, ku fashistët rrëmbyen Aldo Moron.

SHOKU ENVER HOXHA: Ata që kryen këtë akt fashist quhen «brigada të kuqe», «proletare» e plot emra të tillë. Kjo lojë është përgatitur nga imperialistët amerikanë, se ata nuk e duan bashkëpunimin e demokristianëve me revizionistët italianë. Edhe në Francë, ashtu si në Itali, «komunistët» e partisë revii-

zioniste duan të marrin pjesë në pushtetin borgjez. Ata bëjnë sehir zhvillimin e situatës. Për të karakterizuar qëndrimet e këtyre partive do të ishin të përshtatshme fjalët që thonë gjirokastritët: «Si i ati dhe i biri, kunguj bostan çairi».

Kaluam disa ditë shumë të bukura këtu me ju. Mirë thotë kënga popullore:

*«Edhe sonte jam këtu, hoj broj;
nesër ngarkoj e shkroj, hoj broj!»*

Për mua erdhi tani koha që të largohem nga Gjirokastra ku gjithë këto ditë kam ndier një kënaqësi të madhe, shumë të madhe. Nexhmijen e bëra gjirokastrite fare, se i kam shpjeguar shumë gjëra karakteristike të qytetit, por edhe e kam shëtitur gjithandej.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po, po, vërtet kam ndryshuar. Një ditë kur po lexoja një shkrimin tim nga ata të kohës së luftës, qesha me vete, sepse e kisha shkruar gjysmë gegërisht. Kurse tashti e kam ndryshuar fare dialektin. (Të qeshura.)

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë herë që shëtitëm në rrugët e sokaqet u çmallëm mirë, por ndiej se do ta kemi vështirë nesër kur të largohemi. Një poet francez thotë se kur largohesh nga një vend që e do shumë, të duket sikur vdes nga hidhërimi.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Shqipëria është e vogël dhe njeriu shkon përsëri shpejt atje ku dëshiron.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk e kam fjalën këtu vetëm për Gjirokastrën, por edhe për Sarandën, ku do të vemi nesër. Kur del nëpër rrethe dhe njihesh

nga afër me njerëzit, me jetën e tyre, kuvendon gju më gju e qan hallet shtruar me ta, nuk të bëhet të ndahesh më prej tyre.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Edhe koha në përgjithësi, na bëri mirë. Ndoshta nuk do të ishim kënaqur kaq shumë, po të mos ishte edhe koha e bukur.

SHOKU ENVER HOXHA: E vërteta është se kudo që shkuam u kënaqëm. Obelisku që u ngrit vjet këtu ishte me të vërtetë një punë krijuese e bukur. Më kishte thënë edhe shoku Hysni që kishte dalë i bukur, por sot këtë bukuri e pashë me sytë e mi. Dukej i mrekullueshëm, tamam si unazat me gur në mes që bëheshin përpara.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Është realizuar një ide e bukur, origjinale.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë e bukur! Rreth e rrotull tij janë vendosur shkolla, klubi, shtypshkronja, shoqëria «Studenti». Atje ku gjendet shtypshkronja është një mur me një penxhere, para së cilës dukej klubi. Që andej dilej poshtë nëpër shkallët thikë fare. Dera kishte një çelës të madh, të cilin drejtori i liceut u përpoq ta merrte, por nuk mundi. Kishim edhe një çelës tjetër për ballkonin. Aty ishte një e ndarë në dy dhoma të vogla, njëra nga të cilat ishte bibliotekë dhe tjetra dhoma ku rrinim e bënim muhabet. Tregonim për të gjitha ato që kishim lexuar në shqip dhe në frëngjisht.

Kemi pasur atëherë një shok çifut, që quhej Samuel Kofina. Ai ishte njeri i mirë, lexonte në greqisht, kurse Alen Pinkertonin e lexonte në frëngjisht. Kamber Bilali lexonte në turqisht. Mbrëmjeve zakonisht

shkonim nga dera e dyqanit të Samuelit dhe i thoshim: «E, do të vish?». «Do të vij», na përgjigjej ai dhe na tregonte mbi historitë e gjata të Alen Pinkertonit. Ne dëgjonim sa dëgjonim, pastaj i thoshim: «Do të ikim tashti». «Jo, jo, mos ikni, rrini dhe pak se e mbarova», na kthehej Samueli.

Unë kam shumë kujtime për Gjirokastrën, por kam edhe për Korçën.

Në ndeshjen e futbollit, që u zhvillua të dielën midis skuadrës «Luftëtari» të Gjirokastrës dhe skuadrës «Vllaznia» të Shkodrës, nuk shkuam dot se nuk na mbajti koha.

Kur kam qenë nxënës në Liceun e Korçës ne, konviktorët, kishim një skuadër të mirë futbollit, ishin të gjithë futbollistë të mirë e të fortë fizikisht. Një nga futbollistët e skuadrës korçare ishte edhe shoku Pilo Peristeri. Skuadra e konviktit luante shpesh me skuadrën e Korçës dhe herë i mundnim ne e herë na mundnin ata. Një herë mbaj mend që u përleshën keq të dyja skuadrat. Mirëpo korçarët na vunë përpara, te rruga e bankës, andej nga Katavaroshi. Zunë një shokun tonë e i hoqën edhe pantallonat e u katandis për ibret. *(Të qeshura.)*

Në Gjirokastër kemi pasur shokë të mirë. Këtu kam takuar për herë të parë Ali Kelmendin. «Hajde të piqemi me Alinë», më thanë shokët. Vajta e takova. Pas kësaj takoheshim herë pas here, por këto takime nuk vazhduan dot gjatë se Aliun një ditë e thirri prefekti. E pritëm sa u kthye. Prefekti ishte nga Korça; kishte jetuar shumë kohë në Kostancë të Rumanisë dhe prej andej ishte kthyer në Shqipëri. Klubet e pa-

triotëve të Rilindjes sonë Kombëtare në Rumanl kishin ndikuar te ky njeri. Kur u kthye Aliu nga takimi që bëri me prefektin na tregoi: «Nuk më priti keq prefekti, u ngrit në këmbë e më tha: «Uluni, zoti Kelmendi. Më vjen keq, por do të të komunikoj një urdhër nga Tirana: Ose duhet të vesh në burg ose duhet të largohesh nga Shqipëria».

«Po ti, si thua, e kishte pyetur Aliu, si të bëj, se mua nuk më iket këtej.»

«Unë e di ç'ke ti në kokë, iu përgjigj prefekti, por të këshilloj të largohesh. Nuk dihet si vjen puna; ti je akoma i ri, prandaj më mirë largohu, sesa të lësh kockat në burg». «Atëhere po iki, por jashtë dëshirës sime», i tha Aliu.

«Do të të propozoj një gjë jo si prefekt, por si shqiptar. Mund të pranosh disa të holla që t'i kesh për shpenzimet e rrugës?»

«Jo, faleminderit se më japin shokët», iu përgjigj Aliu:

«Këto na i tregoi Aliu. Pastaj u puthëm me të e u ndamë dhe ai u largua.

Aliu ka ndenjur shumë kohë në Korçë. Ai kishte mik të ngushtë Sotir Gurrën, një komunist i vjetër ky, bile më i vjetër nga Miha Lakoja. Edhe unë isha i lidhur aso kohe me Sotirin dhe me Pilon, i cili ishte një nga drejtuesit kryesorë të punëtorëve në Korçë.

Aliun e ndihmoi shumë Hamit Baçe. Hamiti për vete ishte njeri përparimtar. Jetonte duke shitur qymyr te hani me dy porta, ku ishte ndërtesa e shoqërisë së tharjes së kënetës së Maliqit, që, siç dihet, nuk e thau kurrë.

Kur u ktheva më vonë në Korçë, ne mbledheshim në depon e Hamitit, që e kishim shokun tonë, se kishte mbajtur Aliun. Me ne ishte edhe një djalë nga familja e Katros¹, që kishte qenë në Rusi dhe që pas Çlirimit e gjer sa vdiq punoi si përkthyes. Ky kishte një vëlla shumë të keq, edepsëz e maskara që e quanin Petraq Katro. Diku afër, Petraqi kishte punishten e gallosheve. Se ç'mbante atje ca kazanë dhe me to bënte galloshe. Mbaj mend që vishte këpucë me taka dhe hidhte shumë livando.

«Mos po bëni ndonjë komplot ju, bolshevikët?», na thoshte ai.

Sotiri nevríkosej kur e dëgjonte Petraqin që fliste ashtu dhe i thoshte: «Mos më rënç në dorë, pa do ta tregoj unë qejfin!». «Posi, do të bëheni ju që të merrni fuqinë!», fliste ai me qesëndi.

Por ajo kohë erdhi. Ne e çliruam vendin dhe populli e mori fuqinë.

Pas Çlirimit, kur akoma banonim përkohësisht në hotel «Dajti» se nuk kishim zënë shtëpi, vjen njëri nga shokët e sigurimit e më thotë: «Të kemi gjetur një shtëpi, por atje banon Petraq Katroja». Thirra Esat Dishnicën që, siç e dini, dyqanin «Flora» dhe gjithçka tjetër që ai kishte i sakrifikoi për Partinë, dhe e porosit si të vepronte. Ai vajti bashkë me dy partizanë në shtëpinë e Bellotit ku banonte Petraqi. Trokitën në derë, por shtëpinë nuk e hapnin njerëzit brenda.

«Hapeni derën, apo doni t'jua futim me mitraloz?», thirrën njerëzit tanë. Atëherë nga brenda qe dëgjuar

1: Vasil Katro.

një zë gruaje: «Ku e keni urdhrin?». «Nuk ka urdhër me shkrim për të ta dhënë ty, po hap shtëpinë! Ku e ke burrin?». «Nuk është këtu», ishte përgjigjur prapë gruaja. «E kujt është kjo shtëpi?». «Ka qenë e Bellotit, por tashti është e Petraqkës, që e ka me tapi». «Vishni këpucët ti e Petraqka e na jepni çelësat e shtëpisë», i kishte thënë Esati. «Po kjo qeveri nuk është nga ato që të na lërë në rrugë. Nuk e keni mirë këtë që po na bëni», tha ajo. «Kështu është puna, nesër në mëngjes do të vijmë prapë, po se mos trazoni gjë me dorë nga këto sende që janë brenda», kishte urdhëruar Esati. «Si urdhëron!», kishte thënë ajo.

Esati erdhi e më tha mua që u rregulluan edhe shtëpia me gjithë pajisjet e tjera. «Nuk keni nevojë të mendoni për asgjë që i duhet një shtëpie, sepse të gjitha janë gati atje», tha ai.

Kur vajtëm të nesërmen, nuk gjetëm asgjë në shtëpi. Për tërë natën Petraqi me njerëzit e tij i kishin hequr të gjitha.

«Ku i keni fshehur plaçkat, ku e ke Petraqkën?», i thamë ne. Gruaja që gjetëm brenda u mundua të na gënjente, por shokët tanë i gjetën të gjitha. Nuk e di se çfarë u bë më tej, po më vonë mora vesh se Petraqin e kishin arrestuar. Pastaj nuk di gjë më se si vajti puna e tij.

Kështu e pësuan Petraqi me shokë, që iu kundërvunë popullit dhe luftës së tij.

Gëzohem shumë për të gjitha sukseset që keni arritur. Ju uroj suksese më të mëdha. Gjirokastra, si të gjitha rrethet e tjera të Shqipërisë, të përparojë sa të jetë e mundur më shumë. Plani të realizohet në të gj-

thë sektorët që populli të jetojë si kudo edhe këtu, i lumtur e i gëzuar.

SHOKU ALI MANAJ: Shoku Enver, ju lodhëm shumë, na lejoni të shkojmë tani.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit shumë për këtë vizitë. Nesër në orën 10³⁰ do ta lë Gjirokastrën e dashur, popullin e saj, të gjithë miqtë e shokët, të gjithë ju.

Ju uroj të gjithëve shëndet dhe suksese në punë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

NE JEMI KRENARË PËR BURRAT E SHIQUAR QË KA NXJERRË TRUALLI YNË

*Nga biseda gjatë vendosjes së kurorave në varrezat
e dëshmorëve dhe në bustin e Hoxha Tahsinit,
në Sarandë*

25 mars 1978

*Shoku Enver Hoxha takohet me të afërmit e dësh-
morëve të rrethit dhe u shtrëngon duart me përzemërsi.*

SHOKU ENVER HOXHA: *I drejtohet së shoqes
së heroit të popullit Mitro Xhani: Jeni mirë me shën-
ndet?*

SHOQJA ATHINA XHANI: *Mirë jemi ne shoku
Enver, kur të kemi mirë ty. Gëzohem që qenke mirë
me shëndet. Të na rrosh sa malet!*

SHOKU ENVER HOXHA: *I drejtohet një të mo-
shuari: Si je ti xhaxha? («Mirë, faleminderit! Sot që na
erdhe ti këtu, u bëra 25 vjeç», përgjigjet ai.)*

SHOKU ENVER HOXHA: *Të rrosh edhe 100 vjet!
Do të vij edhe më shpesh, se tani që u takova me ju
edhe unë u bëra më i ri.*

*Sa e bukur është bërë Saranda! Kisha kohë pa
ardhur. U gëzova për të gjitha ndryshimet dhe hapat
përpara që janë bërë këtu. U gëzova për njerëzit e*

lumtur që pashë, për qytetin, që është bërë një kopsht i lulëzuar, por u gëzova, gjithashtu, që keni mbajtur fjalën e dhënë Partisë për ta veshur vendin me pemë e gjelbërim.

Pas nja 7 a 8 vjetësh ky vend do të bëhet edhe më i bukur akoma.

(«Edhe më shpejt do të bëhet, *ndërhyn një nga bashkëbiseduesit*, se kemi rininë, që ka përveshur llëret».)

Rinia bën shumë punë te ne, se ajo e di që përgatit të ardhmen e saj. Ne kemi një rini xhevahirë.

I drejtohet veteranit Miho Xhani: Si je Miho, a je burrë i fortë?

SHOKU MIHO XHANI: Mirë faleminderit, shoku Enver! T'ju kemi juve mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem, gëzohem shumë që edhe ti je i fortë. Vitet shkojnë, po ne bëhemi më të rinj. Le t'i kemi flokët të bardhë, po ne nuk duam t'ia dimë.

Ja, edhe koha na hapi.

Shoku Enver Hoxha pasi vendosi një kurorë në lapidarin e varrezave të dëshmorëve tha:

Lavdi heronjve të popullit tonë! Të rrojë Partia! Mbetshi me shëndet!

Shoku Enver Hoxha duke ecur më këmbë, drejtohet për te busti i Hoxha Tahsinit dhe, pasi vendosi kurorën, tha:

Hoxha Tahsini ishte filozof i shquar. Ai kishte dije të gjithanshme, njihte shumë shkenca, si: astronominë, matematikën, fizikën etj. Ishte aq i zoti sa me punën e tij të jashtëzakonshme arriti të bëhej rektor i parë i

Universitetit të Stambollit, që ka pasur rëndësi të madhe në kohën e Perandorisë Otomane. Atje jepnin mësim filozofë e shkencëtarë të shquar që vinin nga Damasku, Teherani etj. Hoxha Tahsini ka qenë një patriot i flaktë që luftoi e punoi për të treguar personalitetin e madh të kombit tonë, prandaj u përpoq të krijonte edhe një alfabet krejt të ndryshëm nga të tjerët. Me këtë ai donte të tregonte, gjithashtu, se populli shqiptar është një popull i lashtë e me një kulturë të vetën.

Hasan Tahsini nuk njihte vetëm kulturën e Lindjes, por edhe kulturën evropiane, se ishte frymëzuar nga dijetarët e mëdhenj evropianë si: Dekarti, Spinoza, Rusoi. Dekarti është një nga filozofët e mëdhenj francezë të shekullit të 17-të që lëkundej midis materializmit dhe idealizmit, pra ishte dualist, por edhe themelues i racionalizmit. Në pozitën e dualizmit ka qenë edhe Rusoi, kurse Spinoza ishte materialist dhe njëkohësisht një nga përfaqësuesit e dëgjuar të racionalizmit.

Duke iu drejtuar sekretares së komitetit ekzekutiv të rrethit¹ që është nga fshati Ninat, vendlindja e Hasan Tahsinit: Të gjithë shqiptarët janë krenarë për këta burra të shquar që ka nxjerrë ky truall i ynë; por, edhe fshati juaj është mjaft krenar që ka nxjerrë një burrë kaq të madh, një nga njerëzit më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare. Për të mbrojtur e për ta zhvilluar kulturën, gjuhën dhe alfabetin tonë ata u bënë ballë perandorisë dhe kulturës osmane.

Ne përulemi me respekt të madh para veprës së Hoxha Tahsinit.

1. Vitori Muça.

Shqipëria ka pasur edhe dijetarë të tjerë të shquar si Naimin, Samiun etj. Sami Frashëri ka bërë shumë libra me vlerë shkencore në turqisht, më i madhi ndër të cilët është «Enciklopedia» apo «Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë», në gjashtë vëllime, që është e para në atë gjuhë. Kjo enciklopedi me të dhëna të shumta informuese, përfshin gati të gjitha shkencat. Samiu ishte një nga shkencëtarët më të mëdhenj jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të Turqisë. Naim Frashëri ka qenë kryetar i komisionit të botimeve pranë Ministrisë së Arsimit të Turqisë.

Të tërë këta kanë qenë njerëz të shquar të Shqipërisë. Ata punuan gjithë jetën për atdheun, prandaj vepra e tyre është e pavdekshme, se lufta për çështjen e popullit të bën të pavdekshëm. Dhe kjo tokë, në tabanin e së cilës, ashtu siç thotë populli, «është derdhur gjak me okë», përherë do të nxjerrë bij dhe bija të denja. Ata gjithmonë do t'ia ngrenë më lart lavdinë Shqipërisë.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU¹: Në këtë shtëpi këtu ka qëndruar dhe ka vdekur Bajo Topulli, prandaj mendojmë ta bëjmë shtëpi-muze.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, ta bëni!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura gjatë kësaj vizite, që gjenden në AQP

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Sarandës.

SA MË PJELLORE T'I BËJMË FUSHAT E MALET. TONA, AQ MË E FORTË DO TË BËHET SHIQIPËRIA

Fjala në mitingun e Ksamilit

26 mars 1978

Të dashur shokë punëtorë e punëtore,
Shokë drejtues të kësaj ndërmarrjeje të rëndësishme,

Ju keni plot diell këtu, prandaj jeni gjithë shëndet. Kisha disa vjet pa ardhur në Ksamil dhe po vërejtme kënaqësi se ky vend shkëmbor është shndërruar në një kopsht të bukur me ullishte e agrume. Tej, paranes, qëndrojnë fushat e bukura të Vrinës dhe të Mursisë, të cilat i kam parë shpeshherë. I kam parë edhe kur kanë qenë plot ferra e shkurre e me disa drurë të egër që kishin mbirë në mënyrë të natyrshme. Kisha parë faqet e kodrave të Vrinës me gurë e me bar, ku kullotnin bagëtitë e pasanikëve, të çelnikëve, siç u thoshin në kohën e kaluar. Dhe ja, tani, në sajë të zbatimit të vijës së Partisë dhe të punës vetëmohuese të njerëzve tanë, ky vend ka ndryshuar krejtësisht. Tani Vrina është bërë tejmbanë si një qilim i blertë dhe ky gjel-

bërim plot gjallëri vjen nga gruri që mbin e rritet këtu aq i shëndetshëm. Në vend të gurëve e të shpellave të dikurshme, sot të bien në sy bagëtitë e imëta që kullojnë. Natyrisht, duhet kujdesur për t'i ruajtur ato, që të mos bëjnë dëme, sepse në ato shpate e kodra janë mbjellë edhe agrume. Gjelbërimi i Vrinës, kaltërsia e qiellit dhe e detit i japin këtij vendi këtu një bukuri të rrallë. Këtu tashmë besoj se ka mbaruar bonifikimi i Bufit, i Vurgut e i Xarrës.

Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe Qeveria kanë ndjekur me kujdes të madh zhvillimin politik, kulturor, ideologjik dhe ekonomik të rrethit të Sarandës. E vërteta është se neve nuk na ka ardhur mirë që fusha e Vrinës dhe ajo e Vurgut, me këtë diell kaq të ngrohtë dhe me këtë tokë kaq pjellore, ku shteti i proletarëve ka harxhuar miliona për t'i sistemuar e për t'i ujitur, për të kanalizuar ujërat e Kalasës etj., nuk kanë marrë nga bimët që mbillen në këto anë rendimente të larta, prandaj dhe ju kemi kritikuar. Por, dikush nga ju mund të thotë: «Ashtu është, more shoku Enver, por ky diell i ngrohtë sjell edhe thatësi». Këtë e dimë, prandaj dhe jemi përpjekur që këtë thatësi ta luftojmë. Qoftë thatësira, qofshin shirat, ashtu edhe dielli përballohen me punë, me organizim, me disiplinë shkencore në çdo periudhë të vitit dhe për çdo bimë. Po të punojmë kështu, dhe kështu duhet të punojmë, atëherë Saranda do të bëhet me të vërtetë një kopsht i mrekullueshëm, jo vetëm për të kënaqur syrin, por edhe një hambar i madh për të mbushur tregun dhe tryczat tona me prodhime të bollshme bujqësore e blegtorale.

Ne duhet t'i shtojmë gjithnjë e më shumë prodhi-

met e të rritim mirëqenien për mbarë popullin tonë, por sidomos për rininë, të ardhmen e Shqipërisë. Mirëqenia, natyra dhe bukuria e saj, janë faktorë që ndihmojnë për të zgjatur jetën. Ja një provë: Drejtori, në ekspozencë që na bëri, na tha se në Ndërmarrjen Bujqësore të Vrinës vdekshmëria e popullatës është tre për mijë. Por me siguri këtu ka zona që e kanë vdekshmërinë edhe më të ulët. Këto përqindje të vdekshmërisë zor se i gjen në vendet e tjera. Kur bëjmë krahasime të statistikave tona me ato të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shohim se kohëzgjatja e jetës tona është nga më të lartat dhe përqindja e vdekjeve nga më të ulëtat.

Ju, vëllezër dhe motra punëtore, duhet t'i mbani parasysh të gjithë faktorët e kushtet pozitive që keni këtu, prandaj mbrujeni mirë këtë «brumë», këtë tokë, që t'i merrni asaj sa më shumë prodhime. Buka piqet në furrë, por ullinjtë, portokallet, zarzavatet, gruri, piqen mbi tokë, në kohë me diell dhe me shi. Bimët rriten me harrje, me krasitje, me prashitje, me spërkatje e me gjithfarë shërbimesh të tjera të domosdoshme. Prandaj të gjitha metodat agroteknike ju lypset t'i shfrytëzoni ashtu si duhet dhe gjatë gjithë stinëve të vitit.

Unë i kam dashur shumë furrxinjtë, se ata punonin dimër e behar me zjarrin. Tani në vendin tonë kemi shumë sektorë prodhimi ku njerëzit tanë punojnë me zjarrin, si fjala vjen, në industrinë metalurgjike e gjetkë. Por, furrxinjtë tanë kanë qenë të parët punëtorë të zjarrit. Furrxhiu e njeh mirë tabanin e furrës; ai e di se në ç'kohë duhet djegur furra dhe kur du-

het të hidhet buka; kur kulaçi ose kur shapkati, kur byreku apo birjani etj., etj. Por, nuk mjafton vetëm kaq për të qenë furrxhi i mirë. Furrxhiu nuk largohet kurrë nga puna, duke e mbyllur furrën e nxehtë kur ka akoma tepsitë dhe tavat brenda. Ai herë pas here e hap derën e furrës, pastaj merr kanxhën dhe i nduk me radhë ato tava apo tepsi që ka për të pjekur. Bukën, byrekun apo diçka tjetër, kur e sheh që ka marrë ngjyrën e verdhë si të floririt, furrxhiu i çon nga ajo anë ku zjarri në furrë është më i dobët. Ushqimet që akoma janë të papjekura i fut sa më afër zjarrit. Kur shikon se furra është nxehur shumë, heq drurët e tepërt; pastaj shtron prushin dhe birjanet, si ajo nikoqirja e mirë që i cigaris, siç i themi nga Gjirokastra, i vë mbi prush. Pse i them të gjitha këto? I them për ju, punëtorët e bujqësisë, që të mos harroni kurrë se nuk mjafton vetëm t'i mbillni këto kodra me ullinj, me agrume, me pemë frutore, me patate, me perime etj., por është e domosdoshme që, qysh në kohën kur vihet fidani në fidanishte dhe derisa ky të ketë jetë, duhet t'i qëndrohet mbi kokë, t'i bëhen të gjitha shërbimet, pse vetëm kështu ai do të na japë sa më shumë prodhime. Toka është bujare, bimët e pemët janë, gjithashtu, bujare. «Po të na doni, do t'jua shpërblejmë», u thonë ato njerëzve. Toka thotë «me miliona vjet përpara unë ju dhashë jetë. Pra, duamëni mua!».

Më falni që po bisedoj duke përdorur edhe ndonjë figurë, por në këtë vend të mrekullueshëm, ku çdo gjë të frymëzon, njeriut i pëlqen të shprehet ca edhe në mënyrë poetike. Por, më kuptoni, poezia jonë socialiste nuk është një poezi ëndërrimesh fantastike dhe pa vlerë,

ajo është poezi realiste. Poetët tanë, kur flasin me gjuhën e poezisë, këndojnë realitetin dhe perspektivën.

Dy çështje dëshiroj të theksoj sot këtu te ju.

Çështja e parë është kjo: Përpara nesh shtrihet gjithë ky vend kaq i bukur nga natyra dhe i veshur nga puna juaj me agrume, ullinj e pemë të tjera. Agrumet, ullinjtë, pemët frutore duhet të konsiderohen nga prodhimet më të rëndësishme të vendit tonë dhe të luftohet pikëpamja e vjetër, e gabuar, qoftë edhe si mbeburinë, që pemëtaria konsiderohet si vrima e fundit e kavallit. Nuk është ashtu. Me të vërtetë çështja e drithërave është kryesorja mbi kryesoret dhe për këtë ne duhet të punojmë me kujdesin më të madh, por kjo nuk do të thotë që të shkojmë në monokulturë. Ne nuk ndjekim këtë rrugë në bujqësinë tonë. Çështja është që të gjitha bimëve t'u japim rëndësinë që kanë e duhet të kenë. Ne bëjmë këtë radhitje kur flasim për prodhimet bujqësore: drithërat e bukës, blegtoria, bimët industriale, pemëtaria. Pavarësisht se në këtë renditje e vëmë në fund pemëtarinë, atë duhet ta konsiderojmë si një sektor të bujqësisë ndër më të rëndësishmit, më të nevojshmit e më të domosdoshmit për jetën e njeriut e për ekonominë përgjithësisht.

Në Gjirokastër, kur ishim të vegjël dhe festohej bajrami, shkonim shtëpi më shtëpi me një shami që e lidhnim në katër kombe. Kudo që venim na gostitnin me nga dy kokrra bajame ose me nga tri kokrra lajthi dhe gëzoheshim sikur ç'na jepnin. Ato që grumbullonim nga vizitat shtëpi më shtëpi i quanim «bobo». Unë kisha një hallë, e cila më jepte gjithmonë nga disa kokrra bajame ose lajthi, prandaj e thërrisja «hallë-bobo».

Për shumë kohë ne kemi jetuar në vendin tonë me pemët që na kishin mbjellë stërgjyshërit, gjyshërit e baballarët. Bënte molla, s'bënte molla, askush nuk interesohej! Bënte kumbulla, s'bënte kumbulla, aq punë prishte. Bënte vreshti a s'bënte vreshti, pak merak kishte nga njerëzit; pemët nënvlerësoheshin dhe sigurisht që nuk mendohej mirë për këtë degë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore. Njerëzve u pëlqente të prodhohej rrush vetëm sa për të bërë pak raki. Megjithëse atyre u pëlqente jo vetëm rakia kur e pinin, po edhe rrushi kur e hanin, ashtu të verdhë si floriri ose të zi, për hardhi e vreshta nuk janë kujtuar të mbillnin e t'u bënin shërbime. Lëngu i rrushit, i kuq si gjaku, u ka shijuar të gjithëve, por jo të gjithë mendonin se kush e bënte atë. Për të zhdukur këtë nënvlerësim Partia, në fillim, luftoi shumë që të vlerësohej drejt kjo situatë dhe, deri në njëfarë shkalle, arriti të bëjë që populli të kuptojë se pemët e frutat kanë rëndësi për shëndetin, për ekonominë e brendshme e për eksport.

Ç'na mungon, thoshim në udhëheqje, që këtë vend si yni, me këtë klimë kaq të përshtatshme ta bëjmë një kopsht me pemë, pa zënë tokat e bukës? Nuk na mungon asgjë. Por kjo kërkon punë dhe dituri, kërkon që pema të ujitet, të plehërohet, të krasitet, të mbrohet nga sëmundjet. Por a mund t'i bëjmë këto? Mundet. Ne kemi bërë gjithë këto vepra. Ky popull e çliroi vendin e tij vetë, me armët e tij dhe me ato armë që ua rrëmbeu armiqve dhe i mundi ata. Si të mos përballojë ai kushtet atmosferike ose mentalitetet e prapambetura të njerëzve edhe në çështjen e pemëtarisë? Me këtë bindje e gjithë Partia iu përvesh punës, dha

udhëzimet e para dhe tha: «Në qoftë se do të mbjellim një pemë këtu e një pemë atje, kështu, vëllezër, do të na i grijnë dhitë dhe asnjëherë s'do të kemi gjë në vijë. Prandaj, në qoftë se duam të kemi pemë me bollëk, duhet të krijojmë blloqe në kooperativa e në ndërmarrje bujqësore dhe të përgatitim njerëz të specializuar, njerëz me kulturë për pemëtarinë». Pemëtarinë nuk mund ta bëjnë njerëz pa kulturë, sepse fidani i vogël është si kalamani që duhet të rritet me shumë kujdes. Ti rritim kudo fidanët si ai bahçevani i mirë; që kur fillon të formohet burbuqja të interesohemi për zhvillimin e saj. Ka një shkencë të tërë që merrret me këtë degë të rëndësishme të bujqësisë. Pema është një qenie e gjallë. Ashtu si në dejtë tanë lëvrin gjaku, në trupin e bimëve lëvrin limfa. Edhe bimët kanë «damarrët» e tyre, kanë «këmbët» e veta. Po nuk punove, nuk ha, dhe po të mos hash, as nuk punon, as jeton dot. Kështu është edhe me bimët e pemët: po nuk u hodhe në rrënjë ushqim që t'u përshtatet atyre dhe tokës, bima dhe pemët nuk zhvillohen dhe atëherë nuk ka prodhim, nuk ka as fruta.

Mjekët e ndihmojnë njeriun për t'u mbrojtur e për ta shëruar nga sëmundjet. Janë dashur breza të tërë njerëzish, që nga Hipokrati dhe deri tani, që mjekësia të bëjë përparime të mëdha. Gati për të gjitha sëmundjet është gjetur shërimi, vetëm për kancerin jo. Jam duke lexuar këto ditë librin e një kancerologu të madh francez titulli i të cilit është «Shpresa». «Ka lindur shpresa e shërimit nga kanceri» thotë ai dhe tregon se ka filluar shërimi me sukses i disa llojeve të leucemisë, kancerit të gjakut. Në gjakun tonë ka disa

«luftëtarë», të cilët me të «kuptuar» se vjen mikrobi, thotë ai, i sulen me furi (siç u sulëm ne kundër push-tuesve italianë e gjermanë) dhe e asgjësojnë. Këta «luftëtarë» janë globulat e bardha të gjakut, janë leukocitet, një ushtri e përgatitur nga natyra në gjakun e njeriut për të mbrojtur organizmin e tij.

Ashtu si njeriu, edhe bimët kanë sëmundjet e tyre, por ne ua dimë kohën kur sëmuren. Dimë, për shembull, kohën kur hyn krimbi në mollë, kur rrezikon kanceri ullirin etj. Bile, po punohet që të krijohen dhe izotope për t'i shëruar ullinjtë dhe pemët e tjera nga kanceri.

Partia arriti në përfundimin se në vendin tonë ishin të gjitha mundësitë që të krijojmë një pemëtari në blloqe, në të gjithë vendin, veçse për këtë qëllim duhej krijuar armata e njerëzve të mësuar për pemëtarinë. A mund të themi se e kemi krijuar në këtë armatë të madhe? Jo, nuk e kemi krijuar akoma. Kemi disa njerëz që janë shumë të interesuar e shumë të apasionuar për pemëtarinë, por ka të tjerë që s'janë kështu. Ne nuk duhet të kënaqemi me kaq sa kemi bërë. Duhet të krijojmë një armatë tjetër akoma më të madhe për këtë degë të ekonomisë bujqësore. Dhe armata e madhe nuk përbëhet vetëm nga specialistët. Ki sa të duash oficerë të zotë, po nuk e pate ushtarin të stërvitur si duhet, në bazë të Artit Ushtarak të Luftës Popullore, ushtria nuk mund të jetë në nivelin që kërkon detyra e madhe e mbrojtjes së atdheut. Që të sigurohet mbrojtja e vendit duhet që e gjithë ushtria të zotërojë artin tonë ushtarak. Kështu është edhe në çdo sektor tjetër të jetës së vendit, kështu është edhe për pemëtarinë.

Ju të gjithë e dini fare mirë se ç'suksese të mëdha ka arritur vendi ynë në të gjitha degët e bujqësisë. Rendimentet që marrim tani në bimët bujqësore janë të mira, por këto s'na kënaqin, se mundësitë i kemi për rendimente akoma më të mëdha.

Le të vijmë prapë te pemëtaria. Në të gjitha ato vende kodrinore, ku nuk mund të mbjellim bimë të tjera, siç janë drithërat, bimët industriale apo perimet, por që janë të përshtatshme për pemëtarinë, t'i përvishemi punës dhe të mbjellim sa më shumë pemë. Të bëjmë përpjekje që të kemi lloj-lloj frutash që janë të shijshme në të ngrënë e të nevojshme për shëndetin e popullit, lëndë e parë për industrinë tonë të lehtë e ushqimore, por të kërkuara edhe për eksport. Ç'nuk prodhon ky vendi ynë i mrekullueshëm! Çdo gjë prodhon. Vetëm banane nuk bën. U përpoqëm që t'i mbjellim edhe bananet në bregdet. Sollëm deri edhe nga Indonezia disa shokë për të na ndihmuar në kultivimin e kësaj peme, në atë kohë kur Partia Komuniste e Indonezisë ishte akoma e fortë, por nuk na u zhvilluan.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Bëjmë edhe pa banane.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë thotë Nexhmija, pa banane bëjmë, por pa vreshta, pa agrume, pa ullinj e të tjera si këto nuk bëjmë dot. Vetëm se, për të marrë prodhime të mira prej tyre, duhet të punojmë me mend, t'i mbjellim pemët në bllok dhe në mënyrë të sistemuar, duke përcaktuar mirë tokat që u përshtaten llojeve të ndryshme të tyre; të shohim pra, se cilat janë më me vlerë për të gjitha ato komponente që thashë dhe jo të mbillen më kot. Atje ku mbin arra, të mbje-

llim arra; atje ku mbin gështenja, të mbjeilim gështenja që të hajë populli, por edhe që të eksportojmë. T'i bëjmë gështenjat me sheqer, siç i bënin «miqtë» e huaj, që i blenin te ne, i sheqerosnin ca dhe i ambalazhonin me pak kartë të bukur dhe pastaj ua shitnin vendeve të tjera deri në Australi me markën e tyre, por me pesëfishin e çmimit të blerjes nga ne. Por ato që shitnin ata si mallin e tyre, ishin gështenja nga të Tropojës sonë, ore vëllezërit e mi të dashur!

Ne duhet ta vazhdojmë punën me ritme akoma më të mëdha për zhvillimin e pemëtarisë. Këtu te ju të zgjidhen varietetet më të mira të portokalleve. «Po ja, i kemi zgjedhur», mund të më thotë ndonjëri. I kemi zgjedhur, por ka akoma për të zgjedhur, se kjo punë nuk ka anë e fund. Atëherë si t'i zgjedhim? Specialistët tok me punëtorët e agrumeve nëpër vende të posaçme të bëjnë kombinime me llojet e portokalleve që kemi ne këtu dhe do të shikojmë se jo 1, por 21 lloje të tjera të reja mund të krijojmë ne dhe të cilësisë së mirë. Po çfarë kërkojmë ne për portokallet? Ëmbëlsinë, shpejtësinë e pjekjes, të jenë plot me lëng, të mos thahen, të ruhen edhe në dimër, që populli të ketë agrume gjatë gjithë vitit. Përveç këtyre të kemi t'u shesim edhe të tjerëve, të eksportojmë, sepse një gjë e tillë është në dobi të ekonomisë sonë.

Nga kriza që ka shpërthyer, bota po vdes për bukë, vëllezër dhe motra. Megjithëkëtë, kudo në vendet e tjera ka dhe njerëz të klasave të pasura që kërkojnë fruta. Prandaj, edhe ne të prodhojmë që t'ua shesim dhe sa më shumë të eksportojmë, aq më mirë është për ne, sepse kështu do të sigurojmë devizë që të blejmë

ato makineri që akoma nuk i bëjmë dot vetë. Ne do të prodhojmë makineri edhe në vend; do të ndërtojmë edhe fabrika çimentoje, sode etj. do ta zgjerojmë e do ta forcojmë vazhdimisht industrinë tonë. Traktorin e shumë makineri të tjera kemi filluar t'i prodhojmë qysh tani, por do të ketë edhe disa pajisje e makineri të komplikuar që do të detyrohemi t'i sjellim nga jashtë. Por me se t'i sjellim? Këto do t'i sjellim me të ardhurat që do të sigurojmë nga eksporti ynë, nga eksporti i mineraleve, por edhe nga eksportimi i prodhimeve bujqësore. Por, që të eksportojmë, duhet të prodhojmë me bollëk, që të na dalin për vete e të kemi dhe për të shitur jashtë. Jo vetëm kaq, por që të shiten ato duhet të jenë edhe të cilësisë së lartë.

Vera që eksportojmë ne ka marrë famë në botë. Pse e ka marrë këtë famë? Se ne shqiptarët e bëjmë verën të kulluar. Verën tonë të kulluar e marrin të huajt, i futin ujë dhe e shesin në treg, duke mashtruar njerëzit, kurse ne nuk jemi hileqarë, ne njohim dhe respektojmë ndershmërinë.

Partia porositi që të mos u bini ullinjve me shkop kur vilni prodhimin, sepse kështu kjo pemë nuk prodhon vitin e ardhshëm. Këtë ca e dinë, ca nuk e dinë. Specialistët e dinë se ulliri lind pikërisht te sythi i vogël i degës, prandaj, në qoftë se i bie me dru, sythi bie tok me degën e ullirit dhe vitin tjetër nuk ke prodhim ullinjsh. Prej kësaj është bërë si zakon të thuhet se kështu e ka ulliri: një vit bën e dy nuk bën. Jo, ulliri s'e ka aspak zakonin kështu; ulliri e ka zakon të bëjë çdo vit dhe do të bëjë çdo vit në qoftë se do të trajtohet nga ne si duhet.

«Portokalli po thahet nga të flohtit, more shoku Enver», mund të thotë ndonjëri. Jo, nuk thahet portokalli nga ngrica, në qoftë se merren masa për ta shpëtuar prej saj. Ç'bëjnë në disa vende njerëzit në raste të tilla? Shpërndajnë kashtë në të katër anët e plantacionit dhe, kur shikojnë se temperatura bie nën zero gradë, atëherë i vënë zjarrin kashtës, tymi dhe ngrohtësia e së cilës ngrihet lart e shpërndahet mbi pemë, pengon ngricën dhe kështu portokallet shpëtojnë. Ju këto i dini, dhe kot që të zgjatem, por desha të vë në dukje se agrumet e ulliri janë me rëndësi të madhe për ekonominë tonë, prandaj t'i zhvillojmë ato si duhet dhe të punojmë fort për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të bujqësisë, për pemëtarinë.

Kur të vij herë tjetër këtu, dëshiroj të shoh të mbushura me pemë edhe ato kodra përtej që kanë mbetur akoma të zhveshura. Ato që janë mbjellë në Vrinë e në Stjar, të cilat i kisha parë më përpara, më kanë thënë që janë mirë. Sa për këtu, nuk mund t'ju them që s'janë mirë; e vërteta është që më pëlqyen, m'u bë zemra behar, prandaj ju uroj: Ju lumtë! Ndonjë specialist edhe mund t'ju kritikojë për ndonjë të metë që konstaton, por ju mos u hidhëroni nga kritika, se kjo ju bën mirë që ta përmirësoni punën më tej.

Si të duken ty Nexhmije? Po pyes Nexhmijen se gratë kanë gusto më tepër.

SHIOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të mira duken.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem kur shoh këtu shumë gra punëtore dhe pikërisht kjo është çështja e dytë që desha të theksoja, çështja e punëtorëve të ndërmarrjes bujqësore. Drejtori i ndërmarrjes :suaj,

shoku Theodhori¹, tha se këtu, për Ksamilin, mungojnë mbi 40 për qind e fuqisë punëtore. Duhet të mendojmë edhe për të tanishmen, po edhe për të ardhmen. Ku do t'i gjejmë ne gjithë këta njerëz? T'i marrim nga kooperativa e Çukës? Por ajo ka nevojë për vete. T'i heqim nga kooperativa e Markatit? Por edhe ajo ka nevojë për veten e saj. Si do ta plotësojmë atëherë këtë fuqi punëtore? Do ta plotësojmë me brezin e ri, me djemtë dhe vajzat tona. Ata duhet ta kuptojnë se Shqipërinë lypset ta duash jo vetëm në asfalt, por edhe në baltë, pse, siç ka thënë poeti ynë, Çajupi, balta (e mëmëdheut) është më e ëmbël se mjalta.

Tashti po hyj edhe në një çështje me rëndësi familjare, në atë të lindjes së fëmijëve. Unë dhe Nexhmija kemi bërë tre fëmijë. Djemve dhe vajzës sime u kam thënë: gjithsecili tre fëmijë duhet t'i bëjë medoemos, por mos qëndroni në këtë numër. Derisa unë t'i kem sytë hapur, dua të kem në divanin e shtëpisë dymbëdhjetë kalamanë. Një nga djemtë e mi ka tashti dy fëmijë; djali tjetër dhe vajza kanë nga një. Mirëpo ka disa çifte që tremben nga fëmijët e shumtë. Pse të trembemi nga shtimi i njerëzve në socializëm? Ne kemi e do të kemi çdo gjë dhe më me bollëk. Vendi ynë është pjellor. Ai mund të ushqejë akoma miliona njerëz. Prandaj të na lindin sa më shumë fëmijë, se vend për të punuar e për të jetuar ka kudo te ne.

Kur ishim të vegjël, ç'është e vërteta, kemi vuajtur shumë, se s'kishim as bukë të hanim; bile, ka pasur edhe raste kur në vend të bukës hanim krunde, prandaj

1. Theodhori Klimi.

popullit tonë i kishte hyrë frika në palcë për bukë. Atëherë, mëmat tona na mësonin: «Kur të uleni të hani, putheni bukën, biro; kur të ngriheni mos lini asnjë thërrime në sofër, por i mblidhni, i bëni kokodashe dhe i futni në gojë». Por tash duhet të ndryshojë dhe ka filluar të ndryshojë mentaliteti për bukën dhe për punën, se Partia e ka ngritur nivelin politik dhe ideologjik të popullit.

Rinia ka kuptuar çështjen kryesore, detyrën që ka ajo për sigurimin e së ardhmes së Shqipërisë. Ajo duhet ta marrë stafetën e brezit tonë. Por kjo stafetë duhet të merret dhe të çohet gjithnjë më lart. Ka punë në fabrika, ka punë në qytete, por ka më shumë punë në fshat. Partia e ka theksuar se bujqësia është një bazë e fortë për ekonominë tonë dhe këtë bazë duhet ta bëjë pjellore. Sa më pjellore t'i bëjmë fushat, malet, kodrat dhe luginat tona, aq më e fortë do të bëhet Shqipëria. Po kjo kërkon punë. Kush e bën forcën e një vendi? E bëjnë njerëzit me punën e tyre, e bën ekonomia e zhvilluar, e bën politika e drejtë, e bën ideologjia e qartë marksiste-leniniste. Prandaj të gjitha këto, i madh e i vogël, duhet t'i ketë kurdoherë parasysh. Rinia, në radhë të parë, duhet ta kuptojë këtë thellë dhe të vejë me dëshirë të madhe në fshat.

Fshatrat tona janë të mrekullueshme dhe ato do të bëhen edhe më të bukura e më të begatshme. Shikoni! Këtu, në Ksamil, kanë ardhur nga shumë rrethe e kra-hina të vendit, prandaj pushteti u ka ngritur ndërtesa të bukura ku të banojnë. Ju lumtë juve që keni ardhur nga Korça e nga Devolli! Nuk është vend i varfër Devolli për të jetuar, por ju erdhët këtu, se kështu ju tha

Partia dhe ju e dëgjuat fjalën e saj, se jeni të bindur që Partia mendon vetëm për të mirën tuaj.

Në Ksamil punohet si në një kopsht të madh e jetohet si në vilexhaturë, si në një vend pushimi. Po a ka vend më të bukur se këtu? «Po pse, të gjitha vendet e Shqipërisë kështu janë, more shoku Enver», mund të thotë dikush. Kjo është e vërtetë, por në Ksamil ka një bukuri të veçantë. Edhe unë them se çdo fshat ka bukurinë e vet. Edhe mali ka bukurinë e vet me pyjet që rrit, me borën aq të shëndetshme dhe me drurë frutorë që ne duhet t'i shtojmë. Kudo, në çdo fshat, ka jetë, ka gjallëri, ka biblioteka, ka shkolla nga të katër anët, ka shtëpi e vatra kulture, ka njerëz të ditur, mësues, agronomë, mjekë, mami; ka dispanseri, spitale, çerdhe, kopshte fëmijësh, dyqane e çdo gjë tjetër të nevojshme për jetën e njeriut. Vetëm asfalt nuk ka. Por populli ynë është dashuruar kurdoherë pas tokës e jo pas asfaltit. Rroftë mëma tokë, mëmëdheu, që aq bukur e ëmbël i ka kënduar poeti i madh i Rilindjes, Naimi ynë!

Të rinjtë, me atdhedashurinë që i karakterizon, jo me qindra, por me mijëra, duhet t'i përvishen punës, të lidhen e të ndërtojnë fshatin tonë socialist, të ngrenë begatinë e kulturën e tij ashtu si nuk ka qenë kurrë. Gjithë Partia, Fronti, organizatat e tjera të masave, baballarët e nënat, t'i mësojnë vajzat e djemtë të jenë trima, të guximshëm, me pikëpamje të re për Shqipërinë socialiste, për të ardhmen e saj. I riu ose e reja të mos sillen kot, fjala vjen, rreth Qafës së Pazarit të Gjirokastrës, por të shkojnë në Mashkullorë, në Lunxhëri, se s'ka më të bukura se fshatrat e kësaj krahine.

Të bukura janë edhe fshatrat e Dropullit, të Delvinës e të Rrëzomës. Më tej, të Skraparit, Dibrës, Shkodrës e të Tropojës. Po ata që punojnë atje nuk janë që të gjithë vëllezërit dhe motrat tona?

Lumturia ndërtohet edhe në fshat. Kjo nuk do të thotë se lumturia nuk është edhe në qytet, por qyteti do të mbajë aq sa mundet. Në qoftë se në një familje ka disa të rinj, ndonjëri prej tyre do të shkojë medemos në fshat. Një grua kishte bërë 23 fëmijë. Ti je tri herë heroinë, i thashë unë. «Marr edhe ndihma nga shteti, më tha ajo, se nuk mund t'i ushqej dot të tërë». Për raste të tilla ndihma nuk duhet kursyer.

E kisha fjalën te mungesa e krahëve të punës në fshat, ato duhen plotësuar. Edhe nevojat për punëtorë për Ksamilin dhe Vrinën duhen plotësuar, se ndryshe nuk realizohen detyrat e planit, mbasi janë krijuar deficite. Këto deficite duhet të mbyllen, se prania e tyre është e dëmshme dhe me pasoja për ekonominë tonë.

Populli, nën udhëheqjen e Partisë, bën përpjekje që të ketë të hajë e të pijë, të vishet e të mbathet dhe çmimet të mos ngrihen. Por në qoftë se nuk prodhohet, atëherë ç'do të bëhej? Mallra do të kishte pak, çmimet do të ngriheshin dhe paraja do të zhvleftësohej. Qeveria nuk nxjerr para pa pasur prodhime. Jashtë, në vendet kapitaliste e revizioniste, ndodh fenomeni i shtimit të tepëruar të sasisë së kartëmonedhës në qarkullim, fenomeni që e quajnë inflacion. Si pasojë e inflacionit ngrihen çmimet, vështirësohet jetesa dhe ata që e pësojnë më tepër janë punëtorët, të cilët, në ato vende ku ndodhin këto, bëjnë greva. Partitë revizioniste u

thonë punëtorëve: «Mos u qani kot, se rrogat tuaja u shtuan 5 për qind ose 10 për qind». Këto parti nuk bëhen merak, se pas 5 ditësh, çmimet ngrihen përnjëherë 30 për qind dhe gjendja e punëtorëve keqësohet edhe më shumë.

Socializmi hap rrugë të gjera për progresin, kurse imperializmi dhe socialimperializmi frenojnë; ata sjellin varfërinë e shtypjen për punonjësit. Prandaj Partia jonë ka luftuar dhe lufton kundër imperializmit, kundër socialimperializmit, kundër kapitalizmit botëror. Ne kemi luftuar dhe do të luftojmë deri në fund, deri në fitoren e revolucionit socialist kudo në botë. Sa më e fortë, më e drejtë dhe më e ashpër të jetë lufta jonë dhe sa më të fortë ta kemi ekonominë, aq më të fortë do të jemi edhe ne.

Ne, shqiptarët, kemi punuar e kemi luftuar, do të luftojmë e do të punojmë kurdoherë me djersën e ballit dhe ndershmërisht. Të drejtë kemi qenë dhe të drejtë jemi. Të vërtetën e themi kurdoherë haptas; të vjen mirë, s'të vjen mirë, je kush je, qofsh shëndoshë! Kjo e ka bërë Shqipërinë të fortë, kjo ua ka ngritur lart emrin shqiptarit dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Këto janë virtyte të larta të popullit tonë. Kapitalizmi dhe revizionizmi këto virtyte i shkelin me këmbë. Por në botë nuk ka vetëm kapitalistë e revizionistë, këta janë pakica, sepse kudo ka me miliona e me qindra miliona njerëz të ndershëm dhe luftëtarë për të vërtetën, por që nuk kanë akoma pushtetin në dorë. Këta luftëtarë të lirisë kemi miq ne, shqiptarët, prandaj i duam dhe ata na duan. Ata na mjaftojnë dhe, tok me

ta, ne jemi të fortë, kurse kapitalistët janë të dobët. Hileqarin, mashtruesin, kusarin e shtypësin nuk i do njeri.

Rreth 19 vjet më parë kemi ardhur në këtë vend me renegatin e madh sovjetik, Nikita Hrushovin. Ai nuk erdhi këtu për të parë portokallet, as për pemëtarinë, as për ullirin, që është pemë që simbolizon paqen, por që të shikonte liqenin e Butrintit. Tek po rrinim, ai tha: «Ç'janë këto gjermime që bëhen këtu, në Butrint? Këto janë gjëra të vdekura! Ç'ju duhen këto?».

«Na duhen, i thashë unë, se janë pjesë e kulturës së madhe të njerëzimit».

«More, çfarë kulture?! Këtu duhet tjetër gjë, tha ai. Ç'thua ti? iu drejtua Hrushovi ministrit sovjetik të Mbrojtjes, mareshalit të Bashkimit Sovjetik Rodion Malinovskit. Sikur të bëjmë këtu një qendër për nëndetëse?».

«Oh, tha mareshali, *oçenj harasho!*»¹

Por të zotët e shtëpisë mendonin ndryshe dhe nuk lejonin dhe nuk lejuan që në truallin tonë të vendosnin të huajt. Të zotët e shtëpisë nuk lejonin dhe nuk lejuan që portet e tyre të bëheshin qendra të anijeve luftarake kundër gjëtonëve tanë dhe popujve miq.

Siç e dini, pas një viti, punët u acaruan keq. Po pse u acaruan? U acaruan se ata ishin revizionistë, imperialistë. Ne i kishim njohur ata me kohë. Stalini i kishte njohur akoma më përpara se ne dhe u kishte thënë në fytyrë: «Ju do ta shisni Bashkimin Sovjetik tek impe-

1. Rusisht: shumë mirë.

rializmi!» Dhe doli ashtu siç parashikonte Stalini. Ne këta njerëz i njohëm edhe më mirë atëherë kur u lidhën me renegatin Tito.

Populli ynë është një popull i durueshëm. Ka disa «zhapinj» sot në Evropë, që vetëquhen «parti komuniste», të cilët thonë se të tjerët i kanë njohur më përpara hrushovianët që kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin. Jo, jo, këto janë gjepura. Renegatët hrushovianë i njohu dhe i demaskoi e para Partia e Punës e Shqipërisë.

Revizionistët sovjetikë kishin për qëllim që Shqipërinë dhe popullin shqiptar t'i robëronin. Por nuk u ndezi. Atëherë filluan shantazhet politike e presionet ekonomike kundër vendit tonë, por Partia e Punës e Shqipërisë u qëndronte këtyre me gjakftohtësi dhe u përgjigjej me vendosmëri. Partia jonë e Punës nuk mashtrohej as nga buzëqeshjet hipokrite të hrushovianëve, as nuk trembej nga kërcënimet e shantazhet e tyre. Ajo u tha Mikojanit dhe Hrushovit: «Ne kemi mosmarrëveshje ideologjike dhe politike me ju; në qoftë se vazhdoni kështu, në këtë rrugë dhe me këto metoda antimarksiste, atëherë ne do t'ju luftojmë!». Por ata ishin të atillë arrogantë dhe të atillë megalomanë, të gatuar me ndjenjat e shtetit të madh, sa për ne mendonin: «Ç'janë këto miza xanxare që pretendojnë se mund të na pickojnë?». Partia e Punës e Shqipërisë u tha atyre: «Shikoni, mos ngatërroni çështjet ekonomike dhe shtetërore me çështjet ideologjike dhe politike, se po i ngatërruat, aq më keq do të jetë për ju». «O... , hapi sytë Mikojani, duke thënë: Keq për

ne?!». «Po, po, keq për ju», ia kthyem ne. «Po ju, tha ai, do të vdisni për bukë». «Jo, nuk do të vdesim kurrë për bukë», iu përgjigjëm ne. «Ju do të shiteni tek imperialistët për 30 aspra», e mori fjalën Hrushovi. «Nuk është shitur kurrë Shqipëria, as shqiptarët tek imperialistët, por do të shiteni ju, u thamë ne. Partia e Punës e Shqipërisë ka të drejtën e saj, ka mendimet e veta, pavarësisht se ju mendoni ndryshe».

Tradhtarët revizionistë sovjetikë vazhduan rrugën e tradhtisë dhe menduan se ne, shqiptarët, do të ulnim kurrizin. Ne jo vetëm s'e ulëm kurrizin, por ishim të vendosur të mbronim ato parti dhe ato shtete që do të sulmoheshin e do të goditeshin nga revizionistët hrushovianë. Dhe këtë Partia e Punës e Shqipërisë e bëri me vendosmëri e guxim, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, duke u vënë nën zjarrin e gjithë revizionistëve modernë, me revizionistët sovjetikë në krye. Dhe nga kjo luftë Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar dolën fitimtarë, më të fortë e më të kalitur se kurrë.

Në vazhdim të bisedimeve në Moskë, hrushovianët na kërcënuan se ne do të ishim shkaktarët e prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, në qoftë se do të flitnim në mbledhjen e 81 partive. Por ne u thamë se «askush nuk mund të na privojë nga e drejta jonë për të shprehur lirisht pikëpamjet që kemi në një mbledhje ndërkombëtare. Ju po i prishni marrëdhëniet dhe për këtë mbani përgjegjësi të plotë». U thamë, gjithashtu, se duhet të respektonin kontratat e nënshkuara nga të dyja palët, «ndryshe ju do të turpëroheni». «Ne

do të turpërohem. . .?!», pyeti Mikojeni. «Do të turpëroheni që ç'ke me të, i thamë ne. Neve s'na e hidhni dot duke na thënë se «ne s'i prishim kontratat». Formalisht këto mund të mos i prishni, por mund të mos i respektoni dhe të mos i realizoni».

Dhe, në fakt, ata kështu vepruan: shkuan deri në prerjen e marrëdhënieve diplomatike.

Ju tashmë e dini se ç'pësoi Bashkimi Sovjetik revizionist. Ai është diskredituar, s'është më një shtet marksist-leninist, por revizionist, kapitalist, socialimperialist. Dhe këtë sot e ka marrë vesh gjithë bota. Për ta demaskuar këtë murtajë, Partia e Punës e Shqipërisë dha kontributin e vet. Prandaj lodra dhe skerco me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë kurkush nuk mund të bëjë.

Populli shqiptar është një popull i drejtë, është një popull që s'do t'i bëjë keq askujt, përveç armiqve të njerëzimit dhe të marksizëm-leninizmit, që është i vendosur t'i demaskojë pa mëshirë. Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës dëshirojnë të rrojnë në një miqësi të ndershme e të singertë me të gjithë ata që luftojnë për liri e pavarësi, për demokraci dhe socializëm. Me marksistë-leninistët ne do të rrojmë në vëllazëri dhe në shoqëri të çeliktë. Edhe me shtetet e tjera që nuk janë socialiste, por që nuk kanë synime armiqësore ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shteti shqiptar dëshiron të ketë marrëdhënie normale, miqësore, kulturore e tregtare.

Spekulimet mbi qëndrimet tona të drejta marksiste-leniniste në politikë, në ekonomi etj., nuk pinë

ujë. Ne për çështjet politike dhe ideologjike kurrë nuk mund ta mbyllim gojën. Të tjerët mund të mendojnë si të duan, por Partia jonë qëndron e patundur në ideologjinë e saj marksiste-leniniste. I pëlqen ose nuk i pëlqen ndokujt ky qëndrim, neve aq na bën, tymi ynë të shkojë drejt. Kush mendon se Shqipëria, si vend i vogël, mund të merret kollaj nëpër këmbë, ai gabohet rëndë dhe ky do të ishte një gabim fatal për të.

Në këtë botë të turbullt, por revolucionare, Partia jonë është një kështjellë e çeliktë. Popujt e botës, proletariati, marksistë-leninistët, kudo që janë, aprovjnë dhe mbështetin vijën dhe qëndrimin e drejtë, heroik, të ndershëm dhe të guximshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Prandaj, vëllezër dhe motra, me besim të madh në forcat tona, me besim të madh në rrugën e drejtë marksiste-leniniste në të cilën na udhëheq Partia, të ecim përpara, të punojmë, të krijojmë, të derdhim djersë, të bëjmë sakrifica dhe të jemi vigjilentë e të gatshëm, kurdoherë vigjilentë e të gatshëm. Fitoret e arritura dhe socializmi që po ndërtojmë e që po ecën përpara në vendin tonë, duhen mbrojtur. Po të zuri gjumi, të mori lumi. Por gjumi nuk na zë aq kollaj, ne, shqiptarët; leshkot i zë gjumi. Ne i kemi sytë të mprehtë, shpatën të ngjeshur fort në brez, gishtin e kemi në çark, kazmën në dorë dhe vendin e kemi mbushur me uzina, fabrika, hidrocentrale, traktorë etj. Akoma më tepër do të ndërtojmë në të ardhmen dhe akoma më shumë e më mirë do të prodhojmë e do të jetojmë. Kjo është vija e Partisë sonë të lavdishme

të Punës marksiste-leniniste, e ndërtuar mbi bazën e
mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Rroftë Partial

Rroftë populli ynë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë, me
shkurtime, në gazetën «Zëri
i popullit», nr. 14 (9247),
28 mars 1978*

*Botohet i plotë, sipas shëni-
meve të mbajtura në këtë
miting, që gjenden në AQP*

KULTURA E POPUJVE DUIHET STUDIUAR ME SERIOZITET E NDERSHIMËRI

Nga biseda gjatë vizitës në Butrint

26 mars 1978

Tani që erdhëm këtu, në Butrint, dhe po bisedojmë me ty, shoku Dhimosten¹, emri yt më kujtoi diçka nga historia e lashtë greke. Aleksandri i Maqedonisë u dërgua nga babai i tij, Filipi, që të merrte pjesë me kuajt e të atit në një olimpiadë në Athinë. Sipas rregullit, ishte aeropagu ai që do të vendoste, nëse mund të merrte pjesë ose jo në këtë olimpiadë i biri i Filipit.

Oratori i madh i Athinës, një nga kundërshtarët më të rreptë të maqedonasve, Demosteni, u ngrit e tha në mbledhje: «Djali i Filipit nuk duhet të marrë pjesë në olimpiadë». Propozimi i tij, si u votua, u aprovua.

Atëherë u ngrit Aleksandri i ri, që në atë kohë mund të ishte rreth 17 vjeç dhe mbajti një fjalim të zjarrtë. Në fjalën e tij ai e atakoi Demostenin, për të cilin tha: «Ç'e dëgjoni këtë, ky është njeriu më i keq. Ky, që i ka gishtat të mbushur me unaza, nuk është

1. Dhimosten Budina, në atë kohë arkeolog në bërthamën arkeologjike të Sarandës.

qytetar i denjë i Athinës». Në përkrahje të Aleksandrit u ngrit edhe shoku i tij i ngushtë Efestioni. I inkurajuar prej tij, Aleksandri shtoi: «Në qoftë se unë do të lejohem të marr pjesë në këtë olimpiadë, do të bëj fli 100 që në altarin e Delfit». Të dhjetë gjyqtarët, të lëkundur, njoftuan se do të tërhiqeshin më vete për ta pleqëruar edhe një herë këtë çështje. Kur u kthyen, në qoftë se nuk gabohem, deklaruan se vendimi i parë, që kishin marrë, sipas të cilit Aleksandri ndalohej të merrte pjesë në olimpiadë, nuk ishte i drejtë, prandaj vendosën në favor të Aleksandrit. Demosteni, i turpëruar nga dështimi, u ngrit, u largua nga mbledhja dhe u fut qosheve.

Nga je ti, shoku Dhimosten?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Nga Korça.

Butrinti përfshihej në Kaoninë antike, që shtrihej në territorin e Sarandës e të Gjirokastrës. Në këtë territor banonte një nga fiset kryesore të Epirit, kaonët.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk fillon këtu territori i Molloisë?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Mollosia shtrihej nga Përmeti, shkante në malet e Pindit dhe vazhonte tutje nga Greqia.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë gjetur gjë objekte me vlerë atje?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Janë gjetur gjëra të rastit, se nuk kemi akoma gërmime sistematike.

SHOKU ENVER HOXHA: Po te vendi ku shtrihet akropoli?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Atje është gjetur një thesar në një vend ku depozitohej ari i qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po monumentet arkitekturore a kanë qenë këtu të asaj natyre si në Athinë?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, akropoli i Athinës ka karakter tjetër; ai është i mbushur me tempuj, kurse qytetet ilire kanë pasur edhe funksionin e mbrojtjes.

Me organizimin e ri që është bërë tani për arkeologjinë, në rrethin e Sarandës është krijuar një bërthamë shkencore, e cila po merret me studimin e këtyre problemeve.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa veta jeni në këtë bërthamë shkencore?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Tani për tani jemi tri veta.

SHOKU ENVER HOXHA: Vijnë këtu studentët e rinj?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Vijnë gjatë ekspeditave verore. Këtu marrim edhe studentë e mësues kur bëjnë punën në prodim.

SHOKU ENVER HOXHA: U rekomandoni atyre që t'i lexojnë artikujt dhe dokumentet, që janë botuar për këtë qytet antik apo ata vijnë këtu për të vrarë kohën, me duar në xhepa?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, ata i marrin e i lexojnë këto materiale. Ne kemi krijuar edhe një shoqatë arkeologësh.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të më thuash çfarë studimesh keni kryer gjatë këtyre dy vjetëve, që krijuat bërthamën shkencore, dhe nga e filluat punën për restaurimin ose zbulimin e mëtejshëm të Butrintit?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ne e kemi për-

qendruar punën në studimin e sistemit fortifikues të qytetit. Deri tani kemi zbuluar një pjesë të mirë të murit. Me forcat e rrethit kemi organizuar edhe një sesion shkencor.

SHOKU ENVER HOXHA: Kanë ndonjë ngjashmëri monumentet e Butrintit me ato të ndonjë qyteti tjetër të zbuluar, që i korrespondon pak a shumë së njëjtës periudhë historike, për shembull, shekullit të 2-të, të 3-të ose të 4-t të erës sonë? E kam fjalën nëse ju, në bazë të studimeve të disa qyteteve të së njëjtës epokë, qoftë këtu, qoftë në Greqi, keni mundur të vëreni, ta zëmë, se afër baptiserit në një qytet tjetër ndodhet kjo gjë, afër teatrit ndodhen këto ose ato monumente arkitekturore si në Butrint e kështu me radhë. Në rast se po, a janë shkruar këto të tëra që të shërbejnë si orientime për studimet në perspektivë?

Në lidhje me studimet, siç e dini, sot është arritur të bëhen vëzhgime edhe nëpërmjet aerofotografisë, duke marrë fotografi nga avionët. Në këtë mënyrë, duke qëndruar këtu, në kala, ne mund të shohim, për shembull, se ku janë tumat, ku janë rrugët e kodrinat, ku janë ato ose këto monumente arkitekturore. Konkretisht, e kisha fjalën se a keni arritur ju të bëni njëfarë rilevimi topografik pak a shumë të përgjithshëm rreth mureve që rrethojnë Butrintin?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ne tani për tani kemi arritur të bëjmë një rilevim topografik të thjeshtë.

Për sa i përket ngjashmërisë së Butrintit me qytetet e tjera, mund të thuhet se këtë e vërejmë, sidomos për periudhën e kulturës romake. Dhe kjo është e

shpjegueshme, se në shkullin e 2-të të erës sonë, në kohën e Augustit, Butrinti u kthye në koloni romake.

SHOKU ENVER HOXHA: Një poet francez thotë se, kur Mark Antoni doli në flotë dhe pa Kleopatren, në sytë e saj të bukur iu duk një det i gjerë me pika yjesh dhe me anijet që po iknin. Nga sytë e bukur të Kleopatres, thotë poeti, Mark Antoni parashikoi thyerjen e tij nga Augusti¹. Dhe kjo thyerje ka ndodhur në gjirin e Nartës.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Një ngjashmëri tjetër Butrinti duhet të ketë me qytetin romak, Pompein.

SHOKU ENVER HOXHA: E di ti që nga gërmimet arkeologjike, që janë bërë aktualisht në Pompei, kanë gjetur objekte të rëndësishme? Tashti, nga sa di unë, në Pompei kanë zbuluar monumente të mrekullueshme arkitekturore, disa statuja të mëdha. Domethënë Butrinti i ngjet Pompeit.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Natyrisht, Butrinti, përveç ngjashmërisë me qytetet e lashta të huaja, ka edhe veçoritë e qyteteve ilire.

SHOKU ENVER HOXHA: Në se konsistojnë këto veçori?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ne i kemi qytetet në kodra të thyera. Natyrisht që sistemi i hipodamit i periudhës helenistike nuk mund të zbatohet plotësisht këtu.

SHOKU ENVER HOXHA: Teatri i këtushëm është i stilit romak apo grek?

1. Këto shprehje shoku Enver i thotë frëngjisht.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: I stilit grek dhe i përket shekullit të 3-të para erës sonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Është teatër i vogël, por i bukur. Ky nuk është sa teatri i Delfit.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Megjithatë edhe ky ka bukurinë e vet.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ashtu është, ky është shumë i bukur. Po luani dhe demi, te porta e madhe, mos janë të kohës së qytetërimit të Mikenës?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, nuk kanë lidhje me Mikenën. Porta e madhe i takon shekullit të 4-t para erës sonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë Porta e Luanit nuk paska lidhje me qytetërimin e Mikenës. Mikena i përket qytetërimit të vjetër, bile më i vjetër nga helenizmi. Unë ju pyeta më tepër që ta kem sa më të qartë këtë çështje. Qytetërimin e Trojës e zbuloi gjermani Shliman, kurse Portën e Mikenës e ka zbuluar një anglez, emri i të cilit nuk po më kujtohet tashti.

Ti, Dhimosten, sigurisht, e di historinë e Shlimanit. Ky ka qenë konsull i Austrisë në Greqi dhe një homerist i pasionuar. Ai e donte Homerin dhe e dinte përmendsh «Iliadën» dhe «Odisenë». Një mëngjes vajti në një shkollë të Athinës për të parë se si mësonin nxënësit. Atë ditë në orën e letërsisë kishin mësim për «Iliadën». Mësuesi i letërsisë ngriti në mësim një vajzë të re e të bukur, e cila recitoi një pjesë të «Iliadës». Kur vajza e mbaroi së recituarit atë pjesë që i tha mësuesi, Shlimani e pyeti: «Di më tutje?». «Di», tha ajo dhe vazhdoi të recitonte shumë bukur.

Ky diplomat i pasur vajti në shtëpinë e vajzës dhe u tha prindërve të saj: «Unë jam një njeri i pasionuar për Homerin, që vajza juaj e reciton shkëlqyeshëm, prandaj ju lutem ma jepni atë për grua». Pasi u menduan, më në fund ia dhanë. Shlimani, tok me të, zbuloi Ilionin. Sa meritë ka Shlimani për këtë zbulim, po aq ka edhe gruaja e tij, e cila i mbante shënim të gjitha sa vërenin të dy bashkë. Ajo shkroi që në këtë vend gjetëm këtë objekt, në atë vend gjetëm këtë monument dhe, në bazë të përshkrimeve të «Iliadës», zbuluan të dy se ku ka qenë porta e madhe, ku hyri e ku doli Hektori etj. Kështu u zbuluan të tëra ato objekte që përmendte «Iliada», që gjer atëherë nuk qenë zbuluar.

A ka këtu rrepe?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Këtu ka më tepër frashër e dafinë, është vendi i kurorave.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, nuk është vendi i orakujve, ku mbillej rrapit.

Imagjinatë është ajo e dramaturgut të madh francez, Rasinit, që thotë se këtu gjetën gruan e Hektorit, Andromakën etj.?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ai nisët nga legjenda.

SHOKU ENVER HOXHA: Me sa duket, Rasini qenka frymëzuar nga Virgjili për këtu në Butrint.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Është edhe legjenda tjetër, po e Virgjilit, që thotë se, kur u shkatërrua Troja, trojanët udhëtuan për të themeluar një qytet të ri, një Trojë të dytë, duke kaluar brigjeve të Epirit. Ata, sipas zakonit, kishin marrë me vete edhe

një ka për ta bërë fli atje ku do të themelonin qytetin.

SHOKU ENVER HOXHA: Mos është koka e kaut në relievin që pamë, apo kjo nuk mund të thuhet pa u vërtetuar, se kjo legjendë është shumë e vjetër.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, ashtu është, shoku Enver, shumë e vjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Greqishten e vjetër dhe latinishten duhet t'i dini ju që merreni me arkeologjinë. Unë e di që kjo legjendë është shumë më e vjetër, por traditat e saj sikur vazhdojnë edhe më vonë.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Rrethi ynë, bashkë me Gjirokastrën, kanë afërsisht 25 qytete dhe kala të vjetra.

Unë kam gërmuar dhjetë vjet në qytetin e Antigonesë.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë vetëm fotografitë ia kam parë Antigonesë, kurse ti paske punuar atje 10 vjet. Shumë bukur!

Ju, shkencëtarët, arkeologët e të tjerë, kurdoherë duhet të mbani parasysh mësimet e Partisë, që çdo gjë ta përcaktoni drejt, me përpikëri, me objektivitet shkencor dhe të zhveshur nga ndjenja e shovinizmit. Kultura e popujve duhet studiuar me seriozitet e ndershmëri. Ajo çka është ilire, është ilire; ajo çka është romake ose greke, është romake dhe greke.

Kam lexuar një herë një shkrim për qytetin e Apononisë. Natyrisht, atje ka pasur edhe ilirë që kanë punuar, por kultura e këtij qyteti antik është romake. Kur themi që kultura është romake, kjo do të thotë që atje mund të kenë skalitur edhe romakët. Ky version s'ka përse të fshihet ose të mohohet. Koka e Demos-

tenit, e këtij filozofi e patrioti të shquar athinas, është punuar bukur e me mjeshtëri në mermer, por ne nuk dimë se kush e ka bërë atë. E kam fjalën që të mos deformohen faktet. Historia është histori dhe ajo nuk duhet shkëputur nga objektiviteti shkencor në studimin e ngjarjeve dhe të proceseve të zhvillimit shoqëror. Edhe ti i di mirë këto gjëra. Unë kam mësuar si diletant për kulturën e popujve të vjetër, që përfaqësohet edhe në monumentet e arkitekturës e në artet e tyre, kurse ti je specialist, prandaj duhet t'i mësosh ata që të vijnë për ndihmë, se në gërmimet arkeologjike nuk punohet me kazëm e lopatë, por, siç e the dhe vetë ti, me furçë, me thikë, me bisturi, ndryshe objektet e shumta e monumentet mund të gërvishten e të dëmtohen.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Butrintin nuk mund ta quajmë koloni greke, siç është parë deri tani ky qytet, sepse nuk ka asnjë të dhënë që ta vërtetojë këtë supozim.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjithë ata që s'ishin të kulturës helene, pavarësisht se kishin kulturën e tyre, grekët i quanin barbarë, domethënë të huaj. Në kohën për të cilën flasim, ne, këtej nga veriu, ishim barbarë për grekët.

Kultura greke ka qenë mjaft e zhvilluar. Të mos harrojmë se grekët e vjetër vunë themelet e shumë shkencave; ata ndihmuan mjaft në zhvillimin e kulturës botërore. Një tok fjalësh greke kanë hyrë e përdoren në shumë nga gjuhët e sotme të popujve të ndryshëm.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Fjala «barbar» nuk është përdorur nga grekët për të treguar shkallën

e ulët të zhvillimit kulturor të popujve të tjerë, por për të treguar se ata nuk ishin grekë, por të huaj. Borgjezia, për qëllime të pandershme, e ka interpretuar fjalën «barbar» të zhveshur nga kuptimi historik.

SHOKU ENVER HONHA: Po, ashtu është, ata kanë spekuluar me këtë.

Kultura greke ka vënë vulën e saj në të gjitha shkencat dhe artet. Ajo është shquar edhe në arkeologji, në histori etj. Gjerësia dhe madhësia e saj është e njohur në tërë botën. Filozofët, shkencëtarët, shkrimtarët, skulptorët dhe shumë njerëz të mëdhenj të Greqisë së lashtë janë bërë të njohur prej kohësh në tërë botën. Monumentet e famshme arkitekturore, tempujt dhe veprat e vyera të arteve figurative të Greqisë së vjetër flasin për lulëzimin e kësaj kulture.

Kur grekët i shtynë dorët, këta u hodhën përtej në Lindje dhe përhapën atje kulturën e tyre. Kjo provohet edhe nga gërmimet që janë bërë në Anadoll. Kultura e madhe greke u zhvillua dhe u përhap në saje të marrëdhënieve të Greqisë së lashtë me vendet e Lindjes së Mesme. Ata kapërcyen Anadollin, u pleksën me kulturën egjiptiane, ranë në kontakt me persët, me dinastinë e Sasanidëve, me fenikasit e me shumë e shumë popuj të tjerë, se ata ishin edhe tregtarë të mëdhenj.

Është fakt që kultura jonë ilire ka veçoritë e saj. Ajo ka rëndësi të madhe dhe zë një vend të nderuar në mes të kulturave të popujve të lashtë.

Çfarë mendimesh ke ti, shoku Dhimosten, kanë ndonjë lidhje me ne etruskët?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Sipas deshifrimit që ka bërë Majani, gjuha etruske mund të ketë ana-

logji me shqipen dhe Majani ta mbush mendjen me ato fjalë që merr si shembull.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të ketë analogji, por ata që merren me llinguistikë nuk i pranojnë shpjegimet e Majanit.

Të tëra gjuhët janë lexuar, por gjuha etruske nuk është lexuar dot akoma. Ky fakt më bën të mendoj se ndoshta do të ketë të drejtë Majani. Hieroglifet egjiptiane i deshifroi Shampolioni. Edhe shkronjat kuneiforme të Hamurabit dhe të kulturës së vjetër asiriane, si dhe të tëra shkrimet e këtij lloji që janë zbuluar në Amerikën Latine etj., janë deshifruar, kurse shkrimet e etruskëve përse nuk po deshifrohen?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Sepse e kanë nënvleftësuar Shqipërinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është, e kanë nënvleftësuar, duke gjuhuar se Shqipëria një vend me pesë male është! Studimet gjuhësore nuk po na nxjerrin në rrugën e Majanit. Sidoqoftë, kjo çështje duhet studiuar me kujdes.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Do të vijë një kohë që deshifrimi do të arrihet, se studimet që janë bërë deri tani, nuk janë veçse përpjekjet e para drejt këtij qëllimi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, me siguri ajo kohë do të vijë.

Tani është deshifruar fjala «knosos»¹. Duhet të për-

1. Qytet shumë i lashtë i Kretës, 5 km në juglindje të qytetit të sotëm Heraklios.

piqemi të zbulojmë akoma edhe fjalë të tjera në këtë drejtim, që të jemi të saktë në konkluzionet që arrijmë.

Tani të shkojmë e të shikojmë teatrin dhe objektet e tjera.

Objektet që janë rreth teatrit janë anekse të tij, apo kanë qenë shtëpi banimi?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Kanë qenë shtëpi banimi karakteristike. Me sa duket, kjo shtëpi do të ketë qenë dykatëshe, se shkallët e saj të ngjitin në katin e dytë.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe muri atje duket që është pak më i lartë.

Po ajo matanë ç'është?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Atje, ku vendi duket si më i harkuar, është banja publike.

SHOKU ENVER HOXHA: E keni parë këtë vend me pëllëmbë?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, po, me pëllëmbë e kemi parë. Matanë kanalit është kalaja e Ali Pashës. Butrinti ka qenë një vend i banuar deri në kohën e Ali pashë Tepelenës.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ku banonin njerëzit në kohën e Ali Pashës?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Nuk banonin këtu, se ky vend ishte caktuar vetëm si qendër gjyctie.

SHOKU ENVER HOXHA: Aliu ka pasur këtej edhe trafik me francezët, që kishin zaptuar Korfuzin në kohën e Napolconit. Aso kohe ishte komandant i Korfuzit një gjeneral, që e quanin Donzëlo. Në arkivat e Parisit janë gjetur dokumente që provojnë se Na-

polcon Bonaparti i shkruante gjeneralit të tij që të kishte kujdes nga Ali pashë Tepelena, se ai ishte njeri shumë i zgjuar, dinak i madh dhe mund ta fuste në thes, në goftë se nuk e kishte futur akoma.

Tani të shkojmë ta shikojmë një çikë më nga afër.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Të bëjmë një fotografi tashti me të gjithë shokët shoqërues.

SHOKU ENVER HOXHA: Dakord, po mund të gjenim ndonjë vend më të mirë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Këta vetë e kanë zgjedhur vendin këtu dhe është i përshtatshëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, si të doni. Bëjmë një këtu, bëjmë dhe një te teatri. Ju jeni artistë, zgjidhni vendin dhe dalim ku të doni.

Qeshni djema, qeshni!

Po me Dhimostenin, që është «i zoti» i Butrintit dhe po na jep gjithë këto shpjegime, nuk do ta bëjmë një fotografi? Pa hajde këtu ti, Dhimosten, të dalim bashkë. Na nxirrni bukur!

Tani, Dhimosten, nga do të shkojmë?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ecim përpara.

Apolonia, megjithëqë e ka emrin kështu, ka si përndë të adhuruar më tepër Dianën sesa Apolonin. Këtë aspekt e gjejmë shpesh në skulpturat e asaj kohe.

SHOKU ENVER HOXHA: Kanë adhuruar Dianën, perëndeshën ilire të bagëtisë, të cilën helenët e patën njësuar me Artemisin, perëndeshën e gjuetisë.

Nuk mund të hiqet me elektropompa ky uji këtu?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Elektropompa ne kemi, por më parë se ta heqim ujin, duhet bërë një

studim, se mund të lidhet me hidrovorin që kemi matanë kanalit.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet ta shikoni këtë çështje që të realizohet pa prishur drenazhimin.

Duke iu drejtuar shoqes Nexhmije: Ja kjo lulja që të pëlqen ty, e shikon?

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Lofata bën lule të bukura.

SHOKU ENVER HOXHA: E mban mend ti, Sano, që i hanim këto lule, kur ishim të vegjël?

SHOQJA SANO HOXHA: Po, po, i hanim.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Instituti i Monumenteve tregon kujdes për mirëmbajtjen e gjithë këtyre objekteve arkitekturore.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet kujdes i madh për ruajtjen e tyre. Kush e ka shtruar këtë rrugë këtu?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Këtë pjesë e kemi bërë ne. Shpesh na e marrin për «antikitet», por duket ndryshimi.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Por edhe fare moderne nuk duhet t'i bëni.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe në Gjirokastrë nuk i restaurojmë dot të tëra rrugët me kalldrëm, se na kushtojnë shumë, prandaj, edhe këtu më mirë ta ruajmë rrugën siç është.

Ti, Dhimosten, na kënaqe sot.

Ka pasur grabitje të pasurive që janë gjetur këtu, kur u braktis Butrinti si qendër e banuar?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Këtu nuk ka pasur grabitje të gurëve për t'i përdorur për qëllime të tjera, siç ka ndodhur, për shembull, me gurët e Apolo-

nisë, me të cilët janë ndërtuar kishat e xhamitë e Myzeqesë.

SHOKU ENVER HOXHA: Një shtëpi e vetme ka qenë kjo që mban mbi vete gjurmët e tri periudhave historike?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, një shtëpi e vetme.

SHOKU ENVER HOXHA: Për këtë shtëpi kaq të madhe aristokratësh thoni ju se nuk gjendet gjëkund?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, kemi të tilla edhe në Antigone e në Apoloni.

SHOKU ENVER HOXHA: Si shtëpi të mëdha e di që kemi edhe atje, po e kam fjalën si shprehje të periudhave të ndryshme historike që na përmende pak më parë.

Kanë shkruar gjë autorët antikë për këto vende?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Për Butrintin flet kryesisht Virgjili. Këtë e përmendin edhe Nikateo, Soroboni, Ciceroni, sidomos kur flet nëpërmjet Pompeit.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse, kanë luftuar edhe këtu Pompei me Cezarin?!

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, ata nuk kanë luftuar, por këtu ka qenë baza e furnizimit. Në një letër, shumë interesante, që Pompei ia bën një shoku të tij, shkruhet: «Jam shumë i gëzuar që ju jeni vendosur në tokat pjellore të Butrintit».

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo duhet të ketë qenë qendra kryesore.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Është një lagje e tërë. Në të vërtetë, është një sipërfaqe e rrafshët, pra-

ndaj atje duhet të kërkojmë një monument të madh.

SHOKU ENVER HOXHA: Doemos, diçka duhet të ketë, se tetëmbëdhjetë hektarë është një sipërfaqe e madhe.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Antigonea është më e madhe, ajo shtrihet në dyzet e pesë hektarë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo punë që po bëni, pra, është me një rëndësi shumë të madhe për ne.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Këtu është muri, kurse blloqet e bardha, më tej, janë të tëra me mbi-shkrime, me dekrete të shkruara.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Lexohen ato mbi-shkrime?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Lexohen, pjesa më e madhe e këtyre mbishkrimeve janë deshifruar.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, shumë bukur. Ju duhet të punoni që të zbuloni këtu objekte e monumente të tjera të rëndësishme, që duhet të ketë akoma. Një qytet kaq i madh, me një periferi kaq të gjerë, me këtë teatër dhe gjithë këto ambiente rreth tij, mendoj se fsheh akoma shumë monumente të tjera, vepra të rralla të arteve figurative dhe objekte të ndryshme të asaj periudhe.

Ugolini, që kryesonte dikur një mision arkeologjik italian për qytetin antik të Butrintit, sigurisht ka qenë financuar nga qeveria italiane për këto zbulime. Por, mendoj se nuk do të ketë pasur fonde të mjaftueshme për të zbuluar gjithçka. Të gjitha gjërat ai i ka lënë përgjysmë, si të gjitha gjërat e tjera që kanë bërë italianët. Edhe në Libi, që është një nga vendet më të pasura të botës në naftë, italianët kishin

kërkuar, por nuk kishin gjetur as një komb naftë. Për sa u përket gërmimeve arkeologjike, me sa di unë, italianët nuk kanë bërë gjë.

Anglezët kanë zbuluar Tutanhamonin¹ e gjithë ato qendra të tjera antike. Amerikanët, gjithashtu, kanë bërë shumë zbulime; kështu edhe Shlimani e të tjerë, kurse italianët, nga sa dimë, nuk kanë bërë ndonjë gjë të madhe. Ata nuk kishin forca për këtë, prandaj ne duhet t'i vazhdojmë gërmimet, se këtu, siç thashë, do të ketë akoma shumë sende me vlerë të pazbuluara.

Kjo figurë me mozaik është pallua. Domethënë, ky mozaik, ka qenë këtu që nga shekulli i 3-të i erës sonë?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Në fillim këtu ka qenë vetëm simboli bashkë me kryqin, ndërsa gjithë pjesa tjetër e mozaikut i përket një kohe pak më të vonshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka ndonjë lidhje këtu me shenjat e Zodiakut?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Jo, nuk ka, se kjo është e një periudhe më të hershme sesa ndërtimi i baptisterit.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po këtë, e shkelin me këmbë?

SHOKU ENVER HOXHA: Natyrisht, ju e mbronin këtë vend që të mos shkelet.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, po, ne nuk lejojmë të shkelet. E mbulojmë me rërë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shikoni, këtu ecet duke

1. Faraon egjiptian i dinastisë së 18-të, që ka sunduar në vitet 1354-1343, para erës sonë.

kërcyer si ai valltari i Konispolit, që luan bukur vallen e Osman Takës. Agronom është valltari?

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, ai është nëndrejtor i Shkollës së mesme Bujqësore në Konispol.

Tani do të punojmë që ta nivelojmë gjithë këtë vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet të keni shumë kujdes kur ta niveloni e ta restauroni.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Në këtë proces punë nuk duhet të priset asgjë.

SHOKU ENVER HOXHA: I drejtohet shoqes Nexhmije: Shiko sa të bukur janë këta mozaikë!

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Shumë të bukur! I kanë ruajtur edhe ngjyrat.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është tamam si thëllëzë.

U... , këtu paska ujë, Dhimosten?!

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Po, ky ujë buro nga poshtë.

SHOKU ENVER HOXHA: U kënaqëm, Nexhmije.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po, u kënaqëm shumë! Edhe koha është e bukur! Unë nuk i kisha parë këto monumente me kaq hollësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Koha na mbajti mirë shumë; edhe shpjegimet e këtyre shokëve na kënaqën.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Në këtë ambient antikiteti gërshetohet me natyrën, prandaj ne nuk i prekim pemët, i kemi lënë siç kanë qenë, se këto ua shtojnë edhe më tepër bukurinë monumenteve.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është.

Organizimi juaj mendoj se duhet të përfshijë Bu-

trintin, Finiqin, gjithë Sarandën dhe Gjirokastrën.

Unë mendoj që ju duhet ta bashkërendoni punën me dy a tre shokë të tjerë. Njëri prej jush, ta zëmë, të mendojë, për restaurimin, tjetri për topografinë, i treti për caktimin pak a shumë me saktësi të disa objekteve. T'i viheni pëllëmbë për pëllëmbë vendit për ta zbuluar dhe, natyrisht, së toku, të vendosni se ç'duhet bërë. Për çdo drejtim të punës të përgjigjet kryesisht njëri, ai që është caktuar.

Ju duhet të mendoni për të gjetur e për të studiuar literaturë të huaj, për të parë se si i kanë bërë arkeologët e shquar zbulimet e tyre. Nuk them se ju nuk keni marrë mjaft njohuri në shkollë, por vetëm dijet e shkollës nuk do të ishin të mjaftueshme për këto punë kaq të rëndësishme. Dihet se thesari i trashëguar në fushën e kulturës materiale dhe shpirtërore të njerëzimit nuk është zbuluar përfundimisht. Shumë gjëra janë nxjerrë në dritë, po shumë të tjera akoma do të nxirren në të ardhmen. Për këtë qëllim bëhen botime të veçanta.

Unë kam libra që flasin për zbulimin e Trojës nga Shlimani. Ju e dini mirë që ai punoi gjatë për këtë zbulim, se nuk e pikasi Trojën që në fillim. Sidoqoftë, merita e këtij zbulimi i takon atij. Edhe ju, mendoj unë, duhet të keni njohuri e pikëpamje të gjera për zbulimet arkeologjike, që të mund të nxirrni deduksione me vlerë shkencore gjatë punimeve që bëni; të jeni në gjendje të bëni krahasime dhe të diskutoni se kjo ka qenë kështu ose ashtu etj. Krahasimet duhen bërë, se kulturat e popujve, vërtet kanë veçoritë e tyre, por ato kanë edhe gjëra të përbashkëta. Siç kanë reflektu-

ar kulturat greke e romake këtu, ka reflektuar edhe kultura jonë ilire, epirote etj.

Përpara nxirrej një revistë me titull «Albania». Unë kam një seri të asaj reviste dhe, në qoftë se nuk gabohem, se kohët e fundit nuk i kam shfletuar ato, në këtë revistë thuhet që një autor i huaj ka shkruar se, duke studiuar mirë zbulimet e Enisesë, ato, thotë ai, të orientojnë në zbulimet e Apolonisë. Ai kishte gjetur në Apoloni njëfarë ngjashmërie në vendosjen e monumenteve. Kjo më ka mbetur në mendje, prandaj ju rekomandoj që ta shfletoni literaturën e huaj, se jam i bindur që ajo do t'ju ndihmojë. Në qoftë se ju dalin pengesa për sigurimin e kësaj literature, na shkruani ndonjë letër dhe ne do t'ju ndihmojmë.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Në këtë drejtim nuk kemi ndonjë pengesë, shoku Enver. Ju keni të drejtë në këto që thoni, sepse arkeologjia është një shkencë krahasuese.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është, shkencë krahasuese. Kulturat e popujve që janë më të mëdhenj kanë asimiluar ato të popujve më të vegjël. Por, kur kultura e një populli është me baza të forta dhe reziston, atëherë ajo nuk asimilohet dot. Kështu, kultura romake nuk është puro romake, se në të ka elemente që vërtetojnë huazimet e saj nga kulturat e tjera, me të cilat ka pasur kontakte kjo kulturë.

Mirë, e mbaruam këtë vizitë të këndshme. Ju faleminderit shumë për shpjegimet interesante që na dhatë. Ju punoni në një nga qendrat monumentale më të rëndësishme të antikitetit në vendin tonë, prandaj bëni përpjekje të mëdha që ta mbani të restauruar dhe

t'i zgjeroni gërmimet këtu për të nxjerrë në dritë dhe për të vënë në dukje thesaret që ekzistojnë. Dora dhe mendja e njerëzve tanë, e fiseve tona, na kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore.

Ne vlerësojmë lart edhe kulturat e të tjerëve. Por, në radhë të parë, duhet absolutisht të vëmë në dukje kulturën tonë, që na e kanë fshchur dhe e kanë nënvleftësuar të tjerët. Partia krijoi mundësitë që kulturën materiale e shpirtërore të popullit tonë ta trajtojnë vetë, me objektivitet, bijtë e tij. Ju duhet të përpiqeni ta zgjeroni horizontin e kërkimeve në këtë «kopsht me trëndafila», që në gjuhën persishte i thonë «gjylistan». Për gjylistanin ka shkruar një libër me plot frymëzim poeti i madh persian Saadiu. Ne jo vetëm duhet t'i zbulojmë dhe t'i ruajmë «trëndafilat» ekzistues të këtij kopshti të bukur, por ta bëjmë atë akoma më të bukur me «trëndafila» të rinj.

SHOKU DHIMOSTEN BUDINA: Ne i premtojmë Partisë se edhe në të ardhmen do të punojmë me zell për t'i zgjeruar gjithnjë e më shumë kërkimet tona në drejtimet që na porositni ju, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Të uroj nga zemra.

Qofshi mirë të gjithë! Dalshi faqebardhë!

Më vjen keq që po largohem nga ju, por më duhet të shkoj. Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
kësaj vizite, që gjenden
në AQP*

ASNJË ORGAN E KUADRO NUK DUIET TË ECË PA PLAN TË DETAJUAR

*Fjala me kuadrot e Partisë të rrethit
të Sarandës*

27 mars 1978

Të dashur shokë e shoqe,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem me ju në këtë mbledhje pune dhe ju falënderoj për raportimet që më bëtë për zhvillimin e gjendjes politike, ekonomike e morale dhe të përgatitjes ushtarake të rrethit tuaj. Natyrisht, për këtë gjendje që më paraqitët, unë konsideroj se keni përparime të dukshme, por, gjithashtu, keni edhe të meta, që shokët i vunë në dukje, të cilat kanë bërë që të krijohen disa deficite në realizimin e planeve.

Jam, gjithashtu, i gëzuar, e për këtë kam qenë i bindur, se organizata e Partisë në rrethin tuaj, si kudo në vendin tonë, është e ngritur politikisht e ideologjikisht dhe, duke qenë në krye të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, udhëheq me sukses ndërtimin e socializmit. Çdo ditë e më shumë ne po bindemi

për këtë ngritje të Partisë sonë, sepse në praktikë shohim rezultate të panumërta dhe të pashlyeshme në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste kudo te ne, në të gjithë sektorët e jetës, në ekonomi, në kulturë, në arsim, në forcimin e mbrojtjes së vendit etj.

Natyrisht, krahas sukseseve të mëdha kemi edhe të meta e boshllëqe në punën tonë, që të gjithë ne, si në qendër, edhe në bazë. Pavarësisht se direktivat që jepen janë të drejta, dhe këto përbëjnë karakteristikën e përgjithshme të Partisë sonë, ne shohim se në drejtimin e punëve nga qendra ka akoma të meta, shfaqje të burokratizmit, disa herë zvarritje, moskoordinime e mungesë kontrolli, nga të cilat burojnë mjaft të meta të tjera. Po të kihen parasysh më shumë e të shmangen këto, puna do të përmirësohet e do të ecë më shpejt edhe te ju në bazë.

Këto që them janë edhe një autokritikë që ne, udhëheqja më e lartë e Partisë dhe e shtetit, bëjmë përpara bazës, gjë që e kemi për detyrë ta bëjmë vazhdimisht. Kjo nuk duhet të jetë një autokritikë formale, por e tillë që të na bëjë t'i vihemi më mirë punës, në mënyrë që t'i kuptojmë sa më thellë të metat e dobësitë që shfaqen në veprimtarinë tonë, t'i vlerësojmë ato edhe si pengesë për punën e të tjerëve ndaj të marrim masa dhe t'i korrigjojmë sa më parë.

Është e domosdoshme të kuptojmë të gjithë se çdo direktivë e drejtë e kongreseve të Partisë dhe e Komitetit Qendror duhet zhvilluar e duhet detajuar; pastaj duhet filluar nga puna për zbatimin e saj, dhe, së fundi, duhet organizuar dhe kontrolli për t'u siguruar se si është zbatuar ajo. Me këto që them të mos kup-

tohet sikur shokët e Partisë dhe të pushtetit në rroth e në bazë nuk i bëjnë të gjitha këto veprime, por vetëm desha të theksoj se ne kemi mundësi akoma më të mëdha që këto punë të bëhen edhe më mirë. Dhe duhet t'i bëjmë medoemos më mirë, për arsye se vija e Partisë sonë është e drejtë dhe e qartë, mjetet materiale e monetare nuk na mungojnë, gjithashtu, kemi kuadro të përgatitur politikisht, ideologjikisht, moralisht, ekonomikisht, ushtarakisht dhe teknikisht. Të gjitha këto pra, na japin mundësi që ta bëjmë një gjë të tillë sa më mirë.

Po ashtu, të meta e boshllëqe që përmenda për veten tonë ekzistojnë edhe te ju, shokë të bazës. Ne duhet të kuptojmë, dhe jemi të ndërgjegjshëm për këtë, se janë shokët në bazë ata që djersijnë më shumë nga të gjithë; janë ata që hasen me vështirësi të panumërta, objektive dhe subjektive, që duhet të kenë kujdes e vëmendje të vazhdueshme për drejtimin sa më të përsosur në shumë çështje dhe të dinë të kombinojnë eksperiencën e mirë të sektorëve të ndryshëm për realizimin e planeve, për ngritjen e kulturës, për edukimin e njerëzve, për plotësimin e detyrave të mbrojtjes etj. Por që ata ta bëjnë këtë si duhet, natyrisht, lypset t'i shohin në sy dhe në kohë të metat e gabimet që vihen re dhe t'i korrigjojnë këto sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo është një detyrë e vazhdueshme e gjithë Partisë, e gjithë kuadrove të pushtetit, nga baza e deri lart.

Punët duhet të harmonizohen me kujdes dhe asnjëherë nuk duhen lënë që të shkojnë në kundërshtim njëra me tjetrën. Veprimet që prishin ekuilibrimet e planit du-

het të evitohen si nga qendra, ashtu edhe nga baza. Këto që thashë, në dukje, mund të kenë një karakter të përgjithshëm, por edhe konkretisht, po të flasim, nga ndjekja e punëve në rrethin tuaj mund t'ju them se, duke gjykuar realisht, siç e thashë edhe në fillim, konstatohet që krahas sukseseve, vihen re edhe të meta e boshllëqe që nuk janë zhdukur, bile vazhdojnë të ekzistojnë në disa sektorë të ekonomisë, e në mënyrë të veçantë në bujqësi, blegtori dhe në nxjerrjen e naftës e të gazit.

Dua të theksoj se për të metat dhe boshllëqet që janë krijuar te ju nga mosrealizimi i planeve në disa sektorë, duhen bërë përpjekje për t'i kapërcyer ato dhe për këtë janë të gjitha mundësitë. Ne jemi të bindur se asnjë arsye objektive nuk ka, asgjë nuk ju mungon në këtë drejtim, vetëm se duhet forcuar seriozisht kuptimi i thellë politik, ideologjik dhe ekonomik i problemeve; të forcohen, gjithashtu, organizimi i mirë i punëve dhe kontrolli për plotësimin e detyrave.

Me këto që thashë, në asnjë mënyrë nuk mendoj të mohoj përpjekjet e mëdha të organizatës së Partisë dhe të të gjithë punonjësve të rrethit tuaj, as rezultatet e mira që nuk kanë munguar në sektorët e ndryshëm. Mbi të gjitha dëshiroj të vë në dukje gjendjen e shëndoshë politike të rrethit të Sarandës si faktorin vendimtar që ndihmon në ecjen e punëve përpara dhe jam i bindur se paskëtaj ato do të ecin akoma më tej.

Në bujqësi tokat shumë pjellore, klima e mrekullueshme, sidomos mundësitë aq të favorshme që janë krijuar pas Çlirimit në rrethin tuaj, lejojnë që të arrihen këtu rezultate të mira dhe të qëndrueshme, si në

prodhimin e drithërave, ashtu edhe në blegtori e në pemëtari dhe veçanërisht në ullinj. Por, si te ju, ashtu edhe në të gjitha rrethet e tjera, ekziston edhe shembulli i ekonomive të përparuara, siç u vu në dukje këtu, që në kushtet e vështira të secilit rreth jo vetëm i kanë plotësuar, por edhe i kanë tejkaluar planet në drithërat e në bimët industriale, kanë realizuar shifrat e pjellshmërisë së bagëtive të imëta e të lopëve, kanë plotësuar detyrat e planit të qumështit etj.

Çfarë tregojnë këto? Këto tregojnë dy gjëra: se kushtet atmosferike nuk mund të flemi se nuk ndikojnë negativisht, pra nuk na dëmtojnë; por, kjo tregon edhe diçka tjetër me shumë rëndësi, që vështirësive atmosferike, sado të mëdha që të jenë, ne mund t'u bëjmë ballë; pasojat negative të tyre mund t'i zvogëlojmë në minimum, në rast se do të bëjmë të ndërgegjegjshëm punonjësit e bujqësisë që të zbatojnë si duhet agroteknikën; në qoftë se do të organizojmë mirë punën për të kryer të gjitha shërbimet që kërkojnë bimët e ndryshme në bazë të kushteve të krijuara.

Këto ju i dini mirë, bile shkencërisht, prandaj është e zorshme për mua që t'u jap mendje agronomëve, zooteknikëve, veterinerëve, skuadërkomandantëve, gjeologëve, doktorëve e të tjerëve, që drejtojnë dhe ndihmojnë në zhvillimin e gjithanshëm të jetës së vendit tonë. Por çështja qëndron në atë që thashë më parë, që lypset një thellim akoma më i madh në kuptimin e shkencës e të teknikës jo vetëm nga kuadrot me arsim të lartë e të mesëm, por nga të gjitha masat e popullit, kudo ku ato punojnë e djersijnë, në mënyrë që gjithë ky thellim, gjithë kjo dituri e tyre, të krijojë atë unitet që

synon drejt disa objektivave që duhen arritur. Por realizimi arrihet kurdoherë me njohuri të plota shkencore të punëve në sektorin ku punon secili dhe me një organizim të shëndoshë e me kontroll të vazhdueshëm të zbatimit të detyrave. Në këto drejtime, më duket mua, Partia duhet të bëjë përpjekje të tjera më të mëdha për ngritjen tekniko-profesionale të punonjësve. pse njohuritë shkencore në bujqësi, fjala vjen, apo edhe në të gjithë sektorët e tjerë, bëjnë që gjithsecili të kuptojë si duhet kërkesat e bimës e të tokës, për të marrë sa më shumë prodhime.

Ju sapo mbaruat plenumin e zgjeruar të Partisë të rrethit, ku punuat vendimet që mori Komiteti Qendror në Plenumin e 3-të dhe të 4-t dhe diskutuat gjerësisht për problemet e mëdha që ngrihen në to. Në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të Partisë u shtrua edhe problemi i edukimit të mëtejshëm të kuadrove, kurse Plenumi i 4-t iu kushtua planit të vitit 1978. Ne menduam që të dyja këto probleme të shtroheshin së bashku e të mos shkëputeshin njëri nga tjetri. Realizimi i planit lyp mobilizimin e forcave të gjalla të popullit dhe në ballë të kësaj lufte duhet të jetë klasa punëtore me armatën e madhe të saj, me njerëzit e specializuar e të pajisur me njohuritë e nevojshme shkencore e teknike. Pra, objektivi kryesor i këtij plenumi që bëtë, është që gjithë këto direktiva që dha Komiteti Qendror jo vetëm të kuptohen drejt e thellë, por, është e domosdoshme që ato të zërthehen në një mënyrë të atillë shkencore nga komitetet, seksionet, kryesitë e kooperativave bujqësore, skuadrat, drejtoritë e ndërmarrjeve, të institucioneve, të shkollave etj., etj., që të sigurohet orga-

nizimi i mirë i punës për zbatimin e plotë të tyre. Asnjë organ e kuadro drejtues në bazë nuk duhet të ecë pa një plan të detajuar të detyrave.

Pasi foli për ngritjen e nivelit ideologjik të komunistëve, për kuptimin dhe për zbërthimin e teorisë e lidhjen e saj me jetën, për luftën kundër mbeturinave të vjetra e shfaqjeve të huaja etj., në përfundim, shoku Enver Hoxha tha:

Ju uroj shëndet të gjithëve dhe ju lutem t'u transmetoni prindërve, burrave, grave e fëmijëve tuaj dhe gjithë popullit të rrethit, urime nga ana ime për suksese të mëtjshme në kryerjen e detyrave.

Partia në Sarandë është në pozita të forta ideologjike dhe politike, prandaj edhe puna edhe lufta që do të bëjë ajo në të ardhmen do ta kalitë atë çdo ditë e më shumë.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli!

Të rroni ju!

Botuar për herë të parë, me shkurtime, në gazetën «Zëri i popullit», nr. 75 (9248), 29 mars 1978

Botohet me shkurtime sipas origjinalit, që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KUR SHOHIM PËRPARIMET E VENDIT NA BËHET ZEMRA MAL

*Nga biseda e lirë me drejtuesit kryesorë
të rrethit të Sarandës¹*

27 mars 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët! Si jeni, shokë?

Mora vesh që në Ksamil paskan ardhur për të punuar e për të jetuar përgjithmonë fshatarë nga Korça. Po nga Gjirokastra kanë ardhur?

SHOKU JORDAN PANI²: Jo, nga Gjirokastra nuk kanë ardhur, megjithëse u bëmë thirrje të na vijnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurimi i ujit për plantacionin e Bregut përbënte një problem të madh për rrethin tuaj, por edhe ky problem tash u zgjidh. U gëzova shumë kur mora vesh për hapjen e tunelit nga do të kalojë uji dhe ju bëra një telegram me këtë rast.

1. Kjo bisedë u zhvillua në Shtëpinë e Pritjes gjatë pushimit të pasdites.

2. Në atë kohë, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Sarandës.

Domethënë uji vjen nga Kalasa dhe i bie rrotull gjatë Bregut.

SHOKU JORDAN PANI: Tani uji duhet çuar te pemët me kanale të betonuara.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju duhet ta keni kujdes vetë këtë çështje dhe të merrni masa që ta çoni deri në fund ujin; mos pritni nga dikasteret.

Për sa i përket zënies me punë të njerëzve në qytet, këtu në Sarandë, mund t'ju krijohen disa vështirësi, prandaj le të shërbejë Ksamili për sistemimin e tyre në punë, sidomos të grave dhe të të rejave.

Prodhimi nga sektori i pemëtarisë atje do të vijë vazhdimisht duke u rritur nga viti në vit, prandaj duhet menduar edhe për ndonjë frigorifer.

SHOKU JORDAN PANI: E kemi një frigorifer të vogël.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se e keni, shumë mirë. Por të bëni shumë kujdes për ambalazhimin e konservave. Kjo punë të bëhet me mend, sidomos mënyra e hapjes së tyre të jetë sa më e përshtatshme. Po i realizuam mirë tërë këto, atëherë konservat tona të huajt do të vijnë të na i marrin në vend.

Po midhjet si duken? Ato mund të na sjellin të ardhura të konsiderueshme, prandaj mos i neglizhoni. Për këtë qëllim të gjeni ose të përgatitni disa specialistë me eksperiencë, që të jenë edhe të pasionuar pas zanatit, sepse për zhvillimin e tyre kërkohet shumë kujdes dhe të mbahet një regjim i rreptë. Për kultivimin e midhjeve të kombinohen me njësitë të gjitha mjetet e burimet, siç janë uji i Kalasës dhe uji i detit.

SHOKU JORDAN PANI: Midhja është shumë e

ushqyeshme dhe, përveç të tjerave, nuk ka as kolesterinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, midhjet janë një ushqim i mirë për popullin.

Duke pasur parasysh se Saranda do të kthehet së shpejti në një rreth me pemëtari të zhvilluar, kujdes i veçantë duhet treguar për frutat, sidomos për ato që do të eksportojmë. Që tani të merren masa për kalibrimin e tyre, se kjo gjë ka rëndësi të madhe. Të huajt i kërkojnë frutat me madhësi dhe peshë të caktuar. Disa edhe domatet i duan të tëra të një kalibri. Lidhur me këtë problem do t'ju tregoj se jashtë bëjnë shumë kujdes për paraqitjen e mallrave.

Kur vajtëm në Konferencën e Paqes në Paris, në vitin 1946, vumë re që, në sallën e ngrënies së delegatëve, përveç frutave të tjera, kishte edhe pjepra. Çdo klient servirej me nga një gjysmë pjepri. Por neve na bëri përshtypje fakti që të gjitha gjysmat e pjeprave ishin të një madhësie e të një ngjyre. Me të vërtetë të kënaqej syri.

Një herë tjetër, kur ishim në një qytet të Çekoslovakisë, vumë re që shalqinj të shitnin me thela. Atje na priti sekretari i komitetit të partisë. Në bisedë e sipër me të, ndër të tjera, folëm dhe për mandarinat, portokajtë dhe limonët. Ai na pyeste nëse ne kishim me bollëk nga këto lloj frutash dhe çuditëj kur i thoshim që kemi. «Kur kisha gruan të sëmurë, na tregonte ai, më duheshin medoemos dy-tri kokrra limonë, por ata nuk gjendeshin në qytet, prandaj u detyrova të veja gjer në Komitetin Qendror të Partisë për të më ndihmuar për një gjë kaq të vogël, por të domos-

doshme». Kaq të vështirë e kishin atje për një kokërr limon! Kurse ne kemi me bollëk e do të kemi edhe më shumë në të ardhmen me gjithë këto plantacione të gjera që po mbjellim, sidomos në rrethin tuaj.

Ne duhet të kultivojmë më shumë ato lloje agrumesh që kërkohen më tepër në treg dhe që kanë karakteristika sa më të mira.

Edhe vendet e tjera të Mesdheut e shikojnë me simpati punën e Partisë e të shtetit tonë për zhvillimin e ekonomisë. Ne tani dërguam një delegacion për eksperiencë në Algjeri e në Irak, ku është pritur mirë. Shokët, që u kthyen, na treguan se atje përfituan shumë, prandaj Ministria e Bujqësisë duhet ta shfrytëzojë si duhet këtë eksperiencë të çmuar që na e sollën shokët që vajtën atje, ndërmjet të tjerave edhe atë për përmirësimin e rasateve të agrumeve.

Edhe qitron duhet ta mbjellim më shumë. Më përpara qitron e kërkonin shumë izraelitët, të cilët, në një festë të tyre fetare, e kishin zakon që të mbante secili përpara nga një qitro. Në Izrael e kanë aq të preferuar qitron, sa ç'keni ju dibranët¹ sheqerparen.

Tani nuk kemi më filokserë në vreshtat tona, se ajo është luftuar dhe është zhdukur. Filoksera është një insekt i rrezikshëm që na i ka pasë dëmtuar shumë hardhitë në të kaluarën. Ajo mund të na kthehet përsëri, në qoftë se e harrojmë dhe nuk marrim masa për ta luftuar që në shfaqjen e parë. Prandaj i mbani sytë hapur edhe kundër kësaj sëmundjeje.

Për sa i përket luftës për mbrojtjen e shëndetit të

1. I drejtohet shokut Jashar Menzelxhiu.

njerëzve në vendin tonë janë bërë përpertime të mëdha. Këto përpertime vërehen jo vetëm në faktin që jeta mesatare e njerëzve tanë është rritur gati dyfish në krahasim me periudhën e Paraçlirimit, por edhe se vdekshmëria e të vegjëlive të ne është ulur shumë në krahasim me të kaluarën. Edhe këtu në rrethin tuaj ka kooperativa që e kanë shumë të ulët numrin e vdekjeve të fëmijëve, bile, në disa fshatra të Gjirokastrës, si në Pogon, vitin e fundit nuk ka vdekur asnjë kalama. Kur mendojmë që Gjirokastra, Shkodra, Puka, Elbasani etj., që përpara e kanë pasur të madh numrin e vdekjeve të fëmijëve, kurse tash kanë bërë përpertime të mëdha në këtë drejtim, na bëhet zemra mal. Përveç masave të shumta që janë marrë për mirërritjen e fëmijëve, një kujdes i madh po tregohet nga Partia dhe pushteti për profilaksinë, për t'i ruajtur njerëzit nga sëmundjet.

Ti, Jordan, kujdesesh për shëndetin apo jo?

SHOKU JORDAN PANI: Herë kujdesem e herë jo.

SHOKU ENVER HOXHA: Megjithëqë ti je i ri, duhet të kujdesesh dhe ta mbash dietën.

Ti, Jashar, je mirë me shëndet, vetëm se nuk duhet të hash shumë.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Unë e bëj rregullisht gjimnastikën.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu sikurse më tregove mua ti, Jashar nuk më duket se ke ndonjë gjë shqetësuese.

SHOKU JORDAN PANI: Shoku Jashar trembet një çikë më tepër nga ç'duhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu e kanë dibranët, tremben. (Të qeshura.)

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Sa për trimëri dibranëve nuk ke çfarë t'u thuash për ndonjë gjë tjetër edhe mund të kritikohen. *(Të qeshura.)*

SHOKU ENVER HOXHA: Dibranët, njerëzit e thjeshtë, janë patriotë të shquar, si për këtë ashtu dhe për andej kufirit, shqiptarët e Dibrës së Madhe, të Tetovës, të Gostivarit etj. Në Jugosllavi është krijuar një rrëmujë e madhe, po i del boja vetadministrimit.

Ka kohë që ne kemi filluar të shkruajmë artikuj për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 100-vjetori i së cilës do të festohet këtë vit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit luftoi atëherë me vendosmëri e patriotizëm të madh për mbrojtjen e tokave tona nga copëtimi i fqinjve, kurse titistët heshtin për këtë ngjarje të rëndësishme historike të popullit tonë. Ata kanë grindje edhe me shtete të tjera fqinje.

Përpara, nacionalistët e tërbuar serbë, kanë mbajtur referate kundër kombit tonë që i lexonin në klubet e tyre, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, në Universitetin e Beogradit ose në Institutin e Kombësive etj. Në këto referate shtrohej edhe problemi se ç'rrugë duhej të ndiqte qeveria e Serbisë për likuidimin e popullsisë me kombësi shqiptare. Për këtë qëllim, si zgjidhje në këto shkrime armiqësore, rekomandoheshin genocidi, vrasjet, nxitja e hakmarrjes, burgosja, dënimi me vdekje, krijimi i kushteve për t'ua bërë shqiptarëve jetën të padurueshme etj. deri atje sa këta të detyroheshin të linin Kosovën, viset shqiptare të Maqedonisë e të Malit të Zi dhe të emigronin në Turqi, në Shqipëri e gjetkë. Shovinistët e tërbuar serbë e dinin që Zogu nuk do të bënte asnjë zë kundër

tyre për të tilla krime monstruoze. Në këto materiale rekomandohej, gjithashtu, edhe shfrytëzimi i fcsë myslimane, për t'i dërguar në Turqi shqiptarët e këtij besimi, që, sipas serbomëdhenjve, ishin një popull «rc-bcl» dhe qëndronin si pykë midis Serbisë dhe Maqedonisë. Ata bënin plane që me largimin e shqiptarëve nga tokat e Kosovës këto vende t'i popullonin me serbë e malazezë.

Këto dokumente i kanë kosovarët dhe, kur ndonjëri prej tyre ngre zërin e protestës për këto qëndrime të llahtarshme çnjerëzore, titistët u përgjigjen: «E tillë ishte politika e carëve të Serbisë». Por, kjo është një hipokrizi e madhe, sepse revizionistët jugosllavë heshitin për faktin se një nga ata që ka shkruar kështu është njëfarë Vaso Çubrilloviç, që u bë më vonë anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, bile edhe ministër i qeverisë së Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë. E pra, politika e poshtër shoviniste, si e Jugosllavisë së vjetër edhe e kësaj të sotmes, është e njëllajtë.

Ju, shokë të Sarandës, duket që jeni përgatitur mirë për festivalin folklorik që do të bëhet në muajin tetor në Gjirokastër.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Shfaqja që u dha mbrëmë, qe e mirë, na pëlqeu; ishte një shfaqje me kulturë.

SHOKU ENVER HOXHA: E mirë ishte. Më morën në telefon Hysniu [Kapo] e Ramizi [Alia] dhe më thanë se, kur e panë në televizor, u pëlqeu shumë. Mua personalisht më pëlqeu më shumë shfaqja e fëmijëve. Ata, të zinjta, i shtypën fare në skenë më të rriturit. Unë, kur

dola në skenë, tek ata e përqendrova më shumë vëmendjen dhe u kënaqa, se edhe këndonin edhe kërcenin. Vura re se shumë prej tyre i mbanin sytë te mësuesi që i drejtonte. Kur shkova e i takova prapa skenës u kënaqa edhe një herë me ta. Njëri prej tyre, me çiltërsinë e tij prej fëmije, më tha: «O xhaxhi Enver, bëjmë një fotografi bashkë?». «Bëjmë jo një, por më shumë», iu përgjigja unë me gjithë zemër dhe, kur morëm një valle së bashku me ta, u thashë: «Dridheni një herë!». Dhe ata aq donin: hidheshin si qengjat. S'kishte gëzim më të madh t'i shikoje.

Kur ishte ambasadori sovjetik në Tiranë, më pati sjellë një herë një televizor që ishte tamam si një kashun. Atëherë nuk ishte rregulluar akoma antena te ne, prandaj shikonim ç'mundnim. Këtë aparat televizori unë e kisha vënë në atë kohë në dhomën e nënës që të bënte sehir ajo. «Si është kjo punë, more Enver, më thoshte aneja, në një odë të vogël të shikosh gjithë ata njerëz që hanë e pinë e ç'nuk bëjnë!». Unë ia shpjegoja dhe e pyesja: «E kuptove tashti?». «E kuptova», më thoshte ajo, por hiçgjë nuk kishte marrë vesh. «Ki mendjen, se një herë në javë del edhe prifti në atë odë!», i thosha unë. *(Të qeshura.)*

Te ne, në fushën e arsimit, të artit e të kulturës janë bërë përparime të pakrahasueshme, lëre me të kaluarën, por edhe me disa vjet më parë. Tani programet tona të radios e të televizionit po bëhen çdo herë e më të pasura, si nga forma kombëtare, ashtu dhe nga përmbajtja e tyre e shëndoshë që ndihmon shumë në edukimin e njerëzve tanë.

Desha të di, a ekziston akoma shtëpia e Hoxha

Tahsinit në vendlindjen e tij, në katundin Ninat? Ka njeri të gjallë nga fisi i tij?

NJË SHOK NGA TË PRANISHMIT: Kjo shtëpi ka kohë që është rrëzuar dhe vetëm gurët e saj ekzistojnë. As njerëz të afërt nuk ka atje ky patriot.

SHOKU ENVER HOXHA: Lavdinë e patriotëve, e njerëzve të shquar shqiptarë, në të kaluarën, lëre të huajt, po edhe borgjezia vendëse e fshihnin. Ja, kur ishim të rinj në shkollë na mësonin se Hasan Tahsini kishte qenë një hoxhë i ditur dhe asgjë më tepër. As njeri nuk na thoshte që ai kishte qenë një filozof i madh, që njihte matematikën, astronominë, fizikën dhe filozofinë e Dekartit, që ishte përkrahës i rrymës së racionalizmit në teorinë e njohjes, që kishte studiuar edhe filozofinë arabe, nga e cila ai, natyrisht, duhet të jetë influencuar. Prandaj, në pikëpamjet e tij filozofike duket dhe kishte doza idealizmi, sepse sidomos Dekarti, nga i cili ai qe frymëzuar, ishte idealist. Por, siç del, fondi kryesor i pikëpamjeve të tij në filozofi është ai i racionalistëve.

Për t'u shpëtuar perskutimeve që i bëheshin, për shkak të pikëpamjeve dhe aktivitetit të tij patriotik e revolucionar, Hoxha Tahsini shkoi gjer në Holandë. Ai ishte njeri me horizont të gjerë kulturor e me njohuri të thella shkencore.

Hasan Tahsini ka bërë shumë për gjuhën dhe shkrimin shqip dhe ka pasur një aktivitet të shquar në këtë drejtim. Dëshira e tij ishte që të krijonte një alfabet të posaçëm, origjinal për gjuhën tonë, me qëllim që të mos huazonte gërma të alfabeteve të tjera.

Të tillë njerëz të shquar, figura të ndritura të dala

nga gjiri i popullit tonë, Partia jonë po i ngre lart dhe i vë në vendin që u takon. E kaluara e popullit tonë është mjaft e pasur, prandaj ne duhet ta gërmojmë mirë se ka akoma shumë e shumë vlera që duhen vënë në dukje.

Ka autorë që thonë se Aleksandri i Madh ka qenë me prejardhje nga fiset që banonin në trevat e Shqipërisë së sotme, ka të tjerë që e kundërshtojnë këtë. Por, dihet nga të gjithë se nëna e tij, kushërira a motra e mbretit Pirro të Mollosëve, ka qenë epirote. Është fakt se e ëma e dërgoi Aleksandrin te Pirroja, i cili e çoi djaloshin në Shkodër. Kur u rrit e u forcua, Aleksandri vajti deri në Danub, por asnjëri nuk thotë se kur u kthye që andej. Ka historianë realistë, që pohojnë diçka në këtë drejtim, por të tjerët heshtin, se duan t'i hedhin një vello historisë së Shqipërisë, nuk duan të flitet për të kaluarën tonë.

Në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, gjermanët dhe austriakët janë marrë me studimin e gjuhës shqipe. Ndërmjet tyre predominon teoria që prejardhjen shqiptarët e kanë nga ilirët. Në fushën e historiografisë dhe të linguistikës janë shprehur edhe mendime që fiset ilire vijnë nga pellazgët, por kjo hipotezë nuk ka shumë argumente. Dihet që pellazgët janë asimiluar, kurse fiset ilire nuk u asimiluan dot. Ka shkencëtarë të mëdhenj të kombësive të ndryshme, si francezë, gjermanë dhe të tjerë, që kanë shkruar dhe shkruajnë për banorët e hershëm të vendit tonë, por ne duhet ta krijojmë vetë shkencën tonë historike dhe bazat e para mund të themi se i kemi hedhur në këtë drejtim. Historianët tanë po u qepen tani dhe

duhet t'u qepen edhe më shumë fakteve historike, duke gërmuar në biblioteka dhe arkiva të ndryshëm të botës. Kurioziteti i zjarhtë shkencor po i shtyn dhe do t'i shtyjë gjithnjë e më tepër historianët tanë për të studiuar. Qytetet e lashta, si: Antigonea, Amantia, Bylisi, Antipatrea etj., kanë njohur një zhvillim të përgjithshëm ekonomik në fushën e zejtarisë e të tregtisë. Ata kanë pasur edhe monedha të vetat. Djemtë e vajzat tona po punojnë që të qëmtojnë dhe të zbulojnë dokumente me vlerë për të kaluarën e lavdishme të kombit tonë, të të parëve tanë, për heroizmat dhe për sakrificat që kanë bërë ata gjatë shekujve, që të mos asimiloheshin nga të huajt.

Ne tash duhet të punojmë akoma ca më shumë e të luftojmë vazhdimisht për ta mbrojtur atdheun, që ta kemi gjithmonë të fortë e të paprekshëm nga të huajt agresorë, kushdo qofshin ata. Për këtë qëllim, duhet të jemi vigjilentë dhe kurdoherë vigjilentë e të mos na zërë gjumi për fatet e Shqipërisë; të flemë me sytë hapur e të punojmë me sytë hapur. Më parë të mendojmë për interesin e përgjithshëm, se, po u dëmtua ky, dëmtohet edhe interesi i secilit. Po nuk vepruam kështu, atëherë krijohen kushte të favorshme që një grup kapitalistësh e bejlerësh, një ditë, të marrin fuqinë në dorë dhe ta kthejnë popullin tonë atje ku ishte më përpara, ashtu siç u bë në vendet e tjera ish-socialiste.

Të ruajmë si dritën e syrit unitetin e popullit, se ky është kushti themelor që vendi ynë të mbrohet nga armiqtë. Ka raste kur grinden me njëra-tjetrën disa familje në një fshat, si i thonë, për «mustaqet e Çelos».

Njëri më ankohej me letër se e kishte dënuar gjykata vetëm për faktin se kishte rrahur një fëmijë. Kjo m'u duk masë e rëndë, sepse i dënuari ka rrethin e vet familjar e miqësor që, në një masë apo në një tjetër, dëshpërohen dhe acarohen në marrëdhëniet midis tyre për shkak të kësaj rrahjeje. Po përse të ndodhin këto mosmarrëveshje pa arsye derisa të vejë puna në gjyq? Pse e rrahu ankuesi djalin e një tjetri, kur fajin e tij, fare lehtë, mund ta denonconte përpara prindërve të tij? Të gjitha këto akte janë pasojë e ekzistencës së mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve. Po të mos kemi të tilla shfaqje negative, të gjitha të mirat do të na vijnë më shpejt e planet do t'i realizojmë më mirë; radhët tona do t'i kemi të shtrënguara më fort e uniteti ynë do të jetë i çeliktë. Në këtë drejtim Partia duhet të punojë pa u lodhur, sepse atëherë bëhemi gjithnjë e më shumë të pathyeshëm.

Çdo ditë që kalon sjell ndryshime pozitive dhe e pasuron më shumë eksperiencën e Partisë. Ne e shikojmë në praktikë se ç'rezultate të mira na jep çdo ditë zbatimi i mësimëve të klasikëve tanë, se si na ndihmojnë ata për të gjetur mjetet dhe format më të përshtatshme për të ecur gjithnjë e më përpara drejt progresit.

Për shumë probleme që na dalin, ne mund t'u drejtohem Marxit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, të cilët, me veprat që na kanë lënë trashëgim, na ndihmojnë bujarisht që t'i zgjidhim ato drejt e pa gabime. Kur e ristudion me vëmendje Karl Marksit vazhdimisht mëson gjëra të reja prej tij, prandaj në çdo rast e për çdo gjë duhet studiuar me këmbëngulje, se studimi të hap horizont. Ju keni në duar dy vëllimet me veprat

e zgjedhura të Engelsit për ushtrinë. Ky është një material me shumë vlerë, për arsye se Engelsi ka qenë aq kompetent në trajtimin e problemeve ushtarake, sa që vetë Marksi e ka vlerësuar lart, prandaj ka pasur respekt të madh për njohuritë e tij në këtë fushë dhe e ka quajtur gjeneral.

Revizionistët modernë luftojnë marksizëm-leninizmin në të gjitha drejtimet. Me qëllim që t'i bastardojnë letërsinë dhe artin realist, si dhe muzikën popullore etj. dhe t'i hapin rrugën artit dekadent, ata pretendojnë me paturpësi se Marksi dhe Lenini për të gjitha kanë folur, po për letërsinë dhe artin nuk paskan folur. Prandaj, sipas tyre, nuk mund të flitet për estetikë marksiste-leniniste si teori e përgjithshme e artit të realizmit socialist. Një pohim i tillë nuk është aspak i vërtetë. Klasikët tanë të mëdhenj kanë folur dhe na kanë lënë orientime të qarta, si për të gjithë sektorët, edhe për letërsinë, për artin dhe për kulturën në përgjithësi. Disa nga shkrimet e klasikëve për këto çështje ne i kemi përkthyer në gjuhën tonë, prandaj të gjithë mund t'i lexojmë me kujdes e t'i studiojmë thellë.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Shoku Enver, faleminderit shumë për të gjitha sa na thatë. Tani na lejoni të shkojmë. Dëshira jonë është që të rrimë sa më tepër me ju, por ju keni punuar tërë ditën sot dhe jeni lodhur shumë.

Të na rroni sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë. Edhe unë u kënaqa me ju, se e kaluam shumë mirë këtu. Për mua këto ditë të bukura që kaluam së bashku do të jenë të paharruara.

Tani të dalim të gjithë në fotografi që ta kemi për kujtim. Ja, më mirë të dalim këtu te shkallët.

Po e përfundojmë edhe këtë takim të këndshëm. Mirupafshim! Rrini me shëndet!

*Etohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

LUKOVA TREGON KULTURË, MENDJE TË ZHVILLUAR E SHPIRT NOVATOR

Nga biseda me punonjësit e Lukovës

28 mars 1978

Duke u larguar nga rrethi i Sarandës shoku Enver Hoxha u ndal në Lukovë për të përshëndetur punonjësit që kishin dalë në të dyja anët e rrugës.

Drejtori i Ndërmarrjes Bujqësore të Lukovës, Vasil Anagnosti, e informoi shokun Enver për punën kolosale që është bërë në këtë masiv dhe për perspektivat që i hapen. Pas kësaj e mori fjalën:

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë, shoku drejtor, që më vure në dijeni për këtë punë madhështore të rinisë sonë heroike. E udhëhequr dhe e frymëzuar nga Partia, rinia, me krahët e saj të fuqishëm dhe me mendjen e saj të kthjellët, ka realizuar këtu një nga monumentet më të mëdha të socializmit. Këto bregore e kodra u kthyen në një kohë relativisht të shkurtër në ullishte, në vreshta, në plantacione agrumesh e pemësh frutore. Kur i shikon tani këto vende, me të vërtetë të mahnitin. Këtu nuk kemi të bëjmë me një kopsht të vogël, por me një sipërfaqe

të lulëzuar, dimër e behar, nga ullishtet dhe agrumet që shtrihen në qindra e qindra hektarë. Ashtu sikurse the edhe ti, shoku drejtor, këtu është me të vërtetë një nga mrekullitë e botës.

Historia e lashtë tregon se në Azinë e Vogël ka pasur një kulturë të zhvilluar. Në këto anë shquhej qytetërimi i sumerëve dhe i babilonasve të Mesopotamisë. Perandoresha Semiramis kishte ndërtuar kopshtije të famshme, që njihen në historinë e lashtësisë me emrin «kopshtijet e varura të Semiramisit», për të cilat janë shkruar shumë e shumë libra. Unë kam lexuar disa prej tyre, kam parë edhe disa piktura të vjetra, por para këtyre që janë bërë në bregdetin tonë, nuk janë gjë kopshtijet e Semiramisit.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Po, këtu është me të vërtetë një nga mrekullitë e botës!

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ky vend me këto kopshtije të bukura pa mbarim është një mrekulli e madhe, e pakrahësueshme me atë të Babilonisë.

Është fakt se kultura e lashtë ka lënë gjurmët e saj në qytetërimet e mëvonshme, pra edhe në qytetërimin tonë, i cili ka përfituar nga trashëgimia e pasur e kësaj kulture, po nuk është kopje e saj, sepse ka lindur, është rritur, është zgjeruar dhe është forcuar në truallin tonë. Ndërtimet e këtyre tarracave janë një vepër e madhe që provon karakterin krijues të popullit shqiptar në fushën e kulturës. Që të krijosh vepra të tilla, duhet të kesh kulturë, mendje të zhvilluar, shpirt novator, të jesh i guximshëm dhe të kesh dashuri të madhe për tokën, për pemët, për bimët. Ndryshe nuk mund

të realizohet kurrë një mrekulli e tillë, nga e cila e ke shumë të vështirë të largohesh.

Mjerisht nuk munda ta shikoj gjatë popullin patriot e punëtor të Lukovës, që kishte dalë në të dyja anët e rrugës dhe donte të më shihte, por edhe unë kisha dëshirë të madhe ta shihja. Shikimi në kalim ishte i shkurtër, por megjithëkëtë u kënaqa, sepse nëpërmjet syve të njerëzve, pashë lumturinë e tyre. Gëzimi i shpirtit duket në sytë, që, siç thotë një fjalë popullore, janë dritarja e ndjenjave të njeriut. Kur e shikon njeriun që i qeshin sytë dhe është i gëzuar, nuk mund të mos ndiesh kënaqësi në zemër. Kjo është arsyeja që dua të rri në këmbë dhe t'i shikoj mirë tërë shokët e shoqet që punojnë këtu, si dhe të admirojmë së bashku e t'i gëzohemi kësaj vepre të madhe në të cilën ata kanë derdhur mundin, djersën dhe mençurinë e tyre.

Për agrumet unë fola në Ksamil. Edhe për ullinjtë kam folur pak, por sot do të flas diçka më tepër për ta.

Më parë dëshiroj të theksoj që në gjithë bregdetin e Jugut të bien menjëherë në sy mjeshtëria, kultura, ndjenja e bukurisë dhe e dashurisë suaj për ullirin. Këtë pemë e kanë vlerësuar lart dhe i kanë thurur këngë të shumta njerëzit që në kohën e lashtësisë, si: Homeri, Hipokrati e të tjerë. Këta tregojnë në shkrimet e tyre se vajin e ullirit e kanë përdorur si ilaçin më të preferuar për mbrojtjen dhe për kurimin e mëlçisë, që bashkë me palcën e kurrizit prodhojnë gjakun, pa të cilin nuk punon zemra dhe, rrjedhimisht, nuk mund të ketë jetë. Të tërë këta dijetarë të mëdhenj të lashtësisë kanë shkruar me dashuri për këtë dru të mrekullueshëm, nga i cili nxirret vaji. Edhe kur tha-

het, nga rrënjët e ullirit lindin prapë filiza të rinj. Është për këtë arsye që thonë se kjo pemë rron në shekuj. Siç e shikoni, degët e ullirit janë të kthyer e të përdredhura në shumë drejtime. Në një gjendje të tillë për drunjtë e tjerë thuhet se nuk mund ta kenë jetën të gjatë, kurse ulliri është i fortë si çeliku dhe na jep frutat e tij aq të domosdoshme.

Sipas mitologjisë, mijëra vjet përpara na qenka bërë «dita e kiametit!». Kjo katastrofë paska ndodhur diku larg, midis dy lumenjve, Tigër dhe Eufrat, pra në Mesopotami, që greqisht do të thotë midis dy lumenjve. Këtë vend e pushtoi Aleksandri i Maqedonisë në shekullin e 4-t para crës sonë. Në Mesopotami, sipas mitologjisë, ra një shi i madh dhe Noeja, për të shpëtuar, lundroi me varkën e tij deri në malin e Araratit në Kaukaz. Kur pushuan shirat e furishme, ai lëshoi një pëllumb, që fluturoi gjer në Mesopotami dhe u kthye përsëri andej duke mbajtur në sqep një degë ulliri. Kjo shenjë donte të thoshte për Noen se ujërat kishin rënë. Nga kjo kohë ulliri u konsiderua i fortë, sepse edhe e tmerrshmja «ditë e kiametit» nuk e asgjësoi dot.

Ullirin nuk e kanë dashur njerëzit vetëm për blerimin e tij të përhershëm, se njërën anë të gjethes e ka jeshile, kurse tjetrën si të bardhë, as vetëm për bukurinë e luleve të tij të vogla, por mbi të gjitha e kanë kultivuar për arsye se kokrrat e kësaj peme na japin vajin që është një nga ushqimet më të nevojshme, më të domosdoshme e më të shëndetshme për organizmin e njeriut. Ulliri edhe në të kaluarën është kultivuar deri lart në veri të Adriatikut, në Dalmaci. Megjithatë

venecianët blinin vaj edhe nga vendi ynë që në kohën e Skënderbeut, bile edhe para tij. Ata, siç e dini nga historia, kanë qenë tregtarë të zotë, por edhe dinakë; ata e tradhtuan Skënderbeun.

Pra, populli ynë e ka njohur dhe e ka kultivuar prej kohësh ullirin. Për këtë kulturë Partia ndoqi rrugën e drejtë të gjyshërve dhe të stërgjyshërve tanë, të cilët e kanë mbjellë, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ruajtur, duke e lënë trashëgim brez pas brezi deri në kohën tonë. Vendi ynë është një vend mesdhetar, që laget nga detet Jon dhe Adriatik dhe ka një klimë shumë të përshtatshme për ullirin. Në botë, përveç Mesdheut, ka edhe vende të tjera ku mbillet e rritet ulliri, por atje ai nuk prodhon aq shumë si në Mesdhe, nga brigjet më pjellore të të cilit janë vendi ynë, Greqia, Tunizia, Algjeria, Spanja dhe Italia e Jugut.

Tash ka ardhur koha që ullinjtë ne t'i shtojmë në mënyrë të pakufizuar, sidomos në vende si këto tuajat, ku klima është më e përshtatshme. Prandaj kudo ku mund të rritet ulliri, asnjë pëllëmbë tokë nuk duhet të mbetet djerrë. Ju këtu, në Bregdet, keni një eksperiencë të madhe për kultivimin e kësaj peme dhe ju jeni të parët që keni stabilizuar prodhimin e saj. Kurdoherë që kam kaluar nga bregdeti, që nga Dhërmiu e deri në Përparim, kam parë punën tuaj të kujdesshme e të vëmendshme. Ullinjtë kanë qenë prodhimi juaj kryesor. Edhe sot ata janë mbjellë kudo. Për këto arsye është e zorshme të mbillen këtu drithërat e bukës. Megjithatë, ndërmjet ullinjve mund të mbillen disa lloje zarzavatesh, cikli i të cilave t'i përshtatet vendit dhe të mos pengohen nga hieja e tyre.

Ka edhe krahina të tjera në Shqipëri ku rritet ulliri. Mundet që atje klima nuk është kaq e përshtatshme sa këtu në bregdetin e Jonit. Sidoqoftë, në rast se do të punojnë edhe atje kështu si punoni ju, do të merret një prodhim i mirë. Kruja dhe Tirana që kanë ullinj, si dhe rrethet që s'kanë, të tëra e duan vajin e ullirit, por këtë vaj ne duhet ta prodhojmë dhe, që ta prodhojmë, lypset t'i kryejmë ullirit të gjitha shërbimet.

Të ardhurat nga ullinjtë, në qoftë se kësaj bime kaq të vlefshme i bëhen me të vërtetë shërbimet e duhura, do të jenë të mëdha për ju, për ndërmarrjen dhe për të gjithë ekonominë e vendit tonë. Kështu ne do të prodhojmë më shumë ullinj dhe vaj. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Përse të importojmë ne çdo vit me dhjetëra mijë tonë vaj nga jashtë për të plotësuar nevojat për yndyrna të popullatës, kur i kemi të gjitha mundësitë ta prodhojmë këtë vaj në vendin tonë? Në radhë të parë, mendoj se duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që vajin, për të cilin kemi shumë nevojë, ta prodhojmë nga ullinjtë tanë, por kjo kërkon që t'u bëjmë shërbime të mira gjithë këtyre masiveve të mëdha të ullinjve që kemi në gjithë zonën bregdetare të vendit.

Në qoftë se aktualisht, siç the ti, shoku drejtor, këtu janë 350 rrënjë ullinj për hektar, shembulli juaj i mirë duhet të përhapet jo vetëm në Vlorë, por deri në skajet më të largëta të vendit ku ekzistojnë mikroklima të përshtatshme dhe mundësi për zhvillimin më të mirë të ullirit, siç janë: Tirana, Kruja, Lezha, Shkodra etj.

Përpara thoshin se ulliri do shumë kohë që të rri-

tet dhe se ai prodhon kokrra pas 15 vjetësh. Por ju vetë e keni provuar që nuk do kaq shumë kohë. Që në vitin e pestë apo të gjashtë, ullinjtë që keni mbjellë ju, kanë dhënë 12 deri 15 kilogramë për çdo rrënjë. Ju keni këtu ullinj nga të cilët merrni deri në 80, 100 apo 150 kilogramë për rrënjë. Unë kam bindjen se ne mund të arrijmë të marrim mesatarisht 50 kilogramë për çdo rrënjë në të gjithë ullinjtë e Shqipërisë. Por, kjo pemë që të japë, siç thashë më parë, kërkon shërbime të kualifikuara. Po kur të arrijmë të marrim 100 apo 150 kilogramë nga qindra e mijëra rrënjë ullinj, sa do të rritet prodhimi i ullirit dhe i vajit në vendin tonë? Kjo na vë detyrën që të marrim të gjitha masat për t'ia kryer kësaj peme shërbimet që kërkon, pra të ecim me kujdes e këmbëngulje në këtë rrugë.

Masa apo shërbimi i parë për këtë qëllim, siç e dini, është ujitja e ullinjve të rinj dhe e të gjithë të tjerëve që keni këtu. Pa ujitje, ullinjtë do të ishin tharë. Por ujitja e ullinjve është një art i veçantë. Dhe ju, duke kuptuar rëndësinë e këtij shërbimi, sipas udhëzimeve të Partisë, çatë malin e Tatzatit, hapët tunelin dhe sollët ujë nga kjo anë e Bregut. Tashti, në të dyja anët e tunelit, keni hapur kanale, që ngjasojnë me krahët e shqiponjës. I mësoni njerëzit, djemtë e vajzat tuaja, që ujitja, një nga shërbimet më të domosdoshme për rritjen dhe për prodhimin e ullirit, të bëhet ashtu siç duhet. Kur ka etje njeriu, dëshiron të pijë ujë, ndryshe nuk reziston dot gjatë dhe shtrihet përdhe. Megjithëse ulliri duron shumë pa ujë, edhe ai ka, gjithashtu, nevojë të ujitet, prandaj nuk duhet ta lëmë pa vaditur. Kështu edhe ai nuk do të na lërë pa kokrra

dhe pa vaj. Tashti, që kemi Fabrikën e Plastmasës, mund të bëjmë tuba sa të na duhen për të ujitur.

Ujitja pra, është një nga shërbimet që i duhet bërë patjetër ullirit. Shërbimi tjetër është lufta që duhet t'u bëjmë sëmundjeve që i kanosen ullirit. Edhe këtë pemë e prekin disa sëmundje. T'i njohësh këto sëmundje, do të thotë t'i shikosh ullinjtë një nga një, ashtu siç bën mjeku për çdo njeri. Pra, kur të vërejmë që sëmundja ka prekur një ulli, duhet t'i lëshojmë përnjëherë ilaçin përkatës që ta shpëtojme atë dhe gjithë të tjerët që janë pranë tij.

Një tjetër shërbim me rëndësi, që ju e dini më mirë nga unë, është krasitja. Ka krasitje të rënda, që nuk bëhen çdo vit, veçse në periudha të caktuara kohe, por ka edhe krasitje të lehta. Nuk e kam fjalën këtu për krasitjen e ullinjve të rinj, por për të tjerët. Çdo punëtor, kur vete për ta spërkatur ullirin kundër sëmundjeve dhe vë re se i janë tharë disa degë, ai duhet t'i presë ato, që pema, pas një apo dy vjetësh, nga ana tjetër e vendit të degës së tharë, të lëshojë lastarë të njomë në vend të atyre që priten. Në qoftë se nuk bëhet krasitja, degët e thata jo vetëm do t'i zënë frymën pemës, por edhe do të bëhen vatra infeksioni dhe pema nuk do të ketë jetë të gjatë. Për këtë qëllim punëtorët duhet t'i mbajnë gërshërët kurdoherë me vete dhe, në qoftë se këto nuk i kanë, t'u sigurohen.

Unë nuk jam specialist, por kam lexuar libra që flasin për shërbimet që i bëhen ullirit në vende të tjera. Atje krasitjen e bëjnë në forma të ndryshme, jo vetëm në një formë. Veprojnë kështu jo për bukuri, por për të shfrytëzuar sa më mirë diellin. Ka ullinj

që i qëndrojnë diellit përballë; ka të tjerë që i qëndrojnë nga një anë, ka edhe nga ata që janë në perëndim. Për të shfrytëzuar si duhet energjinë e diellit, i krasitin ullinjtë në forma të ndryshme, konike, kupore, të hapur etj. Krasitja duhet bërë kurdoherë në mënyrë të tillë që kurora të mos lejojë që degët të shkojnë aq lart sa të jetë nevoja për të hipur në shkallë etj. Një krasitje e tillë do të bëjë që edhe hija e ullirit të mos zërë një sipërfaqe të madhe toke sa të pengojë zhvillimin e zarzavateve që mund të mbjellim në mes pemëve. Në një libër flitet për nja katër a pesë forma të tilla. Në njërin prej tyre thuhej se, megjithëse krasitja ishte bërë e thellë dhe degët qenë lënë të shkurttra, kishin arritur të merrnin prej çdo peme deri në një kuintal kokrra. Pra, nuk ka ndonjë vlerë që ta lësh ullirin me trup të madh dhe të marrësh prej tij prodhim të vogël; puna është që ai të trajtohet në mënyrë të tillë sa që të na japë çdo vit një sasi të konsiderueshme ullinjsh.

Rëndësi të veçantë ka edhe mbledhja e ullinjve. Duhet pasur kujdes si për periudhat, ashtu edhe për mënyrat e vjeljes së kokrrave. Nuk e di në qoftë se ju është komunikuar, por tashti së fundi është marrë një vendim mbi shkurtimin e periudhave të vjeljes së ullirit. Ju nuk keni asnjë humbje në këtë drejtim. Këtu është mbajtur parasysh interesi i prodhuesve të ullinjve dhe i gjithë popullit, që ulliri të këputet në kohën e duhur e jo më vonë. Është bërë pastaj një zakon shumë i keq, bile i palejueshëm që ullinjtë i shkundin me shufër, duke i dëmtuar së tepërmi. Po çfarë na kushton që t'i këputim kokrrat me dorë, duke u ngji-

tur në ulli me shkallë? Asgjë. Shkallët që do të na duhen kushtojnë një «kacidhe», siç thoshim përpara, prandaj të mos humbasim gjithë prodhimin e vitit të ardhshëm për një shpenzim shumë të vogël. Ne mund të bëjmë një herë disa shkallë që t'i kemi për një kohë të gjatë dhe t'i meremetojmë çdo vit kur të prishen. Në qoftë se nuk do t'i biem ullirit me dru, të jemi të bindur se do të marrim prej tij çdo vit prodhim të stabilizuar. Vjelja me krehër është akoma më e mirë. Ne për këtë qëllim sollëm edhe një makinë nga jashtë, të cilën e kam parë kur isha një vit më parë në Vlorë, por mua nuk m'u duk që ajo të bënte shumë punë.

SHOKU VASIL ANAGNOSTI: Ajo makinë rrëzon lastarët e shkatërron edhe pemët.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duam të marrim mesatarisht nga 50 kilogramë për çdo rrënjë ulliri në gjithë republikën dhe vazhdimisht, çdo vit. Kjo arrihet duke i prashitur, duke i spërkatur me solucione të ndryshme kundër sëmundjeve, duke i plehëruar, duke i ujitur, duke i vjelur me dorë.

Kultivimi i ullirit kërkon, pra, dituri të veçanta, njohuri shkencore, prandaj kurrë nuk duhet të kënaqemi me këto që dimë.

Më duket se, megjithëse për ndonjë shërbim fola fare shkurt, i thashë të gjitha ato që duhen bërë për ullinjtë, prandaj nuk kam çfarë të zgjatem. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë unë ju përgëzoj për punën që keni bërë dhe ju rekomandoj t'u bëni ullinjve të gjitha shërbimet e duhura. Pleq e të rinj ta doni ullirin me pasion të madh!

SHOKU VASIL ANAGNOSTI: Për disa nga pemët

e kemi zgjatur ciklin e vjeljes nga janari deri nga fundi i muajit prill.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe agrumeve duhet t'u vini rëndësi të madhe, se nevojiten për konsumin e popullit dhe për eksport.

Të keni parasysh, shokë, që socializmin duhet ta ndërtojmë me forcat tona, siç kemi vepruar gjër tani. Ndihma e miqve, e shprehur me shifra, ka zënë kurdoherë një përqindje të vogël përpara punës së madhe të popullit tonë për çdo vepër që ka ndërtuar. Kur ngremë një kombinat, duket sikur ndihma e të huajve është një gjë e madhe, por ajo nuk është kështu. Kontributi kryesor, në masën 85-90 për qind, kurdoherë ka qenë vetë puna dhe djersa e popullit tonë. Kur prodhojmë ne duhet të gjykojmë se frutat do t'i hajë populli, por një pjesë na duhet edhe t'i eksportojmë që të sigurojmë devizë dhe të blejmë ato mallra për të cilat nuk kemi akoma mundësi t'i bëjmë vetë. Nga bujqësia dhe nga pemëtaria ne kemi mundësi të eksportojmë shumë prodhime.

Partia ka bindjen se ju do t'i shtoni akoma më shumë përpjekjet dhe dituritë tuaja për ta bërë gjithë bregdetin tonë një nga vendet më të bukura të atdheut. Këtu, në këtë vend të mrekullueshëm, duhet të vazhdojnë të vijnë e të punojnë të rinj e të reja nga të katër anët e Shqipërisë. Pemëtaria, si: ulliri, agrumet, bajamet, fiqtë etj. që keni këtu, duan krahë pune. Prandaj është krejt pa kuptim të preferosh të sorollatesh kot në qytet e të mos vish të punosh këtu, në këtë vend kaq të bukur, ku edhe jeta të shtohet.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Jetë, jetë, siç thoshte Gogoja.

SHOKU ENVER HOXHA: Jetë! Jetë, thoshte Gogo Nushi, heroi i Partisë, një nga njerëzit më të shquar që ka nxjerrë Bregu. Kjo zonë ka nxjerrë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare shumë njerëz të shquar, siç thashë, si: Gogo Nushi, Kozma Nushi, Zaho Koka e të tjerë, por ka nxjerrë edhe heronj të ndërtimit socialist. Lufta që po bëjmë aktualisht është e madhe, e koklavitur. E zorshme është edhe lufta me pushkë, që e fituam për disa vjet, por sa «pushkë» kemi hedhur pas Çlirimit në këto vende, sa djersë është derdhur, ç'përpyetje janë bërë e do të bëhen akoma për ta zbukuruar këtë vend, për ta bërë atë gjithnjë e më shumë pjellor dhe të paprekshëm nga armiqtë! Sido që lufta për ndërtimin socialist është më e gjatë, ne kurdoherë kemi dalë me sukses, dhe kështu do të vazhdojmë, prandaj, kur Partia bën thirrje të punojmë në Bregdet, asnjë të mos kursehet.

SHOQJA ATHINA XHANI: Ne nuk iu kursyem luftës kur kërkohet gjak e jo më të kursehemi tashti që kemi gjithë këto të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, nënë. Me duart tona ne kemi siguruar gjithë këto të mira si këtu, që duhet t'ia bëjmë të njohura gjithë Shqipërisë.

Tani dëshiroj të them edhe pak fjalë për telekronistët, kinooperatorët, radiokronistët, fotoreporterët dhe gazetarët që ndodhen këtu. Këta janë punëtorë të dalluar, që meritojnë respekt dhe dashuri. Telekronistët dhe kinooperatorët janë njerëz me kulturë, janë artistë, që mendojnë, shikojnë, vërejnë dhe fiksojnë në filmat

që nxjerrin bukuritë e vendit tonë dhe jetën që bëhet te ne.

Të mos mendohet se punët i bëjnë aparaturat dhe makineritë. Natyrisht edhe këto kanë rolin e tyre, por janë njerëzit që i përdorin ato e që luajnë rolin kryesor. Për ta kuptuar këtë, mjafton të krahasojmë emisionet televizive të huaja me emisionet tona. Ndërsa televizionet e huaja reklamojnë gjalmat e këpucëve, bojën që duhet t'u vënë thonjve dhe llojin e kremit që duhet të përdorin gratë në fytyrë për t'u dukur më të bukura etj., punonjësit tanë të shtypit, të televizionit e të kinemasë punojnë me frymë realiste, socialiste dhe me një art të madh. Televizioni është bërë i dashur për këdo në vendin tonë. Ai është një ushqim i domosdoshëm e i përditshëm për të gjithë punonjësit. Çdo mbrëmje, i madh e i vogël, qëndron para ekranit dhe sodit bukuritë e gjithë Shqipërisë, shikon ç'ndodh brenda dhe jashtë vendit. Kur ndodh një ngjarje në Konispol, në mbrëmje atë e shikojnë njerëzit edhe në Majën e Hekurave, në Veriun e largët dhe anasjelltas.

Ne e dimë se ka disa zona ku akoma nuk shikohet televizioni ynë. Deri tashti kjo e metë nuk ka ardhur për fajin tonë, por le të mos e zgjatim këtu se kush e ka fajin. Qeveria ka marrë dhe do të marrë masa që ta plotësojë këtë boshllëk, për arsye se ka të bëjë me ushqimin e përditshëm shpirtëror të njerëzve tanë. Duke përgatitur kuadro të zotë, për këtë qëllim, ne do t'i zgjerojmë më tej programet televizive, që të mos fillojnë në orën 18⁰⁰, por më përpara, mundësisht që në orën 17⁰⁰, bile, po të jetë e mundur, të ketë emisione edhe në drekë.

Unë i njoh mirë punonjësit e radios, të televizionit, të kinematografisë dhe gazetarët tanë, por sidomos kur bëjmë udhëtime të tilla së bashku, i shikoj më nga afër. Ja, me aparaturat në krahë, që nuk janë të lehta, këta rendin me të shpejtë nga të katër anët e vendit gjatë ditës, punojnë e djersijnë, grumbullojnë materiale dhe pastaj ia hipin automobilin ose helikopterit dhe shkojnë në Tiranë për t'i përpunuar e për t'i transmetuar në radio e në televizion çdo mbrëmje, ngjarjet më të rëndësishme të ditës. Kur shikojmë televizionin ose dëgjojmë radion në mbrëmje, ne kënaqemi, por një meritë të madhe kanë për këtë punë ata që punojnë në këta sektorë. Prandaj, unë mendoj se duhet të jepen në televizion edhe emrat e atyre që i përgatitin emisionet, bile rekomandoj që këto të mos kalojnë aq fluturimthi në ekran, sa të mos lexohen. Kur duam, për shembull, një libër të Dritëro Agollit, atë e gjejmë në bibliotekë dhe mund ta lexojmë çdo herë që dëshirojmë, por emrin tuaj nuk e gjejmë kur të duam. Mirëpo këta emra të mjeshtërive të televizionit dhe të kinematografisë, janë të nderuar siç janë edhe ata të artistëve, të shkrimtarëve e të poetëve, prandaj duhen mbajtur mend, ata duhet t'i njohë populli. Ju keni krijuar vepra të bukura, prandaj këtu, në këtë vend kaq të bukur, dëshiroj t'ju falënderoj për punën tuaj.

NJË SHOK NGA RADIOTELEVISIONI: Faleminderit shumë! Rroftë shoku Enver Hoxha!

SHOKU ENVER HOXHA: Të rroni ju! Të rrojnë këta çeqot¹.

1. E ka fjalën për punonjësit e televizionit e të shtypit.

Dëshiroj që këto fjalë të miat të thjeshta për ju të transmetohen sonte në televizion. Unë e di që ju jeni modestë, por mund të flisni më pak për mua dhe këto që thashë mos i lini pa transmetuar.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Edhe për gazetarët duhet folur në televizor.

SHOKU ENVER HOXHA: Ke të drejtë ti, Nexhmije, unë nuk i përjashtoj nga radhët e atyre për të cilët fola as gazetarët. Kinooperatorët, radiokronistët, telekronistët, fotoreporterët, gazetarët, elektrikistët dhe gjithë personeli tjetër ndihmës, të gjithë punojnë së bashku, punojnë për një qëllim; puna e njërit lidhet dhe ndihmon atë të tjetrit. Po nuk punoi një tel, ndërpritet korrenti, mbetet aparati. Gazetarët, kronistët, spikerët, që i dëgjojmë me vëmendje dhe me etje, japin secili kontributin e vet të çmueshëm në këtë punë me vlerë të madhe edukative.

Unë dëshiroj të falënderoj, gjithashtu, tërë punonjësit e Bregut për punën e lavdërueshme që kanë bërë këtu në këto kodra të bukura. Të keni parasysh porosinë e Partisë për realizimin e tejkalimin e planit. Shtojeni akoma dashurinë për ullirin dhe për tokën dhe mendoni jo vetëm interesat e ndërmarrjes dhe tuajat, por të të gjithë republikës. Punoni që ta shtoni çdo vit e më shumë prodhimin e ullirit dhe të vajit që të mos jetë nevoja të importojmë më vaj nga jashtë. Kështu do të bëhet e mundur që të lirohen edhe tokat e mbjella me lule dielli dhe në to të prodhojmë më shumë misër e grurë.

Falënderoj, gjithashtu, gjithë shokët e tjerë që më

kanë shoqëruar, për punën e palodhur gjatë gjithë këtyre pesëmbëdhjetë ditëve.

Merrni të gjithë nga një portokalle që ta hamë së bashku. Tani po shkojmë. Suksese në punë!

Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDËS

A

Arkeologjia, arkeologët; kërkimet dhe zbulimet arkeologjike — 426-445, 463.

Arkitektura, arkitektët; detyrat e tyre — 272-273, 282-285, 286-287, 289-294, 295-297.

Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 33, 34, 35, 36, 89, 103, 116, 242, 310-311, 319, 320-321, 344, 390.

Arsimi në RPSSH; politika e Partisë për zhvillimin e tij. Mësuesit, nxënësit — 14, 91, 93, 201, 264, 308, 309, 373-374, 376, 460.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — 256-257, 320, 409.

B

Bashkimi Sovjetik (1917—1953) — 43, 90, 145, 146-149, 260-261, 326.

Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik; politika e jashtme. Qëndrimi armiqësor

ndaj PPSH dhe Shqipërisë — 103-104, 314-315, 341-342, 419-422;

— shkaqet e lindjes së revizionizmit në BS; tradhtia e tyre ndaj marksizëm-leninizmit. Degjenerimi i partisë, likuidimi i diktaturës së proletariatit — 99-100, 140-149, 169, 337, 419-420, 421.

Blegtoria në RPSSH — politika dhe direktivat e Partisë për zhvillimin e saj. Vendi dhe roli i blegtorisë në ekonominë popullore — 45, 49-51, 52, 56, 246, 251-252;

— përmirësimi racor i bagëtive; shërbimet në blegtori; produktet blegtorale dhe rritja e rendimenteve — 50-57, 251-253, 265-266;

— baza ushqimore në blegtori. Bagëtitë e imëta; lopa; derri. Bagëtitë e oborreve kooperativiste — 45-46, 52-57, 58-60, 250-251, 253, 328, 329-330;

- kuadrot, specialistët, punonjësit e blegtorisë; traditat blegtorale të popullit tonë — 45, 50, 51-53, 54, 55, 251, 252, 253, 265-266, 346-349.
 - Borgjezia, borgjezia e re revizioniste* — 98, 104, 106, 132, 139, 140, 141-142, 198, 312.
 - Bujqësia në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Vendi dhe roli i bujqësisë në ekonominë popullore* — 32, 44-47, 91-92, 245, 246-247, 251, 254-255, 306, 449-450;
 - organizimi i punës në bujqësi; agroteknika dhe shërbimet agroteknike; zbatimi i shkencës bujqësore — 5-6, 7-8, 9, 19, 20-21, 23-24, 264, 346-347, 404, 405, 408, 410-411, 412-413, 450, 451, 456, 473-477;
 - toka, trajtimi i saj; sistemimi dhe kullimi i tokave; hartat pedologjike — 9-10, 14-15, 93, 403, 404;
 - prodhimet bujqësore dhe rendimentet e tyre; drithërat, prodhimi i bukës — 18, 30-31, 46, 95, 113, 243, 245, 251, 403, 408;
 - pemëtaria (ulliri, agrumet, frutat); perimet; bimët industriale dhe ato mjekësore — 10, 30-31, 44-45, 46, 95-96, 115-116, 251, 406-413, 455-456, 469-477;
 - punonjësit, specialistët dhe kuadrot e bujqësisë; traditat bujqësore të popullit tonë — 19, 20-21, 23, 46-47, 264, 346-349, 409.
- C**
- Centralizmi demokratik* — 119-120, 133-134, 276-278.
- D**
- Dallimet thelbësore ndërmjet fshatit dhe qytetit, ngushtimi i tyre* — 92, 340.
 - Dënimet, masat ndëshkimore; puna parandaluese* — 58, 60, 171, 330-331, 464.
 - Dëshmorët* — 70, 230, 239.
 - Diktatura e proletariatit* — 164-165, 265.
 - Disiplina proletare; disiplina e punës dhe ajo tekniko-shkencore* — 27, 51-52, 54-55, 120-122, 135, 172, 264, 265-266, 404-405, 408, 410-411, 450-451.
 - Dituritë, përvetësimi i tyre* — 264, 311, 346-347, 373-374.

E

Edukimi komunist — 82, 88, 117-118, 119, 135, 160-161, 171-172, 204, 348-349;

— puna e diferencuar me njerëzit. Bindja dhe masat administrative — 15-16, 51, 52, 53, 57, 59-60, 62-64, 89-90, 161-175, 249, 250-251, 326-327, 330-332.

Ekonomia komunale; shërbimet komunale — 273-275, 277, 282, 286-287, 297, 298, 301.

Ekonomia popullore — stabiliteti, zhvillimi e përparimi i saj — 17-18, 19, 31, 32, 35-36, 40-41, 90-91, 117, 119, 160-161, 175-176, 325;

— struktura e degëve; organizimi dhe drejtimi i punës në ekonomi — 38, 134, 254-255, 306.

Ekspozitat — 182, 183-185, 281, 302.

Engels, Fridrih — 83, 84, 89, 98, 124, 126, 141, 159, 178, 247, 374, 424, 464-465.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 1, 3, 8-9, 16, 66-79, 80-82, 107, 109, 112, 135-136, 183, 187-188, 190-192, 193-194, 197, 198, 202-203, 210-211, 212, 213-228, 229-232, 233-234, 239-241, 244, 247-248, 249, 250-251, 255-254, 261, 266-269, 274, 279,

281, 282-283, 285, 286, 287, 289, 291, 293, 303-305, 300, 322-323, 326, 339, 351-369, 370-373, 376-377, 378-389, 390-397, 398-399, 402, 404, 406, 408, 414-415, 419, 425, 432, 433, 428, 444, 455, 459-460, 461, 463, 474, 480, 481-482.

Epoka jonë — karakteri dhe kontradiktat themelore të epokës — 100-101, 102, 139-140, 141-142, 152-154, 258-259, 312-313, 314-315.

Estetika marksiste-leniniste, shifjet estetike — 186, 465.

Evropa, «sigurimi evropian»; konferencat për «sigurimin evropian» — 21, 139, 157, 315, 342-343, 383, 420.

F

Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, objektivë dhe subjektivë — roli i tyre në shoqëri — 31, 88, 96-97, 105-106, 132, 313, 314, 477.

Fashizmi, rreziku i fashizmit; lufta kundër tij — 131-132, 312.

Feja, lufta kundër mbeturtnave fetare dhe zakoneve prapanike — 167-169, 249-250.

Folklori, politika e Partisë për zhvillimin e tij. Festivali i

Tretë Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës (1978) — 80, 192, 193, 194-196, 198-199, 200, 201-202, 459;

— muzika dhe kënga popullore — 86, 194-195, 226-227, 232, 233, 236, 238, 241, 246, 266-269, 317-318, 332-333, 378-379, 391.

Franca; gjendja e brendshme; historia dhe kultura e Francës — 8, 16, 34, 37, 105, 154, 194, 197-198, 203, 289, 332, 343, 390, 436-437.

Fshatarësia; fshatarësia kooperativiste — politika e Partisë ndaj saj; detyrat e fshatarësisë në ndërtimin e socializmit — 57-60, 92, 170-172, 246-247, 249, 306, 325, 326-331.

Fshati socialist; përmirësimi i gjendjes ekonomike e social-kulturore të tij — 92-94, 121-122, 170-171, 183, 402-403, 415-417.

Fuqia punëtore; sigurimi i saj; lëvizja e fuqisë punëtore qytet-fshat — 413-414, 415-417.

G

Greqia; historia dhe kultura e popullit grek; qëndrimi dhe marrëdhëniet me Shqipërinë

— 87, 196, 303-304, 316-319, 332, 333-334, 341, 342, 368, 383, 428, 433-434, 471.

Gruaja dhe vajza shqiptare, politika e Partisë për emancipimin e tyre — 93, 94, 182-183, 184, 186-187, 225, 250, 374.

GJ

Gjirokastra, traditat; zhvillimi ekonomik e socialkulturore i saj — 1, 66-79, 80, 84, 91, 107, 109, 111-117, 136, 182-188, 190-192, 202, 217, 221, 238, 240, 253, 270-302, 304, 336, 339, 349, 362-363, 365, 368, 384, 391, 393, 396-397, 406, 438, 443, 453, 457.

Gjuhësia — studimet gjuhësore. Gjuha shqipe — 304, 308-309, 433-436, 462.

Gjykatat e fshatrave — 171, 330, 331.

II

Historia e filozofisë paramarksisiste, filozofët; mendimi filozofik i rilindësve tanë — 197, 199, 206, 235, 304, 399-401, 461.

Historia e popujve të botës, e kulturës dhe e qytetërimit

të tyre. *Historia si shkencë, objektiviteti shkencor* — 16, 83, 138, 199, 201, 303-304, 302-384, 425-426, 429, 430-435, 436-437, 443-444, 468, 469, 470.

Historia e Shqipërisë

— historia e lashtë e popullit shqiptar dhe e kulturës së tij; prejardhja e popullit shqiptar. Pe-lazgët. Ilirët — 83, 434, 461-463;

— luftërat e popullit shqiptar për liri, pavarësi dhe përparim shoqëror. Qëndrimet armiqësore të fuqive Imperialiste ndaj Shqipërisë dhe popullit shqiptar — 82, 83-88, 232-242, 257, 268;

— Rilindja Kombëtare Shqiptare, rilindësit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881) — 85-87, 199, 232-235, 237-238, 239-241, 316, 355, 399-401, 458, 460-461;

— periudha e feudalizmit në Shqipëri dhe e kalimit në kapitalizëm. Pushtimi turk dhe regjimi feudalo-borgjez i Zogut — 11-16, 232-241, 336, 339, 353-354, 356;

— bashkëpunimi, lidhjet dhe solidariteti i popullit shqiptar me popujt fqinjë

në luftërat për liri e pavarësi — 316-318, 341;

— shkrimet, studimet, dokumentet, studiuesit për historinë e Shqipërisë. Trajtimi materialist dialektik dhe rëndësia e studimit të historisë së Shqipërisë. Historianë dhe dijetarë të huaj për historinë e Shqipërisë — 11-17, 199-200, 203-205, 462-463.

Hungaria; Partia e Punonjëse të Hungarisë — 150, 337.

I

Imperializmi, tipare të tij. Shoqëritë shumëkombëshe; eksportimi i kapitalit — 132, 152, 208-209, 258-259.

Industria e rëndë në RPSSH; industria minerare — 35-36, 61, 90-91, 134, 255-256, 306.

Interesi i përgjithshëm dhe ai vetjak — 57-60, 327-331, 463.

Internacionalizmi proletar — 304-305, 307, 308-310.

Investimet, politika e Partisë në fushën e investimeve — 299-301.

Italia; gjendja e brendshme; qëndrimi ndaj Shqipërisë — 16, 18, 37, 105, 131-132, 155, 197, 257, 313, 390, 471.

J

Jetesa në shoqërinë tonë socialiste — 32, 36, 55, 186.

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; politika e jashtme; agjenturë e imperializmit. Qëndrimi armiqësor ndaj Shqipërisë — 34-35, 150, 151, 209, 327, 458;

— *degjenerimi kapitalist i saj; gjendja e brendshme; çështja nacionale në Jugosllavi* — 37, 98-99, 150-151, 208, 337, 338-339, 458-459.

K

Kapitalizmi — karakteristika të përgjithshme të zhvillimit të tij; kriza, kontradiktat, kalbëzimi dhe pashmangësia e zhdukjes së tij — 32, 34, 37-38, 84, 104-105, 131-133, 139-140, 141-142, 147-148, 152-154, 178, 258, 312-315, 344, 417-418.

Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive të tyre; Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Fierit — 2, 6;

— *Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit dhe ai i Qytetit të Gjirokastrës; këshilltarët,*

detyrat e tyre — 271, 273-282, 284-285.

Këshilli i Ministrave (Qeveria) — 39, 87, 119, 123, 133, 134, 294, 307, 403, 417, 479.

Kina, Partia Komuniste e Kinës; vija e saj — 124, 205-206, 323, 324;

— *zhvillimi i kapitalizmit në Kinë; gjendja e brendshme; klasat dhe lufta e klasave, qëndrimi ndaj borgjezisë* — 124, 125-128, 151-152, 207;

— *strategjia dhe taktikat, përpjekjet për t'u bërë superfuqi; lidhjet me ShBA, me shtetet kapitaliste dhe me klikat reaksionare* — 128-130, 151, 207, 209;

— *roli sabotues i saj në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë* — 31-32, 33, 35, 40, 97, 125, 128-130, 207-208.

Kinematografia, filmi në RPSSH dhe punonjësit e saj — 284, 478-479, 480, 481.

Klasa punëtore në Shqipëri; roli dhe detyrat e saj në ndërtimin e socializmit — 85, 91, 94, 160, 181.

- Klasa punëtore në vendet borgjeze e revizioniste (proletariati); misioni historik i saj* — 81, 104, 139-140, 141-142, 152, 178, 265, 312, 417.
- Klasat dhe lufta e klasave* — 83;
- klasat dhe lufta e klasave në socializëm; lufta e klasave në frontin ideologjik. Zhvillimi drejt luftës së klasave; lufta kundër shfaqjeve sektare dhe oportuniste 89, 163-176, 179-180, 340;
 - lufta e klasave në kapitalizëm — 104-105, 139-140, 152-154, 312-313, 315.
- Kolektivizimi socialist i bujqësisë — thelbi dhe detyrat e tij* — 247, 249, 251, 326-328.
- Kolonializmi, neokolonializmi* — 152-153.
- Kombi — pakicat kombëtare; qëndrimi ndaj tyre* — 99, 304-305, 307, 308, 336-339.
- Komunisti, detyrat e tij; roli pararojë i komunistëve* — 48, 177, 178-179, 260.
- Komunizmi* — 161-162, 173, 338, 375.
- Kontradiktat joantagoniste në shoqërinë tonë dhe rrugët e zgjidhjes së tyre* — 62-63, 89-90, 179-180.
- Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë; ndihma dhe kontrolli* — 24-26, 28-30, 133-134.
- Kooperativat bujqësore; kooperativat e tipit të lartë; organizimi dhe drejtimi i punës, ndihma dhe kontrolli. Organet drejtuese dhe kuadrot në kooperativa, kooperativistët* — 25-31, 59, 60, 171-172, 345-346, 347-349;
- parcelat e kooperativistëve dhe tufëzimi i bagëtive — 57-60, 328, 329-330.
- Kosova dhe popullsia tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi* — 99, 195, 234-235, 338-339, 458-459.
- Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve; kuptimi marksist-leninist i tyre* — 31-32, 40, 97, 208-209, 326, 477.
- Kritika dhe autokritika* — 63, 123, 133, 134, 447.
- Kuadrot, specialistët; politika e Partisë me kuadrin; roli dhe detyrat e tyre në ndërtimin e socializmit* — 19, 23, 24-26, 39, 96-97, 118, 119-122, 167, 180-181, 200, 310, 346-347, 448, 450-452.
- Kultura botërore dhe qëndrimi ndaj saj* — 205-206, 289.
- Shih edhe: Historia e popujve të botës, e kulturës dhe e qytetërimit të tyre...*
- Kultura në RPSSH; politika*

e Partisë në fushën e kulturës — 10-11, 17, 19, 93, 161, 198-199, 200-202, 205, 444-445, 460, 468-469.

L

Lenin, Vladimir Iljç — 84, 85, 88, 89, 98, 99, 104, 106, 124, 126, 132, 141, 145, 147, 148, 149, 150, 152, 154, 157, 159, 178, 208, 247, 249, 259, 260, 265, 312, 313, 327, 345, 374, 388, 424, 464, 465.

Letërsia dhe artet në RPSSH: politika e Partisë për zhvillimin e tyre — 17, 193, 196, 205, 362-363, 405-406, 459-460.

Letërsia dhe artet përparimtare botërore — 193-194, 196-198, 203, 431.

Lëvizja marksiste-leniniste, partitë m-l; marrëdhëniet ndërmjet partive marksiste-leniniste — 102-103, 107, 125, 133, 313-314.

Libri, puna me librin. Literaturë e huaj, shfrytëzimi i saj — 115-116, 443, 444.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar — 85, 233, 239, 241-242, 243, 305, 341, 478.

M

Marksizëm-leninizmi — bu-

sull dhe udhëheqja për veprim; zbatimi krijues i tij — 43, 85, 94, 107, 119, 131, 158, 159, 168, 206, 265, 309-310, 311, 324, 464-465.

Marks, Karl — 83, 84, 85, 89, 98, 104, 124, 126, 141, 145, 143, 150, 157, 159, 178, 198, 208, 247, 265, 309-310, 311, 312, 314, 327, 374, 424, 464, 465.

Mbështetja në forcat e veta — 32, 35, 40, 91-92, 95, 96, 130, 477.

Mbrojtja e atdheut, forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të gjithë vendit për mbrojtje — 36, 100, 103, 209-210, 255-257, 258, 319-321, 340, 344, 423, 463.

Mërgimi, shqiptarët e mërguar — 210-212, 334.

Ministritë

— Ministria e Industrisë dhe e Minerave — 134;

— Ministria e Energjetikës — 3;

— Ministria e Bujqësisë — 324, 456;

— Ministria e Tregtisë së Jashtme — 134.

Minoriteti grek në Shqipëri, politika e Partisë dhe kujdesi i pushtetit popullor për minoritetin — 109, 116-117, 120, 202, 303-305, 306-310, 316, 322, 323-324, 332, 333, 334,

336-337, 338-339, 340, 341, 345, 349-350.

Monumentet e kulturës në Shqipëri; restaurimi i tyre — 272-273, 282-301, 427, 428, 429-430, 433, 436-445.

Morali, virtytet; guximi revolucionar. Edukimi me parimet dhe normat e moralit komunist — 35, 51, 62-63, 109, 122-123, 135, 136, 175, 418.

Muzetë; Obelisku dhe Qendra Kulturore Muzeale e Gjirokastrës — 71-72, 287, 351-359, 360-364, 367, 368, 369, 392, 401.

N

Nafta; shpim-kërkimet, studimet në naftë — 3-5.

Ndërtimet në RPSSH; plani rregullues i qyteteve, studimet dhe organizimi i punës. Traditat e popullit në ndërtim — 271-274, 279-281, 282-301, 321.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri

— rindërtimi i vendit — 35, 135, 326;

— karakteristikat e tij; zhvillimi i pandërprerë dhe konsolidimi i shoqërisë socialiste — 32, 33, 48, 61-62, 88, 94-95, 130, 137-138, 158-160, 242-246,

255-257, 305-306, 309, 335, 337-338, 340-341, 345, 375, 423, 447, 478;

— ndërtimi i socializmit në fshat — 92-94, 246-247, 249, 251, 306, 326-328, 345-346;

— socializmi dhe njeriu, roli i socializmit në zhvillimin e gjithanshëm të njeriut — 95, 167, 176-177, 322, 328-329.

O

Organizata-bazë e Partisë; detyrat e saj — 167, 172, 329, 331-332.

Organizatat e masave; detyrat e tyre — 167, 280.

Organizimi dhe drejtimi — 24-26, 65, 133-134, 171, 347, 447-449.

P

Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat; ndërtimi dhe jeta e brendshme

— vija e Partisë për ndërtimin e socializmit. Masat e marra nga Partia për t'i prerë rrugën revizionizmit dhe për të çuar përpara revolucio-

- nin — 11, 36-37, 42, 43, 47, 48, 90-96, 117-120, 123, 125-126, 127, 130, 137-138, 142-144, 152, 158-181, 244-257, 305-306, 309-310, 323, 324, 326-332, 335, 345-346, 423-424, 448;
- rolli udhëheqës i Partisë. Vendime, direktiva; njohtja dhe zbatimi i tyre — 50, 56, 85, 88, 122, 130, 159, 163, 176, 181, 241-243, 244, 305, 348-349, 447-449, 451-452;
 - vija e masave, lidhjet e Partisë me popullin, puna me njerëzit — 15-16, 24-26, 47-48, 62-64, 65, 82, 260, 331-332;
 - karakteristikat e Partisë; besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit; mbrojtja dhe zbatimi i tij — 42-43, 82, 84-85, 89, 98, 121-127, 131, 163, 259, 305, 307, 308, 423, 464-465;
 - metoda dhe stili i punës së Partisë; ndihma dhe kontrolli për bazën. Punimi i materialeve të Partisë — 1-2, 18-19, 24-26, 133-136, 190, 447-449, 451;
 - qëndrimi i Partisë ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj njerëzve që gabojnë; qëndrimi i Par-

tisë ndaj të përjashtuarve nga Partia — 1-2, 47, 62-63, 89-90, 133-134, 164-175, 260;

- materialet, studimet për organet udhëheqëse; informimi në Parti — 119, 123, 130, 446.

Partia e Punës e Shqipërisë

— *organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe*

- Kongresi VII i PPSH — 64, 100, 102, 110, 130, 347;
- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretarlati i KQ — 1-2, 18, 31, 38-39, 44, 87, 119, 123, 130, 135, 326, 345, 403;
- Plenumi i 2-të i KQ (28—29 qershor 1977); Plenumi i 3-të i KQ (17—18 nëntor 1977); Plenumi i 4-t i KQ (30—31 janar 1978) — 17-19, 32, 110, 117, 124, 451;
- organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve të Gjirokastrës, të Fierit dhe të Sarandës — 1, 2, 3, 4, 5, 17-18, 48, 109, 280, 446, 449, 451, 452.

Partia e Punës e Shqipërisë

— *politika e jashtme*

- politika e jashtme parimore; trajtimi materialist-dialektik i fenomeneve të shoqërisë — 64,

- 100-103, 129, 131, 138, 259-260, 315-316, 422-423;
- demaskimi i revizionizmit sovjetik dhe atij jugosllav — 98, 100, 342, 419-422;
 - qëndrimi ndaj PK të Kinës dhe RP të Kinës — 31-32, 124, 125-127, 129, 130.
- Partia Komuniste e Francës, e Italisë dhe e Spanjës* — 37, 106-107, 154-155, 156-157, 390-391.
- Patriotizmi, patriotët; edukimi patriotik* — 308-309, 330-337, 353-354, 357, 361-362.
- Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj* — 6-7, 44, 263-264, 311, 450, 472.
- Planifikimi i ekonomisë popullore; politika e Partisë në fushën e planifikimit* — 3, 19, 119-120, 324-325;
- plani i 6-të dhe i 7-të pesëvjeçar. Realizimi i planeve — 26-31, 38, 40-42, 44, 47, 119, 130, 133, 324-325, 449, 451.
- Politika dhe ideologjia — trajtimi ideopolitik i problemeve* — 15-16, 36-37, 38, 41-42, 61-64, 107, 138, 158-160, 173, 175-179, 181, 323, 330.
- Politika e jashtme e RPSSH* — parimet themelore marksiste-leniniste të politikës së jashtme — 100, 257, 310-319, 342, 343-344, 418, 422-423, 456;
- rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSSH në botë. Të huajt për Shqipërinë — 8-9, 18, 42, 64, 92, 108, 131, 195-196, 203-204, 209, 259-260, 315-316, 332, 333-334, 340-341, 343-344;
 - marrëdhëniet me vendet fqinje dhe qëndrimet e drejta parimore ndaj tyre — 34-35, 67, 99, 190, 257, 318, 341, 342;
 - marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor ndaj RP të Kinës; marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Turqisë — 31-32, 33, 87, 97;
 - propagandimi i PPSH dhe RPSSH në botë — 131, 195-196, 332-333, 334.
- Polonia; Partia e Bashkuar Punëtore Polake* — 149-150.
- Populli shqiptar; cilësitë, traditat patriotike dhe kulturore të tij* — 36, 62, 82, 83-84, 97-98, 176, 196, 232-242, 319, 331-332, 363, 418, 422, 460.
- Shih edhe: Historia e Shqipërisë — luftërat e popullit shqiptar...*
- Popullsia — demografia* — 271, 414.
- Praktika dhe teoria — unite-*

ti dialektik i tyre; praktika bazë e njohjes dhe kriter i së vërtetës — 19-23, 122, 244, 245, 246, 264-266, 311, 346-347.

Prodhimi material; sasia, cilësia — 94, 95-96, 183-185, 186, 188, 412, 417.

Prona në RPSSH. Prona socialiste (shtetërore dhe e grupit) — kuptimi dhe qëndrimi socialist ndaj pronës — 57, 171-172, 249, 327, 328, 330-331, 345-346;

— oborri kooperativist; politika e Partisë për oborrin kooperativist — 57-60, 171, 247-248, 249, 327-330.

Propaganda, agjitacioni; përmbajtja dhe detyrat e saj — 166-169, 348-349.

Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist — 210-211.

Psikologjia mikroborgjeze, lufta kundër shfaqjeve të saj — 57, 59-60, 171, 247-248, 249, 327-328.

Puna — kuptimi i saj, qëndrimi socialist ndaj punës; puna vullnetare — 15-16, 23, 264, 273-274, 279-280, 281-282, 300.

R

Radiotelevizioni Shqiptar, pu-

nonjësit e tij — 284, 460, 478-481.

Reforma Agrare — 246-247, 306, 327.

Revizionizmi modern; partitë revizioniste — 42, 106-107, 132, 139, 140-144, 154-155, 157, 313, 314, 331, 417-418, 465.

Revolucioni socialist proletar — revolucionit dhe çlirimit i popujve — çështje e shtruar për zgjidhje. Faktorët objektive dhe subjektive për shpërthimin e revolucionit — 88, 104-106, 107, 132-133, 139-140, 152-154, 258-259, 312-313, 314;

— pashmangësia e tij; revolucionit me dhunë si kusht për kalimin nga kapitalizmi në socializëm — 84-85, 141-142, 313-314;

— roli sabotues i borgjezisë dhe i revizionizmit për revolucionin proletar — 139-140, 154-155, 157, 313, 314.

Revolucioni tekniko-shkencor në RPSSH; thelbi dhe detyrat e tij — 38-40, 94, 118, 119, 120.

Rezervat shtetërore — 92, 255, 321.

Rinia në RPSSH — udhëheqja dhe kujdesi i Partisë për rininë. Rinia, bartëse e stafetës së revolucionit — 180-181, 244, 374-376, 399, 415;

— roli i saj në ndërtimin e socializmit. Edukimi patriotik i saj, edukimi me dashurinë për fshatin — 92, 114, 121-122, 161, 172, 204, 239, 244-245, 256-257, 261, 333, 374, 414, 415, 416-417, 467, 477.

RR

Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për çarjen e tyre — 32-35, 158.

S

Saranda; zhvillimi ekonomik e socialkulturor i saj — 391, 398-399, 443, 446, 449-450, 452, 453, 454, 455, 459.

Socializmi, teoria marksiste-leniniste për ndërtimin e socializmit; shtrembërimi i saj nga revizionistët modernë — 124-128, 142-144, 145, 146-149, 150, 151-152, 418.

Shih edhe: Ndërtimi i socializmit në Shqipëri dhe PPSH — vijë e Partisë për ndërtimin e socializmit..

Stalin, Josif Vlsarionoviç — 43, 63, 89, 98, 99, 104, 124, 126, 133, 144-145, 146-148,

149, 151, 159, 178, 247, 249, 260-261, 326, 327, 345, 349, 374, 419-420, 424, 464.

Superfuqitë, strategjia e tyre; aleanca dhe kontradiktat sovjetico-amerikane — 101, 103-104, 314-315, 341-342.

SH

Shëndetësia në RPSSH; higjiena, profilaksia — 25, 274-275, 320, 404, 456-457.

Shfaqjet e huaja dhe mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve; lufta kundër tyre — 11-12, 62-63, 89, 167-169, 179-180, 463-464.

Shkenca botërore, shkencëtarët; zbulimet shkencore në fushën e mjekësisë — 19-20, 21-23, 400-409.

Shkenca në RPSSH; zhvillimi i saj, lidhja e saj me praktikën — 19, 20, 23, 246, 264-266, 311.

Shih edhe: Historia e Shqipërisë — shkrimet, studimet..

Shtetet e Bashkuara të Amerikës; gjendja e brendshme; politika e jashtme — 101, 103-104, 151, 210, 314-315, 323, 341-342.

Shtypi në RPSSH; gazetarët; punonjësit e shtypit — 352, 444, 478-479, 481.

T

Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre

- teoritë për darvinizmin social; për rolin e gruas në shoqëri; për revolucionin tekniko-shkençor — 83, 118-119, 206;
- teoritë e revizionistëve modernë për rrugët e kullimit në socializëm; për mohimin e proletariatit — 106, 118, 154-155, 157, 313, 314;
- teoria dhe praktika e revizionistëve Jugosllavë për vetadministrimin; teoria e «vendeve të pangazhuara» — 98-99, 150-151;
- teoritë dhe pikëpamjet ktheze për «tri botët», për imperializmin, për pluralizmin politik dhe ideologjik. Ksenofobia e tyre — 101-102, 128-130, 157, 205-207, 323, 324.

Tepelena; zhvillimi ekonomik e socialkulturor i saj — 49-62, 114, 136.

Tregtia e brendshme; punonjësit e saj; shërbimet ndaj popullit dhe kultura tregtare — 276, 277, 281-282, 302.

Tregtia e jashtme; importi,

eksporti — 32, 33-34, 40-41, 90, 91-92, 96, 302, 411-412, 454-455, 472.

U

Uniteti i popullit, uniteti Partii—popull — 47-48, 85, 88-89, 100, 163, 174, 180-181, 260, 304-305, 309-310, 331-332, 336-337, 339, 344, 463-464.

Urbanistika — 271-273, 279-280, 282-283, 286-288, 289-291, 292, 293, 296-301.

V

Vendet revizioniste; shkaqet e degjenerimit të tyre në kapitalizëm — 140-152, 169, 181, 247, 337.

Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre — 5-6, 133-134, 403, 450.

Vigjilenca revolucionare — 107, 177, 258, 320, 423, 463.

ZII

Zhvillimi dialektik — 24, 159-160, 161-162, 175-178, 179-181.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 459.
Agoll, Dritëro — 480.
Aleksandri i Madh i Maqedonisë — 425-426, 462, 470.
Alite, Namik — 288.
Anagnosti, Vasil — 467, 476-477.
Angoni, Sali — 299.
Anteu — 81.
Antoni, Mark — 429.
Aristoteli — 45, 304.
Arseni, Zogë — 69.
Artemisi — 437.
Avdalli, Xhevat — 213, 378, 379.
Avicena (Ibn Sina) — 21, 109.
Augusti — 429.

B

- Eabaramo, Abdyl — 220.
Baboçi, Kadri — 299.
Baçe, Hamit — 394, 395.
Bah, Johan Sebastjan — 102.
Bakiri, Hyso — 219.
Bakiri, Lime — 218.

- Bakiri, Nebo — 217-218, 219.
Bakiri, Saliko — 215.
Bakiri, Selim — 218.
Bakiri, Shahin — 387-388.
Bakiri, Zija — 217.
Bakiri, Zilfo — 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223.
Bakunin, Mihail — 99.
Balzak, Honore de — 108.
Basha, Rexho — 220.
Begin, Menahem — 129.
Berberi, Pëllumb — 386.
Berberi, Sako — 281.
Berberi, Vojsava — 386.
Bernar, Klod — 19-20.
Beruka, Koço — 185.
Bethoven, Ludvig van — 205.
Bierut, Boleslav — 149.
Bilali, Kamber — 392.
Bismark, Oto — 265, 268.
Bita, Pirro — 219.
Bize, Zhorzh — 193.
Boçari, Marko — 317.
Bonaparti, Napoleon — 205, 343, 436-437.
Bozo, Naunka — 2-3, 4, 5, 6, 9, 10-11, 15, 26.
Bregasi, Qemal — 114, 192.
Bruse, Fransua — 22.

Bubulina, Llaskarlina — 317,
318.

Budina, Dhlmosten — 425, 426,
427-429, 430, 431-432, 433-435,
436, 437-440, 441, 442, 444,
445.

Buharin, Nikolai — 99.

Buzi, Tafil — 226, 235, 230.

C

Cezari, Jul — 439.

Ç

Çajupi, Andon Zako — 414.

Çali, Lame — 381, 385.

Çali, Lilo — 380, 381, 382, 384,
385, 386.

Çali, Mihare — 381.

Çali (Berberi), Mine — 380.

Çall, Samo — 381.

Çan Kal Shi — 124, 127.

Çani, Fete — 230, 231.

Çani, Flamur — 263, 266-267.

Çani, Niazi — 267.

Çanole, Bedun — 223.

Çanole, Nure — 221, 223, 283,
290.

Çifligu, Ligor — 2, 6-7, 8, 9,
26, 44.

Çipi, Hasaf — 385.

Çipl, Kapo — 385.

Çubrilloviç, Vaso — 459.

Çu En Lal — 207.

Çuka, Pano — 202, 333, 352.

D

Dadaç, Ismail — 267.

Dalipi, Sami — 359.

Darvin, Çarls — 82.

Dekart, Rëne — 400, 461.

Demokriti — 304.

Demosteni — 425, 426, 432-
433.

Didëro, Deni — 197, 206.

Dilo, Lefter — 71-72, 73, 74,
202, 352-353, 354, 355, 357,
358-359, 360-361, 362, 367,
368, 369.

Dishnica, Esat — 395, 396.

Dobi, Eqrem — 299.

Dode, Alfons — 194.

Donzëlo, Fransua — 436, 437.

Doraçi, Hazize — 384-385, 386-
387.

Dudumi, Ahmet — 221.

DH

Dhima, Miho — 93, 304-305.

Dhrami, Çome — 67-68.

Dhrami, Mumtaz — 362, 363.

E

Efestioni — 426.

Elezi, Mehmet — 183-183.

F

Fico, Melo — 68.

Fico, Qani — 68.

Filipi II — 425.

Fino, Engjëll — 69, 224.
 Fino, Hadër — 224-225.
 Fino, Murat — 69, 224, 225.
 Fino, Naim — 221, 224.
 Fino, Xhemal — 224.
 Firdusi (Abu el-Qazim Hasan) — 382.
 Fontenela (Bernar le Bovi dë) — 22.
 Frakulla, Hysni — 4, 5.
 Franko, Françisko — 155, 156.
 Frashëri, Abdyl — 85, 86, 87, 235, 268.
 Frashëri, Naim — 85, 87, 235, 316, 401, 416.
 Frashëri, Sami — 85, 87, 199, 235, 401.

G

Gaxhello, Bejko — 221, 223, 272.
 Gega, Beso — 288.
 Gega, Muharrem — 299, 351, 356, 359.
 Gogo, Marianthi — 182-183, 184.
 Gonxhi, Eledl — 225.
 Gradecl, Sulo — 213, 215, 219, 222, 224.
 Grameno, Mihal — 236, 357.
 Gurl, Idriz — 289, 357, 361.
 Gurra, Sotir — 394, 395.

GJ

Gjebëro, Bazo — 291.
 Gjidede, Pavlo — 189.

Gjika, Llambi — 116, 117.
 Gjini, Rashide — 69-70, 73, 81, 107, 136, 186-187, 222, 225.
 Gjoleka, Zenel — 226, 227, 235, 236.

II

Hoxha, Nexhmije — 66, 73, 75, 76, 77, 114, 136, 183, 184, 185, 186, 187, 192, 195, 198, 203, 213, 214, 215, 216, 220, 221, 225, 228, 231, 243-244, 266, 267, 271, 272, 285-286, 287, 292, 294-295, 301-302, 359-380, 364, 366, 369, 370, 371-372, 373, 380, 383, 384, 390, 391, 392, 410, 413, 414, 435, 437, 438, 440, 441, 442, 458, 459, 463, 478, 481.
 Hamurabi — 435.
 Hasanl, Bufe — 184.
 Hasho, Ali — 13.
 Hipokrati — 408, 469.
 Hodo (mulla) — 202, 353.
 Homerl — 45, 201, 304, 430, 431, 469.
 Hormova, Fero — 67.
 Hoxha, Abdyl — 78, 290.
 Hoxha, Azis — 220, 226.
 Hoxha, Bale — 377.
 Hoxha, Bedulla — 191.
 Hoxha, Brikena — 77.
 Hoxha, Dashmir — 226.
 Hoxha, Dede — 224, 369.
 Hoxha, Fahrudin — 96.
 Hoxha, Faro — 224, 226, 369.

- Hoxha, Fejzi — 366.
 Hoxha, Feruze — 75, 76, 77,
 78, 79.
 Hoxha, Fetah — 222, 223-224,
 225, 226, 227, 366.
 Hoxha, Gjylo — 78, 368, 373,
 460.
 Hoxha, Halil — 240, 363.
 Hoxha, Haxho — 224.
 Hoxha, Hysen — 63, 69, 240,
 274, 339, 353, 354, 355, 361,
 368, 376, 380, 383.
 Hoxha, Iliaz — 353, 354.
 Hoxha, Muço — 227, 228, 363.
 Hoxha, Naxho — 225, 226.
 Hoxha, Nedret — 381.
 Hoxha, Neshet — 271, 272,
 273, 274, 275-276, 277, 278,
 280, 284-285.
 Hoxha, Nexhmo — 228, 274, 281.
 Hoxha, Raship — 96, 226.
 Hoxha, Resul — 365, 366-367,
 369.
 Hoxha, Riza — 75.
 Hoxha, Sano — 73, 75, 76, 192,
 215, 376, 377, 380, 381, 389,
 438.
 Hoxha, Tomor — 78.
 Hoxha, Valbona — 77-78, 79.
 Hoxhi, Koto — 234, 355.
 Hrushov, Nikita — 100, 140,
 419, 420, 421.
 Hua Kuo Fen — 127, 128, 151.

I

- Ibarruri, Dolores — 158.
 Ipsilant, Aleksandër — 317.

J

- Jakshiq, Petar — 339.
 Jani, Viktor — 114, 115, 116.
 Juka, Musa — 240, 241.
 Jupl, Mufit — 299.

K

- Kapo, Hysni — 113, 345, 392,
 459.
 Kabili, Nelo — 288, 289.
 Kalo, Isuf — 74-75.
 Kallajxhlu, Xhevat — 356.
 Kamani (mulla) — 355.
 Kan, Kubilai — 383.
 Kan, Xhengiz — 383.
 Karagjozi, Astrit — 214.
 Karagjozi, Sheraf — 287.
 Karagjozi, Tefta — 67, 214.
 Karajani, Kiço — 355, 356.
 Karajani, Niqi — 355-356.
 Karajani, Spiro — 355, 356,
 368.
 Karajani, Vangjel (Lele) —
 355.
 Karlos, Huan — 156.
 Karter, Xhimi — 105, 151.
 Karriljo, Santiago — 156-157.
 Kasi, Bajram — 75.
 Katro, Petraq — 395, 398.
 Katro, Vasil — 395.
 Kekezi, Fotaq — 351.
 Kelmendi, Ali — 393, 394, 395.
 Këllezi, Abdyl — 40, 120.
 Kënaçi, Avdulla — 221.
 Kleopatra — 429.

Klimi, Theodhori — 414.
 Koçi, Fejzi — 281.
 Koçi, Sefer — 222, 281.
 Kofina, Samuel — 392, 393.
 Koka, Zaho — 478.
 Kokalari, Abdurrahim — 226.
 Kokalari, Mexhit — 222.
 Kokëdhima, Persefoni — 66.
 Kollokotroni, Theodhor — 317.
 Konomi, Pavllo — 113, 344.
 Konjari, Elmaz — 370.
 Konjari, Fiqri — 370.
 Kore, Muslim — 75.
 Kostaqi, Ksenofon — 363.
 Kuka, Kasem — 291.
 Kuke, Pali — 216.
 Kupi, Abaz — 319.
 Kutra, Sokrat — 351, 359, 360,
 364.
 Kyri, Pjer — 23.

L

Lako, Miha — 394.
 Lengo, Spiro — 123, 210, 323-
 -324, 348.
 Libohova, Myfit — 238, 313,
 324.
 Lilati, Froso — 70.
 List, Franc — 196-197.
 Liu Shao Çi — 127.

M

Madamë Pompadur (Zhan An-
 tuanetë Puaso) — 22.
 Majani, Zahari — 435.

Malinovski, Rodion — 419.
 Manaj, Ali — 69, 111, 117, 136,
 212, 270, 397.
 Mao Ce Dun — 31-32, 97,
 127-128, 129, 151, 205.
 Marshe, Zhorzh — 154.
 Marubi, Kel — 362.
 Maskanji, Pietro — 193.
 Matushi, Mufit — 267.
 Menzelxhiu, Jashar — 401,
 456, 457, 465.
 Mezini, Bame — 324.
 Mezini, Lato — 75.
 Mikojan, Anastas — 420-421,
 422.
 Minga, Jani — 233-234.
 Miziri, Fete — 216.
 Mobutu, Sese Seko — 129.
 Molier (Zhan Baptist Pokë-
 len) — 197, 198.
 Molotov, Viaçeslav — 146.
 Monmuso, Gaston — 8-9.
 Moro, Aldo — 132.
 Mosko, Sokrat — 299.
 Muça, Vitori — 400.
 Muçi, Timo — 111-112, 113.
 Myrtaj, Lale — 229, 231.
 Myrtaj, Vehip — 229, 230.

N

Nushi, Gogo — 478.
 Naipi, Bule — 68.
 Negovani, Papa Kristo — 237.
 Nesha, Balil — 235, 238.
 Nishani, Omer — 202.
 Nushi, Kozma — 478.

O

- Omari, Sejdo — 291.
Orlando, Ruxhero — 42.

P

- Peristeri, Pilo — 393, 394.
Paçrami, Fadil — 193.
Pahlevi, Muhamed Reza —
129.
Pani, Jordan — 453, 454-455,
457.
Papamihali, Stefan — 362,
363-364.
Papapano, Thoma — 107, 355,
358, 360.
Paskali, Odhise — 71.
Përroi, Khano — 279.
Picari, Çelo — 235.
Pinkerton, Alen — 392, 393.
Pino (kako) — 301, 389.
Pinoçet, Augusto — 129.
Pirro i Epirit — 462.
Pompei (Pompeo Manjo Njeo)
— 439.
Popoviç, Vojisllav — 339.
Prishtina, Hasan — 87.
Prudon, Pjer — 99.
Pu Ji — 128.

Q

- Qemali, Ismail — 234.
Qemali, Mustafa — 237.

- Qiqi, Ilia — 308.
Qorri, Vehip — 202-203.
Qulli, Muço — 240-241.

R

- Radovicka, Petrit — 96.
Rakoshi, Matias — 150.
Rasin, Zhan — 431.
Robespier, Maksimilian — 203,
206.
Rumbo, Urani — 368.
Ruse, Zhan Zhak — 197, 206,
400.
Rustemi, Avni — 356.

S

- Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
— 355, 471.
Saadi (Muslah al-Din) — 445.
Selfo, Aqif — 286, 356, 370.
Selfo, Hasan — 286.
Selfo, Xhevdet — 286.
Selfo, Zenel — 286.
Selimi, Musa — 202.
Semiramis (perandoresha) —
468.
Sen-Zhyst (Lui Antuan) —
203.
Simixhlu, Ajjet — 72.
Sinoimeri, Violeta — 222.
Skob, Ronald — 341.
Sofokliu — 45, 304.
Spinoza, Baruh — 400.
Stefani, Mihal — 3.

Suarez, Adolfo — 156, 157.
Sulioti, Jorgo — 228.

SH

Shampolionl — 435.
Shekspir, Uiliam — 21.
Shkrapi, Janaq — 339.
Shliman, Hajnrih — 430, 441,
443.

T

Tahsini, Hasan — 199, 398,
399-400, 460-461.
Tarifa, Sevo — 244.
Tartale, Hamdi — 225.
Tashko, Tefta — 194.
Ten Hsiao Pin — 323, 324.
Tepelena, Ali pashë — 71, 288,
317, 436, 437.
Tito, Josip Broz — 98, 99, 151,
420.
Tona, Dhimitër — 72.
Toptani, Esat pashë — 241.
Topulli, Bajo — 234, 236, 237,
239, 240, 287.
Topulli, Çerçiz — 66, 226, 229,
232, 234, 236, 237, 239, 240,
241, 248, 264, 267, 286, 287,
291.
Topulli, Jonuz — 239, 240.
Toska, Hektor — 73.
Tremishti, Hajredin — 233, 239.

Trocki, Lev — 99.
Tushe, Bido — 68.
Tushe, Drita — 68.
Tutanhamon (faraon) — 441.

U

Ugolini, Luixhi — 440.

V

Vardhami, Sotir — 371, 372,
373.
Verdi, Xhuzepe — 193, 197.
Vigu, Bastri — 215.
Virgjili — 431.
Volter (Fransua Mari Arué)
— 197, 198.
Vrioni, Aziz — 13.
Vrioni, Kahreman — 13.

XH

Xhani, Athina — 398, 478.
Xhani, Miho — 399.
Xhani, Mitro — 398.
Xharahu, Leo — 188.
Xharahu, Niko — 188.
Xhavella — 317.
Xhaxhiu, Fejo — 388.
Xhaxhiu, Selami — 356-357,
388.
Xhaxho, Koll — 4.

- Xhebro, Feim — 114. 285, 288, 290, 295, 296, 367,
 Xheko, All — 231, 232. 380.
 Xheko, Kasëm — 231. Zazani, Farije — 371, 374.
 Xhepi, Kamber — 221, 272, Zazani, Hasan — 374.
 283, 285. Zazani, Teuta — 371.
 Xhiku, Masan — 234. Zeko, Aslian — 380.
 Xhiku, Hasim — 291. Zeko, Isuf — 380.
 Zere, Abdi — 191.
 Zere, Malo — 191.
 Zogu, Ahmet — 239, 240, 252,
 313, 336, 458-459.
- Z**
- Zani, Resul — 67, 68, 69, 74,
 136, 192, 213, 271, 274, 277,

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

Adriatik (deti ~) — 470, 471.
Afrikë — 104, 108, 315.
Akademia Franceze — 108.
«Albania» (revista ~) — 444.
Algjeri — 456, 471.
Amantia (qyteti i lashtë ~, Vlorë) — 463.
Amerika e Jugut — 315.
Amerika e Veriut — 108, 315.
Amfiteatri i Butrintit — 429-430.
Amfiteatri i tempullit të Delfit (Greqi) — 364-365, 430.
Amfiteatri i tempullit të Dodonës (Greqi) — 365.
Anadoll (Turqi) — 203, 434.
Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe i Valleve Popullore të RPSSH — 332.
Antigonea (qyteti i lashtë ~, Gjirokastër) — 432, 463.
Antipatrea (qyteti i lashtë ~, Berat) — 463.
Apoloni (qyteti i lashtë ~, Fier) — 432, 444.
«Arleziana» (libri ~, A. Do-

de) — 193-194.
«Arleziana» (opera ~, Zh. Blize) — 193-194.
Athinë — 425, 427, 430.
Australi — 411.
Azi — 101, 103, 139, 315.
Azia e Vogël — 468.

B

Babiloni — 468.
Ballkan — 237.
Beograd — 342.
«Bohema» (opera ~, Xh. Puçini) — 193.
Borovë (Kolonjë) — 216.
Bregu i Detit [Bregu] (Vlorë-Sarandë) — 453, 454, 473, 478, 481.
Britania e Madhe — 16, 105, 209.
Butrint (Ilqeni ~) — 419.
Butrint (Sarandë) — 419, 425, 427, 428, 429, 431, 438, 440, 442-443.
Bylis (qyteti i lashtë ~, Fier) — 463.

C

Cfakë (lagjja ~, Gjirokastër) — 291, 371.

CIA (Agjencia Qendrore e Shërbimit Informativ në ShBA) — 153.

Ç

Çekoslovakia — 455-456.

D

Dalmaci (Jugosllavi) — 470.

Damask — 400.

Dangëlli (Përmet) — 86.

Danub (lumi ~) — 462.

Dar-es-Salam — 131.

Delvinë (Sarandë) — 417.

Deti Jon — 209, 471.

Devoll (Korçë) — 415.

«Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve» (poema ~, N. Frashëri) — 316.

Dibër — 215, 271, 417, 458.

Dibër e Madhe — 458.

Dishnicë (Korçë) — 183.

Donofrosë (Berat) — 44, 96.

Drin (lumi ~) — 321.

Drino (lumi ~) — 321.

Dropull (Gjirokastër) — 109, 112, 113, 188, 202, 303, 304, 306-308, 321, 325, 333, 334, 335, 336, 338, 417.

DH

Dhërmi (Vlorë) — 471.

E

Elbasan — 457.

Elbë (ishulli ~) — 343.

«Emili» (libri ~, Zh. Zh. Ruso) — 206.

Enise — 444.

Erind (mall ~, Gjirokastër) — 112.

Euftrat (lumi ~) — 470.

F

Fabrika e Plastmasës [Uzina e Lëndëve Plastike], Lushnjë — 474.

Festivali Folklorik Ndërkombëtar i Dizhonit (Francë, 1972) — 195.

Fier — 1-17, 44.

«Filiqi Eteria» [«Shoqëria e miqve»] — 317.

Finiq (Sarandë) — 443.

«Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë» [Enciklopedia] (vepra ~, S. Frashëri) — 235, 401.

Fusha e Devollit (Korçë) — 7.

Fusha e Korçës — 7.

Fusha e Mursisë (Sarandë) — 402.

Fusha e Vurgut (Sarandë) —
403.

Fushëbardhë (Gjirokastrë) —
70.

G

Gorë (Korçë) — 7.

Gostivar — 458.

Grapsh (Gjirokastrë) — 335.

Greqia e lashtë — 45, 434.

GJ

Gjermani — 34.

Gjiri i Nartës (Vlorë) — 429.

H

Hazmurat (lagjja ~, Gjirokastrë) — 191, 354.

Helsinki — 342.

Hidrocentrali i Fierzës [Hidrocentrali «Drita e Partisë»] —
96-97, 321-322.

Hidrocentrali i Komanit [Hidrocentrali «Enver Hoxha»] —
41.

«Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (teksti ~) —
131.

Holandë — 461.

Hormovë (Tepelenë) — 257.

Hotel «Dajti», Tiranë — 385.

I

«Iliada» (poema ~, Homeri)
— 201, 430, 431.

Ilion [Trojë] (qyteti i lashtë ~)
— 431, 443.

Indi — 382-384.

Indonezi — 410.

Instituti i Folklorit [Instituti i Kulturës Popullore], Tiranë
— 200.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë — 286, 293.

Instituti i Naftës [Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Naftës e të Gazit], Patos — 5.

Irak — 456.

Izrael — 456.

J

Janinë — 233, 316.

Japoni — 127.

«Jeta fillon në 50 vjeç» (libri ~) — 81.

K

Kalaja e Gjirokastrës — 71, 72, 74, 75, 291.

Kalasë (lumi ~, Sarandë) —
403, 454.

Kamboxia — 101.

Kapshticë (Korçë) — 86.

Katavarosh (Korçë) — 393.

Kavajë — 249-250.

- Këneta e Maliqit (Korçë) — 394.
- Kios (ishulli ~, Greqi) — 201.
- Klubi i Opingarëve (Gjiroka-stër) — 365.
- Kolonjë — 86.
- Koman (Pukë) — 322.
- Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 97.
- Komuna e Parisit (18 mars 1871—28 maj 1871) — 265.
- Konferenca e Paqes e Parisit (1946) — 455.
- Kongresi i Berlinit (qershor 1878) — 86.
- Kongresi i Manastirit (1908) — 236.
- Kongresi i Vjenës (shtator 1814—qershor 1815) — 343.
- Konispol (Sarandë) — 442, 479.
- Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Strumit, Fier — 2.
- Kooperativa bujqësore e bashkuar «35 dëshmorët e Cepos» e Mashkullorës, Gjiroka-stër — 231, 232, 251-253, 262, 263-264.
- Kooperativa Bujqësore e Çukës, Sarandë — 414.
- Kooperativa Bujqësore e Markatit, Sarandë — 414.
- Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Grapshit, Gjiroka-stër — 341, 349.
- Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Lapardhasë, Berat — 46, 92-93.
- Korçë — 2, 6-7, 8-9, 44, 55, 58, 95, 183, 184, 252, 368, 393, 394, 395, 415, 453.
- Kore — 101.
- Korfuz (Greqi) — 436.
- «Koriolani» (drama ~, U. Shekspir) — 21.
- Korsikë (Francë) — 343.
- Kostancë (Rumani) — 393.
- Kotorr (Jugosllavi) — 209.
- Krujë — 472.
- Ksamil (Sarandë) — 402, 414, 415, 416, 417, 453, 454, 469.
- Kukës — 230.
- Kuvendi i Gjirokastrës (23 korrik 1880) — 85-86.

L

- Labëri — 91, 109, 188.
- Lajpcig (RD Gjermane) — 343.
- Laos — 101.
- Lezhë — 472.
- Libi — 440-441.
- Libofshë (Fier) — 13.
- Liceu i Korçës — 203, 393.
- Lidhja e Komunistëve (1847—1852) — 265.
- Lindja e Mesme — 434.
- Linja ajrore Tiranë—Athinë — 318.
- Lisbonë — 343.
- Londër — 265.

Lufta e Mashkullorës (18 mars 1908) — 239.

Lukovë (Sarandë) — 467-469, 477.

Lunxhëri (Gjirokastër) — 112, 188, 281, 416.

Lushnjë — 44.

LL

«Llaiko Vima» (gazeta ~) — 117.

M

Mali i Gjerë (Gjirokastër) — 237.

Mali i Zi — 86, 458.

Mallakastër (Fier) — 7, 9-10.

Manalat (lagjja ~, Gjirokastër) — 291-292.

Manastir — 237.

Mançuri (Kinë) — 127.

Mangalem (lagjja ~, Berat) — 286, 290-291.

«Manifesti i Partisë Komuniste» (K. Marks—F. Engels, vepra ~) — 309-310.

Maqedoni — 458, 459.

Mashkullorë (Gjirokastër) — 59, 229-233, 234, 243-244, 246, 261, 268, 293, 416.

«Mbi prejardhjen e llojeve» (libri ~, Ç. Darwin) — 82.

Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Moskë (1957) — 102.

Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor—1 dhjetor 1960) — 102.

Mesdhe (zona ~) — 45, 342, 453, 456, 471.

Mesopotami — 468, 470.

Miniera e Qymyrgurit e Mborje-Drenovës, Korçë — 210.

Miniera e Qymyrgurit e Memaliajt, Tepelenë — 61, 134.

Mollosia — 426.

Monpelle (Francë) — 194.

More (Greqi) — 317, 383.

Moskë — 421.

Myzeqe (krahu ~) — 7, 44.

N

NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) — 155.

Ndërmarrja Bujqësore e Gosës, Kavajë — 250.

Ndërmarrja Bujqësore e Pemëtarisë e Ksamilit, Sarandë — 413-414.

Ndërmarrja Bujqësore e Vrinës, Sarandë — 404.

Ndërmarrja e veshjeve «Bule Naipi», Gjirokastër — 136, 182-187, 188, 190.

Ninat (Sarandë) — 199, 400, 461.

O

Odisea (poema ~, Homeri) — 201, 430.

Opar (Korçë) — 7.
Organizata e Kombeve të Bashkuara — 404.

P

Palokastër (Gjirokastrë) — 245.
Palorto (lagjja ~, Gjirokastrë) — 68, 213-228, 282, 378-389.

Panarit (Korçë) — 7.
«Pararoja» (gazeta ~) — 72, 222, 352.

Paris — 226, 265, 343.

Patos — 3.

Pekin — 151.

Persi — 382.

Pesjak (Gjirokastrë) — 325.

Peshkëpi (Gjirokastrë) — 116.

Përmet — 114, 136, 192.

Përparim (Sarandë) — 471.

Pllakë (lagjja ~, Gjirokastrë) — 75, 290.

Pogon (Gjirokastrë) — 188, 389, 457.

Pompei (Itali) — 429.

Prizren — 85.

Pukë — 457.

Q

Qipro — 341.

R

Revolucioni Grek (1821) — 316-317.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917) — 145.

Romë — 132.

Rumanë — 34, 337, 394.

Rusi — 395.

RR

Rrëzomë (Sarandë) — 417.

S

Seman (zona ~) — 10.

Serbi — 86, 339, 459.

«Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm» (V. I. Lenin, libri ~) — 313.

Skandali «Lokhid» — 208.

«Skenat e jetës së bohemes» (libri ~, H. Murzhe) — 193.

Skrapar — 417.

Spanjë — 155-157, 471.

Stamboll — 235.

Stegopul (Gjirokastrë) — 70.

Stjar (Sarandë) — 413.

Suedi — 195, 332.

Suhë (Gjirokastrë) — 184, 325.

SH

Shampanjë (krahina ~, Francë) — 8.

Shangai (Kinë) — 127.

Shkodër — 109, 240, 241, 252, 302, 362, 417, 457, 462, 472.

Shkolla e mesme e përgjithshme «Asim Zeneli», Gjiro-

kastër — 370, 373.
 «Shpresa» (libri ~) — 408-409.
 Shqipëria e Jugut — 469.
 Shqipëria e Veriut — 321, 479.
 Shtëpia-muze «Vëllezërit Frashëri» — 86.

T

Tanzani — 131.
 Tatzat (mall ~) — 473.
 Teheran — 400.
 Tetovë — 458.
 Tigër (lumi ~) — 470.
 Tiranë — 10, 86, 87, 121, 239, 247, 472.
 Traktati i Shën-Stefanit (mars 1878) — 85.
 Tropojë — 411, 417.
 Tulon (Francë) — 343.
 Tunizi — 471.
 Turqi — 87, 195, 235, 338, 341, 342, 401, 458, 459.

U

Universiteti i Beogradit — 458.

Universiteti i Damaskut — 199.
 Universiteti i Kajros — 199.
 Universiteti i Stambollit — 199, 400.
 Uzina e prodhimeve të azotuaras «Gogo Nushi», Fier — 31.

V

Vietnam — 101, 103.
 Vlorë — 202, 234, 356, 368, 472, 476.
 Vrinë (Sarandë) — 402-403, 413, 417.
 Vrisera (Gjirokastër) — 345.

X

Xarrë (këneta ~) — 403.

Z

Zagorie (Gjirokastër) — 114, 115, 188.
 «Zosimea» (gjimnazi ~, Janinë) — 316.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 64-T

V—IX

1978

- PËR REALIZIMIN E PLANEVE KËRKOHEN ORGANIZIM DHE KONTROLL I VAZHDUESHËM — Nga biseda me kuadro kryesorë të organeve të Partisë, të pushtetit e të organizatave të masave të rrethit të Fierit (14 mars 1978) 1—48
- BLEGTORINË TA KENI MIRË NË QENDËR TË VËMENDJES — Nga biseda në takimin me kuadro drejtues të rrethit të Tepelenës (15 mars 1978) 49—85
- DUA TI SHOH TË GJITHA VENDET E TË ÇMALLËM ME GJIROKASTRËN — Nga bisedat gjatë ditës së parë të vizitës në Gjirokastrë (16 mars 1978) 66—79
- THESARET MË TË MËDHA JANË POPULLI DHE PARTIA — Fjala në mitingun me popullin në Gjirokastrë (17 mars 1978) 80—110
- POPULLI DHE PARTIA KANË FORCA TË MËDHA PËR TA NDËRTUAR VETË SOCIALIZMIN — Nga biseda në takimin me kuadro drejtues të rrethit të Gjirokastrës (18 mars 1978) 111—136

KUR E SOTMJA QËNDRON MBI THEMELE TË ÇELIKTA, E ARDHIMJA ËSHTË E SIGURUAR — Fjala e mbajtur me kuadrot e rrethit të Gjirokastrës (18 mars 1978)	137—181
BUKURIA QËNDRON NË THJESHTËSINË, ASHTU SI TRIMËRIA NË URTËSINË — Nga bisedat gjatë vizitës në ndërmarrjen e veshjeve «Bule Naipi» të Gjirokastrës (18 mars 1978)	182—189
KARAKTERI KOMBËTAR UA RRRIT EDHE MË TEPËR VLERËN KULTURËS E ARTIT — Nga biseda me disa kuadro kryesorë të rrethit të Gjirokastrës (18 mars 1978)	190—212
TASH QË U ÇMALLA ME NJERËZIT, ME RRUGËT E ME SOKAQET MË DUKET SE U BËRA MË I RI — Nga bisedat gjatë vizitës në lagjen Palorto të qytetit të Gjirokastrës (19 mars 1978)	213—220
TRADITAT PATRIOTIKE T'I RUAJMË TË PASTRA E T'I ÇOJMË MË TEJ — Nga bisedat gjatë vizitës në fshatin Mashkullorë (20 mars 1978)	229—262
PUNA JEP REZULTATE MË TË MIRA KUR BASHKOHET ME DITURINË E ME SHKENCËN — Nga biseda në takim me një grup kuadrosh të Mashkullorës (20 mars 1978)	263—269
NË ÇDO NDËRTIM E RESTAURIM, NË GJIROKASTËR, TË RUAJMË KARAKTERISTIKAT E QYTETIT — Nga biseda me kuadro drejtues të rrethit të Gjirokastrës (21 mars 1978)	270—302
MIQËSIA JONË ME POPULLIN GREK ËSHTË E LIDHUR ME GJAKUN E DERDHUR NË LUFTËN PËR LIRI E PAVARËSI KUNDËR TË NJËJTËVE ARMIQ — Fjala në mitingun në Grapsh me popullin e krahinës së Dropullit (22 mars 1978)	303—335

- NË SHQIPËRI ZBATOHEN PLOTËSISHT TË DREJTAT E MINORITETIT — Nga biseda me kuadro të kooperativës bujqësore të Vriserasë dhe asaj të Grapshit (22 mars 1978) 336—350
- KËTU NË GUR ËSHTË SHKRUAR LUFTA E MADHE E SHQIPTARËVE PËR ÇLIRIM DHE PËR ARSIM — Nga biseda gjatë vizitës në qendrën muzeale dhe në obelisk në qytetin e Gjirokastrës (23 mars 1978) 351—369
- TË JESH MËSUES ËSHTË NJË DETYRË E SHENJTË — Nga bisedat gjatë vizitës në shkollën e mesme «Asim Zeneli» (23 mars 1978) 370—377
- SA MË PËLQEN TË SHËTIT NË KËTO RRUGË! — Nga bisedat me banorë të lagjes Palorto (23 mars 1978) 378—389
- TAKIMET ME POPULLIN KURDOHERË MË JAPIN KËNAQËSI — Nga biseda me disa kuadro të rrethit të Gjirokastrës (23 mars 1978) 390—397
- NE JEMI KRENARË PËR BURRAT E SHQUAR QË KA NXJERRË TRUALLI YNË — Nga biseda gjatë vendosjes së kurorave në varrezat e dëshmorëve dhe në bustin e Hoxha Tahsinit, në Sarandë (25 mars 1978) 398—401
- SA MË PJELLORE TI BËJMË FUSHAT E MALET TONA, AQ MË E FORTË DO TË BËHET SHQIPËRIA — Fjala në mitingun e Ksamilit (26 mars 1978) 402—424
- KULTURA E POPUJVE DUHET STUDIUAR ME SERIOZITET E NDRERSHMËRI — Nga biseda gjatë vizitës në Butrint (26 mars 1978) 425—445
- ASNJË ORGAN E KUADRO NUK DUHET TË ECË PA PLAN TË DETAJUAR — Fjala me kuadrot e Partisë të rrethit të Sarandës (27 mars 1978) 446—452
- KUR SHOIHIM PËRPARIMET E VENDIT NA BËHET ZEMRA MAL — Nga biseda e lirë me drejtuesit kryesorë të rrethit të Sarandës (27 mars 1978) 453—460

LUKOVA TREGON KULTURË, MENDJE TË ZHVI- LLUAR E SHPIRT NOVATOR — Nga biseda me pu- nonjësit e Lukovës (28 mars 1978)	467—482
Treguesi i lëndës	483
Treguesi i emrave	499
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	507

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «8 Nëntori» Tiranë, 1989